


Komenti i
Librit te Teuhidit

Vëllimi - 1 -

Muhammed el-Uthejmin



Muhamed ibn Salih el Uthejmin

Komenti
i
Librit të
Teuhidit

Vëllimi I

Muhamed ibn Salih el Uthejmin

Komenti i Librit të Teuhidit

Titulli i origjinalit: *El Kaulul Mufid Ala Kitab et-Teuhid* (Fjala e dobishme në shpjegimin e librit të Teuhidit)

Përktheu nga arabishtja *Azem Bardhoshi*

Redaktor *Illir Haxhiaj*

Faqosja dhe korrektimi *Elton Gjeçi*

© të gjitha të drejtat janë të rezervuara për përkthyesin.

Dy fjalë nga përkthyesi

Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar. Lavdërimi, paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të Dërguarin e Tij, Muhamedin ‘alejhisselam., mbi familjen, shokët e tij dhe mbi ata që ndjekin rrugën e tij deri në ditën e Gjykimit.

Falënderoj Allahun që më bëri të mundur përshtatjen në gjuhën shqipe komentit e dijetarit të njohur Muhamed ibn Salih el Uthejmin për Librin e Teuhidit. Në këtë libër, komenti i shejh Ibn Uthejminit është paraqitur i plotë me përjashtim të disa pjesëve të detajuara që kanë të bëjnë kryesisht me analiza gjuhësore arabe e për të cilat është menduar se janë shumë specifike për t’u kuptuar nga lexuesi në shqip.

Teksti i “Librit të Teuhidit” është veçuar nga komenti i tij me anë të një vije në anë të tij. Kjo që ai të dallohet më lehtë për lexuesin.

Materiali është pasuruar me referenca dhe për hadithet që nuk gjenden në dy librat e hadithit të Burahut dhe Muslimit është vendosur vlerësimi i shejh Albanit për saktësinë e tyre. Gjithashtu janë vendosur edhe disa shënime, shumica e të cilave është marrë nga libri “Tejsirul Azizil Hamid” i shejh Sulejmanit.

Dua të falënderoj vëllain tim, Ismailin, i cili që shtytësi kryesorë për ta nisur këtë përkthim dhe personi me të cilin konsultohesha për çdo gjë që për mua ka qenë e vështirë në përkthim. Po kështu i jam mirënjohës edhe hoxhës Ahmed Kalaja i cili me vërejtjet e tij ka ndikuar në cilësinë e këtij materiali. Gjithashtu i jam mirënjohës çdokujt që ka dhënë kontributin e tij në këtë punim.

Së fundmi lus Allahun e Lartësuar që kjo punë modeste të jetë sinqerisht për hir të Tij dhe të jetë e dobishme për besimtarët shqiptarë.

Azem Bardhoshi
Mars 2010

Parathënie

Bismil-lahirr Rrahmanirr Rrahim.

Falënderimi, mirënjohja dhe lavdia i takojnë Allahut të Madhëruar! Vetëm Atij i kërkojmë ndihmë e falje dhe vetëm Atij i lutemi të na mbrojë nga e keqja që kemi në vetvete dhe nga pasojat e këqija të veprave tona. Atë që udhëzon Allahu askush nuk mund ta nxjerrë nga Udhë e Drejtë dhe atë që Ai e lë në humbje askush nuk mund ta udhëzojë. Dëshmojmë se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, të Vetmit, të Pashoqit, dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij. Lavdërimi, paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të, familjen e shokët e tij dhe mbi ata që e pasojnë atë me mirësi!

Allahut i takon falënderimi dhe mirënjohja që ne arritëm të shpjegojmë “*Librin e Teuhidit*” të shejhut të Islamit, Muhamed Ibn Abdul Uehabit, gjatë tubimeve tona në Xhaminë e Madhe në Unejze, dhe që disa nxënës i regjistruan mësimet tona.

Dy vëllezërit e nderuar dr. Sulejman el Abdullah Ebu el Hajli dhe dr. Halid el Alij el Mishekahu ishin ata që morën nismën të transkriptonin regjistrimet e zërit dhe t’i botonin ato në formën e një libri, me titull “*El Koul el Mufid ala Kitab et Teuhid*”. Lus Allahun e Lartësuar që t’i shpërblejë ata me të mira dhe ta bëjë të dobishme këtë vepër të tyre!

Dihet se ligjëratat e folura ndryshojnë nga gjuha e shkruar, prandaj gjatë transkriptimit të një ligjërate në tekst të shkruar shfaqen probleme. Këto probleme dolën në pah në botimin e parë, ndaj libri u rimor, u redaktua dhe u korrektua, pastaj u botua për së dyti. Megjithatë rishikimi i tekstit që përsëri i nevojshëm dhe ja,

tani, ai po përgatitet të dalë në qarkullim për herë të tretë.

Mendova që kësaj here të hiqen nga libri të gjitha shënimet me përjashtim të treguesve të ajeteve kuranore dhe haditheve.

Lus Allahun që kjo punë të ketë qenë veç për Fytyrën e Allahun, për kënaqësinë e Tij, e dobishme për robërit e Tij, sepse Ai është Bujari dhe Fisniku!

Autori (Muhamed Ibn Abdul Uehabi, Allahu e mëshiroftë!) shkruan (në titull):

“Libri i Teuhidit”

Në kopjen që kemi në dorë nuk përmendet që ky libër të ketë një hyrje të tijin. Ose kjo nuk i ka rënë në dorë kopjuesit, ose dijetari e ka parë si të mjaftueshëm vetëm titullin, pasi ai përmban edhe temën e librit: *teuhidin*.

Sipas kuptimit leksikor “*teuhid*” përkufizohet: “përnjësimi i diçkaje, konsiderimi i saj si një e vetme”; ndërsa si term fetar, “*teuhid*” do të thotë: njësimi i Allahut në çdo gjë që është e posaçme për Të, qoftë në rrububije, uluhije, emra dhe cilësi.

Kësisoj, teuhidi është tri llojesh:

- 1- Teuhidi *rububije* (Njësimi i Allahut në veprat e posaçme të Tij).
- 2- Teuhidi *uluhije* (Njësimi i Allahut në adhurim).
- 3- Teuhidi *el esma ue sifaat* (Njësimi i Allahut në emrat dhe atributet e Tij).

Në Kuran llojet e teuhidit i gjen të përmbledhura në thënien e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “... Zot i qiejve e i tokës, dhe i gjithçkaje që gjendet mes tyre, kështu që adhuroni veç Atë dhe jini të vazhdueshëm e të duruar në adhurimin ndaj Tij. A mos dini ndonjë që është i ngjashëm me Të?” (Merjem, 65).

Teuhidi *rububije* (Njësimi i Allahut në veprat e posaçme të Tij).

Kjo do të thotë ta njësosh Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala) për sa

u përket çështjeve të krijimit, zotërimit dhe përkujdesjes ndaj krijesave.

▪ Ta njësoh Allahun në çështjet e krijimit do të thotë të besosh se nuk ka krijues tjetër veç Tij: “Vërtet Atij i përket krijimi, rregullimi i punëve të krijesave, urdhërimi dhe ligjënia.” (Araf, 54). Kjo fjali, sipas gjuhës arabe, shpreh kufizim të veprimit për një subjekt. Po kështu edhe nga thënia e Allahut: “A ka krijues tjetër përveç Allahut që t’ju furnizojë nga qielli dhe nga toka?” (Fatir, 3), kuptohet qartë se krijimi i përket vetëm Allahut, kjo ngase këtu kjo pyetje është pyetje sfiduese.

Ndërsa për “krijimet” që aludohen në ajetin, “i Lartësuar me madhësi goftë Allahu, më i miri i krijuesve” (Mu’minun, 14) dhe në thënien e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) lidhur me ata që bëjnë figura qeniesh me shpirt, “... atyre do tu thuhet: ‘Jepuni jetë atyre që keni krijuar’”, themi se në këto raste nuk flitet për krijim e mirëfilltë. Krijim i mirëfilltë është atëherë kur diçka sillet në ekzistencë pa ekzistuar më parë në çfarëdo lloj forme; ndërsa këtu kemi vetëm shndërrim të diçkaje nga një gjendje në një gjendje tjetër. Gjithashtu, ky lloj krijimi nuk është gjithëpërfshirës, por i kufizuar brenda mundësive njerëzore, brenda një rrethi të ngushtë. Përfundimisht, asgjë nuk bie ndesh me përkufizimin e mësipërm: “Ta njësoh Allahun në çështjen e krijimit”.

▪ Ta njësoh Allahun në çështjen e sundimit do të thotë të besosh se krijesat nuk i sundon askush tjetër veç Krijuesit të tyre, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala): “Allahut i përket sundimi i qiejve dhe i tokës” (Ali Imran, 189) apo: “Thuaj: ‘Kush është Ai që ka në dorë zotërimin e çdo gjëje ...?’” (Mu’minun, 88).

E për sa u përket rasteve kur pohohet zotërimi i dikujt tjetër veç Allahut si për shembull: “... me përjashtim ndaj bashkëshorteve të veta dhe ndaj atyre që i kanë në *zotërimin* e tyre, për të cilat nuk qortohen.” (Mu’minun, 6), si dhe: “... ose në shtëpinë së cilës i zotëroni çelësat ...” (Nur, 60), në këto raste kemi të bëjmë me një zotërim gjithashtu të kufizuar që përfshin vetëm një pjesë fare të vogël të krijimit. Një njeri zotëron vetëm çfarë ka në pronësinë vet, e jo atë çka ndodhet në dorën e të tjerëve. Megjithatë, edhe ky lloj zotërimi është i mangët, sepse njeriu edhe atë që ka nuk e sundon në mënyrë absolute. Ai mund të veprojë me zotërimin e tij vetëm

sipas normave të Sheriatit. Për shembull, nëse ai do që ta djegë pasurinë e vet ose do që të ndëshkojë kafshën e vet, kjo nuk i lejohet. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) është Ai që sundon në mënyrë absolute.

▪ Ta njësosoh Allahun në çështjet e përkujdesjes ndaj krijesave do të thotë të besosh se askush tjetër veç Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) nuk i rregullon çështjet e krijesave:

“Thuaj (Muhamed): ‘Kush ju sjell furnizim nga qielli e nga toka dhe kush është zotëruesi i të dëgjuarit dhe të shikuarit? Kush e nxjerr të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Kush është rregulluesi i të gjitha çështjeve?’ Do të thonë të gjithë: ‘Allahu’. Thuaju: ‘E, atëherë, nuk paskeni frikë nga ndëshkimi i Allahut?’ Ky është Allahu, Zoti juaj i vërtetë. Kështu, përtej së vërtetës e ç’mund të ketë tjetër veç së gabuarës?! Si atëherë keni humbur?!” (Junus, 31, 32)

Rregullimi i çështjeve nga ana e njeriut është i kufizuar vetëm në atë që ndodhet nën sundimin e tij dhe vetëm në atë që ia lejon feja.

Këtë lloj teuhidi (*rububije*) nuk e kundërshtonin as politeistët tek të cilët u dërgua Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), madje ata e pranonin këtë. Allahu i Lartësuar thotë:

“E me të vërtetë, po t’i pyesësh ata se kush i ka krijuar qiejt dhe tokën me siguri do të thonë: “I Gjithëfuqishmi, i Gjithëdituri i krijoi.” (Zuhruf, 9).

Pra, ata e pohonin se Allahu është Ai që rregullon çdo çështje dhe që në dorën e Tij është sundimi i qiejve dhe i tokës. Këtë të vërtetë nuk e ka mohuar asnjë i njohur nga bijtë e Ademit. Askush nuk ka thënë se bota ka dy krijues të barabartë. Pra, askush nuk e ka kundërshtuar *teuhidin rububije*, qoftë duke mohuar krejtësisht se Zoti është krijues, qoftë duke i shoqëruar Atij dikë tjetër si krijues, me përjashtim të Faraonit. Ky i fundit e mohoi ekzistencën e Allahut për shkak të kryelartësisë, duke mos pranuar veprat e Tij të posaçme. Faraoni tha: “Unë jam zoti juaj, më i larti.” (Naziat, 24); “Faraoni tha: ‘O pari! Unë nuk di që ju të keni ndonjë perëndi tjetër, veç meje...’” (Kasas, 38). Kjo ishte thjesht kryeneçësi nga ana e tij, sepse, në fakt, ai e dinte se Zoti i vërtetë ishte dikush tjetër: “Ata i mohuan argumentet Tona padrejtësisht e me mospërfillje, edhe pse në vetvete ishin të bindur për vërtetësinë e tyre ...” (Neml, 14)

Po kështu Allahu ka treguar polemikën e Musait me Faraonin: “(Musai) i tha: ‘Vërtet ti tashmë e more vesh se këto shenja nuk kanë zbritur nga askush tjetër veç Zotit të qiejve dhe tokës ...’” (Isra, 102) Pra, Faraoni në veten e tij e dinte se Zot është Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala).

Ndërsa adhuruesit e zjarrit e mohonin *teuhidin rrububije* në aspektin e shoqërimit, duke thënë se bota ka dy krijues: Dritën dhe Errësirën. Megjithatë, ata përsëri nuk i konsideronin të barabartë këta krijues. Ata thonin se Drita është më e mirë se Errësira, sepse ajo është burim i së mirës, ndërsa Errësira sjell të keqen, dhe ajo që krijon të mirën është më e mirë sesa ajo që krijon të keqen. Gjithashtu, Errësira është hiç dhe nuk ndriçon, ndërsa Drita është ekzistencë dhe ndriçon, pra Drita është më e përsosur në qenien e saj. Një ndryshim të tretë ndërmjet tyre – sipas adhuruesve të zjarrit – është që: Drita është e hershme, pa fillesë; ndërsa për Errësirën ata kanë dy mendime: disa thonë se është e pa fillesë, disa të tjerë thonë që ajo ka një fillesë.

Logjika të mëson se Krijuesi i botës është një i vetëm:

“Asnjë fëmijë nuk lindi Allahu dhe asnjë perëndi tjetër nuk gjendet përkrah Tij. (Po të kishte shumë perëndi) atëherë ç’të shihje: Secila perëndi do të kishte hequr mënjanë atë që do të kishte krijuar vetë dhe disa do të përpiqeshin të mposhtnin të tjerët!” (Mu’minun, 91).

Pra, nëse ne do të pohojmë se bota paska dy krijues atëherë çdo krijues do të veçohet me atë që ka krijuar e të jetë i pavarur, siç e kanë zakon sundimtarët. Ata nuk do të kënaqeshin që në krijimet e sundimet e tyre të kishte pjesë tjetërkush, dhe nëse do të arrinin të bëheshin të pavarur do të donin diçka tjetër: që sundimi të ishte vetëm i tyre dhe askush të mos i shoqëronte në të. Kësisoj, kur secili e do për vete sundimin ata mund të jenë ose të barabartë ose njëri do të sundojë mbi tjetrin. Nëse njëri sundon mbi tjetrin atëherë zotërimi i takon atij, e nëse janë të barabartë, pra secili është i pafuqishëm kundrejt tjetrit, atëherë ky zotërim nuk i përket asnjërit prej tyre, sepse një i pafuqishëm nuk vlen të jetë zot.

Teuhidi uluhije (Njësimi i Allahut në adhurim).

Quhet ndryshe edhe *teuhid ibadeh*. Duke e parë në dy këndvështrime: nëse merret parasysh faktin se ai i kushtohet Allahut quhet *teuhid uluhije*; e nëse merret parasysh faktin se atë e kryejnë krijesat quhet *teuhid ibadeh*. Kjo do të thotë ta njësoh Allahun në adhurim, sepse Ai që meriton të adhurohet është vetëm Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala):

“Kjo ngaqë Allahu është i Merituari, Ai është i Vërteti, dhe gjithçka që ata (politeistët) lusin në vend të Allahut, ose bashkë me Të, është e pavërtetë.” (Lukman, 30).

Fjala ‘adhurim’ ngërthen dy koncepte:

1- *et teabud*, që do të thotë: nënshtrimi ndaj Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) duke vepruar ato që Ai ka urdhëruar dhe duke u larguar nga ato që Ai ka ndaluar, në shenjë dashurie dhe madhërimit për Të;

2- *el muteabed bihi* (aktet e adhurimit), që, sipas përkufizimit të bërë nga shejhu i Islamit Ibn Tejmije, është: emër që përfshin çdo fjalë dhe vepër, të dukshme ose të padukshme, që Allahu e do dhe e pëlqen. Për shembull, namazi është një mënyrë nënshtrimi dhe përukje ndaj Zotit si dhe një mënyrë për shprehjen e dashurisë dhe madhërimit të Tij, e në këtë kuptim ai quhet *teabud* - adhurim. Nga ana tjetër në vetvete ai është *el muteabed bihi* - një akt adhurimi.

Ta njësoh Allahun me adhurim do të thotë të bëhesh rob vetëm i Allahut, t’i nënshtrohesh vetëm Atij, në shenjë dashurie dhe madhërimit për Të, dhe ta adhurosh sipas mënyrës që Ai ka caktuar:

“Mos vër përkrah me Allahun të adhurosh tjetër, dhe pastaj të bëhesh i përçmuar e i braktisur (në Zjarr)..” (Isra, 22);

“Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun, Zotin e botëve”. (Fatiha, 1)

Përshkrimi i Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) si Zoti i botëve është arsye për pohimin uluhijes (adhurimit) për Të. Ai është i Adhurosh, sepse është Zoti i botëve. “O njerëz! Adhuroni Allahun, Zotin tuaj, i Cili ju krijoi ju dhe ata që qenë përpara jush.” (Bekare, 21), do të thotë se: Ai është Krijuesi i vetëm, prandaj meriton të adhurohet. Është mendjehetësi që një krijesë ta quash perëndi e ta adhurosh. Ajo në realitet nuk të bën dobi as në aspektin e ekzistencës, as në atë të përgatitjes dhe as në atë të ndihmës. Është mendjehetësi të

shkosh te varri i një personi, eshtrat e të cilit janë kalbur, dhe ta lusësh e ta adhurosh atë. Vetë ai ka nevojë për lutjen tënde e assesi nuk mund të të bëjë dobi ty. Atje ai nuk ka mundësi që t'i bëjë dobi apo dëm vetvetes, e si paska mundësi të bëjë diçka për të tjerët?!

Shumica e njerëzve e kanë mohuar dhe e kanë kundërshtuar këtë lloj teuhidi dhe për këtë shkak Allahu ka dërguar Pejgamberët dhe ka zbritur shpalljet: “Ne nuk kemi sjellë ndonjë të Dërguar para teje (O Muhamed) e që të mos i kemi shpallur se: ‘Nuk ka të adhurosh tjetër me meritë veç Meje, prandaj vetëm Mua më adhuroni!’” (Enbija, 25). E, pavarësisht nga kjo, ndjekësit e Pejgamberëve kanë qenë të pakët. I Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë njëherë: “... Pashë Profet me të cilin ishin disa njerëz, Profet me të cilin ishin një ose dy burra, dhe Profet me të cilin nuk ishte askush.”¹

Një nga çuditë e kohëve të sotme është se shumica e atyre që shkruajnë për teuhidin, përqendrohen në teuhidin rrububije (egzistencën e Allahut dhe veprat e posaçme të Tij), a thua se shkruajnë vetëm për njerëz që e mohojnë ekzistencën e Zotit. Pavarësisht se ka nga ata që e mohojnë Zotin, janë të shumtë edhe muslimanët që kanë rënë në shirkun e adhurimit. Për këtë arsye, ne duhet të përqendrohemi në këtë lloj teuhidi, me qëllim që t'i largojmë këta “muslimanë” nga kjo rrugë, të cilët thonë se janë muslimanë, ndërkohë që, në të vërtetë dhe pa e ditur, janë idhujtarë.

Teuhidi *el esma ue sifaat* (Njësimi i Allahut në emrat dhe atributet e Tij).

Kjo do të thotë ta njësosh Allahut me ato emra dhe atributete që i përkasin Atij.

Ky përmban dy gjëra:

1- pohimi, që do të thotë të pohosh për Allahun të gjithë emrat dhe cilësitë që Ai ia përshkuan Vetes në Kuran ose në Sunetin e Pejgamberit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem);

2- mohimi i përngjasimit të tyre, domethënë të mohosh se dikush tjetër përveç Allahut ka emra dhe attribute të ngjashme me

¹ Buhariu.

Të.

“Asgjë nuk i shëmbëllen Atij dhe Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi.” (Shura, 11).

Ky ajet tregon se Atij nuk i përngjan asnjë nga krijesat në çfarëdolloj cilësie. Në aspektin gjuhësor këto cilësi mund të shprehen me terma të njëjtë me ato të krijesave, por që në thelb dhe në përmbajtje ato ndryshojnë absolutisht.

Kush nuk i pohon Allahut atë që Ai ia ka pohuar Vetes, është mohues i cilësive të Tij, dhe ky mohim është njëlloj si ai i Faraonit. Nga ana tjetër, t’i pohosh këto cilësi duke i përngjasuar ato me cilësitë e krijesave do të thotë të bëhesh njëlloj me idhujtarët, të cilët adhuruan zota tjerë bashkë me Allahun. Vetëm ai që i pohon ato pa i përngjasuar me cilësitë e krijesave është monoteist i vërtetë.

Në këtë lloj teuhidi kanë humbur rrugën e drejtë mjaft njerëz nga bashkësia islame, të cilët u ndanë pastaj në grupe të shumta. Ka nga ata që i kanë mohuar krejtësisht atributet e Zotit duke pretenduar se kështu po e lartësojnë Atë. Në fakt ata kanë dalë nga Udhë, sepse dëlirësues i vërtetë i Allahut është ai që mohon se Ai ka cilësi të mangëta dhe nuk e pranon që fjala e Tij është e paqartë dhe devijuese. Nëse dikush thotë se Allahu nuk ka dëgjim, shikim, dije dhe fuqi nuk e ka lartësuar Allahun, përkundrazi, e ka përshkruar me mangësi, ndërkohë dhe fjalën e Tij e ka konsideruar si të paqartë dhe devijuese. Shumë herë Allahu e përshkruan Vetën si: Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi, i Gjithëfuqishmi, i Urti, Gjithëgjykuesi, Mëkatfalësi, Mëshirëbërësi. Nëse ti pranon që këto cilësi ndodhen në Kuran dhe mendon se ato nuk përshkruajnë Allahun, nuk ke bërë gjë tjetër por ke mëtuar se fjalët e Allahut qenkan të pakuptimta dhe të paqarta.

Grupe të tëra i kanë përngjasuar atributet e Zotit me ato të krijesave, duke pretenduar se kështu po vërtetojnë përshkrimin që Ai i ka bërë Vetes. Këta kanë humbur, sepse nuk e kanë vlerësuar Allahun ashtu siç e meriton Ai, duke e përshkruar Atë me të meta dhe duke e krahasuar të Përkryerit absolut me të mangët. Kur krahason të përkryerit me të mangët ia ke ulur vlerën të përkryerit, siç thuhet:

A s’e sheh, vallë, si shpatën përçmojnë,
kur me një shkop atë e krahasojnë?

Si mund të përngjasosh të përsosurin me të mangëtini?! Kjo është një përdhosje e të drejtës së Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Këta njerëz ashtu si edhe mohuesit bëjnë një krim të madh, sepse që të dyja kategoritë nuk e vlerësojnë Allahun ashtu siç e meriton Ai të vlerësohet.

Detyra jonë është që të besojmë në atë që Allahu e ka përs shkruar dhe emërtuar Vetën e Tij në Librin e Tij dhe nëpërmjet gjuhës së Pejgamberit të Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), pa i shtrembëruar kuptimet (*tahrif*), pa i mohuar (*ta'til*) ato, pa i përqsasur (*temthil*) këto emra dhe cilësi me diçka tjetër dhe pa bërë përs shkruarime dhe shpjegime të hamendësuarra të tyre (*tekjif*). Kjo është ajo që ka thënë shejhu i Islamit Ibn Tejmije dhe mjaft dijetarë të tjerë. Ne duhet të distancohemi nga këto katër veprime: nga shtrembërimi i kuptimit të teksteve, nga mohimi i tyre dhe nga krahasimet e përs shkruarimeve e hamendësuarra të cilësive.

Kur flasim për '*tahrif*' kjo do të thotë "interpretimet" që bëjnë shtrembëruesit e teksteve hyjnore që përs shkruajnë cilësitë e Allahut. Ata e quajnë vetën "interpretues" për të zbukuruar rrugën që kanë marrë, me qëllim që të mos u largohen njerëzit, sepse natyra e pastër e njeriut nuk mund ta pranojë fjalën "shtrembërim". Interpretimi i tyre është *tahrif*, që do të thotë "ndryshim i domethënies së drejtpërdrejtë të fjalës". Duhet theksuar se ky ndryshim është i drejtë vetëm nëse për të ka argument fetar, e në këtë rast nuk është interpretim shtrembërues, por komentim i saktë (*tefsir*).

Kjo kategori njerëzish i pohojnë cilësitë e Allahut, por – siç e thamë – duke i keqinterpretuar ato. Këta humbën dhe shkuan në rrugë të kundërt me rrugën e *ehlu sunetit dhe xhematit*. Ata nuk mund të përs shkruhen si *Ehlu Sunet dhe xhemat*, sepse përs shkruarimi do të thotë përkatësi. *Ehlu suneti* i përkasin Sunetit dhe janë të kapur pas tij, ndërsa ata, duke deformuar kuptimet e teksteve fetare, nuk e kanë përqsafuar Sunetin. Po kështu, *xhemati* në thelb tregon bashkim, unitet, ndërsa ata nuk janë të bashkuar në mendimet e tyre. Në librat e tyre ka kundërthënie dhe mospajtime, saqë disa prej tyre akuzojnë njëri-tjetrin për humbje nga e vërteta.

Shpjeguesi i akides "*Tahauije*" ka sjellë nga Gazaliu – i cili ka arritur kulmin në *ilmul kelam* – fjalë të tilla, që po t'i lexosh, të bëhet

e qartë se në ç'gabim, rrëshqitje dhe absurditet janë ndjekësit e kësaj rryme, dhe se sa të paqartë janë në idetë e tyre.

Raziu, icili është një nga mësuesit e tyre, thotë:

Guximi i logjikës fundin ka hutim,
Përpjekjet njerëzore mbarojnë me dështim,
Shpirtrat brenda trupit jetojnë në trishtim,
Gjithçka kemi arritur është veçse një lëndim.
Jetën e tërë, sa shumë kemi qëmtuar,
Thashetheme, fjalë – kaq kemi fituar!

Më pas thotë: “Meditova në rrugët e skolastikës dhe metodat e filozofisë, por nuk arrita në përfundimin se ato të shuajnë etjen e të shërojnë sëmundjen. Pashë se rruga më e afërt me të vërtetën është rruga e Kuranit. Lexo shpalljet: “I Mëshirploti u ngrit lart mbi Fron” (Ta Ha, 5) dhe: “Tek Ai ngjiten të gjitha fjalët e dëlira” (Fatir, 10) dhe pohoji. Lexo shpalljet: “Asgjë nuk i shëmbëllen Atij” (Shura, 11) dhe: “... dhe ata kurrë nuk mund ta përfshijnë dijen e Tij” (Ta Ha, 110), që do të thotë se nuk duhet të pranosh përngjasimin e Zotit me krijesat dhe se duhet të mohosh që krijesat mund të arrijnë dijen e Tij. Kush provon të kundërtën siç e provova unë, do ta pësojë siç e pësova unë.”

Pra, duket qartë vorbulla ku ata ndodhen duke mos qenë të sigurt në mendimet e tyre, ndërsa atë që Allahu e ka udhëzuar në rrugën e drejtë e gjen të qetë dhe të kthjellët. Ai lexon në Kuran dhe në Sunetin e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) emrat dhe cilësitë që Allahu ia ka përshkruar Vetes dhe i pohon ato. Askush nuk e njeh Allahun më mirë sesa Ai njeh Vetën e Tij. Nuk ka lajm më të vërtetë se lajmi i Allahut dhe as sqarim më të saktë sesa sqarimi i Tij.

“Allahu dëshiron t’ju qartësojë...” (Nisa, 26)

“Kështu Allahu jua bën të qartë, që të mos gaboni.” (Nisa, 176)

“Ne ta kemi zbritur ty Librin (Kuranin) si pasqyrim të çdo gjëje, shpjegues të gjithçkaje.” (Nahl, 89)

“Fjalët e kujt tjetër mund të jenë më të vërteta sesa fjalët e Allahut?!” (Nisa, 122)

“Kush është më i vërtetë në fjalë sesa Allahu?!” (Nisa, 87)

Këto ajete dhe mjaft të tjera tregojnë se Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) ua ka sqaruar plotësisht krijesave rrugën që i çon ata drejt

Tij. Gjëja më kryesore për të cilën kanë nevojë krijesat të sqarohen janë çështjet që kanë të bëjnë me Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala), me emrat dhe atributet e Tij me qëllim që ta adhurojnë Atë me dije. Të adhurosh diçka që nuk ia njeh cilësitë ose që nuk ka aspak cilësi është e pamundur. Pra, patjetër duhet të njohësh cilësitë e të Adhuruarit, që kjo të të bëjë të kthehesh tek Ai e t’i përkushtohesh realisht.

Njeriu nuk duhet t’i kalojë caqet e veta duke përkthyer me hamendësim cilësitë e Zotit, e as t’i përqsasë ato me cilësitë e krijesave. Kur njeriu është i paaftë të përfytyrojë shpirtin i cili gjendet brenda tij, është akoma më i paaftë për të përfytyruar se si janë në realitet cilësitë e Zotit. Prandaj është detyrë që t’ia ndalojmë vetes pyetjet “si” dhe “pse” kur bëhet fjalë për emrat dhe cilësitë e Allahut. Gjithashtu, ne duhet që t’ia ndalojmë vetes tonë të menduarit për formën ose mënyrën e këtyre attributeve. Nëse veprojmë kështu do të jemi më të qetë. Në këtë mënyrë kanë vepruar edhe të hershmit e muslimanëve – Allahu i mëshiroftë! Një burrë shkoi te Malik Ibn Enesi (Allahu e mëshiroftë!) e i tha: “O Ebu Abdurrahman, i Gjithëmëshirshmi u ngrit lart mbi Fron. Si u ngrit?” Imam Maliku uli kokën dhe u përgjigj: “Që “u ngrit lart” dihet, – mënyra se si, është e panjohur. Ta besosh (që u ngrit) është detyrë, ndërsa të pyesësh për mënyrën se si, është bidat. Unë mendoj se ti je i humbur.”

Në kohën tonë hasim nga ata që thonë se m.q.s. Allahu zbret çdo natë në qiellin e dynjasë kur ka mbetur një e treta e fundit e natës, kjo do të thotë se Ai gjatë gjithë kohës qëndron në qiellin e dynjasë sepse gjithmonë diku në tokë është një e treta e natës. Sahabët (radij-Allahu ‘anhum) nuk e kanë thënë këtë gjë. Nëse një gjë e tillë do të kishte hyrë në zemrën e një besimtari, atë do ta kishte sqaruar Allahu, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose me anë të Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ose duke bërë që disa të pyesnin për këtë e ai t’u jepte përgjigje. Për shembull, sahabët e pyetën Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) se ku ka qenë Allahu para se të krijonte qiejt dhe tokën, e ai u përgjigj¹: “Ka qenë vetëm Allahu; nuk ka pasur asgjë tjetër veç Tij. Froni i Tij ka qenë mbi ujë”². Kjo është

¹ Siç thuhet në hadithin e Imran Ibn Husejnit – radij-Allahu ‘anhum

² Buhariu.

një pyetje e rëndësishme sepse, veç të tjerash, tregon se çdo gjë për të cilën kanë pasur nevojë njerëzit Allahu e ka sqaruar me njërën nga tri mënyrat që përmendëm më lart. Për sa i përket paqartësisë në lidhje me hadithin e “zbritjes së Allahut” përgjigjja ndaj saj është të thuhet se, përderisa vazhdon një e treta e fundit e natës në një zonë të caktuar, zbritja ndodh vetëm në të, ndërsa në vendet e tjera nuk ndodh para një të tretës së fundit ose gjysmës së saj. Ndërkohë, duhet pasur parasysh se Allahu nuk i përngjet asgjëje. Hadithi në fjalë tregon se koha e zbritjes mbaron me fillimin e agimit. Detyrë për ne është që të dorëzohemi e të themi: “dëgjuam e u bindëm, ndoqëm dhe besuam”, duke mos e tejkaluar Kuranin dhe Sunetin.

Tema 1

Thënia e Allahut: "Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë."

Në këtë temë Autori (Allahu e mëshiroftë!) ka renditur disa ajete kuranore:

Ajeti 1: "Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë."

Lidhëza "që", në këtë ajet, tregon qëllim, domethënë sqarimin e arsyes së krijimit. E thënë ndryshe: "që të më adhurojnë", do të thotë se qëllimi i krijimit të xhindëve dhe njerëzve është që ata të adhurojnë Allahun. Përfundimisht, shprehja "që të më adhurojnë", sqaron urtësinë e krijimit të xhindëve dhe njerëzve.

Qëllimi nuk e detyron realizimin e tij, sepse po të ishte kështu, atëherë, me patjetër, të gjitha krijesat do të të ishin adhurues të Allahut dhe të nënshtruar ndaj Tij, por nuk është kështu. Qëllimi i një veprimi mund të sqarohet, por veprimi mund të realizohet ose jo. Ne mund të themi p.sh. "e kam mprehur lapsin, që të shkruaj", por, megjithatë, ne mund të shkruajmë me të ose jo. Kësisoj, kjo nuk është një marrëdhënie shkak-pasojë. Në marrëdhëniet shkak-pasojë pasoja varet drejtpërdrejtë nga shkakun, pra patjetër që do të ndodhë, si, për shembull, u thye xhami për shkak të nxehtësisë së madhe.

– "...kam krijuar..." – që i kam sjellë në ekzistencë. Kjo ekzistencë

paraprihet nga paracaktimi (*kaderi*). Zanafilla e krijimit është paracaktimi.

– “...*xhindët...*” – Xhindët përbëjnë një botë të fshehtë për ne. Fjala “xhind” (*el xhinn*) në gjuhën arabe është e përbërë nga shkronjat *xhim* dhe *nun*, të cilat tregojnë për fshehtësi dhe perde. Të tilla janë fjalët: *el xhennetu* (Xheneti), *el xhinnetu* (xhinde) dhe *el xhunnetu* (mburoja).

– “...*njerëzit...*” – Njerëzit (*el ins*) janë emërtuar kështu ngaqë nuk mund të jetojnë pa shoqëri. Ata shoqërojnë dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin.

– “...*vetëm që të më adhurojnë*” – Kjo është komentuar: “vetëm që të më njësojnë”, dhe ky komentim është i drejtë. Është komentuar edhe “të më përulen Mua me bindje duke zbatuar urdhrat dhe duke u larguar nga harami”; megjithatë pjesë e bindjes ndaj Allahut është edhe *teuhidi*, i cili përbën arsyen e krijimit të xhindëve dhe njerëzve. E kështu, për këtë gjë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) u dha njerëzve mendjen, u dërgoi Profetët dhe u zbriti librat hyjnorë.

Sikur qëllimi i krijimit të xhindëve dhe njerëzve të ishte i njëjtë me qëllimin e krijimit të kafshëve, atëherë nuk do të kishte urtësi në dërgimin e Profetëve dhe shpalljen e librave, sepse ata në fund të fundit do të ishin si një pemë, e cila mbin, zhvillohet dhe zhduket. I Madhëruari thotë: “Me të vërtetë, Ai që të ka zbritur ty (o Muhamed) Kuranin dhe ta ka bërë detyrë përcjelljen e mesazhit dhe të kapurit pas tij, patjetër do të të kthejë në botën tjetër.” (Kasas, 85). E ky kthim “që të shpërblehesh për veprat e tua: nëse ato janë të mira, do të shpërblehesh me të mira, e nëse janë të këqija, do të shpërblehesh me të këqija.”

Urtësia e krijimit të tyre nuk është për t’i bërë dobi Allahut: “Unë nuk dua prej tyre ndonjë furnizim dhe as nuk dua që ata të më ushqejnë.” (Dharijat, 57). Kur Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Kush do t’i japë Allahut një hua të mirë, që Ai t’ia kthejë shumëfish?” (Bekare, 245), nuk flet për një huadhënie reale, sepse Ai nuk ka nevojë për të, por me huadhënien është krahasuar marrëdhënia e ndërsjellë e njeriut me Zotin, të cilën Ai patjetër që

do ta shpërblejë. Është një angazhim nga Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) që t'ia japë shpërblimin njeriut për veprat e tij ashtu siç e përmbush detyrimin borxhliu ndaj huadhënësit.

Ajeti 2: “Çdo populli Ne i kemi çuar një të Dërguar (**që u thoshte**): Adhuroni vetëm Allahun dhe shmanguni nga *taguti* (idhujt)!” (**Nahl, 36**)

Në arabisht, *umet* (popull) tregon një grup të papërcaktuar njerëzish. Pra, në çdo popull është dërguar një Profet, që nga koha e Nuhut e deri në kohën e Pejgamberit tonë Muhamed (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Urtësitë e dërgimit të Profetëve janë:

- Paraqitja e argumentit. Allahu i Madhëruar thotë: “... Profetë, përgëzues dhe paralajmërues, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut pas ardhjes së të Dërguarve.” (Nisa, 165)

- Tregimi i mëshirës. Argument për këtë është thënia e Allahut të Madhëruar: “Dhe Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) si mëshirë për botët” (Enbija, 107).

- Qartësimi i udhës që të çon tek Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). Njeriu nuk mund t'i mësojë me hollësi detyrimet që ka ndaj Allahut, pa njohur rrugën e Profetëve.

– “... *Adhuroni vetëm Allahun...*” – do të thotë: nënshtrojuni Atij me adhurim.

– “... *dhe shmanguni nga taguti (idhujt)*” – domethënë: largohuni nga *taguti* (idhujt) në mënyrë që të mos keni asnjë lidhje me ta. Fjala “*tagut*” vjen nga “*tug'jan*” që do të thotë “tejkalim i kufirit”, ashtu siç thuhet në ajetin: “Vërtet kur uji u ngrit tej kufijve të tij ...” (Hakah, 12). Përkufizimi më i thukët është ai që ka përmendur Ibn Kajimi (Allahu e mëshiroftë!): “*Tagut* quhet çdo gjë ndaj të cilës njeriu e tejkalon kufirin duke e pasuar, adhuruar ose duke iu bindur”. Këtu nënkuptohet çdo gjë që e pëlqen të adhurohet, ose në të kundërt thuhet se është *tagut* përkundrajt atij që e adhuron, pason ose i bindet, sepse ai e tejkalon kufirin, duke e ngritur mbi

gradën që i ka caktuar Allahu. Kështu, adhurimi i *tagutit*, pasimi i tij dhe bindja ndaj tij, për atë që i kryen këto gjëra është tejkalim kufiri. Shembuj *tagut*-ësh që adhurohen janë idhujt, ata që pasohen janë falltorët, magjistarët dhe dijetarët e prishur, ndërsa *tagut*-ë në aspektin e bindjes ndaj tyre janë, për shembull, prijësit që kundërshtojnë Allahun. Nëse njeriu i konsideron këta si perëndi, atëherë ai e lejon atë që Allahu e ndalon, për shkak se janë “zotat” e tij që e lejojnë, dhe ndalon atë që Allahu e lejon, ngase janë ata që e ndalojnë. Këta janë *tagut*-ët, ndërsa ndjekësit e tyre janë pasues të *tagut*-ëve. Allahu i Lartësuar thotë: “A nuk i sheh ata të cilëve u qe dhënë pjesë nga Libri? Ata besojnë në *Xhibt* (idhujt) dhe *tagut* (hyjnitë e rreme) ...”, (Nisa, 51) por nuk ka thënë se edhe vetë ata janë *tagut*-ë.

Lidhja e këtij shpjegimi të ajetit me *teuhidin* qëndron në faktin se idhujt janë *tagut*-ë që adhurohen përveç Allahut.

Teuhidi plotësohet me dy shtylla: *pohimin* dhe *mohimin*. Nëse diçka vetëm do të mohohej, mohimi do të ishte gjithëpërfshirës, e nëse kjo diçka vetëm do të pohohej, pohimi nuk do të përjashtonte diçka tjetër shoqëruese. Nëse themi, për shembull: “Zejdi u ngrit”, ne pohojmë që ai është ngritur, por kjo nuk do të thotë aspak se ishte vetëm ai që u ngrit. Nga ana tjetër, nëse thuhet vetëm “nuk u ngrit”, ky është mohim i përgjithshëm (që përfshin edhe Zejdin). Por nëse themi se askush nuk u ngrit, përveç Zejdit, kjo do të thotë se vetëm ai është ngritur, pasi në thënie është përfshirë edhe pohimi, edhe mohimi.

Ajeti kuranor i mësipërm ndodhet në “Librin e Teuhidit”, sepse ai tregon që të gjithë Profetët kanë qenë të bashkuar në thirrjen për në teuhid; të gjithë ata u dërguan të përçonin teuhidin e Allahut: “Adhuroni vetëm Allahun dhe shmanguni nga idhujt!”

Ajeti 3: “Ndërsa Zoti yt ka urdhëruar (**kada**) që të mos adhuroni asgjë tjetër përveç Tij, dhe që të jesh respektues ndaj prindërve.” (**Isra, 23**)

Në ajet përmendet fjala “*kada*” – përcaktim. Përcaktimi i Allahut ndahet në dy lloje:

- Përcaktimi juridik.

- Përcaktimi i ligjeve të krijimit.

Përcaktimi juridik mund të zbatohet ose jo, dhe përfshin vetëm atë që Allahu e do, siç thotë Ai: “Ndërsa Zoti yt ka urdhëruar (*kada*) që të mos adhuroni asgjë tjetër përveç Tij, dhe që të jesh respektues ndaj prindërve”, ku fjala “*kada*” është përdorur me kuptimin: “ka ligjëruar, urdhëruar”, por ky përcaktim mund të kryhet ose jo, sepse jo të gjithë njerëzit e adhurojnë Allahun të Vetëm.

Përcaktimi i ligjeve të krijimit zbatohet patjetër, dhe përfshin atë që e do Allahu dhe atë që Ai nuk e do. Shembull për këtë është thënia e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “Dhe Ne përcaktuam për bijtë e Israilit në Libër (Teurat) se ‘vërtet ju do të bëni dy herë padrejtësi në tokë ...’” (Isra, 4). Këtu bëhet fjalë për një përcaktim ose vendim për krijim, sepse Allahu nuk ligjëron e as nuk e do padrejtësinë në tokë.

Një paqartësi dhe përgjigja për të

Thuhet se Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) ka përcaktuar krijimin e asaj që Ai nuk e do. E si e përcakton Allahu atë çfarë nuk e do?

Përgjigje: Për sa i përket pëlqimit, gjërat ndahen në dy lloje: 1 - E pëlqyeshme në vetvete; 2 - E papëlqyeshme në vetvete, por e pëlqyeshme për shkak të asaj që arrihet nëpërmjet saj.

E para është e kuptueshme, kurse e dyta mund të jetë e urryer në vetvete, por duhet për shkak të dobive dhe urtësive që ka në të. Ajo, në këtë rast është e urryer nga njëra anë, por e dashur nga ana tjetër. Kështu, prishja në tokë që vjen nga çifutët, është e urryer për Allahun, sepse Ai nuk e do shkatërrimin e as ata që e shkaktojnë atë, por nga ana tjetër, për shkak të urtësisë që përmban, është e dashur tek Allahu. Shembuj të tjerë janë: thatësira, sëmundjet, varfëria etj. Allahu nuk do që t’i lëndoje robërit e Tij, përkundrazi, Ai do lehtësimin për ta, por i përcakton vështirësitë për shkak të urtësive që rrjedhin prej tyre. Kësisoj, ato janë të urryera për Allahun nga njëra anë, dhe të dashura nga ana tjetër¹. Allahu i

¹ Sa më sipër do të thotë se Allahu i urren këto gjëra, por pëlqen dobite dhe urtësitë që rrjedhin ose që arrihen nëpërmjet tyre. Kështu, Allahu e pëlqen *teuben* nga gjynahu, por kjo nuk arrihet pa ekzistencën e gjynahut. Ai e pëlqen lutjen dhe përgjërimitin e robit ndaj Tij, prandaj i jep ndonjë vështirësi ose mundim besimtarit, me qëllim që t’i lutet dhe t’i përgjërohet Allahut. Ai ka dashur dhe do që të shfaqë fuqinë e Tij, të shpalosë urtësinë e

Madhëruar thotë: “Prishja ka dalë hapur në tokë e në det, e merituar për çfarë kanë bërë dhe fituar vetë duart e njerëzve. Kështu Ai mund t’i bëjë ata të “shijojnë” një pjesë të asaj që kanë punuar, me qëllim që të kthehen të penduar.” (Rum, 41).

Si mund të jetë diçka e dashur nga njëra anë dhe e urryer nga ana tjetër? Për këtë mund të sillet shembulli i një të sëmuri të cilit i japin një ilaç të hidhur e me erë të rëndë. Ai e pi ilaçin edhe pse e urren shijen dhe erën e tij, sepse do që të shërohet. Kjo është e urryer për atë nga njëra anë, por e dashur nga ana tjetër.

Përse të mos përfshihet ajeti: “Ndërsa Zoti yt ka urdhëruar (*kada*) që të mos adhuronit asgjë tjetër përveç Tij ...”, në përcaktimin e ligjeve të krijimit?

Kjo është e pamundur, sepse, po të ishte kështu, të gjithë njerëzit do të adhuronin Zotin e tyre. Këtu flitet për përcaktim juridik i cili mund të kryhet ose jo.

Allahu (Subhanehu ue Te’Ala) në këtë ajet i është drejtuar Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në numrin njëjës me fjalën “Zoti yt”, por shprehja tjetër “*që të mos adhuronit*” është në

Tij, të tregojë madhërinë e Tij, prandaj ka krijuar gjërat e përkundërta, si: shejtani dhe melaiket, dita dhe nata, jeta dhe vdekja, shikimi dhe verbëria, shëndeti dhe sëmundja, e mira dhe e keqja, gëzimi dhe hidhërimi etj. Ai do që të shprehë begatitë e Tij, të tregojë lavdinë, madhërinë dhe drejtësinë e Tij; të falënderohet dhe të adhurohet, prandaj e solli njeriun në këtë botë, e formoi atë me intelekt, prirje dhe dëshira, krijoi Xhenetin dhe Xhehenemin, vuri dënimin dhe shpërblimin etj. S’ka dyshim se kështu, nga njëra anë, shfaqen më shumë mirësitë, drejtësia, dhe veprimet e lavdishme të Zotit dhe, nga ana tjetër, njeriu bëhet më shumë adhures e falënderues ndaj Tij. Këto gjëra nuk do të arriheshin nëse nuk do të kishte: edhe adhures, edhe mosadhures të Tij; edhe mirënjohës edhe mosmirënjohës ndaj Tij; edhe të drejtë edhe të padrejtë; edhe vend ku njerëzit të provohen, edhe vend ku të begatohen; edhe vend ku të ndëshkohen, edhe vend ku të kënaqen e lumturohen. Pa ekzistencën e verbërisë nuk do të vlerësohej mirësia e shikimit, madje nuk do të njihej realiteti dhe koncepti i tij; pa ekzistencën e vuajtjes dhe mjerimit nuk mund të vlerësohet begatia dhe lumturia. Përjetimi i vështirësive të kësaj bote bën që besimtarët t’i përjetojnë më shumë begatitë e Xhenetit dhe t’i vlerësojnë më shumë ato sesa po të hynin në Xhenet pa u sprovuar më parë në këtë botë. Për këtë arsye, Ademi ka për t’i përjetuar dhe vlerësuar begatinë e Xhenetit kur të hyjë për herë të dytë në Xhenet më shumë sesa e përjetoi dhe e vlerësoi në herën e parë. Allahu dëshiron që të ndodhin dhe të shfaqen veprimet, ndikimet, rrjedhimet dhe pasojat e emrave të Tij të bukur dhe cilësive të Tij të Larta, si: bukuria, madhëria, mëshira, pranimiti i pendimit, durimi, butësia, drejtësia, ndëshkimi, fuqia etj. Kjo që përmenda është vetëm një pikë e detit të pafund të urtësive të Allahut të Lartësuar.

numrin shumë. E dyta ndryshon sepse është përgjithësuere. Shembull i njëjtë është edhe ajeti: “O Pejgamber, kur t’i ndani gratë ...” (Talak, 1), ku fjala e parë i është drejtuar të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ndërsa e dyta është gjithëpërfshirëse. Po cila është dobia e ndryshimit të formës së të shprehurit? Këtu mund të sjellim disa përgjigje:

Së pari, nëpërmjet ndryshimit të formës së të shprehurit përfitohet një vëmendje më e madhe e atij të cilit i drejtohet fjala.

Së dyti, i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është prijësi i umetit, dhe fjalët që i drejtohen atij janë të vlefshme për të gjithë ndjekësit e tij.

Së treti, me këtë formë aludohet se ajo çfarë i thuhet Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është ligj për të dhe për të gjithë umetin e tij, përveç rasteve kur argumentet e tjera fetare tregojnë se ligji ka qenë enkas për të.

Së katërti, posaçërisht në këtë ajet, nënkuptohet se Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka qenë krijesë dhe jo krijues, adhurues dhe jo i adhuruar. Ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) përfshihet në objektin e fjalës “adhuroni”. Për të mjafton që të jetë i nderuar me titullin “rob i Allahut”, se vetë Allahu e përshkruan këtë titull të Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) si gradën më të lartë të Tij. Ja disa shembuj:

- Në sfidën me Kuranin dhe mbrojtjen që i bën atij, Allahu thotë: “Nëse ju dyshoni për Kuranin që Ne i kemi zbritur *robit Tonë* (Muhamedit), ...” (Bekare, 23).

- Kur flet për profetësinë e tij, Zoti thotë: “I dëlirësuar nga çdo e metë është Ai, që i ka zbritur Furkanin (Kuranin) *robit të Vet ...*” (Furkan, 1).

- Kur flet për mrekullinë e Israsë dhe Miraxhit, thotë: “I dëlirësuar nga çdo e metë është Ai që e mbarti robin e Tij (Muhamedin) natën, nga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) deri në Xhamin e Largët (të Jerusalemit) ...” (Isra, 1) .

Llojet e nënshtrimit ndaj Zotit janë tre:

1. Nënshtrimi i përgjithshëm. Ky është nënshtrimi që i përfshin të gjitha krijesat. Allahu thotë: “Nuk ka asgjë në qiell dhe në tokë që të mos i kthehet të Gjithëmëshirshmit si rob i nënshtruar.” (Merjem, 93). Në këtë lloj nënshtrimi përfshihen edhe jobesimtarët.

2. Nënshtrimi i posaçëm, i cili është nënshtrimi i vullnetshëm e që përfshin besimtarët. Allahu thotë: “Dhe robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata, të cilët ecin në tokë me përulje dhe me qetësi.” (Furkan, 63). Ky lloj nënshtrimi përfshin çdonjë që i nënshtrohet Allahut sipas fesë së Tij.

3. Nënshtrim i përzgjedhur. Ky iu përket Profetëve. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë për Nuhun (alejhi selam): “Me të vërtetë, ai ishte rob mirënjohës e falënderues.” (Isra, 3); për Muhamedin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Dhe nëse ju dyshoni për atë (Kuranin) që Ne i kemi zbritur robit Tonë ...” (Bekare, 23) dhe për të Dërguarit e tjerë: “Dhe kujto robërit Tanë: Ibrahimin, Is’hakun dhe Jakubin, të fortë (në përkushtim dhe në dije) dhe largpamës ...” (Sad, 45) Ky lloj nënshtrimi është atribut i Pejgamberëve. Askush tjetër nuk mund të konkurrojë me ta në këtë aspekt.

– “... dhe që të jesh i përkushtuar ndaj prindërve të tu” – Allahu i Lartësuar ka urdhëruar të jesh bamirës ndaj prindërve. Termi “prind” përfshin: nëna, babai dhe personat mbi ta, por nëna dhe babai janë kryesorët. Sa më afër të jenë të tjerët me prindërit, aq më e detyrueshme është bamirësia ndaj tyre. Ky ajet është argument që tregon se detyra ndaj prindërve është menjëherë pas detyrës ndaj Allahut. Ndërsa detyra ndaj Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) përfshihet në detyrën ndaj Allahut, sepse Allahu adhurohet vetëm sipas mënyrës që e ka ligjëruar Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Ajeti 4: “Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë. Silluni mirë ndaj prindërve, të afërmve, jetimëve, të varfërve, fqinjëve të afërt dhe të largët, ndaj atij që keni pranë, udhëtarit **(që ka mbetur ngushtë)** dhe atyre që janë robër nën pushtetin tuaj. Në të vërtetë, Allahu nuk i do njerëzit që mbahen me të madh e mburravecë.” **(Nisa, 36)**

– “Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (shej'en). ...” – Fjala arabe “shej'en” është gjithëpërfshirëse. Pra, nuk duhet t'i

shoqërojmë Allahut të Madhëruar as Profet, as engjëll (melek), as shenjtor e as ndonjë gjë tjetër të dynjasë. Gjithashtu, nuk duhet ta bësh dynjanë ortak me Allahun, sepse kur njeriun e shqetëson veç dynjaja dhe kur e ka atë qëllim të vetin kryesor, mund të kthehet në një rob të saj, siç ka thënë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Ka dështuar robi i dinarit (arit, parasë), robi i argjendit, robi i veshjes së bukur, robi i shtrojës së pelushit...”¹

– “... *Silluni mirë ndaj prindërve ...*” – Për këtë shprehje gjykohet njëlloj si në ajetin e tretë.

– “... *të afërmve, jetimëve, të varfërve ... udhëtarit*” – Të afërmit janë ata me të cilët ke lidhje gjaku që nga katragjyshi. ‘Jetim’ quhet personi të cilit i ka vdekur babai dhe që ende nuk e ka arritur moshën e pubertetit. Të varfër janë ata që nuk kanë pasuri të mjaftueshme, ndërsa “udhëtari” këtu nënkupton atë kategori që ka mbetur në rrugë për shkak se i kanë mbaruar paratë.

– “... *fqinj të afërt dhe fqinj të largët ...*” – Fqinj i afërt është ai që banon ngjitur me shtëpinë tënde ose rreth saj.

– “... *ndaj shokut pranë vetes ...*” – Thuhet se bëhet fjalë për bashkëshorten, por thuhet gjithashtu se bëhet fjalë për shokun e udhëtimit, sepse edhe ai qëndron pranë teje. Ndaj të dyve ke detyrime, kështu që ajeti i përfshin të dyja kategoritë.

– “... *dhe ndaj atyre që i keni nën pushtetin tuaj.*” – Kjo përfshin bamirësinë ndaj robërve dhe kafshëve, pasi të gjitha këto janë nën sundimin tënd.

– “... *Në të vërtetë, Allahu nuk i do njerëzit që mbahen me të madh e mburravecë.*” – Ata që mbahen me të madh në paraqitje dhe ata që mburren me fjalë; Allahu nuk do as njërin dhe as tjetrin.

█ Ajeti 5: “Thuaj: ‘Ejani, t’ju lexoj çfarë ju ka ndaluar Zoti

¹ Buhariu.

juaj: të mos i shoqëroni Allahut asgjë; që të silleni mirë me prindërit; që të mos i vrisni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne ju furnizojmë ju dhe ata; që të mos iu afroheni veprave të turpshme, qofshin ato të hapëta apo të fshehta, dhe mos vrisni atë njeri që jua ka ndaluar Allahu, përveçse kur e kërkon drejtësia **(e ligji)**. Këto ju porosit Ai, me qëllim që të logjikoni. Mos iu afroni pasurisë së jetimëve, përveçse për ta rregulluar, derisa të mbërrijnë pjekurinë! Kryeni drejt matjen dhe peshimin; Ne nuk ngarkojmë asnjë përtej mundësive të tij! Kur të flisni, thoni të vërtetën edhe në qoftë se çështja ka të bëjë me ndonjë të afërmin tuaj. Përmbushni besën e dhënë Allahut! Këtë ju porosit Ai, që të përkujtoheni. Kjo është udha Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera, që t’ju shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porosit Ai, që të bëheni të devotshëm.”

– *“Thuaj: ‘Ejani, do t’ju lexoj çfarë ju ka ndaluar Zoti juaj...’*” – Fjala i është drejtuar Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), të cilin Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) e urdhëron që t’u thoshte njerëzve: “Ejani”, pra, “afrohuni pranë meje t’ju lexoj çfarë ju ka ndaluar Zoti juaj”. Nuk thuhet “çfarë ju ka ndaluar Allahu”, sepse përdorimi i fjalës Zot këtu është më i goditur, pasi me të tregohet pushteti dhe sundim absolut që Ai zotëron mbi krijesën, sipas asaj që përmban urtësia e Tij.

– *“... të mos i shoqëroni Allahut asgjë ...”* – domethënë: t’ju lexoj, që të mos i shoqëroni Allahut asgjë.

– *“... të silleni mirë me prindërit ...”* – pra: t’ju lexoj, që të silleni mirë me prindërit.

– *“... të mos i vrisni fëmijët tuaj ...”* – Pasi përmendet detyra ndaj paraardhësve (prindërve) përmendet edhe ajo ndaj pasardhësve (fëmijëve).

– “... për shkak të varfërisë ...” – domethënë, për arsye të varfërisë.

– “... Ne ju furnizojmë ju dhe ata ...” – me kuptimin: nëse ju i lini ata të jetojnë, nuk do të ndjeni ngushtim në furnizim për shkak të ekzistencës së tyre, sepse Ai i Cili garanton furnizimin është Allahu. Në këtë ajet është përmendur së pari furnizimi i prindërve, ndërsa në një vend tjetër, në suren Isra, ajeti fillon me përmendjen e furnizimit të fëmijëve. Këtu thuhet “për shkak të varfërisë”, pra varfëria ekziston, sepse janë përmendur fillimisht dy prindër të varfër. Ndërsa në ajetin (numër 31) të sures “Isra” thuhet: “frika e varfërisë”, që do të thotë se kemi të bëjmë me rastin kur prindërit janë të pasur, por kanë frikë se mos varfërohen. Pra, është përmendur furnizimi i fëmijëve para furnizimit të prindërve.

Vrasja e fëmijëve për shkak të varfërisë u ndalua, duke u nisur nga fakti se idhujtarët asokohe e kryenin shpesh diçka të tillë, por kjo nuk do të thotë se ky veprim është i kufizuar vetëm për ata.

– “... që të mos iu afroheni veprave të turpshme ...” – Këtu nuk thuhet “mos veproni”, sepse ndalimi i këtyre veprave duke përdorur togun “mos iu afroheni” bëhet më i fortë dhe më kategorik, pasi nuk përfshin vetëm ndalimin e veprimit të tyre, por edhe gjithçka që të çon në to. Për këtë arsye është e ndaluar që burri të shohë një grua të huaj apo të veçohet me të, ose që gruaja të udhëtojë pa u shoqëruar nga një i afërm (me të cilin nuk i lejohet martesja), ngaqë punë të tilla çojnë drejt imoralitetit.

– “... të hapëta apo të fshehta ...” – Sipas një komenti, flitet për vepra të turpshme të qarta dhe vepra të turpshme të mbuluara, pasi ka gjëra që konsiderohen të turpshme për të gjithë njerëzit, por ka dhe nga ato në të cilat ka një farë maskimi. Po ashtu komentohet: atë që e shfaqni hapur dhe atë që e fshihni, domethënë imoraliteti i kryer haptas – Allahu na ruajt prej tij – dhe imoraliteti i kryer fshehurazi. Shpjegohet edhe kështu: ato me turp më të madh dhe ato me turp më të vogël, sepse gjynahet e turpshme nuk janë të një rangu. Për këtë, në një hadith thuhet: “A t’ju lajmëroj për gjynahun

më të madh?”¹ Ky hadith tregon se edhe gjynahet e mëdha ndahen në disa më të mëdha e disa të tjera nën to.

– “... dhe mos vrisni atë njeri që jua ka ndaluar Allahu, përveçse kur e kërkon drejtësia.” – Njeriu që Allahu ka ndaluar të vritet është njeriu i mbrojtur, siç është muslimani, *dhimi*-u (jomuslimanët që jetojnë nën pushtetin islam), ai që ka bërë marrëveshje armëpushimi me muslimanët dhe ai që muslimanët e kanë marrë në mbrojtje.

Këtu “*drejtësia*” është ajo që pohohet në Sheriat, ndërsa “e padrejtë” është ajo që mohohet nga ai. Një nga rastet kur Sheriati e quan të drejtë vrasjen e njeriut të mbrojtur është kur i martuari bën imoralitet. Dënimi i tij është të goditet me gurë derisa të vdesë. Raste të tjera që dënohen me vdekje janë: kur dikush vret një njeri me të cilin ka të drejta të barabarta; kur dikush braktis Islamin; kur dikush u pret njerëzve rrugën për t’i grabitur. I Dërguari (sal-lallahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Nuk lejohet të derdhet gjaku i muslimanit, përveçse në tri raste: kur ai vret një musliman qëllimisht dhe pa të drejtë; kur bën imoralitet duke qenë i martuar, dhe kur lë fenë e tij e largohet nga xhemati i muslimanëve.”²

Në pjesën që po komentojmë, Allahu thotë: “... mos vrisni atë njeri që jua ka ndaluar Allahu, përveçse kur e kërkon drejtësia”, ndërsa më lart thotë: “mos i vrisni fëmijët tuaj”. Ndalimi për vrasjen e fëmijëve përsëritet dy herë: një herë në mënyrë të posaçme dhe një herë në mënyrë të përgjithshme.

– “*Këto ju porosit Ai ...*” – “Këto” domethënë “ato që u përmendën më lart”. Porosia është një lloj përgjegjësie që jepet, e tillë që pala tjetër t’i kushtojë rëndësi. Ne themi p.sh. “e porosita për filanin”, që do të thotë: ia kam ngarkuar si detyrë që të kujdeset për të.

– “... me qëllim që të logjikoni (*ta’kilun*)” – Me logjikën këtu nënkuptohet sjellja normale, ndërsa në thënien e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “Në të vërtetë, Ne e kemi shpallur Kuranin në gjuhën arabe, për ta kuptuar (*ta’kilun*) ju.” (Zuhruf, 3), kuptimi i

¹ Buhariu.

² Buhariu, Muslimi.

fjalës *ta'kilun* është “ta kuptoni”. Në ajet tregohet se ai që u përmbahet atyre normave është i logjikshëm, i arsyeshëm, e nëse i kundërshton ato, nuk është i logjikshëm. Ajeti përmban pesë porosi:

1. Njësimin e Allahut.
2. Bamirësinë ndaj prindërve.
3. Mosvrasja e fëmijëve tanë.
4. Mosafrimi te gjynahet e turpshme.
5. Moskryerja e vrasjes që Allahu ka ndaluar, veçse sipas drejtësisë.

– “... *Mos iu afroni pasurisë së jetimit, përveçse për ta rregulluar ...*”
 – “Mos iu afroni” me qëllim që të mbrohet pasuria e tyre. Asaj mund t’i afrohem vetëm për ta përmirësuar; kur bëjmë atë që është më e mira për të. Nëse përgjegjësit për pasurinë e jetimit i paraqiten dy variante për ta shtuar atë, njëri më fitimprurës se tjetri, duhet të zgjedhë atë që ka më shumë fitim, sepse kjo është më e mira, por gjithmonë duke qëndruar larg haramit. Kështu p.sh., nëse njëri variant ka më shumë fitim, por është me kamatë, ndërsa tjetri ka më pak fitim, por është i papërzier me kamatën, zgjidhet e dyta sepse gjithmonë respektimi i Sheriatit është përpara të mirës materiale të dynjasë.

– “... *derisa të mbërrijnë pjekurinë ...*” – Në këtë moment duhet t’ia dorëzojmë pasurinë atij, pasi ta kemi provuar e vrojtuar se di ta administrojë atë; nuk lejohet që pas kësaj kohe të mbajmë pasurinë e jetimit. Me mbërritjen e pjekurisë nënkuptohet pjekuria mendore dhe trupore. Fjala këtu u është drejtuar përgjegjësve të jetimëve ose prijësve – sipas thënieve të disa dijetarëve. Koha e pjekurisë është koha në të cilën fillojnë detyrimet për individin. Ajo është në kohën kur mbush pesëmbëdhjetë vjeç ose me daljen e qimeve rreth organit gjinorë ose me ejakulimin.

– “... *Kryeni drejt matjen dhe peshimin ...*” – Mbusheni plotësisht enën matëse, kur matet malli, si në rastin e ushqimeve dhe farave. Peshoni drejt, kur të peshoni gjëra që peshohen, siç është rasti i mishit etj. Kjo i përfshin të gjitha marrëdhëniet e ndërsjella midis

njerëzve, pra është detyrë ta plotësosh peshën dhe masën në marrëdhëniet e ndërsjella.

Meqenëse kjo në disa raste është e vështirë, sepse njeriu ndonjëherë nuk arrin ta plotësojë si duhet masën ose peshën, Allahu e pason këtë pjesë ajeti duke thënë: “Ne nuk ngarkojmë asnjë përtej mundësive të tij”. Pra, nëse përpiqesh me të gjitha mundësitë, por ndodh ndonjë mangësi, nuk konsiderohesh mëkatar, sepse çka është përtej mundësive është e falur. Në këtë fjali, ashtu siç tregohet nga njëra anë falja, kur gabimi është përtej mundësive për të mos ndodhur, ashtu tregohet edhe ashpërsia ndaj atij që neglizhon ose abuzon në përmbushjen e drejtësisë. Për këtë arsye sapo të qartësohet gabimi, ai duhet të shmanget.

– “... *Kur të flisni, thoni të vërtetën ...*” – Do të thotë se kurdo që të flasësh duhet të thuash gjithmonë të drejtën, qoftë ajo kundër dikujt, qoftë kundër teje, qoftë për gjykimin ndërmjet dy personave. E kundërta e kësaj është padrejtësia dhe njëanshmëria. Allahu në këtë rast nuk ka thënë: “Ne nuk ngarkojmë asnjë përtej mundësive”, sepse në përgjithësi nuk është e vështirë të jesh i drejtë në fjalë.

– “... *edhe në qoftë se çështja ka të bëjë me ndonjë të afërmin tuaj ...*” – Çfarëdolloj afërsie të kesh me dikë, mos e favorizo duke anuar në dëm të një tjetri. Çështjen tënde lërja Allahut, i Cili të ka krijuar dhe të ka urdhëruar, sepse tek Ai do të kthehesh dhe Ai do të të pyesë se çfarë bërë me këtë amanet.

Njeriu më i nderuar dhe më i drejtë – Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) – ka thënë: “Pasha Allahun, sikur Fatimja, bija e Muhamedit, të vidhte, do t’ia kisha prerë dorën.”¹

– “... *Përmbushni besën e dhënë Allahut*” – Kjo është besa që Ai u ka marrë robërve të Tij për adhurim dhe zbatim të urdhrimit të Tij, siç thotë Allahu në Kuran: “Vërtet Allahu mori zotimin nga bijtë e Israilit dhe Ne caktuam dymbëdhjetë udhëheqës prej tyre. Allahu u tha: “Unë jam me ju në qoftë se do të kryeni namazin, do të jepni zekatin, do të besoni të Dërguarit e Mi, do t’i ndihmoni ata dhe do t’i jepni Allahut hua të mirë.” (Maide, 12). Këtij zotimi duhet t’i

¹ Buhariu.

përmbahemi ne. Ndërsa thënia: “Unë do t’jua fal gjynahet dhe do t’ju fus në Xhenete poshtë të cilëve rrjedhin lumenj” është premtimi i Allahut.

– “... *Këto ju porosit Ai, që të përkujtoheni ...*” – Në këtë ajet ka katër porosi nga Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala):

1. Të mos i afrohem pasurisë së jetimit ndryshe, veç për të mirë.
2. Të peshojmë dhe masim me drejtësi.
3. Të jemi të drejtë kur të flasim.
4. Të përmbushim besën e dhënë Allahut.

Ajeti i parë përmbante pesë porosi, dhe bashkë me ato të ajetit të dytë bëhen nëntë. Më pas Allahu thotë: “*Kjo është rruga Ime e drejtë, prandaj ndiqeni*”. Kjo e fundit është porosia e dhjetë. Thënia e Tij: “*Kjo është Rruga Ime*”, mund të aludojë të gjitha këto porosi, pasi ato kanë përfshirë të gjithë Sheriatin (fenë) ose tekstualisht, ose me domethënie. Mund të aludojë edhe çka është e njohur nga feja e Allahut sipas këtij komenti: ajo me të cilën ju erdhi juve i Dërguari, është rruga Ime – domethënë rruga që të çon tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala).

“*Rruga*” i atribuohet Allahut ose edhe atyre që ndjekin këtë rrugë. Në ajetin: “Në udhën e Allahut, të Cilit i takon gjithë ç’është në qiell dhe gjithë ç’është në tokë” (Shura, 53), i atribuohet Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), ndërsa në ajetin tjetër: “Në rrugën e atyre të cilëve Ti u ke dhuruar mirësinë Tënde.” (Fatiha, 7), i është atribuar atyre që e ka marrë këtë rrugë. I atribuohet Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) sepse kjo udhë të shpie tek Ai dhe se është Ai që e caktoi për robërit e Vet. Ndërsa atyre që ecin në të i atribuohet për faktin se janë ata që e përshkojnë këtë rrugë.

– “... *e mos shkoni rrugëve të tjera, që t’ju shmangin nga udha e Tij ...*” – “Rrugët e tjera” janë drejtimet e devijuara jashtë udhës së drejtë. Ajeti nënkuptohet: Nëse ju i ndiqni ato, do t’ju ndajnë nga udha Ime e do t’ju çorientojnë e do t’ju largojnë. “Rrugëve të tjera” është në numrin shumë, ndërsa udha të cilën Allahu ia ka atribuar Vetes është në numrin njëjës, “udha e Tij”, sepse është një rrugë e vetme. Udha e Allahut është një, ndërsa të tjerat janë të shumta, prandaj i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Ky umet

do të ndahet në shtatëdhjetë e tre grupe. Të gjithë do të jenë në Zjarr përveç njërit.”¹ Pra, rruga e shpëtimit është një, ndërsa të tjerat janë të ndara e pa drejtim.

Nga thënia e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “... me anë të të cilit Allahu udhëheq të gjithë ata të cilët kërkojnë kënaqësinë e Tij drejt rrugëve të paqes” (Maide, 16), nuk lind ndonjë paqartësi, sepse rrugët e përmendura në ajet edhe pse janë përmendur në numrin shumë i atribuohen paqes, domethënë ato të çojnë drejt shpëtimit, dhe me to nënkuptohen detyrat e Islamit.

– “... *Kjo është ajo që ju porosit Ai, që të bëheni të devotshëm*” – Të gjitha këto që u përmendën janë porositë e Tij me qëllim që ju të arrini gradën e devotshmërisë dhe të zbatoni atë që ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Në lidhje me këtë Abdullah Ibn Mesudi ka thënë: “Kush dëshiron të shikojë testamentin e Muhamedit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), mbi të cilën është vula e tij, le të lexojë thënien e Allahut të Madhëruar: ‘Thuaj: ‘Ejani t’ju lexoj çfarë ju ka ndaluar Zoti juaj ...’ deri te: “Kjo është udha Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera ...”²”

– “*Kush dëshiron...*” – Shprehja tregon nxitje dhe thuhet për ta bërë çështjen më tërheqëse, ndërsa shprehja “*le të lexojë*” është për orientim.

– “... *testamentin ...*” – Testamenti lihet për çështje të rëndësishme.

– “... *e Muhamedit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ...*” – Do të thotë se ai është i Dërguari i Allahut, Muhamedi, i biri i Abdullah el Hashimi el Kurejshi-t. Kjo mënyrë e të shprehurit nga Ibn Mesudi dëshmon për lejimin e përdorimit të saj, pra, lejohet të thuhet: “ka

¹ Ahmedi, Ebu Daudi dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

² Tirmidhiu dhe Tabariani. Sipas Albanit senedi është i dobët.

thënë Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem)”; “testamentin e Muhamedit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem)” etj. Kjo nuk bie ndesh me fjalën e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “Mos e thirrni Pejgamberin ashtu siç thërrisni njëri-tjetrin” (Nur, 63), sepse kjo ka të bëjë me thirrjen e drejtpërdrejtë të të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), pra, të mos i drejtoheshe atij duke i thënë: “O Muhamed!”, por: “O i Dërguari i Allahut!”. Ndërsa kur tregon për Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) çështja është më ndryshe, pasi gjatë tregimit përdoren fjalë ose shprehje që nuk përdoren kur thërret. Për këtë arsye lejohet të thuash: “Unë jam ndjekës i Muhamedit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem)”, ose “*Allahumme sal-li ala Muhammedin*” e të ngjashme me këto.

Për sa i përket testamentit të Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ai nuk është as i shkruar, as i vulosur, sepse Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk la asnjë testament të tillë. Për këtë tregohet se Ebu Xhehife e pyeti Ali Ibn Ebu Talibin:

- A ka lënë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ndonjë gjë për ju me testament?
- Jo, – iu përgjigj ai, – pasha Atë që e shpërthen farën (për të mbirë) dhe që ka krijuar njeriun, përveç kuptimit të Kuranit që Allahu ia jep kujt të dojë prej robërve të Tij dhe ç’farë kam të shkruar në këtë letër.
- Ç’ka në atë letër? – e pyeti Ebu Xhehife.
- Pagimi i gjakut trashëgimtarëve të të vrrarit kur ai është vrrarë gabimisht, lirimi i robit nga duart e qafirëve, dhe mosvrasja e muslimanit për kafirin. – iu përgjigj Aliu (r.a.).¹

Askush të mos mendojë se i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka porositur për këto ajete me testament të posaçëm e të shkruar, por Ibn Mesudi (r.a.) ka menduar se këto ajete kanë përfshirë të gjithë fenë, duke e përqsatur me një testament, të cilin Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka vulosur dhe e ka lënë për umetin e tij.

Këto janë ajete madhështore, e nëse njeriu mediton e i zbaton ato, arrin plotësisht tri cilësi: logjikën, përkujtimin e Zotit dhe devotshmërinë.

¹ Buhariu.

Muadh Ibn Xhebeli (**Zoti qoftë i kënaqur me të!**) tregon: “Isha hipur pas Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në gomar kur më tha: ‘O Muadh, a e di cila është detyra e robërve ndaj Allahut dhe detyra e Allahut ndaj robërve?’ I thashë: “Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri.” Ai më tha: “Detyra e robërve ndaj Allahut është që ta adhurojnë Atë dhe të mos i shoqërojnë asgjë, ndërsa detyra e Allahut ndaj robërve është që të mos i ndëshkojë ata që nuk i shoqërojnë asgjë Atij.” Unë i thashë: “O i Dërguari i Allahut, a t’i përgëzoj njerëzit?” Ai m’u përgjigj: “Mos i përgëzo, se mbështeten te kjo pastaj.”¹

– “... *cila është detyra e robërve ndaj Allahu ...?*” – Pra me çfarë i ka obliguar ata Zoti, çfarë detyrash duhet të kryejnë. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ia tha Muadhut (Zoti qoftë i kënaqur me të!) në formë pyetjeje që zemra e tij të përqendrohej sa më tepër për të kuptuar atë që do të thoshte Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

– “... *detyra e Allahut ndaj robërve? ...*” – Ajo që është detyrë për Të në sjelljen me ta. Robërit nuk e detyrojnë atë për asgjë, por është vetë Ai që e ka detyruar Vetën si mirësi mbi robërit e Tij. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Zoti juaj ka shkruar (caktuar) mëshirën për Vetën e Tij, kështu që, nëse ndonjë prej jush vepron të keqen nga padija, e pastaj pendohet, duke kryer drejtësi e mirësi, atëherë vërtet Ai është gjithnjë Falës i Madh, Mëshirëplotë.” (En’am, 54). Allahu ia ka obliguar Vetes që të mëshirojë këdo që bën një të keqe apo që sillet keq pa u menduar, por që pastaj pendohet e kryen vazhdimisht vepra të mira.

– “... *Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri ...*” – Pra, ata janë më të ditur se kushdo tjetër.

– “... *ta adhurojnë ...*” – t’i nënshtrohen Atij me bindje.

¹ Buhariu, Muslimi.

– “... dhe të mos i shoqërojnë asgjë ...” – të mos i shoqërojnë në adhurimin e Tij dhe në gjithçka që është e posaçme për Të. Fjala “asgjë” mohon gjithçka, pra, të mos shoqërohet me Të as Profet, as melek, as velij e as të tjerë.

– “... ndërsa detyra e Allahut ndaj robërve është që të mos i ndëshkojë ata që nuk i shoqërojnë asgjë Atij” – Kjo detyrë është mirësi e Allahut për robërit e Tij; askush nuk ia ka obliguar këtë Atij. Mos mendo se fjala e tij në hadith: “...që nuk i shoqërojnë asgjë Atij” nuk përfshin adhurimin, sepse përcaktimi është: “...ta adhurojnë Atë dhe të mos i shoqërojnë asgjë”. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk ka thënë tekstualisht “kush adhuron Allahun”, sepse kjo nënkuptohet nga pjesa: “detyra e Allahut ndaj robërve”. Cilido që përfshihet te “robërimi” patjetër duhet të jetë i nënshtruar ndaj Zotit.

A ndëshkohet ai që nuk e adhuron Allahun, por që nuk i shoqëron asgjë Atij? Ndëshkohet; sepse kjo thënie përmban diçka që nuk është përmendur, por që nënkuptohet, domethënë: “kush adhuron Allahun dhe nuk i shoqëron asgjë”. Për këtë dëshmojnë dy fakte; shprehja: “detyra ndaj robërve”, sepse kushdo që përshkruhet me “robëri” (*ubudije*), patjetër duhet të jetë adhurues (*abid*). Kjo duhet kuptuar bashkë me pjesën e parë: “ta adhurojnë Atë dhe të mos i shoqërojnë asgjë”. Atëherë kuptohet se domethënia e pjesës së dytë: “... të mos i ndëshkojë ata që nuk i shoqërojnë asgjë Atij”, është: “të mos i ndëshkojë ata që nuk i shoqërojnë asgjë Atij në adhurimin që i bëjnë”.

– “... A t’i përgëzoi njerëzit? ...” – Pra, “a të hesht e të mos i përgëzoi njerëzit?” Kështu qëndron edhe sipas një varianti tjetër të këtij hadithi; ndërsa sipas një variantit tonë është pa pjesën “a të hesht ...”.

Përgëzim (*el-bishare*) do të thotë të njoftosh dikë për diçka që e gëzon, mirëpo (në arabisht) kjo mund të përdoret edhe nëse njofton për diçka që dëmton, siç është rasti në thënien e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “Prandaj përgëzoi ata për dënimin e rëndë.” (Inshikak, 24). Megjithatë përdorim më të gjerë ka rasti i parë.

– “... *Mos i përgëzo, se mbështeten te kjo pastaj.*” – Pra, mos ua përcill këtë gjë. Kuptimi i hadithit është se Allahu nuk ndëshkon atë që nuk i shoqëron asgjë Atij dhe se njeriut i falen gjynahet me realizimin e teuhidit. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ndaloi t’ua përçonte këtë lajm njerëzve, që ata të mos mbështeten në të dhe të lënë pa realizuar kërkesat e tjera. Realizimi i teuhidit detyron largimin nga mëkatet, të cilat burojnë nga epshi, që përbëjnë një nga llojet e shirkut: “A e ke vënë re atë njeri që dëshirat e veta i mori për Zot.” (Xhathijeh, 23).

Ky hadithi është sjellë në këtë temë për shkak se ai tregon vlerën e teuhidit dhe të mëson ruajtjen nga ndëshkimi i Allahut.

■ **Dobitë e temës**

- Urtësia e krijimit të njerëzve dhe xhindëve.

Këtë autori (Allahu e mëshiroftë!) e ka nxjerrë prej fjalës së Allahut: “Unë i krijova xhindët dhe njerëzit vetëm që të më adhurojnë.” Pra, qëllimi i ekzistencës është adhurimi i Allahut e jo kënaqësia në ngrënie, pirje dhe marrëdhënie seksuale.

- Adhurimi i Allahut pa i bërë shok Atij është teuhidi, sepse kundërshtimet kanë lindur pikërisht për të.

Adhurimi është i ndërtuar mbi teuhid, dhe çdo lloj adhurimi që nuk ka teuhid, nuk është adhurim i vërtetë. Këtë e përforcon edhe fakti se disa selefë e kanë komentuar fragmentin: “*vetëm që të më adhurojnë*” si “*vetëm që të më njësojnë*”. Kjo është në përputhje të plotë me atë që ka nxjerrë autori (Allahu e mëshiroftë!) që adhurimi është vetë teuhid. Çdo adhurim që nuk bazohet në teuhid është i papranueshëm. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka treguar, në një hadith *kudsi*, se Allahu thotë: “Unë nuk kam nevojë për pjesën (e veprës) që ma kushtojnë në ortakëri. Kush kryen një vepër dhe shoqëron në të me Mua dikë tjetër, Unë e lë atë dhe

shirkun e tij.”¹

Ndërsa thënia, “sepse kundërshtimet kanë lindur pikërisht për të”, do të thotë se kundërshtimi ndërmjet Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe kurejshëve ishte në lidhje me teuhidin. Kureshët adhuronin Allahun, bënë tavaf rreth Qabes dhe faleshin për Të, por pa e njësuar Atë dhe jo sipas mënyrës së ligjësuar në Sheriat. Kështu adhurimi i tyre nuk vlente për shkak se ata nuk patën teuhidin. Allahu ka thënë: “Asgjë tjetër nuk pengon që atyre t’u pranohet ndihmesa, përveç mosbesimit të tyre në Allahun dhe të Dërguarin e Tij.” (Teube, 54)

- Kush nuk e përnjëson Zotin nuk e ka adhuruar Atë. Ky është kuptimi i ajetit: “Dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj.” (**Kafirun, 3**)

Pra, nuk do të jeni adhurues sipas mënyrës së adhurimit tim, sepse adhurimi juaj është i ndërtuar në shirk, e kësisoj nuk konsiderohet adhurim.

- Urtësia e dërgimit të Profetëve.

Autori (Allahu e mëshiroftël!) këtë e ka nxjerrë nga fjala e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “Çdo populli Ne i çuam një të Dërguar (që u thoshte): Adhuroni vetëm Allahun dhe shmanguni nga taguti (idhujt).” (Nahl, 36). Pra, urtësia e dërgimit të tyre ka qenë të ftonin njerëzit në adhurimin e Allahut dhe t’i largonin nga adhurimi i idhujve.

- Shpallja hyjnore ka përfshirë të gjithë popujt.

Kjo është nxjerrë nga fragmenti: “Çdo populli Ne i çuam një të Dërguar”.

- Feja e Profetëve është një.

¹ Muslimi.

Kjo është nxjerrë nga ajetet: “Çdo populli Ne i çuam një të Dërguar (që u thoshte): Adhuroni vetëm Allahun dhe shmanguni nga idhujt” dhe: “Ne nuk kemi sjellë ndonjë të Dërguar para teje (o Muhamed) e që të mos i kemi shpallur se: nuk ka të adhuruar tjetër të merituar veç Meje, kësisoj më adhuroni Mua të Vetëm.” (Enbija, 25). Kjo nuk bie në kundërshtim me ajetin: “Për secilin prej jush Ne kemi përcaktuar një ligj dhe një rrugë të qartë” (Maide, 48), sepse legjislacionet ndryshonin sipas popujve, vendeve dhe kohërave, ndërsa themeli i fesë është një. Allahu thotë: “Ai (Allahu) ka përcaktuar e urdhëruar për ju të njëjtën fe, të cilën Ai e pati urdhëruar për Nuhun e të cilën Ne ta kemi shpallur ty (O Muhamed), dhe atë të cilën Ne e urdhëruam për Ibrahimin, Musain dhe Isain, që ta praktikoni fenë e të mos përçaheni në të.” (Shura, 13)

- Çështja e madhe, adhurimi i Allahut, arrihet veçse me mohimin e tagutit (idhujve). Ky është dhe kuptimi i: “... dhe shmanguni nga taguti (idhujt)”.

Ai që adhuron Allahun dhe nuk mohon tagutin (idhullin) nuk është monoteist. Prandaj dhe dijetari (Allahu e mëshiroftë!) e ka quajtur “çështje të madhe”, sepse shumë muslimanë në kohën e tij, ashtu si edhe në kohën tonë, nuk e kanë pasur të qartë këtë.

Vërejtje: Nuk lejohet t'i vësh etiketën e *shirkut*, *kufrit* apo të mallkosh atë që vepron një vepër treguese të tyre, sepse të japësh gjykime të tilla përfundimtare duhet të marrësh parasysh shumë rrethana të tjera përjashtuese. Kështu nuk themi për dikë që shfrytëzon kamatën se ai është i mallkuar, sepse ndoshta ka arsye të tjera që e përjashtojnë mallkimin ndaj tij, siç është injoranca, dyshimi e të ngjashme me këto. Po kështu, nuk ia mveshin politeizmin çdokujt që vepron një vepër tipike të tij, pasi ai ndoshta nuk është përballur realisht me argumentin e vërtetë e kjo ndoshta për shkak të neglizhencës së dijetarë në vendin ku ai qëndron. Po ashtu, ne themi se çdokush që agjëron ramazanin me besim dhe duke llogaritur shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet që ka vepruar, por nuk gjykojmë se i janë falur mëkatet një personi konkret që

agjëron, pasi gjykimi që jepet për veprat apo shkaqet, nuk vlen të jepet për një person të caktuar veçse në rastet kur plotësohen të gjitha kushtet dhe kur largohen të gjitha pengesat. Nëse shohim një person që kryen nevojën në rrugë, a mund t'i themi: "Paç mallkimin e Zotit!"? Natyrisht që jo, vetëm nëse mallkimi synon atë që ka thënë i Dërguari (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Ruhuni nga vendet e mallkimit ..."¹, sepse vetë njerëzit e mallkojnë dhe e urrejnë një person të tillë. Ata e shohin si njeri të ulët, që cenon muslimanët; por kjo është çështje tjetër. Gjithashtu, lutja pranë një varri është vepër idhujtarie, por nuk mund t'i themi idhujtar një personi që e vepron këtë, derisa të dimë në i është sqaruar e vërteta atij, ose e quajmë idhujtar duke marrë në konsideratë gjendjen e tij të dukshme.

- *Tagut*-i është fjalë e përgjithshme që përmbledh gjithçka që adhurohet përveç Allahut.

Pra, çdokush që adhurohet veç Allahut, është *tagut*. Ibn Kajimi e ka përkufizuar: "*Tagut* quhet çdo gjë ndaj të cilës njeriu e tejkalon kufirin duke e pasuar, adhuruar ose duke iu bindur". Të adhuruar mund të jenë idhujt e ndryshëm, të pasuar mund të jenë "dijetarët", kurse prijësit mund të jenë ata të cilëve njerëzit iu binden.

- Rëndësia e madhe e tri ajeteve të qarta (***muhkemat***) të sures En'am për selefët, ngase ato përmbanin dhjetë norma, e para e të cilave ishte ndalimi nga shirku.

Të qenit "*muhkemat*" do të thotë se ato nuk mund të shfuqizohen. Këtë autori e ka nxjerrë nga thënia e Ibn Mesudit (*r.a.*).

- Rëndësia e ajeteve *muhkemat* të sures Isra, të cilat përmbajnë tetëmbëdhjetë norma. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) e ka nisur me ajetin: "Mos adhuro diçka

¹ Ebu Daudi, Ibn Maxhe dhe Hakimi. Sipas Albanit hadithi është i mirë. Teksti i plotë i hadithit është kështu: "Ruhuni vendeve të cilat sjellin mallkimin e njerëzve: kryerja e nevojës në rrugët e burimeve të ujit, në rrugë dhe në hije".

tjetër krahas me Allahun, se do të poshtërohesh, i përçmuar dhe i braktisur **(në Zjarr)** ...” dhe e ka mbyllur me: “... dhe mos adhuro perëndi tjetër tok me Allahun, se do të hidhesh në Xhehenem, fajtor dhe i dëbuar ...” Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) na ka tërhequr vërejtjen për rëndësinë e madhe të këtyre çështjeve me fjalën e Tij: “Këto rregulla të qarta, që Ne sqaruam, të janë shpallur nga Zoti yt.”

Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) e ka filluar me ndalimin e shirkut me fjalën e Tij: “Mos adhuro diçka tjetër krahas me Allahun, se do të poshtërohesh, i përçmuar dhe i braktisur...” I poshtëruari nuk nderohet, sepse nuk ka mirësi për atë njeri që i bën shok Allahut. Ai është i përçmuar nga Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) dhe të dashurit e Tij; i braktisuri nuk fiton as në dynja, as në ahiret. Allahu e ka mbyllur duke thënë: “... dhe mos adhuro perëndi tjetër tok me Allahun, se do të hidhesh në Xhehenem, fajtor dhe i dëbuar ...”. Ky është përfundimi i atij që adhuron diçka tjetër krahas me Allahun; të gjithë e fajësojnë dhe e lënë vetëm, e do të mbetet i braktisur, Allahu na ruajtë!

- Rëndësia e ajetit të sures Nisa, i cili quhet “ajeti i dhjetë të drejtave”, të cilin Allahu e ka filluar me fjalët: “Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë ...”.

E drejta më e madhe është ajo e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala); të drejtat e tjera nuk kanë asnjë dobi pa përmbushjen e saj. Kur Hakim Ibn Hizami e pyeti nëse do të përfitonin ndonjë shpërblim ata që kishin dhënë sadaka, që kishin liruuar robër dhe ruajtur lidhjet farefisnore në kohën para Islamit, i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) iu përgjigj: “Kur je bërë musliman të janë pranuar të gjitha të mirat që ke vepruar më parë.”¹ Kjo tregon se, nëse ai nuk do të ishte bërë musliman nuk do të kishte marrë shpërblim. Të gjitha detyrimet marrin vlerë vetëm pasi realizohet detyra ndaj Allahut.

¹ Buhariu.

- Tërheqja e vëmendjes për porosinë e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në pragun e vdekjes.

Kjo është nxjerrë nga hadithi i Abdullah Ibn Mesudit (r.a.). I Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në realitet nuk ka porositur, por na ka orientuar se, po të kapemi fort pas Librit të Allahut nuk kemi për të humbur. Nga ajetet më madhështore që janë përmendur në Librin e Allahut është edhe: “Thuaj: ‘Ejani, unë do t’ju shpall (lexoj) çfarë ju ka ndaluar Zoti juaj ...” (En’am, 151).

- Njohja e të drejtës së Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) nga ana jonë.

Kjo arrihet duke e adhuruar Atë pa i shoqëruar asgjë.

- Njohja e të drejtës së robërve nga Allahu.

Kjo nëse njerëzit e kryejnë detyrimin që kanë ndaj Allahut. Kjo e drejtë është: mosndëshkimi i individit që nuk shoqëron gjë në adhurimin e Allahut, ndërsa ai që i shoqëron Atij diçka meriton të ndëshkohet.

- Pak sahabë e kanë ditur këtë çështje.

Kjo ngase Muadhi e përcolli këtë njohuri vetëm pasi kishin vdekur shumica e sahabëve. Kështu ai u ruajt nga mëkati i fshehjes së dijes. I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) druhej se mos njerëzit sprovoheshin duke u mbështetur plotësisht te ky përgëzim; megjithatë, i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk ka pasur qëllim ta mbante këtë gjë absolutisht të fshehtë, se po të ishte kështu ai nuk do t’ia tregonte as Muadhit e as ndonjë tjetri.

- Lejohet të fshehësh diturinë për një qëllim të mirë.

Lejohet por jo ta fshehësh në mënyrë absolute. Fshehja e plotë e

dijes nuk lejohet, sepse kështu nuk ka dobi. Kjo është arsyeja që i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ia tregoi Muadhit çështjen në fjalë. Fshehja e dijes në disa raste, ose ndaj disa personave, është e lejuar, për shkak të dobisë që mund të ketë kjo gjë, siç veprimi i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Ai nuk ua tregoi atë çështje sahabëve të tjerë nga frika se mos ata mbështeteshin vetëm në të e i tha Muadhit: “Mos i përgëzo, se pastaj mbështeten te kjo.” I ngjashëm me këtë është hadithi i të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) treguar Ebu Hurejres: “Përgëzoji njerëzit se ai që thotë *La ilahe il’All-llah*, me sinqeritet nga zemra e tij, futet në Xhenet.” Madje, ndonjëherë, është më e vlefshme që të mos e kryesh një punë të mirë, për shkak se dobia e moskryerjes së saj është më e madhe. P.sh. i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dëshironte ta shembte Qaben e ta ndërtonte atë në themelet e ndërtimit të Ibrahimit (alejhi selam), por nuk e bëri këtë nga frika se mos kështu provokoheshin njerëzit, të cilët sapo e kishin lënë idhujtarinë.

➤ Kënaqja e muslimanit me sihariqe.

Kjo është marrë nga thënia e Muadhit: “A t’i përgëzoj njerëzit?” Kënaqja e muslimanëve me sihariqe është ndër veprat më të vlefshme.

➤ Droja prej mbështetjes së tepruar në mëshirën e gjerë të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala).

Kjo është marrë nga shprehja: “... *Mos i përgëzo, se pastaj mbështeten te kjo.*” Mbështetja e tepruar te mëshira shkakton një të keqe të madhe; sigurinë nga dënimi i Allahut. Nga ana tjetër, humbja e shpresës te mëshira e Allahut e largon njeriun nga pendimi dhe sjell pesimizëm në lidhje me mëshirën e Tij. Imam Ahmedi ka thënë: “Ai që ecën për tek Allahu duhet të jetë ndërmjet frikës dhe shpresës; dalja e njërës prej tyre mbi tjetrën e shkatërron njeriun. Nëse sundon shpresa, kjo e çon në sigurinë nga dënimi i Allahut, e nëse sundon frika, e çon në humbjen e shpresës nga mëshira e Tij.”

Disa dijetarë kanë thënë se nëse je i sëmurë duhet të mbizotërojë

shpresa, e nëse je shëndoshë duhet të mbizotërojë frika.

Të tjerë kanë thënë se, kur robi mediton rreth mëshirës së Allahut dhe mirësive të Tij duhet të mbizotërojë shpresa, e nëse mediton rreth veprimeve të veta duhet të mbizotërojë frika, me qëllim që të pendohet. Këta argumentohen me fjalën e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) "... kur japin diçka, zemrat e tyre i kanë gjithë frikë e përkushtim" (Mu'minun, 60), që do të thotë: të frikësuar se ndoshta nuk është pranuar prej tyre vepra e mirë, për shkak të ndonjë mangësie. Ky është një mendim i mirë.

Gjithashtu është thënë se, gjatë kryerjes së punës së mirë duhet të mbizotërojë shpresa, me qëllim që njeriu të mendojë mirë për Allahun, ndërsa kur dëshiron të bësh ndonjë të keqe duhet të mbizotërojë frika, me qëllim që të mos e veprosh atë që e ka ndaluar Allahu.

Po kështu, thënia "a t'i përgëzoi njerëzit?" është argument se sihariqet për çështje të fesë apo të dynjasë janë të pëlqyera. Prandaj dhe melekët e përgëzuan Ibrahimin, "... i dhanë sihariqin për një djalë të mençur e të dijshëm" (Dharijat, 28) i cili ishte Is'haku, ndërsa El Halimi (i Duruari) u quajt Ismaili. Edhe Pejgamberi (sal-lallahu 'alejhi ue sel-lem) e përgëzoi familjen me djalin që i lindi (Ibrahimin) duke thënë: "Më ka lindur sonte një djalë që i kam vënë emrin e babait tim, Ibrahimit."¹ Nga kjo del se njeriu duhet të përçojë gëzim të vëllezërit e tij muslimanë me sa të mundet, qoftë kjo me fjalë ose vepra, me qëllim që të arrihet paqja dhe mirësia.

Në të njëjtën mënyrë, muslimani nuk duhet të fusë të keqen te muslimanët e tjerë. Për këtë arsye, është përcjellë se i Dërguari (sal-lallahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Askush të mos më flasë për askënd, sepse unë dua t'ju dal përpara me zemër të pastër."² Në këtë hadith ka dobësi transmetimi, por kuptimi është i saktë, sepse kur të flasin keq për dikë në zemrën tënde nxitet diçka kundër tij edhe nëse ai sillet mirë me ty. Nëse ti ke marrëdhënie të ndërsjella me të dhe nuk i di të metat e tij është gjë e mirë, pasi ndoshta ai e pranon më shumë këshillën prej teje. Disa njerëz u largohen disa të tjerëve shpirtërisht, para se t'u largohen fizikisht. Këto janë çështje të holla, që të zgjuarit i rrokin me anë të meditimit.

¹ Muslimi.

² Ahmedi, Ebu Daudi dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i dobët.

- Shprehja: “Allahu dhe i Dërguari i Tij janë më të diturit” kur nuk e di përgjigjen e një pyetje.

Këtë e vërteton pohimi që i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i bëri përgjigjes së Muadhit. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk e kundërshtoi Muadhin kur ai e përmendi në krah të emrit të Allahut me lidhëzën bashkërenditëse “dhe”, por ai ka kundërshtuar një tjetër që tha “Çfarë të dojë Allahu dhe ti, (bëhet)”, ia ktheu: “E si më bëre të barabartë me Allahun?” Thuaj: “Çfarë të dojë Allahu i Vetëm (bëhet)”.¹

Sigurisht, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kishte dije fetare që Muadhi nuk e kishte, prandaj ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk e kundërshtoi këtë të fundit, ndryshe nga rasti tjetër ku bëhej fjalë për përcaktimin dhe rregullimin e çështjeve të krijesave, gjë të cilën e zotëron vetëm Allahu. Kështu, nëse na pyesin, për shembull: “A është haram agjërimi i dy ditëve të Bajramit?”, lejohet të themi: “Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë.” Kur sahabët kishin paqartësi në ndonjë çështje, shkonin tek Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe ai ua sqaronte atë. Por, nëse pyetemi: “A mund të bjerë shi këtë muaj?”, nuk lejohet të themi: “Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë.”, sepse kjo është dije që ka të bëjë me *kaderin*, të cilën e ka vetëm Allahun.

- Në lidhje me dhënien e dijes lejohet veçimi i disa njerëzve nga të tjerët.

Kjo është ashtu siç veproi Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): ai ia kallëzoi atë çështje Muadhit, pa ia treguar sahabëve të tjerë, si Ebu Bekrit, Omerit, Othmanit, Aliut etj. Disa njerëz, ndoshta, nëse u tregon për diçka, bien në sprovë. Ibn Mesudi ka thënë: “Nëse u flet njerëzve me ndonjë fjalë që nuk mund ta perceptojnë për disa prej tyre mund të jetë sprovë.” Ndërsa Aliu (radiallahu anhu) ka thënë: “Folu njerëzve sipas asaj që ata njohin.” Pra, çdonjërit i flitet sipas mundësisë, kuptimit dhe perceptimit të

¹ Ahmedi, Ibn Maxhje. Sipas Albanit hadithi është i saktë.

tij.

- Thjeshtësia e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), duke hipur vetë i dytë mbi gomar.

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka qenë njeriu më i lartë në pozitë, megjithatë, ai ka qenë dhe njeriu më i thjeshtë. Hipja në një gomar vetë i dytë tregon kulmin e modestisë së tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Njerëzit e mëdhenj e kanë zakon që të mos hipin në të njëjtën kafshë me dikë tjetër, ndërsa Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka hipur në një gomar. Ai, po të dëshironte, mund të hipte mbi çdo kafshë tjetër që pëlqente. Kush bëhet modest për Allahun, Allahu e ngre lart atë.

- Lejimi i hipjes mbi një kafshë vetë i dytë.

Kjo me kusht që kafsha të mos mundohet.

- Pasqyrimi i vlerës së Muadh Ibn Xhebelit.

Vlera e tij tregohet nga vetë veçimi nga të tjerët që i bëri atij Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për t’i dhënë këtë lajm dhe duke e hipur pas tij mbi kafshë.

- Rëndësia e madhe e kësaj çështjeje (teuhidit).

Kjo çështje ka rëndësi të madhe sepse i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e lajmëroi Muadhin duke i dhënë sihariq për njerëzit.

Tema 2

Vlera e teuhidit dhe gjynahet që fshin realizimi i tij në jetë.

Më përpara autori shkroi “Libri i Teuhidit” dhe tregoi se teuhidi është detyrë, ndërsa ajeti: “Unë i krijova xhindët dhe njerëzit vetëm që të më adhurojnë” do të thotë se adhurimi është i saktë vetëm me teuhid.

Në këtë temë dijetari ka shpalosur vlerën e teuhidit. Shpjegimi i vlerave të diçkaje nuk do të thotë se ajo nuk është detyrë, por tregon se vlera është pjesë e rezultateve dhe ndikimeve të saj. P.sh. për namazin me xhemat në një thënie të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), e cila ka ardhur në rrugë të sakta, thuhet: “Namazi me xhemat është njëzet e shtatë gradë më i vlefshëm se namazi më vete.”¹ Pohimi i vlerës së namazit nuk do të thotë se ai nuk është detyrë. Kështu, teuhidi është detyra më madhore pa të cilën nuk pranohet asnjë vepër. Njeriu afrohet te Zoti vetëm përmes tij dhe, në të njëjtën kohë, teuhidi ka vlerat e veta.

Autori e ka shkruar këtë temë për dy arsye: së pari, për të sqaruar vlerën e teuhidit; së dyti, për të sqaruar gjynahet që fshihen, sepse pjesë e ndikimit të vlerës së teuhidit është fshirja e gjynaheve. Ja disa nga dobitë e teuhidit:

- Ai është ndihmësi më i madh për veprimin e të mirave, sepse çdo monoteist punon haptas e fshehtas, veç për hir të Allahut të Lartësuar. Ndërsa monoteisti i rremë është shtirak: ai jep sadaka, fal namaz dhe e përmend Allahun vetëm kur e shohin të tjerët. Për

¹ Buhariu dhe Muslimi.

këtë arsye disa selefë thonin për veten e tyre: “Unë dua të afrohem tek Allahu me një vepër të mirë që vetëm Ai ta dijë.

- Ata që e njësojnë Allahun në adhurim kanë siguri dhe janë të udhëzuar, ashtu siç thotë i Madhëruari në ajetin që përmend autori në vijim:

“Ata të cilët besojnë dhe nuk e përziejnë imanin e tyre me zullum kanë siguri të plotë dhe janë të udhëzuar.”

(En’am, 82)

- “... *me zullum* ...” – Zullumi tregon atë që bie ndesh me imanin, pra *shirk*-un. Kur zbriti ky ajet sahabëve iu duk e vështirë prandaj thanë: “Cili prej nesh nuk i bën padrejtësi vetes? Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: “Nuk është ashtu siç e mendoni ju. Me fjalën “zullum” këtu nënkuptohet shirku. A nuk e keni dëgjuar thënien e burrit të mirë, Llukmanit: “Vërtet shirku është padrejtësia më e madhe.” (Lukman, 13)

Padrejtësia mund të jetë disa llojesh:

- 1- Padrejtësia e shirk-ut, që cenon të drejtën e Allahut. Kjo është padrejtësia më e madhe.
- 2- Padrejtësia ndaj vetes, kur njeriu nëpërkëmb nevojat e tij. Për shembull kur agjëron çdo ditë të vitit ose kur fal namaz çdo natë pa fjetur.
- 3- Padrejtësia ndaj tjetrit. Për shembull me rrahje, vrasje, marrje të pasurisë etj.

Nëse eliminohet padrejtësia arrihet siguria. Po a është ajo një siguri e plotë? Nëse imani është i plotë dhe nuk përzihet me mëkate siguria është e plotë. Nëse imani nuk është i plotë as siguria nuk është e plotë. Një shembull për këtë është vepruesi i një gjynahi të madh. Ai është i sigurt për mosqëndrimin e përhershëm në Zjarr, por nuk është i sigurt nga ndëshkimi. Ai është nën dëshirën e Allahut të Madhëruar: “Vërtet, Allahu nuk e fal idhujtarinë, por, veç kësaj, fal kë të dëshirojë” (Nisa, 116).

Ajeti 82 i sures En’am lidhet me një polemikë të Ibrahimit me popullit të tij kur ai u tha atyre: “E si t’u frikësohem atyre që ju i bashkoni në adhurim me Allahun?!...” deri te: “Vërtet, sikur ta

dinit.” (En’am, 81-82). Pas kësaj Allahu thotë: “Ata të cilët besojnë dhe nuk e përziejnë imanin e tyre me zullum.” Ndoshta dikush mund të thotë se këto janë fjalë të Ibrahimit për të sqaruar popullin e tij. Për këtë shkak Allahu ka vijuar: “Dhe kjo ishte prova Jonë që Ne ia dhamë Ibrahimit ndaj popullit të tij.” (En’am, 83)

– “... *siguri* ...” – Vjen në trajtën e shquar (në arabisht), prandaj ne e komentuar sigurinë si të plotë ose të mangët, sipas shkallës së padrejtësisë.

– “... *dhe ata janë të udhëzuar*” – Të udhëzuar në këtë botë për në fenë e Allahut, me dituri dhe punë. Udhëzimi i diturisë shërben për orientimin, ndërsa udhëzimi i punës shërben për suksesin. Ata do të jenë të udhëzuar edhe në botën tjetër, në Xhenet. Ndërsa për banorët e Zjarrit Allahu (Subhanehu ue Te’Ala) thotë: “Mblidhini (do t’u thuhet melekëve) ata që bënë keq, bashkë me shokët e tyre (shejtanët) dhe ata që kanë adhuruar në vend të Allahut, dhe drejtojini në rrugën e Zjarrit të ashpër e flakërues.” (Safat, 22-23). Ky është drejtimi në botën tjetër; për mizorët është Xhehenemi, e për ata që kanë besuar dhe nuk kanë bërë padrejtësi ata udhëzohen drejt begatisë.

Shumë komentues thonë për pjesën “ata kanë siguri të plotë ...” se siguria do të jetë në botën tjetër, ndërsa udhëzimi është në këtë botë, por e sakta është se kjo thënie përfshin sigurinë dhe udhëzimin në këtë botë dhe në tjetrën.

Lidhja e ajetit me temën është për faktin se Allahu në këtë ajet pohon sigurinë për atë që nuk bën shirk. Ai që nuk bën shirk është njësues. Kjo argumenton se një nga vlerat e teuhidit është siguria e qëndrueshme.

Nga Ubade Ibn Samiti përcillet se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kush dëshmon se s’ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut të Vetëm e pa ortak, se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij, se Isai është rob i Allahut, i Dërguari i Tij dhe Fjala e Tij (**bëhu**) të cilën ia ka drejtuar Merjemes, si dhe shpirt (**i krijuar**) prej Tij, dhe se Xheneti është i vërtetë e Zjarri është i

vertetë, Allahu e fut në Xhenet, sido që të ketë punuar.”¹

– “... *Kush dëshmon se s’ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut ...*” – Dëshmia duhet të paraprihet nga njohja. Allahu i Madhëruar thotë: “... përveç atyre të cilët dëshmojnë për të vërtetën me dituri.” (Zuhruf, 86). Kjo dije mund të jetë e fituar, por mund të jetë edhe e natyrshme.

Dija se s’ka të adhuruar tjetër përveç Allahut është edhe e natyrshme, sepse Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: “Çdo foshnje lind me natyrë të pastër.”² Ajo edhe mund të fitohet me anë të studimit dhe hulumtimit të ajeteve kuranore. Së pari, duhet që patjetër të ekzistojë dija se s’ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, që pastaj ta dëshmosh atë.

– “... *s’ka të adhuruar ...*” – ‘I adhuruar’ quhet ai që adhurohet me dashuri dhe madhërim. Ta duash Atë dhe ta madhërosh, sipas dijes që ke në lidhje me cilësitë e Tij madhështore dhe veprimet e Tij të larta.

– “... *s’ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut ...*” – Pra, nuk ka të adhuruar përveç Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Për këtë, Allahu tregon habinë e kurejshëve, të cilët thanë: “A mos kërkon ai që të gjithë zotat t’i bëjë një Zot të Vetëm? Vërtet që kjo është një gjë e çuditshme!” (Sad, 5). Ndërsa ajeti: “... Kurse zotat që ata lutnin në vend të Allahut nuk u sollën ndonjë dobi ...” (Hud, 101) do të thotë se ky lloj adhurimi është i pasaktë, sepse është i padrejtë. Si i tillë ai është i mohuar nga ana e Sheriatit. Kur mohohet nga Sheriati, është njësoj si të mos ekzistojë; kështu ai nuk ka qëndrueshmëri: “Dhe shembulli krahasues për një fjalë të ligë është një pemë e keqe, e shkukur nga sipërfaqja e tokës, pa pasur aspak qëndrueshmëri.” (Ibrahim, 26). Me këtë që u tha bëhet lidhja mes ajeteve: “... Kurse zotat që ata lutnin në vend të Allahut nuk u sollën ndonjë dobi ...”, “A mos kërkon ai që të gjithë zotat t’i bëjë një Zot të Vetëm? Vërtet që kjo është një gjë e çuditshme!” dhe: “Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut ...” (Ali Imran, 62). Këta zota janë

¹ Buhariu.

² Buhariu dhe Muslimi.

thjesht emra që nuk kanë domethënie apo vërtetësi. Ata janë të pasaktë nga ana e Sheriatit dhe nuk meritojnë të quhen zota, sepse nuk bëjnë as dëm, as dobi, as nuk krijojnë e as nuk furnizojnë, siç ka thënë Allahu: “Ju adhuroni përpos Tij, veçse emra të cilët ju i keni sajuar, ju dhe baballarët tuaj, për të cilët Allahu nuk ka dërguar asnjë provë e mbështetje.” (Jusuf, 40)

Për *mutekelimin*-ët, – fjala *Ilah*¹, do të thotë: i Plotfuqishëm për krijim. Atëherë kuptimi i shprehjes “*La ilahe il’All-llah*” do të thotë: nuk ka të Pushtetshëm për krijim veç Allahut. – teuhid sipas tyre do të thotë: ta njësoh Allahun e të thuash se Ai është Një në Qenien e Tij dhe i Pandashëm. Ai është i Vetëm në veprat e Tij, pa ortak, është i Vetëm në cilësitë e Tij e s’ka të ngjashëm.²

Por, sikur të ishte ky kuptimi i shprehjes “*La ilahe il’All-llah*”, kurejshët nuk do të ishin mohues të thirrjes së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), përkundrazi, do të ishin besimtarë, sepse kurejshët e pranonin se s’ka Krijues tjetër përveç Allahut. Fjala “Krijues” është më e fortë se fjala “i Pushtetshëm”, sepse i pushtetshmi mund të veprojë, por edhe mund të mos veprojë, ndërsa Krijuesi ka vepruar dhe realizuar me pushtetin e Tij. Kështu kuptimi i kurejshëve për Zotin ishte më i plotë se kuptimi i *mutekelimin*-ëve të cilët janë pjesë e Islamit. Teuhidi me të cilin erdhën Profetët është pikërisht ashtu siç përmendet në thënien e Allahut të Madhëruar: “Ju nuk keni ndonjë të adhuroar tjetër veç Tij” pra të Adhuroar të vërtetë që meriton të adhurohet, e Ai i Cili e

¹ Siç e dimë shpjegimi i fjalës *ilah* në arabisht me kuptim e rububijes duke e komentuar si: “i Plotfuqishëm për krijim” (el-kadiru aalel ihtira), “i pavarur nga të gjithë, ndërsa të gjithë të tjerët varen nga Ai” (el mustegni amma siuahu elmuftekir ilejhi kul-lu men adahu) është një gabim i esharinjëve të cilët pohuan se kjo fjalë rrjedh nga “*elihe -j’elehu- alihun*” që ka kuptimin e hutimit të mendjeve. Kjo është njëra prej arsyeve pse ata pohuan se motoja e profetëve ishte: teuhidi err-rububije. E drejta është se fjala *ilah* rrjedh nga *elihe – j’elehu – m’eluhun*” d.m.th. i adhuroar, se shehadeti shpreh njëshmërinë e Allahut në adhurim dhe në këtë thirrjen të gjithë pejgamberët, ndërsa kuptimi që i kanë dhënë esharitë është i dobët gjuhësisht.

² Ata nuk thonë se Ai është i Vetëm në adhurimin e Tij (Kjo pjesë është marrë nga botimi i parë).

meriton këtë është Allahu.

Është për të ardhur keq kur sheh shumë shkrimtarë që shkruajnë sot në këto tema, kur flasin për teuhidin kufizohen vetëm në aspektin e njohjes së Zotit si Krijues. Ky është gabim dhe një mangësi e madhe. Ne duhet të mbjellim në zemrat e muslimanëve *teuhidin e adhurimit* më shumë, sepse Zotin si Krijues te vetëm askush nuk e ka mohuar me mohim të vërtetë. Kur ne pohojmë vetëm këtë gjë e cila ndodhet në natyrën e njeriut, është e pranuar nga logjika e shëndoshë dhe në anën tjetër heshtim ndaj asaj mbi të cilën ngadhënjën epshi, tregon një mangësi të madhe. Adhurimi i dikujt tjetër veç Allahut ndodh kur brenda njeriut ngadhënjëjnë dëshirat përkundër *fitra-s* (natyrshmërisë së pastër), derisa e shmangin atë nga adhurimi i Allahut të Vetëm duke e bërë të adhurojë eulija (njerëz të mirë) dhe egon e vet. Njerëzit që kanë shqetësim të tyrin kryesor dërhemin dhe dinarin Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka quajtur adhurues të tyre. Po ashtu Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “A e ke vënë re atë njeri që dëshirat e veta i mori për zot.” (Xhathijeh, 23)

Mëkatet në kuptimin e përgjithshëm mund t’i konsiderojmë si shirk, ndërsa në kuptim të posaçëm i ndajmë në disa lloje:

1. shirk i madh,
2. shirk i vogël,
3. mëkat i madh,
4. mëkat i vogël.

Ka mëkate që lidhen me të drejtën e Allahut, ka që lidhen me të drejtën e vetë njeriut dhe ka që lidhen me të drejtën e krijesave.

Realizimi i dëshmisë ‘*La ilahe il’All-llah*’ është një çështje mjaft e vështirë, ndaj disa selefë kanë thënë se “çdo mëkat është një lloj shirku”.

Disa nga selefët kanë thënë: “Nuk jam përpjekur për diçka tjetër siç kam bërë për sinqeritetin.” Këtë e njeh dhe e kupton vetëm besimtari, ndërsa jobesimtari nuk pyet për sinqeritetin. Lidhur me këtë i janë drejtuar Ibn Abasit: “Çifutët thonë se nuk kanë ngacmime në namaz.” Ai u përgjigj: “E ç’të bëjë shejtani me një zemër të prishur? Ai nuk vjen të shkatërrojë atë që është tashmë e prishur, por atë që është e rregullt.”

Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i kanë thënë se njeriu gjen

në vetvete disa gjëra që kurrsesi nuk mund t'i shprehë. Ai u tha: “A gjendet vërtet te ju?” “Po”, iu përgjigjën. Ai tha: “Ky është imani më i fortë.” Pra, kjo është shenjë se imani është i fortë, sepse ai nuk e dëshiron këtë, e kjo gjë ndodh vetëm në zemrën e shëndoshë.

– *“Kush dëshmon se s’ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut ...”* – Fjalja këtu është kushtore, ndërsa veprimi që ndodh me plotësimin e kushtit është: “Allahu do ta fusë në Xhenet sido që të ketë punuar.”

Dëshmia e vërtetë është ta shprehësh me gjuhë, ta besosh me zemër dhe ta vërtetosh me punë, e në të kundërt ajo është gënjeshtër. Kur munafikët i thanë Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) “Ne dëshmojmë se ti je vërtet i Dërguar i Allahut”, – deklaratë e cila në gjuhën arabe vjen me tri fjalë përforcuese: *“neshhedu”* (dëshmojmë), *“ine”* (se pa dyshim) dhe shkronja *“lam”* (të sigurt) – Allahu i përgënjeshtroi me thënien e Tij: “Allahu e di se ti je i Dërguari i Tij, Allahu dëshmon se hipokritët janë me të vërtetë gënjeshtarë” (Munafikun, 1). Atyre nuk u bëri dobi pohimi me gjuhë, sepse ai ishte i zbrazur nga besimi me zemër dhe nga vërtetimi me punë. Përfundimisht, themi se dëshmia nuk realizohet pa besim me zemër, shprehje me gjuhë dhe pa vërtetim me punë.

– *“S’ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut”* – Kjo shprehje do të thotë se s’ka të adhuruar tjetër, në atë formë që meriton të adhurohet përveç Allahut. Idhujt të cilët adhurohen nuk e meritojnë adhurimin, sepse ata nuk kanë asgjë prej veçorive të Adhuruarit të Vërtetë.

– *“... të vetëm e pa ortak ...”* – Pjesa e parë përmban pohim, ndërsa pjesa e dytë mohim. Pra, u mohohet të tjerëve gjithçka që është e posaçme për Allahun, qofshin këto veprat e Tij, qofshin emrat dhe cilësitë e Tij.

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe besimtarët e tjerë mbështeteshin veç tek Allahu kur ishin në vështirësi. Njëherë, një beduin iu drejtua Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), pranë të cilit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishin dhe disa shokë të tij. Beduini rrëmbeu shpatën, të cilën Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-

lem) e kishte varur në pemë dhe i tha: “Kush të mbron tani prej meje?”, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u përgjigj: “Më mbron Allahu”.¹ Ai nuk tha: “Shokët e mi”. Ky është realizimi i teuhidit *rrububije* (veprimet e posaçme të Zotit të cilat nuk i kryen kush tjetër veç Tij), sepse Allahu është Ai që e zotëron dobinë, dëmin, krijimin, rregullimin e punëve të gjithësisë dhe trajtimin e saj si të dëshirojë Ai. Ai është pa ortak në gjithçka që i përket vetëm Atij, si në vepra, adhurime, në emra e cilësi. Themë që i përket vetëm Atij, me qëllim që të shpëtojmë nga dyshimet e shumta. Këto dyshime rrjedhin prej mohuesve të cilësive, të cilët pretendojnë se pohimi i cilësive është *shirk*, duke argumentuar se prej këtij pohimi rrjedh domosdoshmërisht përngjasimi i tyre me cilësitë e krijësive. Ndërsa ne u themi se Krijuesi ka cilësi të vetat, të posaçme për Të, ashtu si krijësat kanë cilësi që u përshtaten atyre.

– “... se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij. ...” – “Muhamedi” këtu është Muhamedi i biri i Abdullahut, të birit të Abdul Mutalibit, prej popullit kurejsh, nga fisi Hashim, i cili ishte vula e Profetëve.

– “... robi i Tij ...” – Do të thotë se Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk është ortak me Allahun.

– “... dhe i Dërguari i Tij. ...” – Do të thotë se ai u dërgua me shpallje prej Zotit dhe nuk ishte gënjeshtar.

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte rob i krijuar dhe kishte të gjitha cilësitë e njerëzve, përveç moralit të ulët, prej të cilit ai ishte i mbrojtur. Allahu i Lartësuar thotë: “Thuaj: Unë nuk mund t’i sjell vetes as dobi, as dëm, përveçse aq sa dëshiron Allahu.” (Araf, 188). Po kështu: “Thuaj: “Unë nuk mundem t’ju largoj ndonjë dëm e as t’ju sjell ndonjë dobi.” Thuaj: “Edhe mua askush nuk mund të më mbrojë nga dënimi i Allahut, dhe nuk gjej strehim tjetërkund, përveçse tek Ai.”” (Xhin, 21-22). Ai ishte njeri sikurse edhe ne, vetëm se atij i erdhi Shpallja hyjnore: “Thuaj (o Muhamed): “Në të vërtetë unë jam vetëm një njeri, si ju. Mua më është shpallur që Zoti juaj është Një.”” (Fusilet, 6).

¹ Buhariu.

Thënia të tilla si: Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk lëshonte hije kur ecte në diell, sepse hijen ia hiqte drita e tij, janë gënjeshtër krejt të pabaza. Për këtë, Aishja (i kënaqur qoftë Allahu me të!) thoshte: “Kur i zgjasja këmbët përpara tij, i kërkoja ndjesë, se nuk kishim kandil në dhoma.” Sikur Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të kishte dritë personale, ajo nuk do të kërkonte ndjesë, prandaj themi se kjo është pjesë e teprimeve, të cilat prishin fenë dhe jetën e kësaj bote. Lusim Allahun të na mbrojë! Teprim janë edhe fjalët e Busirit në një nga poezitë e tij:

O krijesa më e nderuar,
Kur të zezat t’më kenë pushtuar,
Ndihmë veç ty kam për t’kërkuar!
Në s’më shpëton në t’Gjykimit Ditë,
Thuaj “mjerë” për mua, që kam rrëshqitë.
Dynja dhe ahiret – prej bujarisë që pate,
Prej dijes që ke ti, janë shkruar këto fate.

Në lidhje me këtë, Ibn Rexhebi dhe të tjerë kanë thënë se, në këtë mënyrë, ky autor nuk ka lënë asgjë për Allahun, përderisa dynjaja dhe ahireti qenkan “nga bujaria e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem)”! Ne dëshmojmë se ai që e thotë këtë, nuk ka dëshmuar se Muhamedi është rob i Allahut, përkundrazi, ka dëshmuar se Muhamedi është mbi Allahun. Si i ka çuar teprimi deri në këtë pikë?! Ky tejkalim kufijsh është edhe më i madh se ai i të krishterëve, që thonë se Mesihu është bir i Zotit dhe se Allahu është “njëri prej të Treve” (Trinia).

Ka njerëz që shprehen: Allahu thotë: “Atë që më përmend Mua në një grup, Unë e përmend atë në një grup më të mirë; Unë jam me robin Tim kur ai më përmend Mua”, kështu që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është me ne, kur ne e përmendim atë. Për këtë arsye, gjatë mevludeve,¹ kur lexohet fjala e Mustafait, ngrihen që të gjithë në këmbë, duke mëtuar se ngrihen për të respektuar Profetin, që ndodhet mes tyre. Sahabët (radij-Allahu ‘anhum) kanë qenë ndaj Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) shumë herë më të respektueshëm se këta e se ne, megjithatë, kur Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) hynte mes tyre e u fliste, ata nuk çoheshin, ndërsa këta ngrihen vetëm duke imagjinuar ose duke

¹ Festimi i Mevludit është bidat.

parë ndonjë fantazmë – nëse me të vërtetë shohin diçka. Shiko se deri ku ka arritur logjika e tyre! Këta nuk kanë dëshmuar se Muhamedi është rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij, por janë matufë të ulët. Nëse i shohim nga këndi i *kaderit* (paracaktimit dhe krijimit), ata janë për të ardhur keq, por ne lusim Allahun t'i shpëtojë. E nëse i shohim nga aspekti i ligjeve fetare, ne duhet t'i kundërshtojmë, derisa të kthehen në rrugën e drejtë.

Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e adhuronte Allahun dhe i frikësohej Atij më shumë se çdokush tjetër. Ai ngrihej e falte namaz derisa i ënjteshin këmbët, edhe pse i ishin falur gjynahet e kaluara dhe ato të ardhshme. Kur e pyetën përse e bënte një gjë të tillë, ai u përgjigj: “A të mos jem rob falënderues?!” Ky është realizimi i adhurimit.

Në lidhje më Shpalljen ai ishte Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) të cilin Allahu e dërgoi me legjislacionin më të plotë të gjitha krijesat. Ai ua përcolli mesazhin atyre në formën më të mirë, edhe pse ata i shkaktuan mundime, edhe pse u luftua, derisa i hodhën edhe shtratin e këlyshit të devesë mbi shpinë, kur ishte në sexhde, në Qabe. Të gjitha këto i bënë nga urrejtja ndaj tij dhe ndaj mesazhit që ai solli, megjithatë ai i duroi. Ata i hidhnin mbeturina e plehra në pragun e derës, dhe kjo ishte (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) sprovë për të nga Allahu i Madhëruar, me qëllim që të dukej durimi dhe vlera e tij. Ai dilte dhe u thoshte: “E çfarë fqinjësie është kjo, o fisi i Abdul Menafit?!” Kjo vazhdoi derisa Allahu i dhuroi fitore. Ai ftoi në Islam banorët e Mekës dhe rrethinat e saj. Më pas e mbartën këtë fe njerëzit që e ruanin më shumë amanetin dhe më të fortët në pasim, sahabët (radij-Allahu 'anhum), të cilët, më pas, e përçuan tek umeti të pastër e pa mangësi. Allahut i takon falënderimi!

Ne e duam Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) për hir të Allahut dhe në sajë të Allahut. Dashuria ndaj tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është pjesë e dashurisë ndaj Allahut. Ne i japim përparësi atij mbi vetet tona, fëmijët tanë dhe njerëzve në përgjithësi. E duam atë për shkak se ai është i Dërguari i Allahut dhe e realizojmë dëshminë se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, duke e besuar atë me zemrat tona, duke e shprehur me gjuhë dhe duke e jetësuar me ndjekjen e rrugës së tij në veprat tona. Ne

punojmë sipas rrugës së tij, por nuk punojmë për të.¹ Faktorët që e prishin realizimin e kësaj dëshmie janë:

1. Kryeja e mëkateve. Mëkati është mangësi në realizimin e kësaj dëshmie, sepse me kryerjen e tij ke dalë nga udha e Profetit (sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem).

2. Sajimet në fe. Çka nuk është pjesë e fesë është mangësi në realizimin e kësaj dëshmie, sepse kështu kërkohet afrimi tek Allahu me anë të diçkaje që nuk e ka ligjëruar as Allahu, as i Dërguari i Tij. Bidati në fe, në të vërtetë, është tallje me Allahun, sepse kështu kërkon t’i afrohesh me një vepër që Ai nuk e ka ligjëruar. Nëse qëllimi është afrimi tek Allahu, gabimi është në rrugën që ke ndjekur, pavarësisht qëllimit. Kundërshtimi i rrugës së drejtë nuk mund të justifikohet, në momentin që e mëson të vërtetën.

Për praktikuesit e bidatit, kur nuk e dinë të vërtetën, themi se ata do të shpërblehen për nijetin, megjithëse e konsiderojmë krejtësisht të gabuar veprimin e tyre. Ndërsa prijësit e tyre, të cilët e dinë të vërtetën, por nuk e pranojnë për të ruajtur pozitën e tyre, i ngjajnë Ebu Xhehlit, Utbe Ibn Rebias, Uelid Ibn Mugires e të tjerë, të cilët e pritën shpalljen e Profetit (sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem) me refuzim, për hir të pozitës së tyre udhëheqëse. Pasuesit e këtyre prijësve ndahen në dy grupe:

- Ata që nuk e dinë të vërtetën, nuk kanë mësuar gjë për të dhe nuk e kanë lënë mangët kërkimin e saj, aq sa mendojnë se mënyra e tyre është e vërteta; këta janë të justifikuar.

- Ata të cilët e njohin të vërtetën, por e refuzojnë nga fanatizmi për prijësit e tyre. Këta nuk janë të justifikuar, por janë si ata që përshkruan Allahu: “Ne gjetëm baballarët tanë të ndjekin njëfarë rruge e një lloj feje, dhe sigurisht që Ne do të ndjekim gjurmët e tyre.” (Zuhruf, 22).

– “... se Isai është rob i Allahut dhe i Dërguar i Tij ...” – Dëshmia për Isain është si dëshmia për Muhamedin (sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem), që është i Dërguari i Allahut. Ne besojmë në profetësinë e Isait (alejhi selam), por nuk ndjekim rrugën e tij kur legjislacioni i tij

¹ Detyrimi ynë ndaj Profetit është: 1- Të besojmë se ai është i Dërguari i Allahut; 2- ta duam për hir të dashurisë ndaj Allahut të Madhëruar, dhe 3- të realizojmë dëshminë se ai është i Dërguari i Allahut. (Marrë nga botimi i parë).

kundërshton legjislacionin tonë.

Në legjislacionet para nesh, përkundër Sheriatit të sotëm, mund të dallojmë tri raste:

- 1- Kanë pasur ligje që kundërshtojnë legjislacionin tonë. Në këtë rast ne punojmë sipas legjislacionit tonë.
- 2- Kanë pasur ligje që përputhen me legjislacionin tonë. Edhe në këtë rast ne jemi pasues të legjislacionit tonë.
- 3- Kanë pasur ligje për të cilat legjislacioni ynë ka heshtur. Për këtë rast, dijetarët e jurisprudencës islame kanë mendime të ndryshme nëse duhet punuar me ato ligje apo jo. Mendimi më i drejtë është se këto ligje janë edhe për ne. Argument për këtë është thënia e Allahut: “Ata janë të cilët Allahu i udhëzoi, kështu që ndiqni udhëzimin e tyre.” (En’am, 90) dhe: “Në tregimet e tyre ka mësimet e përvojë për të zotët e mendjes.” (Jusuf, 111)

Në lidhje me Isain (alejhi selam) kanë kaluar në ekstrem dy grupe:

- Çifutët, të cilët e mohuan dhe thanë se ai ishte fëmijë i lindur nga imoraliteti, se nëna e tij qe lavire dhe se ai nuk ishte Profet. Në gjykimin e fesë, për Allahun ata gjykohen sikur ta kenë vrarë, sipas thënies së Tij: “... dhe për shkak të thënies së tyre (duke u mburrur): ‘Ne e vramë Mesihun, Isain, birin e Merjemes.’” (Nisa, 157). Realisht nuk ndodhi ashtu, sepse ata nuk e vranë. Përkundrazi, Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) e ngriti Isain në qiell, kurse ata vranë dhe kryqëzuan një tjetër, që atyre u ngjau si Isai (‘alejhis-selam).
- Të krishterët, të cilët thanë se Isai është biri i Allahut dhe i dyti i Trinisë, e bënë atë të adhuruar me Allahun, duke thënë të pavërteta.

Ne dëshmojmë që ai ishte rob i Allahut dhe Profeti i Tij, dëshmojmë se nëna e tij ishte besnike dhe e sinqertë, ashtu siç e ka përshkruar Allahu i Madhëruar. Ajo e ruajti dëlirësinë e saj dhe ishte e pamartuar. Rasti i Isait për Allahun është si ai i Ademit, të cilin Allahu e krijoi nga balta dhe pastaj i tha “bëhu!” e ai u bë.

Deklarata se ai ishte “rob i Allahut” është kundërpërgjigje ndaj të krishterëve, ndërsa pjesa “dhe i Dërguar i Tij” është kundërpërgjigje

ndaj çifutëve.

– “... dhe Fjala e Tij, të cilën ia dërgoi Merjemes ...” – Allahu i Lartësuar përdor termin “fjalë”, sepse Isai u krijua me fjalën “Bëhu!”. Ky term nuk mund të kuptohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Isai (alejhi selam) nuk qe thjesht “fjalë”, sepse ai hante, pinte, kryente jashtëqitje dhe kishte të gjitha vetitë njerëzore. Allahu i Lartësuar thotë: “Rasti i Isait për Allahun është si rasti i Ademit, të cilin Ai e krijoi prej baltës e pastaj i tha: ‘Bëhu!’ dhe ai u bë.” (Ali Imran, 59). Isai (alejhi selam) nuk ishte fjalë e Allahut, pasi fjala e Allahut është cilësi e Qenies së Allahut e, si e tillë, ajo është e pandashme prej Tij. Ai (alejhi selam) ishte qenie e ndarë nga Allahu, shkante e vinte, hante ushqim dhe pinte.

– “... të cilën ia ka dërguar Merjemes ...” – Pra, fjalën: “Bëhu!” që ia drejtoj Merjemes, dhe kështu Isai (‘alejhis–selam) u krijua, ashtu siç thotë Allahu i Madhëruar: “Rasti i Isait për Allahun është si rasti i Ademit që e krijoi prej baltës e pastaj i tha: ‘Bëhu!’ dhe ai u bë.” (Ali Imran, 59).

Merjemja, bija e Imranit, nuk ishte motra e Musait dhe Harunit (*alejhimu selam*), siç mendojnë disa njerëz, por është ashtu siç thotë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), se: “Ata thirreshin me emrat (vinin emrat) e Profetëve të tyre.”¹ Haruni vëllai i Merjemes nuk është Haruni vëllai i Musait, përkundrazi ai ishte një tjetër që thërritej me emrin e tij. Po ashtu edhe Imrani thirrej me emrin e babait të Musait, Imranit.

– “... si dhe shpirt (i krijuar) prej Tij. ...” – Pra, trupi i Isait (alejhi selam) u formua me urdhrin krijues “Bëhu!”, e pas formimit, trupit të tij iu dha shpirti që, në fakt ishte krijuar nga Allahu. Shpirti i Isait (‘alejhis–selam) është një prej krijesave të Zotit, që i atribuohet Atij për fisnikërim dhe nderim. Isai (alejhi selam) nuk ishte vetëm shpirt, por ishte trup me shpirt. Allahu i Lartësuar thotë: “Mesihu, biri i Merjemes, është vetëm një i Dërguar. Edhe para tij kanë kaluar të Dërguar ...” (Maide, 75). Me ‘fryrjen’ (nga Xhibrili) u formua trupi, ndërsa me ‘shpirtin’ ai u bë trup dhe shpirt.

¹ Muslimi.

– “... prej Tij. ...” – Kjo frazë është ajo që i bëri të krishterët, dhe shumë të tjerë, të humbnin, se menduan që ai ishte pjesë e Allahut. Ndërsa ne themi se Allahu i verboi shikimet e tyre, apo më mirë të themi zemrat brenda në kraharor, sepse është e njohur që Isai (alejhi selam) hante ushqim, e gjithashtu dihet se çifutët mëtuan që e kryqëzuan. A mundet që një pjesë e Krijuesit të ndahet prej Tij, e pastaj kjo pjesë të hajë, të pijë e të pretendohet se u vra e u kryqëzua?! Atëherë fjala “prej” nuk tregon origjinën e pjesës, por kuptohet si në thënien e të Madhëruarit: “Ai ka vënë në shërbimin tuaj çka gjendet në qiej dhe në Tokë; të gjitha janë prej Tij.” (Xhathijeh, 13). Ne nuk mund të themi se dielli, hëna dhe lumenjtë janë pjesë e Allahut, madje këtë askush nuk e deklaroi. Atëherë shprehja “prej Tij”, do të thotë “një shpirt që burimin e ka nga Allahu i Madhëruar e që nuk është pjesë e Tij”, siç pretendojnë të krishterët.

Tri kategori Allahu i Madhëruar i ka quajtur “të Vetat”:

1. Qeniet e mëvetësishme. Këto quhen “të Tij” sepse janë të krijuara prej Tij. Në këtë kategori mund të përfshihen të gjitha krijesat, siç thuhet në ajetet: “Ai ka vënë në shërbimin tuaj çka gjendet në qiej dhe në Tokë; të gjitha janë prej Tij” apo: “Tokë Ime është vërtet e gjerë.” (Ankebut, 56). Por mund të futen edhe krijesa të posaçme, si nderim për to, siç vjen në fjalën e Allahut: “... Pastrojeni Shtëpinë Time (Qabenë).” (Bekare, 125) dhe: “Kjo është deveja e Allahut.” (Shems, 13).

2. Diçka që i atribuohet krijesës te e cila qëndron dhe që përbën një pjesë të saj. Shembull për këtë është thënia e Allahut: “*shpirti prej Tij*”. (Nisa, 171). Deklarimi këtu që ky shpirt është prej Tij do të thotë që ai i përket krijesave të Zotit. Nënvizimi i kësaj përkatësie është bërë si vlerësim dhe nderim për këtë krijesë të caktuar. Kështu, ai është shpirt si të gjithë shpirtrat e tjerë që ka krijuar Allahu, domethënë nuk është pjesë e Tij ose e lidhur me Të. Ky shpirt u fut tek Isai (alejhi selam) i cili ishte qenie e mëvetësishme, e ndarë nga Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala). Edhe ky lloj është i krijuar.

3. Atributin që nuk është diçka e krijuar. Shembull për këtë është fjala e Allahut: “Unë të kam zgjedhur ty mbi gjithë njerëzit me

kumtimet e Mia dhe të folurin Tim.” (Araf, 144). Kumtimi dhe fjala, në këtë rast, i mvishen Allahut, sepse ato janë realisht attribute të Tij, të Qenies së Tij, dhe nuk janë të krijuara.

Me këtë shtjellim qartësohet se nga këto tri kategori, dy janë të krijuara, ndërsa njëra jo. Qeniet e mëvetësishme dhe ato që u bashkëngjiten krijesave, janë të krijuara, ndërsa cilësitë për të cilat nuk përmendet krijesa ku ajo qëndron, nuk janë të krijuara; ato janë cilësi të Allahut, dhe cilësitë e Tij nuk janë të krijuara. Këto dy lloje të ndryshme nga njëra-tjetra (të krijuara dhe të pa krijuara) i gjen brenda hadithit të mësipërm: “*Fjala e Tij*” dhe “*shpirt prej Tij*”. “*Fjala*” është atribut që këtu i bashkëngjitet Allahut dhe, sipas asaj që thamë më lart, ajo është një nga atributet e Allahut. Nga ana tjetër, “*shpirt prej Tij*” i bashkëngjitet një qenieje, sepse shpirti hyri tek Isai, kështu që ai është i krijuar.

– “*...e fut Allahu në Xhenet.*” – Futja në Xhenet është në dy mënyra:

1. Hyrje e menjëhershme, pa dënim përpara, për atë që i ka veprat e plota.
2. Hyrje jo e menjëhershme, e paraprirë nga dënimi, për atë që ka mangësi në vepra.

Besimtarin, i cili veprat e këqija i ka më të shumta se të mirat, Allahu, nëse do, e dënon sipas veprave, e nëse do, e fal: “Vërtet, Allahu nuk e fal të shoqërohet dikush a diçka me Të, por fal veç kësaj atë që dëshiron.” (Nisa, 116).

Po prej atyre të dyve, përcillet hadithi i Itbanit: “Me të vërtetë Allahu ia ka ndaluar Zjarrit të përfshijë atë që thotë *La ilahe il’All-llah*, duke pasur për qëllim me të Fytyrën e Allahut.”¹

Itban Ibn Maliku ka qenë ensar (radijAllahu ‘anha). Ai falej si imam te populli i tij, por iu dobësua shikimi dhe iu bë e vështirë të dilte. Kështu kërkoi nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) që ai të vinte e të falej në një vend të shtëpisë së tij duke e kthyer atë në

¹ Buhariu dhe Muslimi.

vendfalje. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) shkoi tek ai bashkë me një grup sahabësh, mes të cilëve ishin edhe Ebu Bekri me Omerin (radij-Allahu ‘anhum). Pasi u fut në shtëpi, e pyeti: “Ku dëshiron që të falem?” Ai iu përgjigj: “Falu këtu!”, duke i treguar vendin. Profeti u priu atyre, duke falur dy rekatë namaz. Pastaj u ul në sofrën që kishin përgatitur për të, e filluan të diskutojnë për një burrë që quhej Malik Ibn Duhejshin. Disa thanë se ai qe munafik, por Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ua ktheu: “Mos thoni kështu. A nuk dëshmon ai se s’ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut?” Pastaj tha: “Me të vërtetë Allahu ia ka ndaluar Zjarrit atë që thotë *La ilahe il’All-llah*, duke pasur për qëllim me të Fytyrën e Allahut.”

Ai i ndaloi të flisnin ashtu, me arsyen se ata nuk e dinin ç’kishte në zemrën e tjetrit, kur dihej se ai dëshmonte: *La ilahe il’All-llah*. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk e shpalli “të pastër” personin në fjalë, por solli një shprehje të përgjithshme: se “Allahu ia ka ndaluar Zjarrit atë që thotë *La ilahe il’All-llah*, duke pasur për qëllim me të Fytyrën e Allahut”. Ai ndaloi ta lëshojmë gjuhën ndaj njerëzve, pamja e jashtme e të cilëve është e mirë, e të themi se filani e bën për sy e faqe, ky tjetri është i prishur etj., sepse në këtë mënyrë, nëse do të gjykonim sipas asaj që mendojmë, do të shkatërronim dynjanë dhe ahiretin e shumë njerëzve. Ne mund të mendojmë për shumë njerëz se janë të këqij, por nuk na lejohet ta themi këtë kur në dukje ata janë të rregullt. Në lidhje me këtë, dijetarët thonë se është e ndaluar të mendojmë keq për një besimtar, kur në paraqitje ai është i drejtë.

– “... ia ka ndaluar Zjarrit ...” – Pra, e ruan nga Zjarri ose e ndalon Zjarrin që ta djegë atë person, gjithmonë n.q.s. personi është i sinkertë. Argument për këtë është vazhdimi.

– “... duke pasur për qëllim me të Fytyrën e Allahut.” – Domethënë me këtë deklaratë duhet të synohet vetëm shikimi në Fytyrën e Allahut. Kush kërkon Fytyrën e Allahut, patjetër punon gjithçka që është në mundësinë e tij për t’ia arritur qëllimit; ai që realisht dëshiron diçka, përpiqet për arritjen e saj. Sipas kësaj që thamë, nuk kemi nevojë për thënien e Zuhriut (Allahu e mëshiroftë!), i cili, pasi ka sjellë hadithin, që gjendet në “Sahihun” e Muslimit, thotë:

“Pas kësaj, bëhen detyrë disa gjëra dhe ndalohen disa të tjera, kështu që të mos mashtrohet ndokush me këtë.” Hadithi tregon qartë se kushti i pranimit të shprehjes *La ilahe il’All-llah* është të kesh qëllim parjen e Fytyrës së Allahut. Për këtë arsye, disa selefë, në lidhje me këtë hadith, kanë thënë; “çelësi i Xhenetit është fjala *La ilahe il’All-llah*, por atij që mban një çelës pa dhëmbë, nuk i hapet dera.

Shejhu i Islamit Ibn Tejmije ka thënë: “Dëshiruesi i diçkaje duhet patjetër të realizojë kushtet për arritjen e saj; në këtë rast, nëse i realizon ato (bën veprat dhe plotëson kushtet), atij i ndalohet Zjarri plotësisht. Nëse ai vjen me vepra të mira e të plota, edhe Zjarri i ndalohet plotësisht, por nëse veprat janë me mangësi, edhe dëshira është e mangët, kështu që edhe ndalimi i Zjarrit për të nuk ka për të qenë i plotë. Gjithsesi, teuhidi i tij do ta mbrojë nga qëndrimi i përhershëm në Zjarr. Nga ana tjetër, nëse dikush që bën imoralitet, pi alkool apo vjedh, e pastaj thotë: ‘Dëshmoj se s’ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe, përmes kësaj fjale, dëshiroj Fytyrën e Tij’, ai është pretendues i rremë, pasi Profeti (alejhi selam) ka thënë: ‘Gjatë kohës kur imorali bën imoralitet, nuk është besimtar’, e mos llogarit pastaj dëshirën për Fytyrën e Allahut.”

Hadithi është njëkohësisht kundërpërgjigje ndaj *murxhive*, *havarixhëve* dhe *mutezilëve*. *Murxhitë* thonë se mjafton për të hyrë në Xhenet thënia *La ilahe il’All-llah*, qoftë edhe pa dëshiruar Fytyrën e Allahut. Ndërsa *havarixhët* dhe *mutezilët* thonë se vepruesi i gjynaheve të mëdha do të jetë i përhershëm në Zjarr, kur nga konteksti i hadithit del qartë se ai që bën këto gjynahe e meriton dënimin, por nuk do të ndëshkohet përjetësisht.

Ebu Seid el Hudriu përcjell nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) se: “Musai tha: ‘O Zot, më mëso mua diçka, me të cilën të të përmend Ty dhe të lutem me të.’ Allahu i tha: ‘O Musa, thuaj *La ilahe il’All-llah*.’ Ai tha: ‘O Zot, të gjithë robërit e Tu e thonë këtë!’ Allahu i tha: ‘O Musa, sikur shtatë qiejt dhe banorët e tyre, përveç Meje, si dhe shtatë tokat të jenë në një anë të peshores, dhe fjala *La ilahe il’All-llah* në anën tjetër të saj, më shumë do të

rëndojnë fjala *La ilahe il'All-llah*.”¹

Musai (alejhis selam) kërkoi diçka me anë të së cilës arrihen dy gjëra: *dhikri* (përmendja) i Allahut dhe lutja, ndërsa Allahu iu përgjigj me fjalët: “Thuaj: *La ilahe il'All-llah*”. Kjo shprehje është përkujtim i Zotit, që përmban edhe lutje, sepse ai që bën *dhikër* synon të arrijë kënaqësinë e Allahut dhe Xhenetin e Tij.

Ibn Abasi ka argumentuar se, në vargjet e mëposhtme, përkujtimi i Zotit ka kuptimin “lutje”:

Kur robi Ty të përkujton,
i mjafton Ai të Cilin synon.

– “... të gjithë robërit e Tu e thonë këtë ...” – Nuk do të thotë se fjala *La ilahe il'All-llah* është pa vlerë, sepse Musai (alejhi selam) e njihte madhësinë e saj, por ai kërkonte diçka që të ishte e posaçme për të, sepse kjo tregon gradën dhe pozitën e një njeriu. Allahu i sqaron Musait se çfarëdo që t'i jepte, nuk do të ishte më e vlefshme se ajo deklaratë. Ajo është më e madhe dhe më e rëndë sesa qiejt dhe toka. Kjo tregon vlerën dhe madhësinë e fjalës *La ilahe il'All-llah*, por, gjithmonë, duke përmbushur kushtet e saj. Nëse dikush e thotë thjesht me gjuhë, (sa njerëz e thonë atë!) ajo për ta është pa peshë, si pupël, sepse nuk e ka thënë në atë formë që të plotësohen me të kushtet e saj dhe mohohen pengesat.

– “... përveç Meje.” – Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) e ka përjashtuar Vetën e Tij, sepse fjala “*La ilahe il'All-llah*” është lavdërim që i bëhet Atij, dhe Ai që lavdërohet është më madhështor se vetë lavdërimi.

Tani kemi prekur një çështje, që duhet të jetë e qartë: ekzistenca e Allahut në qiell nuk është si ajo e melekëve. Ekzistenca e melekëve në qiell lidhet me nevojën; ata banojnë në qiell pasi kanë nevojë për të. Nga ana tjetër, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) nuk ka nevojë për qiellin, përkundrazi, qielli e të tjera krijesa kanë nevojë për Allahun. Kështu që askush të mos mendojë se qielli e mban Allahun, se e mbulon apo se e përfshin Atë. Për melekët, qielli ku qëndrojnë është

¹ Ibn Hibani dhe Hakimi. Por sipas Albanit hadithi është i dobët.

vendi i tyre mbajtës, ndërsa qiejt e tjerë mbi ta, janë si strehë mbi ta. Për sa i përket Allahut, qiejt janë thjesht një anë¹, sepse Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) është i lartësuar mbi Arshin e Tij dhe asnjë nga krijesat e Tij nuk e mban Atë.

Tirmidhiu përcjell nga Enesi **(r.a.)** – duke e quajtur hadithin *hasen* – se ai e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të thotë: “Allahu i Lartësuar thotë: ‘O biri i Ademit! Nëse më vjen Mua me pothuajse sa toka me gjynahe, pastaj më takon duke mos më shoqëruar asgjë, Unë do të vij tek ty po me aq falje.’”

– “... Allahu i Lartësuar thotë: ‘O biri i Ademit! ...’ – Ky është një hadith *kudsi*. Hadith *kudsi* është ai që i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka përcjellë nga Allahu. Dijetarët e hadithit e kanë renditur ndër hadithet profetike, sepse është komunikim i të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Dijetarët janë të një mendimi që hadithi *kudsi* nuk është pjesë e Kuranit, edhe pse i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ia ka përcjellë umetit të tij këtë kumt nga Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala).

Dijetarët (Allahu i mëshiroftë!) janë ndarë në dy mendime për sa i përket tekstit të hadithit *kudsi*: a citohen aty fjalë të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), apo Allahu i ka shpallur të Dërguarit të Tij kuptimin, ndërsa shprehja është prej të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Mendimi i parë: Hadithi *kudsi* ka ardhur nga Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) si në shprehje ashtu edhe në përmbajtje, sepse Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ia ka atribuar thëniet Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Dihet se fjala e atribuar dikujt përmban shprehjen e thënësit e jo të përcjellësit, sidomos në rastin e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), i cili ka qenë njeriu më besnik në përmbushjen e amanetit dhe më i sakti në përcjellje.

Mendimi i dytë: Hadithi *kudsi* është nga Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) vetëm në përmbajtjen e tij, ndërsa shprehja është prej të

¹ Në raport me Allahun qiejt dhe çka nën to janë në anën e poshtme, ndërsa Allahu është në lartësi.

Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem); dhe kjo për dy arsye:

E para, sikur shprehja dhe kuptimi i hadithit *kudsij* të ishte nga Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), vargu i përcjelljes së tij do të ishte më i lartë se i Kuranit, sepse i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e përcjell atë nga Zoti i tij pa ndërmjetës, siç del nga konteksti, ndërkohë që Kurani ka zbritur tek i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) me anë të Xhibrilit: “Thuaj (O Muhamed): ‘Shpirti i Shenjtërisë (Xhibrili) e ka zbritur atë (Kuranin) prej Zotit tënd.” (Nahl, 102). Po kështu Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Të cilin *Shpirti* (meleku Xhibril) i besueshëm e ka zbritur në zemrën tënde (O Muhamed), që të mund të jesh prej këshilluesve; (i zbritur) në gjuhën e qartë arabe.” (Shuara, 193-195)

E dyta, sikur shprehja tok me përmbajtjen të ishin nga Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), atëherë nuk do të kishte ndryshim ndërmjet hadithit *kudsij* dhe Kuranit, e që të dy, sipas këtij supozimi, do të ishin fjalë të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Urtësia i gjykon si të barabarta kur ato përputhen në zanafillë, por ndërmjet Kuranit dhe hadithit *kudsij* ka ndryshime të shumta:

- Leximi i hadithit *kudsij* nuk shërben si adhurim, që do të thotë se njeriu nuk mund ta adhurojë Allahun duke e lexuar atë dhe nuk shpërblehet për çdo shkronjë me dhjetë sevape. Nga ana tjetër, leximi i Kuranit është adhurim, pasi për çdo shkronjë të tij shpërblehet me dhjetë sevape.

- Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) i ka sfiduar njerëzit që të sjellin një të ngjashëm me Kuranin ose me një ajet prej tij,¹ ndërkohë që kjo sfidë nuk është edhe për hadithet *kudsij*.

- Kurani është i ruajtur nga ana e Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala): “Vërtet, jemi Ne që e kemi zbritur Përkujtimin (Kuranin) dhe padyshim që Ne do të jemi Gjithëruajtës të tij.” (Hixhër, 9). Ndërsa hadithet *kudsij* janë të ndarë në: *sahih* (të saktë) dhe *hasen* (të mirë), madje ka të dobët dhe të trilluar. Këta të fundit, edhe pse nuk janë nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), i atribuohen atij. Po kështu, në to ka shtojca në fillim apo në fund të hadithit, ka shtesa dhe mangësi.

- Kurani nuk lejohet të lexohet me kuptim dhe jo tekstualisht, me pajtimin e plotë të të gjithë muslimanëve, ndërsa për hadithet

¹ Shejhu në fakt ka thënë ajet, por ndoshta ka pasur për qëllim sure.

kudsij, ka kundërshtim mes dijetarëve, dhe kjo si pasojë e mosmarrëveshjes së tyre lidhur me përcjelljen e haditheve të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) me kuptim (jo tekstualisht). Mendimi i shumicës është që lejohet.

- Kurani është përcaktuar të lexohet në namaz, ndryshe nga hadithet *kudsij*.

- Kurani mund ta prekin vetëm të pastrit, sipas mendimit më të saktë, ndryshe nga hadithet *kudsij*.

- Kurani nuk lejohet ta lexojë ai që është *xhunub*, derisa të lahet, sipas mendimit më të saktë, ndryshe nga hadithet *kudsij*.

- Kurani ka ardhur me rrugë të shumta, nga të cilat përfitohet dije e sigurt, dhe sikur të mohosh prej tij një shkronjë, – për të cilën janë pajtuar të gjithë lexuesit, – bëhesh kafir, ndryshe nga hadithet *kudsij*: nëse mohon diçka prej tyre, duke pretenduar se ajo nuk është pjesë e hadithit, nuk bën kufër; megjithatë, nëse e mohon duke e ditur se i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka thënë atë, bëhesh kafir për shkak të mohimit që i bën Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Këto shtjellojnë çështjen se i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka cituar këto fjalë nga Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), dhe fjala e cituar i përket burimit të saj. Megjithatë, ka raste kur një thënie citohet me përmbajtje e jo me shprehje, siç ndodh edhe në Kuran. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) citon fjalë të ndryshme, dhe ne e dimë se, në fakt, është cituar përmbajtja e tyre, siç është rasti i historive të Profetëve e të tjerë. Gjithashtu, fjalët e Hud-hudit¹ dhe milingonës, nuk janë cituar fjalë për fjalë, ashtu si ne i lexojmë. Të gjitha këto pika tregojnë qartë saktësinë e mendimit të dytë.

Mospajtimi në këtë çështje nuk është si ai ndërmjet *esharive* dhe *ehli sunetit* në lidhje me fjalën e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), sepse mospajtimi ndërmjet tyre, është për natyrën e fjalës së Tij. *Ehlu suneti* thotë se fjala e Allahut është e vërtetë dhe e dëgjueshme, se Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) flet me zë dhe tinguj. Esharitet nuk e pohojnë këtë, por thonë se fjala e Allahut është e mëvetësishme, ajo nuk është as zë, as tingull, mirëpo kur shpallte Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) krijonte zë me anë të tij, duke

¹ Zogu që ka folur me Sulejmanin, gjë e cila përmendet në suren Neml.

shprehur atë kuptim të cilin Xhibrili e përcillte te Muhamedi. Pasaktësia e këtij mendimi nuk ka kurrfarë dyshimi. Në realitet, ky është mendimi i *mutezilëve*, sepse ata thonë se Kurani është i krijuar dhe është fjalë e Allahut, ndërsa *esharitë* thonë se Kurani është i krijuar dhe është i njëvlershëm me fjalën e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala).

Nëse thuhet se për çështjen në fjalë (dallimin mes Kuranit dhe hadithit *kudsij*) është më mirë të mos thellohemi, për t’u ruajtur nga teprimi, ndoshta nuk do të ishte gabim apo do të ishte e mjaftueshme të themi se hadith *kudsij* quhet kumti të cilin Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e përcolli nga Allahu. Megjithatë, Allahu e di më së miri.

Shtojcë: Kur vargu i përcjelljes së hadithit mbaron tek Allahu, quhet *kudsij* për shkak të shenjtërisë së tij, ndërsa kur përfundon tek i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), quhet *merfu*. Kur zinxhiri i përcjelljes mbaron te një sahab, quhet *meukuf*, ndërsa kur mbaron te një tabiin ose të tjerë pas tij, quhet *mektuun*.

– “... *me pothuajse sa toka ...*” – Pra që i përafrohet në masë, peshë ose vëllim.

– “... *me gjynahe ...*” – Edhe nëse janë të vogla, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala): “Nuk është kështu si thoni ju! Ata që bëjnë vepra të këqija dhe mbulohen nga fajet e veta ...” (Bekare, 81)

– “... *më takon duke mos më shoqëruar asgjë ...*” – Fjala “*asgjë*” përfshin gjithçka, pra, as shirk të vogël, as të madh. Ky është një kushtëzim i madh, edhe pse njeriu e nënvlerëson, duke mos e pranuar se është idhujtar. Ai nuk e di se dashuria e dynjasë që e largon nga bindja ndaj Allahut është pjesë e shirkut. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Ka dështuar robi i dinarit (arit), ka dështuar robi i argjendit, ka dështuar robi i veshjes së bukur, ka dështuar robi i shtresës së butë ...”¹. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) atë që shqetësimin e tij ka këtë, e ka quajtur rob të tij.

– “... *do të vij ty po me aq falje.*” – Pra, e mira e teuhidit është

¹ Buhariu.

madhështore. Ajo i fshin gjynahet e mëdha, nëse njeriu e takon Allahun duke mos i shoqëruar Atij asgjë.

Përshtatja e hadithit me temën në fjalë është në faktin se këtu shfaqet vlera e teuhidit dhe tregohet se ai është shkak për fshirjen e mëkateve. Hadithi është në përputhje me fjalën e shejhut: “... dhe gjynahet që ai fshin”, në titullin e temës që ai ka vendosur.

| Dobitë e temës

- | ➤ Mirësia e madhe e Allahut.

Kjo del nga thënia e Profetit: “... e fut Allahu në Xhenet, sido që të ketë punuar”.

- | ➤ Teuhidi ka shpërblim të shumëfishtë tek Allahu.

Në pjesë thuhet: “... do të rëndojë më shumë fjala *La ilahe il’All-llah*”.

- | ➤ Teuhidi fshin edhe gjynahet.

Kjo nxirret nga pjesa: “... do të vij ty po me aq falje”. Ndoshta njeriun ndonjëherë mund ta sundojë epshi dhe të bjerë në gabime, por në adhurimin dhe bindjen ndaj Allahut ai është i sigurtë. Kështu, e mira e teuhidit ia fshin atij mëkatet kur të takojë Allahun.

- | ➤ Komenti i ajetit nr. 82 të sures En’am.

“Ata të cilët besojnë dhe nuk e përziejnë imanin e tyre me zullum ...” Fjala “zullum” këtu nënkupton shirkun, sipas fjalës së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “A nuk e keni dëgjuar thënien e burrit të mirë (Llukmanit): “Vërtet, idhujtaria është zullumi më i madh.”

- Meditimi për pesë mësimet që janë përmendur në hadithin e Ubades.

Dy mësimet janë nga dy dëshmitë; i treti: Isai ishte rob i Allahut, i Dërguari i Tij, urdhri i Tij “Bëhu!” i realizuar te Merjemja, dhe shpirt prej Tij; i katërti: Xheneti është i vërtetë; dhe i pestë: Zjarri është i vërtetë.

- Nëse bashkon hadithin e Ubades, hadithin e Itbanit dhe të tjerët, sqarohet për kuptimin e fjalës *La ilahe il’All-llah* si dhe sqarohet për gabimin e të mashtruarve.

Pa tjetër duhet që me këtë dëshmi të synojë Fytyrën e Allahut, nëse është kështu, atëherë ajo patjetër duhet ta shtyjë për punë të mira.

- Aludimi për kushtin që përmendet në hadithin e Itbanit.

Të kërkohet me deklarimin e saj Fytyra e Allahut; dhe nuk mjafton thjesht artikulumin e saj, sepse edhe munafikët e thonin atë, por kjo nuk u bëri dobi.

- Edhe Profetët e kishin të nevojshme t’u tërhiqej vëmendja për vlerën e fjalës *La ilahe il’All-llah*.

Kur kjo për Profetët po për të tjerët?

- Tërheqja e vëmendjes se kjo fjalë është më e rëndë se të gjitha krijesat, e megjithatë shumë prej deklaruesve të saj do t’u peshojë lehtë.

E keqja është te thënësi e jo te thënia. Ai që e deklaroi atë ose nuk ka përmbushur ndonjë kusht, ose ka ndonjë prej pengesave, kështu që pesha e saj humbet në varësi të mungesës së kushtit ose

të pranisë së pengesës, edhe pse në vetvete peshon më shumë se gjithë krijesat.

➤ Theksimi se ndodhen shtatë toka, po aq sa edhe qiej.

Në Kuran kjo nuk është përmendur në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndërsa për shtatë qiejt është ndryshe: “Thuaj: Kush është Zoti i shtatë qiejve ...” (Mu’minun, 86). Në lidhje me tokën, ka ardhur vetëm fjala e Allahut: “Allahu është Ai i Cili ka krijuar shtatë qiej dhe nga toka po aq të tilla ...” (Talak, 12). Kjo nuk është thënë për të treguar ngjashmërinë e tokës me qiellin në formë, për shkak se ndryshimi ndërmjet tyre, si në formë, lartësi dhe bukuri është i dukshëm. Atëherë ngjashmëria mbetet vetëm në numër. Ndërsa në Sunet tregohet qartë se janë shtatë toka, siç përcillet në fjalën e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Kush zapton një pëllëmbë tokë padrejtësisht, Ditën e Kijametit do të detyrohet të mbajë shtatë toka si ajo.”¹

Ka pasur mendime të ndryshme në lidhje me pohimin në ajet: “... dhe nga toka po aq të tilla ...”. Është thënë, për shembull, se kjo nënkupton shtatë kontinentet, por kjo nuk është e saktë, sepse kjo gjë nuk krijon asnjë lidhje me hadithin: “... do të detyrohet të mbajë shtatë toka si ajo”. Është thënë, gjithashtu, se ato janë planetët e sistemit diellor, por, me sa duket nga konteksti i argumenteve, ato janë shtresa (kate) si të qiellit. Ne mund të themi për to vetëm atë që ka ardhur në Kuran dhe Sunet.

➤ Qiejt kanë banorë.

Banorët e qiejve janë melekët.

➤ Pohimi i cilësive të Allahut ndryshe nga *esharitë*².

Në disa nga kopjet e librit e gjen “ndryshe nga mohuesit”, dhe kështu është më e mirë, sepse përfshin edhe të tjerë që i mohojnë

¹ Muslimi.

² Esharitë janë një grup i humbur që kanë devijime në shumicën e çështjeve të besimit. Një nga devijimet e tyre është mohimi i cilësive të Allahut, përveç shtatë prej tyre.

cilësitë, si: *mutezilët, xhehmitë*, etj. Me shprehjen “*duke shpresuar me të Fytyrën e Allahut*”, pohohet Fytyra e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), pohohet “Fjala e Tij”, si edhe të folurit e Tij: “Thuaj: *La ilahe il’All-llah*”.

- Nëse e njeh hadithin e Enesit mëson se fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në hadithin e Itbanit “me të vërtetë Allahu ia ka ndaluar Zjarrin atë që thotë *La ilahe il’All-llah* duke shpresuar me të Fytyrën e Allahut”, synon largimin nga politeizmi dhe nuk është thjesht një deklaratë me gjuhë.

Kjo sepse ai që shpreson Fytyrën e Allahut nuk mund të bëjë kurrë shirk.

- Vëzhgimi në statusin e përbashkët të Isait dhe Muhamedit si robër të Allahut dhe si të Dërguar të Tij.

Kjo në dy aspekte: *së pari*, duke bashkuar në secilin prej tyre ndërmjet profetësisë dhe robërinë ndaj Zotit; *së dyti*, duke bashkuar ndërmjet të dy burrave. Qartësohet se Isai ishte si Muhamedi, domethënë rob dhe Pejgamber. Ai nuk ishte as Zot e as bir i Zotit. Dijetari përdor fjalën “vëzhgim”, sepse kjo çështje ka nevojë për vëzhgim e meditim.

- Njohja e veçimit të Isait si i krijuar me fjalën e Allahut “Bëhu!”.

Pra, Isai është ndryshe nga Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për sa i përket mënyrës së krijimit. Ai është krijuar me fjalën “Bëhu!”, ndërsa Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është krijuar nga fara e babait të tij.

- Njohja e Isait si shpirt i krijuar prej Zotit.

Shpirt që i ka ardhur nga ana e Allahut dhe jo një pjesë e

Allahut. Shpirti i tij është një ndër shumë shpirtrat që ka krijuar Allahu.

- Njohja e vlerës së besimit në Xhenetin dhe Xhehenemin.

Kjo merret nga pjesa e hadithit: “... se Xheneti është i vërtetë, Zjari është i vërtetë”. Ky besim është një nga faktorët e futjes në Xhenet.

- Njohja e domethënies së shprehjes: “si do që të ketë punuar”.

Në këtë rast, njeriu do të hyjë në Xhenet me ato vepra të mira që ka bërë, edhe sikur të jenë pak, ose me ato punë të këqija që ka, edhe sikur të jenë shumë. Kjo ndodh, me kusht që të mos jenë vepra që mohojnë teuhidin dhe detyrojnë futjen në Zjarr. Gjithashtu, mjafton të ketë kryer vepra, nuk nënkuptohet detyrimisht vepra të mira të plota, siç mëtojnë *mutezilët* dhe *havuarixhët*. Këtu nuk janë përmendur shtyllat e Islamit, sepse me lënien e disave prej tyre njeriu bën kufër, ndërsa me lënien të tjerave nuk bëhet kafir. E sakta është se bën kufër vetëm me lënien e dy dëshmimeve dhe me lënien e namazit, edhe pse është përcjellë nga imam Ahmedi se njeriu bën kufër me lënien e çdo shtylle të Islamit.

- Njohja e faktit se peshorja e veprave do të ketë dy anë peshimi.

Autori këtë e ka nxjerrë nga thënia: “sikur shtatë qiejt dhe banorët e tyre, përveç Meje, si dhe shtatë tokat të jenë në një anë të peshores, dhe fjala *La ilahe il’All-llah* në anën tjetër të saj...”. Me sa duket, përmbajtja e hadithit është ilustruar me një shembull, që do të thotë se fjala *La ilahe il’All-llah* është më e rëndë se çdo gjë. Në hadith nuk përmendet drejtpërdrejt se kjo peshore është në botën tjetër. Siç duket, autori (Allahu e mëshiroftë!) ka bërë një kalim logjik nga kjo peshore tek ajo e ahiretit.

- Njohja e argumentit ku përmendet Fytyra e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala).

Fytyra është prej cilësive *khaberije dhatije*¹, të cilat, për sa i përket njeriut shënojnë pjesët dhe gjymtyrët e tij trupore, kurse ne lidhje me Zotin nuk mund të themi që ato janë pjesë, pasi kur flasim për atributet e Allahut ne duhet të mënjanojmë përdorimin e shprehjeve të tilla si pjesë, gjymtyrë apo përbërje.

¹ Cilësitë e Allahut të Lartësuar ndahen në cilësi *dhatije* dhe cilësi *fi'lije*. Cilësitë *dhatije* janë atributet, vetitë e domosdoshme dhe të përhershme të qenies së Allahut të Lartësuar, ndërsa cilësitë *fi'lije* janë veprimet e Allahut të Lartësuar të cilat varen nga vullneti i Tij, pasi Ai vepron ç'të dëshirojë dhe kur të dëshirojë. Duke marrë parasysh argumentet e njohjes dhe pohimit, si dhe kuptimin që shënojnë ato klasifikohen ndryshe: në cilësi *ma'nevije* dhe cilësi *khaberije*. Cilësitë *ma'nevije* janë ato që pohohen nga argumentet fetare dhe nga argumentet logjike, pra përveç teksteve fetare për to dëshmon edhe arsyeja logjike, ndërsa cilësitë *khaberije* janë ato që pohohen nga argumentet fetare, cilësi këto të cilat nëse nuk do të përmendeshin në tekstet fetare, njeriu nuk do të arrinte t'i kapte me logjikën e tij. Si shembull për cilësitë *ma'nevije* përmendim: Jetën, Dijen, Fuqinë, Vullnetin, Dëgjimin, Shikimin etj., kurse si shembull për cilësitë *khaberije* përmendim: Fytyrën, dy Duart etj. Cilësia *khaberije*, për sa i përket njeriut shënon një gjymtyrë dhe pjesë trupore, kurse për sa i përket Allahut, ajo shënon një atribut të qenies së Tij të cilin nuk lejohet ta quajmë pjesë a gjymtyrë sikurse për njeriun, sepse Allahu i Lartësuar nuk krahasohet me krijesat. Kështu, kur flasim për atributet *khaberije* të Allahut të Lartësuar duhet të mënjanojmë shprehje të tilla si pjesë trupi, gjymtyrë apo përbërje trupore.

Tema 3

Kush realizon teuhidin, futet në Xhenet pa dhënë llogari.

Kjo temë është plotësuese e të mësipërmes e cila ishte: “*Vlera e teuhidit dhe gjynahet që ai fshin.*” Kështu vlerë tjetër e tij është edhe kjo mirësi e madhe, të cilën përpiqet ta arrijë çdo i mençur, e që është: futja në Xhenet pa dhënë llogari.

Kush realizon teuhidin futet në Xhenet pa llogari, pra, nuk llogaritet as për mëkatet, as për të tjera. Realizimi i teuhidit është pastrimi i tij nga shirku, dhe ai mund të realizohet vetëm nëse përmbushen tri kushte:

1. Dija. Nuk mund të realizosh asgjë para se ta dish atë. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Dije se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut.” (Muhamed, 19).

2. Besimi. Nëse e di diçka, por nuk e beson për mendjemadhësi, nuk e ke realizuar teuhidin. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) tregon ç’thonin idhujtarët: “A mos kërkon ai, që të gjithë zotat t’i bëjë një Zot të Vetëm? Vërtet që kjo është diçka e çuditshme.” (Sad, 5). Pra, ata nuk besuan se Allahu është i Vetmi që meriton të adhurohet.

3. Nënshttrimi. Nëse e di dhe e beson, por nuk i nënshtrohesh, nuk e ke realizuar teuhidin. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “... sepse kur u thuhej atyre: ‘Nuk ka të adhuruar tjetër të merituar përveç Allahut’, ata tregoheshin mendjemëdhenj dhe thonin: ‘Vallë, a t’i braktisim hyjnitë tona për shkak të një poeti të marrë?’” (Safat, 35-36).

Nëse arrihen këto kushte dhe realizohet teuhidi, atëherë Xheneti

është i siguruar për robin, pa dhënë llogari, e nuk ka nevojë të themi *insha-Allah* - në dashtë Allahu -, sepse kjo është e përcaktuar në Sheriat. Për këtë arsye, dijetari e ka deklaruar në formë të prerë në titullin e temës, pa përmendur shprehjen *insha-Allah*. Kjo vlen, kur flasim në përgjithësi, e për sa i përket një personi të caktuar, duhet patjetër të themi *insha-Allah*.

“Vërtet Ibrahim i ka qenë prijës shembullor, i përlulur (**kanitan**), me besim monoteist (**hanifen**), e nuk ka qenë idhujtar.” (Nahl, 120).

Autori (Allahu e mëshiroftël!) në këtë temë ka përmendur dy ajete, dhe shkakun është se ato aludojnë për realizimin e teuhidit, dhe kjo nuk mund të arrihet ndryshe, por veçse duke mohuar të gjithë shirkun.

– “Vërtet Ibrahim i ka qenë prijës shembullor ...” – Për Ibrahimin ky ajet është një lavdërim nga ana e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), sepse atij i është dhënë titulli ‘prijës’. Ai ishte njëri nga Profetët e ndershëm dhe ndër Pesë Profetët e Zgjedhur. Ai qe shembull në veprat dhe luftën e tij. Ai u përpoq me popullin e tij, duke hasur në shumë vështirësi, madje atë e hodhën edhe në zjarr, por çdo herë ai duroi.

Më pas Allahu e provoi me fljimin e birit të tij të vetëm, Ismailin, i cili sapo kishte arritur moshën e pjekurisë. Në këtë moshë, ai nuk ishte as shumë i madh, i tillë që Ibrahim i të ishte ngopur me të, e as shumë i vogël, që të mos ishte krijuar ndonjë lidhje e fortë. Kësisoj, Ibrahim i ishte në kulmin e lidhjes me të birin. Por atij iu dha sukses që të kishte të bënte me një djalë bamirës dhe të bindur ndaj Allahut. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “O babai im, vepro ashtu siç je urdhëruar! Dashtë Allahu, unë do të jem i duruar.” (Safat, 102). Ai nuk e kundërshtoi të atin, apo të rebelohej e të arratisej, por kërkoi prej tij ta çonte në vend urdhrin e Allahut. Kjo ishte rrjedhojë e respektit të tij ndaj babait dhe bindjes ndaj Zotit. Shiko çfarë fuqie dhe mbështetje tek Allahu, në fjalën: “Dashtë Allahu, unë do të jem i duruar.” (Safat, 102). Ata të dy zbatuan urdhrin, u dorëzuan dhe iu nënshtruan Allahut (Subhanehu ue

Te'Ala). “*Unë do të jem*” tregon siguri, e megjithatë ai nuk u mbështet në veten e tij, por kërkoi ndihmën e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), kur tha: “*Dashtë Allahu*”. Të dy iu dorëzuan urdhrin të Allahut dhe iu nënshtruan Atij. Ibrahimimi e vuri me ballë përtokë, me qëllim që ta therte pa e shikuar fytyrën e tij, por në atë çast erdhi zgjidhja nga Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): “Ne i thirrëm atij: ‘O Ibrahim! Ti e përmbushe tashmë ëndrrën!’ Kështu i shpërblejmë Ne punëmirët!” (Safat, 104-105). Nuk është e saktë ajo që thonë disa, se thika na qenka rrotulluar, se qafa u bë hekur, e të ngjashme me këto.

– “*... i përrulur (kanitan) ...*” – Adhurues i Allahut në vazhdimësi, në të gjitha gjendjet. Ai ka qenë i bindur ndaj Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) dhe i përqendruar në bindjen e tij. I tillë ishte edhe i biri, Ismaili (alejhi selam). Ai e përmendte Allahun në çdo moment: kur ngrihej, kur ulej, kur flinte, kur hante, para se të kryente nevojat vetjake, pra, ka qenë i nënshtruar gjatë ditës dhe gjatë natës.

– “*... me besim monoteist (hanifen) ...*” – Domethënë i distancuar prej shirkut, larg çdo gjëje që kundërshton bindjen ndaj Zotit. Kështu ai zotëronte dy elementët: pohimin e së vërtetës dhe mohimin e shirkut.

– “*... nuk ka qenë nga idhujtarët.*” – Kjo shprehje përforcon faktin e përhershmerisë së tij në monoteizëm. Ibrahimimi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka qenë i siguruar nga rënia në shirk, edhe pse populli i tij ka qenë politeist. Pra, mosrënien në shirk Allahu e ka përshkruar me fjalën “*hanifen*” dhe me shprehjen: “*Nuk ka qenë nga idhujtarët*”. Argument tjetër është se Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) e bëri atë prijës, dhe Allahu kurrë nuk bën prijës atë që nuk përmbush teuhidin.

Kushdo që mediton për karakterin e Ibrahimimit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) do të shohë se ai ka pasur gradën më të lartë të durimit, si dhe në shkallën më të lartë të sigurisë, pasi ndaj këtyre provave të mëdha, mund të durojë vetëm ai që është i sigurt për shpërblimin. Ai që ka dyshime ose heziton nuk mund të durojë, sepse egoja mund ta braktisë diçka vetëm për diçka tjetër që është

më e dashur se e para. Egoja mund të dëshirojë diçka vetëm pasi mendon se është e dobishme ose është e sigurt për dobinë e saj, dhe nëse kjo gjë është e dyshimtë, ajo nuk përpiqet më për të.

Qëllimi që Allahu e përmend dikë për mirë, nuk është vetëm që kjo të arrijë te ne, por edhe për të na treguar dy çështje të rëndësishme:

1. Dashurinë ndaj personit që përmendet për mirë, e nëse përmendet dikë për keq, ne duhet ta urrejmë atë. Ne e duam Ibrahimin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), sepse ai kishte virtyte të larta, sepse ishte i nënshtruar ndaj Allahut dhe nuk ishte idhujtar. Nga ana tjetër, ne e urrejmë popullin e tij, sepse ata ishin të humbur. I duam melekët edhe pse nuk janë prej llojit tonë, sepse janë të bindur ndaj Allahut, dhe i urrejmë shejtanët, sepse ata janë kundërshtarë të Allahut, armiq tanët dhe të Allahut; ne i urrejmë edhe ndjekësit e shejtanëve, sepse ata janë kundërshtarë të Allahut dhe tanët gjithashtu.

2. Ta marrim atë si shembull në këto cilësi për të cilat Allahu e ka lavdëruar, sepse ato janë të lakmueshme për secilin prej nesh. Ne meritojmë të lavdërohemi sipas shkallës që i për afrohem atij në këto virtyte. Zoti thotë: “Vërtet që në ndodhitë e tyre ka mësim për njerëzit me mend.” (Jusuf, 111); “Me të vërtetë që ka qenë një shembull i shkëlqyer për ju tek Ibrahimimi dhe ata me të.” (Mumtehine, 4); “Me të vërtetë që tek ata pati shembull të shkëlqyer për ju, që ta ndiqni.” (Mumtehine, 6).

Kjo është çështje e rëndësishme, sepse njeriut ndonjëherë i ikën nga mendja qëllimi i parë, që është dashuria për atë që Allahu e ka lavdëruar. Por kjo nuk duhet të ndodhë, sepse dashuria dhe urrejtja për hir të Allahut është një nga hallkat më të forta të besimit.

Përfitimet nga ajeti

Së pari, babai i Ibrahimimit ka vdekur në kufër. Mendimi më i drejtë, që ne e besojmë, është se ai quhej Azer, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala): “Dhe kujto kur Ibrahimimi i tha babait të tij, Azerit: ‘A i merr idhujt për zota?’” (En’am, 74). Po kështu, Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Edhe lutja e Ibrahimimit për faljen e babait të vet ishte vetëm për shkak të premtimit që ai ia bëri atij (babait)” (Teube, 114), sepse Ibrahimimi i tha të atit: “Do t’i kërkoj falje

Zotit tim për ty, se vërtet Ai është i Mëshirshëm me mua.” (Merjem, 47) “... por kur iu qartësua mirë atij se ai ishte armik i Allahut, (Ibrahimi) u largua prej tij. Vërtet Ibrahim i lutej Allahut me nënshtrim dhe shumë i duruar.” (Teube, 114). Po kështu, në suren “Ibrahim” thuhet: “O Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët në Ditën kur do të jepet llogaria.” (Ibrahim, 41), mirëpo më pas u largua prej tij (prej babait). Ndërsa Nuhu, ka thënë: “Zoti im! Më fal mua, prindërit e mi, atë që hyn në shtëpinë time si besimtar dhe të gjithë besimtarët e besimtare.” (Nuh, 28). Kjo tregon se dy prindërit e Nuhut kanë qenë besimtarë.

Së dyti, imam Ahmedi ka thënë: “Tri gjëra nuk kanë zinxhirë përcjelljeje: betejat, luftërat e ashpra dhe tefsiri. Këto, në të shumtën e rasteve përmenden pa zinxhirë transmetimi, prandaj komentuesit e Kuranit përmendin historinë e Ademit lidhur me ajetin: ‘Por kur Ai u dhuroi atyre një fëmijë të mirë ...’ (Araf, 190), e megjithatë pak prej tyre nënvizojnë faktin se tregimi në fjalë është i trilluar¹.”

Rregulli është se askush nuk di për popujt e mëparshëm, vetëm se nëpërmjet Shpalljes hyjnore. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “A nuk ju ka ardhur juve (o njerëz) lajmi i atyre para jush: i popullit të Nuhut, Adit e Themudit dhe i të tjerëve më vonë? Askush nuk i njeh ata veç Allahut.” (Ibrahim, 9)

“Dhe ata të cilët Zotin e tyre nuk e shoqërojnë me asgjë.”
(Mu’minun, 59).

Këtij ajeti i ka paraprirë një tjetër, “Me të vërtet, ata që dridhen nga frika e Zotit të tyre ...” (Mu’minun, 57), por autori ka përmendur vetëm ajetin që dëshmon për temën në fjalë.

– “... nga frika e Zotit të tyre ...”, do të thotë nga frika e tyre prej Tij, duke qenë të vetëdijshtëm. Ndërsa “dridhen”, do të thotë që janë të frikësuar nga ndëshkimi i Tij, nëse e kundërshtojnë Atë.

Mëkatet, sipas kuptimit të përgjithshëm janë shirk, sepse ato rrjedhin si pasojë e dëshirës që kundërshton Sheriatin. Allahu

¹ Komenti i këtij ajeti, me të cilin është emërtuar njëra nga temat e librit, do të bëhet më pas.

thotë: “A e ke vënë re atë njeri që dëshirat e veta i mori për Zot?” (Xhathijah, 23). E për sa i përket kuptimit të veçantë, dijetarët i ndajnë mëkatet në dy lloje: idhujtari dhe gjynahe.

– “... nuk shoqërojnë asgjë.” – Kjo shprehje ka të bëjë me shirkun, sipas kuptimit gjithëpërfshirës, pasi teuhidi mund të realizohet vetëm duke iu larguar shirkut. Kjo nuk do të thotë se nuk duhet të bëhet asnjë mëkat, sepse të gjithë bijtë e Ademit gabojnë. Ata nuk janë të siguruar nga rënia në mëkat, por kur gabojnë, pendohen dhe nuk vazhdojnë me to, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala): “Dhe ata të cilët kur bëjnë vepra të turpshme, ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun e i kërkojnë falje për gjynahet e tyre – e kush mund t’i falë gjynahet përveç Allahut? – dhe nuk vazhdojnë me gabimet që kanë bërë, kur e dinë.” (Ali Imran, 135)

Nga Husejn Ibn Abdurrahman përcillet: “Isha te Seid Ibn Xhubejri, kur ai më tha: ‘Cili e ka parë yllin që u shkëput mbrëmë?’” I thashë: “Unë. Nuk isha duke u falur, por më pickoi diçka.” – “Çfarë bëre?” – “Kërkova të më bëjnë rukje.” – “Nga u nise që e bëre?” – “Nga hadithi që na tregoi Shabiu.” – “E çfarë ju tregoi?”, – më pyeti. Unë i thashë: “Përcillet nga Burejde Ibn Husejbi se rukja lejohet vetëm për mësyshin ose pickimet (**helmuese**)¹.” – “Ka vepruar mirë ai që është bazuar tek ajo që ka dëgjuar, por neve na ka përcjellë Ibn Abasi se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: ‘M’u paraqitën popujt. Pashë një Profet me një grup të vogël njerëzish (1-9 veta), një

¹ Sipas Ibn Haxherit kufizimi i rukjes në këto të dyja është për faktin se ato janë origjinë për çdo rast që ka nevojë për rukje, kështu që tek mësyshi përfshihet lejimi i rrukjes për të çmendurin, të zaptuarin nga xhindi e të ngjashëm, sepse këto bëjnë pjesë në sëmundjet që shkaktohen nga faktorë djallëzorë qofshin njerëz apo xhindë. Ndërsa tek helmimi përfshihet çdo sëmundje që prek trupin si plagë, puçër, qelbëzim, acarim, ënjtje etje. Kurse sipas Hatabiut do të thotë se rukja më e dobishme është ajo që bëhet për mësyshin ose pickimet. Po kështu Ibn Kajimi thotë se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk ka pasur për qëllim se nuk lejohet rukja në sëmundje të tjera, por në këto që janë përmendur ajo është më e dobishme, siç tregojnë për këtë hadithet e përgjithshme dhe të posaçme që flasin për *rukjet*.

Profet me një burrë, një Profet me dy burra dhe një Profet pa asnjë. Në këtë kohë pashë një turmë të madhe. Mendova se është populli im, por m'u tha se ishte Musai dhe populli i tij. Pastaj pashë një turmë të madhe, për të cilin m'u tha se ishte populli im. Me ta ishin shtatëdhjetë mijë persona që do të futen në Xhenet pa llogari dha pa dënim.' Pastaj Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) u ngrit dhe u fut në shtëpinë e tij.

Njerëzit filluan të diskutojnë për ta. Disa thoshin se flitej për shokët e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), të tjerë thoshin se ndoshta janë ata të cilët kanë lindur në Islam dhe nuk kanë bërë asnjëherë shirk, dhe kështu vazhduan duke sjellë variante të shumta.

Më pas, kur doli Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), i kallëzuan për diskutimin. Ai u tha: 'Janë ata të cilët nuk kërkojnë rukje, nuk kërkojnë që të mjekohen me hekur të nxehtë, nuk parandiejnë fatin e keq për shkak të shenjave ogurzeza, por vetëm Zotit të tyre i mbështeten.' Në këtë moment, u ngrit Ukashe Ibn Mihsan dhe i tha: 'Lute Allahun të më bëjë prej tyre.' Ai i tha: 'Po, ti do të jesh prej tyre.' Më pas u ngrit një burrë tjetër dhe tha: 'Lute Allahun të më bëjë edhe mua prej tyre.' Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i tha: 'Ta kaloi Ukashja...'¹

– “ *Nga Husejn Ibn Abdurrahman përcillet: “Isha te Seid Ibn Xhubejri ...”* – Këta kanë qenë dy persona të besueshëm tabiinë.

– “*... Cili prej jush e ka parë yllin që u shkëput mbrëmë?” I thashë: “Unë ...”* – Domethënë Husejni.

– “*... Nuk isha duke u falur ...*” – Ai (Allahu e mëshiroftë) e tha këtë me qëllim që të mos mendonte ndokush se ai kishte qenë në namaz, dhe kështu të lavdërohej për diçka që nuk e kishte vepruar, ndryshe nga ndonjë tjetër që kënaqet kur njerëzit mendojnë se ai ngrihet

¹ Buhariu dhe Muslimi.

natën e falet, veprim i cili përbën mangësi në teuhid. Fjala e Husejnit (Allahu e mëshiroftë!) nuk është shtirje, përkundrazi ajo i jep vlerë atij. Ai, gjithashtu nuk duhet të konsiderohet si ndokush që lë një vepër të mirë nga frika prej shtirjes. Shejtani mund të luajë me njeriun duke ia zbukuruar atij lënien e punës së mirë gjoja nga frika e shtirjes. Duhet të bësh të kundërtën: veproje të mirën, por pa pasur shtirje në zemër.

– “... por më kafshoi diçka helmuese ...” – Akrep ndoshta, ose diçka tjetër. Me sa duket ka qenë kafshim i fortë, sepse ai nuk ka fjetur dot për këtë shkak.

– “... Çfarë bëre?” – “Kërkova të më bëjnë rukje” – “Nga u nise që e bëre?” – “Nga hadithi që na tregoi Shabiu. ...” – Kjo tregon se selefët debatonin që të arrinin tek e vërteta. Seid Ibn Xhubejri nuk kishte për qëllim ta kundërshtonte, por donte të kuptonte e të dinte se ku ishte bazuar.

– “... rukja lejohet vetëm për mësyshin ose pickimet. ...” – Disa, në vendet tona, mësyshit i thonë *hased* (zili). Ky ndodh me shikimin e ziliqarit, me karakter të poshtër. Kjo mënyrë e veçantë e të parit rrezaton faktorët që sëmurin të prekurin.

- “... ose pickimet. ...” – Pickimet nga çdo kafshë helmuese.

– “... Ka vepruar mirë ai që është bazuar tek ajo që ka dëgjuar, por neve na ka përcjellë Ibn Abasi se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem) ka thënë ...” e deri në fund. – Husejni është bazuar në hadithin: “Nuk lejohet rukja, me përjashtim të rastit të mësyshit ose helmimit.” Kjo tregon se rukja për mësyshin ose për helmimin (nga ndonjë kafshë helmuese) është e dobishme, dhe kjo është e vërtetë. Rukja për mësyshin ose për helmimin nga ndonjë kafshë helmuese bën dobi, me lejen e Allahut. Shumë njerëz u kanë lexuar atyre që janë pickuar nga ndonjë kafshë

helmuese, dhe shërimi ka qenë në moment. Këtë e dëshmon edhe ndodhia e personit që Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e dërgoi me një ekspeditë ushtarake. Kur kaluan pranë një fisi, kërkuan prej tyre që t’i prisnin si miq, por ata nuk e bënë këtë. Më pas, prijësi i tyre u thumbua nga një akrep. Ata pyetën se kush mund t’i bënte rukje, duke menduar se ky grup njerëzish (sahabët) ndoshta kishte ndonjë që mund ta bënte këtë. Sa kaq shkuan tek grupi i sahabëve dhe thanë: “A ka ndonjë prej jush që bën rukje?” – “Po, – i thanë, – por vetëm po të na jepni nga delet tuaja.” – “Do t’ju japim. Thanë ata”. Kështu ata ndanë për ta një numër delesh. Atëherë, një sahab i lexoi të sëmurit suren Fatiha tri ose shtatë herë, dhe ai u ngrit sikur të mos kishte asgjë. Pra, i thumbuari nga akrepi pati dobi nga leximi i saj, prandaj i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: “*Ku e dije ti se ajo – pra surja Fatiha – është rukje?*”¹

Rukja është e dobishme edhe për mësyshin, madje për këtë të fundit mund të bëhen edhe gjëra të tjera, për shembull: i kërkohet personit që e ka marrë tjetrin mësysh të marrë avdes. Më pas, uji që bie prej gjymtyrëve të tij duhet të derdhet mbi atë që e ka goditur syri, si edhe i jepet të pijë nga ky ujë. Pastaj, me lejen e Allahut, i sëmuri shërohet.

Ka edhe një formë tjetër, e cila nuk ka ndonjë pengesë që të praktikohet: merret diçka nga pjesa e përparme e trupit të atij që ka marrë mësysh, si: rrobë, takije, shallvare e të tjera, ose merret nga dheu mbi të cilin ai ka shkelur, kur është i njomë, e hidhet ujë mbi këto. Me këtë ujë i sëmuri spërkatet ose i jepet ta pijë. Kjo është diçka e provuar konkretisht.

¹ Kjo ndodhi përmendet në sahihun e Buhariut dhe Muslimit.

Që të mos marrësh mësysh të tjerët, duhet që, kur të shohësh diçka që të pëlqen tek tjetri, t'i thuash për të: “*Bareke Allahu alejke!* - (Allahu t'i shtoftë mirësitë!)”, sipas fjalës së të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për Amir Ibn Rrabian, kur ky mori mësysh Sehl Ibn Hanifin: “Sikur të thoshe: ‘*Bareke Allahu alejke!*’”

– “... *M’u paraqitën popujt ...*” – Ai që ia shfaqti ishte Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), siç duket nga konteksti. Kjo ka ndodhur në ëndërr. Me “popujt” nënkuptohet popujt e të Dërguarve.

– “... *dhe një Profet pa asnjë ...*” – Domethënë është dërguar nga Allahu, por asnjë nuk e ka pasuar. Megjithatë, Allahu e ka dërguar për t’u paraqitur argument njerëzve. Kur ngritet argumenti, atëherë Allahu nuk lë më vend për t’u justifikuar Ditën e Gjykimit.

– “... *m’u tha se ishte Musai dhe populli i tij. ...*” – Kjo argumenton për ndjekësit e shumtë të Musait (alejhi selam) nga populli i tij.

– “... *Pastaj pashë një turmë të madhe, e m’u tha se ishte populli im. ...*” – Kjo ishte më e madhe se turma e parë, sepse umeti i Muhamedit sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem është shumë herë më i madh se umeti i Musait (alejhi selam).

– “... *pa llogari dha pa dënim ...*” – Domethënë nuk do të ndëshkohen dhe nuk do të llogariten, e kjo si nderim për ta. Nga konteksti duket se nuk kanë për t’u ndëshkuar as në varre, as pas Kiametit.

– “... *Njerëzit filluan të diskutojnë për ta ...*” – Diskutimi i tyre ishte për të arritur tek e vërteta teorikisht dhe praktikisht, me qëllim që të mund të ishin pjesë e kësaj kategorie.

– “... *disa prej tyre thanë se flitej për shokët e Profetit ...*” – Mund të nënkuptohet se ishte fjala për sahabët, mendim të cilin e përforcon konteksti i hadithit. Mund të nënkuptohet se janë ata që e shoqëruan Pejgamberin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem.) gjatë hixhretit, e këtë mendim e përforcon fakti se: po të ishin sahabët,

atëherë ata do të thoshin se “flitet për ne”, pasi ata që po flisnin ishin vetë sahabë. Këtë e dëshmon edhe thënia e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) drejtuar Halid Ibn Uelidit: *“Mos i shani shokët e mi!”* Kësisoj, flitet për njerëzit që e shoqëruan Pejgamberin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem.) gjatë hixhretit. Megjithatë saktësinë e këtij mendimi e pengon fakti se muhaxhirët nuk e plotësonin numrin shtatëdhjetë mijë, ndërsa saktësinë e mendimit të parë e pengon fakti se sahabët kanë qenë më shumë se shtatëdhjetë mijë.

Mund të nënkuptohet se janë njerëzit të cilët kanë qenë me të Dërguarin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) deri në çlirimin e Mekës, sepse pas çlirimit të Mekës, njerëzit futeshin në fe grupe-grupe. Megjithatë, kjo çështje ka nevojë për më shumë rishqyrtim.

– *“... disa të tjerë thanë se ndoshta janë ata të cilët kanë lindur në Islam ...”* – Që do të thotë se janë ata që kanë lindur pas dërgesës së Muhamedit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe janë bërë muslimanë, por këta janë numër shumë i madh. E nëse themi se flitet për sahabët e lindur në Islam, ata nuk e plotësonin numrin shtatëdhjetë mijë.

– *“... kur doli Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ata e lajmëruan ...”* – I treguan çfarë kishin thënë dhe ç’kishte ndodhur mes tyre.

– *“... Janë ata të cilët nuk kërkojnë rukje ...”* – Në disa përcjellje ka ardhur: *“Janë ata të cilët nuk bëjnë rukje.”*, por kjo e dyta është e gabuar, siç ka thënë shejhu i Islamit Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!), sepse i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka bërë vetë rukje.¹ Atij i ka bërë rukje Xhibrili² dhe Aishja.³ Edhe sahabët bënë rukje. E vërteta është se hadithi ka kuptimin: “të cilët nuk kërkojnë rukje”, pra nuk kërkojnë prej askujt që t’u lexojë rukje, për

¹ Siç ka përmendur Buhariu në “Kitab et-tib” në temën “Rrukjetu en-Nebij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe Muslimi në “Kitab es-selam” në temën “Pëlqimi i rukjes nga mësyshi”.

² Siç përcjell Muslimi nga Aishja (radijallahu anha) në “Kitab es-selam” temën “Et-tib ue el merred ue er-ruka”.

³ Siç përcillet nga Buhariu në “Kitab fedail el Kuran” në temën “Fadl maudhat” dhe Muslimi në “Kitab es-selam” në temën “Rrukjetu el merred”.

arsyet e mëposhtme:

- Për shkak të mbështetjes së tyre të fortë tek Allahu.
- Për shkak të krenarisë së tyre dhe mospërujjes ndaj dikujt tjetër, veç Allahut.
- Për shkak se në këtë veprim ka njëfarë lidhjeje me diçka tjetër veç Allahut.

– “... nuk kërkojnë prej dikujt që t'i mjekojë me hekur të nxehtë ...”

– Pra, nuk kërkojnë prej askujt që t'i mjekojë duke i djegur me hekur. Kjo është e ngjashme me “nuk kërkojnë rukje”.¹ Për sa i përket mjekut të specializuar për këtë punë nga organe të caktuara shtetërore, nuk është përulje të kërkosh prej tij, sepse ai merr shpërblim nga ana e shtetit për këtë gjë. Pastaj, edhe nëse i thotë, ky është thjesht një njoftim nga ana e atij që e kërkon, se ka nevojë për djegie me hekur, e nuk është lypje poshtëruese.

– “... nuk parandiejnë fatin e keq për shkak të shenjave ogurzeza ...” – Fjala burimore e kësaj është “*et-tetajur*”, që shënon parashikimin e keq me anë të lëvizjes së zogjve. Megjithatë, kuptimi i saj është më gjithëpërfshirës. Ajo shënon parashikimin e keq me anë të asaj që shikon, dëgjon, me anë të kohës ose vendit. Arabët e kishin traditë parashikimin e fatit me anë të lëvizjes së zogjve. Nëse donin të bënin diçka të mirë, ata fillimisht lëshonin një shpend në fluturim dhe shikonin ç’drejtim do të merrte. Nëse shpendi fluturonte nga drejtimi i padëshiruar, ata zbrapseshin nga veprimi që kishin pasur ndër mend. Gjithashtu, kur dëgjonin ndonjë zë ose shikonin ndonjë person të caktuar ata besonin se këto ndillnin ters. Kishte njerëz që e quanin ogurzezë martesën në muajin *sheval*. Kjo është arsyeja që Aishja (radijallahu anha) ka thënë: “I Dërguari (sal-lallahu ‘alejhi ue sel-lem) bëri me mua aktin e martesës në muajin *sheval*,² dhe u bashkua me mua po në këtë muaj. Cila prej jush ka qenë më me fat tek ai se unë?”³ Gjithashtu, kishte prej tyre që e quanin ters ditën e mërkurë apo muajin *sefer*. Të gjitha këto i ka

¹ Që do të thotë se nëse e mjekon veten me hekur të nxehtë është njëlloj siç bën rukje për veten e tij.

² Muaji pas Ramazanit, i cili është muaj ndërmjet dy Bajrameve.

³ Muslimi.

bërë të pavlefshme Sheriati, për shkak të dëmit që i shkakton njeriut në logjikë, mendim dhe sjellje. Njeriu nuk duhet t'i marrë parasysh këto besëtytni, dhe kjo është dhe mbështetja në Allahun. Kështu dhe çështja mbyllet me fjalën:

– “... dhe në Zotin e tyre mbështeten. ...” – Mosprania e këtyre gjërave tek ata, tregon për mbështetjen e fortë të tyre tek Allahu.

Nëse me këto cilësi që i përshkroi Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ata do të futen në Xhenet pa llogari dhe pa u ndëshkuar, a do të thotë kjo se ai që nuk i ka këto cilësi është i qortuar apo thjesht i ka humbur përsosmëria?

Mund të themi se këtij njeriu i humb përsosmëria, me përjashtim të besëtytnisë në shenjat ogurzeza, e cila nuk lejohet, sepse është dëmtuese dhe nuk ka vërtetësi.

Për sa i përket kërkimit të mjekimit, me sa duket ai është i ngjashëm me atë.¹ Mund të themi se po të mos ishte fjala “*nuk kërkojnë rukje*”, do të thoshim se nuk përfshihet, sepse kërkimi i djegies me hekur është dëm real, është djegie me zjarr, që i shkakton dhimbje njeriut, ndërsa dobia vetëm shpresohet. Por fjala: “*nuk kërkojnë rukje*” është problem, se në rukje nuk ka dëm: nëse nuk të bën dobi, nuk të dëmton. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për ilaçet, të cilat nëse nuk të bëjnë dobi, nuk të dëmtojnë; megjithatë ato mund të bëjnë dëm kur nuk përdoren ilaçe për sëmundjen e duhur. Si do qoftë, kjo çështje ka nevojë për studim të mëtejshëm.

Po kur dobia e mjekimit – për shembull në rastet e thyerjeve, të prerjeve të gjymtyrëve apo dhe të apandesitit – është e sigurt dhe kur njeriu nuk e ul veten, a mund të themi se ky mjekim nuk i bën dëm, domethënë nuk e humb përsosmërinë e njeriut? Nëse do të thuhej se ky rregull vlen vetëm për rastet e përmendura në hadith, që do të thotë se veprimi i metodave të tjera mjekuese nuk pengon futjen në Xhenet pa llogari dhe pa ndëshkim, do të ishte përgjigje e argumentuar, për shkak të dëshmive që kanë ardhur në lidhje me urdhërimin për mjekim dhe lavdërimin që u është bërë disa ilaçeve si mjalti, fara e zezë, etj.

Nëse dikush kërkon të të bëjë rukje, a të humb përsosmëria, nëse

¹ Me sa duket, shejhu ka pasur për qëllim atë që nuk kërkon prej të tjerëve t'i bëjnë rukje.

ti nuk e ndalon atë? Mund të përgjigjemi se jo, nuk të humb. I Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk e ndaloi Aishen (*radijallahu anha*) që t’i bënte atij rukje, kur dihet se ai ka qenë njeriu më i përsosur në mbështetjen dhe sigurinë tek Allahu. Hadithi është për rastin kur këto gjëra nuk kërkohen, por arrihen pa i kërkuar, e ndryshimi mes këtyre është i qartë.¹

¹ Shejh Sulejmani (komentuesi i Kitabu Teuhid në Tejsir El-Aziz El-Hamid) thotë: “Dije se hadithi nuk tregon se ata i lënë shkaqet, siç mendojnë disa injorantë, sepse marrja e shkaqeve është çështje *fitrije* (e natyrshme) e domosdoshme, e askush s’mund t’u shmanget atyre, madje as kafsha. Gjithashtu vetë mbështetja konsiderohet si marrje e shkakut më të madh, siç ka thënë Allahu: “Kush i mbështetet Allahut, Ai i mjafton atij.”. Qëllimi është se ata lënë çështjet e urryera, edhe pse i kanë të nevojshme, për shkak të mbështetjes tek Allahu (subhanehu ue teala), si: kërkimi i rukjes dhe mjekimit me *kej*. Këto, jo se nuk janë shkaqe, por janë shkaqe të urryera e sidomos i sëmuri i cili kapet pas gjithçkaje që e mendon se është shkak për shërimin e tij edhe pse është i pa efektshëm, siç thuhet në një shembull, kapet qoftë edhe me fijen e merimangës. Pra, marrja e shkaqeve dhe mjekimi në një formë që nuk është e ndaluar, nuk e prish mbështetjen, e gjithashtu lënia e kurimit nuk është bërë e ligjshme nga Sheriati, siç përcillet në një hadith të saktë nga Ebu Hurejre (radijallahu anhu): “*Allahu nuk ka zbritur ndonjë sëmundje, vetëm se ka sjellë edhe shërim për të.*” (Buhariu dhe Muslimi). Po kështu, përcillet nga Usama Ibn Shurejk se ka qenë tek i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) kur erdhën beduinët dhe thanë: “O i Dërguari i Allahut, a të mjekohemi?” Ai u tha: “*Po, o robërit e Allahut! Mjekohuni se Allahu nuk ka zbritur ndonjë sëmundje e të mos ketë vendosur për të shërimin, përveç një sëmundjeje të vetme.*” I thanë: “Cila është ajo?” Tha: “*Pleqëria.*” (Ahmedi).

Ibn Kajimi në “Zadul mead” ka thënë: “Këto hadithe përmbajnë pohimin e shkaqeve dhe pasojave që rrjedhin prej tyre dhe pasaktësinë e mendimit të atij që i mohon ato; përmbajnë urdhrin për t’u mjekuar dhe se ai nuk bie ndesh me mbështetjen, ashtu siç nuk bie ndesh shmangia e së keqes së urisë dhe etjes, e nxehtësisë dhe të ftohtit me të kundërtat e tyre. Madje, Teuhidi realizohet vetëm me punimin e shkaqeve, të cilat Allahu i ka bërë si kushte të domosdoshme për pasojat e tyre, qofshin praktike të provuara apo fetare. Lënia e shkaqeve bie ndesh me vetë mbështetjen, ashtu siç bie ndesh me urdhrin dhe urtësinë. Lënia e tyre është paaftësi që bie ndesh me *teuekulin*, i cili është mbështetja e zemrës tek Allahu për arritjen e asaj që i bën dobi robit në dynja dhe ahiret, dhe shmangia e asaj që i bën dëm atij në dynja dhe ahiret. Kësaj mbështetjeje, patjetër duhet t’i bashkëngjitet marrja e shkaqeve, ose përndryshe robi bëhet mohues i urdhrin, urtësisë dhe fesë. Pra, robi të mos e bëjë paaftësinë e tij mbështetje dhe as mbështetjen e tij paaftësi.”

Dijetarët janë ndarë në disa mendime, për sa i përket çështjes së mjekimit: a është i lejuar, por lënia e tij është më e mirë? Është i pëlqyer, apo është detyrë? Ajo që njihet nga imam Ahmedi është mendimi i parë, sipas këtij hadithi dhe kuptimit të tij. Mirëpo, siç u sqarua më parë, nuk përmbushet argumentimi me të, (pra të qenët i lejuar dhe lënies së tij për më mirë). Ndërsa më i njohur te Shafiu është mendimi i dytë, ku Neueuiu në “Sherh

– “... U ngrit Ukashe Ibn Mihsani dhe tha: ‘Lute Allahun të më bëjë prej tyre.’ Ai i tha: ‘Ti je prej tyre.’...” – Deklarata ‘ti je prej tyre’ ishte shpallje hyjnore konfirmuese, shpallje e inspiruar, apo shpallje nëpërmjet të Dërguarit? Themi se, raste të tilla mund të jenë shpallje të inspiruara ose nëpërmjet të Dërguarit, por mund të jenë edhe shpallje konfirmuese, domethënë të kumtuara nga Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe nëse Allahu ia konfirmon atij atëherë është shpallje konfirmuese. Mirëpo transmetimi që vjen në “Sahihun” e Buhariut: “O Zot bëje atë prej tyre!”, tregon se shprehja “ti je prej tyre” është një informim që në vetvete ngërthen lutje.

– “... Më pas u ngrit një burrë tjetër e tha: ‘Lute Allahun të më bëjë edhe mua prej tyre.’ Ai tha: ‘Ta kaloi Ukashja.’” – Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk i tha atij jo, por: ta kaloi në këtë vlerë, mirësi, apo çështje Ukashe Ibn Mihsani. Dijetarët kanë mendime të ndryshme për arsyet që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i tha atij burri ashtu. Disa kanë thënë se ai ishte munafik, dhe Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk donte t’i përgjigjej me një formë të urryer, me qëllim që të ruhej uniteti i muslimanëve. Ndërsa të tjerë kanë thënë se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u druajt se mos krijohej mundësia që diçka të tillë ta kërkonte edhe ndonjë që

el Muslim” ka thënë: “Ky është medhhebi (mendimi) i tyre, i shumicës së selefëve dhe përgjithësisht i *halefëve* (brezave pasardhës). Këtë mendim ka zgjedhur edhe Vezir ebu el Madhfer.”

Në Medhhebin e Ebu Hanifes gjendet se mjekimi është më e sigurta, madje i afrohet të qenit të tij uaxhib (detyrë).

Në Medhhebin e Malikut përmendet se janë të barasvlershme veprimi dhe lënia e tij. Ai ka thënë se s’ka gjë në mjekimin ose lënien e tij.

Shejhu i Islamit Ibn Tejmije ka thënë se ai (mjekimi) nuk është detyrë tek shumica e dijetarëve, por e ka bërë detyrë një grup i vogël i dijetarëve shafij dhe hambelij.

Ndërsa shejhu (Muhamed el Uthejmini), në “Sherh el Mumti”, në fillim të kapitullit të xhenazes, ka thënë se, e sakta në lidhje me mjekimin është:

- Kur dihet ose mendon se mjekimi mund t’i bëjë dobi dhe ekziston mundësia t’i rrezikohet jeta me lënien e tij, ai është uaxhib.
- Kur mendon se mund t’i bëjë dobi mjekimi, por edhe nëse e lë nuk ka rrezik për jetën, marrja e mjekimit është më e mirë.
- Nëse barazohen të dyja çështjet, duke mos e ditur a të bën dëm apo të sjell dobi, lënia është më e mirë. (Marrë nga futnota e botimit të parë).

s’e meritonte aspak. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) iu përgjigj me një mënyrë, që merret si shembull edhe sot e kësaj dite.

■ **Dobitë e temës**

- Njohja e kategorive të njerëzve në varësi të teuhidit.

Argument është thënia e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... do të futen në Xhenet pa llogari dha pa dënim”. E më pas ka thënë: “Janë ata të cilët nuk kërkojnë rukje, nuk kërkojnë që të mjekohen me hekur të nxehtë, nuk parandiejnë fatin e keq për shkak të shenjave ogurzeza, por vetëm Zotit të tyre i mbështeten.”

- Kuptimi i realizimit të teuhidit.

Në fillim të temës thamë se ky realizim është pastrimi nga shirku.

- Lavdërimi që i bën Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) Ibrahimit duke e theksuar se ai nuk ishte idhujtar.

Kjo është e qartë në ajetin e Kuranit: “Vërtet Ibrahimimi ka qenë prijës shembullor, i përrulur para Allahut, me besim monoteist dhe nuk ka qenë idhujtar.” (Nahl, 120). Nuk ka dyshim se ky ajet është sjellë për lavdërimin e Ibrahimit (‘alejhis-selam). Përderisa shkak i lavdërimit është se ai nuk qe idhujtar, kjo tregon se çdokush që nuk është idhujtar, meriton të lavdërohet nga Allahut.

- Lavdërimi i Tij për më të mirët e evliave¹, për shkak të ruajtjes së tyre nga idhujtaria.

Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “... ata që nuk i shoqërojnë asgjë (në adhurim) Zotit të tyre.” Ky lavdërim ndodhet në kontekstin e disa ajeteve të cilat Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) i ka filluar kështu: “Me të vërtetë, ata që dridhen nga frika e Zotit të tyre; ata

¹ Çdo besimtar i devotshëm konsiderohet evlija.

që besojnë në Ajetet e Zotit të tyre (në Kuran); ata që nuk i shoqërojnë asgjë (në adhurim) Zotit të tyre dhe ata që japin (sadaka e mirësi) me zemrat e tyre gjithë frikë e përkushtim (nëse do t'u pranohet bamirësia apo jo nga Zoti i tyre), ata janë të sigurt në kthimin e vet te Zoti i tyre (për llogari). Pikërisht këta janë që garojnë për vepra të mira dhe për këto punë janë të parët.” (Mu'minun, 57- 61). Pra, këta janë evlijatë, janë më të mirët. Autori e përmend këtë jo për të treguar më të mirët e evlijave, por të tregojë që evlijatë janë më të mirët. Këtu nënkuptohen evlijatë, të cilët janë më të mirët e njerëzve.

- Mospraktikimi i kurimit me rukje dhe hekur të nxehtë është pjesë e realizimit të teuhidit.

Argument për këtë është thënia e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): “Janë ata të cilët nuk kërkojnë rukje, nuk kërkojnë të mjekohen me hekur të nxehtë ...” Edhe qëllimi i autorit është për atë që i kërkon vetë këto metoda.

- Mbështetja në Allahun i përmbledh këto cilësi.

Domethënë: moskërkimin e rukjes, moskërkimin e mjekimit me hekur të nxehtë dhe heqjen dorë nga besëtytnitë. Shkak i këtyre është mbështetja e fortë tek Allahu (Subhanehu ue Te'Ala).

- Nga hadithi del në pah edhe dija e thellë e sahabëve, sepse ata e dinin që shtatëdhjetëmijë vetët këtë shpërblim e arritën veçse përmes punës.

Kjo për faktin se ata u zhytën në diskutimin se kujt i përkiste ky shpërblim i madh, duke përmendur kategori të shumta njerëzish.

- Përkushtimi i sahabëve për arritjen e së mirës.

Ata diskutonin mënyrat e arritjes së të mirës, me qëllim që të mësonin se cilat ishin ato dhe t'i zbatonin.

- Vlera e këtij umeti në sasi dhe cilësi.

Për sa i përket numrit; Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) pa një turmë të madhe njerëzish, më të madhe se turma që ishte me Musain (alejhi selam). Ndërsa dallimi në cilësi është se me ta ishte kategoria e njerëzve që nuk kërkojnë rukje, nuk kërkojnë të mjekohen me hekur të nxehtë, nuk ndikohen nga shenjat ogurzeza, por mbështeten te Zoti i tyre.

- Vlera e pasuesve të Musait (**alejhi selam**).

Argument për këtë është thënia e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Kur pashë një turmë të madhe njerëzish, mendova se ishin populli im, por më thanë se ishte Musai me popullin e vet.”

- Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i janë paraqitur popujt e mëparshëm.

Paraqitja e tyre para tij ka dy dobi: së pari, për t’i larguar mërzinë Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), pasi ai pa një Profet me të cilin ishte vetëm një person, një Profet me të cilin ishin dy burra dhe një Profet pa asnjë pasues. Ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e largoi mërzinë me anë të kësaj duke thënë: “Unë nuk jam i pari Profet.” (El-Ahkaf, 9). Së dyti, sqarimi i vlerës së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe nderimi i tij, duke pasur ndjekësit më të shumtë dhe më të mirë.

- Çdo popull do të ringjallet bashkë me Profetin e vet.

Kjo del nga fragmenti: “... një Profet tjetër me një person, një Profet tjetër me dy burra ...”. Po të mos ishte çdo i Dërguar i dallueshëm nga i Dërguari tjetër, atëherë do të përziheshin me njëri-tjetrin dhe ndjekësit e tyre nuk do të njiheshin. Për këtë tregon edhe ajeti: “Atëherë të gjithë popujt do t’i shohësh të gjunjzuar, çdo popull do të thirret në Librin i tij ...” (Xhathijeh, 28), që tregon gjithashtu se çdo popull në Ditën e Gjykimit do të jetë më vete.

- Ata që i janë përgjigjur Profetëve kanë qenë të paktë.

Kjo është e qartë në pjesën: "... një Profet me një person, një Profet me dy burra dhe një Profet pa asnjë."

- Profeti të cilit nuk i besoi askush, do të vijë i vetëm.

Kjo del nga thënia e tij: "... një Profet pa asnjë."

- Frytet e kësaj dijeje, që janë mosmashtrimi me shumicën dhe mosnënçmimi i pakicës.

Shumica mund të jetë në humbje. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Nëse u bindesh shumicës së njerëzve që gjenden në tokë, ata do të të shmangin nga rruga e Allahut." (En'am, 116). Kur njeriu mashtrohet me shumicën, duke menduar se ajo nuk thyhet, se është gjithmonë e fituar, kjo është shkak për zhgënjim. Nëse ne do të shikojmë shumicën e njerëzve në tokë, do të vërejmë se ata janë të humbur, ndaj nuk duhet të na gënjejë kjo gjë. Nuk duhet të themi se të gjithë njerëzit janë të tillë, prandaj s'mund të veçohemi prej tyre. Po kështu, kur ke shumë pasues në të drejtën, mos u mashtro.

Kjo fjalë e autorit ka dy interpretime. Së pari, të mos mashtrohemi me shumicën e të shkatërruarve, e që, si rrjedhim, të mos shkatërrohemi bashkë me ta. Së dyti, të mos mashtrohemi me shumicën e të shpëtuarve e të tundohevi, e as të mos e nënçmojmë pakicën, se ajo mund të jetë më e mirë se shumica.

- Lejohet të bëhet rukje kur sëmuremi nga syri i keq dhe helmi.

E argumentuar me thënien e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Rukja lejohet vetëm për mësyshin ose pickimin (e ndonjë kafshe helmuese)."

- Dija e thellë e selefëve, që del nga fjala: "... ka vepruar mirë ai që është bazuar tek ajo që ka dëgjuar, por ...".

U bë e qartë se hadithi i parë nuk e kundërshton të dytin.

Hadithi i parë nuk kundërshton të dytin sepse thënia: “Rukja lejohet vetëm për mësyshin ose pickimin” nuk e kundërshton hadithin e dytë. Njëri është për kërkimin e rukjes, kurse tjetri është për llojin e rukjes.

Nëse një personi i vjen dikush për t’i bërë rukje dhe ai nuk e ndalon, kjo nuk bie ndesh me fjalën: “Janë ata të cilët nuk kërkojnë rukje ...”. Në lidhje me këtë veprim ka tri gradë: 1. Të kërkojë që të bëjë rukje. Në këtë rast humb përsosmëria. 2. Të mos e ndalosh atë që të bëjë rukje. Në këtë rast nuk humb përsosmëria, sepse nuk kërkohet vetë që të bëhet rukja. 3. Të ndalosh atë që të bëjë rukje. Kjo është në kundërshtim me Sunetin. I Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk e ndaloi Aishen t’i bënte rukje. Edhe sahabët nuk kanë ndaluar asnjë që t’u bënte rukje, sepse kjo nuk ndikon në mbështetjen tek Allahu.

- Selefët i shmangeshin lavdërimin për diçka që nuk e kishin.

Kjo është nxjerrë nga dialogu: “Kush e pa yllin që u shkëput mbrëmë?” I thashë: “Unë. Por nuk isha duke u falur, sepse më kafshoi një kafshë helmuese.” Përderisa e kishte parë yllin që ishte shkëputur, do të thoshte se kishte qenë zgjuar dhe ai që është zgjuar, ose është duke u falur, ose ka ndonjë punë tjetër, ose diçka e ka penguar nga gjumi.

- Thënia: “Ti je prej tyre” është një nga shenjat që tregon për vërtetësinë e profetësisë së të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Ukashe Ibn Mihsani nuk ra në kufër derisa vdiq si musliman. Ky është një argument që tregon për profetësinë e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), nëse pranojmë se shprehja në hadith është lajmërim dhe nuk është lutje. Nëse do të themi se shprehja është lutje, përsëri mund të jetë shenjë e profetësisë, për faktin se

Allahu iu përgjigj lutjes së të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Megjithatë, përgjigjja e lutjes nuk është e posaçme vetëm për Profetët, se Allahu mund t’u përgjigjet lutjeve edhe të atyre që nuk janë Profetë. Atëherë kjo mund të jetë një shenjë tipike e profetësisë, vetëm nëse e konsiderojmë thjesht si një shprehje lajmëruese.

➤ Vlera e Ukashes (r.a.).

Ai do të futet në Xhenet pa llogari dhe ndëshkim. Po a e dëshmojmë ne këtë për Ukashen? Mund të themi se e dëshmojmë, përderisa i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka dëshmuar këtë.

➤ Përdorimi i shprehjeve të tërthorta.

Argument për këtë është thënia e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): *“Ta kaloi Ukashja.”* Fjalët me dy kuptime të japin mundësinë të ruhesh nga gënjeshtria, sipas kësaj thënieje të Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Kjo, në të vërtetë, nuk ishte pengesa për mosplotësimin e kërkesës së personit të dytë. Pengesa e vërtetë ishte ajo që përmendëm më lart gjatë shpjegimit: ose për shkak se ishte munafik, dhe i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk desh të bënte që njerëz si ata të futeshin në Xhenet pa llogari dhe pa ndëshkim, ose nga droja se mos hapej porta e kështu ta kërkonte këtë privilegj dikush që nuk e meritonte.

➤ Morali i lartë i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Ai ia “mbylli derën” personit të dytë, pa lënë të nënkuptohej diçka e keqe a e urryer.

Tema 4

Frika nga idhujtaria.

Lidhja e kësaj teme me dy të mëparshmet qëndron në faktin se në njërën prej tyre autori përmend realizimin e teuhidit, në tjetrën përmend se ai që e realizon teuhidin do të futet në Xhenet pa llogari dhe pa ndëshkim, por ka raste kur njeriu mendon se e ka realizuar teuhidin dhe e vërteta mund të mos jetë kështu. Për këtë arsye disa selefë kanë thënë: “Nuk ka diçka për të cilën jam përpjekur më shumë sesa për sinqeritetin.” Kjo, për arsye se egoja është e lidhur me dynjanë. Ajo do që të arrijë të mirat e dynjasë si në pasuri, poste drejtuese etj., dhe ndonjëherë mund ta bëjë këtë edhe nëpërmjet punëve të ahiretit. Pikërisht kjo është mangësia në sinqeritet. Janë të paktë ata që synojnë ahiretin në të gjitha veprat e tyre. Ja përse autori (Allahu e mëshiroftë!) pas dy kapitujve pararendës, ka sjellë temën “Frika nga idhujtaria”, duke e nisur me dy ajete.

Ajeti 1. “Vërtet, Allahu nuk fal që të shoqërohet dikush apo diçka me Të, por gjynahet e tjera më të vogla se shirku ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut në adhurim, ai me të vërtetë ka humbur dhe është larguar shumë prej udhës së drejtë.” **(Nisa, 116)**

– “Vërtet, Allahu nuk fal që të shoqërohet dikush apo diçka me Të ...” – Allahu kurrë nuk e fal shirkun, sepse është shkelje e të drejtës së padiskutueshme të Allahut: teuhidit. Me gjynahet e tjera, si imoraliteti apo vjedhja, ndoshta *nefsi* njerëzor gjen kënaqësi, për

shkak të përmbushjes së epshit, ndërsa shirku është shkelje e të drejtës së Allahut, në të cilën nuk të shtyn ndonjë epsh, por ai është thjeshtë një padrejtësi, prandaj Allahu i Lartësuar thotë: “Vërtet shirku është padrejtësia më e madhe.” (Lukman, 13).

Lind pyetja: a nënkuptohet më këtë vetëm shirku i madh apo çdo lloj shirku? Disa dijetarë kanë thënë se kjo përfshin çdo lloj shirku, qoftë edhe i vogël, siç është betimi jo në Allah; pra Ai nuk fal çdo lloj shirku. Për sa u përket mëkateve të mëdha, si vjedhja, konsumi i alkoolit etj., ato janë nën dëshirën e Allahut; ndoshta i fal. Shejhu i Islamit Ibn Tejmije, i cili e ka shqyrtuar mirë këtë çështje, ka dhënë përfundime kontradiktore: njëherë ka thënë se Allahu nuk e fal shirkun, edhe nëse është i vogël, e njëherë tjetër ka thënë se ai të cilin Allahu nuk e fal është shirku i madh. Sido që të jetë, është detyrë të ruheni nga shirku në mënyrë maksimale. Përgjithësimi mund të përfshijë edhe shirkun e vogël, sepse shprehja: “... që të shoqërohet me Të ...” tregon përgjithësim, sipas rregullave të gjuhës arabe.

– “... gjynahet e tjera më të vogla se shirku ...” – Nënkuptohen gjynahet më të vogla se shirku, dhe jo çdo gjë tjetër përveç shirkut.

Ajeti 2. Allahu i Madhëruar përmend në Kuran se Ibrahim tha: “Më largo mua dhe bijtë e mi nga adhurimi i idhujve.” **(Ibrahim, 35)**

– “... Më largo mua dhe bijtë e mi nga adhurimi i idhujve.” – Thuhet se flitet për ata që lindën prej tij, dhe ne nuk dimë që ai të ketë pasur fëmijë të tjerë veç Ismailit dhe Is’hakut. Thuhet gjithashtu se bëhet fjalë për pasardhësit e tij dhe për ata që lindën prej tyre, e kjo është edhe më e sakta, mbështetur edhe tek ajetet që tregojnë për ftesën e tij drejtuar pasardhësve të vet. Ishte pjesë e urtësisë së Allahut që Ai të mos i përgjigjej lutjes së Ibrahim për disa prej tyre, ashtu sikurse nuk iu përgjigj lutjes së Pejgamberit tonë (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) që umeti i tij të mos kishte armiqësi mes veti.

Saktësinë e mendimit të parë e pengon edhe fakti se ajeti vjen në numrin shumë (më shumë se dy), ndërkohë që Ibrahim nuk ka pasur fëmijë të tjerë përveç Ismailit dhe Is’hakut.

– “... *mē largo mua ...*” – Pra, mē bëj që të qëndroj larg tyre: unë të jem në njërën anë e idhujt në anën tjetër. Shprehja “mē largo” është mē e fortë sesa: “mē ndalo”, sepse largësia nga e keqja është mē e sigurt.

Ibrahimi frikësohej për veten e tij nga shirku, edhe pse ishte *halilullah* (mik i Allahut) dhe prijës në fenë e drejtë. Po gjendja jonë si duhet të jetë? Prandaj, mos mendoni se jeni të sigurt nga shirku dhe hipokrizia! Nga hipokrizia është i sigurt vetëm hipokriti, ndërsa besimtari i ruhet gjithmonë asaj.

Ibn Ebu Mulejke ka thënë: “Kam arritur tridhjetë shokë të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), dhe që të gjithë ata i frikësoheshin hipokrizisë.”

Omeri (*r.a.*) e ka kapur Hudhejfen, të cilit i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i kishte treguar emrat e munafikëve, dhe i ka thënë: “Të lutem për hir të Allahut, a mē ka përmendur mua i Dërguari i Allahut ndër munafikët?” Hudhejfja i tha: “Jo, dhe pas teje nuk do t’i kallëzoj mē askujt.” Omeri donte të shtonte sigurinë, edhe pse i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e kishte përgëzuar me Xhenet. Nuk është e drejtë të thuhet se Omeri për vete nuk kishte frikë (*r.a.*), por kishte si qëllim nxitjen e të tjerëve për t’iu ruajtur kësaj dukurie, sepse kjo është në kundërshtim me kuptimin e drejtpërdrejtë të shprehjes. Parimisht shprehja merret sipas kuptimit të drejtpërdrejtë të saj. Mirëpo disa dijetarë në lidhje me atë që i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ia atribuonte vetes së tij disa gjëra thonë se me to synonte të mësonte të tjerët dhe t’i sqaronte ato për ta. Kështu është thënë se i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk është lutur: “O Zot mē fal!” sepse ai kishte mëkate, por për t’u mësuar njerëzve kërkimin e faljes, por kjo është në kundërshtim me rregullin bazë. Po kështu disa kanë thënë se i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka bërë dhikrin me zë pas namazeve, për t’ua mësuar atë njerëzve, dhe jo se dhikri me zë është synet, etj.

– “... *nga adhurimi i idhujve.*” – Fjala arabe “*sanem*” (idhuj) shënon çdo gjë që ka formën e njeriut ose ndonjë formë tjetër dhe që adhurohet përveç Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), ndërsa “*uethen*”

quhet çdo gjë që adhurohet veç Allahut, në çfarëdolloj aspekti qoftë. Në një hadith thuhet: “Mos e bëni varrin tim ‘*uethen*’ që të adhurohet.” Nga kjo del se fjala “*uethen*” ka kuptim më të gjerë se fjala “*sanem*”.

Nuk ka dyshim se Ibrahim i kërkoj nga Zoti i tij që ta përforconte në teuhid, sepse po ta largonte nga adhurimi i idhujve do të mbetej detyrimisht në teuhid.

Dëshmia që merret nga ky ajet është se Ibrahim kishte frikë shirkun, ndërkohë që ishte prijësi i të drejtëve në besim dhe më i miri ndër ta, përveç Pejgamberit tonë (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Në një hadith përcillet: “Gjëja që frikësohem më shumë për ju, është shirkun i vogël.” Kur u pyet se cili është ai, tha: “Shtirja.”¹

Hadith quhet çka i atribuohet të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), qoftë kjo thënie, punë, pohim apo përshkrim. *Ether* është çka i atribuohet dikujt tjetër, veç Pejgamberit, si sahabëve dhe të tjerëve pas tyre. Nëse thuhet se ka ardhur në *ether* nga i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), atëherë kjo i përket atij tek i cili kufizohet.

– “... *Gjëja që frikësohem më shumë për ju ...*” – Këtu iu është drejtuar muslimanëve e jo të gjithë njerëzve, sepse vetëm për muslimanin ekziston frika e rënies në shirkun e vogël.

– “*Shtirja.*” – Shtirja është kur adhuron Allahun me qëllim që të të shohin njerëzit e të të lavdërojnë se je adhurues. Një person i tillë nuk e bën adhurimin për njerëzit, se po të kishte këtë për qëllim, do të bënte shirk të madh. Ajo që kuptohet nga konteksti është vetëm si shembull, sepse mund të jetë për t’u dukur, por mund të jetë edhe për tu dëgjuar, që do të thotë se ka për qëllim me adhurimin e tij që të dëgjojnë njerëzit e ta lavdërojnë për këtë. Kjo përfshihet në shtirje. Të shprehurit me shtirje është në aspektin e të shprehurit me atë që ndodh në më të shumtën e rasteve. Megjithatë, nëse me

¹ Transmeton Ahmedi. Sipas Albanit hadithi është i saktë.

adhurimin synohet dhënia shembull për të tjerët, kjo nuk është shtirje, përkundrazi, është ftesë për tek Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). I Dërguari (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë njëherë: “E veprova këtë, që të më pasoni mua dhe të mësoni namazin tim.”¹

Shtirja që e prish adhurimin ndahet në dy lloje:

1- Kur gjendet në fillësë të adhurimit, domethënë kur adhurimi nis për syfaqësi. Në këtë rast, adhurimi është i papranueshëm. Sipas hadithit të Ebu Hurerejres, Allahu ka thënë: “Unë nuk kam nevojë për pjesën (e veprës) që ma kushtojnë në ortakëri me të tjerë.² Kush kryen një vepër dhe shoqëron në të me Mua dikë tjetër, Unë e lë atë dhe shirkun e tij.”³

2- Kur puna nis për hir të Allahut, por në mes futet syfaqësia. Edhe kjo ka dy shfaqje:

- a) Kur kjo ndjenjë mposhtet. Në këtë rast, kjo nuk e dëmton adhurimin. Për shembull, dikush fillon dhe fal një rekat. Pastaj, në rekatën e dytë, vijnë disa njerëz dhe bashkohen me të. Ai ndjen diçka në zemër që e shtyn të zgjasë rukunë ose sexhden apo të bëjë sikur qan. Nëse e mposht këtë ndjenjë, ajo nuk i bën dëm, sepse ai u përpoq.
- b) Kur vazhdohet me shtirjen, për shembull, të zgjatësh qëndrimin në këmbë në namaz, në ruku dhe sexhde, ose kur të bësh sikur qan. Kjo vepër zhvlerësohet plotësisht, sepse çdo punë që buron nga shtirja fshihet.

Lind pyetja: adhurimi nuk pranohet i tëri apo vetëm pjesërisht? Në këtë pikë duhet të qartësohen dy raste:

1. Nëse fundi i adhurimit është i lidhur me fillimin e tij, atëherë fillimi i mirë nuk vlen kur fundi është i prishur. Kështu, e gjithë puna konsiderohet e pavlefshme, si në rastin e namazit, te i cili nuk mund të priset fundi e të mos priset fillimi. Pra kur gjatë kryerjes së namazit lind syfaqësia dhe personi nuk e shmang, atëherë i tëri

¹ Buhariu.

² Kjo nuk do të thotë se Allahu ka nevojë për atë punë që i kushtohet vetëm Atij pa i shoqëruar askënd tjetër, por do të thotë se Ai nuk e shpërblen dhe nuk e pranon punën në të cilën shoqërohet dikush tjetër me Të.

³ Muslimi.

bëhet i pavlefshëm.

2. Nëse fillimi i adhurimit është i ndarë nga përfundimi i tij. Në këtë rast, pjesa e fillimit vlen, ndërsa fundi është i prishur. Kjo mund të ndodhë në rastin kur, për shembull, dikush ka 10.000 lekë dhe jep gjysmat e tyre si sadaka për hir të Allahut, kurse gjysmën tjetër e jep për t'u dukur. Të parat i pranohen si sadaka, ndërsa të dytat jo.

Po sikur të ketë shtirje gjatë marrjes së avdesit, a mund të gjykojmë si në rastin e namazit, domethënë ta konsiderojmë të gjithë avdesin të pavlefshëm, apo duhet gjykuar si në rastin e sadakasë e ta quajmë të pavlefshëm vetëm atë pjesë në të cilën ka ndodhur syfaqësia? Them i se mund të jetë si njëra (domethënë të gjykohet si në rastin e namazit) ashtu edhe tjetra (të gjykohet si në rastin e sadakasë). Gjykohet si për namazin, sepse abdesi është një rit i pandashëm, ku njëra pjesë është e lidhur ngushtë me tjetrën, dhe nuk mund të konceptohet pastrimi i çdo gjymtyre si rit më vete. Gjithashtu, mund të gjykohet njëloj si për sadakanë, sepse avdesi nuk është si namazi në të gjitha aspektet dhe as si sadakaja në të gjitha aspektet. Nëse themi se është e pasaktë pjesa në të cilën futet syfaqësia dhe personi e përsërit pastrimin e asaj pjese të trupit, nuk ka ndonjë dëm, sepse përsëritja e larjes së një pjese, nuk e prish avdesin, edhe sikur të jetë qëllim në vetvete. Për sa i përket namazit, nëse personi e përsërit një pjesë të tij, si rukunë apo sexhden, pa ndonjë shkak të ligjshëm, ajo është e pavlefshme. Nëse personi, pasi ka larë krahët, kthehet dhe lan fytyrën, nuk i prishet avdesi, por nëse pas sexhdes, kthehet të bëjë rukunë, namazi i tij prishet. Renditja ekziston te të dy adhurimet, por shtesa në namaz e prish atë, ndërsa shtesa në abdes jo. E rëndësishme është të dihet se ka ndryshim ndërmjet avdesit dhe namazit e, rrjedhimisht, kuptohet se kjo është një çështje që ka nevojë për studim.

Nga Ibn Mesudi përcillet se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kush vdes duke lutur dikë tjetër përveç Allahut, hyn në Zjarr.”¹

¹ Transmeton Buhariu.

– “... duke lutur dikë tjetër përveç Allahut ...”. Domethënë i bën Allahut rival, sido që të jetë lutja e tij, *lutje adhurimi* apo *lutje kërkimi*, sepse vetë lutjet ndahet në dy lloje:

a) Lutjet e adhurimit, si: namazi, agjërimi, haxhi, etj., të cilat i përkasin adhurimeve. Kur njeriu falet ose agjëron, e ka lutur Zotin e tij me gjendjen e tij që ta falë dhe ta shpëtojë nga ndëshkimi e t'i japë prej mirësive të Tij. Kjo qëndron në thelbin e namazit, por ai përmban edhe lutje kërkimi. Për këtë lloj lutjeje tregon fjala e Allahut: “Zoti juaj ka thënë: ‘Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem ...’” (Gafir, 60). Këtu, lutja është quajtur adhurim. Ky adhurim është shirk nëse bëhet për dikë tjetër veç Allahut. Kur dikush ia kushton një lloj adhurimit dikujt tjetër veç Allahut, ka rënë në kufër që të nxjerr nga feja, për shembull, kur bën ruku ose sexhde për ndonjë person, duke e madhëruar atë, siç madhëron Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala). Kush e bën këtë është idhujtar. Për këtë arsye, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka ndaluar përkuljen e trupit përpara në shenjë nderimi, në takime. Kur u pyet nëse një burrë që takon vëllain e tij, duhet ta përkulë trupin për të apo jo, tha: “Jo.”¹ Ndryshe veprojnë disa injorantë, të cilët kur të përshëndesin, përkulen. Është detyrë për çdo besimtar që ta ndalojë këtë ves, sepse kështu njerëzit madhërojnë njëri-tjetrin, duke cenuar fenë.

b) Lutja e kërkimit, e cila nuk është në të gjitha rastet shirk, por ka shtjellim. Nëse një krijesë ka mundësi reale ta plotësojë kërkesën që i bëhet, nuk është shirk, si për shembull kur i kërkon ujë për të pirë dikujt që ka mundësi të të japë. I Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kur dikush ju fton, përgjigjuni atij.”² Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Kur të afërmit, jetimët dhe të varfërit ndodhen aty në kohën e ndarjes (së pasurisë), jepuni edhe atyre nga pasuria ...” (Nisa, 8). Ndërsa të lusësh krijesën për diçka që mund të ta japë vetëm Allahu, është shirk që të nxjerr nga feja, për shembull nëse i lutemi dikujt që të sjellë shi, duke besuar se ai është i fuqishëm për ta bërë këtë, etj.

– “... Kush vdes duke lutur dikë tjetër përveç Allahut ...”

¹ Ahmedi dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i mirë.

² Ahmedi, Ebu Daudi, Nesaiu, Hakimi dhe Bejhakui. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

nënkuptohej shirku me lutjen e adhurimit, kurse shirku me lutjen e kërkit është sipas sqarimit të lartpërmendur. Për fat të keq, në disa vende islame, ka nga ata që besojnë se një person që është varrosur dhe i ka mbetur vetëm kufoma, ose edhe kufomën e ka kalbur toka, bën dobi ose dëm, besojnë se mund ta bëjë një grua shterpë që të lindë fëmijë. Ky besim – Allahu na ruajtë – është shirk i madh, që të nxjerr nga feja, dhe është më i keq sesa vepra e pirjes së alkoolit, imoralitetit apo homoseksualitetit, sepse është vepër kufri, e jo vetëm vepër mëkati.

– “... *hyn në Zjarr*” – Domethënë, hyn në të përgjithmonë, edhe pse shprehja nuk tregon për këtë, sepse fjala ‘*hyn*’ nuk e përcakton kohën e qëndrimit. Gjithashtu Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Nuk ka dyshim se kushdo që i vë shok Allahut, Allahu ia ka bërë haram (të ndaluar) Xhenetin, dhe vendbanimi i tij do të jetë Zjarri; dhe për zullumqarët nuk do të ketë asnjë ndihmues.” (Maide, 72). Nëse i bëhet haram Xheneti, kjo do të thotë se ai do të jetë i përhershëm në Zjarr. Atëherë, është detyrë të frikësohemi nga politeizmi, përderisa ndëshkimi i tij është ky. Politeisti ka humbur ahiretin, sepse do të jetë i përhershëm në Zjarr. Po kështu, ai ka humbur edhe dynjanë, sepse nuk përfiton asgjë prej saj, ndërkohë që i është paraqitur e vërteta dhe i ka ardhur këshilluesi. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “A nuk ju dhamë Ne jetë mjaft të gjatë, saqë kushdo që donte të merrte këshillim, mund ta merrte atë?! Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi ...” (Fatir, 37).

“Dhe nga mesi i njerëzve është edhe ai, i cili adhuron Allahun me mëdyshje (luhatshëm): nëse i bie ndonjë e mirë, kënaqet me të, por nëse e godet ndonjë sprovë, kthehet në fytyrën e vet të vërtetë (kthehet në mosbesim), duke i humbur kështu të dyja, edhe këtë botë edhe botën tjetër. Kjo është humbje e qartë. Ai në vend të Allahut lut atë që nuk mund t’i sjellë as dëm e as dobi. Pikërisht kjo është humbja pa mbarim. Ai i lutet atij, dëmi i të cilit është më afër se përfitimi i tij; sa ndihmëtarë i keq dhe sa shok i keq është ai!” (Haxh, 11-13).

“Të humburit janë ata që do të humbin vetveten dhe familjet e tyre në Ditën e Kijametit. A nuk është kjo tamam humbja e qartë?!” (Zumer, 15). Kanë humbur veten e tyre, sepse nuk kanë përfituar

asgjë prej saj. Kanë humbur familjen e tyre, sepse, nëse familja janë besimtarë, do të jenë në Xhenet, dhe kështu nuk do të kënaqen me ta në ahiret. E nëse familja do të jenë në Zjarr, nuk do të kënaqen gjithashtu, sepse sa herë që futet një grup në Zjarr, mallkon të tjerët që kanë hyrë para tij.

Shirku është shumë i fshehtë, aq sa ndoshta njeriu nuk e kupton ndryshe, vetëm pas një shqyrtimi të hollësishëm. Për këtë arsye disa selefë thoshin, çka e kemi përmendur edhe më parë: “Nuk jam përpjekur për diçka tjetër, siç jam përpjekur për sinqeritetin.”

Çështja e shirkut nuk është e lehtë, por e vështirë, megjithëse Allahu ia lehtëson sinqeritetin njeriut, duke ia vendosur atë në qendër të vëmendjes dhe duke e bërë të synojë me punën e tij shpërblimin e Allahut të Madhëruar dhe jo lavdërimin e njerëzve ose sharjen e tyre. Njerëzit kurrë nuk mund t’i bëjnë atij dobi, edhe nëse dalin të gjithë për t’i përcjellë xhenazen. Ajo që të bën dobi është vetëm puna jote. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Të vdekurin e ndjekin tri gjëra: dy kthehen pas dhe njëra mbetet. Atë e ndjekin familja, pasuria dhe puna e tij. Pas i kthehet familja dhe pasuria, ndërsa puna e tij i mbetet.”¹

Po kështu, është e rëndësishme për njeriun, të mos kënaqet që njerëzit pranojnë fjalën e tij, por vetëm kur mendon se ajo është e vërteta dhe duhet pranuar. Ai nuk duhet të mërzitet kur njerëzit e refuzojnë fjalën e tij, por duhet të mërzitet kur ajo është e vërteta dhe nuk duhet refuzuar, sepse kështu realizohet sinqeriteti.

Sinqeriteti është shumë i vështirë, dhe vetëm kur njeriu është drejtuar tek Allahu me besnikëri të pastër për në rrugën e drejtë, Ai e ndihmon dhe ia lehtëson atë.

Nga Xhabiri përcillet se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kush e takon Allahun, duke mos i shoqëruar Atij asgjë, do të futet në Xhenet, dhe kush e takon Allahun, duke i shoqëruar Atij dikë tjetër, hyn në Zjarr.”²

¹ Buhariu.

² Muslimi.

– “*Kush e takon Allahun, duke mos i shoqëruar Atij asgjë, do të futet në Xhenet...*” – Kjo futje në Xhenet nuk e mohon ndëshkimin sipas mëkateve, nëse ka pasur të tilla, siç tregojnë për këtë argumentet e kërcënimit, dhe kjo nëse nuk e fal Allahu, sepse ai është nën mëshirën e Tij.

– “*... duke mos i shoqëruar Atij asgjë ...*” – Çfarëdolloj shoqërimi që i bëhet Allahut, qoftë edhe me më të nderuarën krijesë, Pejgamberin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), do të futet në Zjarr. E ç’mund të thuhet atëherë për atë që e konsideron Pejgamberin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) më të madh sesa Allahu, duke iu drejtuar atij kur është në vështirësi në vend që t’i drejtohet Allahut. Ka edhe nga ata që i drejtohen ndokujt që është nën gradën e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ashtu siç ka prej atyre që nuk duan t’ia dinë kur betohen në Allahun, se a betohen për një të vërtetë apo një gënjeshtër, e që kur betohen në kombësinë e vet thonë vetëm të vërtetën. Për këtë arsye dijetarët kanë mendime të ndryshme lidhur me atë që nuk do t’ia dijë kur betohet në Allahun, e që kur betohet në fenë e vet, ose në diçka tjetër që e madhëron, thotë vetëm të vërtetën, se një personi të tillë i kërkohet të betohet në Allah apo në ato gjëra që i madhëron? Më e sakta është se atyre duhet t’u kërkohet të betohen në Allahun, edhe nëse gënjejnë, sepse të paktën kjo nuk i shtyn ata drejt shirkut. Megjithatë, është thënë se mund ta vësh të betohet jo në Allah, sepse qëllimi është zbardhja e të vërtetës, e si rrjedhim nëse një person i tillë është gënjeshtar, ai nuk mundet të betohet. Por në fakt ky mendim nuk është i saktë sepse kur ka të drejtë, ai betohet në atë që e madhëron veç Allahut, duke rënë kështu në shirk.

Çështje për diskutim: A do të thotë hadithi se ai që futet në Zjarr për shkak se ka bërë shirk, do të qëndrojë në të përgjithmonë?

Kjo varet sipas shirkut. Nëse është shirk i vogël, atëherë ai nuk do të mbetet përherë në Zjarr, e nëse është i madh, do të mbetet përgjithmonë atje, siç tregojnë argumentet. Nëse dy hadithet: “*Kush vdes duke lutur dikë tjetër përveç Allahut, do të futet në Zjarr*” dhe: “*Kush e takon Allahun, duke i shoqëruar Atij dikë tjetër, do të futet në Zjarr*”, i referohen shirkut të madh, atëherë mund të themi se kush

e takon Allahun pa bërë shirk të madh, do të futet në Xhenet. Ky do të jetë përfundimi i tij, edhe nëse ndëshkohet përpara me zjarr, sipas asaj që meriton. Nga ana tjetër, kush e takon Allahun, duke i bërë Atij shirk të madh, do të futet përgjithmonë në Zjarr. Megjithatë, ne nuk kemi nevojë për këtë shtjellim.

Dobitë e temës

➤ Njeriu duhet të ketë frikë nga shirku.

Argument është thënia e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “Vërtet, Allahu nuk fal që të shoqërohet dikush apo diçka me Të”; “Më largo mua dhe bijtë e mi nga adhurimi i idhujve.”

➤ Shtirja është pjesë e shirkut.

Argument është hadithi: “Gjëja së cilës i druhem më shumë për ju është shirku i vogël.” Kur u pyet Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) se cili është ai, tha: “Shtirja.”

➤ Shtirja është shirk i vogël.

Kur u pyet Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për shirkun e vogël, tha se është shtirja. Po a mund të arrijë ajo të bëhet shirk i madh? Siç duket nga kuptimi i drejtpërdrejtë i hadithit, nuk mundet, sepse i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha “shirku i vogël”, dhe kur u pyet për të, tha se është syfaqësia (shtirja). Por Ibn Kajimi (Allahu e mëshiroftë), kur flet për shirkun e vogël, thotë se ai është si shtirja e vogël, dhe kjo tregon se kur ajo është më e madhe, nuk është më shirk i vogël. Nëse ai ka pasur për qëllim sasinë, atëherë po, sepse nëse çdo punë bëhet për sy e faqe, atëherë ky është shirk i madh, për shkak të mungesës totale të sinqeritetit në vepra. Nëse Ibn Kajimi ka për qëllim cilësinë, atëherë themi se, nga konteksti i hadithit, duket se syfaqësia është shirk i vogël.

- Syefaqsia është gjëja më e rrezikshme, së cilës i druhemi për njerëzit e mirë.

Kjo është marrë nga fjala: “Gjëja së cilës i druhem më shumë për ju është shirku i vogël”, se ndoshta ai futet në zemrën e njeriut pa e kuptuar, për shkak të fshehtësisë së tij dhe sepse epshi e dëshiron. Gjithashtu, shumë nga njerëzit dëshirojnë të lavdërohen me adhurimin që i bëjnë Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala).

- Për sa i përket përfundimit, njeriu është shumë afër si Xhenetit ashtu dhe Zjarrit.

Argument është thënia e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Kush e takon Allahun duke mos i shoqëruar asgjë Atij, futet në Xhenet, dhe kush e takon Atë duke i shoqëruar diçka, futet në Zjarr.”

- Pozicionimi i të dyjave (**Xhenetit dhe Xhehenemit**) në një hadith të vetëm.

Hadithi është: “Kush e takon Allahun, duke mos i shoqëruar asgjë Atij ...”

- Kush e takon Allahun duke i shoqëruar Atij diçka, do të futet në Zjarr, edhe nëse ka qenë ndër adhuruesit më të mëdhenj.

Pra, nëse shirku i tij është i madh, nuk do të futet në Xhenet, edhe nëse ka qenë ndër njerëzit më adhurues. “Nuk ka dyshim se kushdo që i vë shok Allahut, Ai ia ka bërë haram (të ndaluar) Xhenetin dhe vendbanimi i tij do të jetë Zjarri.” (Maideh, 72). Nëse shirku i tij është i vogël, ai do të ndëshkohet sipas mëkateve që ka bërë, e pastaj do të futet në Xhenet.

- Kërkimi i mbrojtjes për veten dhe bijtë e tij nga ana e Ibrahimit, për të mos rënë në adhurimin e idhujve,

tregon se kjo është një çështje e madhe.

Në Kuran përmendet: “Më largo mua dhe bijtë e mi nga adhurimi i idhujve.”

- Marrja në konsideratë nga ana e tij e gjendjes së shumicës, sipas ajetit: “O Zoti im! Vërtet që **(idhujt)** kanë gabuar dhe humbur shumë nga njerëzit.” **(Ibrahim, 36)**

Këtu ka një paqartësi: autori ka përdor fjalën ‘*ekther*’, që do të thotë ‘shumicë’, ndërsa në ajet thuhet: “shumë nga njerëzit”, duke u përdorur fjala ‘*kethir*’. Ka ndryshim ndërmjet fjalës ‘*ekther*’ (shumicë) dhe ‘*kethir*’ (shumë). Allahu (*subhanehu ue teuala*) thotë: “... dhe i kemi ngritur ata përmbi shumë prej atyre që Ne i kemi krijuar ...” (Isra, 70). Pra, nuk ka thënë “përmbi shumicën e krijesave” e as “përmbi krijesat”. Njerëzit janë ngritur përmbi shumë prej krijesave të Allahut, mirëpo ata nuk janë krijesa më e nderuar tek Allahu (*subhanehu ue teuala*), ndonëse janë të nderuara.

- Komenti i fjalës *La ilahe il’All-llah*, siç ka thënë edhe Buhariu.

Me sa duket, kjo është marrë nga e gjithë tema, sepse shprehja *La ilahe il’All-llah* përmban pohim dhe mohim.

- Mirësia e atij që shpëton nga shirku.

Argument është thënia e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Kush e takon Allahun, duke mos i shoqëruar Atij asgjë, do të futet në Xhenet.”

Tema 5

| Ftesa në dëshminë *La ilahe il'Allah.*

Kjo renditje temash nga autori është ndër më të mirat. Pasi shpjegon teuhidin në dobi të vetë individit, ai flet për ftesën e të tjerëve në të, sepse besimi i muslimanit nuk plotësohet pa ftuar të tjerët në teuhid. Allahu i Madhëruar thotë në suren Asr: “Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt, me përjashtim të atyre që besuan, bënë vepra të mira, porositën njëri-tjetrin t’i përmbahen së vërtetës dhe e këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.”

Është e domosdoshme të ftosh në teuhid, pasi, në të kundërt, ai është i mangët. Nuk ka dyshim se ai që merr rrugën e teuhidit, ka menduar se kjo është rruga më e mirë, por nëse është i sigurt në besimin e tij, patjetër duhet të ftojë në të. Ftesa për në dëshminë “Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut”, është pjesë e plotësimit të teuhidit.

| Allahu i Madhëruar thotë: “Thuaj: (o Muhamed) ‘Kjo është rruga ime: të ftoj drejt Allahut me dije të sigurt, unë dhe çdokush që më pason mua. I pastër nga të metat është Allahu; unë nuk jam prej idhujtarëve!’ (Jusuf, 108)

– “... Thuaj: ‘Kjo është rruga ime ...’ – Pra, thuaj që kjo është rruga ime, rruga me të cilën erdhi Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), rruga e Sheriatit, me adhurim dhe ftesë për tek Allahu.

– “... të ftoj drejt Allahut ...” – Ftuesit ndahen në dy lloje: 1. Ftues për në rrugën e Allahut. 2. Ftues për në rrugë të tjera.

Ftuesi për në rrugën e Zotit është i sigurtë dhe dëshiron që t'i shpjerë njerëzit drejt Allahut të Madhëruar.

Ftuesi për në rrugë të tjera, mund të jetë ftues drejt vetes së tij, për arsye që të madhërohet e të respektohet ndër njerëz. Ndaj e sheh atë të mërëzitur, kur njerëzit nuk veprojnë çka i urdhëron të veprojnë dhe nuk zemërohet kur ata kryejnë një haram të madh, pasi ai nuk urdhëron për lënien e haramit. Ka raste të tjera, kur dikush fton për në rrugën e prijësit të tij, siç kanë bërë shpesh këshilltarë të humbur shtetesh apo qeverish, të cilët nuk janë dijetarë të fesë. Shembull konkret për këtë është shfaqja e ideve komuniste në vendet arabe, ku disa “dijetarë” të humbur u ngritën për ta argumentuar me ajete e hadithe, që nuk kishin lidhje fare me të vërtetën. Këta pra, kanë ftuar në një rrugë tjetër nga ajo e Allahut.

Kush fton drejt Allahut, edhe nëse sheh se njerëzit largohen prej tij, nuk i humb shpresat dhe ta lërë thirrjen, sepse Profeti (sal-lallahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka thënë Aliut (r.a.): “Vazhdo me kujdes, se, për Zotin, nëse Allahu udhëzon nëpërmjet teje një person të vetëm, është më mirë për ty sesa devetë e kuqe.” Kjo do të thotë se udhëzimi i një çifuti apo një kafiri tjetër, është më mirë sesa devetë e kuqe”. Nëse fton tek Allahu dhe nuk të përgjigjen, zemërohu për shkak se nuk u pasua e vërteta, e jo për faktin se nuk po të përgjigjen ty. Kjo është shenjë se ftesa është e sigurtë për Allahun. Nëse i përgjigjet vetëm njëri, kjo i mjafton thirrësit, e nëse nuk përgjigjet asnjë, përgjegjësia është shkarkuar. Në një hadith thuhet: “... (pashë) një Profet, me të cilin nuk ishte askush. ...”

Thirrësit i mjafton të ftojë drejt së vërtetës e të tërheqë vërejtjen nga e kota, që njerëzve t’u sqarohet se cila është e vërteta dhe cila është e kota. Nëse do të heshtim të gjithë në sqarimin e së vërtetës dhe do të pohojmë me heshtje të kotën, me kalimin e kohës e vërteta do të shihet si e kotë dhe e kota si e vërtetë.

– “... me dije të sigurt ...” – Pra, kjo ftesë duhet të përmbajë sinqeritetin dhe dijen, sepse në shumicën e rasteve, ajo që e prish ftesën është mungesa e dijes ose mungesa e sinqeritetit. Qëllimi

përsa i përket thënies: “... me dije të sigurt ...” këtu, nuk nënkuptohet vetëm njohja e Sheriatit, por në të përfshihet: njohja e Sheriatit, njohja e gjendjes së personit i cili ftohet dhe njohja e rrugës që të çon drejt përmbushjes së qëllimit. Kjo është urtësia: të kesh dije të sigurt në gjykimin e Sheriatit, të njohësh gjendjen e të ftuarit dhe të njohësh rrugën që të shpie drejt realizimit të ftesës. Për këtë, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka thënë Muadhrit: “Ti po shkon te një popull që është ndjekës i Librit ...”.¹ Këto nuk ishin që të gjitha prej dijes që ka të bëjë me gjykimet e sheriatit, sepse dija që dikush pranon daven me butësi; tjetri pranon daven me ashpërsi; ndërsa dikush tjetër ka dituri e, mund të më paraqisë dyshime (atëherë duhet të jesh i përgatitur për të sqaruar dyshimet që mund të paraqesë ai). Kjo është diçka më tepër sesa njohja e gjykimit të Sheriatit. Po ashtu, duhet të njohësh mënyrat për të afruar të ftuarin, duke e nxitur me diçka dhe inkurajuar, siç thotë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Atij që vret një person (armik), i takon plaçka e personit të vvarë.” Ose për afrimin e zemrave, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në luftën e Hunejnit. Atyre që donte t’u afronte zemrat, ai u dha nga njëqind deve. E gjithë kjo ishte pjesë e urtësisë.

I padituri nuk vlen për të ftuar në fenë e Allahut, sepse rruga e tij nuk është ajo e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), dhe ai më shumë prish sesa ndreq.

– “... unë dhe çdokush që më pason mua ...” – Për interpretimin e kësaj shprehjeje ka dy variante: 1. Unë dhe kushdo që më pason mua me dije të sigurt, në adhurimin tim dhe ftesës time. 2. Kjo është rruga ime, unë ftoj drejt Allahut; kushdo që më pason mua, fton drejt Allahut dhe të gjithë ne ftojmë me dije të sigurt.

– “... I pastër nga të metat është Allahu ...” – Ky madhërim i Allahut tregon se ishte e pamundur që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të ftonte pa dije të sigurt.

– “... unë nuk jam prej idhujtarëve!” – Roli i kësaj shprehjeje në lidhje me atë të mësipërmen është përforcues, sepse kuptimi i

¹ Buhariu dhe Muslimi.

teuhidit është mohimi i shirkut.

Ibn Abasi (r.a.) rrëfen se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), kur e dërgoi Muadhin (r.a.) në Jemen, i tha: “Ti po shkon te një popull, që është ndjekës i Librit. Gjëja e parë në të cilën do të ftosh, do të jetë dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut (**kurse në një përcjellje tjetër: “... që ta njësojnë Allahun”**). Nëse të binden në këtë, mësoju atyre se Allahu u ka bërë detyrë të kryejnë pesë namaze në çdo ditënatë. Nëse do të binden për këtë, mësoju atyre se Allahu u ka bërë detyrë të japin zekatin, që merret nga të pasurit e tyre dhe u jepet të varfërve nga mesi i tyre. Nëse ata të binden për këtë, tregohu i kujdesshëm dhe mos merr pjesën më të mirë të pasurisë së tyre. Frikësoju lutjes së të dëmtuarit, sepse ndërmjet saj dhe Allahut nuk ka pengesë.”¹

– “Ibn Abasi (r.a.) rrëfen se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), kur e dërgoi Muadhin (r.a.) në Jemen ...”. I Dërguari i Allahut e ngarkoi atë me cilësinë e mësuesit, gjykatësit dhe ftuesit. E dërgoi në muajin *rebiul euvel* të vitit të dhjetë hixhri, sipas mendimit më të njohur, bashkë me Ebu Musa el Eshariun. Muadhin e dërgoi në San'a dhe zonat rreth saj, kurse Ebu Musën në Aden dhe zonat përreth. I urdhëroi që të unifikohen, të bashkëpunonin dhe të mos përçaheshin, të lehtësonin dhe të mos vështirësonin, të afronin njerëzit e të mos largonin.

– “... Ti po shkon te një popull, që është prej ndjekësve të Librit ...”
– Këtë ia tha për ta orientuar. Kjo tregon se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e njihte gjendjen e njerëzve, dhe këtë nëpërmjet dy mënyrave: së pari, nëpërmjet Shpalljes dhe, së dyti, nëpërmjet dijes dhe përvojës.

Me shprehjen “ndjekës të Librit” nënkuptojmë çifutët dhe të krishterët, që përbënin shumicën e banorëve të Jemenit në atë

¹ Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

kohë, edhe pse ndër ta kishte edhe idhujtarë. Për këtë arsye, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) mori në konsideratë shumicën dhe e njoftoi Muadhin për dy gjëra: 1. të njihite mirë gjendjen e atyre që do të ftonte; 2. të ishte i përgatitur, sepse ata ishin ndjekës të Librit dhe, si të tillë, ata kishin dituri.

– “... Gjëja e parë në të cilën do të ftosh, do të jetë dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut ...” – Gjëja e parë në të cilën do të ftosh do të jetë dëshmia *La ilahe il’All-llah*.

– “... dëshmia ...” – Dëshmia këtu është pjesë e dijes. Allahu ka thënë: “... përveç atyre që dëshmojnë për të vërtetën duke e ditur ...” (Zuhruf, 86). Pra, dëshmia këtu është njohja e saj dhe shqiptimi me gjuhë, sepse ai që dëshmon lajmëron për atë që di. Megjithatë, nuk mjafton vetëm lajmërimi, duhet patjetër dija, lajmërimi, pranimi, pohimi dhe nënshtrimi.

Nëse personi e beson me zemër, por nuk e thotë me gjuhën e tij, shejhu Islam Ibn Tejmije thotë se ai nuk është musliman, sipas mendimit të të gjithë dijetarëve (*ixhma*), derisa ta shprehë, sepse fjala ‘*dëshmoj*’ tregon kumtim, ndërsa kumtimi përfshin edhe shqiptimin. Pra patjetër duhet të shqiptohet. Vetëm qëllimi nuk mjafton dhe as nuk bën dobi tek Allahu, derisa personi ta shqiptojë dëshminë. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i tha xhaxhait të tij Ebu Talibit: “Thuaje!”, por ai nuk e tha që besonte se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut.

– “... nuk ka të adhuruar (ilah) ...” – Kuptimi i fjalës “*ilah*” është “*i adhuruar*”, pra, Allahu është ai të cilit i kushtohen adhurimet, ndërsa për *mutekelimin-ët ilah* është *vepruesi*, dhe shprehja në fjalë, sipas tyre, do të thotë “nuk ka të Pushtetshëm për të shpikur e krijuar”. Sikur të ishte i pranueshëm ky koment atëherë idhujtarët, të cilët i luftoi i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), do të ishin monoteistë, sepse ata e pohonin këtë. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Dhe nëse i pyet ata se kush i ka krijuar, patjetër që do të thonë: ‘Allahu.’” (Zuhruf, 86). “Dhe nëse i pyet ata se kush i krijoi qiejt dhe tokën, sigurisht që do të thonë: ‘Allahu.’” (Zumer, 38).

Po si thuhet se nuk ka të adhuruar veç Allahut, kur dihet se

idhujtarët adhurojnë idhujt e tyre? Përgjigjja është se ata i adhurojnë idhujt padrejtësisht. Edhe pse i kanë quajtur *të adhuruar* ky vlerësim është i pavërtetë, sepse ata nuk janë të adhuruar me të drejtë. Për këtë arsye, kur idhujtarëve u vinte ndonjë e keqe ata i drejtoheshin vetëm Allahut me sinqeritet. Rrjedhimisht, ata idhujt nuk e meritojnë të quheshin *të adhuruar*. Politeistët i adhuronin idhujt, dhe pohonin të kundërtën, vetëm për shkak që t'i afronin tek Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). Pra i bënë ata ndërmjetës. Kësisoj, nuk duhet të kemi ndonjë paqartësi në lidhje me fjalën e Profetëve drejtuar popujve të tyre: “Nuk keni *të adhuruar* tjetër veç Tij ...” (Araf, 59), sepse këta “të adhuruarit” e tjerë nuk e meritojnë të adhurohen. Zoti që meriton të adhurohet është vetëm Allahu (Subhanehu ue Te'Ala).

– “... se nuk ka *të adhuruar tjetër me të drejtë, përveç Allahut ...*” – Në këtë shprehje ka mohim të adhurimit për dikë tjetër veç Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) dhe pohim të adhurimit vetëm për Allahun. Për këtë arsye, shprehja ka ardhur në mënyrë kufizuese, pra, e kufizon adhurimin vetëm për Allahun (Subhanehu ue Te'Ala).

Sehl Ibn Sadi tregon se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), ditën e Betejës së Hajberit, ka thënë: “Nesër do t'ia jap flamurin një burri që e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij, dhe që Allahu dhe i Dërguari i tij e duan atë. Allahu do ta japë fitoren në duart e tij.” Njerëzit e kaluan natën duke diskutuar se cilit prej tyre do t'i jepej flamuri, dhe kur zbardhi dita, erdhën tek i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), duke shpresuar secili që t'i jepej flamuri. Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) tha: “Ku është Ali Ibn Ebu Talibi?” I thanë se po ankohej nga dhimbja e syve. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) urdhëroi që të dërgonin dikë tek ai e ta sillnin, pasi e sollën pështyu në sytë e tij, bëri duá dhe ai u shërua, sikur të mos kishte pasur kurrë dhimbje. Më pas, ia dha flamurin dhe i tha: “Vazhdo me kujdes, derisa të mbërrish në oborret e tyre. Pastaj ftoji ata në Islam dhe lajmëroji

për detyrimet që kanë ndaj Allahut. Për Allah, nëse Allahu udhëzon nëpërmjet teje qoftë edhe një person të vetëm, kjo është më e mirë për ty sesa devetë e kuqe¹.

– “... Nesër do t’ia jap flamurin një burri që e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij, dhe që Allahu dhe i Dërguari i tij e duan atë ...” – Këtu është pohuar se, në lidhje me Allahun, dashuria është e dykahshme: Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) do dhe duhet. Këtë e kanë mohuar keqinterpretuesit të teksteve të Kuranit dhe Sunetit, duke thënë se me dashurinë e Allahut ndaj robit nënkuptohet shpërblimi ose dëshira e Tij për ta shpërblyer atë; ndërsa dashuria e robit ndaj Zotit të tij është dëshira për shpërblimin e Tij. Ky është keqinterpretim gjuhësor i fjalës dhe bie ndesh me atë që janë pajtuar të parët tanë, që nga sahabët, tabiinët e deri tek imamët e udhëzuar pas tyre. Dashuria e Allahut është reale dhe përbën një nga cilësitë vepruese.² Çdo cilësi e Allahut që është lidhur me një shkak quhet cilësi vepruese. Vetë dashuria ka shkak; ndoshta Allahu e urren një person për njëfarë kohe dhe e do në një moment tjetër, për shkaqe të caktuara.

– “... do ta japë fitoren në duart e tij. ...” – Allahu do ta çlirojë Hajberin në duart e tij. Ky ishte përgëzim për fitoren e pritur.

– “... duke shpresuar secili që t’i jepej flamuri ...” – Qëllimi ishte që të arrinin gradën e dashurisë së Allahut dhe të Dërguarit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

– “... Ku është Ali Ibn Ebu Talibi? ...” – Pyeti i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

– “... I thanë se po ankohej nga dhimbja e syve ...” - Ndjente dhimbje në sy, mirëpo ankohej vetëm tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) për sëmundjen.

¹ Buhariu dhe Muslimi.

² Quhen kështu sepse varen nga dëshira e Allahut, nëse Ai dëshiron i vepron, e nëse dëshiron, nuk i vepron. Po kështu, janë quajtur të tilla sepse janë vepra të Allahut.

– “... u dërguan tek ai ...” – Me urdhër të të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

– “... dhe e sollën ...” – Duket se Aliu ka qenë i verbuar nga sytë, aq sa e kanë marrë duke e mbajtur për krahu.

– “... u shërua ...” – Kjo ishte një nga provat e Allahut, që argumentojnë forcën e Tij dhe vërtetësinë e Profetit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Përzgjedhja që iu bë Ali Ibn Ebu Talibit (r.a.) ishte rrjedhojë e viryeteve të prijësit të besimtarëve, sepse ai e donte Allahun dhe Profetin e tij, por edhe Allahu dhe Profeti i Tij e donin atë. Për këtë shkak, i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e dalloi atë nga sahabët e tjerë.

– “... sikur të mos kishte pasur kurrë dhimbje ...” – Në sytë e tij nuk kishte më as gjurmë skuqjeje e as ndonjë shenjë tjetër, si më parë.

– “... Vazhdo me kujdes ...” – Sepse pozicioni ishte i vështirë dhe ekzistonte frika e ndonjë pusie, se çifutët janë të poshtër dhe të pabesë.

– “... derisa të mbërrish në oborret e tyre ...” – Pra, afër ose rreth tyre. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Nëse ne zbresim në oborret e një populli, zullumqarëve u vjen fundi.” Kjo arrihet nëse ecim në shembullin e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe shokëve të tij. Por, nëse udhëhiqemi nga nacionalizmi, edhe pse mund të hyjmë në prehrin e tyre, ata mund të fitojnë e ne të humbim.

– “... ftoji ata ...” – Ftoji banorët e Hajberit.

– “... në Islam ...” – Që t’i dorëzohen (binden) Allahut.

– “... dhe lajmëroji ata për detyrimet që kanë ndaj Allahut. ...” – Pra, mos u mjafto vetëm duke i ftuar në Islam, por lajmëroji për detyrimet, derisa të binden dhe t’i respektojnë ato, sipas renditjes që

vjen në hadithin e dërgimit të Muadhrit (r.a.).

Në këtë çështje njeriu mëdyshet: a t'u tregojë njerëzve për detyrimet që kanë ndaj Allahut para se të bëhen muslimanë, apo pasi ta kenë pranuar Islamin?

Nëse do të shohim hadithin e Muadhrit dhe hadithin e Sehlit, mund të themi se fillimisht duhet t'i ftosh në Islam, e nëse e pranojnë, u tregon për detyrimet që ka në të.

Nga ana tjetër, po të shohim gjendjen aktuale të njerëzve, se disa prej tyre nuk e pranojnë me bindje Islamin, por ndoshta bëhen muslimanë dhe më pas kur i lajmëron për detyrat fetare karshi Allahut, ata mund të zmbarsen, atëherë themi se, së pari, lajmërohen për detyrimet që kanë ndaj Allahut në Islam, me qëllim që, pas kësaj, të mos dalin nga Islami, sepse atëherë bëhet detyrë ekzekutimi i tyre për shkak të daljes nga feja.¹

Po kështu, mund të thuhet se kjo çështje i lihet aktualitetit dhe dobisë së njërës mënyrë apo tjetrës.

– “... Nëse Allahu udhëzon nëpërmjet teje qoftë edhe një person të vetëm ...” – Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk thotë “nëse ti i udhëzon”, sepse ai që udhëzon është Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) dhe me udhëzimin këtu, nënkuptohet udhëzimi i suksesit dhe orientimit. Po a nënkuptohet këtu udhëzimi nga kufri në Islam, apo çdo lloj udhëzimi? Them i se Aliu (r.a.) ishte drejtuar te një popull i caktuar për ta ftuar atë në Islam. Argumenti aktual vlen vetëm për rastin në fjalë, ndërsa ai që bëhet shkak që dikush të udhëzohet në një nga çështjet e fesë, nuk e arrin këtë shpërblim, siç del nga konteksti, sepse Aliu ishte dërguar tek një popull qafir për ta ftuar në Islam. Allahu e di më mirë.

– “... kjo është më e mirë për ty se devetë e kuqe.” – Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka përmendur devenë e kuqe për shkak se ajo ka qenë deveja më e preferuar dhe me më shumë vlerë ndër arabët.

¹ Vetëkuptohet që kjo masë penale mund të jepet veçse nga autoriteti i sheriatit në një shtet ku zbatohen ligjet Islame.

■ **Dobitë e temës**

- Ftesa për në fenë e Allahut është rruga e atyre të cilët e pasojnë të Dërguarin e Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem).

Argument për këtë është ajeti: “Thuaj: (o Muhamed) ‘Kjo është rruga ime: të ftoj drejt Allahut me dije të sigurt, unë dhe çdokush që më pason mua. I pastër nga të metat është Allahu; unë nuk jam prej idhujtarëve!’ Më e përgjithshme dhe më në përputhje me ajetin është të thuhet se ftesa për në fenë e Allahut është rruga e të Dërguarve të Tij dhe ndjekësve të tyre.

- T’i kushtohet vëmendje sinqeritetit, sepse shumë njerëz, edhe pse ftojnë drejt të vërtetës, në fakt ftojnë drejt vetvetes.

Kjo del nga fjala e Tij: “... të ftoj drejt Allahut ...”. Për këtë arsye autori ka thënë: “... sepse shumë nga njerëzit, edhe pse ftojnë drejt të vërtetës, në fakt ftojnë drejt vetvetes.” Ai i cili fton për te Allahu do vetëm që të ngrihet feja e Tij, ndërsa ai që fton drejt vetvetes do vetëm që të pranohet fjala e tij, qoftë ajo e vërtetë apo e kotë.

- Dija e sigurt është detyrë.

Kjo është nxjerrë nga fjala: “... unë ju thërras drejt Allahut me dije të sigurt.” Dija e sigurt është detyrë, për shkak se ftuesi duhet të ketë dije për atë në të cilën fton, e përderisa ftesa është detyrë, edhe dija rreth saj është detyrë.

- Ndër argumentet që tregojnë të mirat e teuhidit, është edhe dëlirja e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) nga cenimi.

Kjo është marrë nga ajeti: “... I pastër nga të metat është Allahu;

unë nuk jam prej idhujtarëve!” (Jusuf, 108). Shprehja “I pastër është Allahu nga të metat” e përdorur në ajet tregon se Ai është i Vetëm në përsosmërinë e Tij.

Kuptimi i fjalës “nga cenimi” do të thotë: nga përngjasimi i Krijuesit me krijesat, sepse përngjasimi i të përsosurit me të mangëtin e bën edhe të përsosurin të mangët, siç thotë poeti:

A nuk e sheh si shpatën përçmojnë,
kur me një shkop e krahasojnë?

- Ndër të këqijat e shëmtuara të shirkut, është se ai konsiderohet fyerje për Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala).

Kjo është nxjerrë nga: “... unë nuk jam prej idhujtarëve!”, që vjen pas shprehjes: “... I pastër nga të metat është Allahu ...”

- Nga pikat më të rëndësishme është largimi i muslimanit nga idhujtarët, që të mos bëhet si ata, edhe pse nuk bën shirk.

Argument është ajeti: “... unë nuk jam prej idhujtarëve!”. Nuk thuhet “unë nuk jam idhujtar”, sepse përderisa ndodhesh mes tyre, edhe pse nuk je idhujtar, në pamjen e jashtme dukesh si ata. Për këtë arsye, kur Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) u tha melekëve: “... Bini në sexhde para Ademit.” Dhe ata ranë në sexhde, përveç Shejtanit.” (Bekare, 34), fjala iu drejtua gjithashtu edhe Shejtanit.

- Teuhidi është detyra e parë.

Dëshmi është thënia e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): Gjëja e parë në të cilën do të ftosh, do të jetë dëshmia se nuk ka të adhurar tjetër me të drejtë përveç Allahut (kurse në një përcjellje tjetër: “... që ta njësojnë Allahun”). Disa nga dijetarët kanë thënë se detyra e parë është *shqyrtimi i të vërtetës*, por më e sakta është që detyra e parë të jetë teuhidi, sepse për njohjen e Krijuesit tregon vetë natyra e krijimit.

- Të fillohet me teuhidin para çdo gjëje, madje edhe para namazit.

Kjo është nxjerrë nga pjesa: “... Pastaj ftoji ata në Islam dhe lajmëroji për detyrimet që kanë ndaj Allahut.”

- Kuptimi i shprehjes “që ta njësojnë Allahun” është kuptimi i dëshmisë “Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut”.

Kjo është nxjerrë nga shprehja e sahabit, duke qenë se ai, në njërën nga përcjelljet është shprehur me fjalët: “të dëshmojnë se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut”, ndërsa në tjetrën është shprehur me fjalët: “që ta njësojnë Allahun”.

- Njeriu mund të jetë prej ndjekësve të Librit, por nuk e di këtë të vërtetë; ose e di, por nuk punon sipas kësaj.

Shprehja “nuk e di këtë të vërtetë” është për dëshminë ‘*La ilahe il’All-llah*’, që kuptohet nga thënia: “Gjëja e parë në të cilën do të ftosh, do të jetë dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut”. Po ta dinin ata se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe ta zbatonin atë, nuk do të kishin nevojë për t’u ftuar tek ajo.

- Paralajmërimi se mësimdhënia duhet të jetë graduale.

Provë është fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Gjëja e parë në të cilën do të ftosh, do të jetë dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut (kurse në një përcjellje tjetër: “... që ta njësojnë Allahun”). Nëse të binden në këtë, mësoju atyre se Allahu u ka bërë detyrë të falin pesë namaze në çdo ditënatë.

- Fillimi është nga më e rëndësishmja.

Kjo është nxjerrë nga fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kur ai e urdhëroi Muadhin që fillimisht t’i ftojë njerëzit në teuhid, pastaj në namaz, e pastaj në dhënien e zekatit.

➤ Sqarimi për faktin se kujt i jepet zekati.

Kjo është marrë nga pjesa: “... që merret nga të pasurit e tyre dhe u jepet të varfërve të tyre.”

➤ I dituri ia largon dyshimin nxënësitn.

Argument është fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... mësoju atyre se Allahu ka bërë detyrë të japin zekatin, që merret nga të pasurit e tyre dhe u jepet të varfërve të tyre.” Pra, i sqaroi atij se zekati merret nga të pasurit dhe u jepet të varfërve.

➤ Ndalimi i marrjes së pjesës më të mirë të pasurisë për zekat.

Dëshmi është fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... tregohu i kujdesshëm dhe mos merr pjesën më të mirë të pasurisë së tyre.”

➤ Frikësimi nga lutja e atij që i është bërë padrejtësi.

Argument është fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Ruaju lutjes së të dëmtuarit ...”

➤ Kumtimi se lutja e atij që i është bërë padrejtësi është pa pengesë.

Kjo është nxjerrë nga thënia: “... ndërmjet saj dhe Allahut nuk ka pengesë.” Pra, inkurajimit ose frikësimit i ka bashkangjitur dispozita çka e nxit njeriun nëse është inkurajim, dhe e largon atë nëse është frikësim, siç thuhet: “Ruaju lutjes së të dëmtuarit”. Njeriu mund të mos ruhet, por kur i thuhet se ndërmjet kësaj lutjeje dhe Allahut nuk ka pengesë, frikësohet dhe nuk e dëmton

tjetrin.

- Nga argumentet e teuhidit, janë edhe vështirësitë, uria dhe sëmundjet që provoi më i miri i Profetëve dhe më të mirët e evliave.

Me sa duket, autori (Allahu e mëshiroftë) ka për qëllim të përmendë ndodhinë e Hajberit, pasi atëherë ra një zi e madhe buke, saqë besimtarët arritën të hanin mish gomari e hudhra. Sëmundja ishte ajo që ra në kohën e Ali Ibn Ebu Talibit, kurse vështirësitë që përjetuan janë të qartë. Qenia e tyre prova të teuhidit është se durimi e qëndresa në gjëra të tilla, dëshmojnë për teuhidin e pastër të personit, dhe se qëllimi i tij është Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), e si rrjedhojë ai bën durim gjatë tyre.

- Thënia e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Do t’ia jap flamurin...”, qe një nga shenjat e profetësisë.

Kjo u bë realitet: Aliu e donte Allahun dhe Pejgamberin, ndaj Allahu dhe Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem e donin atë.

- Pështyma në syrin e Aliut qe një tjetër mrekulli e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Me këtë pështymë syri i tij u shërua sikur të mos kishte pasur asgjë.

- Vlera e Aliut (**r.a.**).

Kjo është e qartë, sepse ai e donte Allahun dhe të Dërguarin e tij, dhe Allahu dhe i Dërguari i Tij e donin atë.

- Vlera e sahabëve në diskutimin e tyre gjatë gjithë natës dhe angazhimi i tyre ndaj sihariqit të fitores. me sihariqin e fitores.

Ata u angazhuan ndaj sihariqit të fitores, duke dashur të dinë se kush ishte ai që e donte Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe që Allahu dhe i Dërguari i Tij e donin atë.

- Besimi në caktimin e Allahut, pasi flamurin e mori ai që nuk qe angazhuar për të dhe jo ata që ishin angazhuar për të.

Sahabët shkuan herët tek Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe çdonjëri shpresonte t’i jepej flamuri, por asnjërit nuk iu dha. Ndërkohë, Aliu ishte i sëmurë dhe nuk u mundua për këtë, megjithatë, sipas kaderit, flamuri iu dha atij.

- Edukata që përfitohet nga fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... vazhdo me kujdes ...”.

Ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e urdhëroi Aliun (r.a.) për maturi e mosnxitim.

- Ftesa për në Islam bëhet përpara luftës.

Argument është fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... derisa të mbërrish në oborret e tyre. Pastaj ftoji ata në Islam ...”

- Është e ligjshme të luftohen befasisht ata që janë ftuar më parë në Islam, por nuk e kanë pranuar atë.
- Ftesa duhet të bëhet me urtësi. Argument është fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... lajmëroji ata për detyrimet që kanë ndaj Allahut ...”.

Pjesë e urtësisë është përmbushja e ftesës. Kjo arrihet duke i urdhëruar fillimisht njerëzit për Islamin, e pastaj duke i lajmëruar për detyrat e tyre, si të drejtat e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Por nuk mjafton vetëm t’u tregosh atyre Islamin me të cilin i ke urdhëruar, sepse mund ta praktikojnë ose jo. Përkundrazi, duhet

patjetër të kujdesesh për ta, që të mos kthehen më në kufër.

- Njohja e së drejtës së Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) në Islam.

Argument është fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... lajmëroji ata për detyrimet që kanë ndaj Allahut.”

- Shpërblimi për atë, nëpërmjet të cilit udhëzohet qoftë edhe një person i vetëm.

Kjo shihet në fjalën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... nëse Allahu udhëzon nëpërmjet teje qoftë edhe një person të vetëm, është më e mirë për ty se devetë e kuqe.” Kjo do të thotë se është më e mirë se çdo gjë që pëlqehet në dynja, dhe jo siç kanë thënë disa: është më mirë sesa të japësh sadaka devetë e kuqe.

- Betimi gjatë dhënies së fetvasë.

Argument është fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Për Allah, nëse Allahu udhëzon përmes teje qoftë edhe një person të vetëm ...” Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u betua, ndonëse nuk iu kërkua ta bënte një gjë të tillë. Dobia ishte nxitja e personit që të bëhej shkak udhëzimi dhe përforcimi i kësaj. Megjithatë, betimi për fetvatë duhet të bëhet vetëm kur ka dobi, sepse ndoshta dëgjuesi mund të mendojë se kjo bëhet për shkak të dyshimeve që ka ai i cili jep fetvanë. Imam Ahmedi në përgjigjet e tij, ndonjëherë thoshte: “Po, për Allah.”

Allahu e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për betim në tri vende në Kuran:

“Ata kërkojnë shpjegim prej teje: ‘A është e vërtetë (çfarë na ke premtuar)?’ Thuaju: ‘Po, për Zotin tim!’ (Junus, 53).

“Ata që nuk besuan, mendojnë se nuk do të ringjallen kurrë më. Thuaju: ‘Po, për Zotin tim! Ju padyshim që do të ringjallen ...’ (Tegabun, 7).

“Dhe ata që nuk besojnë, thonë: ‘Ora nuk do të vijë tek ne.’ Thuaju (O Muhamed): ‘Po, për Zotin tim! Ajo do të vijë ...’” (Sebe, 3).

Nëse betimi ka dobi, – kur betohesh që në fillim ose për përgjigjen e ndonjë pyetjeje – ai lejohet, madje mund të jetë edhe i kërkuar.

Tema 6

Komenti i teuhidit dhe i dëshmisë: “La ilahe il-lallah - Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut”

Tefsir do të thotë: zbulim dhe qartësim. Më përpara kemi shpjeguar përkufizimin e teuhidit, ndërsa tani do të shpjegojmë besimin se Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) është i vetëm në meritën e adhurimit. Nga ana tjetër, fjala “dëshmi” në këtë temë vjen si sinonim i fjalës “teuhid”, sepse realizimi i teuhidit është realizmi i dëshmisë se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut.

Kjo çështje është e rëndësishme, se pasi folëm për teuhidin, vlerën e tij dhe ftesën në të, njeriu dëshiron të qartësohet se çfarë është ky teuhid, për të cilin janë shkruar këto kapituj. Përgjigjja është në temën në fjalë.

Autori (Allahu e mëshiroftë!) ka përmendur në të pesë ajete:

Ajeti 1. “Vetë ata që idhujtarët iu luten, kërkojnë t’i afrohen Zotit të tyre, shpresojnë në mëshirën e Tij dhe i frikësohen ndëshkimit të Tij.” **(Isra, 57)**

– “Vetë ata që idhujtarët iu luten, kërkojnë t’i afrohen Zotit të tyre ...” – Pra, si i lutni, kur vetë ata kanë nevojë për afrimin tek Allahu?! Kjo, në të vërtetë, është mendjelehtësi. Ajeti bën fjalë për të gjithë ata të cilët njerëzit u luten si Isain – birin e Merjemes, engjëjt, eulijatë (miq, mbrojtës) dhe njerëzit e mirë, ndërsa pemët e gurët nuk futen në këtë ajet. Këta – nënthurhet në ajet – të cilët ju pretendoni se janë mbrojtës të tjerë përveç Allahut, nuk kanë mundësi për largimin e së keqes e as ndryshimin e saj, sepse vetë ata kërkojnë afrimin te Zoti i tyre. Secili prej tyre do të donte të

ishte më i afërti tek Allahu. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) e sqaron gjendjen e këtyre të luturve, në fjalën e Tij: “Kurse ata që ju i lutni krahas Tij, nuk zotërojnë as sa cipa e bërthamës së hurmës. Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur ta dëgjonin, nuk mund t’ju përgjigjen. Në Ditën e Kijametit ata do ta mohojnë adhurimin që u bënit atyre. Askush nuk mund të të njoftojë ty (O Muhamed) ashtu si Ai që është i Gjithëdijshëm” (Fatir, 13-14).

– “... u luten ...” – I lusin me duanë e kërkit, si t’i lutesh kur bie në vështirësi për shembull Aliut (r.a.), ose t’i lutesh Pejgamberit (sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem) siç thotë poeti:

O krijesa më e nderuar,
Kur të zezat t’më kenë pushtuar,
Ndihmë veç ty kam për t’kërkuar!

Shprehja në fjalë, mund të ketë edhe kuptimin e lutjes së adhurimit, si rasti i atij që u nënshtrohet atyre duke i adhuruar, me zotim, *ruku* dhe *sexhde*.

– “... t’i afrohen ...” – Ata kërkojnë çka i afron me Zotin e tyre, se cili do të jetë më afër tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), shpresojnë mëshirën e Tij dhe i frikësohen ndëshkimit të Tij.

Përshtatja e ajetit me temën në fjalë, qëndron në faktin se teuhidi përmban largimin nga shirku, duke mos lutur bashkë me Allahun askënd, as melekë të afërt e as Pejgamberë. Ndërkohë, këta që lusin Pejgamberët dhe melekët, nuk janë larguar nga shirku, madje kanë rënë në të. Është e çuditshme sepse lutja u drejtohet atyre të cilët vetë kanë nevojë për Allahun dhe për çka i afron tek Ai (Subhanehu ue Te‘Ala). Ata nuk janë të panevojshëm për Allahun, atyre nuk u mjafton vetja, atëherë si mund të jenë të mjaftueshëm për të tjerët?!

Ajeti 2. “**(Kujto)** kur Ibrahim i tha të atit dhe popullit të tij: ‘Në të vërtetë unë jam i distancuar nga ajo që ju adhuron. **(Unë adhuroj)** Vetëm Atë që më ka krijuar dhe i Cili do të më udhëzojë në rrugë të drejtë.” **(Zuhruf, 26-27)**

– “... unë jam i distancuar ...” – Unë jam në kulmin e largësisë nga

ajo që ju adhuroni, me përjashtim të Atij që më krijoi mua.

Ibrahimi ka qenë i fortë në besimin ndaj Allahut. Këto fjalë ai ia drejtoi babait të vet, Azerit, dhe popullit të tij.

– “... *ju adhuroni* ...” – Me adhurimin këtu nënkuptohet nënshtrimi dhe përrulja, sepse në popullin e tij kishte njerëz që adhuronin idhujt, apo që adhuronin diellin, hënën e yjet.

– “... (*Unë adhuroj*) *Vetëm Atë që më ka krijuar* ...” – Këtu kemi pranëvënien e mohimit me pohimin: mohimin e asaj që ata adhuronin duke thënë “në të vërtetë unë jam i distancuar nga ajo që ju adhuroni”, dhe pohimin për atë që duhet adhuruar duke thënë “unë adhuroj vetëm Atë që më ka krijuar”. Kjo argumenton se teuhidi plotësohet vetëm me mohimin e adhurimit të gjithçkaje veç Allahut dhe me besimin në Allahun e vetëm: “Kushdo që mohon *tagut*-in dhe beson Allahun, është kapur për lidhjen më të fortë ...” (Bekare, 256).

Ata adhuronin Allahun dhe të tjerë, sepse Ibrahimi (alejhi selam) tha: “...vetëm Atë që më ka krijuar” e kjo do të thotë se ka pasur edhe të adhuruar të tjerë. Megjithatë, ai u distancau prej tyre.

Në disa vende islame ka nga ata që falen, agjërojnë dhe japin zekatin, por shkojnë edhe në varreza e u bëjnë varreve *ruku* dhe *sexhde*. Ata janë kafirë, nuk janë monoteistë dhe Zoti atyre nuk u pranon asnjë vepër. Kjo është gjëja më e rrezikshme për popujt muslimanë, sepse për ata mohimi i të tjerëve veç Allahut është krejt i parëndësishëm. Kjo është injorancë nga individët dhe neglizhencë nga ana e dijetarëve të tyre. Njeriu i thjeshtë e merr dijen vetëm nga dijetari i tij, por disa njerëz – Allahu na ruajtë – janë “dijetarë” të qeverive e jo të fesë.

– “... *vetëm Atë që më ka krijuar* ...” – Nuk tha: “vetëm Allahun”, dhe kjo për dy arsye: së pari, t’u tregonte arsyen e njësisimit të Allahut në adhurim. Sikurse është i Vetëm në krijim, duhet të njësohet si i tillë edhe në adhurim. Së dyti, t’u tregonte pavlefshmërinë e adhurimit të idhujve, sepse ata nuk ishin krijuesit e tyre. Kjo shprehje zbërthen edhe teuhidin, tek i cili gërshetohen mohimi dhe pohimi. Gjithashtu, kjo tregonte edhe elokuencën e

plotë të Ibrahimit në të shprehur.

Nga ajeti konkludohet se teuhidi nuk arrihet me adhurimin e dikujt tjetër bashkë me Allahun. Duhet patjetër që adhurimi të jetë vetëm për Allahun. Njerëzit, në këtë pozicion, janë të ndarë në tre grupe: 1. ata që e adhurojnë Allahun të Vetëm; 2. ata që dhurojnë vetëm dikë tjetër, veç Allahut; 3. ata që adhurojnë Allahun dhe dikë tjetër bashkë me Të. Nga këta, vetëm grupi i parë është njësuës i vërtetë i Allahut.

Ajeti 3. “Ata i konsideruan rabinët dhe murgjit e tyre si zota **(të adhuruar)** në vend të Allahut, si dhe Mesinë, të birin e Merjemes, ndërkohë që janë urdhëruar të adhurojnë vetëm një Zot, përveç të Cilit nuk ka tjetër që meriton të adhurohet. I Lartësuar qoftë Ai mbi gjithçka që ia shoqërojnë.” **(Teube, 31)**

Çifutët dhe të krishterët i bënë priftërinjtë si zota përveç Allahut, sepse ata zbatonin urdhrat e tyre në kundërshtim me urdhrin e Tij, pra u bindeshin atyre në kundërshtim me Allahun. Ata i kthyen murgjërit në zota, duke i bërë ata eulija (mbrojtës, miq) dhe duke i adhuruar, përveç Allahut.

– “... edhe Mesihun, të birin e Merjemes ...” – Po kështu bënë edhe me Mesihun, të birin e Merjemes. Ata e bënë zot, kur thanë se Zoti është tre dhe Isai është pjesë e Trinisë.

– “... të adhurojnë ...” - T'i nënshtrohen me bindje vetëm Allahut, të Vetëm, i Cili ka krijuar Mesihun, rabinët, murgjit, qiejt dhe tokën.

Ky ajet është koment për teuhidin dhe dëshminë se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, për faktin se Allahu ua kundërshtoi çifutëve dhe të krishterëve marrjen e rabinëve dhe murgjve të tyre si zota në vend të Allahut.¹ Pra, ata i konsideruan rabinët e tyre si ortakë me Allahun, në bindje ndaj tyre. Sa herë që ata i urdhëronin për diçka, u bindeshin, qoftë ose jo në pajtim me

¹ Më pas, autori do të sjellë një temë të plotë për këtë ajet.

urdhrin e Allahut. Komenti i teuhidit me *La ilahe il'All-llah* do të thotë që bindja duhet të jetë vetëm për Allahun. Edhe pse i ka mëshuar bindjes ndaj udhëheqësve, Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Vërtet, bindja është në të mirën.”

Ajeti 4. “Dhe ka njerëz, të cilët zgjedhin **(për adhurim)** të tjerë përveç Allahut si shokë **(ortakë)** të barabartë me Të. Ata i duan këta të adhuruar të tjerë si Allahun, por ata që besuan, e duan Allahun më shumë **(se gjithëka tjetër)** ...” **(Bekare, 165)**

– “... të barabartë ...” – Do të thotë: të ngjashëm, ndaj i Dërguari (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), kur dikush tha: “Çfarë të dojë Allahu dhe ti, (bëhet)”, ia ktheu: “E si më bëre të barabartë me Allahun?” Thuaj: “Çfarë të dojë Allahu i Vetëm (bëhet)”.¹

– “... Ata i duan këta të adhuruar të tjerë si Allahun ...” – Ky është aspekti i ngjashmërisë, që do të thotë: barazi në dashuri, pra i duan ata siç duan Allahun. Komentatorët e Kuranit kanë dhënë interpretime të ndryshme në lidhje me fjalën e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) “*si Allahun*”. Kështu, është thënë se ata e bëjnë dashurinë e idhujve të barabartë me dashurinë e Allahut. Në zemrat e tyre gjendet dashuria për Allahun dhe dashuria për idhujt, dhe këto ndjenja ata i kanë të barabarta, pra i duan ata siç duan Allahun. Është thënë gjithashtu se ata i duan idhujt me një dashuri të madhe, siç është dashuria e besimtarëve për Allahun. Sipas kontekstit të ajetit, mendimi i parë është më i qëndrueshëm.

– “... ata që besuan, e duan Allahun më shumë ...” – Sipas mendimit të parë, besimtarët e duan Allahun më shumë sesa njerëzit për të cilët flitet në ajet. Kjo, sepse dashuria e besimtarit është e sinqertë për Allahun, kurse dashuria e tyre është e përpjesëtuar ndërmjet Allahut dhe idhujve.

Sipas mendimit të dytë, besimtarët e duan Allahun më shumë sesa këta njerëz duan idhujt e tyre, sepse dashuria e besimtarit

¹ Ahmedi, Ibn Maxhja. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

është e qëndrueshme, si në mirësi, ashtu edhe në vështirësi, dhe kjo është e faktuar. Nga ana tjetër, dashuria e idhujtarëve për idhujt, dobësohet kur atyre u bie ndonjë e keqe.

E si mund të jetë çështja e atij që do dikë tjetër përveç Allahut, më shumë se Allahun, ose do dikë tjetër dhe nuk e do Allahun?! Kjo është akoma më e poshtër dhe një e keqe edhe më e madhe. Për të ardhur keq është fakti se kjo ndodh me disa që e quajnë veten muslimanë, të cilët i duan eulijat (miqt) e tyre më shumë sesa Allahun. Nëse u thuhet të betohen për Allahun, ata e bëjnë këtë, qofshin të singertë apo jo, e nëse u thuhet të betohen për evlijanë e tyre, betohen vetëm kur janë të singertë. Shumë prej tyre vijnë në Mekë e Medinë dhe besojnë se vizita te varri i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është më e rëndësishme se vizita e Kabes. Kjo ndodh sepse ata e duan Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) siç duan Allahun, apo edhe më tepër, e kjo vepër është shirk. Allahu e di se ne e duam Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) vetëm për hir të dashurisë së Allahut të Madhëruar, dhe nuk e duam sepse ai është Muhamedi, djali i Allahit, por sepse është i Dërguari i Allahut. Kështu që ne e duam atë nga dashuria që kemi për Allahun, kurse ata, dashurinë për Allahun – nëse vërtet e duan Atë – e bëjnë ndjekëse të dashurisë për Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Në këtë ajet ka një provë të madhe për shumë nga zemrat e muslimanëve sot, të cilët dikë apo diçka tjetër, veç Allahut, e barazojnë me Të në dashuri. Po kështu, ka njerëz që shoqërojnë me Allahun dikë apo diçka tjetër, edhe pse jo në formën e adhurimit të Sheriatit, por në formën e adhurimit të përmendur në hadithin “*Dështoi robi i dinarit ...*”, e cila është dashuri e valutës, thesarit dhe e veshjeve. Ka njerëz që po t’u shohësh zemrat, do t’i gësh të mbushura me dashurinë për kënaqësitë e kësaj bote, e nëse ata vijnë në xhami, zemrat e tyre vazhdojnë të angazhohen me dynjanë. Ky, në të vërtetë, është një lloj adhurimi. Njeriu, nëse do ta pyesë veten përse është krijuar, do ta kuptojë se është krijuar për të adhuruar Allahun. Kjo botë është kalimtare dhe është rruga përmes së cilës do të kalojë njeriu për në botën tjetër, botës së cilës duhet t’i jepet rëndësi, Ahiretit.

Sa mirë do të ishte sikur njeriu, një ditë të mendonte: “Çfarë kam

punuar, sa më ka mbetur në këtë botë për të jetuar dhe çfarë kam fituar. Ditët kalojnë e unë nuk e di a e kam shtuar afrimin tek Allahu apo jam larguar më tepër prej Tij.” A i pyesim vetet për këto çështje? Çdo njeri i mençur, patjetër duhet të ketë një qëllim. Po cili është qëllimi i tij? Ne tani po kërkojmë dije që, me këtë vepër, të afrohem tek Allahu, të mësojmë vetveten dhe të tjerët. Gjithsesi, ne shohim në vetvete një mangësi të madhe. A jemi nga ata që sa herë mësojmë diçka, e zbatojmë atë? Nëse mësojmë një gjë të re, a i ftojme robërit e Allahut në të? Kjo është një çështje që ka nevojë për llogari. Prandaj, mbi nxënësin e dijes bie një përgjegjësi aspak e lehtë, sepse ai duhet të japë një zekat më të rëndësishëm se zekati i pasurisë. Ai duhet të punojë, të lëvizë dhe të përhapë dijen në umetin islam, e në të kundërt, ai është shmangur nga Sheriati i Allahut. Ibn Kajimi thotë: “Gjithçka lëviz në sajë të dashurisë. Ti nuk lëviz për diçka, pa e dashur atë, aq sa edhe kafshatën nuk e ha, nëse nuk e do.” Për këtë arsye thuhet se çdo gjë lëviz duke pasur në themel dashurinë. Dashuria është themeli i çdo gjëje.

Llojet e dashurisë:

1- Dashuria për Allah. Kjo nuk është në kundërshtim me teuhidin, përkundrazi është plotësim i tij. Dashuria për hir të Allahut dhe urrejtja për hir të Tij është lidhja më e fortë e besimit. Dashuria për hir të Allahut është të duash diçka, sepse atë e do Allahu, qoftë kjo vepër apo qenie njerëzore, dhe kjo është pjesë e plotësimit të teuhidit. Siç ka thënë i *marrosuri pas Lejlës*:

Kur kaloj në vendbanimin e Lejlës
puth muret e atjeshëm.

Nuk jam i dashuruar me atë vend
por me atë që banonte atje.

2- Dashuria e natyrshme, së cilës njeriu nuk i jep përparësi në raport me dashurinë e Allahut, dhe kjo nuk e kundërshton dashurinë e Tij, siç është p.sh. dashuria për bashkëshorten, për fëmijët, për pasurinë etj. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), kur është pyetur se cili ishte njeriu më i dashur për të, tha: “Aishja.” – “Po nga burrat?” – e pyetën. – “Babai i saj (Ebu Bekër es Sidiku).” E njëjtë me këtë lloj dashurie është edhe ajo për ushqimin dhe veshjen.

3- Dashuria për diçka tjetër bashkë me Allahun, e cila e kundërshton dashurinë për Allahun, sepse njeriu do diçka tjetër,

siç do Allahun, ose edhe më shumë. Nëse te një person i tillë përballet dashuria për Allahun me dashurinë për dikë tjetër, ai i jep përparësi së dytës dhe dashuria për Allahun humbet.

Pjesa e ajetit që dëshmon për çështjen në fjalë, është ajo pjesë ku Allahu, ata që e barazuan dashurinë për Të me dashurinë për dikë tjetër, i ka quajtur idhujtarë, që i kanë vënë Allahut ortakë.

Në një hadith të saktë, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem) ka thënë: “Kush thotë *La ilahe il’All-llah* dhe mohon atë që adhurohet përveç Allahut, i mbrohet pasuria dhe gjaku i tij, kurse llogaria e tij është tek Allahu.”¹

– “... *Kush thotë La ilahe il’All-llah...*” – Pra, që nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut.

– “... *dhe mohon atë që adhurohet përveç Allahut ...*” – E themi këtë për arsye se Isai, i biri i Merjemes është adhuruar përveç Allahut. Ne e besojmë atë, por nuk besojmë në adhurimin e tij dhe as se ai meriton të adhurohet: “Kur Allahu do të thotë (në Ditën e Gjykimit): ‘O Isa, biri i Merjemes! Vallë, a ti ishe që u the njerëzve: ‘Adhuromëni mua dhe nënën time si dy zota krahas Allahut?!’ Ai (Isai) do të thotë: ‘I dliurë nga të metat je Ti! Mua nuk më takon të them diçka, për të cilën nuk kam aspak të drejtë. Sikur ta kisha thënë një gjë të tillë, Ti padyshim që do ta dije. Ti e di se ç’ka në veten time, po unë nuk di çfarë ka në Vetën Tënde. Vetëm Ti je i Gjithëdituri për të gjitha të fshehtat. Unë nuk u kam thënë asgjë tjetër përveç asaj që më ke urdhëruar Ti: ‘Adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj! ...’” (Maide, 116-117)

– “... *dhe mohon atë që adhurohet përveç Allahut...*” – Këtu tregohet se nuk mjafton vetëm shprehja e dëshmisë *La ilahe il’All-llah*, por patjetër duhet të mohojë adhurimin e atyre që adhurohen përveç Allahut, e gjithashtu të mohojë çdo lloj kufri.

¹ Transmeton Muslimi.

Kushdo që thotë *La ilahe il'All-llah*, e pastaj thotë se të krishterët dhe hebretë sot, janë në një fe të saktë, nuk është musliman. Po kështu, nuk është musliman edhe kushdo që mendon se fetë janë mendime prej të cilave mund të zgjedhësh cilën të duash, apo se fetë janë besime të projektuara nga Allahu, sipas të cilave ecin njerëzit. Prandaj duhet të kundërshtohen disa njerëz kur shprehen e thonë “mendimi islam”, pasi ata duhet të thonë “feja islame” ose “besimi islam.” Nga ana tjetër, nuk ka gjë nëse thuhet “mendimtari islam”, sepse ky është përshkrim i vetë personit, e jo i fesë që ai ndjek. Për më tepër, kjo temë do të sqarohet më pas, në temat e tjera.

Dobitë e temës

- Çështja më e madhe është komentimi i teuhidit dhe i dëshmisë, që janë sqaruar hollë nga autori.

Për sa i përket komentit të teuhidit, duhet patjetër të përmbushen dy gjëra: 1. mohimi i adhurimit për cilindo tjetër veç Allahut; 2. pohimi i adhurimit vetëm për Allahun. Pra, për realizimin e teuhidit duhet patjetër mohimi dhe pohimi, sepse ‘teuhid’ do të thotë ta konsiderosh diçka si një të vetëm në besim dhe në vepra. Nëse thua se “Zejdi është ngritur”, ke pohuar ngritjen e tij, por nuk e ke veçuar. Kur thua “askush nuk është ngritur, veç Zejdit”, ke pohuar ngritjen e tij dhe e ke veçuar atë me këtë veprim. Nëse do të thuash se Allahu është i adhuruari, ke pohuar adhurimin për Të, por nuk e ke mohuar për të tjerët veç Tij dhe, në këtë rast, teuhidi nuk është plotësuar. Nëse thua *La ilahe il'All-llah*, ke pohuar adhurimin për Allahun dhe e ke mohuar për të tjerët.

Për sa i përket fjalës së autorit “komenti i dëshmisë”, dëshmi është të shprehurit e njeriut për atë që ka të sigurt në zemrën e vet. Atëherë, fjala *La ilahe il'All-llah*, do të thotë shprehimisht: unë flas me gjuhën time, duke shprehur bindjen që ka zemra ime, se

nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut.

- Komentimi i ajetit të sures Isra, ku theksohet kundërpërgjigjja ndaj idhujtarëve, të cilët u luteshin njerëzve të mirë, dhe ku sqarohet se ky është shirk i madh.

Ky ajet është: “Vetë ata që idhujtarët u luten, kërkojnë t’i afrohen Zotit të tyre, shpresojnë në mëshirën e Tij dhe i frikësohen ndëshkimit të Tij.” Shirku është i madh, sepse lutja është adhurim. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Zoti juaj ka thënë: ‘Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem. Me të vërtetë, ata që nga mendjemadhësia nuk duan të më adhurojnë Mua, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar.” (Gafir, 60). Në këtë ajet tregohet që duaja është adhurim, sepse fjalia e fundit është komenti i fillimit. Pra, kushdo që lut dikë tjetër veç Allahut, të gjallë apo të vdekur, është idhujtar dhe ka rënë në shirkun e madh.

Lutja që u drejtohet krijesave ndahet në tri lloje:

a) Lutja për një çështje që mund të realizohet me forma të njohura e konkrete. Kjo nuk është lutje adhurimi, por është diçka e lejuar. I Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “... nëse ju ftojnë, përgjigjuni ftesës.”¹

b) Lutja drejtuar një krijese çfarëdo, të gjallë apo të vdekur, për gjëra që ka mundësi t’i realizojë vetëm Allahu. Ky është shirk i madh, sepse atë që lut, e bën ortak me Allahun në ato gjëra që mund t’i realizojë vetëm Ai (Subhanehu ue Te‘Ala). Kjo është si të lusësh dikë, duke thënë: “O filan, bëje mashkull fëmijën në barkun e gruas sime.”

c) Të lusësh një krijesë të vdekur, e cila nuk mund të përgjigjet konkretisht. Edhe ky gjithashtu është shirk i madh, sepse lutja bëhet duke besuar se i vdekuri ka ndikim të fshehtë në gjithësi.

- Komentimi i ajetit të sures “Teube”. Në të sqarohet se ndjekësit e Librit i morën rabinët dhe murgjit e tyre si zota në vend të Allahut. Ai ka sqaruar se ata kanë

¹ Buhariu.

qenë urdhëruar të adhuronin vetëm një Zot. Komenti i tij është i qartë: shirku i tyre ishte në bindjen ndaj dijetarëve dhe murgjërve në mëkat, e jo se ata u luteshin atyre¹.

Ky shirk është shirk në bindje. Ai kundërshton më tepër *teuhidin rububije* sesa *teuhidin uluhije*, sepse gjykimi, qoftë ky i Sheriatit apo i ligjësive të krijimit, i takon Allahut, dhe kjo është pjesë e *rububije*-s së Tij: “Dhe për çfarëdo që të diskutoni, gjykimi për të është tek Allahu ...” (Shura, 10). “Atij i takon Vendimi dhe tek Ai do të ktheheni (ju të gjithë) ...” (Kasas, 70).

Dijetari (Allahu e mëshiroftë!) e ka konsideruar shirkun në bindje si shirk të madh. Kjo kërkon shpjegim, i cili do të vijë në temën “Kush u bindet prijësve dhe dijetarëve duke lejuar atë çfarë ka ndaluar Allahu, ose e kundërta”.

- Thënia e Ibrahimit për jobesimtarët: “**(Kujto)** kur Ibrahim i tha të atit dhe popullit të tij: ‘Në të vërtetë unë jam i distancuar nga ajo që ju adhuroni. **(Unë adhuroj)** Vetëm Atë që më ka krijuar dhe i Cili do të më udhëzojë në rrugë të drejtë.’”

Ai e përjashtoi Zotin e tij nga “hyjnitë” e politeistëve. Allahu i Madhëruar përmend se “distancimi” dhe “miqësimi” janë pikërisht shpjegim i dëshmisë “Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut”, kur thotë: “Ai **(Ibrahimi)** e bëri këtë fjalë të përhershme te pasardhësit e tij, me qëllim që ata të kthehen **(vazhdimisht te Allahu)**”.

Pjesa e parë e fjalës së autorit tregon se teuhidi duhet të përmbajë mohim dhe pohim, distancim nga gjithçka tjetër veç Allahut dhe pohimin e adhurimit vetëm për Allahun.

Togfjalëshi “atë fjalë” në ajet, nënkupton dëshminë *La ilahe*

¹ Në temën “Kush u bindet dijetarëve dhe prijësve në ndalimin e asaj që e ka lejuar Allahu ose në lejimin e asaj që Ai e ka ndaluar, i ka konsideruar ata si Zota” sqarohet se kur është bindja ndaj tyre shirk i madh dhe kur është gjynah.

il'All-llah. Atëherë, kuptimi i fjalës së Allahut: “Në të vërtetë unë jam i distancuar nga ajo që ju adhuroni, në vend të Tij. (Unë adhuroj) Vetëm Atë (Allahun) që më ka krijuar ...”, është, në fakt, kuptimi i dëshmisë *La ilahe il'All-llah*.

- Komentimi i ajetit të sures “Bekare” në lidhje me qafirët, për të cilët Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “... ata s'kanë për të dalë kurrë nga Zjarri.”

(Bekare, 167)

Është përmendur se ata i duan idhujt e tyre siç duan Allahun. Kjo tregon se ata e donin shumë Allahun, e megjithatë mbetën jashtë fesë islame. E ç'mund të thuhet për atë që i do idhujt më shumë se Allahun, apo për atë që do vetëm idhujt dhe nuk e do Allahun?!

Allahu e ka quajtur dashurinë shirk, kur diçka tjetër duhet siç duhet Ai, dhe, në këtë rast, njeriu i ka bërë ortakë Allahut në dashuri. Prandaj, dashuria për Allahun është detyrë të jetë e pastër, pa i shoqëruar Atij askënd, qoftë ky edhe i Dërguari i Allahut (sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem). Sikur ai të mos ishte Pejgamber, nuk do të ishte detyrë bindja e as dashuria ndaj tij, por do të ishte si ajo ndaj çdo besimtari tjetër. Njeriu nuk e ka të ndaluar të dojë edhe gjëra të tjera veç Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), përkundrazi, i lejohet të dojë çdo gjë për të cilën është e lejuar dashuria, si: fëmijën, gruan etj., por kjo nuk duhet të jetë kurrsesi si dashuria për Allahun.

Ndërsa në lidhje me fjalën e autorit: “E ç'mund të thuhet për atë që i do idhujt më shumë se Allahun, apo për atë që do vetëm idhujt dhe nuk e do Allahun?!” mund të themi se njeriu ka katër forma të dashurisë në raport me Allahun:

1. Ta dojë Allahun më shumë se çdokënd tjetër veç Tij, dhe ky është teuhidi.
2. Të dojë tjetërkënd veç Allahut ashtu siç e do Atë, dhe ky është shirk.
3. Të dojë tjetërkënd më shumë sesa Allahun, dhe kjo është edhe më e keqe se rasti i dytë.

4. Të dojë tjetërkënd duke mos pasur në zemër aspak dashuri për Allahun (Subhanehu ue Te'Ala), dhe kjo është akoma më e keqe.

Dashuria ka shkaqe dhe faktorë me të cilët lidhet. Ajo ndryshon në varësi të faktorëve me të cilët lidhet ashtu siç ndryshon edhe kënaqësia me ndryshimin e faktorëve dhe shkaqeve me të cilat lidhet. Kënaqësia nga kënga e muzika, për shembull, nuk është si kënaqësia që vjen nga përmendja e Allahut. Ajo që duam të themi është se dashuria, në vetvete, ndryshon. Kemi dashuri ndaj prindërve dhe dashuri ndaj fëmijëve, por ndërmjet tyre ka dallim. Gjithashtu, kemi dashuri ndaj Allahut dhe ndaj fëmijës, por edhe ndërmjet tyre ka dallim. Kështu, të gjitha çështjet e brendshme si dashuria, kënaqësia dhe mërzia, ndryshojnë me ndryshimin e faktorëve me të cilët lidhen. Inshallah, kjo çështje do të shpjegohet më gjerësisht te fjala e autorit: “Dhe ka njerëz që zgjedhin (për adhurim) të tjerë përveç Allahut, si shokë të barabartë me Të ...”.

- Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kush thotë *La ilahe il’All-llah* dhe mohon atë që adhurohet përveç Allahut, i mbrohet pasuria dhe gjaku i tij, kurse llogaria e tij është tek Allahu.”

Ky hadith është një nga argumentet më të rëndësishme që sqaron kuptimin e fjalës *La ilahe il’All-llah*. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk e lidhi mbrojtjen e gjakut dhe të pasurisë vetëm me shqiptimin e saj, madje as me njohjen e kuptimit të saj duke e shqiptuar, as me pohimin e saj, as me lutjen drejtuar Allahut pa i shoqëruar asgjë, por pasuria e gjaku i njeriut mbrohen vetëm kur ai t’i bashkëngjisë kësaj dëshmie mohimin e gjithçkaje që adhurohet përveç Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Nëse dyshon ose nuk shpreh asnjë qëndrim, atëherë e humbet të drejtën e mbrojtjes së pasurisë dhe gjakut të tij. Sa e madhe dhe sa e qartë është kjo çështje! Sa i fortë e i prerë është ky argument për rrëzimin e

pretendimit të kundërshtarit!

– “... *Kush thotë La ilahe il’All-llah...*” – Kjo pjesë deri në fund të saj shpreh domosdoshmërinë e mohimit të *tagut*-it dhe domosdoshmërinë e besimit në Allahun e Lartësuar. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “... Kushdo që mohon *tagut*-in dhe beson Allahun është kapur për lidhjen më të fortë ...” (Bekare, 256)

– “... dhe mohon atë që adhurohet përveç Allahut, i mbrohet pasuria dhe gjaku i tij, kurse llogaria e tij është tek Allahu.” – Kjo do të thotë se mohon idhujt dhe vlefshmërinë e këtij adhurimi. Pra, nuk mjafton të thotë “*La ilahe il’All-llah*” dhe nuk i adhuron idhujt, por duhet të deklarojë se i mohon idhujt dhe mohon adhurimin e tyre. Për shembull, nuk mjafton të thotë: “*La ilahe il’All-llah*”, unë nuk e adhuroj Latin,¹ por duhet ta mohojë atë dhe të deklarojë se adhurimi i Latit është i kotë, e nëse nuk e bën këtë, ka pohuar kufirin. Kush pëlqen fenë krishtere, si fe me të cilën adhurohet Allahu, është jobesimtar, sepse kush barazon fe të tjera me fenë Islame, ka mohuar thënien e Allahut: “Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet ...” (Ali Imran, 85). Pra, me të tilla shprehje njeriu bëhet jobesimtar. Me anë të kësaj ne njohim rrezikun e madh që ka goditur muslimanët e sotëm, për shkak të përzierjes së tyre me të krishterët. Këta të fundit i ftojnë në fenë e tyre mëngjes e mbrëmje, ndërsa muslimanët, sidomos ata që nuk e njohin mirë fenë, tregohen të butë me ta. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Ata kanë dëshirë që ti të bësh lajka, e që edhe ata të bëjnë lajka.” (Kalem, 9). Kjo është një nga sprovat që sot ka goditur muslimanët e i ka çuar deri në këtë poshtërim që po përjetojnë.

¹ Një nga idhujt e arabëve paraislamikë.

Tema 7

Mbajtja e rrathëve, fijeve etj., për largimin e së keqes ose pengimin e saj, është pjesë e shirkut¹

Shprehja “është pjesë e shirkut”, do të thotë se ka diçka nga shirku, por nuk është shirk i plotë.

Shirk është një term i përgjithshëm, që përfshin shirkun e madh dhe atë të vogël. Mbajtja e këtyre gjërave, mund të jetë shirk i vogël ose shirk i madh, sipas besimit të personit që e vë. Mbajtja e këtyre gjërave është pjesë e shirkut, sepse çdokush që pohon një shkak, të cilin Allahu nuk e ka bërë as *shkak fetar*² dhe as *shkak kaderij*³, e ka bërë veten ortak me Allahun. Por, nga ana tjetër, leximi (për shembull) i sures Fatiha është *shkak fetar* për shërim, ndërsa pirja

¹Nëse personi që mban rrethin apo diçka të ngjashme me të beson se ai ndikon vetvetiu, *pa urdhërin apo lejen e Allahun të Madhëruar*, bën shirk të madh në *teuhidin rububije* (pra, i bën shok Allahut në veprimet hyjnore, veprime këto që i kryen vetëm Ai). Arsyeja qëndron në faktin se ky person beson që bashkë me Allahun është edhe një krijues tjetër, kështu që bëhet idhujtar.

Nëse beson se rrathët apo gjëra të tjera janë shkaqe, por që nuk kanë ndikim të vetvetishëm, ai ka rënë në shirk të vogël ngaqë beson si shkak diçka që nuk është shkak. Ky i bën ortak Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) duke gjykuar se këto gjëra janë shkak, kur Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) nuk i ka bërë të tilla. Shirku i vogël nuk e nxjerr njeriun nga feja, por e bën teuhidin jo të plotë dhe konsiderohet gjynah i madh dhe përveç kësaj mund ta çojë njeriun në shirkun e madh.

² Shkaku quhet *fetar* ose *sher'ij* kur efekti apo ndikimi i tij mësohet nga argumentet fetare.

³ Shkaku quhet *kaderij* kur efekti, pasoja apo ndikimi i tij mësohet nga përvoja, provimi ose eksperimentimi shkencor.

e purgativit është *shkak kaderij* për heqjen e barkut. Ai është *shkak kaderij* dhe efekti i tij është i provuar dhe i njohur nga përvoja.

Për sa i përket qëndrimit ndaj shkaqeve, njerëzit ndahen në tri grupe:

a) Mohuesit e shkaqeve. Këtu bëjnë pjesë të gjithë ata që mohojnë Urtësinë e Allahut, si *xhebritë* dhe *esharitë*.

b) Tepruesit në shkaqe. Këtu bëjnë pjesë ata që e bëjnë *shkak* edhe atë që nuk është i tillë, siç janë njerëzit e rëndomtë sufistë etj., që merren me gjëra të pavërteta.

c) Ata që pranojnë shkaqet dhe ndikimin e tyre, duke pohuar vetëm ato që ka përcaktuar Allahu dhe i Dërguari i Tij si shkaqe fetare apo si shkaqe shkencore. Nuk ka dyshim se këta janë ata të cilët e besojnë Allahun me vërtetësi dhe besojnë në Urtësinë e Tij, duke i lidhur shkaqet dhe qëllimet me pasojat e tyre. Kjo, me të vërtetë është pjesë e urtësisë së plotë.

Mbajtja e rrethit apo e diçkaje të ngjashme me të, nëse personi që e mban beson se ajo ndikon vetvetiu, pa Allahun e Madhëruar, është shirk i madh dhe cenon *teuhidin rububije*. Kjo, sepse ky person, beson që, bashkë me Allahun, është edhe një krijues tjetër, kështu që bëhet idhujtar.

Nëse beson se rrathët apo gjëra të tjera, janë shkaqe, por që nuk kanë ndikim të vetvetishëm, ai ka rënë në shirk të vogël, ngaqë beson si *shkak* diçka që nuk është *shkak*. Ky i bën ortak Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) duke gjykuar se këto gjëra janë *shkak*, kur Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) nuk i ka bërë të tilla.

Pra, për ta njohur diçka si *shkak*, ka dy rrugë:

a) Nëpërmjet rrugës së Sheriatit, siç është rasti i mjaltit, për të cilin Allahu thotë: "... në të cilin ka ilaç e shërim për njerëzit ...” (Nahl, 69). Po kështu mund të themi edhe për leximin e Kuranit: “Dhe Ne kemi zbritur nga Kurani atë që është shërim e mëshirë për ata që besojnë ...” (Isra, 82).

b) Nëpërmjet përvojës¹. Kur provojmë diçka dhe shohim se ajo është e dobishme në largimin e dhimbjeve, e pranojmë si *shkak*, por duke u siguruar më parë për efektin e drejtpërdrejtë të saj. Përdorimi i djegies me hekur, për shembull, është një *shkak* i qartë.

¹ Shkaku që njihet nëpërmjet kësaj rruge quhet *kaderij*.

E bëmë këtë sqarim, që të mos thotë ndokush se ka provuar diçka dhe ajo i ka bërë dobi, ndërkohë që ajo nuk ka ndikim të dukshëm e të qartë, siç është vendosja e rrathëve, duke menduar se ata janë të dobishëm. Ndoshta kjo edhe mund t'i bëjë dobi, sepse optimizmi vetjak për diçka është ndikues i qartë. Mund të shkojë dikush e t'i bëjë rukje një të sëmuri, por ai nuk qetësohet. Por nëse i shkon një person tjetër, dhe i sëmuri beson se leximi i tij është i dobishëm, dhe i lexon të njëjtat gjëra, ai qetësohet dhe ndjen lehtësim të dhimbjeve. Po kështu, edhe ata që vendosin rrathë, lidhin fije peri etj., ndoshta ndjejnë lehtësim ose largimin e së keqes, duke pasur besim në dobinë e tyre. Lehtësimi i dhimbjes për atë që beson në dobinë e rrethit, vjen thjesht nga ndjenjat vetjake, por këto ndjenja nuk janë rrugë e ligjshme për pohimin e shkaqeve, ashtu sikurse edhe “inspirimi” nuk është burim legjislacioni.

– *“Mbajtja e rrathëve dhe fijeve ...”* – Rrathët mund të jenë prej hekuri, ari, argjendi etj., ndërsa fijet dihet si janë.

Sendet e tjera mund të jenë zbukurime në formë të rrumbullakët, apo në forma të tjera, prej bakri ose prej ndonjë materiali tjetër, për “largimin” e belave. Gjithashtu, ka njerëz që varin në qafë pjesë të vogla kafshësh, njerëz që varin në makinat e tyre calikë të kalbur etj., për të shmangur, gjoja, prekjen nga syri i keq, që, kur t'i shohin njerëzit e tjerë, të neveriten prej tyre.

– *“... për largimin e të keqes ose për pengimin e saj ...”* – Ka ndryshim ndërmjet tyre, sepse largimi kërkohet pasi të godet e keqja, ndërsa pengimi kërkohet para se të bjerë ajo.

Shejhu i Islamit Muhamed Ibn Abduluehabi nuk mohon shkaqet e vërteta për largimin e së keqes ose për pengimin e saj, por mohon shkaqet e rreme.

“Më thoni pra, gjërat që ju i lutni në vend të Allahut, nëse Allahu do të donte të më bënte mua ndonjë të keqe, a do të mundeshin ta largonin të keqen e Tij? Thuaj: ‘Më se i mjaftueshëm për mua është Allahu. Vetëm Atij le t'i mbështeten të mbështeturit.’” **(Zumer, 38)**

– “*Më thoni pra, gjërat që ju i lutni në vend të Allahut ...*” – Me lutjen nënkuptohet *lutja e adhurimit* dhe *lutja e kërkitimit*. Ata i lutnin këta idhuj me *duanë e adhurimit*, duke i marrë për të adhuruar në *zotime, ruku dhe sexhde*; si dhe me *duanë e kërkitimit*, duke u kërkuar atyre largimin e së keqes dhe arritjen e së mirës. Nëse Allahu do të donte t'i bënte ndonjë të keqe robit të Tij, këta idhuj nuk do të mundeshin kurrë ta largonin atë. E nëse Ai do të donte t'i bënte ndonjë të mirë, ata nuk do mundeshin kurrë ta ndalonin atë. Pra, ato as nuk e largojnë të keqen, as nuk mund ta pengojnë të mirën. Atëherë, pse duhet të adhurohen?!

– “*... Thuaj: ‘Më se i mjaftueshëm për mua është Allahu. Vetëm Atij le t'i mbështeten të mbështeturit.’*” – Do të thotë: “Më mjafton Allahu nga të gjithë të tjerët”. Ndërsa i mbështetur realisht, është ai që i është mbështetur Allahut, kurse ai që i është mbështetur idhujve, eulijave (të ashtuquajtur njerëz të mirë) dhe varreve nuk është i tillë. Kjo nuk bie ndesh me rastin kur një person bën përfaqësues një person tjetër për diçka, duke ia lënë atij në dorë. Ka ndryshim ndërmjet mbështetjes tek njeriu që vepron diçka me urdhrin tënd dhe mbështetjes tënde tek Allahu, sepse kjo e dyta tregon që ti beson se në dorën e Tij është dobia dhe dëmi. Ti i je nënshtuar dhe mbështetur Atij, duke shfaqur nevojën tënde para Tij dhe duke ia dorëzuar çështjen tënde vetëm Atij.

Ky ajet dëshmon për faktin se këta idhuj nuk u bëjnë dobi atyre që i adhurojnë e as nuk ua largojnë të këqijat, dhe as nuk janë shkaqe për këtë. Të njëjtin gjykim kanë të gjitha ato gjëra që nuk janë shkaqe fetare ose nëpërmjet përvojës. Marrja e tyre për shkaqe konsiderohet si shirk ndaj Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala).

Ky gjykim dëshmon për zotësinë dhe deduksionin e fortë të autorit (Allahu e mëshiroftë!). Ajeti pa diskutim bën fjalë për shirkun e madh, i cili është adhurimi i idhujve, por krahasimi është shumë i qartë, sepse këta idhuj nuk janë shkaqe për dobinë, ndaj me ta krahasohet çdo gjë që nuk është shkak dhe konsiderohet shoqërim me Allahun.

Po kështu, në ajet ka një argument tjetër, që dëshmon për çështjen në fjalë: “Më se i mjaftueshëm për mua është Allahu.” Ky është dorëzimi ndaj mjaftueshmërisë së Allahut dhe jo ndaj

shkaqeve të paqena. Për sa i përket shkaqeve të vërteta, marrja e tyre nuk kundërshton mbështetjen e njeriut tek Allahu dhe dorëzimin e çështjes tek Ai, sepse ato janë vendosur nga vetë Ai.

Nga Imran Ibn Husejni përcillet se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka parë një burrë me një rreth bakri në dorën e tij, të cilit i tha: “Çfarë është kjo?” – “Është për të kaluar dobësinë” – iu përgjigj ai. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: “Hiqe atë, sepse ajo vetëm ta shton dobësinë. Nëse vdes duke e mbajtur këtë, ti nuk shpëton kurrë.”¹

– “... ka parë një burrë ...” – Nuk është treguar emri i personit, pasi në këtë rast i rëndësishëm është sqarimi i çështjes dhe gjykimi i saj, dhe jo emri. Megjithatë është përcjellë se ai ka qenë vetë Imrani, por nuk e ka shfaqur veten e tij. Për sa i përket rrethit dhe bakrit, ata janë të njohur, ndërsa fjala “*el uahine*” e përmendur në hadith, është dhimbja që ndjen në krah.

– “... ti nuk shpëton kurrë.” – Shpëtim do të thotë t’i shmangesh asaj që i frikësohesh dhe të arrish atë që kërkon.

Ky hadith është në përshtatje të plotë me temën, sepse ky burrë kishte vendosur një rreth bakri ose për shmangien e së keqes, ose për largimin e saj. Ajo që duket nga konteksti është se e kishte vënë për largimin e së keqes, sipas shprehjes “*vetëm ta shton dobësinë*”. Ndërsa shtimi është mbi atë që ka qenë në origjinë.

Në këtë hadith ka disa dobi:

- Ai person që dëshiron të ndryshojë një të keqe, duhet të pyesë fillimisht, sepse ndoshta e mendon si të keqe diçka që nuk është e tillë. Argument është pyetja e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Çfarë është kjo?” Mesa duket pyetja këtu është për hetim e jo për kundërshtim. Ndërsa fjala e burrit: “Është për të kaluar dobësinë.” Pra e kam veshur për t’u qetësuar nga “*el uahine*” (dhimbja). El uahine është një sëmundje që e dobëson trupin e njeriut. Ajo mund të jetë në të gjithë trupin, por mund të jetë edhe në disa gjymtyrë siç

¹ Transmeton Ahmedi dhe Ibn Maxhe. Sipas Albanit hadithi është i dobët.

u përmend më parë.

▪ Është detyrë të largohet e keqja, siç vjen në fjalët: “Hiqe atë.” Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e urdhëroi personin për heqjen e rrethit, sepse vënia e tij ishte diçka e keqe, dhe ai e përforcoi këtë me fjalët: “...vetëm ta shton dobësinë”. Bëhet fjalë për dobësi të gjendjes shpirtërore e jo trupore. Ndoshta këto gjëra mund t'i shtojnë njeriut edhe dobësinë trupore, ndërsa dobësia shpirtërore vjen për shkak se kur njeriu e lidh veten e tij me të tilla gjëra ai dobësohet, u mbështetet atyre dhe harron mbështetjen tek Allahu i Lartësuar. Ndjenjat shpirtërore kanë ndikim të madh në dobësinë e njeriut. Ndonjëherë, njeriut të shëndoshë i bëhet sikur është i sëmurë, dhe sëmuret vërtet. Ndonjëherë, i sëmuri e harron sëmundjen e tij dhe shërohet vërtet. Shkak për sëmundjet psikike të mjaft njerëzve është bërë gjithashtu dobësia shpirtërore. Njeriu mendon se është i sëmurë me këtë apo atë sëmundje, i shtohet iluzioni pak nga pak, derisa bëhet vërtet i sëmurë. Po kështu, atij që ka vendosur një rreth kundër dobësisë i shtohet dobësia, sepse beson që përderisa ka vendosur atë, është i ruajtur, dhe nëse e heq, i kthehet dobësia. Kjo, padyshim, është dobësi në shpirt.

▪ Njeriu nuk ka përfitim nga shkaqet që nuk janë të përcaktuara nga Sheriati, nga tradita apo përvoja.

▪ Vendosja e rrathëve apo gjërave të ngjashme me to, për pengimin e së keqes ose largimin e saj, janë pjesë e shirkut. Argument për këtë është fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Nëse vdes duke e mbajtur atë, nuk shpëton kurrë.” Mohimi i shpëtimit është argument për dështimin dhe humbjen. Po a është ky shirk i madh apo i vogël? Në fillim të kësaj teme thamë se kjo varet nga besimi i personit që i mban ato.

▪ Punët vlerësohen sipas përfundimit të tyre. Sipas fjalës së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Nëse vdes duke e mbajtur këtë ...”, mësohet se, nëse njeriu e heq para se të vdesë, nuk do t'i bëjë dëm, sepse njeriu që pendohet para se të vdesë, është si ai që nuk ka fare gjynahe.

■ Nga Ukbeh Ibn Amiri, përcillet se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Atij që mban hajmali

(temime¹), mos ia plotësoftë Allahu dëshirën! Atij që mban guaskë, mos i lëntë Allahu asnjë të mirë!”²

Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet: “Kush mban hajmali, ka bërë shirk.”³

– “... *Atij që mban hajmali ...*” – Atij që i mban hajmali, pra që i ka varur ato, duke e lidhur zemrën e tij me to, në kërkimin e së mirës ose në largimin e së keqes. hajmalia është diçka që u varet fëmijëve, si për shembull vargje me rruaza etj., për t’i mbrojtur nga syri i keq.

– “... *mos ia plotësoftë Allahu dëshirën! ...*” - Kjo është një fjali dëshirore, në formë lutjeje e mallkimi, por mund të jetë edhe dëftore. Që të dyja mundësitë tregojnë se hajmalitë janë haram; njësoj, si i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të ketë mohuar që Allahu t’ia plotësojë dëshirën, si të jetë lutur që të mos ia plotësojë dëshirën. Nëse i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka pasur për qëllim kumtimin, atëherë ne përcjellim me atë që ka kumtuar i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ose në të kundërt lusim, siç është lutur i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). E ngjashme me këtë është edhe thënia e tij: “Atij që mban guaskë (si hajmali), mos i lëntë Allahu asnjë të mirë!” Me fjalën (*el ued’atu*) në hadith, nënkuptohen guaskat e detit, që përdoren për të shmangur mësyshin. Po t’i varte njeriu ato guaska, besohej se nuk e kapte syri ose nuk e godiste xhindi.

– “... *mos i lëntë Allahu asnjë të mirë! ...*” – Mos e lëntë Allahu në rehati e qetësi. Të kundërtat e rehatisë dhe qetësisë janë pikëllimi dhe dhimbja. Po kështu, është thënë se kjo shprehje do të thotë: “u shpërbleftë me të kundërtën e asaj që kishte qëllim!”

– “... *ka bërë shirk.*” – Ky shirk është i madh nëse besohet se vetë

¹ Temimet ishin sende që ua lidhnin fëmijëve për t’i mbrojtur me to nga syri i keq. Kjo fjalë përfshin hajmalitë, nuskat, guaskat, dordolecët, patkonjtë, vargjet e hudhrave dhe çdo gjë tjetër që vihet apo varet për shmangien e të këqijave. Fjala ‘hajmali’, në çdo vend ku përmendet ‘në tekst, përfshin gjithë sa përmendet në këtë shënim.

² Ahmedi. Sipas Albanit hadithi është i dobët.

³ Ahmedi. Sipas Albanit ky variant është i saktë.

nuska pengon të keqen ose e largon atë, pa urdhrin e Allahut, e në të kundërt, është shirk i vogël.

Nga Ibn Ebu Hatimi përcillet se Hudhejfja kishte parë një burrë, i cili kishte vënë në dorë një fije peri, për shkak të etheve. Ai ia këputi atë dhe lexoi fjalën e Allahut: “Dhe shumica nuk e besojnë Allahun, veçse duke i bashkuar Atij shokë e ortakë të barabartë me Të.” **(Jusuf, 106)**

– “... për shkak të etheve. ...” – Do të thotë se ai kishte vendosur një pe në dorë, me qëllim që të shërohej prej etheve.

– “... ia këputi atë ...” – Kjo tregon xhelozinë e të parëve tanë të ndershëm dhe vendosmërinë e madhe të tyre për ta ndryshuar çdo të keqe, me dorë apo me gojë.

– “... dhe lexoi fjalën e Allahut: “Dhe shumica nuk besojnë Allahun, veçse duke i bashkuar Atij shokë e ortakë të barabartë me Të.” – Hudhejfja lexoi këtë ajet, i cili ka për qëllim idhujtarët, që besojnë teuhidin rububije dhe mohojnë teuhidin uluhije.

– “... duke i bashkuar Atij shokë e ortakë ...” – Do të thotë se ata përzihen me shirk, ndërsa fjala e Hudhejfes ishte për një musliman që kishte vendosur një pe për t’u shëruar nga ethet. Në këtë hadith tregohet se te një njeri mund të bashkohen besimi dhe shirku, por jo shirku i madh. Pra, qëllimi këtu është për shirkun e vogël, dhe kjo është një çështje e njohur.

■ **Dobitë e temës**

- Rreptësia në ndalimin e mbajtjes së rrathëve, fijeve e të tjera të ngjashme me to.

Kjo gjë del nga fjala e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Hiqe atë, sepse vetëm ta shton dobësinë. Nëse vdes duke e mbajtur

atë, ti nuk shpëton kurrë.”

- Edhe sahabi, nëse do të vdiste duke e mbajtur atë, nuk do të shpëtonte. Kjo është provë nga sahabët, se shirku i vogël është mëkat më i madh sesa gjynahet e mëdha.

Kur nuk mund të shpëtonte sahabi, çfarë mund të mendohet për të tjerët?! Natyrisht, shpëtimi për ta është akoma më i vështirë.

Fjala e autorit: “Kjo është provë nga sahabët, se shirku i vogël është mëkat më i madh sesa gjynahet e mëdha”, do të thotë se ky ka qenë qëndrimi i sahabëve dhe, në fakt, ashtu është: shirku i vogël është mëkat më i madh sesa gjynahet e mëdha. Ibn Mesudi (r.a.) ka thënë: “Të betohem në Allahun duke gënjyer, është më e dashur për mua sesa të betohem në dikë tjetër veç Tij, duke thënë të vërtetën.”¹ Kjo, për arsye se e keqja e shirkut është më e rrezikshme se e keqja e mëkatit të madh. Allahu nuk fal shirkun edhe nëse është i vogël, e kjo ndryshon nga mëkatet e mëdha, pasi këto të fundit janë nën mëshirën e Allahut.

- Njeriu nuk shfajësohet për shkak të injorancës së tij rreth kësaj çështjeje.

Kjo ka nevojë për shqyrtim, sepse fjala e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Nëse vdes duke e mbajtur atë, ti nuk shpëton kurrë”, nuk tregon qartë nëse flitet për vdekjen para se ta mësosh të keqen e asaj pune. Përkundrazi, nga konteksti del ky kuptim: nëse vdes duke e mbajtur atë, ti nuk do të shpëtosh kurrë, pasi e ke mësuar dhe pasi je urdhëruar për heqjen e tij.

Injoranca është dy llojesh: injorancë për të cilën njeriu është i justifikuar, dhe injorancë për të cilën njeriu nuk mund të justifikohet. Ajo që vjen nga neglizhenca dhe lënia pas dore, me gjithë mundësinë për të mësuar, është e pajustificueshme, qoftë kufër apo mëkat. Ndërsa ajo që vjen jo nga neglizhenca, por nga pamundësia për të mësuar, është e justifikueshme. Nëse personi

¹ Abdurr-Rrezaku dhe Tabarani në "El-Kebir". Sipas Albanit thënia është e vërtetë.

është me përkatësi Islame, kjo mosnjohje nuk e dëmton, e nëse nuk është në Islam, në dynja konsiderohet kafir, ndërsa në botën tjetër, çështja e tij është tek Allahu. Sipas mendimit më të saktë, ai do të vihet në provë në ahiret: nëse bindet, do të futet në Xhenet, e nëse kundërshton, do të futet në Xhehenem. Sipas asaj që u tha, edhe ai që rritet në ndonjë bjeshkë apo në vende të largëta, ku nuk ka njerëz të ditur dhe nuk i ka shkuar në mendje se një gjë e caktuar është e ndaluar ose që është detyrë, është i justifikuar.

Për këtë mund të marrim si shembull një person që ka arritur moshën e detyrimeve, edhe pse është akoma i vogël. Duke qenë se ai jeton në bjeshkë, ku nuk ka njerëz të ditur dhe ku nuk ka dëgjuar asgjë nga feja, ai mendon se njeriut i ngarkohen obligimet e adhurimit vetëm pasi të ketë arritur moshën pesëmbëdhjetë vjeçare. Kështu, ai qëndron pa u falur, pa agjëruar dhe pa u larë nga të qenit xhunub derisa mbush moshën pesëmbëdhjetë vjeç. Ky person nuk urdhërohet që të kryejë ato adhurime që i kanë kaluar, sepse ai është i justifikuar me padijen e tij, pasi nuk ka neglizhuar që të mësojë dhe as nuk i ka shkuar në mendje.

Po kështu, nëse është femër dhe i vijnë të përmuajshmet, ndërkohë që ajo është ende e vogël dhe nuk ka se kë të pyesë e as nuk i ka shkuar në mendje se kjo gjë e fut në moshën e detyrimeve, justifikohet nëse nuk ka agjëruar dhe nuk është falur. Nga ana tjetër, nëse banon në qytet dhe ka mundësi të pyesë, por e neglizhon këtë, nuk justifikohet. Kjo sepse, në përgjithësi, në qytet këto rregulla nuk mund të mos njihen, kur ka njerëz të ditur, të cilët mund t'i pyesësh me lehtësi. Për rastin e dytë, është detyrë kryerja e adhurimeve që ka lënë dhe nuk justifikohet për injorancën.

- Hajmalitë nuk bëjnë dobi, përkundrazi, të dëmtojnë. Argument është thënia e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "... vetëm ta shton dobësinë."

Autori (Allahu e mëshiroftë!) ka përdorur deduksionin në këtë çështje dhe ka sjellë përfundimin e tij.

- Ndryshimi i së keqes me ashpërsi, ndaj atij që vepron

diçka të tillë.

Kjo është marrë nga konteksti i hadithit që ka përmendur dijetari dhe nga fjala e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

- Deklarimi i hapur se ai që var diçka, (si hajmali etj.), lihet në mbështetjen e saj.

Kjo është marr nga thënia: “Atij që mban nuska, mos ia plotësoftë Allahu dëshirën!” Nëse e marrim këtë si fjali thjesht dëftore – se atij që mban nuska, Allahu nuk ja plotëson dëshirën –, atëherë ai është lënë në mbështetjen e kësaj nuske. E kush lihet në mbështetjen e krijesës mbetet i zhgënjyer. Kjo çështje bëhet më e qartë në temën: “Ai që mbështetet në diçka, lihet në mbështetjen e saj”, e cila do të shtjellohet më tej gjatë librit.

- Deklarimi i hapur se ai që var hajmali ka bërë shirk.

Kjo është njëra nga dy përcjelljet e hadithit të Ukbe Ibn Amirit.

- Lidhja e fijeve për shërimin e etheve është njëlloj si mbajtja e nuskave.

Kjo është marrë nga veprimi i Hudhejfes, i cili kur pa dikë që kishte në dorën e tij një pe për të luftuar ethet, ia këputi dhe i lexoi fjalën e Allahut: “Dhe shumica nuk besojnë Allahun, veçse duke i bashkuar Atij shokë e ortakë të barabartë me Të.”.

- Leximi i ajetit nga Hudhejfja, është argument se sahabët argumentoheshin për shirkun e vogël, me ajetet që përmendin shirkun e madh, siç bëri Ibn Abasi me ajetin e sures “Bekare”.

Kjo do të thotë se fjala e Allahut: “Dhe shumica nuk e besojnë Allahun, veçse duke i bashkuar Atij shokë e ortakë të barabartë me Të”, është për shirkun e madh, por është marrë si argument edhe

për shirkun e vogël, sepse në realitet, i vogli është shirk, edhe pse nuk të nxjerr nga feja. Për këtë arsye, themi se shirku është dy llojesh: i madh dhe i vogël.

Pjesa: “... siç bëri Ibn Abasi me ajetin e sures ‘Bekare’”, është për fjalën e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “Dhe ka nga njerëzit që zgjedhin (për adhurim) të tjerë përveç Allahut si shokë të barabartë me Allahun. Ata i duan këta të adhuruar të tjerë si Allahun, por ata që besojnë, e duan Allahun më shumë.” Këtu, dashuria që është si ajo ndaj Allahut, konsiderohet si shirk ndaj Allahut.

- Varja e guaskave që nxirren nga deti për t’u mbrojtur nga syri është si hajmalitë.

Do të thotë se janë si hajmalitë që përmbajnë shirk, sepse ata nuk kanë ndikim të pohuar në fe dhe as të vërtetuar nga praktika.

- Lutja kundër atij që mban hajmali, që Allahu të mos ia realizojë dëshirën. Po kështu, atij që mban guaskë, mos i lëntë Allahu asnjë të mirë!

Kjo është marrë nga duaja e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për ata që mbajnë hajmali e guaskë. Nuk është e çuditshme që urdhërohemi të lutemi kundër atyre që kundërshtojnë dhe bëjnë mëkate. I Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Nëse dëgjoni ndonjë që kërkon gjënë e tij të humbur në xhami, i thoni: ‘Mos ta ktheftë Allahu!’”¹ Ndaj dhe ne themi: “Mos ta plotësoftë Allahu dëshirën!” Megjithatë, i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka thënë këtë – siç është në hadith – në mënyrë të përgjithshme. Kështu që kur shikojmë dikë që ka varur një hajmali, nuk i themi në mënyrë të drejtpërdrejtë: “Mos ta plotësoftë Allahu dëshirën!” – se mund të bëhemi shkak për largimin e tij, por e këshillojmë t’i lërë hajmalitë dhe varjen e guaskave, se i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Atij që mban hajmali, mos ia plotësoftë Allahu dëshirën! Atij që mban guaskë, mos i lëntë Allahu asnjë të mirë!”

¹ Muslimi.

Tema 8

Argumentet që flasin për *rukjet* (yshtjet) dhe *temime-t* (hajmalitë).¹

Autori nuk ka përmendur që kjo temë është shirk, sepse gjykimi për rukjet dhe nuskat, ndryshon nga ai i vënies së rrathëve dhe penjve. Prandaj autori, (Allahu e mëshiroftë!) në temën para kësaj, ka thënë në mënyrë të prerë se ato janë pjesë e shirkut pa përjashtim. Ndërsa në këtë temë, nuk është shprehur që ato janë shirk, sepse ka rukje që nuk janë shirk.

– “... *rukjet* ...” – Janë lutje që u lexohen të sëmurëve për shërim.

– “... *temime-t*.” – Në gjuhën arabe ato janë quajtur *et-temimeh*, sepse arabët mendonin se me anë të tyre realizohej shmangia e mësyshit.

Në një hadith të saktë, përmendet se Ebu Beshir el Ensari, ka qenë bashkë me Profetin në disa udhëtime të tij. Ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ka dërguar një person që të mos linte pa prerë asnjë rreth në qafat e deveve, qoftë rrethi prej gjalmi të harkut² ose diçkaje

¹ Temimet ishin sende që ua lidhnin fëmijëve për t'i mbrojtur me to nga syri i keq. Kjo fjalë përfshinë hajmalitë, nuskat, guaskat, dordolecët, patkonjtë, vargjet e hudhrave dhe çdo gjë tjetër që vihet apo varet për shmangien e të këqijave.

² Gjalmi (*vetër*) është filli i harkut. Kur vjetrohej filli i harkut, arabët ua varnin në qafë deveve për mbrojtje nga mësyshi.

■ tjetër.

- “... *udhëtime* ...” – Në arabisht *es-sefer* do të thotë “lënie e vendqëndrimit”. Është quajtur kështu për dy arsye: 1. ndijore, për arsye se gjatë daljes dhe largimit nga shtëpia zbulohet, shfaqet vendi; 2. morale, për arsye se zbulohet morali i vërtetë i burrave. Shumë njerëz e shfaqin moralin, zakonet dhe natyrën e tyre vetëm gjatë udhëtimeve.

- “...*qoftë rrethi prej gjalmi të harkut ose diçkaje tjetër...*” – Njerëzit besonin asokohe se ky rreth largonte mësyshin. Ky ishte një besim i kotë, sepse kapej pas diçkaje që nuk është shkak. Theksuam në temën e kaluar se ai që merr si shkak diçka që nuk është e ligjshme fetarisht dhe as e vërtetuar nga përvoja, ka bërë shirk. Me lidhjen e atyre rrathëve, pranohej ndikimi i gjërave që nuk janë vërtetuar as fetarisht dhe as praktikisht. Për këtë arsye, i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) urdhëroi që ato të këputeshin.

Nëse ky rreth nuk është prej gjalmit të harkut apo nëse përdoret si fre apo kapistër për të drejtuar kafshën, atëherë nuk ka gjë po të përdoret, për shkak se nuk ka lidhje me besimin. Edhe asokohe njerëzit bënë shumë të tilla prej leshi ose ndonjë materiali tjetër.

- “... *në qafat e deveve* ...” – Ka përmendur devenë, sepse ajo ka qenë më e përhapura në atë kohë. Ky kufizim është bazuar në aktualitetin e atyre njerëzve, kështu që është thjesht shembull për ilustrim dhe jo e posaçme vetëm për kafshën në fjalë.¹

Disa dobi të hadithit:

- Prijësi i një vendi duhet të kujdeset për gjendjen e popullit të tij, duke qenë në dijeni të plotë për të.

- Ai duhet të kujdeset për ta, sipas asaj që e detyron Sheriati. Nëse ata veprojnë diçka të ndaluar, i ndalon ta bëjnë atë, e nëse neglizhojnë në kryerjen e detyrimeve, i nxit për t'i bërë ato.

¹ E njëjta gjë është edhe ajo që bëjnë njerëzit sot, duke vënë majmunë nëpër makina, patkonj mbi dyer, kallinj gruri ose vargje hudhrash. Të gjitha këto janë injorancë dhe të ndaluara, sepse njeriu mund të arrijë deri në shirkun e madh, nëse beson se vetë këto gjëra kanë mundësi për ta larguar të keqen.

- Ndalohet varja e gjërave të ndryshme në qafat e deveve, duke i konsideruar ato si shkaqe për arritjen e dobisë ose shmangien e dëmit, sepse ato nuk janë të tilla, as në aspektin fetar dhe as të vërtetuara nga përvoja, madje janë shirk. Nuk është kusht që varësja të jetë në qafën e kafshës, ajo mund të jetë edhe në gjymtyrë të tjera të saj dhe përsëri ka të njëjtin gjykim, sepse gjykohet varësja dhe jo vendi ku ajo vendoset.

- Ai që ka mundësi duhet ta ndryshojë të keqen me dorën e tij.

Ibn Mesudi transmeton, se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të thotë: “Me të vërtetë rukjet (yshtjet) që nuk përputhen me Sheriatin, temimet (hajmalit) dhe *tivele*-ja (diçka që bëhej me pretendimin se sillte dashuri) janë shirk.”¹

- “... *rukjet* ...” – Fjala në hadith nuk përfshin të gjitha rukjet, por vetëm ato që nuk janë përcjellë në Sheriat, ndërsa ato që janë përcjellë në Sheriat, nuk janë shirk. I Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë për suren “Fatiha”: “Ku e dije ti se ajo është rukje?”

Po çfarë nënkuptohet atëherë me “rukjet” në hadith: ato që nuk janë të përcjella në Sheriat, edhe sikur të jenë të lejuara, apo ato që janë shirk?

Mund të themi se nënkuptohen ato që janë shirk, sepse fjalët e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk kundërshtojnë njëra-tjetrën. Atëherë, rukjet që kanë ardhur të përcjella në Sheriat, si rukjet me lutje, që i lexohen të sëmurit dhe nuk përmbajnë shirk, janë të lejuara.

- “... *temimet* ...” – Autori i ka sqaruar ato vetë, kur thotë: “sende që u varen fëmijëve për t’i mbrojtur nga syri i keq”. Këto janë shirk, sepse Ligjvënësi (Allahu) nuk i ka bërë ato shkak për t’u mbrojtur nga mësyshi.

A lejohet që t’u veshësh fëmijëve rroba të vjetra e të rreckosura, nga frika e marrjes mësysh?

¹ Transmeton Ebu Daudi, Ahmedi.

Me sa duket, kjo është e lejuar, sepse këtu nuk po veprohet diçka, por thjesht po lihet diçka: zbukurimet. Ibn Kajimi ka përmendur në “*Zadul Mead*” se, njëherë, Othmani (*radiallahu anhu*) kur pa një djalë të bukur, tha: “Nxijani gropëzën e faqes!”

Po shkrimet nga Kurani, që mblidhen dhe vendosen në një lëkurë, qepen me rroba dhe u vendoset fëmijëve në dorë ose në qafë?

Në lidhje me këtë veprim ka mendime të ndryshme ndërmjet dijetarëve. Nga konteksti i hadithit duket se kjo lloj nuske është e ndaluar, nuk lejohet. Si kjo është edhe ajo që vepronë disa, të cilët shkruajnë të gjithë Kuranin në fletushka, e vendosin në një kuti të vogël e pastaj ua varin fëmijëve. Ky është bidat dhe nënçmim për Kuranin fisnik, se fëmijëve mund t’u rrjedhin jargë, mund të ndoten apo të futen me të në banjë a në vende të tjera të pista. E gjithë kjo është nënçmim për Kuranin.

Mirëpo për fat të keq, ka njerëz që i shohin disa ibadete vetëm në aspektin e begatisë. Disa njerëz fërkojnë *Ruknul Jemani*-n¹ e pastaj fërkojnë fytyrën ose gjoksin e fëmijëve. Kjo do të thotë se ata e kanë kthyer fërkimin e *Ruknul Jemani*-t mënyrë begatimi e jo adhurimi, por kjo është injorancë. Ndërsa Omeri (r.a.) ka thënë për Gurin e Zi të Qabes: “Unë e di se ti je vetëm një gur, që nuk bën as dëm, as dobi, dhe po të mos kisha parë të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të të puthte, nuk do të të puthja.”

– “... *tivele-ja* (diçka që bëhej me pretendimin se sillte dashuri) ...” – Kjo është diçka që ia varin bashkëshortit ose bashkëshortes, duke pretenduar se shtojnë dashurinë ndërmjet tyre. Ky veprim është shirk, sepse ai nuk është as shkak *sher’ij* dhe as shkak *kaderij* për arritjen e dashurisë.²

E ngjashme me të është edhe unaza, që blihet me rastin e martesës dhe që bashkëshortët e vendosin në dorë. Disa, duke besuar fatin apo tersin që vjen prej saj, thonë se po ta heqë njëri prej tyre, tjetri mendon se nuk e do më, ndërsa mbajtja e unazës

¹ Qoshe e Kabes nga drejtimi i Jemenit.

² Shkaku quhet *fetar* ose *sher’ij* kur efekti apo ndikimi i tij mësohet nga argumentet fetare, ndërsa, kur efekti, pasoja apo ndikimi i tij mësohet nga përvoja, provimi ose eksperimentimi shkencor, ai quhet *kaderij*.

tregon një lidhje të fortë e të qëndrueshme. Kjo lloj besëtytnie është shirk i vogël. Edhe nëse nuk mbahet me këtë qëllim – megjithëse kjo ndodh rrallë – vënia e unazës ka përngjasim me të krishterët, sepse kjo traditë është marrë prej tyre. Nëse unaza është prej floriri, dalim në një ndalesë të tretë, sepse për meshkujt nuk lejohet vendosja e floririt. Atëherë, mbajtja e unazës ose është pjesë e shirkut, ose përngjasim me të krishterët, ose e ndaluar për shkak të materialit – kur është fjala për burrat. Nëse nuk përmban asnjë nga elementët përkatës, atëherë ajo është e lejuar, sepse mbetet një unazë e thjeshtë.

– “... *janë shirk.*” – A është shirk i madh apo i vogël? Kjo varet sipas asaj që ka për qëllim njeriu. Nëse e përdor atë duke besuar se është Allahu që jep dashurinë, është shirk i vogël; nëse beson se ajo ndikon vetvetiu, atëherë është shirk i madh.

Abdullah Ibn Ukejmi, në një transmetim *merfun* tregon: “Ai që kapet pas diçkaje, lihet në mbështetjen e saj.”¹

– “... *Ai që kapet pas diçkaje ...*” – Pra, mbështetet tek ajo dhe e konsideron si qëllimin kryesor dhe kulmin e dijes së tij, duke e lidhur me të shpresën dhe largimin e frikës.

Ai që i mbështetet Allahut, i ka lidhur dëshirat dhe shpresat me Të dhe i frikësohet vetëm Atij; “Atij që i mbështetet Allahut, i mjafton Ai” (Talak, 3). Për këtë arsye, duaja e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe e shokëve të tij në vështirësi e fatkeqësi, ka qenë: “*HasbunAll-llahu ue nia’mel uekil*” (Na mjafton vetëm Allahu dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve!). Këtë fjalë e ka thënë edhe Ibrahimimi (‘alejhîs-selam) kur e hodhën në zjarr, si dhe Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e shokët e tij, kur hipokritët thanë: “Vërtet populli pagan kishte grumbulluar kundër jush (një ushtri të madhe), por kjo në të vërtetë vetëm ua shtoi besimin dhe thanë: ‘*HasbunAll-llahu ue nia’mel uekil.*’”

Llojet e mbështetjeve në diçka tjetër përveç Allahut:

¹ Transmeton Ahmedî dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i dobët.

- Mbështetja që mohon teuhidin në thelbin e tij. Ajo është lidhja pas diçkaje që nuk ka ndikim, duke u mbështetur tek ajo plotësisht dhe duke i kthyer shpinën Allahut. E tillë është lidhja e adhuruesve të varreve me të vdekurit, që, kur u bie ndonjë fatkeqësi, thonë: “O filan, më shpëto!” Ky, padyshim është shirk i madh, që të nxjerr nga feja.

- Mbështetje që cenon plotësinë e teuhidit. Kjo është mbështetja në një shkak fetar të saktë duke qenë i shkujdesur ndaj Allahut të Lartësuar i Cili ka vënë këtë shkak, dhe duke mos e drejtuar zemrën tek Ai. Ky është njëfarë shirku, e nuk themi se është shirk i madh, pasi shkakun është pohuar nga Allahu.

- Mbështetje që nuk bie ndesh me teuhidin, as me plotësinë e as me thelbin e tij. Kjo është lidhje me shkakun, thjesht si shkak, duke pasur mbështetjen bazë tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) dhe duke besuar se ky shkak është nga Allahu, e nëse do Ai, e bën të vlefshëm apo të pavlefshëm ndikimin e tij.

Edhe pse ka shkaqe të sakta, të ligjëruara në Sheriat, njeriu nuk duhet të mbështetet pas tyre, por të mbështetet tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala). Punëtori që e lidh plotësisht zemrën e tij me rrogën, duke qenë i shkujdesur ndaj Krijuesit të shkakut, i Cili është Allahu i Lartësuar, ka rënë në njëfarë shirku, por nëse beson se rroga është shkak dhe se Ai që e bëri të mundur e të efektshëm këtë shkak është Allahu i Lartësuar, mbështetja e tij është e pranueshme. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i vepronte shkaqet duke u mbështetur tek Ai që i krijon shkaqet dhe bën që ato të japin efekt.

Në hadith thuhet “kush kapet pas diçkaje ...” dhe nuk thuhet “kush varet”, sepse i kapuri pas diçkaje lidhet me zemrën dhe veten e tij, duke pasur frikën dhe shpresën në të, ndërsa ai që varet nga diçka, nuk është i tillë.

Temimet (hajmalit) janë sende që u varen fëmijëve për t’i mbrojtur nga mësyshi, ku përfshihen dhe nuskat. Por nëse nuskat përmbajnë vetëm pjesë nga Kurani, disa nga selefët i kanë lejuar, ndërsa disa të tjerë jo. Këta të fundit e kanë futur te gjërat e ndaluara, dhe prej tyre është Ibn

Mesudi (r.a.).

– “... Por nëse nuskat përmbajnë vetëm pjesë nga Kurani ...” – Këtu është fjala për rastin kur nuska përmban pjesë nga Kurani, lutje të lejuara ose *dhikër* të përcjellë në Sheriat.

Kjo çështje ka ngjallur polemikë ndër selefët. Një grup prej tyre e kanë lejuar, nisur nga fjala përgjithësuese e Allahut: “Dhe Ne kemi zbritur nga Kurani atë që është shërim e mëshirë për ata që besojnë...” (Isra, 82). Këtu nuk është përmendur mënyra se si arrihet shërimi me anë të Kuranit, dhe kjo tregon se çdo lloj mënyre përmes së cilës arrihet shërimi është e lejuar, njëlloj sikur Kurani të ishte ilaç material.

Një grup tjetër e ndalon këtë metodë duke thënë se nuk lejohet mbajtja e Kuranit për shërim, sepse shërimi me anë të Kuranit ka ardhur në një formë të caktuar, e cila është vetëm përmes leximit të tij. Kjo do të thotë që duhet t’ia lexosh atë të sëmurit, kësisoj format e tjera nuk lejohen. Nëse ne do ta bëjmë shërimin me Kuran në një formë që nuk është përcjellë, do të thotë se kemi vepruar një shkak të paligjshëm në Sheriat. Ndërkaq, autori (Allahu e mëshiroftël!) ka sjellë një dëshmi nga Ibn Mesudi (r.a.). Sikur të mos ishte ndjenja e brendshme se varja e Kuranit është shkak për shërim, do të ishte i qartë mohimi i kësaj forme si shkak, sepse veç mbajtja në vetvete nuk ka lidhje me sëmundjen, ndryshe nga fryrja në vendin e dhimbjes, e cila ka ndikim.

Prandaj, më afër së vërtetës është të thuhet se nuk duhet të varen ajetet kuranore si mjete shërimi, veçanërisht kur ai që i mban varur ato mund të veprojë gjëra që bien ndesh me shenjtërinë e Kuranit, si: përgojimi, futja në banjë etj. Por edhe nëse njeriu i var ato dhe ndjen se përmes tyre arrihet shërimi ato nuk duhen varur sepse kështu bëhet i panevojshëm leximi i Kuranit, që, në fakt, është i ligjshëm. Për shembull, dikush var në gjoksin e tij ajetin *Kursij* dhe thotë se nuk ka nevojë që ta lexojë atë, përderisa e ka në gjoks. Në këtë rast ai mjaftohet me një vepër të paligjshme kundrejt një veprë të ligjshme, dhe ndoshta e ndjen të panevojshëm leximin e ligjshëm të Kuranit, kur e ka atë të varur në gjoks. Gjithashtu, nëse kemi të bëjmë me fëmijë, ai mund të urinojë dhe lagështira mund të arrijë deri tek ajo që ka varur. Gjithashtu, nuk ka ardhur asgjë nga

i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) që të dëshmojë varjen e Kuranit. Prandaj, më pranë së vërtetës është të thuhet se duhet të mos veprohet një gjë e tillë. Megjithatë unë nuk mund të deklaroj se kjo gjë arrin gradën e haramit. Kur nuska përmban diçka të ndaluar, ajo bëhet haram për shkak të kësaj përmbajtjeje.

Rukjet quhen këndimet që i bëhen të sëmurit. Argumentet fetare veçojnë ato që nuk përmbajnë shirk, sepse i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka lejuar për kurimin e mësyshit dhe helmimit (**nga ndonjë kafshë helmuese**).

– “... Argumentet fetare veçojnë ato që nuk përmbajnë shirk.” – Do të thotë se ato që nuk përmbajnë shirk janë të lejuara, si formulat e përcjella: “Allahu me rraben-nas idh-habil-bas ue shfi Entesh-shaafi. La shifaa’e il-laa shifaa’uke shifaa’en laa jugaadiruhu sekama.” (O Zot i gjithë njerëzve, largoje dhimbjen dhe shëroje, sepse Ti je shërues dhe nuk ka shërim veç asaj që Ti shëron, shërim pas të cilit sëmundja nuk rikthehet!) dhe: “Allahume ishfihi ve aphihi” (O Zot, shpëtoje e shëroje!). Nëse në to ka shirk, atëherë nuk lejohet, si për shembull: “O xhind, më shpëto!”, “O filan i vdekur, shëroje atë!” etj.

– “... për kurimin e mësyshit dhe helmimit (nga ndonjë kafshë helmuese).” – Në temën “Kush realizon teuhidin, do të futet në Xhenet pa dhënë llogari” është përmendur përkufizimi i tyre. Ajo çka duket nga fjala e autorit tregon se argumentet fetare lejojnë rukjet vetëm për këto dy gjëra: mësyshin dhe helmimin. Mirëpo është përcjellë në raste të tjera se i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka fryrë në duart e tij, duke lexuar dy suret e fundit të Kuranit (Felek dhe Nas), para se të flinte, dhe fërkonte trupin me to sa më shumë të mundte. Kjo është një formë *rukjeje*, duke mos qenë as për mësysh dhe as nga helmimi. Prandaj disa nga dijetarët mendojnë se *rukja* me Kuran është e lejuar për mësyshin dhe helmimin, por edhe për raste të tjera në përgjithësi. Ata thonë se kuptimi i fjalës së të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) “nuk lejohet *rukja*, përveçse për mësyshin ose helmimin”, është se

kërkimi i *rukjes* lejohet vetëm në këto dy raste. Kështu, atij që ka marrë dikë mësysh i kërkohet t'i lexojë atij që e ka kapur syri; personi i kafshuar nga ndonjë kafshë helmuese, lejohet të kërkojë prej dikujt që t'i lexojë, sepse kjo ka rezultat, siç ka ardhur në hadithin e Ebu Seidit, në ngjarjen e kompanisë ushtarake.

Kushtet e lejimit të rukjes:

- Të mos besosh se ajo bën dobi vetvetiu, pa Allahun e Madhëruar. Nëse besohet një gjë e tillë, është haram, madje është shirk, por duhet të besohet se ajo është shkak që bën dobi veç me lejen e Allahut.

- Të mos jetë nga ato që bien në kundërshtim me Sheriatin, si: të përmbajë lutje të drejtuara dikujt tjetër veç Allahut ose të kërkojë ndihmë nga xhindët. Në këtë rast është haram, madje është shirk.

- Të jetë e kuptueshme dhe e njohur. Nëse është e pakuptueshme dhe e paqartë, nuk lejohet.

Për sa i përket *temime*-ve ku përfshihen edhe nuskat, kur këto të fundit përmbajnë gjëra të ndaluara, nëse besohet se ato bëjnë dobi vetvetiu apo nëse janë me shkrim të pakuptueshëm, nuk lejohen në asnjë mënyrë.

Nëse plotësohen tri kushtet e lartpërmendura të rukjes, dijetarët kanë mendime të ndryshme për lejimin apo jo të tyre, siç u përmend më lart.

Tivele është diçka që njerëzit e bëjnë, duke besuar se shton dashurinë e gruas për bashkëshortin e saj dhe anasjelltas.

Ahmedi përcjell nga Ruvejfiu, se i Dërguari i Allahut (sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem) i ka thënë: "O Ruvejfi, ndoshta do të kesh jetë të gjatë. Lajmëroji njerëzit se Muhamedi është i distancuar prej atij që e lidh mjekrën e tij, prej atij që vendos varëse prej gjalmit dhe prej atij që pastrohet (pas kryerjes së nevojës) me bajgat e kafshëve apo me kocka."¹

¹ Transmeton Ahmedi dhe Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

– “... *prej atij që e lidh mjekrën e tij ...*” – Arabët nuk e prisnin e as nuk e rruanin mjekrën, ashtu siç është edhe Suneti. Ata i lidhnin mjekrat e tyre për disa shkaqe, si për shembull, për mburrje dhe madhështi. Kishte nga ata që e lidhnin mjekrën, duke e kapur nga cepat e saj ose në mes, për t’u njohur si të mëdhenj apo si prijës të popullit. Shkak tjetër ishte ruajtja prej syrit të keq, sepse kur e lidhnin, mjekra dukej e shëmtuar. Ndaj Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u distancua nga ata që bëjnë të tilla gjëra.

Disa njerëz të thjeshtë, kur blinin ushqim në pazar, merrnin pak prej tij dhe e ngjyenin në tokë, për të shmangur marrjen mësysh. Ky lloj besimi është i gabuar dhe në kundërshtim me fjalën e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), i cili thotë: “Nëse dikujt prej jush i bie në tokë kafshata, le t’i largojë papastërtitë që ka marrë dhe le ta hajë.”¹

– “... *varëse prej gjalmi ...*” – Ky gjalmë apo spango përdorej në të kaluarën për të ndërtuar harkun. Disa i përdornin ato duke i vendosur në qafat e deveve, kuajve apo në qafat e veta, me pretendimin se ato largonin dëmtimin nga mësyshi. Kjo është pjesë e shirkut.

– “... *ose pastrohet me bajgat e kafshëve ...*” – Pra, pastrohet prej asaj që mbetet pas jashtëqitjes.

- “... *apo me kocka.*” – Kockat janë ushqim i xhindëve. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është distancuar nga ai që pastrohet me këto dy gjëra, sepse bajgat janë ushqim për kafshët e xhindëve, ndërsa kockat janë ushqim për vetë xhindët, që i gjejnë ato plot me mish. Çdo gjynah nga i cili është distancuar Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është nga gjynahet e mëdha, dhe kjo çështje është e njohur gjerësisht ndër dijetarët.

Pjesa e hadithit që dëshmon për çështjen në fjalë është: “... vendos varëse gjalmi...”.

¹ Muslimi.

Seid Ibn Xhubejri ka thënë: “Kur dikush i heq një njeriu një nuskë, është sikur të ketë liruar një skllav.” (Transmeton Uekiu)

Krahasimi ndërmjet heqjes së nuskës dhe lirit të një skllavi bëhet për arsye se kur dikush i heq nuskën një njeriu, është sikur ta ketë liruar atë nga shirku, dhe kështu e ka ndaluar nga Zjarri. Heqja e saj duhet bërë në mënyrën më të mirë, pasi vrazhdësia të çon në armiqësi dhe përçarje, përveç rastit kur ndryshuesi i së keqes është me pozitë: prijës, gjykatës etj. Këta kanë të drejtë t’ia heqin menjëherë.

Po nga Uekiu përcillet se Ibrahim¹ ka thënë: “I urrenin të gjitha *temime*-t (hajmalitë), qofshin të shkruara me pjesë nga Kurani ose diçkaje tjetër.”

Ne më parë thamë se ky ishte qëndrimi i Ibn Mesudit, por edhe shokët e tij mendonin të njëjtën gjë.

– “... *Ibrahimi* ...” – Bëhet fjalë për Ibrahim en Nuhaiun.

– “... *I urrenin* ...” – Cilët ishin këta që i urrenin ato? Këta ishin shokët e Ibn Mesudit, sepse ata kanë qenë bashkëkohësit e Ibrahim En Nuhaiut.

– “... *temime*-t ...” – Janë ato që varen mbi të sëmurin ose të shëndoshin apo tek kafshët, qofshin pjesë të Kuranit ose jo, për shërim ose për t’u mbrojtur nga mësyshi.

Ndërsa në këtë kohë, Kurani nuk po varet për shërim, por për bukuri dhe për të sjellë mbarësi, siç janë varëset e floririt, ose varëset në të cilat janë shkruar emrat e Allahut të Lartësuar, *ajeti Kursij* ose i tërë Kurani. Të gjitha këto janë bidate. Kurani nuk ka zbritur për shërim në këtë formë. Shërimi me anë të tij bëhet në atë mënyrë që është e ligjshme me Sheriat.

¹ Bëhet fjalë për Ibrahim Nuhaiun I cili ishte një tabiin.

| **Dobitë e temës**

- | ➤ Komenti mbi rukjet (yshtjet) dhe temimet (hajmalitë).

Siç u sqarua më lart.

- | ➤ Komenti mbi *tivele*-n.

Siç u sqarua më lart duke shtuar edhe çështjen e unazës, kur beson se ajo ka lidhje në marrëdhëniet burrë-grua.

- | ➤ Që të trija këto gjëra janë pjesë e shirkut, pa përjashtim.

Siç duket nga fjala e autorit, këtu përfshihen edhe rukjet, por kjo ka nevojë për shqyrtim, sepse nga i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është pohuar se i është bërë rukje dhe u ka bërë rukje të tjerëve, por ai nuk ka kërkuar që t’i bëhet rukje. Vetë autori ka përmendur se argumentet fetare kanë veçuar ato rukje që nuk përmbajnë shirk. Po kështu edhe për sa u përket *temime*-ve (ku përfshihen edhe nuskat), për këto të fundit, sipas mendimit të shumicës së dijetarëve është çështje që ka nevojë për shqyrtim. Ndërsa sipas mendimit të Ibn Mesudit, kjo është e saktë. E për sa i përket *tivele*-s (diçka që bëhej me pretendimin se sillte dashuri ndërmjet bashkëshortëve), ajo është shirk, pa diskutim.

- | ➤ Rukjet me fjalë të vërteta, kundër mësyshit ose helmimit nuk janë pjesë e shirkut.

E kundërta e fjalëve të vërteta janë fjalët e kota të rreme, po kështu edhe fjalët e panjohura, që nuk dihen në janë të vërteta apo jo. Autori (Allahu e mëshiroftë!) ka veçuar rastin e mësyshit ose helmimit duke u bazuar në fjalën e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Nuk lejohet *rukja*, me përjashtim të syrit ose helmimit”,

por e sakta është se ajo mund të përdoret edhe për raste të tjera veç këtyre të dyjave, si për shembull, për magjinë.

- Kur *temime*-t (hajmalitë) bëhen me pjesë nga Kurani, dijetarët kanë rënë në mosmarrëveshje: a janë të ndaluara apo jo,

Kjo u sqarua më lart. Më i sigurt është mendimi i Ibn Mesudit, sepse në parim kjo ndalohet, derisa të sqarohet nga Suneti.

- Vendosja e varëseve prej filli në qafat e kafshëve, për t'i mbrojtur ato nga syri i keq është pjesë e shirkut.

Vërejtje: Kohët e fundit ka dalë në shitje një hallkë bakri, për të cilën thonë se bën dobi për reumatizmen. Pretendohet se atij që vuan nga kjo sëmundje, po ta vendosë në krah, i bën mirë dhe e lehtëson. Nuk e di plotësisht a është e saktë kjo apo jo, por, parimisht, themi se nuk mund të jetë e saktë, përderisa nuk kemi ndonjë argument nga Sheriati apo nga shkencat që ta vërtetojnë këtë. Ajo nuk ndikon në trup, sepse nuk ka ndonjë lëndë, që të themi se trupi e thith atë dhe pastaj ka dobi prej saj. Parimisht kjo është e ndaluar, derisa të vërtetohet me argument të saktë e të qartë se metoda ka lidhje të drejtpërdrejtë me reumatizmen që të ketë dobi prej saj.

- Ata që vendosin varëse prej filli si mbrojtje nga syri i keq, paralajmërohen me dënim të ashpër.

Kjo, për shkak të distancimit të të Dërguarit (sal-IAllahu 'alejhi ue sel-lem) nga ai që e kryen këtë punë. Madje nga konteksti duket se është kufër që të nxjerr nga feja. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Dhe një shpallje e hapur nga Allahu dhe i Dërguari i Tij për mbarë njerëzimin në ditën më të madhe, se Allahu dhe i Dërguari i Tij janë të lirë (të distancuar) nga çdo detyrim ndaj idhujtarëve ..." (Teube, 3). Dijetarët (Allahu i mëshiroftë) thonë se me distancimin këtu nënkuptohet distancimi vetëm nga ky veprim. E ngjashme me këtë është edhe thënia e të Dërguarit (sal-IAllahu 'alejhi ue sel-lem):

“Nuk është prej nesh ai që na mashtron ne.”¹

- Vlera e madhe e shpërblimit për atë që i heq një nuskë dikujt.

Sipas dëshmisë së Seid Ibn Xhubejrit “është sikur të kishte liruar një skllav”. Po a është fjala e tij argument apo jo? Nëse thuhet se nuk është argument, atëherë pse e ka thënë ai këtë? Themi që e ka thënë për shkak se heqja e një nuske nga dikush, është shpëtim për të nga robëria e shirkut. Ai është si lirimi nga skllavëria, madje edhe më e madhe. Ky përfundim arrihet përmes krahasimit: kur dikush e shpëton një njeri nga shirku, është si ta kishte shpëtuar nga robëria, sepse ashtu e ka shpëtuar nga robëria e shejtanit dhe epshit.

- Fjala e Ibrahim Nuhaiut nuk bie ndesh me çka u tha për kundërshtimin midis dijetarëve, sepse ai ka pasur për qëllim bashkëmendimtarët e Ibn Mesudit.

Pra, qëllimi i tij nuk ishte për sahabët dhe tabiinët në përgjithësi.

¹ Muslimi.

Tema 9

Gjykimi i Sheriatit për kërkimin e bereqetit nëpërmjet një peme, një guri e të ngjashme me to.

Kërkimi i bereqetit mund të bëhet vetëm në dy mënyra:

E para, nëpërmjet një mënyre fetare të njohur, siç është Kurani: “Ky (Kurani) është një libër i begatshëm, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed).” (Sad, 29). Pjesë e begative të tij është se kush vepron me të, arrin fitore. Nëpërmjet tij, Allahu i Madhëruar ka shpëtuar shumë njerëz nga idhujtaria. Po kështu, ai është i begatshëm sepse një shkronjë e vetme e tij shpërblehet me dhjetë të mira, dhe kjo i kursen njeriut kohë dhe përpjekje. Kurani ka edhe plot begati të tjera.

E dyta, nëpërmjet një forme konkrete e të njohur, si: dija, lutja etj. Njeriu fiton begati përmes diturisë dhe ftesës së tij drejt së mirës. Kjo është begati, sepse përmes tyre arrihen mjaft të mira¹.

¹ Kërkimi i ligjshëm i bereqetit ka disa lloje:

Kërkimi i bereqetit me anë të fjalëve, punëve dhe formave të veprimit.

Ka disa fjalë, punë dhe forma veprimesh, nëpërmjet të cilave besmtari mund të arrijë begatinë nga Allahu, por ama me kusht që të jenë në përputhje me Sunetin dhe të mos ketë ndonjë pengesë.

Nga fjalët përmendim, për shembull, përmendjen e Allahut, leximin e Kuranit etj. Në lidhje me bereqetin dhe vlerën e dhikrit, Ebu Hurejra përcjell se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Melekët vijnë rotull nëpër rrugë duke kërkuar ata që bëjnë dhikër. Allahu i Madhëruar thotë: ‘Ju dëshmoj se Unë i fala ata.’ Një melek thotë: ‘Midis tyre është filani, që nuk është si ata, por ka ardhur për një nevojë.’ Allahu thotë: ‘Ata janë një grumbull, ku asnjë nga pjesëmarrësit në të nuk është i pafat.’” (Buhariu)

Pjesë e bereqetit të Kuranit është se: “Një shkronjë e vetme shpërblehet me dhjetë të mira.” Ebu Umamete el Bahilij përcjell se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Lexojeni Kuranin, sepse ai do të vijë në Ditën e Kijametit si ndërmjetësues për ta. Lexojeni “Zehrauejn”-in Bekare dhe Ali Imran, se shpërblimi i tyre do të vijë në Ditën e Kijametit si dy re, si dy hijelëshuese ose si dy grupe shpendësh që i dalin në mbrojtje lexuesve të tyre. Lexojeni suren ‘Bekare’, sepse leximi i sajë vazhdimisht dhe punimi me të është bereqet, kurse lënia e saj është dëshpërim (për shpërblimin që të ka humbur), ndërsa magjistarët nuk mundën ta lexojnë e të meditojnë në domethëniet e saj” (Muslimi) Nga bereqeti i Kuranit, është se ai është shërim për njerëzit, udhëzim dhe mëshirë.

Ndër punët që janë shkaqe për bereqet përmendim:

- Nxënia dhe dhënia e dijes. Kjo punë e ngre njeriun në dynja dhe ahiret.
- Falja e namazit me xhemat, gjë që ia shumëfishon shpërblimet dhe ia shlyen mëkatet.
- Kryerja e shtyllave të tjera të Islamit, pasi në veprimin e tyre ka bereqete të mëdha;
- Xhihadi në rrugë të Allahut, pasi nga begatitë e tij madhështore është rënia shehid (dëshmor).

Disa forma apo gjendje për kërkimin dhe arritjen e begatisë nga Allahu janë:

Grumbullimi rreth ushqimit, ngrënia në anët e enës, lëpirja e gishtave, matja e ushqimit. Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Grumbullohuni rreth ushqimit dhe përmendni emrin e Allahut që të begatoheni në të.” (Ahmedi, Ebu Daudi, ndërsa Albani thotë se hadithi është i mirë) “Bereqeti zbret në mesin e ushqimit. Hani në anët e tij e mos hani në mesin e tij.” (Ahmedi, Ebu Daudi, Ibn Maxhja, Albani thotë se hadithi është i saktë) Ai (salallahu alejhi ue selem) ka urdhëruar lëpirjen e gishtave duke thënë: “Ai nuk e di se ku është bereqeti.” (Ahmedi) “Mateni ushqimin që të begatoheni në të.” (Buhariu)

Çdo fjalë ose vepër që ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i tij – kur e kryen me sinqeritet dhe duke pasuar Sunetin e Profetit (salallahu alejhi ue selem) – bëhet shkak për bereqet.

Kërkimi i bereqetit nëpërmjet vendeve të veçanta.

Në disa vende të caktuara Allahu ka vendosur bereqet, por kushti i arritjes së begatisë në to është që punët të kryhen në to me sinqeritet dhe në përputhje me Sunetin. Ndër këto vende janë xhamitë, bereqeti i tyre është për shkak të faljes së namazeve, i itikafit e të tjera gjëra të ligjshme. Nga ana tjetër, nuk bën të fërkosh muret dhe dheun e tyre, ngase këto janë gjëra të ndaluara. Ka xhami që janë më të bereqetshme se të tjerat, dhe ato janë: Mesxhidul Haram (Kabja), Mesxhidun Nebij (xhamia e Profetit në Medine) dhe Xhamia Aksa (në Palestinë). Një namaz në xhaminë e Kabes është sa 100 000, në Xhaminë e Profetit sa 1000 dhe në Xhaminë Aksa sa 250 namaze që falen në xhami të tjera veç tyre. Vende të tjera të begatshme janë: Meka, Medine dhe Shami. Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Ibrahimi e bëri të shenjtë Mekën dhe bëri duá për banorët e saj, kurse unë e bëra të shenjtë Medinen, ashtu siç e bëri Ibrahimi Mekën dhe unë kam bërë lutje për *sain* (njësinë matëse) dhe grushtin e banorëve të Medines, ashtu sikur bëri Ibrahimi duá për banorët e Mekës.” (Transmeton Muslimi). Po kështu ka thënë: “Atë që dëshiron të keqen për banorët e saj, e shkruftë Allahu siç shkrin kripa në ujë.” (Transmeton Muslimi) “Mirësia (tuba) qoftë për Shamin.” I thamë: “E përse?” Tha: “Sepse melekët e Mëshiruesit shtrijnë krahët e tyre mbi të.” (Ahmedi, Hakimi)

Kush banon në Mekë, Medine ose Sham, duke kërkuar prej Allahut bereqetin që është në to – për të cilin ka lajmëruar i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) – i është dhënë sukses në një mirësi të madhe, ndryshe nga ata që e kërkojnë atë në fërkimin e dheut, mureve dhe pemëve, apo në gjëra të tjera që nuk janë përcjellë në Sheriat, të gjitha këto janë bidate.

Po kështu, vendet ku kryhen ritet e haxhit, si: Arafati, Muzdelifeja dhe Minaja. Ato janë vende të begatshme, sepse për shkak të qëndrimit dhe kryerjes së riteve në to besimtarit i falen gjynahet dhe merr shpërblime të mëdha, por me kusht që të respektohet tradita e Profetit për sa i përket, vendit dhe kohës së qëndrimit dhe formës së kryerjes së riteve.

Kërkimi i bereqetit në kohë të veçanta.

Ka disa kohë që Sheriati i ka veçuar me më shumë mirësi dhe bereqet, si: muaji i Ramazanit, me agjërimin falen gjynahet, bëhet më i bollshëm rrizku dhe mjetet e jetesës për besimtarin etj.; nata e Kadrit, dhjetë ditët e para të muajit Dhul'hixhe, dita e Xhuma, 1/3 e fundit e natës, e të tjera. Kërkimi i bereqetit prej Allahut në këto kohë, arrihet duke ndjekur udhëzimet e të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem).

Kërkimi i bereqetit në ushqime dhe kafshë.

Nga ushqimet nëpërmjet të cilave kërkohet bereqeti janë:

Vaji i ullirit: “Hani vajin e ullirit dhe lyhuni me të, sepse ai është prej pemës së begatshme.” (Ahmedi, Hakimi);

Qumështi: Përcillet nga Aishja se Profeti (salallahu alejhi ue selem), kur i sillej qumësht thoshte: “E sa ka në shtëpi, një apo dy bereqete?” (Ahmedi)

Fara e Zezë, e cila është shërim për çdo sëmundje me përjashtim të vdekjes, siç ka thënë për këtë i Dërguari (salallahu alejhi ue selem).

Uji i Zemzemit, i cili është i begatshëm dhe ushqim për atë që do të ushqehet.

Pema e hurmës: “Është një pemë, bereqeti i së cilës është si bereqeti i muslimanëve.” (Buhariu)

Nga kafshët përmendim kalin: “Mirësia qëndron në balluket e kalit (për qëllim është kali që mbahet për luftë në rrugë të Allahut dhe nuk është qëllimi për çdo lloj kali) deri në Ditën e Kiametit.” (Buhariu)

Kërkimi i bereqetit nëpërmjet këtyre gjëra, bëhet ashtu siç është urdhëruar në Sheriat, pa i tejkaluar të ligjshmet dhe të lejuarat.

Së fundi, duhet theksuar se gjërat e mësipërme janë thjeshtë shkaqe për begatim, për arritjen e bereqetit. Krijuesi dhe dhuruesi i bereqetit është vetëm Allahu.

Disa prej mënyrave të ndaluara të kërkimit të bereqetit janë:

- *Kërkimi i bereqetit nëpërmjet vendeve të begatshme në kundërshtim me Sheriatin, si puthja e xhamive, fërkimi i shtyllave, kërkimi i shërimit nëpërmjet dheut të tyre, fërkimi i mureve të Kabes ose të mekami Ibrahimit, etj.*

- Vizita e varrezave për të bërë dua tek ato, për shkak të bereqetit dhe besimit se duaja në to është më e vlefshme.

- Kërkimi i afrimit tek Allahu, duke u falur në vendet ku i Dërguari i Allahu (salallahu alejhi ue selem) vërtet është falur gjatë udhëtimeve, etj, por jo duke pasur për qëllim veçimin e tyre. Këtu futen të gjitha ato vende që lidhen me ngjarjet që i kanë ndodhur Profetit

Usejd Ibn Hudejri ka thënë njëherë: “Nuk është kjo begatia juaj e parë, o familja e Ebu Bekrit!” Përmes disa njerëzve, Allahu përmbush disa të mira që nuk i realizon nëpërmjet të tjerëve.

Nga ana tjetër, ka disa forma mashtruese e të kota të ardhjes së begatisë, siç janë ato që mëtojnë ca sharlatanë, si për shembull: filani i vdekur është njeri i mirë, prandaj ju ka sjellë gjithë këto begati, e të ngjashme si kjo. Këto lloj formash janë të rreme dhe nuk kanë ndikim. Ndoshta në të tilla raste ka dorë shejtani, duke bërë që njeriu të ndiejë ndonjë rezultat, si “ndihmë” nga shejtani, e duke shkaktuar kështu një sprovë të madhe.

E për sa i përket dallimit të begative të rreme apo të vërteta që vijnë për shkak të një personi, ky arrihet duke parë gjendjen e personit. Nëse është vërtet nga evlijatë e Allahut, nëse është prej eulijave të Allahut të devotshëm, pasues i Sunetit dhe i larguar nga bidati, atëherë Allahu përmbush nëpërmjet tij të mira dhe begati që nuk arrihen nga të tjerët. Një nga këto begati është ajo që Allahu

(salallahu alejhi ue selem) si: shpella Hira, shpella e Theurit, beteja e Bedrit, vendi i pemës Bejatu Riduan, etj.

- Kërkimi i bereqetit në kohët e begatshme, si: muaji i Ramazanit, Nata e Kadrit, dita e Xhuma etj, duke bërë vepra të ndaluara. Kërkimi i begatisë në një kohë të caktuar, apo vend të caktuar duhet të bëhet vetëm me ibadete të ligjshme.

- Veçimi i kohëve të caktuara me madhërim, festë dhe adhurim si: ditëlindja e Profetit (salallahu alejhi ue selem), nata e Israsë dhe Miraxhit, dita e Emigrimit, dita e Bedrit, çlirimi i Mekës etj. Kërkimi i mirësisë në këtë mënyrë është bidat (shitesë në fe).

- Kërkimi i bereqetit duke prekur trupat e njerëzve të mirë dhe duke përdorur gjurmët e tyre. Nuk ka asnjë dëshmi prej fesë që ndonjëri të ketë kërkuar bereqet duke përdorur ujin e avdesit, djersën apo rrobat e Ebu Bekrit, Umerit, Uthmanit apo Aliut (radij-Allahu ‘anhum). Sahabët kërkonin bereqet (prej Allahut) duke përdorur ujin e avdesit të të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem), trupit, djersës, pështymës, flokëve dhe rrobave të tij. Kjo ka qenë e veçantë për të dhe nuk lejohet të krahasohet me të askush prej njerëzve të mirë, qoftë edhe katër prijësit e udhëzuar (Hulefa err-Rrashidin), apo dhjetë të përgëzuarit me Xhenet, për të mos diskutuar pastaj për të tjerët.

Kërkimi i bereqetit është adhurim, prandaj ai duhet të bazohet vetëm në argumentet e transmetuara nga Profeti (salallahu alejhi ue selem).

Shënim: Nëse ndonjëri i përdor a i kryen format e paligjshme të kërkimit të bereqetit thjeshtë si shkaqe, duke mos besuar se ato e japin vetë bereqetin, atëherë ai ka bërë diçka të ndaluar, ose shirk të vogël që nuk e nxjerr nga Islami, e nëse i përdor apo i kryen, me besimin se ato e japin vetvetiu begatinë, atëherë bën shirk të madh që e nxjerr nga feja.

realizoi me anë të shejhut të Islamit Ibn Tejmijes, nga i cili njerëzit përfituan si kur ishte gjallë, ashtu edhe pas vdekjes së tij. Nga ana tjetër, nëse është kundërshtues i Kuranit e Sunetit dhe fton tek e kota, “e mira” që vjen prej tij është iluzion. Ndoshta atë ia përgatisin shejtanët, për ta ndihmuar në rrugën e keqe të tij. E tillë është ajo që ndodh me disa që qëndrojnë me njerëzit në Arafat, pastaj shkojnë në vendin e tyre dhe bëjnë kurban me njerëzit e vendit të tyre. Shejhu i Islamit Ibn Tejmije ka thënë se ata i mbajnë shejtanët me qëllim që njerëzit të mashtrohen prej tyre. Për pasojë, këta kanë rënë në vepra të ndaluara si: mosplotësimi i haxhit apo moskalimi në gjendjen e *muhrim*-it.¹

– “... një peme ...” – Kjo fjalë përfshin çfarëdolloj peme. Nga të mirat e prijësit të besimtarëve Omer Ibn Hatabit (r.a.), është se kur ai e pa që njerëzit po e vizitonin shpesh pemën nën të cilën u bë *Besëlidhja e Kënaqësisë*, urdhëroi që ajo të pritet.

– “... një guri ...” – Termi përfshin çdo lloj guri, qoftë edhe gurin e xhamisë Aksa, nga i cili nuk duhet të pritet begati. Po kështu, edhe nga *Guri i Zi* në Kabe, nuk duhet të kërkohet mirësi. Me prekjen dhe puthjen e tij realizohet një adhurim ndaj Allahut, si dhe një traditë e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe rrjedhimisht fitohet mirësia e shpërblimit për këtë vepër. Prandaj Omer Ibn Hatabi (r.a.) tha: “Unë e di se ti je vetëm një gur, që nuk sjell as dëm e as dobi, e sikur unë të mos kisha parë të Dërguarin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të të puthte, nuk do të të puthja.” Pra, puthja e tij është thjesht një rit, ndryshe nga ç’veprojnë disa njerëz të thjeshtë që mendojnë se ai sjell begati në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndaj kur e prekin, fërkojnë të gjithë trupin, për t’u “begatuar” me të.

– “... e të ngjashme me to.” – Kjo nënkupton shtëpitë, kubetë dhe gurët, qoftë edhe dhomën e varrit të Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), e cila nuk duhet të fërkojë për begati. Por nëse fërkon, për shembull, hekurin rrethues për të parë se a është i lëmuar apo jo, kjo nuk ka ndonjë gjë të keqe, vetëm nëse ekziston droja se mos

¹ Veshja e ihramit dhe ndalimi nga disa gjëra të caktuara si: parfumosja, mbulimi i kokës për burrat etj.

të tjerët të ndjekin si shembull.

Allahu i Madhëruar thotë: “A e keni parë Latin dhe Uzën? Po Menatën,¹ të tretën, të fundit? Vallë, për ju janë djemtë, ndërsa, për Atë (Allahun) vajzat?! Kjo ndarje është e padrejtë. Këta janë vetëm emra që ua keni ngjitur (idhujve) ju dhe të parët tuaj, kurse Allahu nuk ju ka dërguar për ata ndonjë provë. Ata ndjekin vetëm hamendjet dhe atë që ua ka qejfi, ndonëse u ka ardhur prej Zotit të tyre udhëzim.” (Nexhm, 19-23)

Pasi Allahu përmend që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) pa disa nga shenjatat e Tij: “Vërtet ai (Muhamedi) pa disa nga shenjatat madhështore të Zotit të tij!” thotë: “A e keni parë Latin dhe Uzën? Po Menatën, të tretën, të fundit.” Pra: më tregoni Mua, si janë ata idhuj përpara këtyre shenjave të mëdha? Ata janë asgjë. Pyetja në ajet është e formës që tregon nënçmim dhe urrejtje për këto idhuj.

– “... *Latin* ...” – Lati ka qenë një idhull. Origjina e tij, sipas një leximi të Kuranit, ka qenë një burrë që u jepte ujë dhe ushqente haxhinjtë. Kur ai vdiq, ata shkonin e vinin tek varri i tij dhe gradualisht e kthyen në idhull. Sipas një leximi tjetër, emri i tij është nxjerrë nga emri *Allah* ose *Ilah*. Pra, ata kanë nxjerrë nga emrat e Allahut një emër për këtë idhull dhe e kanë emërtuar atë *Lat*. Ky idhull adhurohej nga banorët e Taifit dhe arabët rrotull tyre.

– “... *Uzën*” – Ky ka qenë një idhull që adhuronin kurejshët dhe fisi Benu Kinane. Emri i tij është nxjerrë nga emri i Allahut “*El Aziz*” dhe ndodhej në Nahle, ndërmjet Mekës dhe Taifit.²

– “... *Menatën* ...” – Ky emër është nxjerrë nga emri i Allahut “*El*

¹ Lati, Uza dhe Menata kanë qenë tre idhuj të arabëve paganë.

² Ibn Xheriri për Uzën ka thënë se ka qenë një pemë e rrethuar me mur dhe perde, ndërmjet Mekës dhe Taifit, të cilën kurejshët e madhëronin. Thuhet gjithashtu se ka qenë një pemë hurme (palme) mbi të cilën varnin rrobat. Mendo veprimin e idhujtarëve me këtë idhull dhe krahasoje me ato që bëjnë sot shumë adhurues varresh, si: lutje, therje kurbanit, e të tjera adhurime tek tyrbet (Tejsirul Azizil Hamid).

Menan” (Begatuesi). Po ashtu thuhet se e kanë quajtur me këtë emër për shkak të gjakut të shumtë që idhujtarët derdhnin tek ai. Këtë emër ka marrë edhe Minaja, për shkak të gjakut të madh që derdhet atje gjatë prerjes së kurbaneve të haxhit.

Ky idhull ka qenë ndërmjet Mekës dhe Medinës. Ai ishte idhulli i fisit Hudhejl dhe Huza. Atë e madhëronin edhe fiset Aus dhe Hazrexh, të cilët tek ai nisnin *tebije*-n e haxhit.¹

– *“Menatën, të tretën, të fundit.”* – Fjala këtu është për idhullin që arabët madhëronin dhe për të cilin thernin kurban; rrotull tij derdhej shumë gjak. Ai quhet “i fundit” për ta nënçmuar.

Pra këta tre idhuj të arabëve, ç’vlerë kanë ata përkundrejt mrekullive të mëdha që pa Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem)? Asgjë.

Allahu i ka përmendur këta tre idhuj, për shkak se ata kanë qenë më të njohurit dhe më të mëdhenjtë ndër arabët.

– *“... Vallë, për ju janë djemtë, ndërsa për Atë vajzat?! ...”* – Këtu pyetja shpreh mohim ndaj idhujtarëve, të cilët i mveshin Allahut vajzat, ndërsa për vetet e tyre djemtë. Kur ndonjërit prej tyre i lindte djalë, kënaqej e gëzohej me të, e nëse i lindte vajzë, nxihej në fytyrë dhe përbrenda mbushej plot hidhërim. Ata thoshin se melekët janë bijat e Allahut, pra bijat ia mvishnin Allahut – Allahu na ruajtë! – ndërsa për vetet e tyre zgjidhin çfarë u pëlqente.

– *“... Kjo ndarje është e padrejtë. ...”* – Sepse më e pakta, nëse doni të bëni ndarje, është të pranoni për vete vajzat, ndërsa për

¹ Ibn Is’haku, në sira, thotë: “Përveç Kabes, arabët kishin edhe tagutë (idhuj, tyrbe) dhe shtëpi të tjera që i nderonin ashtu siç nderonin Kaben. Këto tyrbe e këto shtëpi ishin të veshura me perde dhe kishin edhe shërbëtorë. Idhujtarët dhuronin dhe thernin kurbane pranë tyre, ashtu siç bëhen kurbane në Mekë. Ata bënin tavaf rreth tyre dhe thernin kurbane pranë tyre edhe pse e dinin se Kabja ishte më e vlefshme. Në atë kohë dihej që Kabja është shtëpia që ndërtoi Ibrahim (alejhi selam) dhe se ajo ka qenë xhamia e tij”. Pikërisht, këto forma idhujtarie tek arabët, të cilat i përmend Ibn Is’haku, i bëjnë edhe adhuruesit e sotëm të varreve, madje edhe më tepër. Sipas shpjegimit të Kurtubiut, kuptimi i ajetit është kështu: ‘Këtu ka pjesë të pathëna, por që nënkuptohen: A i keni parë këta idhuj? A kanë bërë ata ndonjë dobi ose dëm që të jenë bashkëpunëtorë (ortakë) me Allahun?’ (Tejsiril Azizil Hamid).

Allahun djemtë. Por ju, për veten tuaj zgjidhni ata që ju pëlqejnë, djemtë, ndërsa ato që i urreni, vajzat, ia mvishni Allahut. Kjo është ndarje e padrejtë.

– “... *Ata janë vetëm emra që ua keni ngjitur (idhujve) ju dhe të parët tuaj, kurse Allahu nuk ju ka dërguar për ata ndonjë provë. ...*” – Kjo do të thotë se këta idhuj, të cilët i keni quajtur hyjni e që i adhuroni, nuk janë tjetër, por veçse emra që ju ua keni vënë vetë. Allahu nuk ka zbritur për ta asnjë provë dhe argument. Madje Allahu i ka bërë të pavlefshëm duke thënë: “Kjo është kështu, sepse Allahu është i Vërteti, kurse gjithçka që lusin përveç Tij është e pavërteta. Dhe padyshim Allahu është i Lartësuarit dhe i Madhërishmi.” (Haxh, 62).

– “... *Ata ndjekin vetëm hamendjet ...*” – Ata hamendësonin kur thonin se ata ishin hyjni, apo kur thonin se Allahu ka vajza, ndërsa ata djem. Padyshim, hamendja nuk vlen aspak ndaj së vërtetës siç thotë Allahu në një ajet tjetër.

– “... *dhe atë që ua ka qejfi ...*” – Ata ndjekin çfarë dëshirojnë, dhe kjo është gjëja më e dëmshme për njeriun. Njeriu që adhuron Allahun me epsh, në realitet nuk adhuron Allahun, por logjikën dhe dëshirat e tij: “A e ke vënë re atë njeri që dëshirat e veta i mori për Zot? Dhe Allahu, duke e ditur (atë si të tillë) ia humbi rrugën ...” (Xhathijeh, 23). Ndërsa ai që e adhuron Allahun sipas udhëzimit, e jo sipas dëshirave, është në të vërtetën.

– “... *ndonëse u ka ardhur prej Zotit të tyre udhëzim.*” – Domethënë, udhëzimi që erdhi me Muhamedin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Prandaj për ta do të ishte më e vlefshme të ndiqnin udhëzimin dhe jo dëshirat e tyre.

Lidhja e ajetit me temën në fjalë qëndron në faktin se ata besonin që këta idhuj u sillnin dobi dhe dëm, prandaj shkonin tek ata, u luteshin, bënin kurban e të tjera gjëra, që t’u afroreshin atyre. Ndoshta Allahu e provon ndonjë duke bërë që ai të arrijë atë që dëshiron në shmangien e së keqes ose arritjen e së mirës nëpërmjet

këtij shirku. Ne kemi përmendur edhe më parë çështje të tilla kur Allahu e provon ndonjë me lehtësimin e shkaqeve të mëkatit, kjo që të dallohet ai që i frikësohet Atij në fshehtësi.

Ebu Uakid el Lejthi ka thënë: “Dolëm me të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në Hunejn. Në atë kohë, ne sapo kishim dalë nga kufri. Idhujtarët kishin një pemë që i thuhej Dhatu Enuat, tek e cila qëndronin dhe varnin armët e tyre. Kur kaluam pranë një peme, ne i thamë: ‘O i Dërguari i Allahut, na përcakto edhe ne një “Dhatu Enuat”, siç e kanë ata.’ Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u përgjigj: ‘Allahu Ekber! Vërtet këto janë rrugë (që morën njerëzit para jush). Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, keni thënë diçka të ngjashme me atë që tha populli i Musait: “Na bëj edhe ne një zot, ashtu siç kanë edhe ata zotat e tyre. Ju jeni një popull i paditur.” (El Araf, 136) Edhe ju do të ndiqni rrugët e atyre para jush.”¹

– “... *Dolëm me të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ...*” – Kjo ndodhi pas çlirimit të Mekës kur fisi Thekif dhe Heuazin u bashkuan me një ushtri të madhe kundër Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u nis kundër tyre me 12000 vetë. 2000 ishin nga banorët e Mekës dhe 10000 erdhën nga Medina. Kur panë këtë numër të madh, besimtarët thanë se tani nuk do t’i mundnin armiqtë që ishin më pak, duke u gëzuar me numrin e madh në radhët e veta. Mirëpo Allahu sqaroi se fitorja vjen prej Tij dhe jo prej shumicës: “Në të vërtetë, Allahu ju ka ndihmuar në shumë beteja, si dhe në luftën e Hunejnit, kur juve ju mahniti numri juaj i madh, por ai numër nuk ju solli dobi aspak. Toka ju duk e ngushtë edhe pse është e gjerë, dhe kthyet shpinën duke ia mbathur.” (Teube, 25). Pasi zbritën në

¹ Transmeton Ahmedi dhe Tirmidhiu, hadithi është i vërtetë. Edhe sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

luginën e Hunejnit, besimtarët panë se idhujtarët kishin ngritur një kurth, dhe pastaj ndodhi ajo që ndodhi. Muslimanët u përçanë, u larguan nga i Dërguari i Allahut e me të mbetën vetëm 100 burra. Megjithatë, në fund fitorja që për Pejgamberin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), dhe për këtë falënderimi i takon Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala).

– “... *Ne sapo kishim dalë nga kufri ...*” – Ky sahab (radijAllahu ‘anhu) e ka thënë këtë për të justifikuar kërkesën e tyre. Po të kishin besim të fortë në zemrat e tyre nuk do të kishin kërkuar assesi këtë gjë.

– “... *varnin ...*” – Ata varnin armët e tyre për t’u sjellë fat.

– “... *i thuhej Dhatu Enuat. ...*” – Është emërtuar kështu për arsye se në të vareshin armët duke shpresuar fat prej saj. Sahabët i kërkuan Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) t’i përcaktonte edhe atyre një pemë si të idhujtarëve, që të varnin armët e tyre atje për mbarësi.

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: “*Allahu Ekber*”, për shkak të përmasave të mëdha të kësaj kërkesë dhe nga habia, dhe jo nga gëzimi. Ai u çudit se si ata mund ta thonin këtë fjalë, ndërkohë që kishin besuar se nuk ka të adhuruar me të drejtë, përveç Allahut. Por “*vërtet këto janë rrugë*” – pra, rrugë që i ndjekin njerëzit.

– “... *Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, tani keni thënë diçka të ngjashme me atë që tha populli i Musait: ‘Na bëj edhe ne një zot, ashtu siç kanë edhe ata zotat e tyre ...*” – I Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e krahasoi atë që thanë sahabët me atë që benu Israilët i thanë Musait: Na bëj edhe ne një zot ashtu siç kanë edhe ata zotat e tyre. Pra, ju kërkuat një “Dhatu Enuat” ashtu si Dhatu Enuati i idhujtarëve.¹

¹ Pra, ajo që kërkuan prej tij (përcaktimi i një peme për të qëndruar tek ajo dhe për të varur armët mbi të për bereqet) ishte si rasti i Beni Israilëve, që kërkuan nga Musai t’u sajonte edhe atyre një zot, siç kishin paganët zotat e tyre. Shndërrimi i pemës në vend *itikaf* (duke qëndruar pranë saj për adhurim) dhe varja e armëve tek ajo, u quajt si i

– “... *Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im ...*” – Këtu kuptohet se shpirti i tij është në dorën e Allahut, jo thjesht në aspektin e vdekjes dhe të jetës, por edhe në aspektin e rregullimit të çështjeve dhe veprimit, si të dëshirojë Ai, pasi çdo gjë ndodhet nën sundimin e Tij të plotë.

– “... *ju do të ndiqni rrugët e atyre para jush.*” – Pra, do të veproni siç vepruan popujt e mëparshëm dhe do të thoni siç kanë thënë ata. Me këtë shprehje, nuk nënkuptohet miratimi i këtij veprimi, por paralajmërimi. Kjo, pasi dihet se rrugët e atyre që kanë qenë para

adhuruar krahas Allahut, edhe pse ata nuk kishin ndërmend ta adhuronin dhe të kërkonin gjë prej saj. Atëherë çfarë mendon për atë që bëjnë adhuruesit e varreve, duke lutur të vdekurit, duke kërkuar shpëtim prej tyre, duke therur e premtuar për ta, duke bërë tauaf rrotull tyre, duke i puthur ato dhe muret e pragjet, duke u fërkuar pas tyre, duke bërë *itikaf*, duke vendosur shërbëtorë dhe perde (mbulesa)? A mund të krahasohet kjo që bëjnë këta me kërkesën për varjen e armëve për bereqet? Nga kjo shprehje del se besimi në pemët, gurët e varret, duke kërkuar bereqet prej tyre, duke bërë *itikaf* dhe duke therur për to, është shirk. Nuk duhet të mashtrohemi me njerëzit e rëndomtë dhe masën. Të qenët e kësaj gjëje shirk, nuk është aspak e largët dhe do të ndodhë në këtë umet. Përderisa disa nga sahabët menduan se do të ishte e mirë që Pejgamberi të plotësonte dëshirën e tyre, aq sa Pejgamberit iu desh t'i sqaronte, atëherë ç'do të ndodhë me të tjerët pas tyre, kur sundon padituria dhe njerëzit janë larg gjurmëve profetike? Për sa i përket çështjes së rregullave, në konsideratë merren domethëniet e jo emërtimet që mund të kenë ato. Prandaj dhe i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) e konsideroi kërkesën e tyre si kërkesa e beni Israilëve dhe nuk i dha rëndësi emrit *Dhatu Enuat* që përdorën ata (për varjen e armeve për bereqet). Idhujtari, edhe pse mund ta emërtojë shirkun e tij me çfarëdolloj emri – siç quajnë lutjen e të vdekurve, therjen, prerjen e kurbanit për to e të tjera – veprimi mbetet po idhujtari, pavarësisht nga emri. Po kështu kuptojmë se ai që adhurohet është *ilah* (i adhuruar), sepse beni Israilët dhe sahabët nuk kishin qëllim (nga idhujt dhe pema) krijimin dhe rrizkun, por bereqetin dhe *itikafin*. Pikërisht kjo ishte bërja e të adhuruarve të tjerë me Allahun (subhanehu ue tealà). Po kështu, nxjerrim se domethënia e fjalës *ilah* është i *adhuruar* dhe se një person që do të bëjë një vepër shirku, nga injoranca, kur ndalohet dhe nuk e vepron atë, nuk konsiderohet kafir. Megjithëse kjo çështje është shumë e imtësishme, sa që këta sahabë nuk arritën ta kapin dot, ajo bie ndesh me fjalën “la ilahe il-Allah”. Atëherë, ç’mund të thuhet për gjëra të tjera më të mëdha sa kjo? Këto dobi të hadithit e ka nxjerrë autori. Gjithashtu, këtu ka kundërpërgjigje ndaj injorantëve që mendojnë se domethënia e fjalës “la ilahe il-Allah” është vetëm pohimi se Allahu është krijues i gjithçkaje dhe se gjithçka tjetër veç Tij është krijesë, e shprehje të tjera të ngjashme që i përkasin vetëm tehidit rrububije. Dobi tjetër që del nga kjo ndodhi është qëndrimi i ashpër ndaj atyre që kanë rënë në këtë gabim nga injoranca. (Marrë nga “Tejsirul Azizil Hamid”).

nesh e që janë imituar, janë rrugë të humbura, sepse ata kanë kërkuar të adhuroar të tjerë me Allahun. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) deshi të paralajmëronte umetin e tij, që të mos ndiqnin rrugët e atyre që kanë qenë më përpara në humbje dhe devijim.

Pjesa e hadithit që dëshmon për çështjen në fjalë është: “O i Dërguari i Allahut, na përcakto edhe ne një Dhatu Enuat, siç e kanë ata.” Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) shprehu kundërshtimin e tij ndaj kërkesës së tyre.

■ **Dobitë e temës**

■ ➤ Komenti i ajeteve të sures Nexhm.

Allahu thotë: “A e keni parë Latin dhe Uzën? (dy idhuj të arabëve paganë)? Po Menatën, të tretën, të fundit ...”; “Vallë, për ju janë djemtë, ndërsa, për Atë (Allahun) vajzat?! Atëherë kjo ndarje është e padrejtë. Ata janë vetëm emra që ua keni ngjitur (idhujve) ju dhe të parët tuaj, kurse Allahu nuk ju ka dërguar për ata ndonjë provë. Ata ndjekin vetëm hamendjet dhe atë që ua ka qejfi, ndonëse u ka ardhur prej Zotit të tyre udhëzim.” Këto ajete u komentuan më parë dhe u tha se Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) i kundërshtoi ata që adhuronin Latin dhe Uzan. Ajeti ka ardhur me fjali pyetëse, formë që tregon poshtërim dhe nënçmim për ata idhuj.

■ ➤ Njohja e mënyrës se si ata e shtruan kërkesën.

Ata kërkuar nga i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) t’u përcaktonte një pemë, siç kishin edhe idhujtarët. Ata patën si qëllim të kërkonin bereqet nëpërmjet kësaj peme dhe jo për ta adhuroar. Kjo tregon se kërkimi i mbarësisë me anë të pemëve është i ndaluar dhe se kjo është rrugë e atyre popujve të mëparshëm që kanë humbur.

■ ➤ Ata nuk e kryen një veprim të tillë.

Pra, nuk i varën armët e tyre mbi pemë, dhe pastaj të kërkonin nga i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) që t’ua konfirmonte këtë veprim. Përkundrazi, ata kërkuan nga ai që t’ua përcaktonte atë paraprakisht.

- Ata deshën të afroheshin tek Allahu me atë veprim, duke menduar se Ai e pëlqente atë.

“Me atë veprim” do të thotë: me varjen e armëve apo gjërave të tjera të ngjashme në atë pemë që do t’u përcaktonte i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Kjo qe arsyeja që bënë atë kërkesë: që të realizonin nëpërmjet saj kuptimin e adhurimit.

- Përderisa sahabët nuk e dinin këtë çështje, të tjerët janë akoma më të paditur.

Sahabët, pa dyshim, kanë qenë njerëzit më të ditur në fenë e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Kur ata nuk e dinin se kërkimi i mbarësisë me anë të atij veprimi është një lloj idhujtarie, atëherë të tjerët janë akoma edhe më të paditur. Autori (Allahu e mëshiroftë!) me anë të kësaj synon që të mos gënjehemi nga veprat e njerëzve, sepse ato mund të bëhen edhe nga padija. Ne duhet të vështrojmë çka argumenton Sheriati dhe jo çka veprojnë njerëzit.

- Sahabët kanë pasur prej të mirave dhe premtimeve për falje, çka nuk e kanë të tjerët.

Kjo është e njohur nga ajetet e Kuranit: “Nuk janë të barabartë ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar para çlirimit. Ata kanë shkallë më të lartë se ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar më pas, mirëpo Allahu u premtonte të gjithëve më të mirën (Xhenetin) ...” (Hadid, 10). Sahabët (r.a.) kishin plot mirësi, premtim për falje dhe shkaqet për falje, çka nuk i kishin të tjerët e, megjithatë, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk i justifikoi për kërkesën e tyre.

- Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk i justifikoi

ata, përkundrazi ua ktheu me ashpërsi, “Allahu Ekber! Vërtet këto janë rrugë. Ju do të ndiqni rrugët e atyre para jush”, Me këto tri shprehje Pejgamberi e bëri këtë gjë problem shumë të madh.

Bëri *tekbir* e tha: “Vërtet këto janë rrugë” dhe më pas: “Ju do të ndiqni rrugët e atyre para jush.” Pra, me anë të këtyre shprehjeve, ai i dha ton çështjes, sepse *tekbiri* tregonte përmasat e mëdha të asaj kërkesë. Shprehja: “Vërtet këto janë rrugë”, tregonte paralajmërim, ndërsa shprehja tjetër: “Ju do të ndiqni rrugët e atyre para jush”, tregonte përforsim të atij paralajmërimi.

- Rëndësia e çështjes, kur Profeti (sal-IAllahu ‘alejhi ue sel-lem) bëri të ditur se kërkesa e tyre ishte si ajo e israilitëve, të cilët i thanë Musait: “Na bëj edhe ne një zot, ashtu siç kanë edhe ata zotat e tyre.”

Sahabët kërkuan një pemë për mbarësi, ashtu siç kishin edhe idhujtarët, ndërsa jehuditë kishin kërkuar një zot, ashtu siç kishin edhe idhujtarët zotat e tyre. Në të dyja këto kërkesa kishte mohim të teuhidit, sepse kërkimi i mbarësisë me anë të një peme është njëfarë shirku, ndërsa konsiderimi i saj si hyjni është shirk i qartë.

- Mohimi i formave të tilla të kërkimit të mbarësisë (bereqetit) është pjesë e domethënies së deklaratës *La ilahe il’All-llah*, megjithëse ata nuk arritën ta kapnin diçka të tillë.

Fjala *La ilahe il’All-llah* mohon çdo të adhuruar përveç Allahut dhe mohon adhurimin e çdokujt tjetër përveç Tij. Po ashtu, edhe bereqeti nuk mund të vijë prej dikujt tjetër veç Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala).

- Profeti (sal-IAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u betua për fetvanë. Ai betohej veçse për dobi.

U betua duke thënë: “Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti

im.” Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) betohej vetëm për diçka që kishte dobi ose për të larguar ndonjë të keqe, dhe nuk ishte nga ata që betoheshin për çdo gjë, siç e kanë zakon disa njerëz.

- Termi “shirk” përfshin si shirkun e vogël edhe të madhin, sepse ata nuk dolën nga Islami me atë që kërkuan.

Ata nuk e kërkuan pemën për ta adhuruar, por për t’u begatuar me të. Shirku është i madh dhe i vogël, i dukshëm dhe i padukshëm. Shirk i madh është ai që të nxjerr nga feja, ndërsa shirk të vogël përbëjnë veprat e tjera veç tije.

Shprehja “veprat e tjera veç tije” nuk është kriter i qartë. Për këtë arsye, në lidhje me kriterin përcaktues të shirkut të vogël, dijetarët janë ndarë në dy mendime:

Mendimi i parë: Shirk i vogël është çdo gjë që Sheriati e ka emërtuar shirk dhe që argumentet e tjera tregojnë se ai nuk është shirk i madh, siç është fjala: “Kush betohet në dikë tjetër përveç Allahut ka bërë shirk.”¹ Këtu shirku është i vogël, sepse argumentet tregojnë se thjesht betimi jo në Allahun, nuk të nxjerr nga feja.

Mendimi i dytë: Shirku i vogël është rrugë që të çon në shirkun e madh, edhe pse Sheriati nuk e ka emërtuar me emrin “shirk”, si në rastin kur njeriu mbështetet në diçka tjetër, ashtu si tek Allahu, por nuk e merr atë gjë për zot. Ky shirk është i vogël, sepse kjo mbështetje që bëhet njëloj si në Allahun, së fundi do ta çojë në shirk të madh. Ky përkufizim është më përfshirës se i pari, sepse i pari të pengon të përcaktosh diçka si shirk, me përjashtim të rastit kur ke argument fetar, ndërsa i dyti bën shirk çdo gjë që të çon në shirk. Ndoshta, sipas këtij përkufizimi, mund të themi se të gjitha mëkatet janë shirk i vogël, sepse ai që çon në veprimin e tyre është epshi i njeriut. Allahu i Lartësuar thotë: “A e ke vënë re atë njeri që dëshirat e veta i mori për Zot? Dhe Allahu, duke e ditur (atë si të tillë) ia humbi rrugën ...” (Xhathijeh, 23). Për këtë arsye, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka lidhur me shirkun lënien e namazit, megjithëse vepra nuk është shirk: “Ndërmjet njeriut dhe

¹ Transmeton Ahmedi, Ebu Daudi dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

shirkut e kufrit, është lënia e namazit.”¹

Përfundimisht, autori (Allahu e mëshiroftë!) thotë se shirku është i vogël dhe i madh, sepse sahabët nuk dolën nga feja me veprën e tyre, gjë e cila u sqarua më lart.

Ndërsa për shirkun e dukshëm dhe të padukshëm, disa nga dijetarët kanë thënë se është shirku i madh dhe ai i vogël. Disa të tjerë kanë thënë se i dukshëm quhet ai që është i qartë për njerëzit, qoftë ky i madh ose i vogël, si: betimi jo në Allahun ose sexhdja për një idhull. Ndërsa i padukshëm është ai që njerëzit nuk e dinë, qoftë ky i madh apo i vogël, si për shembull: syfaqësia ose besimi se bashkë me Allahun ka zot tjetër. Po kështu, mund të thuhet se i dukshëm është shirku i qartësuar si i tillë, edhe nëse është i vogël; ndërsa i padukshëm është gjithçka tjetër veç tij.

Po cili prej këtyre nuk falet? Shejhu i Islamit Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: “Allahu nuk e fal shirkun edhe nëse është i vogël, për shkak të fjalës së Tij gjithëpërfshirëse: ‘Vërtet, Allahu nuk fal që të shoqërohet dikush apo diçka me Të.’ (Nisa, 116).” Disa dijetarë të tjerë kanë thënë se shirku i vogël është nën dëshirën e Allahut, kurse në këtë ajet flitet për shirkun e madh. Allahu e fal shirkun e vogël, sepse ai nuk të nxjerr nga feja, dhe çdo mëkat që nuk të nxjerr nga feja është nën dëshirën e Allahut. Sido që të jetë, ai që bën shirk të vogël është në rrezik, sepse ky shirk është më i madh se mëkatet e mëdha. Ibn Mesudi (r.a.) ka thënë: “Të betohem në Allah duke gënjyer është më e dashur për mua sesa të betohem në dikë tjetër duke thënë të vërtetën.”²

- Sahabi thotë: “Ne sapo kishim dalë nga kufri”, ndërsa të tjerët, që ishin futur në Islam më parë, nuk ishin të paditur për këtë çështje.

Thënia “*ne sapo kishim dalë nga kufri*” do të thotë; se ai donte të shpjegonte arsyen e kërkesës së tyre. Ata u justifikuan me faktin se sapo kishin dalë nga kufri, ndërsa të tjerët, që ishin futur në Islam më parë, nuk ishin të paditur për këtë çështje. Sipas kësaj, themi se

¹ Transmeton Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Nesaiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

² Transmeton Abdurr-Rrezak dhe Taberani. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

njeriu duhet t'i arsyetojë fjalët apo veprimet e tij, me qëllim që të mos e ekspozojë veten ndaj përfoljeve apo paragjykimeve. Për këtë tregon hadithi që flet për Pejgamberin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), që shoqëroi Safijen, gjatë kohës së *itikafit*. Kur aty kaluan dy burra nga ensarët, ai tha: “Kjo është Safija, e bija e Hujejit.”¹

- Thënia: “Allahu Ekber!” kur habitemi, ndryshe nga ata që e urrejnë këtë.

Kjo është marrë nga shprehja e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): “Allahu Ekber”, që do të thotë se Allahu është më i Madhi nga shoqërimi me dikë tjetër. Në një përcjellje të Tirmidhiu vjen se i Dërguari (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Subhanall-llah!”, që do të thotë: “I pastër është Allahut nga çdo gjë që nuk i përshtatet Atij!”.

- Masat parandaluese.

Këtu është fjala për mjetet, rrugët dhe mënyrat që të shpien të diçka. Në fakt rrugët dhe mjetet janë dy llojesh: a) Rrugë që të shpien në çështje të duhura. Këto nuk pengohen, madje hapen dhe kërkohen. b) Rrugë që të shpien në çështje të qortuara. Këto udhë duhet të parandalohen, dhe këtë kategori ka pasur për qëllim autori – Allahu e mëshiroftë!

Ajo pemë ishte një rrugë që të çonte në shirkun e madh. Nëse ata do të varnin atje armët e tyre e do të kërkonin bereqetin e saj, shejtani më tej do t'i shtynte drejt adhurimit të saj, duke i bërë të kërkonin drejtpërsëdrejti nga ajo që t'u plotësonte nevojat e tyre. Kjo që arsyehet që i Dërguari (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i mbylli këto rrugë.

- Ndalimi i përngjasimit me njerëzit e kohës së injorancës.

¹ Transmeton Buhariu. Safija ishte gruaja e Profetit (salallahu alejhi ue selem) dhe ai ua tregoi atyre këtë, që të mos i ngacmonte shejtani e të paragjykonin e të mendonin keq për të.

Kjo është marrë nga thënia e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), “... thatë diçka të ngjashme me atë që tha populli i Musait ...”, thënie me të cilën ai kundërshtoi sahabët. Nga kjo mësojmë se injoranca nuk është e posaçme vetëm për kohën para të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), përkundrazi, çdokush që nuk e njeh të vërtetën dhe kryen vepra të injorancës, është pjesë e njerëzve të saj.

- Shfaqja e zemërimit kur mëson të tjerët për diçka.

Hadithi nuk është shumë i qartë në lidhje me këtë, por ndoshta kjo është marrë nga konteksti i fjalëve: “Allahu Ekber. Vërtet këto janë rrugë ...”, sepse toni i tyre tregon zemërim.

- Një rregull i përgjithshëm i nxjerrë nga thënia e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Vërtet këto janë rrugë ...”.

Ky umet do të ndjekë rrugët e atyre që kanë qenë para tij, dhe kjo nuk do të thotë lejim, por tërheqje e vërejtjes. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “... Ky umet do të ndahet në shtatëdhjetë e tre grupe; të gjitha do të jenë në Zjarr, me përjashtim të njërit ...”; gjithashtu: “Vërtet do të ketë në umetin tim nga ata që do ta bëjnë të lejuar imoralitetin dhe mëndafshin ...” Përveç këtyre, ka edhe çështje të tjera, për të cilat i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) na ka parathënë se ne do të biem në to, megjithëse janë të ndaluara.

- Kjo është një nga shenjat e profetësisë, për faktin se ka ndodhur ashtu siç lajmëroi ai.

Tashmë janë ndjekur rrugët e atyre që kanë qenë para nesh. Dikush mund të pyesë se si mund të ndodhë adhurimi i shejtanit, kur i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), gjatë ligjëratës së tij në Arafat, ka thënë: “Vërtet shejtani është bërë i pashpresë që ndonjëri prej besimtarëve të kthehet në adhurimin e idhujve e ti

rikthehet idhujtarisë në gadishullin Arabik, por ai nuk e ka humbur shpresën në mbjelljen e grindjeve ndërmjet tyre.”¹

Lajmërimi i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për pesimizmin e shejtanit, nuk tregon se ai nuk do të adhurohet kurrë; përkundrazi, kjo do të ndodhte, ndryshe nga ç’mendoi shejtani. Ai, kur pa çlirimet e njëpasnjëshme, forcimin e Islamit dhe futjen e njerëzve në fenë e Allahut grupe-grupe, u bë pesimist se ndokush tjetër veç Allahut mund të adhurohej në atë gadishull. Mirëpo ishte urtësia e Allahut që të adhurohej dikush tjetër veç Tij – dhe kjo nuk ka diskutim – me qëllim që të mos thuhej se të gjitha veprimet që ndodhin në gadishullin Arabik nuk mund të jenë shirk. Pastaj dihet se shejh Muhamed Ibn Abduluehabi (Allahu e mëshiroftë!) përtëriu teuhidin në gadishullin Arabik, kur atje kishte edhe idhujtarë edhe të tjerë që nuk ishin të tillë.

Hadithi tregon se çfarë mendoi shejtani në atë kohë, dhe jo se nuk do të ndodhte ajo gjë. Vetë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u tha: “Ju do të ndiqni rrugët e atyre para jush”, ndërkohë që u drejtohej sahabëve, të cilët ndodheshin në gadishullin Arabik.

- Çdo gjë për të cilën Allahu, në Kuran, qorton çifutët dhe të krishterët është njëkohësisht qortim edhe për ne.

Kjo, jo në formë gjithëpërfshirëse, por për një pjesë prej nesh. Pra qëllimi është për një grup e jo për të gjithë, siç kanë thënë dijetarët për fjalën e Allahut: “O ju bashkësia e xhindëve dhe e njerëzve! A nuk erdhën te ju të Dërguar nga mesi juaj ...” (En’am, 130), Profetët kanë qenë vetëm nga njerëzit. Atëherë, nëse përngjason me çifutët dhe të krishterët, qortimi për ta është edhe për ty. Në përgjithësi, nuk ka njerëz që të mos përngjasojnë me çifutët dhe të krishterët. Ai që e kundërshton Allahun me vetëdije përngjan me çifutët, ndërsa ai që e adhuron Allahun me injorancë ngjason me të krishterët. Kush i ka zili njerëzit për atë që u ka dhënë Allahu, ngjan me çifutët, e kështu me radhë.

Nëse autori (Allahu e mëshiroftë!) ka dashur të thotë se në umet

¹ Muslimi.

do të ketë patjetër cilësi të ngjashme me ta, atëherë hadithi merret si gjithëpërfshirës, sipas kontekstit të tij, sepse janë të paktë ata që shpëtojnë nga kjo qasje. E nëse ai ka pasur për qëllim të thotë se çdo gjë për të cilën janë qortuar çifutët dhe krishterët, është qortim edhe për këtë umet në formë të përgjithshme, atëherë ky mëtim nuk është i saktë.

- Nga hadithi del se sahabët që pyetën të Dërguarin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishin të vetëdijshëm se ligjërimi i ibadeteve duhet të bazohet në urdhrat e Zotit. Tregimi në fjalë nënkupton edhe dëshmitë për tri çështjet, për të cilat njeriu do të pyetet në varr. Argumenti për *rububijen* (kush është Zoti yt), e cila është pyetja e parë që do t'i bëhet njeriut në varr, kuptohet qartë. Ndërsa argumenti mbi profetësinë e Muhamedit ‘alejhis-salam. e cila është pyetja e dytë që do t'i bëhet njeriut në varr, merret nga fakti që në këtë hadith ai lajmëron për disa gjëra të fshehta. Argumenti mbi fenë, e cila është pyetja e tretë që do t'i bëhet njeriut në varr, nënkuptohet nga thënia e tyre: “Na bëj edhe ne një zot ...” e deri në fund.

Është e qartë se adhurimi bëhet sipas porosisë hyjnore dhe ai adhurim për të cilin nuk urdhërohem nga Sheriati është bidat. I Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kur dikush kryen një vepër që nuk është prej fesë sonë, ajo është e refuzuar.”¹ dhe: “Ruhuni nga gjërat e sajara, se çdo sajim në fe është humbje.”²

Kujtudo që kryen ndonjë adhurim, i kërkohet argument për të, pasi parimisht çdo adhurim është i ndaluar, përveç rastit kur ka një argument fetar që e bën atë të ligjshëm. Ndërsa ushqimet, marrëdhëniet e ndërsjella, edukata e veshjes e të tjera, parimisht janë të lejuara, përveç rastit kur ka argument për ndalimin e tyre.

¹ Muslimi.

² Transmeton Ebu Daudi dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

– “... Tregimi në fjalë nënkupton edhe dëshmitë për tri çështjet, për të cilat njeriu do të pyetet në varr ...”. Ato janë: “Kush është Zoti yt?”; “Kush është Profeti yt?”; dhe “Cila është feja jote?”. Në këtë ngjarje ka argument për tri pyetjet e varrit. Qëllimi i autorit nuk ka qenë se në këtë ngjarje ka argument që njeriu do të pyetet në varr, por në të ka argument për pohimin e *rububijes*, profecisë dhe adhurimit.

Për sa i përket *rububijes*, është e qartë se do të thotë: “nuk ka zot tjetër veç Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala)”. Argumenti lidhur me profetësinë, merret nga fakti që në këtë hadith ai lajmëron për disa gjëra të fshehta, duke thënë: “Ju do të ndiqni rrugët e atyre para jush”; kjo ndodhi siç ka lajmëruar ai. Për sa i përket pyetjes për fenë, ajo është marrë nga fjala e tyre: “Na bëj edhe ne një zot ...”, që do të thotë: të adhuruar. Pra, adhurimi është feja. Të kuptuarit e teksteve nga ana e autorit Muhamed Ibn Abduluehab (Allahu e mëshiroftë!) ka qenë shumë i mprehtë, sepse ndonjëherë është e vështirë për njeriun nxjerrja e dobive nga argumentet.

- Rruga e ndjekësve të Librit është e qortuar, ashtu siç është rruga e idhujtarëve.

Kjo është marrë nga thënia: “... diçka të ngjashme me atë që benu Israilët i thanë Musait.”

- Njeriu që kalon nga një e kotë, me të cilën i është mësuar zemra, tek e vërteta, nuk ka siguri që në zemrën e tij nuk ka mbetur asgjë nga zakonet e vjetra. Kjo sipas fjalës së tyre të përmendur në hadith: “Ne sapo kishim dalë nga kufri ...”.

Kjo është e saktë, sepse njeriu që kalon nga një gjendje në një tjetër – qoftë kjo e pavërtetë ose jo – nuk sigurohet që në zemrën e tij të mos mbesë asgjë nga gjendja e mëparshme. Kjo mbetje largohet vetëm pas njëfarë kohe, sipas fjalës që përcillet në hadith: “Ne sapo kishim dalë nga kufri ...”. Sahabi duket sikur do të thotë me këtë se: ia kërkuan atë gjë Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem), pasi kishin akoma mbetje të injorancës. Për këtë arsye, dëbimi i imoralit (pasi është rrahur njëherë) nga vendi ku e ka kryer këtë të

keqe, është pjesë e urtësisë së gjykimit, me qëllim që ai të mos i kthehet më asaj. Njeriu gjithashtu duhet të largohet nga vendet e kufrit, shirkut dhe të këqijave, me qëllim që të ruajë sa më mirë zemrën prej tyre.

Tema 10

Argumentet që kanë ardhur lidhur me therjen e kurbanit jo për Allahun e Lartësuar.

– “... me therjen e kurbanit ...” – Domethënë me therjen e kafshëve për kurban.

– “... jo për Allahun ...” – Domethënë, kur therja e kurbanit nuk bëhet në emër të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Therja jo për Allahun ndahet në dy lloje:

a) Therja jo për Allahun, si afrim dhe madhërim. Kjo gjë është shirk i madh, që të nxjerr nga feja.

b) Therja jo për Allahun, nga gëzimi dhe bujaria. Kjo vepër nuk të nxjerr nga feja dhe është diçka e zakonshme. Ajo ndoshta mund të jetë e pëlqyer, e ndoshta jo, por në thelb është vepër e lejuar. Megjithatë, autori ka për qëllim këtu llojin e parë.

Nëse vjen një prijës dhe njerëzit presin kurban për të, për t’iu afruar dhe për ta madhëruar, atëherë kemi të bëjmë me shirk të madh. Ky lloj kurbanit është haram, sepse bëhet thjesht para tij dhe nuk përdoret për ushqim. Nga ana tjetër, nëse therim kafshë në shenjë bujarie dhe mikpritjeje, duke e gatuar dhe ngrënë këtë mish, atëherë nuk kemi të bëjmë me shirk, por me bujari.

– “... jo për Allahun ...” – përfshin kurbanet për Profetët, melekët, evlijatë etj.

Për sa i përket titullit të temës, autori ka përmendur argumentin, pa përmendur gjykimin. Tema të tilla dijetarët i vendosin për çështje

që nuk japin gjykim të prerë ose për ato të cilat kanë diskutime të stërholluara. Kurse çështjet që kanë gjykim të prerë, i titullojnë prerazi, si për shembull: “Argumentet mbi detyrimin e namazit”, “Argumentet mbi ndalimin e përgojimit”, e kështu me radhë.

Autori (Allahu e mëshiroftë!) pa dyshim mendon që kurbanit për dikë tjetër përveç Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), në formë afrimi e madhërimit, është haram dhe shirk i madh, por ai donte që nxënësi të ushtrohej në nxjerrjen e një gjykimi nga argumentet. Kjo është një lloj metode e mësimdhënies. Dijetari ose autori e lë gjykimin të hapur, pastaj sjell argumentet, me qëllim që ta lërë gjykimin në dorë të nxënësit, dhe ky i fundit gjykon për të, sipas argumenteve që i janë sjellë.

Autori (Allahu e mëshiroftë) ka përmendur në këtë temë tri ajete:

“Thuaj (O Muhamed): ‘Në të vërtetë namazi im, kurbanit im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari musliman (që i nënshtrohem Atij).’ (En’am, 161-162)

– “*Thuaj ...*” – Fjala i është drejtuar Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe do të thotë: “Thuaji idhujtarëve duke ua deklaruar atyre zbatimin e teuhidit të pastër nga ana jote”, sepse kjo sure është zbritur në Mekë.

– “*... Në të vërtetë namazi im ...*” – Fjala arabe *salat* (namaz), në kuptimin gjuhësor do të thotë duá (lutje), ndërsa në kuptimin terminologjik të Sheriatit do të thotë rit adhurimi për Allahun, që përmban fjalë dhe veprime të njohura, të cilat fillojnë me *tekbir* dhe mbyllen me *selam*.

– “*... kurbanit im ...*” – Fjala arabe *nusuk* (kurban) në kuptimin gjuhësor do të thotë “adhurim”, ndërsa në terminologjinë e Sheriatit do të thotë therje e kurbanit. Atëherë, fjala në ajet do të merret sipas kuptimit gjuhësor apo sipas kuptimit të Sheriatit? Ajo që vjen në gjuhën e Sheriatit, merret sipas realitetit të Sheriatit. Po kështu, ajo që vjen në gjuhën e zakonit, merret sipas realitetit të zakonit.

Ndërsa ajo që vjen në gjuhën arabe, sipas realitetit të gjuhës arabe.

Kur një person e pyesim: “A ke bagëti (*shat*)?”; nënkupton një dele femër. Mirëpo në gjuhën arabe fjala “*shat*” shënon një dele ose një dhi, qoftë mashkull apo femër.

Atëherë, sipas kësaj, fjala arabe *nusuk* në ajet, është përdorur në kuptimin e Sheriatit. Është thënë gjithashtu, se është përdorur në kuptimin gjuhësor, sepse e tillë është më përfshirëse, që do të thotë se *nusuk* është adhurim, si të thuash: “Unë nuk lus tjetër veç Allahut dhe nuk adhuroj tjetër veç Tij”. Kjo përfshin duanë dhe adhurimin.

Nëse do të merret sipas kuptimit të Sheriatit, atëherë kemi veçim në aspektin e llojit të adhurimit. Në rastin konkret, ai është namazi dhe therja e kurbanit. Kjo është përmendur si shembull. Namazi është më i larti i adhurimeve trupore, ndërsa kurbanit është më i larti i adhurimeve me pasuri, sepse kur ai bëhet për madhërim, mund të ndodhë vetëm për afrim te Zoti. Kështu ka vendosur në këtë çështje shejhu i Islamit Ibn Tejmije.

U tha se kurbanit është më i larti i adhurimeve me pasuri, por kjo ka nevojë për diskutim, sepse nuk ka dyshim që adhurimi më i lartë që bëhet me pasuri është zekati.

Ka edhe një mendim të tretë, që thotë se fjala “*namaz*” shënon ibadetin e njohur në Sheriat, ndërsa fjala *nusuk* tregon për çdo lloj adhurimi pa përcaktim, e sipas këtij kuptimi termi përgjithësues *nusuk* i është bashkëlidhur termit të posaçëm “*namaz*”.

– “... *jeta ime dhe vdekja ime* ...” – Do të thotë: Allahu vepron me mua si të dëshirojë dhe çështjet e mia, i gjallë apo i vdekur, janë në dorën e Tij. Atëherë, togu: “Në të vërtetë namazi im, kurbanit im ...”, pohon *teuhidin e adhurimit*, ndërsa pjesa: “... *jeta ime dhe vdekja ime* ...”, pohon *teuhidin e veprave të Zotit*.

– “... *i përkasin vetëm Allahut* ...” – Allah është emër i Zotit. Origjina e kësaj fjale është “*ilah*”, që do të thotë “i adhuruar, i dashur, i madhëruar”.

– “... *Zotit të botëve (alemin)* ...” – *Alemin* (botëve) përfshin gjithçka përveç Allahut. Është quajtur kështu, sepse ajo dëshmon

për Krijuesin e saj, siç thotë poeti:

Çudi, se si njeriu kundërshton Allahun dhe e mohon
Atë;

Kur çdo gjë dëshmon se Ai është Një.

Fjala *alemin* përdoret gjithashtu edhe për një etapë kohore, si në fjalën e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “... dhe që ju kam ngritur mbi gjithë *Alemin*-nin (njerëzit dhe xhindët e asaj kohe).” (Bekare, 47).

Fjala *Rab* (Zot) këtu, ka kuptimin: Sundues, Rregullues i çështjeve, që tregon zotërimin absolut.

– “... *Ai nuk ka asnjë ortak ...*” – Allahu nuk ka shok në adhurim, as në veprimet e Tij, as në emrat dhe cilësitë e Tij, prandaj ka thënë: “Asgjë nuk i shëmbëllen Atij; Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi.” (Shura, 11).

Ka humbur kush pretendon se Allahu ka ortakë, si ata që adhurojnë idhujt, Isain, të birin e Merjemes, apo disa poetë ekstremistë, të cilët e kanë ngritur krijesën në gradën e krijuesit, siç lavdëron njëri prej tyre:

Si cili të duash mund të bëhesh ti,
O ti, me të cilin nuk ngjan asnjëri;
Gjithçka mund të bësh, si të dëshirosh,
Krijesë tjetër s’ka, që ty të ta afrosh.

Po kështu ka bërë edhe Busiri në *kaside*-n e tij, kur lavdëron Pejgamberin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem):

O krijesa më e nderuar,
Kur të zezat t’më kenë pushtuar,
Ndihmë veç ty kam për t’kërkuar!
Në s’më shpëton në t’Gjykimit Ditë,
Thuaj “mjerë” për mua, që kam rrëshqitë.
Dynja dhe ahiret – prej bujarisë që pate,
Prej dijes që ke ti, janë shkruar këto fate.

Kjo është pjesë e shirkut më të madh, sepse ai dynjanë dhe ahiretin e quan si pjesë të bujarisë së të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), që do të thotë se Allahut nuk i ka mbetur asnjë rol në të. Po kështu, ai thotë se: “Prej dijes që ke ti, janë shkruar këto fate”, që do të thotë se nuk qenka Zoti Ai që i di të gjitha!

Atëherë Allahut nuk i paska mbetur as dije e as rregullim të çështjeve të krijesave. Allahu na ruajtë!

– “... *Kështu jam urdhëruar ...*” – Ky është urdhri kryesor, sepse është nga më madhështorët: sinqeriteti për Allahun dhe mohimi i shirkut. Pra, duket sikur ishte urdhëruar vetëm për këtë gjë. Dihet se ai që është i sinqertë me Allahun (Subhanehu ue Te’Ala), do ta realizojë adhurimin e Allahut në të gjitha çështjet.

– “... *dhe unë jam i pari musliman.*” – Kuptimi i parësisë mund të jetë në kohë, pra, “jam i pari musliman i këtij umeti”, sepse muslimanë ka pasur edhe në kohët e mëparshme. Por parësia mund të kuptohet edhe në aspektin cilësor, sepse njeriu me Islamin më të lartë dhe me nënshtrimin më të plotë ka qenë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Rrjedhimisht, themi se parësia këtu është në çdo aspekt.

Kjo mënyrë të shprehuri përdoret shpesh kur kemi të bëjmë me parësi në cilësi, si në rastin kur thua se je i pari që beson diçka, edhe pse para teje kanë besuar edhe të tjerë. Por ti, në fakt, nënkupton me këtë se je nga të parët njerëz që besojnë në atë që beson ti, ndërkohë që nuk ke mohuar kurrë. I tillë është edhe hadithi i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Ne kemi më shumë përparësi për të dyshuar, sesa Ibrahim kur tha: ‘Zoti im! Më shfaq mua se si i ngjall Ti të vdekurit.’”¹ Kuptimi i tij nuk është se Ibrahim dyshonte në këtë, por nëse supozohet se tek ai lindi një dyshim, ne kemi më shumë përparësi për të dyshuar sesa ai, pavarësisht se ne nuk kemi dyshime, ashtu sikurse Ibrahim nuk kishte asnjë dyshim.

– “... *musliman ...*” – Kur Islami përmendet në veçanti, ai përfshin imanin, sepse qëllimi këtu është dorëzimi ndaj Allahut me trup dhe me zemër. Këtë e tregon ajeti: “Vërtet, ata që i përulen Allahut ...” (Bekare, 112). Këtu nënkuptohet dorëzimi me zemër, ndërsa thënia e Tij: “... duke qenë mirëbërës ...”, nënkupton dorëzimin me trup. Gjithashtu, ajeti: “Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet ...” (Ali Imran, 85), përfshin Islamin (dorëzimin ndaj

¹ Buhariu dhe Muslim.

Allahut) me trup dhe me zemër. Po kështu, nëse përmendet vetëm imani, ai përfshin Islamin: “Allahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve kopshte (të Xhenetit), nëpër të cilat rrjedhin lumenj ...” (Teube, 72) Ekzistenca e imanit të vërtetë kushtëzon praninë e Islamit. Nëse përmenden të bashkuar, atëherë me Islamin nënkuptohen veprat e dukshme, ndërsa me imanin veprat e padukshme (ato të zemrës), siç vjen në hadithin e Xhibrilit, i cili i kërkoi Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) t’i tregonte ç’ishte Islami, dhe Pejgamberi e përshkroi me vepra të dukshme. Pastaj Xhibrili i kërkoi t’i tregonte ç’ishte imani, dhe ai e përshkroi me vepra të padukshme. I tillë është edhe ajeti: “Arabët e shkretëtirës thanë: ‘Ne besuam.’ Thuaj (O Muhamed): ‘Ju nuk keni besuar, por thoni: ‘Ne jemi nënshtruar (në Islam)’, pasi besimi akoma nuk ka hyrë në zemrat tuaja ...” (Huxhurat, 14).

Lidhja e ajetit me temën është se therja e kurbanit duhet të jetë patjetër vetëm për Allahun.

“Kështu pra, falu për Zotin tënd dhe **(vetëm për Të) ther kurban.**” (Keuther, 2)

– “... *falu për Zotin ...*” – Kjo lidhet me ajetin e parë të po kësaj sureje: “Vërtet Ne të kemi dhënë ty (O Muhamed) shumë të mira, prej tyre dhe Keuther-in”, që do të thotë: “për shkak të dhuratës Sonë, falu dhe ther kurban, duke e falënderuar Allahun e Lartësuar për këtë begati”. Qëllimi me fjalën *salat* këtu është namazi i njohur në Sheriat.

– “... *ther kurban ...*” – Pra, kushtoja kurbanin tënd Allahut, ashtu siç ia kushton Atij edhe namazin.

Nga ajeti konkludohet se kurbanin është pjesë e adhurimit. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar ka urdhëruar për të dhe e ka vënë pranë namazit.

Fjala “ther” është e papërcaktuar, që do të thotë se ajo përfshin të gjitha llojet e therjeve që Sheriati i ka ligjëruar, të cilat janë tri: flijimet e Kurban Bajramit, kurbanet e Haxhit dhe kurbanet (*el akika*) për të porsalindurit. Këto tri lloje kurbanesh i kërkohen muslimanit.

Kurbanet e Haxhit ndahen në: të detyrueshme dhe të pëlqyeshme. I detyrueshëm është në rastin e haxhit *temetu*: "... ai që prej jush kryen umren deri në haxh, le të therë kurban, sipas mundësisë ..." (Bekare, 196). Po kështu edhe për atë që pengohet nga kryerja e haxhit: "Nëse në këtë rrugë pengoheni, atëherë thorni kurban, sipas mundësisë." (Bekare, 196). I tillë është edhe për atë që duhet të rruajë kokën në haxh, por nuk e bën këtë: "... atëherë ai le ta shlyejë me agjërime, lëmoshë ose kurban ..." (Bekare, 196). Këto të fundit, nëse është e saktë mund të shprehemi se ato janë *hedj* (kurbane të haxhit), por më mirë është të themi: *fidjeh* (shlyerje), siç i ka emërtuar Allahu i Lartësuar, sepse ato janë për shlyerje.

Pastaj është kurban i që pritet në ditën e Kurban Bajramit. Dijetarët kanë mendime të ndryshme në lidhje me të. Disa prej tyre kanë thënë se ai është detyrë, të tjerët kanë thënë se është i pëlqyeshëm. Shumica e dijetarëve thonë se prerja e kurbanit është e pëlqyeshme, ndërsa për atë që ka mundësi dhe nuk e bën është e urryer. Mendimi i Ebu Hanifes është se kurban i është detyrë për atë që ka mundësi. Këtë mendim ka zgjedhur edhe shejhu i Islamit Ibn Tejmije.

Kurbani nuk bëhet për të vdekurve, siç kujtojnë disa njerëz të rëndomtë, përkundrazi, ai është për të gjallët. Për sa u përket të vdekurve, nuk është e ligjruar të pritet kurban për ta, pa ndonjë lidhje, sepse nuk ka ndonjë fakt nga i Dërguari (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), përveç kur ata kanë lënë porosi. Në këtë rast të fundit, kjo bëhet për të çuar në vend porosinë.

Ndërsa *akika* është kurban i që pritet për të porsalindurit, në ditën e tyre të shtatë. Nëse fëmija është mashkull, priten dy kokë bagëti, e nëse është femër, një. Po kështu, kur nuk ka mundësi ekonomike, për mashkullin mjafton edhe një. *Akika* është sunet, sipas shumicës së dijetarëve. Disa prej tyre kanë thënë se ky lloj kurban i është detyrë, sepse Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Çdo fëmijë është peng i kurbanit të tij"¹.

¹ Transmeton Ahmed, Tirmidhiu, Ebu Daudi dhe Ibn Maxhja. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë. Është thënë se hadithi i referohet ndërmjetësimit në Ditën e Gjykimit, domethënë, nëse për fëmijën nuk pritet kurban dhe ai vdes i vogël, atëherë ky fëmijë nuk do të bëjë ndërmjetësim për prindërit e vet.

Aliu (r.a.) thotë: “Më ka folur i Dërguari i Allahut (sal-lallahu ‘alejhi ue sel-lem.) për katër gjëra: ‘Allahu e mallkon atë që ther kurban jo për Allahun; Allahu e mallkon atë që mallkon prindërit e tij; Allahu e mallkon atë që strehon bidatçiun ose kriminelin; Allahu e mallkon atë që ndryshon kufijtë e tokës.’”¹

– “... Allahu e mallkon ...” – Mallkimi i Allahut të Lartësuar është dëbim dhe largim nga mëshira e Tij. Shprehja “Allahu e mallkon” ka kuptimin: e përzë dhe e largon nga mëshira e Tij; ndërsa: “Allahu e mallkoftë filanin!”, ka kuptimin: “Ai e dëboftë nga mëshira e Vet!”

– “... atë që ther kurban ...” – Kjo përfshin therjen e deveve, lopëve, pulave etj.

– “... jo për Allahun ...” – I përfshin të gjitha përveç Allahut të Lartësuar, edhe sikur të jetë për ndonjë Profet, melek, xhind etj.

– “... e mallkon ...” – Me këtë fjalë mund të nënkuptohet se Allahu e mallkon atë që bën kurban për dikë tjetër. Sipas këtij varianti, i Dërguari (sal-lallahu ‘alejhi ue sel-lem) thjesht kumton. Ndërsa sipas një varianti tjetër, kjo shprehje mund të jetë lutje: “O Zot, mallkoje atë që ther kurban për dikë tjetër veç Teje!” Megjithatë, varianti i parë është më i saktë, sepse, për sa i përket të dytit, Allahu mund t’i përgjigjet lutjes ose jo.

– “... prindërit e tij ...” – Këtu futet babai, nëna edhe më lart, si gjyshi apo gjyshja, sepse gjyshi është baba, ashtu siç quhen edhe fëmijët e birit apo bijës, fëmijë, në detyrimin e respektimit të trungut të tyre. Këtu nuk bëhet fjalë për çështje pasurie, por për detyrimet e fëmijës ndaj prindërve. Prandaj, mallkimi i të afërmit është më i rëndë se i të largët, sepse prindi meriton më shumë bamirësi, ndërsa mallkimi e mohon bamirësinë.

– “... atë që mallkon prindërit e tij ...” – Pra, atë që i shan dhe i fyen

¹ Transmeton Muslimi.

ata të dy, sepse mallkimi është sharje dhe fyerje. Nëse e shan një njeri, ky është si ta kesh mallkuar atë. I është thënë Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Si mund t’i mallkojë njeriu prindërit e vet?” Është përgjigjur: “Ai i fyen babain një tjetri dhe ai tjetri ia kthen duke i fyer babain e tij, ose i fyen nënën një tjetri dhe ai pastaj fyen nënën e këtij.”¹ Dijetarët kanë nxjerrë një rregull nga ky hadith: shkaktari i mëkatit, ligjërisht, trajtohet njëlloj si kryesi i mëkatit, edhe nëse ndryshon nga ai me shkallën e përgjegjesisë.²

– “... atë që strehon bidatçiuin ose kriminelin ...” – Që do të thotë: shoqërohet me të dhe e mbron.

Bidati përfshin sajimet në fe, siç qenë bidatet e *xhehmive*, *mutezilëve* e të tjerë, si dhe veprimi i gjërave që kanë të bëjnë me çështjet e umetit, si krimet e të tjera si këto. Kush strehon atë që bën një sajese në fe, është i mallkuar, e po ashtu edhe ata që e ndihmojnë atë. Kjo, sepse strehimi i tij bën që të mos zbatohet dënimi i Sheriatit mbi të, ndërsa ndihmesa që i jepet atij është akoma më e keqe dhe më e rëndë. Megjithatë, vetë bidatçiu ose krimineli është në një gjendje shumë më të keqe, sepse kur strehimi i tij qenka shkak për mallkim, atëherë vetë vepruesi është disa herë më i mallkuar.

Në hadith është paralajmëruar për bidatet, për sajesat në fe. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Ruajuni sajese në fe, sepse çdo sajese e tillë është humbje.” Sipas kontekstit, thënia përfshin çdo bidat, sado i vogël qoftë ai.

– “... atë që ndryshon kufijtë e tokës ...” – Ai që ndryshon shenjat kufizuese që vendosen midis fqinjëve. Kush i ndryshon ato padrejtësisht, është i mallkuar. Sa shumë ka nga ata që lëvizin

¹ Buhariu.

² Ndryshimi mes kësaj dhe asaj që u përmend më lart është se e drejta e prindërve vjen menjëherë pas të drejtës së Allahut. Allahu i Lartësuar thotë: “Ndërsa Zoti yt ka ligjëruar (përcaktuar) që të mos adhuronit askënd e asgjë veç Atij dhe që të jesh i përkushtuar ndaj prindërve të tu.” (Isra, 23)

“Adhuronit Allahun dhe mos i vini Atij shok në adhurim dhe trajtojini mirë prindërit.” (Nisa, 36) Profeti (salallahu alejhi ue selem) pasi përmendi humbjen e hakut të Allahut të Lartësuar dhe mohimin e Tij, përmendi humbjen e hakut të prindërve, sepse haku i tyre është pas hakut të Allahut të Lartësuar.

shenjat e tokës, sidomos kur vlera e saj është e madhe. A nuk e dinë këta njerëz se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kush zaptonte një pëllëmbë tokë padrejtësisht, do të mbajë në kurriz nga shtatë tokat.”¹ Kjo vepër është shumë e rrezikshme. Zaptuesi i tokës mund t’i ndryshojë kufijtë e tokës dhe të marrë atë që nuk i takon, por ai nuk e di se, ndoshta, mund të përfitojë prej saj në këtë botë, por ndoshta edhe mund të vdesë para se të përfitojë apo edhe mund ta kaplojë ndonjë bela, që do ta bëjë të lërë gjithçka që ka grabitur.

Si përfundim, kjo tregon se ndryshimi i sinorëve të tokës është nga mëkatet e mëdha, prandaj Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka bashkuar me shirkun, sjelljen e keqe ndaj prindërve dhe sajimet në fe. Kjo vepër është tepër e rrezikshme, prandaj njeriu duhet të ruhet nga ajo e t’i frikësohet Allahut që të mos bjerë në të.

Tarik Ibn Shihabi tregon se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Një burrë hyri në Xhenet për shkak të një mize dhe një tjetër hyri në zjarr për shkak të një mize”. Të pranishmit thanë: “E si kështu, o i Dërguari i Allahut?!” Ai u përgjigj: “Dy burra kaluan pranë një populli, të cilët kishin një idhull. Ata nuk linin asnjë që të kalonte andej e të mos flijonte diçka për idhullin e tyre. I thanë të parit: ‘Flijo diçka për këtë idhull!’ Ai u përgjigj: ‘S’kam asgjë që t’i flijoj!’ I thanë: ‘Flijo qoftë edhe një mizë.’ Ai flijoi një mizë dhe ata e lanë të lirë të ikte, por ai u fut në Zjarr. I thanë tjetrit: ‘Flijo edhe ti diçka!’ Ai u përgjigj: ‘Nuk flijoj asgjë për ndonjë tjetër veç Allahut!’ Atë e vranë, por ai u fut në Xhenet.”²

Hadithi bën pjesë te hadithet e dobëta.³

¹ Transmeton Muslimi.

² Transmeton Ahmedi në "Zuhd". Sipas Abdul Kadir Arnautit, kjo është e saktë si thënie sahabiu, d.m.th si një thënie e Selman Farisiut.

³ Sipas mendimit të shejhut hadithi është i dobët. Ai ka përmendur në të dy *ileh* (probleme).

– “... për shkak të një mize ...” – Pra, për shkak të një mize. E ngjashme me këtë është fjala e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Një grua u fut në zjarr për një mace ...” Pra, për shkak të një maceje.

– “... u fut në Zjarr ...” – Edhe pse flijoi diçka pa vlerë, që nuk hahet, u bë idhujtar dhe u fut në Zjarr, për shkak të qëllimit të asaj veprë.¹

Dobitë e temës

- Komenti i ajetit 161 në suren En’am: “Thuaj (**O Muhamed**): ‘Në të vërtetë, namazi im, kurbanimi im ...’”,

Ai u zhvillua në fillim të temës.

- Komenti i ajetit 2 të sures Keuther. “Kështu pra, falu për Zotin tënd dhe (vetëm për Të) ther kurban”.

Edhe ky është zhvilluar në fillim të temës.

- Mallkimi i parë (në hadith) është për atë që flijon

¹ Në fjalën e tij “Ofro qoftë edhe një mizë. Ai ofroi një mizë, ata e lanë të lirë të kalonte dhe ai u fut në zjarr.”, sqarohet rreziku i madh i shirkut, edhe pse mund të jetë për shkak të diçkaje të vogël. Po kështu, ai e bën të detyrueshme futjen në zjarr. A nuk shikon te ky person, kur ai ofroi për idhullin më të ultin dhe më të pavlefshmin insekt, mizën, ndëshkimi i tij qe Zjarri, për shkak të shoqërimit që bëri në adhurimin e Allahut. Kjo, sepse kur bëhet therja për afrim dhe madhërim, është ibadet. Kjo është në përputhje me fjalën e Allahut: “Nuk ka dyshim se kushdo që i vë shok Allahut, Ai ia ka bërë të ndaluar (haram) Xhenetin dhe vendbanimi i tij do të jetë Zjarri ...” (Maide, 72) Po kështu, këtu ka paralajmërim për mëkatet, edhe nëse i mendon ato të vogla, siç ka thënë Enesi: “Vërtet ju punoni disa punë që në syrin tuaj janë më të holla se qimja, të cilat ne i konsideronim në kohën e Pejgamberit (salallahu alejhi ue selem) si gjëra shkatërruese.” (Buhariu) Kurse në fjalën: “... Nuk ofroj asgjë për dikë tjetër veç Allahut”, e deri në fund, sqarohet vlera e Teuhidit dhe sinqeritetit. (Marrë nga Tejsirul Azizil Hamid)

| kurban jo për Allahun.

Një veprim i tillë është shirk. Allahu, kur përmend të drejtat, së pari fillon me teuhidin, sepse e drejta e Allahut është e drejta më e madhe. Ai thotë: “Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); silluni mirë ndaj prindërve ...” (Nisa, 36); “Ndërsa Zoti yt ka porositur që të mos adhurosh askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit ...” (Isra, 23). Ndalimet duhet të fillohen me ndalimin e shirkut dhe ndëshkimet duhet të fillohen me ndëshkimin e tij.

- | ➤ Kush mallkon prindërit, është vetë i mallkuar. Kjo ndodh kur mallkon prindërit e një tjetri dhe ai, si kundërpërgjigje, mallkon prindërit tu.

Mallkimi i një tjetri ka dy forma: ose duke bërë lutje kundër tij me mallkim, ose duke e sharë dhe ofenduar, sepse Pejgamberi (sal-lallahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka komentuar vetë këtë kur ka thënë: “Ai i fyen babain një tjetri dhe ai tjetri ia kthen duke fyer babain e tij, ose i fyen nënën një tjetri dhe ai pastaj fyen nënën e këtij.”¹

- | ➤ Ai që strehon një bidatbërës ose një kriminel, është i mallkuar. Këtu bëhet fjalë për personin i cili merr në mbrojtje bidatbërësin (ose kriminelin) që ka kryer një vepër të ndëshkueshme penalisht nga Sheriati; ky person është i mallkuar.

Më parë u shpjegua se ky gjykim përfshin veprën e bidatit dhe të kimit, domethënë i mallkuar është ai që strehon një bidatbërës, si edhe ai që strehon një kriminel.

- | ➤ Ai që ndryshon sinorët e tokës është i mallkuar. Sinorët janë kufijtë ndarës ndërmjet parcelës tënde dhe parcelës fqinje. Të ndryshosh këta kufij do të

¹ Buhariu.

thotë t'i lëvizësh ata më brenda ose më jashtë tokës.

Ky gjykim është njëlloj: qoftë ky kufi ndërmjet teje dhe një fqinji, qoftë ndërmjet teje dhe tokës publike, sepse hadithi është gjithëpërfshirës.

- Ndryshimi ndërmjet mallkimit ndaj një personi konkret dhe ndaj atyre që bëjnë gjynahe në përgjithësi.

Vepra e parë është e ndaluar, ndërsa e dyta është e lejuar. Nëse sheh dikë që strehon një bidatçi ose kriminel, mos i thuaj “Të mallkoftë Allahu!”, por thuaji: “Allahu e ka mallkuar atë që strehon një bidatçi ose kriminel. Këtë e argumenton fakti se, kur Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) filloi të mallkonte disa nga idhujtarët dhe injorantët duke thënë: “O Allah, mallkoje filanin, filanin dhe filanin!”, Allahu i Lartësuar e ndaloi nga ky veprim me fjalën e Tij: “Ti nuk ke asgjë në dorë, nëse do t’ua pranohet Ai pendimin apo do t’i dënojë, se ata janë vërtet keqbërës” (Ali Imran, 128). Pra, nuk ke të drejtë të mallkosh një person konkret. Sa njerëz kanë arritur në gjendje që ta meritojnë mallkimin, por që më pas janë penduar dhe Allahu ua ka pranuar pendimin! Atëherë, mallkimi i një personi të caktuar bëhet me argument të posaçëm.

Duket sikur autori (Allahu e mëshiroftë!) thotë se, në parim, mallkimi nuk lejohet, dhe se ky hadith vjen për mallkimin në përgjithësi. Kësisoj e posaçmja mbetet në origjinën e saj. Muslimani nuk është as akuzues e as mallkues, sepse edhe Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk ka qenë as a ekuzues as mallkues. Ndoshta kjo është mënyra e gjykimit që del nga hadithi, se përndryshe ai nuk bën dallim mes llojeve të mallkimeve.

- Ngjarja e flijimit të mizës është mahnitëse.

Duket sikur autori (Allahu e mëshiroftë!) e saktëson hadithin, prandaj ndërton mbi të një gjykim. Gjykim është nxjerrë duke u bazuar në saktësinë e tij, sepse ngjarja është e njohur.

- “Ai u fut në Xhehenem për shkak të asaj mize, që nuk kishte qëllim ta flijonte, por e bëri këtë për të shpëtuar nga e keqja e atij populli.”

Ky vlerësim nuk është i pranueshëm, sepse shprehja: “Flijo qoftë edhe një mizë”, do të thotë se ai e bëri me qëllim adhurimi. Nëse do ta bënte për të shpëtuar nga e keqja e tyre, ai nuk do të kishte rënë në kufër, sepse nuk do të kishte qëllim adhurimin. Nisur nga ky parim, dijetarët thonë se kur burri e ndan bashkëshorten duke qenë i detyruar nga dikush tjetër, atëherë nuk konsiderohet divorc; ndryshe është kur ai ka si qëllim divorcin. Kjo është e vërtetë, sipas fjalës së të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Vërtet punët shpërblehen sipas qëllimeve ...” Ajo çka duket nga ngjarja, është se ai burrë e flijoi mizën me qëllim adhurimi. Në parim, veprimi që vjen si rezultat i një kërkesë, është në pajtim me këtë kërkesë. Ne mendojmë ndryshe nga çka mendon autori (Allahu e mëshiroftë!) që do të thotë se nëse ai e ka bërë me qëllim për të shpëtuar veten, duke mos pasur për qëllim adhurimin, atëherë nuk ka bërë kufër, sipas fjalës gjithëpërfshirëse të Allahut: “Kushdo që mohon Allahun pasi ka besuar (do të dënohet ashpër), përveç atij që është i detyruar me forcë, ndërkohë që zemra e tij është plot besim. Ndërsa ata që ia hapin zemrën mosbesimit ...” (Nahl, 106). Domethënë, flitet për atë që kryen një vepër mohimi, për të shpëtuar jetën e vet, por që zemrën e ka të qetë, plot me besim.

Gjithashtu, e sakta është se nuk ka ndryshim ndërmjet fjalës së thënë me detyrim dhe veprimit me detyrim, ndonëse disa dijetarë bëjnë dallim mes tyre, duke u argumentuar me ngjarjen e flijimit të mizës. Ata thonë se nëse detyrohesh për fjalën, nuk bën kufër, por nëse e kryen veprën qoftë edhe me detyrim, ke bërë kufër. Saktësia e ngjarjes në fjalë është e lëkundur kështu që edhe argumentimi me të është i paqëndrueshëm. Sipas sqarimit të lartpërmendur, se veprimi që vjen si rezultat i kërkesës, është në pajtim me këtë kërkesë, nëse supozohet se burri e flijoi mizën për të shpëtuar nga e keqja e tyre, atëherë ne kemi argument të qartë në këtë çështje ajetin: “*Kushdo që mohon Allahun ...*”, pra, nuk përmendet nëse mohimi është me fjalë apo vepër. Përderisa ne kemi një argument të qartë nga Kurani, edhe nëse ai vjen nga Suneti në formë të paqartë,

ai interpretohet sipas argumentit të qartë.

Si përfundim, ai që detyrohet me forcë për të bërë kufër, nuk është kafir, përderisa zemra e tij është e qetë në besim dhe nuk i është hapur gjoksi në mohim.

- Njohja e përmasave të shirkut në zemrat e besimtarëve. Si pranoi vdekjen ai burrë dhe nuk u pajtua me kërkesën e tyre, megjithëse i kërkuan vetëm një vepër të dukshme?!

Autori (Allahu e mëshiroftë!) e ka sqaruar këtë.

A është më mirë që njeriu kur detyrohet të mohojë, të durojë e të vritet, apo të shtiret sikur bën kufër? Kjo çështje duhet shtjelluar.

Kështu, të përputhësh atë që shfaq (kur deklaroi kufrin) me atë që fsheh, kjo nuk lejohet, madje konsiderohet si dalje nga Islami. Nga ana tjetër, ta pranosh (kufrin) në dukje, por jo me zemër, duke pasur për qëllim që të shpëtosh nga pasojat, kjo është e lejuar. Gjithashtu, të mos pranosh kufrin me zemër dhe as në dukje, e për këtë të vritesh, edhe kjo është e lejuar dhe është pjesë e durimit.

Po si është më mirë, të durosh edhe nëse vritesh, apo ta pohosh kufrin vetëm syfaqësisht? Edhe kjo duhet shtjelluar.

Nëse imponimi është i tillë që nuk shkakton dëm në fe për të tjerët, atëherë më e mira është që njeriu ta pohojë kufrin në shfaqje, por jo me zemër, sidomos kur jeta e tij është në dobi të të tjerëve, si në rastin e një pasaniku që shpenzon pasurinë për bamirësi apo të një dijetari e kështu me radhë. Por, edhe nëse jeta e tij nuk sjell ndonjë dobi për shoqërinë, mjafton qëndrimi i tij në Islam dhe shtimi i veprave të mira, e atij i lejohet të shfaqë kufër (pa e pranuar me zemër) në rast detyrimi me forcë. Atëherë pra, më mirë është të shtiret, duke u pajtuar me veprën në sipërfaqësi dhe jo me qëllimin e saj.

Nëse ky pohim i kufrit në shfaqje dhe mosdurimi janë në dëm të Islamit, atëherë njeriu duhet të durojë. Ndoshta durimi në raste të tilla është detyrë, njëlloj si durimi gjatë luftës në rrugë të Allahut të Lartësuar, kur nuk duhet të mendosh më për ruajtjen e jetës. Kur sahabët iu ankuan Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për vështirësitë që u shkaktonin idhujtarët, ai u tregoi çfarë kishte

ndodhur në popujt e mëparshëm, kur njeriut ia ndanin lëkurën nga mishi i tij me krehër të hekurt dhe ai duronte. Me këtë, ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), sikur donte t’u thoshte: “Duroni ndaj vështirësive.” Sikur të ndodhte që sahabët në atë kohë të mohonin syfaqësisht para idhujtarëve, duke qenë të paktë në numër, kjo do t’i sillte një dëm të madh Islamit. Imam Ahmedi, në sprovën e tij të njohur, sikur të pohonte syfaqësisht se Kurani është i krijuar, atëherë do të shkaktohej një dëm i madh për Islamin.

- Ai që u fut në Zjarr ishte musliman, sepse po të ishte kafir, nuk do të thuhej se u fut në Xhehenem për një mizë.

Kjo është e saktë. Ai ka qenë musliman, pastaj ka mohuar me anë të blatimit që bëri për idhullin, vepër e cila u bë shkak për futjen e tij në Zjarr. Po të kishte qenë kafir para blatimit, futja e tij në Zjarr do të ishte për shkak të kufrit të mëparshëm e jo për blatimin.

- Kjo ngjarje përforcon hadithin e saktë: “Xheneti është më afër ndonjërit prej jush sesa rripi i sandales së tij, e po kështu edhe Xhehenemi.”¹

Qëllimi i tij është nxitja për vepra të mira dhe frikësimi nga veprat e këqija. Nëse e di që Xheneti është më afër njeriut sesa rripi i sandales së tij, atëherë ai do të përpiqet për atje, duke menduar se nuk është larg, siç ka thënë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), kur u pyet (nga Muadhi) se çfarë të fut në Xhenet dhe të largon nga Zjarri: “Ke pyetur për diçka të madhe, po që është e lehtë për atë që ia lehtëson Allahu.”² Njësoj mund të themi edhe për Zjarrin: nëse personit i thuhet se ai është më afër se rripi i sandales, ai frikësohet e rrjedhimisht ruhet, me qëllim që të mos rrëshqasë e të shkatërrohet. Ndoshta veç një fjalë mund ta çojë

¹ Buhariu.

² Transmeton Ahmedi, Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Nisaiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

njeriun në gradën më të lartë, e një fjalë tjetër mund ta çojë atë në gradën më të ulët.

- Veprimi i zemrës është qëllimi më i madh, qoftë edhe për adhuruesit e idhujve.

Në fakt, ky përfundim është gati kontradiktor me pikën e nëntë, sepse këtu autori gjykimin e fundit e lidh me zemrën, ndërsa në pikën e nëntë e lidh me veprat e dukshme, duke thënë: “Ai u fut në Xhehenem për shkak të asaj mize, që nuk kishte qëllim ta flijonte, por e bëri këtë për të shpëtuar nga e keqja e atij populli.” Kjo do të thotë se zemra e tij kishte besim të pastër. Ndërsa këtu thotë se veprat vlerësohen sipas qëndrimit të zemrës. Nuk ka dyshim se ajo që ka thënë autori këtu (Allahu e mëshiroftë!) është e vërtetë, sepse boshti i të gjitha çështjeve është zemra.

E vërteta është se puna e ka esencën në zemër dhe se njerëzit ndryshojnë në punët e zemrës më tepër sesa në veprat e dukshme. Ndryshimi ndërmjet tyre në qëllim dhe përulje me zemër, është më i madh se ndryshimi që ata kanë në vepra. Ka njerëz që adhurojnë Allahun me vepra, por janë mendjemëdhenj, gjë e cila i pengon të përulen ndaj çdo të vërtete. Ndërsa disa të tjerë përulen ndaj së vërtetës, por kanë mangësi në qëllimin e tyre, pra tek ata shihet njëfarë syëfaqësie.

Për këtë arsye, qëndrimet dhe “fjalët” e zemrës kanë rëndësi madhore. Njeriu e ka detyrë që t’i ketë ato vetëm për Allahun. “Fjalët” e zemrës janë besimet e njeriut, si: besimi në Allah, në melekët e Tij, librat e Tij, të Dërguarit e Tij, Ditën e Fundit dhe Caktimin - i mirë qoftë ai i keq - e Tij. Ndërsa qëndrimet e saj janë: dashuria, frika, shpresa, mbështetja, kërkimi i ndihmës e të tjera.

Shërimi për këto është Kurani, Suneti dhe kthimi në jetën e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), për të njohur gjendjet, fjalët, përpjekjet dhe thirrjen e tij. Kjo është ajo që të ndihmon në luftën e zemrës. Po kështu, një nga shkaqet e rregullimit të zemrës është mosangazhimi i tepërt i saj me dynjanë.

Tema 11

Nuk lejohet kurbanin për Allahun në ato vende ku bëhen fljime për të tjerë veç Allahut.

Kjo është ndër renditjet më të shkëlqyeshme të autorit, pasi në temën e kaluar ai trajtoi kurbanin jo për Allahun, kurse në këtë temë trajton kurbanin për Allahun, por në një vend ku bëhen fljime për të tjerë veç Tij, domethënë të bësh kurban për Allahun në një vend ku bëhen blatime për idhujt. Kjo është e ndaluar, sepse është përputhje në dukje me idhujtarët. Shejtani, në këtë rast, mund të shtjerë në zemrën tënde qëllimin e keq dhe, rrjedhimisht, mund të besosh se kurbanin në këtë vend është gjë më e mirë, e kjo është tepër e rrezikshme.

Allahu i Madhëruar thotë: “Ti në atë xhami kurrë mos fal namaz! Ndërsa xhamia e themeluar në përkushtim (**ndaj Allahut**) që në ditën e parë, pa dyshim që është më e denjë për të falur namaz në të. Aty ka njerëz që duan të pastrohen. Allahu i do ata që pastrohen shpesh.” (**Teube, 108**)

– “*Ti në atë xhami kurrë mos fal namaz!*” – Është fjala për xhaminë që u ngrit për qëllime të këqija Allahu thotë: “Janë edhe ata që ndërtojnë një xhami për t’u shkaktuar dëm (besimtarëve), për ta forcuar mohimin dhe për të krijuar përçarje në mesin e besimtarëve, duke iu shërbyer ajo si pusi atyre që qysh më parë luftonin kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij ...”. (Teube, 107)

Qëllimet e ngritjes së kësaj xhamie ishin:

1. Dëmtimi i xhamisë Kuba, dhe për këtë u quajt *Mesxhid ed Dirar* (Xhamia e Sherrit).

2. Mohimi i Allahut. Në të planifikohej kufri (Allahu na ruajtë prej tij!), pasi ata që e ndërtuan ishin munafikët.

3. Përçarja e muslimanëve. Nga një rresht apo dy me besimtarë, që faleshin në Xhaminë Kuba, do të faleshin vetëm gjysmë rreshti.

4. Mbrojtja e atyre që luftonin Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Një burrë i quajtur Ebu Amir el Fasik, i cili mbante lidhje me ndërtuesit e xhamisë, pasi ai kishte qenë edhe ideatori i saj, shkoi në Sham, me qëllim që të mblidhte njerëzit e vet në të, e së bashku të kurdisnin kurthe kundër Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe shokëve të tij. Allahu i Lartësuar thotë: “Vërtet ata betohen: ‘Ne kishim për qëllim që të bënim vetëm një vepër të mirë!’” Kjo është tradita e munafikëve, betimi i rremë, por përgjigjja për këtë betim ishte: “Por Allahu dëshmon se, në të vërtetë, ata janë gënjeshtarë.” (Teube, 107). Allahu dëshmoi për gënjeshtren e tyre, sepse ajo që fshihnin, ishte në zemrat e tyre dhe atë që është në zemër e di vetëm Njohësi i të fshehtave. Pra, për Allahun, ajo që fshihet në zemër është njëlloj si diçka e dukshme që shihet me sy. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “... dhe Allahu dëshmon se hipokritët janë me të vërtetë gënjeshtarë.” (Munafikun, 1).

– “... *Ti në atë xhami kurrë mos fal namaz ...*” – Tregon se kjo xhami do të mbeste xhami hipokrizie.

– “... *Ndërsa xhamia e themeluar në përkushtim që në ditën e parë, pa dyshim që tek ajo është më e denjë për të falur namaz ...*” – Kjo do të thotë se devotshmëria ishte themeli i saj dhe mbi atë bazë u ndërtua. Cilësimi i xhamisë si “më e denjë” nuk tregon shkallë krahasore, pra nga ajeti nuk duhet të kuptohet se të dyja xhamitë janë të vlefshme, por njëra ka vlerë më shumë se tjetra, sepse xhamia e Sherrit nuk mund përdorej kurrsesi si xhami. Këtë fenomen e has në shumë vende në Kuran, si për shembull: “Banorët e Xhenetit, atë Ditë do të kenë banesën më të mirë dhe vendet më të këndshme për prehje.” (Furkan, 24).

– “... *në të. ...*” – Në këtë xhami, themelet e së cilës janë vendosur

në përkushtim.

– “... *Aty ka njerëz që duan të pastrohen. ...*” – Ndryshe nga ata të xhamisë së Sherrit, të cilët ishin të pistë, siç thotë Allahu për munafikët: “Kur të ktheheni tek ata, do t’ju betohen për Allahun që t’i lini. Largohuni prej tyre! Vërtet ata janë të papastër ...” (Teube, 95).

Pastërtia përfshin dëlirësinë e zemrës nga hipokrizia, zilia, mëria e të tjera, si edhe pastrimin e trupit nga ndotjet dhe jashtëqitjet.

– “... *Allahu i do ata që pastrohen shpesh.*” – Kjo dashuri është reale. Ajo i pohohet Allahut (Subhanehu ue Te’Ala) ashtu siç i përshtatet Madhërisë së Tij dhe nuk i shëmbëllen dashurisë së krijesave. Ndërsa shtrembëruesit e attributeve të Zotit thonë se me “dashurinë e Tij” nënkuptohet shpërblimi dhe dëshira e Tij. Ata e komentojnë me një veprim të Tij ose me dëshirën e Tij, por kjo është gabim.

Ajeti lidhet me temën në fjalë sepse xhamia e Sherrit u ndërtua për kryerjen e gjynaheve, për të dëmtuar, për kufrin dhe përçarjen e muslimanëve dhe, për këtë arsye, Allahu i Lartësuar e ndaloi të Dërguarin e Tij të shkonte atje për të falur namazin. Kjo tregon se ne nuk duhet të qëndrojmë në një vend ku kundërshtohet Allahu i Lartësuar. Ajo xhami u ngrit kinse për namaz, por, në të vërtetë, ajo ishte vend gjynahu, prandaj njerëzit nuk mund të faleshin atje.

Kurbani është haram në ato vende ku blatohet për tjetërkënd veç Allahut të Lartësuar, dhe kjo ngjan me faljen e namazit në xhaminë e Sherrit. I tillë është edhe ndalimi i namazit në çastet kur dielli është duke lindur dhe duke perënduar. Ato janë dy kohë kur idhujtarët i bëjnë sexhde diellit. Kjo në aspektin kohor, ndërsa hadithi që ka përmendur autori (Allahu e mëshiroftë!) flet për aspektin vendor.¹

¹ Pika e argumentimit me ajetin për çështjen në fjalë, është në aspektin e analogjisë (kijasit). Allahu e ka ndaluar të Dërguarin e Tij (salallahu alejhi ue selem) të qëndrojë në këtë xhami e cila u ndërtua për qëllime të poshttra, megjithëse ai do të qëndronte në të për Allahun. Po kështu, nuk u lejohet njësuesve të Allahut të presin kurbanë për Allahun, në vendet të cilat janë përgatitur për t’u therur në to për dikë tjetër përveç Tij. Kjo, sepse ato janë themeluar për kundërshtimin e Allahut dhe ortakëri me Të. Kjo domethënie

Thabit Ibn Dahaku tregon: “Një burrë ishte zotuar se do të therte një deve në vendin e quajtur Buvaneh. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) pyeti: ‘A ka pasur ndonjë idhull atje, që adhurohej në kohën e injorancës?’ Të pranishmit iu përgjigjën: ‘Jo.’ Ai vazhdoi: ‘A festohej atje ndonjë nga festat e tyre?’ – ‘Jo.’ – i thanë. Atëherë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i tha: ‘Çoje në vend zotimin tënd! Nuk zbatohet zotimi që bie në kundërshtim me Allahun e Lartësuar, e as për gjëra që njeriu nuk i zotëron’”¹

– “... Një burrë ishte zotuar ...” – Zotim do të thotë t’i vësh detyrë vetes diçka që nuk është obligim fetar, për hir të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Të tjerë kanë thënë se nuk është e nevojshme të thuhet: “diçka që nuk është obligim fetar”, sepse zotimi për një obligim fetar bëhet dy herë detyrë: si zotim dhe si urdhër fetar. Në këtë është detyrë shlyerja (*kefareti*), nëse nuk përmbushet.

Në vetvete zotimi është i urryer. Madje disa dijetarë shkojnë deri në konsiderimin e tij haram, sepse Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka ndaluar atë duke thënë: “Ai nuk sjell të mira, por del vetëm nga koprraci.”² Duke u zotuar, njeriu e detyron veten me diçka për të cilën Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) e ka lënë të lirë, që do të thotë të shtosh detyrimet mbi veten. Po kështu, në të shumtën e rasteve, ai që zotohet, pendohet dhe, më pas, e sheh atë të pyesë andej-këtej, duke kërkuar të shpëtojë nga pesha dhe vështirësia e përmbushjes së zotimit. Kjo ndodh sidomos me disa njerëz të thjeshtë, të cilët, kur sëmuren ose kur u vonohet diçka që e duan, nisin e zotohen. Kjo shpreh pesimizmin e njeriut, se gjoja Allahu e ka lënë pas dore, e kështu i duhet të zotohet.

– “... A ka pasur ndonjë idhull atje ...” – Fjala “idhull” (*uethen*)

përforcohet edhe me hadithin që vjen më pas. (Marrë nga “Tejsirul Azizil Hamid”.)

¹ Transmeton Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

² Buhariu.

shënon çdo gjë që adhurohet veç Allahut, qoftë pemë apo gur, i gdhendur, i skalitur apo jo. Ndërsa fjala (arabe) “*sanem*” shënon posaçërisht një idhull që e ka prodhuar njeriu.

– “... *injurancës* ...” – Ky term cilëson periudhën para Shpalljes (së Islamit). Është quajtur kështu, sepse njerëzit asokohe ishin në një injurancë të madhe.

– “... *festë* ...” – Fjala arabe “*iid*” (festë) tregon diçka që përsëritet. Domethënë pyetja ishte: a e kishin zakon njerëzit e kohës së injurancës të shkonin tek ai vend e të festonin atje, edhe nëse nuk kishte idhull? Përgjigjja ishte “Jo”. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e pyeti atë për dy gjëra: për shirkun dhe për mjetet që të çojnë në të. Për shirkun, pyeti: “A ka pasur ndonjë idhull atje?” Ndërsa për mjetet që të çojnë drejt tij, tha: “... A festohej atje ndonjë nga festat e tyre? ...”

– “... *Çoje në vend zotimin tënd!* ...” – A është ky një urdhër i vërtetë apo ai nënkupton lejimin e veprës? Me të mund të nënkuptohet lejimi, ashtu siç mund të merret edhe si urdhër i vërtetë. Për sa i përket flijimit të devesë, urdhri merret me kuptimin e drejtpërdrejtë, ndërsa për sa i përket vendit të flijimit, themi se shprehja nënkupton thjesht lejimin e veprës, sepse nuk është kusht që të bësh kurban atje. Çfarëdolloj vendi në tokë është i papërcaktuar, vetëm nëse ai dallohet për vlerën e tij. Vendet e përcaktuara për vlerën e tyre janë tri xhamitë e shenjta. Atëherë, për sa i përket urdhrin për therjen e devesë, ai ishte detyrë, ndërsa për vendin e caktuar, ai ishte thjesht tregues i lejimit të veprës. Këtë e vërtetojnë dy pyetjet që bëri Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Sikur përgjigjja e kthyer të ishte pozitive, ai do të thoshte që zotimi të mos zbatohet. Përdërisa flitet për ndalim dhe lejim, atëherë themi që urdhri në këtë rast tregon lejim.

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e përligji këtë urdhër me mospasjen e ndonjë pengese, duke thënë: “Nuk zbatohet zotimi që bie në kundërshtim me Allahun e Lartësuar...”

– “... *Nuk zbatohet zotimi që bie në kundërshtim me Allahun.*” –

Pra, nuk mund të zbatohet zotimi duke kundërshtuar Allahun, sepse nuk mund të afrohesh tek Ai duke kundërshtuar Atë.

Llojet e zotimit

- *Zotimi, përmbushja e të cilit është detyrim*, siç është zotimi në bindje ndaj Allahut. Argument është thënia e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Kush zotohet që t’i bindet Allahut, le t’i bindet Atij.”¹

- *Zotimi, zbatimi i të cilit është haram*, siç është zotimi që bie në kundërshtim me Allahun. “Kush zotohet që ta kundërshtojë Allahun, të mos e kundërshtojë Atë.”² “Nuk zbatohet zotimi që bie në kundërshtim me Allahun.”

- *Zotimi i lejuar*, si në rastin e betimit. Për shembull, kur dikush zotohet se do të veshë një rrobë të caktuar, po të dojë, e vesh, e po të mos dojë, nuk e vesh, por e shlyen zotimin, njëlloj siç shlyhet betimi.

- *Zotimi në gjendje depresioni dhe mërzie*. Është quajtur kështu, sepse – siç ndodh shpesh – shkaktar i tij është zemërimi dhe hidhërimi i madh, por nuk është e thënë që të këtë patjetër inat dhe zemërim. Kjo ndodh kur synimi është betimi, nxitja, pengimi, mohimi ose besimi, si në rastin kur dikush thotë: “Sot ndodhi kështu dhe kështu.” Ngrihet një tjetër dhe thotë: “Jo, nuk është e vërtetë! Nëse është e vërtetë, unë zotohem para Allahut të Lartësuar se do të agjëroj një vit.” Qëllimi i këtij zotimi është mohimi. Pasi i bëhet e qartë se nuk është ashtu si mendon ai, ky zotues zgjedh: ose të agjërojë një vit, ose ta shlyejë zotimin, siç shlyhet betimi. Nëse agjëron, ai e ka përmbushur zotimin, nëse nuk agjëron, e ka shkelur atë; dhe shkelësi i zotimit shlyen këtë shkelje me shlyerjen e betimit.

- *Zotimi, zbatimi i të cilit është i urryer* dhe, si rrjedhojë, në këtë rast është detyrë shlyerja e tij ashtu siç shlyhet betimi.³

- *Zotimi i papërcaktuar*, kur nuk përmendet forma e zotimit. Nëse, për shembull, dikush thotë: “I kam vënë detyrë vetes të bëj diçka

¹ Buhariu.

² Buhariu.

³ P.sh.: Një burrë të zotohet për të ndarë gruan e tij, ose për të ngrënë hudhra apo qepë. (Marrë nga futnota e botimit të parë.)

për Allahun”, shlyerja e tij është si shlyerja e betimit, siç ka thënë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Shlyerja e zotimit të papërcaktuar bëhet si shlyerja e betimit të papërmbushur ...”¹

A konsiderohet i vlefshëm zotimi për të bërë gjynah?

Mund të përgjigjemi se po, quhet i vlefshëm, pasi Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kush zotohet që do ta kundërshtojë Allahun, të mos e kundërshtojë Atë!” Po të mos ishte i vlefshëm, do të thoshte: kush zotohet të kundërshtojë Allahun, nuk ka bërë zotim. Fjala e Profetit sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem “... të mos e kundërshtojë Atë!” tregon se zotimi konsiderohet i vlefshëm, por nuk zbatohet.

Nëse ai quhet i vlefshëm, a është detyrë shlyerja e mospërmbushjes së tij apo jo?

Në lidhje me këtë çështje, dijetarët kanë dhënë dy mendime të ndryshme. Nga imam Ahmedi kanë ardhur të dyja variantet. Sipas mendimit të parë, shlyerja e mospërmbushjes së këtij zotimi nuk është detyrë. Argument është thënia e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Nuk zbatohet zotimi që bie në kundërshtim me Allahun”, si dhe: “Kush zotohet që do ta kundërshtojë Allahun, të mos e kundërshtojë Atë!”. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk e ka përmendur shlyerjen, e po të ishte detyrë, ai do ta thoshte.

Sipas mendimit të dytë, shlyerja është detyrë. Ky mendim është edhe më i njohuri në *medhheb*-in tonë,² sepse Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka treguar në një hadith tjetër se shlyerja e tij është si shlyerja e betimit. Mospërmendja e çështjes në hadith, nuk do të thotë se ajo nuk ekziston. Sikur i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të thoshte se nuk ka shlyerje për zotimin e shkelur, ndërmjet dy haditheve do të kishte mospërputhje, dhe ne do të kërkonim atëherë se cili prej tyre ka më shumë epërsi. Por Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk e ka mohuar shlyerjen, përkundrazi, ai ka heshtur, dhe heshtja nuk e mohon të kundërtën. Përfundimisht, argumenti ynë është mospërmendja e kësaj çështjeje.

Nëse Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka thënë hadithin para se ta ndalonte personin, atëherë, nisur nga kjo,

¹ Transmeton Ibn Maxhe dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

² *Medhheb*-in Hanbeli.

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk e ka shprehur që shlyerja është obligim sepse nuk është e detyrueshme që në çdo rast kur diçka përmendet në mënyrë të përgjithshme të ketë kufizim apo veçim. Nëse kjo do të ishte e detyrueshme, atëherë hadithet profetike do të tejzgjateshin. Përkundrazi, kur Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë një hadith me kuptim të përgjithshëm, ndërkohë që ekziston një tjetër hadith që e specifikon të parin, atëherë hadithi i parë interpretohet sipas hadithit tjetër, edhe nëse elementi i veçantë nuk përmendet në hadithin e përgjithshëm. Gjithashtu, duke përdorur analogjinë, sikur një njeri të betohet se do të kryejë një gjynah, atëherë ai duhet të mos e veprojë atë, por duhet të bëjë shlyerjen e shkeljes së betimit. Zotimi është i ngjashëm me betimin. Atëherë, sipas kësaj, shlyerja e tij është si ajo e betimit, e ky është edhe mendimi më i saktë.

– “... e as për gjëra që njeriu nuk i zotëron.” – Kjo shprehje ka dy kuptime. Sipas të parit, do të thotë që nuk është në dorën e zotuesit që ta kryejë atë veprim në aspektin ligjor, si për shembull, kur thuhet: “Zotohem për Allahun, që do të liroj skllavin e filanit.” Ky zotim nuk vlen, sepse ai nuk e ka në dorë lirimimin e skllavit të tjetrit. Ndërsa sipas kuptimit të dytë, veprimi nuk është në dorën e personit në aspektin praktik, si për shembull kur thuhet: “Zotohem për Allahun, që do të të fluturoj me duart e mia.” Ky zotim nuk është i saktë, sepse njeriu nuk mund ta bëjë këtë. Dijetarët e përdorin këtë shembull për gjërat e pamundura.

Nga hadithi mësohet se nuk bëhet kurban në atë vend ku bëhen blatime për dikë tjetër veç Allahut. Ky është shkaku për të cilin autori (Allahu e mëshiroftë!) e ka sjellë këtë hadith.

Urtësi që del prej tij, është se:

- a) Vepra në fjalë të çon në përngjasimin me qafirët.
- b) Ajo bëhet shkak për mashtrimin e të tjerëve me këtë veprim, sepse ai që të sheh duke bërë kurban në një vend ku blatojnë idhujtarët, mund të mendosh se veprimi i tyre është i lejuar.
- c) Idhujtarët, nga ana tjetër, do të forcoheshin në veprimin e tyre, po të shihnin se një besimtar do të vepronte si ata. Pa dyshim që të forcosh idhujtarët është e ndaluar. Po ashtu, t’u shtosh dhembjen idhujtarëve është ndër veprat e mira: “... As

nuk marrin ndonjë hap për t'u shtuar dhembjet dhe plagët armikut, pa iu shkruar si vepër e mirë ..." (Teube, 120).

Dobitë e temës

- Komenti i fjalës së Allahut: "Ti në atë xhami kurrë mos fal namaz."

Ky koment u dha në fillimin e temës.

- Gjynahet mund të lënë ndikim në tokë, po kështu edhe adhurimet.

Kur është vend idhujtarie, njeriut i ndalohet të kryejë atje ndonjë rit që ngjan në formë me ritet pagane, për shkak të përngjasimit me idhujtarët.

A mund të falet namaz në një kishë? Namazi ndryshon në formë nga lutjet e të krishterëve, prandaj edhe nëse e fal namazin në një kishë, nuk bëhesh përngjasues me jomuslimanët. Ky rast është ndryshe nga kurbanit që bëhet në një vend idhujtarie, sepse ky rit (namazi) nuk është i njëjtë në formë me blatimet e idhujtarëve. Rrjedhimisht, edhe nëse fal namaz në një vend ku idhujtarët bëjnë kurbane, kjo lejohet, sepse riti që po kryen ti nuk është i njëjtë me llojin e ritit që bëjnë idhujtarët në atë vend.

Po kështu, edhe adhurimet kanë ndikim në tokë, prandaj thuhet se xhamitë janë më të vlefshme sesa tregjet, dhe xhamitë e vjetra janë më të vlefshme sesa të rejtat.

- Për çështjet e paqarta i referohemi atyre të qarta, që të shmangim kështu paqartësitë.

Ndalimi i kurbanit në atë vend ishte ende një çështje e paqartë, por Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e sqaroi duke kërkuar detaje nga personi që pyeti.

- Kërkimi i hollësive qartësuese nga ana e myftiut, kur është e nevojshme.

Kjo për faktin se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kërkoi hollësi sqaruese. A është detyrë kërkimi i detajeve në të gjitha rastet, apo vetëm kur ekziston mundësia për të kundërtën? Përgjigjemi se nuk është detyrë për çdo rast, por vetëm atëherë kur ekziston mundësia për të kundërtën. Po të kërkonim sqarim për çdo çështje, puna do të shkonte gjatë. Për shembull, sikur të na pyesë dikush për aktin e shitblerjes, nuk është detyrë të kërkojmë sqarime se a ka qenë e njohur kostoja apo plaçka, a ka qenë shitja me kusht apo pa kusht, a e ka pasur pronë të tij apo jo, si e ka pronën e tij, hallall apo haram, a ka faktorë që pengojnë shitblerjen apo jo etj. Mirëpo, nëse ekziston mundësia për të kundërtën, atëherë kërkojmë sqarim, si p.sh. kur vdes dikush dhe lë pas një vajzë, një vëlla dhe një xhaxha nga nëna e babai, dhe diskutohet trashëgimia. Këtu është detyrë të kërkohet sqarim për vëllain, se a është ai vëlla për nënë e babë, apo është vëlla vetëm për nënë. Kjo, se po të jetë vetëm për nënë, nuk i takon trashëgimi, e pjesën që mbetet nga vajza, e merr xhaxhai nga nëna e babai. Në të kundërtën, xhaxhai nuk trashëgon dhe atë që mbetet e merr vëllai.

- Të caktosh një vend për të përmbushur një zotim, nuk ka ndonjë të keqe, gjithmonë nëse nuk ka faktorë pengues.

Ky përfundim del nga fjala: “Çojë në vend zotimin tënd!”

Për sa u përket faktorëve pengues, është njëlloj: si të jenë të pranishëm, si të jenë të pritshëm. Të pranishëm janë kur, për shembull, në atë vend ka ndonjë idhull ose festohet ndonjë festë idhujtarësh, kurse të pritshëm janë atëherë kur ekziston frika se kurbanin në këtë vend mund të çojë në madhërimin e tij. Kështu nëse dikush dëshiron të bëjë kurban në një mal, parimisht ky veprim është i lejuar, por nëse ekziston mundësia se masa e thjeshtë e njerëzve do të mendojë që ai vend paska cilësi të veçanta, atëherë bëhet e ndaluar.

- Pengesë për zbatimin e zotimit është edhe kur në atë vend ka pasur ndonjë idhull, edhe sikur tashmë të jetë hequr.

Kjo del nga fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “A ka pasur ndonjë idhull atje, që adhurohej në kohën e injorancës?” Pyetja “A ka pasur?” është për kohën e shkuar, por ndalesa vazhdon të mbetet edhe pas largimit të idhullit nga ai vend, se ndoshta ai mund të vendoset përsëri aty.

- Gjithashtu, pengesë për përmbushjen e zotimit është edhe kur në atë vend është festuar dikur ndonjë ditë pagane, edhe sikur ajo të mos festohet më atje.

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) pyeti: “A është festuar atje ndonjë nga festat e tyre?”

- Nuk lejohet ta zbatosh zotimin në një vend të tillë, sepse ai konsiderohet zotim në kundërshtim me Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala).

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Nuk zbatohet zotimi që bie në kundërshtim me Allahun!”

- Kujdesi që duhet treguar ndaj përngjasimit me idhujtarët, në festat e tyre, edhe nëse këtë nuk e ke për qëllim.

Nga shejhu i Islamit Ibn Tejmije përcillet se qëllimi nuk është kusht që të ngjasosh me jomuslimanët. Ndalimi i përngjasimit është i vlefshëm edhe nëse njeriu nuk e ka për qëllim, por nëse e ka edhe qëllim, mëkati është akoma më i rëndë. Prandaj shejhu i Islamit Muhamed Ibn Abdul Uehabi thotë: “... edhe nëse këtë (përngjasimin) nuk e ke për qëllim.”

- Nuk lejohet të përmbushet zotimi që bie në kundërshtim me Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala).

Kështu ka thënë autori, por kjo dallon nga shprehja që vjen në hadith: “Nuk zbatohet zotimi që bie në kundërshtim me Allahun”. Nëse thuhet se nuk ka zotim për mëkat, kjo do të thotë se zotimi nuk quhet më i tillë; e nëse thuhet se ai nuk mund të zbatohet, kjo do të thotë se zotimi quhet i tillë, por nuk zbatohet. Në traditën Pejgamberike i gjen të dyja këto forma, por shprehja “nuk ka zotim” interpretohet si “nuk zbatohet zotimi”, sipas hadithit të saktë: “Kush zotohet që do ta kundërshtojë Allahun, të mos e kundërshtojë Atë!”

- Nuk lejohet të përmbushet zotimi për diçka që nuk e zotëron.

Kjo vlen si në aspektin e kompetencave ligjore, ashtu edhe në atë praktikë, gjë të cilën e kemi sqaruar më lart.

Tema 12

Zotimi në emër të dikujt tjetër veç Allahut është politeizëm.

Zotimi në emër të dikujt tjetër veç Allahut është, për shembull, kur dikush zotohet në emër të një njeriu, një varri, apo edhe të vetë Xhibrilit, duke pasur për qëllim shenjtërimin e tyre. Ndryshimi ndërmjet kësaj vepre dhe zotimit për gjynahe është sepse, në rastin e parë zotimi nuk bëhet aspak për Allahun, kurse zotimi për të bërë një gjynah është në emër të Allahut, por përfshin edhe një gjynah. Kur dikush thotë, për shembull, se, për hir të Allahut, ia detyron vetes të bëjë një mëkat, këtu zotimi është për Allahun, por vepra për të cilën është zotuar është gjynah. I ngjashëm me të është betimi në Allah për diçka të ndaluar përkundër betimit në dikë tjetër përveç Tij, për shembull, të thuash: “Për Pejgamber, do të veproj kështu!” Ndërsa të betohesh në Allah për të bërë një gjynah është haram, për shembull, të thuash: “Për Allah, do të vjedh!”

Zotimi jo në emër të Allahut është shirk, sepse ai është një lloj adhurimi e, rrjedhimisht, kush e kryen atë është idhujtar. Ky lloj zotimi nuk konsiderohet aspak zotim dhe nuk është detyrë as shlyerja e shkeljes së tij. Kjo vepër konsiderohet politeizëm, për të cilin njeriu duhet të pendohet. Kështu ndodh edhe me betimin në emër të dikujt tjetër veç Allahut, i cili nuk konsiderohet si betim dhe për të nuk ka shlyerje të shkeljes. Kurse zotimi për të bërë një mëkat konsiderohet zotim, por nuk lejohet të përmbushet. Detyrë mbi të është shlyerja e mospërmbushjes, ashtu siç shlyhet betimi

në Allah për diçka të ndaluar fetarisht.¹

Në këtë temë, autori ka sjellë dy ajete kuranore:

■ Ajeti 1. “Ata e zbatojnë zotimin ...” (Insan, 7)

Ky ajet lavdëron besimtarët e devotshëm, për të cilët thuhet pak më lart (në Kuran): “S’ka dyshim se të devotshmit do të pinë kupa me pije të përzier me kamfur (kamfur aromatik).” (Insan, 5). Lavdërimi që bëhet duke u përmendur këtë cilësi të tyre, tregon se vepra në fjalë është adhurim, sepse njeriu lavdërohet dhe meriton të futet në Xhenet vetëm duke kryer diçka që është adhurim. Nëse autori këtë ajet do ta pasonte me fjalën e Allahut: “... t’i përmbushin zotimet e tyre ...” (Haxh, 29), do të ishte më e qartë, sepse shprehja: “t’i zbatojnë zotimet e tyre” është urdhër, dhe urdhri për zbatimin e një veprë tregon se ajo është adhurim.

Argumentimi i dijetarit me ajetin, që zotimi në dikë tjetër përveç Allahut është politeizëm, qëndron në faktin se Allahu (Subhanehu ue Te’Ala) i ka lavdëruar besimtarët për zbatimin e zotimit, duke e bërë atë shkak për futjen e tyre në Xhenet. Nuk mund të ketë shkak që e fut njeriun në Xhenet, përveç atij që është adhurim, e kjo do të thotë se kush ia kushton adhurimin dikujt tjetër veç Allahut, ka bërë *shirk*.

■ Ajeti 2. “Çfarëdo gjëje që të shpenzoni dhe çdo zotim që të bëni, me siguri që Allahu ka dijëni për atë! ...” (Bekare, 270)

– “Çfarëdo gjëje që të shpenzoni ...” – Me “shpenzimin” nënkuptohet shpenzimi i pasurisë, i cili mund të jetë për mirë apo për keq.

¹ Shejh Sadi thotë: “Zotimi është adhurim dhe Allahu i Lartësuar i ka lavdëruar përmbushësit e zotimeve. Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka urdhëruar për zbatimin e zotimit në punë të mira. Çdo çështje që lavdërohet nga Sheriati, dhe lavdërohet ai që e kryen ose urdhëron për të, është adhurim. Adhurimi është një term i përgjithshëm që përfshin çdo gjë që e do Allahu dhe kënaqet me të, qoftë kjo fjalë apo vepër, e dukshme apo e padukshme, dhe zotimi është pjesë e tyre.

– “... me siguri që Allahu ka dijëni për atë!” – Lidhja e një vepre me dijen e Allahut është argument për shpërblimin e saj. Nuk dimë ndonjë shpjegim tjetër të shoqërimit të diçkaje me faktin që Zoti e di atë, përveçse ajo do të marrë shpërblimin e vet. Shpërblimi i një vepre dëshmon se ajo përfshihet në adhurim, prandaj e ka sjellë këtë ajet autori.

Në një hadith të saktë, përcillet nga Aishja se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kush zotohet që do t’i bindet Allahut, le t’i bindet Atij. Kush zotohet që do ta kundërshtojë Allahun, le të mos e kundërshtojë Atë.¹

– “Kush zotohet ...” – Kjo është një fjali kushtore përgjithësuese. Po a i përfshin ky përkufizim edhe të miturit? Disa dijetarë kanë thënë se i përfshin, domethënë zotimi i tyre konsiderohet i vlefshëm. Po ashtu, të tjerë kanë thënë se nuk përfshihet, sepse të miturit nuk kanë përgjegjësi për detyrimet fetare dhe as për zbatimin e tyre. Rrjedhimisht, të miturit përjashtohen nga ky përgjithësim.

– “... që t’i bindet Allahut ...” – Bindje është zbatimi i urdhrit, që do të thotë të pajtohesh me Allahun në atë që Ai do prej teje kur të urdhëron. Bindje është kryerja e urdhëresave, e nëse Allahu ta ndalon diçka, bindje është largimi prej së ndaluarës. Ky është kuptimi i bindjes kur ajo përmendet veçmas. Nëse pranë fjalës “bindje” vihet fjala “kundërshtim”, bindja i referohet zbatimit të urdhrave, ndërsa kundërshtimi nënkupton kryerjen e haramëve.

– “... t’i bindet Atij ...” – Nga kuptimi i drejtpërdrejtë i hadithit duket se bindja këtu është kryerja e adhurimeve, të cilat për nga lloji mund të jenë *vaxhib*, si për shembull: namazi, haxhi, etj, ose jo *vaxhib*, siç është thellimi në dituri etj.

Disa dijetarë kanë thënë se përmbushja e zotimit është detyrë vetëm nëse adhurimi është i llojit *vaxhib*, por, në të vërtetë, domethënia e tërësishme e hadithit i kundërshton ata. Gjithashtu, kuptimi i drejtpërdrejtë i hadithit duket se përfshin edhe zotimin

¹ Transmeton Buhariu.

për të kryer ndonjë adhurim, qoftë ky i pakushtëzuar, për shembull të zotohesh se do të agjërosh tri ditë, qoftë edhe i kushtëzuar, për shembull: nëse kjo punë del me sukses, unë i zotohem Allahut të Lartësuar se do të agjëroj tri ditë. Megjithatë, nuk është mirë që të bëjmë dallim ndërmjet këtyre rasteve, sepse hadithi është gjithëpërfshirës.

Dije se zotimi nuk sjell të mira, edhe nëse bëhet për punë të mira. Ai buron nga koprraci, dhe kjo është arsyeja që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka ndaluar atë, madje disa dijetarë e konsiderojnë haram. Nga ky mendim anon edhe shejhu i Islamit Ibn Tejmije. Me zotimet, njeriu i ngarkon vetes detyra, nga të cilat ai është i lirë. Sa njerëz zotohen, e së fundi pendohen dhe ndoshta as nuk i përmbushin?! Mendimin se ai është haram e mbështet edhe ajeti: “Ata (hipokritët) betohen për Allahun me deklaratat më solemne, se po t’i urdhërosh ata (o Muhamed) që të shkojnë në luftë - ata me siguri do të shkojnë.” (Nur, 53). Ky angazhim i sigurt me anë të betimit është si zotimi. Pastaj Allahu thotë: “Thuaju: ‘Mos u betoni! Juve ju kërkohet bindja ...’” (Nur, 53), që do të thotë: “Për ju është detyrë bindja, pa pasur nevojë për t’u betuar”. Kur njeriu e bën adhurimin vetëm me zotime ose me betime, duke e quajtur këtë si barrë mbi veten e tij, kjo do të thotë se adhurimi është tepër i rëndë për të.¹

Provë tjetër që tregon epërsinë e mendimit se zotimi është haram – veçanërisht zotimi i kushtëzuar – është se ai që zotohet shpreh njëfarë pasigurie tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) duke menduar se Ai e ndihmon vetëm nëse i premton diçka. Prandaj, kur njerëz të tillë i humbin shpresat për ndihmë, shkojnë e detyrojnë veten me zotime, pa llogaritur se kjo do të thotë të mendosh keq për Allahun e Lartësuar. Për këtë arsye, mendimi se zotimi është haram është mjaft i drejtë.

Nëse pyet ndokush se si mund të konsiderohet i ndaluar, kur Allahu e ka lavdëruar përmbushësin e zotimit, përgjigjemi se ne nuk

¹ Zotimi i kushtëzuar shpjegohet në thënien e Allahut të Lartësuar: “Dhe prej atyre janë disa që bënë marrëveshje me Allahun (duke thënë): ‘Nëse Ai do të na dhuronte neve Begatinë e Tij, me të vërtetë që do të jepnim sadaka dhe padyshim që do të ishim prej të drejtëve.’ Pastaj, kur Ai u dha atyre nga Begatitë e Tij, ata u bënë koprracë dhe kthyen shpinën pa dëshirë (për të dhënë gjë).”

e konsiderojmë përmbushjen e tij të ndaluar, që të thuhet pastaj se e shkatërroam argumentin, por ne themi se e ndaluar ose e urryer në maksimum është bërja e zotimit, e dallimi mes tyre është i qartë.

– *“Kush zotohet që do ta kundërshtojë Allahun, le të mos e kundërshtojë Atë.”* – Ndalimi është sipas mëkatit: nëse kundërshtimi është haram, edhe përmbushja e tij është haram; nëse kundërshtimi është i urryer, edhe përmbushja e tij është e urryer. Kjo, sepse veprat e ndaluara dijetarët i ndajnë në dy kategori: në harame dhe në të urryera.

Dobitë e temës

➤ Përmbushja e zotimit është detyrë.

Bëhet fjalë për zotimin në bindje të Allahut, siç ka thënë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Kush zotohet që t’i bindet Allahut, le t’i bindet Atij ...”. Këtë e mbështet edhe fjala e autorit: “Nuk lejohet zbatimi i zotimit që bie në kundërshtim me Allahun.”

➤ Pasi mësohet se zotimi është adhurim, atëherë t’ia kushtosh atë dikujt tjetër veç Allahut është politeizëm.

Është rregull në teuhidin e adhurimit: për çdo veprim i cili është adhurim, t’ia kushtosh dikujt tjetër veç Allahut është shirk.

➤ Nuk lejohet përmbushja zotimit që është në kundërshtim me Allahun.

Siç ka thënë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Kush zotohet që do ta kundërshtojë Allahun, le të mos e kundërshtojë Atë!”

Tema 13

Kërkimi i mbrojtjes nga dikush apo diçka tjetër, veç Allahut të Lartësuar, është shirk.

Allahu i Lartësuar thotë: “Në të vërtetë, ka pasur burra nga njerëzit, që u kërkonin mbrojtje burrave nga radhët e xhindëve, por ata (xhindët) ua shtuan atyre (njerëzve) edhe më shumë frikën dhe tmerrin.” (Xhin, 6)

– “... është element politeizmi.” – Parafjala arabe “*min*”, në titullin e temës, tregon pjesë të së tërës. Ky rregull nuk është në formë absolute, sepse kur kërkon mbrojtje nga një person për diçka që ai ka mundësi ta bëjë, është e lejuar, njëlloj sikur kërkon një ndihmë.

– “... Në të vërtetë, ka pasur burra nga njerëzit, që kërkonin mbrojtje ...” – Në gjuhën arabe ka dy fjalë për kërkimin e mbrojtjes: *a’adhe* dhe *ladhe*¹. “*A’adhe*” përdoret për gjëra nga të cilat ke frikë, ndërsa “*elijadh*” është për gjërat që shpreson.

– “... që u kërkonin mbrojtje burrave nga radhët e xhindëve ...” – Pra, kërkonin mbrojtjen e tyre nga ajo që kishin frikë, duke menduar se ata do t’i mbronin, por kjo ua shtoi më shumë frikën, panikun dhe mosbesimin. Arabët në kohën paraislamike, kur zbrisnin në ndonjë luginë, thërrisnin me zë të lartë: “Unë mbrohem

¹ “El-Lijadh” është kërkim ndihme për të mirë, pra kur do ndonjë të mirë thua: “eludhu bike”; ndërsa për gjërat që ke frikë thua: “eu’dhu bike”

me të parin e kësaj lugine nga mendjelehtët e popullit të tij!”

Ajeti dëshmon se kërkimi i mbrojtjes me anën e xhindëve është haram dhe nuk i bën dobi atij që e kërkon atë, madje përkundrazi ia shton tmerrin. Pra, ata për të cilët flitet në ajet, u dënuan me të kundërtën e asaj që deshën të arrinin.

Këtë fragment e kanë komentuar gjithashtu, duke thënë se njerëzit ua shtuan xhindëve mendjemadhësinë dhe arrogancën, por i saktë është mendimi i parë.

- “... *burrave nga radhët e xhindëve ...*” – Nga kjo pjesë mësohet se në mesin e xhindëve ka burra dhe gra.

Është e mundur që burrat e xhindëve të kryejnë marrëdhënie seksuale me gratë e njerëzve dhe anasjelltas. Dijetarët kanë pasur mendime të ndryshme për sa i përket detyrimit të *guslit* pas kësaj lloji marrëdhënieje. Juristët, në temën e *guslit*, thonë se: nëse një grua pretendon se ajo ka një xhind si burrë, me të cilin kryen marrëdhënie seksuale, atëherë për të është detyrë të bëjë larje *gusël*. Edhe për rastin kur burri bën marrëdhënie seksuale me një grua xhinde (ose perrri), thuhet një gjë e tillë, por unë nuk e kam gjetur të cituar nga dijetarët. Thuhet gjithashtu se të gjitha këto janë trillime, dhe Allahu është më i Dituri. Ajo çfarë duhet të besojmë ne është ekzistenca e xhindëve dhe fakti se ata kanë detyrime Sheriati. Nga ata ka të drejtë dhe të padrejtë, disa prej tyre janë besimtarë dhe disa jobesimtarë e ndër ta ka burra dhe gra.

Lidhja e ajetit me çështjen në fjalë është se në të qortohen ata që kërkojnë mbrojtje me të tjerë veç Allahut të Lartësuar. Ai që kërkon të mbrohet me diçka, nuk ka dyshim se e ka lidhur shpresën me të dhe është mbështetur tek ajo, e kjo është një nga format e politeizmit.

Heula Bintu Hakimi tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të thotë: “Kushdo që ndalet në një vend dhe thotë aty: ‘Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut nga e keqja e asaj që Ai ka krijuar!’ (*Eudhu bi kel-limatil-lahi tam-mati min sherr-rii ma haleka*), nuk ka për t’i bërë keq asgjë, derisa të

zhvendoset nga ai vend.”¹

– “... *Kushdo që ndalet në një vend ...*” – Kjo vlen si kur ndalet vazhdimisht e për të qëndruar gjatë, edhe për qëndrimet e përkohshme, për pak çaste.

– “... *kërkoj mbrojtje ...*” – Do të thotë: kërkoj strehim dhe siguri.

– “... *me fjalët e përsosura të Allahut ...*” – Me “*fjalët*” nënkuptohen urdhrat krijues dhe vënia e ligjeve. Ato janë të përsosura në dy aspekte: së pari, në vërtetësinë e kumtit dhe, së dyti, në drejtësinë e gjykimit: “Fjala e Zotit tënd është e përsosur me vërtetësi dhe drejtësi.” (En’am, 115).

– “... *nga e keqja e asaj që Ai ka krijuar ...*” – Allahu i Lartësuar ka krijuar gjithçka, si të mirën, ashtu edhe të keqen, por e keqja nuk i atribuohet Atij, sepse Ai e krijoi atë për një urtësi, nëpërmjet së cilës e keqja kthehet në të mirë. Sipas kësaj që u përmend themi se e keqja nuk është në veprimin e Allahut të Lartësuar, por në pasojën e veprimit të Tij, pra krijesat e Tij.

Jo në çdo gjë që ka krijuar Allahu ka ligësi, por mund të kërkojmë mbrojtje nga e keqja e saj, nëse ajo ka, sepse krijesat e Allahut të Lartësuar ndahen në tri lloje: 1. krijesa tërësisht të këqija, si: Xhehenemi e Iblisi. Kjo, sa u përket qenieve të tyre, ndërsa në pikëpamjen e urtësisë për të cilën Allahu i krijoi, ato janë mirësi. 2. Krijesa krejtësisht të mira, si: Xheneti, Profetët etj. 3. Krijesa që përmbajnë edhe mirësi, edhe ligësi, siç janë krijesat e tjera në përgjithësi. Pra, mbrojtja kërkohet nga e keqja e asaj që përmban ligësi.

– “... *nuk ka për t'i bërë keq asgjë ...*” – Kjo thënie është përgjithësuere. Ajo përfshin gjithçka që ka ligësi, qoftë nga xhindët apo nga njerëzit etj. i dukshëm apo i padukshëm, derisa të zhvendoset nga ai vend. Ky është një lajmërim, e si i tillë nuk mund të jetë në kundërshtim me realitetin, sepse atë e ka sjellë Muhamedi

¹ Transmeton Muslimi.

(sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i cili thotë vetëm të vërtetën dhe është i frymëzuar nga Allahu me të vërtetën. Por nëse ajo nuk realizohet, shkak është prania e ndonjë pengese, e jo faktori i pafrytshëm apo fjala e pavend.

Kjo vlen për çdo faktor të ligjshëm e real që na ka treguar Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), por që kur vepron, nuk jep rezultat. Për shembull, leximi i sures “Fatiha” mbi të sëmurin është faktor shërues real, edhe pse shumë njerëz e lexojnë atë mbi të sëmuret, por këta të fundit nuk shërohen. E meta nuk qëndron te faktori, por te pengesat që nuk lejojnë që shkak të japë efektin e vet. Po kështu ndodh edhe me rastin e lutjes së njohur që bëhet para kryerjes së marrëdhënieve seksuale, e cila pengon dëmin e shejtanit ndaj fëmijës. Ka raste që lutja bëhet, e megjithatë shejtani mund ta dëmtojë fëmijën, për ndonjë shkak që e pengon arritjen e rezultatit të këtij faktori. Atëherë, duhet të hetosh se cila është pengesa, me qëllim që ta largosh, dhe kështu do të arrish frytet e pritshme.

Kurtubiu thotë: “Këtë lutje e kam provuar, por një ditë hyra në banesën time pa e thënë atë dhe më kafshoi një akrep.”

Pjesa e hadithit që dëshmon për temën në fjalë është: “Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut ...”. Por, në titullin e temës thuhet: “Kërkimi i mbrojtjes nga dikush apo diçka tjetër, veç Allahut të Lartësuar”, ndërkohë që këtu autori flet për kërkimin e mbrojtjes me fjalët e Allahut dhe jo nga Allahu i Lartësuar. Përse ndodh kjo? Përgjigjja është se fjalët e Allahut të Lartësuar janë attribute të Tij. Dijetarët argumentohen me këtë hadith, se fjalët e Allahut të Lartësuar janë atribut i Tij e nuk janë të krijuara prej Tij. Kërkimi i mbrojtjes nga krijesat nuk lejohet në çështje të tilla si kjo, e sikur fjalët e Allahut të ishin të krijuara, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk do të porosiste për kërkimin e mbrojtjes nëpërmjet tyre. Për këtë arsye, tema e dhënë nga autori mund të kuptohet: “Kërkimi i mbrojtjes nga dikush apo diçka tjetër, veç Allahut të Lartësuar dhe ndonjë atributi të Tij”.

Në një hadith tjetër thuhet: “Mbrohëm me Krenarinë e Allahut dhe Fuqinë e Tij nga e keqja që gjej (nga dhimbja) dhe i ruhem.”¹ Edhe këtu, mbrojtja kërkohet me Krenarinë dhe me Fuqinë e

¹ Muslimi.

Allahut të Lartësuar dhe jo nga Allahu i Lartësuar. Krenaria dhe Fuqia janë attribute të Allahut të Lartësuar dhe nuk janë të krijuara. Po për këtë arsye, lejohet betimi në Allahun e Lartësuar dhe në atributet e Tij, sepse këto të fundit nuk janë të krijuara, pra nuk janë krijesa.

Për sa i përket betimit në ajetet, nëse është fjala për ajetet e Sheriatit (ajetet e Kuranit), lejohet, e nëse është fjala për ajetet e krijimit (shenjat, faktet që përshijnë në vetvete krijesat), nuk lejohet¹.

Kërkimi i mbrojtjes nga krijesat ka nevojë për sqarim. Kështu, nëse për krijesat është totalisht dhe realisht e pamundur ta bëjnë një gjë të tillë, atëherë t'ua kërkosh atyre këtë gjë është politeizëm. Shejhu i Islamit Ibn Tejmije ka thënë: “Asnjë nga imamët e mëdhenj nuk e quan të lejuar kërkimin e mbrojtjes nga krijesat.” Ky rregull nuk merret në formë absolute, sepse qëllimi është për atë mbrojtje që askush nuk ka mundësi të ta japë, veç Allahut. E tillë është, për shembull, të kërkosh mbrojtje nga të vdekurit në varreza, të cilët, në fakt, nuk mund të bëjnë as dëm e as dobi. Kjo vepër është shirk i madh, e kryer ajo qoftë te varret, qoftë larg tyre.

Ndërsa kërkimi i ndihmës nga krijesat në atë gjë që kanë mundësi ta bëjnë, është i lejuar. Në të ka orientuar shejh Sulejmani në “Tejsirul Azizil Hamid”. Kjo është domethënia e haditheve të sakta që kanë ardhur në sahihun e Muslimit, kur Profeti (sal-lallahu ‘alejhi ue sel-lem) përmendi fitnet (sprovat) tha: “Kush gjen ndonjë vendstrehim (mbrojtje) nga e keqja e saj (fitnes), le të mbrohet me të.”²; historia e gruas që i kërkoi mbrojtje Umu Selemes³; djaloshi që u mbrojt me Profetin; tregimi i atyre që kërkuan strehim në Kabe, në Vendin e Shenjtë⁴ e të tjerë të ngjashëm.

Këtu le të sqarojmë diçka. Nëse më dalin banditët në rrugë (për të më shkaktuar dëm) e unë mbrohem me një njeri që ka mundësi të

¹ Ajetet e Kuranit janë fjalë e Zotit dhe jo të krijuara, kështu që lejohet të betohesh në to. Ndërsa ajetet e krijimit (keunije) si p.sh dielli hëna, toka, etj., janë të krijuara, kështu që nuk lejohet të betohesh në to.

² Buhariu dhe Muslimi.

³ Sipas përcjelljes në “Sahihun” e Muslimit.

⁴ Transmetimi është po te Muslimi.

më shpëtojë prej tyre, nuk ka asgjë të keqe. Por, nuk ka dyshim, lidhja e zemrës me krijesat është shirk. Nëse ti e lidh zemrën, shpresën, frikën dhe të gjitha çështjet e tua me një person të caktuar, duke e bërë atë mbrojtjen tënde, kjo është shirk, sepse një gjë e tillë duhet të jetë vetëm për Allahun. Atëherë, sipas kësaj, fjala e shejhut se “imamët nuk e lejojnë kërkimin e mbrojtjes nga krijesat”, është e kufizuar për gjërat që nuk ka mundësi dikush tjetër përveç Allahut. Sikur argumentet të mos kishin ardhur të shtjelluara, do ta merrnin fjalën si të përgjithshme e do të thoshim se nuk lejohet në mënyrë absolute kërkimi i mbrojtjes nga dikush tjetër veç Allahut.

■ **Dobitë e temës**

- Komenti i ajetit të sures “Xhin”.

U bë në fillim të temës.

- Kërkimi i mbrojtjes nga të tjerë veç Allahut është politeizëm.
- Hadithi tregon se fjalët e Allahut nuk janë të krijuara, pasi hadithin e lartpërmendur dijetarët e sjellin si argument që fjalët e Allahut nuk janë të krijuara, për vetë faktin se kërkimi i mbrojtjes nga krijesa është idhujtari.

Mënyra e argumentimit tregon se kërkimi i mbrojtjes me fjalët e Allahut nuk ndryshon prej kërkimit të mbrojtjes nga vetë Ai, sepse ato janë attribute të Tij.

- Vlera e madhe e kësaj lutjeje, edhe pse është e shkurtër.

Dobia e saj nuk shteron, përderisa vazhdon të qëndrosh në një vend të caktuar.

- Fakti se se diçka mund të jetë dobiprurëse në këtë botë, si për pengimin e një të keqeje apo për arritjen e një të mire, nuk tregon se ajo nuk është shirk.

Kuptimi i kësaj është se ndoshta një vepër mund të jetë *shirk* edhe pse njeriu mund të ketë prej saj ndonjë dobi. Njeriu mund të “përfitojë” nga një vepër që është shirk, si për shembull kur kërkon mbrojtje nga xhindët. Po kështu edhe kur i përulesh në sexhde një mbreti dhe ai të dhuron pasuri e pallate. Ky veprim është politeizëm, pavarësisht se ka dobi materiale. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ca njerëz që i ngrenë që qiell me lavdërime mbretërit e tyre, për shkak të favoreve që përfitojnë nga ata, dhe kjo nuk i përjashton ata nga të qenët idhujtarë.

Mësim tjetër prej hadithit është se feja, për çdo dukuri të kohës paraislamike që e ka zhvleftësuar, ka treguar diçka tjetër më të mirë se ajo. Në kohën e *xhahilijet*-it njerëzit kërkonin mbrojtje nga xhindët, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ndryshoi këtë, duke e zëvendësuar me mënyrën tjetër: “Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut nga e keqja e asaj që Ai ka krijuar!”

Kjo është rruga më e mirë që duhet të ndjekë çdo ftues në fenë e Allahut. Kur ai të mbyllë një derë të së keqes për njerëzit duhet të hapë për ta një derë të mirës, e jo të thotë thjesht se është haram dhe të heshtë. Allahu i Lartësuar thotë: “O besimtarë! Mos thoni “*Ra’ina*” (na shiko me kujdes që të kuptojmë), por thoni “*Undhurna*” (Na shiko!)¹ Dhe dëgjoni! Për mohuesit ka dënim të dhimbshëm.” (Bekare, 104). Pasi ua ndaloi fjalën “*Ra’ina*”, Allahu u mësoi një fjalë tjetër, që e zëvendësonte të parën: “*Undhurna*”, e cila kishte të njëjtin kuptim. Ndërsa shembull nga Suneti është rasti kur Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ndaloi këmbimin tregtar të një sasi më të vogël hurmash më një sasi tjetër më të madhe, por duke mësuar mënyrën e lejuar: “Shiti ato me para, pastaj, me vlerën e

¹ “*Ra’ina*” dhe “*Undhurna*” janë dy fjalë që në arabisht kanë kuptim të njëjtë, por në hebraishten-arabe të shekullit të shtatë fjala “*Ra’ina*” ishte sharje me kuptimin “O i keqi ynë”. Kjo qe arsyeja që u ndalua përdorimi i fjalës së parë.

tyre, bli të tjera.”¹ Pasi ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ndaloi formën që ishte haram, i hapi derën mënyrës së pastër hallall, e cila nuk kishte ndonjë pengesë.

¹ Buhariu.

Tema 14

Kërkimi i ndihmës nga diçka tjetër veç Allahut apo lutja e tjetërkujt, veç Tij, është shirk.

Siç e shpjeguem edhe në temën e kaluar, parafjala arabe “*min*”, në titullin e temës, tregon pjesë të së tërës, që do të thotë se këto fjalë nuk përkufizojnë krejt politeizmin; ai nuk është i tëri vetëm në këtë çështje. Këtu flitet për kërkimin e ndihmës (*istigathe*) vetëm në gjendje vështirësie.

Fjala e autorit nuk merret në aspektin absolut, por duhet të kufizohet me rastet kur njeriut të cilit i kërkohet ndihma nuk ka asnjë mundësi reale të ndihmojë, si për shembull: kur është i vdekur, kur nuk është i pranishëm aty apo kur kërkesa është e plotësueshme vetëm nga Allahu. Kështu, të kërkosh nga i vdekuri apo nga ai që nuk është i pranishëm të të shmangë një të keqe, apo të kërkosh nga një i gjallë dhe i pranishëm që ta bëjë shiun të bjerë, e gjithë kjo është politeizëm. Por nëse kërkon ndihmë nga një njeri i gjallë dhe i pranishëm për diçka që ai ka mundësi reale ta bëjë, kjo është e lejuar. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Njeriu i grupit të vet i kërkoi ndihmë (Musait) kundër atij të popullit armik ...” (Kasas, 15).

Kur kërkon ndihmë nga dikush për të të nxjerrë nga një situatë e vështirë dhe ai ka mundësi të të ndihmojë, atëherë që të jesh i saktë në teuhid, bëhet detyrë për ty që të besosh se ai është thjesht një shkak që nuk ka ndikim të vetvetishëm në largimin e të keqes. Duhet menduar kështu, sepse mund të mbështetesh plotësisht në të, duke harruar Krijuesin e shkakut, e kjo është mangësi në

plotësimin e teuhidit.

– “... apo lutja e tjetërkujt ...”¹ – Kjo i është bashkëlidhur togut

¹ Këtu bëhet fjalë për duanë e kërimit në ato gjëra që nuk ka mundësi askush veç Allahut. Kjo është shirk kur ajo i drejtohet dikujt tjetër veç Allahut, siç do ta përmendë edhe dijetari. Duaja është dy llojesh, duaul *ibade* (lutja e adhurimit) dhe duaul *mes'ele* (lutja e kërimit), siç e kanë vërtetuar shumë dijetarë, prej të cilëve shejhu i Islamit Ibn Tejmije dhe Ibn Kajim el Xheuzi, e të tjerë. Kur përmendet duaja në Kuran njëherë është fjala për njërin lloj, njëherë për tjetrin e nganjëherë për të dyja llojet së bashku.

Duaul *mes'ele*: është kërkitimi i asaj që i bën dobi kërkuarit, për arritjen e dobisë ose shmangin e dëmit. I adhuruari, patjetër duhet të sundojë dobinë dhe dëmin, prandaj Allahu (subhanehu ue teala) e ka kundërshtuar atë që adhuron veç Tij dikë që nuk ka në dorë as dëm, as dobi: “Thuaj (o Muhamed): ‘Si mundet vallë, që ju adhuron në vend të Allahut, atë që nuk është në gjendje t’ju sjell as dëm, as dobi; ndërkohë që Allahu është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdituri.’” (Maide, 76) “Dhe adhurojnë në vend të Allahut gjëra që as i dëmtojnë e as u sjellin dobi dhe thonë: ‘Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu ...’” (Junus, 18) Në Kuran sqarohet shpesh herë se i adhuruari patjetër duhet të sundojë dëmin dhe dobinë. Ky i adhuruar, lutet për dëm dhe dobi me lutjen e kërimit, ndërsa me frikë dhe shpresë me atë të adhurimit. Kështu pra, këto të dyja janë të gërshetuara me njëra-tjetrën: çdo dua adhurimi, tregon detyrimisht për duanë e kërimit dhe çdo dua kërkitimi, përfshin edhe atë të adhurimit.

Me këtë sqarim (kërkim) të hollësishëm, mënjanohej dilemat që hedhin adhuruesit e varreve. Kur ti argumentohesh kundër tyre me ajetet që Allahu ka përmendur në Kuran për faktin se duaja duhet të jetë vetëm për Allahun, thonë se është fjala për adhurimin. Ata thonë se fjala e Allahut: “Xhamitë janë për adhurimin e Allahut, prandaj mos iu lutni askujt krahas Allahut!” (Xhin, 18), do të thotë: mos adhuro askënd me Allahun. Atyre u thuhet se edhe nëse është fjala për duanë e adhurimit, kjo nuk mohon që të përfshihet duaja e kërimit në duanë e adhurimit, sepse kjo e fundit, tregon detyrimisht për duanë e kërimit dhe duaja e kërimit, e përfshin duanë e adhurimit. Kjo, nëse nuk përmendet në mënyrë të veçantë në Kuran duaja e kërimit, por vetëm ajetet ku përmendet duaja e adhurimit. E ç’farë mund të thuhet pastaj, kur në Kuran është përmendur më shumë se një herë: “Lutjuni Zotit tuaj përlulshëm dhe duke qenë të vetmuar. Vërtet Ai nuk i do ata që e kalojnë kufirin.” (Araf, 55) “... dhe i kërkoni Allahut nga Begatitë e Tij.” (Nisa, 32) Po kështu në ajetet En’am, 40-41; Rad, 14; Merjem, 48-49; Isra, 56 e të tjera. Këto ajete janë të mjaftueshme si argument për ndryshimin ndërmjet Teuhidit dhe shirkut në përgjithësi, si dhe për çështjen në fjalë në veçanti.

Ndërsa hadithet e Pejgamberit (salallahu alejhi ue selem) që sqarojnë këtë çështje janë të panumërta. Prej tyre është fjala e tij (salallahu alejhi ue selem) në hadithin *kudsij* që ka përcjellë nga Zoti i tij (subhanehu ue teala): “O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni të uritur, me përjashtim të atij që Unë e ushqej, prandaj kërkoni prej Meje ushqim, t’ju ushqej ju. O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni të zhveshur, me përjashtim të atij që Unë e vesh, prandaj kërkoni prej Meje veshje, t’ju vesh ju. O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni të humbur, me përjashtim të atij që Unë e udhëzoj, prandaj kërkoni prej Meje udhëzim, t’ju udhëzoj ju. O

robërit e Mi! Vërtet të gjithë ju gaboni natën dhe ditën, ndërsa Unë i fal të gjitha mëkatet, prandaj kërkoni prej Meje falje, t'ju fal ju." (Muslimi)

"Zoti ynë zbret në qiellin e dynjasë, kur ka mbetur një e treta e fundit e natës, pastaj thotë: 'Kush më lut Mua, t'i përgjigjem? Kush kërkon prej Meje, t'i jap atij? Kush kërkon falje prej Meje, ta fal?'" (Buhariu, Muslimi)

"Nuk ka gjë më të nderuar te Allahu sesa duaaja." (Ahmedi, Tirmidhiu, Ibn Maxhja, Ibn Hibani dhe Hakimi, i cili edhe e ka saktësuar)

"Ai që nuk e lut Allahun, Allahu zemërohet me të." (Ahmedi, Ibn Ebu Shejbe, Hakimi)

"Kërkojini Allahut prej mirësive të Tij, se Ai do që të kërkohet prej Tij." (Tirmidhiu)

"Duaaja është arma e besimtarit, shtylla e fesë dhe drita e qiejve dhe tokës." (Hakimi dhe e ka saktësuar)

"Duaaja është adhurimi." (Ahmedi, Tirmidhiu), ndërsa në një transmetim tjetër: "Duaaja është palca e adhurimit." (Tirmidhiu) Gjithashtu kur Profeti është pyetur se cili është adhurimi më i vlefshëm, tha: "Duaaja e robit për veten e tij." (Buhariu në "Edeb")

"Kërkoni nga Allahu çdo gjë, deri edhe rregullimin e rripit të këpucës, nëse këputet, se nëse nuk ta lehtëson Ai, nuk është e lehtë." (Ebu Ja'la me zinxhir të saktë)

Umeri (radijallahu anhu) ka thënë: "Mua nuk më shqetëson përgjigjja, por më shqetëson lutja. Kur ndjej të bëj dua, e di se përgjigjja do të jetë me të."

Ibn Abasi ka thënë: "Duaaja është adhurimi më i vlefshëm." dhe lexoi: "Lutmuni Mua, se do t'ju përgjigjem." (Gafir, 60) (Ibn Mundhiri, Hakimi e ka saktësuar)

Mutraf ka thënë: "Mendova se cila është përmbledhësja e mirësisë dhe pashë se e mira ishte e shumtë: namaz, agjërim etj. Ndërkohë ajo është në dorë të Allahut, dhe ti mund ta arrish atë që është në dorë të Allahut vetëm duke e lutur Atë që ta japë". (Ahmedi).

Hadithet dhe dëshmitë që flasin për këtë çështje nuk mund t'i numërojë askush tjetër veç Allahu.

Nga kjo që u tha del se duaaja është një ndër adhurimet më të mira. Madje ajo është nga më të lavdëruarat e tyre tek Allahu, siç u përmend. Nëse ortakëria në të nuk është shirk, atëherë nuk ka shirk në faqen e dheut, e nëse ka shirk në tokë, ai më së pari është në duá, sesa në llojet e tjera të ibadeteve. Madje, shirku në duá ishte shirku më i imadh në të cilin ranë idhujtarët te të cilët u dërgua i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem). Ata lusnin të Dërguarit, njerëzit e mirë dhe melekët. Punonin vepra për t'u afruar tek ata, me qëllim që të ndërmjetësonin për ta tek Allahu. Prandaj, në situata të vështira ata i drejtoheshin Allahut me sinqeritet dhe i harronin ortakët. Është përcjellë se kur ata përjetonin situata të vështira në anijet e tyre, i hidhnin idhujt në det dhe thoshin: "O Allah! O Allah!", pasi e dinin se të adhuruarit (zotat) e tyre nuk mund ta largonin të keqen e as t'i përgjigjeshin atij që kishte rënë në vështirësi. Allahu (subhanehu ue tealá) thotë: "A nuk është Ai, i Cili i përgjigjet të pikëlluarit, kur ai i drejtohet Atij dhe i Cili e largon të keqen edhe u bën juve trashëgues të tokës bres pas brezi? A ka ndonjë zot tjetër me Allahun? Sa pak që mendoni." (Neml, 62) Ata e dinin se kjo i përket vetëm Allahut dhe se zotat e tyre s'kishin asgjë në dorë për këtë çështje. Për këtë arsye, Allahu (subhanehu ue tealá) u argumentoi se Ai është i adhuruarit i tyre i vërtetë dhe u vuri në dukje kotësinë e të adhuruarve të tjerë veç Tij: "Dhe kur hipnin në anije, ata lusnin Allahun duke e bërë besimin e tyre të pastër vetëm për Të, po kur Ai i sjell shëndoshë e mirë në tokë, ç'të shohësh?! Ata i japin një pjesë të adhurimit të tyre, të tjerëve në vend të Allahut."

“*kërkimi i ndihmës*” që do të thotë se të lusësh dikë tjetër veç Allahut, është politeizëm. Kjo për faktin se lutja është formë adhurimi. Allahu i Madhëruar thotë: “Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem. Me të vërtetë, ata të cilët e përbuzin adhurimin ndaj Meje, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar.” (Gafir, 60). “... E përbuzin adhurimin ...” do të thotë: Nuk më luten Mua. Pra, Allahu (Subhanehu ue Te’Ala) e ka quajtur lutjen si adhurim, ndërsa Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Lutja është adhurimi.”¹

Lutja është dy llojesh. Kur është në formë adhurimi, t’ia drejtosh atë dikujt tjetër veç Allahut, është vepër shirku. Kjo ndodh kur ajo shoqërohet me frikë, shpresë, dashuri dhe përlujë. Kur lutja nuk është e tillë, domethënë nuk është adhurim, atëherë lejohet t’ia drejtosh atë një krijese. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kur dikush ju fton, përgjigjuni atij.”² Si dhe: “... nëse të fton, përgjigju.”³ Atëherë, sipas kësaj, autori me thënien “... apo lutja e tjetërkujt ...” do të thotë: t’i drejtohesh me lutje adhurimi ose lutje kërkimi për diçka që ai nuk ka mundësi reale ta përmbushë.

Në titull “lutja” (*duaja*) si koncept i përgjithshëm, vjen pas nocionit të kufizuar të “kërkimit ndihmë” (*istigathe*). “*Istigathe*” (në arabisht) tregon një lutje që bëhet vetëm për largimin e vështirësive,

(Ankebut, 65) Kjo ka qenë gjendja e idhujtarëve më parë, kurse gjendja e adhuruesve të varreve në kohën tonë – La ilahe il-l Allah – sa i madh është ndryshimi i tyre me idhujtarët e parë në çështjen e shirkut. Këta të sotmit, kur i kap e keqja në tokë apo në det, u drejtohen me lutje të singërta të adhuruarve të tyre, idhujve të tyre, të cilët i lusin veç Allahut. Shumica prej tyre, e ka bërë përmendjen e zotit të tij (përveç Allahut) dhe shejhut të tij, gjë të zakonshme, kur ulet, ngrihet dhe pengohet. Njëri thotë: “O Ali!”, tjetri thotë: “O Abdul Kadër!”, tjetri: “O bedeuji!” etj. Në përgjithësi në çdo vend, në të shumtën e rasteve, ka njerëz që i lusin dhe kërkojnë prej tyre përmbushjen e nevojave dhe largimin e të urryerave. Madje, çështja ka arritur deri aty sa të kërkojnë prej tyre faljen e mëkateve, rëndimin e peshores, futjen në Xhenet dhe shpëtimin nga Zjarri, përforcimin në momentin e vdekjes dhe pyetjeve, e lloje të tjera kërkesash, të cilat kërkojnë vetëm prej Allahut. Ndoshta ata i kërkojnë këto prej njerëzve që pretendojnë se janë eulija, duke i mveshur vetvetes mundësinë për këto punë dhe të tjera, nga llojet e dobive dhe dëmeve, të cilat janë të posaçme për Allahun. Njerëzit shpifin për ta, në lidhje me këto çështje, gënjeshtër e gjëra të çuditshme. (Marrë nga “Tejsirul Azizil Hamid”)

¹ Ahmedi, Tirmidhiu dhe Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

² Ahmedi, Ebu Daudi, Nesaiu, Hakimi dhe Bejhakui. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

³ Muslimi.

ndërsa *dua*-ja është e përgjithshme, për faktin se ajo bëhet për arritjen e dobisë ose për largimin e dëmit.

Dijetari (Allahu e mëshiroftë!) në këtë temë ka sjellë disa ajete:

Ajeti 1. “Mos lut tjetër përveç Allahut, nga ata që nuk të sjellin as dobi, as dëm. Nëse do ta bëje këtë, atëherë, ti do t'i kishe bërë padrejtësi vetes.” (Junus, 106)

– “*Mos lut tjetër përveç Allahut ...*” – Nga konteksti duket se ajeti i është drejtuar të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Ajeti mund të jetë i posaçëm për Pejgamberin, ose edhe i përgjithshëm: për të dhe të tjerët, por disa dijetarë kanë thënë se është e pasaktë të mendosh se ajeti i drejtohej vetëm të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), pasi ishte e pamundur që ai të bënte të kundërtën. Kështu që në ajet duhet të nënkuptohet fjala “*thuaj*”. Megjithatë, ky mendim është shumë i dobët dhe e nxjerr ajetin nga konteksti i tij.

E sakta është se ai, ose është i posaçëm për të Dërguarin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ndërsa gjykimi është për të dhe të tjerët, ose është i përgjithshëm, për çdonjë që e meriton t'i drejtohet fjala e Tij (Subhanehu ue Te‘Ala), dhe këtu përfshihet edhe Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Kur paralajmërimi i drejtohet Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), nuk do të thotë se rreziku mund të vijë patjetër prej tij. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Me të vërtetë, të është shpallur ty (o Muhamed) si dhe atyre (të Dërguarve) para teje: ‘Nëse i shoqëron Allahut diçka tjetër në adhurim me siguri që punët e tua do të jenë të pavlera dhe padyshim që do të jesh nga të humburit.’” (Zumer, 65). Pra, fjala i është drejtuar atij dhe të gjithë të Dërguarve, ndërkohë që ishte e pamundur që ai ta kryente atë vepër, duke u nisur nga pozita e tij, e jo nga fakti i të qenit njeri. Atëherë, urtësia e ndalimit është që të tjerët të ndjekin rrugën e tij. Nëse ndalesa i është drejtuar atij – i cili nuk mund t'a bënte kurrësi një gjë të tillë, për shkak të pozitës si pejgamber – atëherë për të tjerët, që mund ta kryejnë atë, është edhe më i fortë.

Lutje quhet kërkesa për një të mirë ose kërkesa për të larguar një të keqe. Ajo është dy llojesh, siç thonë dijetarët:

1. Lutja e adhurimit. Kjo ndodh kur njeriu është duke kryer

urdhrin e Allahut, sepse kur njeriu falet, agjëron, jep zekat, për të fituar shpërblimin e Allahut ose shpëtimin nga dënimi, atëherë veprimet e tij përfshijnë në vetvete edhe lutjen, por këto veprime mund të shoqërohen edhe me lutje të mirëfillta.

2. Lutja e kërkimit. Kjo është thjesht kërkesë për diçka që të bën mirë ose që të ndihmon për të larguar një të keqe.

Lutja e llojit të parë nuk lejohet t'i kushtohet dikujt tjetër veç Allahut, ndërsa lloji i dytë lipset të qartësohet, siç u përmend më lart.

– “... që nuk të sjellin as dobi, as dëm ...” – Pra, nëse i adhuron, ata nuk të sjellin as përfitim dhe as nuk të largojnë ndonjë të keqe. Po ashtu thuhet se, nëse e lë adhurimin e dikujt tjetër veç Allahut, ai idhull nuk mund të të dëmtojë, sepse nuk mund të hakmerret. Kjo është çfarë kuptohet nga shprehja.

Pra, ajeti kuptohet kështu: Mos lut tjetër përveç Allahut, nga ata që nuk të sjellin as dobi, as dëm, sepse ata nuk mund të bëjnë ty as dëm e as dobi. Përcaktimi që i bëhet përemrit “ata” (*që nuk të sjellin as dobi, as dëm*) këtu ka karakter përshkrues, dhe jo dallues, domethënë që nuk do të thotë se ti ke të drejtë të lutësh atë që të bën dobi dhe të bën dëm, përkundrazi, shpjegimi është dhënë për të qartësuar se nga i luturi përveç Allahut, nuk arrihet as dëm, as dobi: “Kush është në rrugë më të gabuar sesa ai, i cili, në vend të Allahut, u lutet atyre që nuk mund t'i përgjigjen atij deri në Ditën e Kiametit e që janë krejt të pavetëdijshëm për lutjet që u bëhen atyre?! Kur njerëzimi të grumbullohet (Ditën e Kijametit), ata (idhujt e tyre) do të jenë armiq të tyre dhe do ta mohojnë adhurimin e tyre.” (Ahkaf, 5-6). Rastin tjetër kur përcaktimi (i një emri ose përemri) nuk është dallues, por përshkrues e gjen në ajetin: “O njerëz! Adhuroni Allahun, Zotin tuaj, i Cili ju krijoi ju dhe ata që ishin para jush ...” (Bekare, 21) Pra, pjesa: “...i Cili ju krijoi ju dhe ata që ishin para jush ...” jep informacion shtesë mbi gjymtyrën përkatëse “Zoti juaj” dhe nuk është dallues, pasi dihet që nuk ka ndonjë Zot tjetër që na ka krijuar ne dhe ata para nesh. Ka edhe mjaft ajete të tjera me shembuj të tillë.

Çdo përcaktim me anë të të cilit synohet përshkrimi më i hollë i reales është edhe arsyetim për gjykimin, si p.sh.: “O njerëz!

Adhuroni Allahun, Zotin tuaj, i Cili ju krijoi ju ...” (Bekare, 21), që do të thotë: adhurojeni Atë, sepse Ai ju ka krijuar. Po kështu: “O besimtarë! Përgjigjuni Allahut dhe të Dërguarit, kur ai (Muhamedi) ju thërret drejt asaj që do t’ju japë jetë ...” (Enfal, 24), do të thotë: sepse Ai ju thërret vetëm në atë që ju jep juve jetë. Gjithashtu: “Përveç Allahut, mos iu lut tjetërkujt nga ata që nuk të sjellin as dobi, as dëm...”, që do të thotë: sepse çdo gjë tjetër nuk të bën ty as dëm e as dobi. Atëherë, përfundimisht, ky përcaktim nuk është dallues.

– “... Nëse do ta bëje këtë, atëherë, ti do t’i kishe bërë padrejtësi vetes.” – Pra, nëse lut dikë tjetër përveç Allahut, që nuk të sjell as dobi e as nuk mund të të dëmtojë, atëherë ti do të bëhesh si të padrejtët, por nëse pendohesh për këtë, ky cilësim do të hiqet prej teje. Njeriu, para se të bëjë një veprim negativ, nuk është mizor keqbërës, po ashtu edhe mbas pendimit nuk është i tillë, por në kohën kur e kryen gjynahun ai është i keq. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: “Njeriu nuk është besimtar gjatë kohës që bën imoralitet.”¹ Pra, mohohet besimi i tij gjatë kohës së atij veprimit.

Lloji i padrejtësisë këtu është shirku. Allahu i Madhëruar thotë: “Idhujtaria është padrejtësia më e madhe.” (Llukman, 13). Zoti (Subhanehu ue Te‘Ala) ka përdorur fjalën “keqbërës” dhe jo “idhujtar” me qëllim që të sqarojë se shirku është padrejtësi, sepse që je idhujtar kur lut dikë tjetër veç Allahut është e qartë, por që je edhe i padrejtë, ndoshta nuk është e qartë.

Ajeti 2. “Nëse Allahu të prek ty me ndonjë të keqe, askush nuk mund të ta largojë atë, përveç Tij e, nëse Ai dëshiron për ty ndonjë të mirë, s’ka kush që ta pengojë mirësinë e Tij; Ai ia jep atë mirësi kujt të dëshirojë prej robërve të Tij. Ai është Falës dhe Mëshirëplotë.” (Junus, 107)

– “... të prek ty me ndonjë të keqe ...” – Pra, nëse të godet me ndonjë të keqe si: sëmundje, varfëri etj, nuk ka kush që mund ta

¹ Buhariu.

heqë atë kurrë, veç Allahut. Kjo është si thënia e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Dije se sikur të gjithë njerëzit të mblidhen për të të bërë një të mirë, nuk kanë për të të bërë asnjë të mirë, përveçse aq sa ka caktuar Allahu për ty.”¹

- “... nëse Ai dëshiron për ty ndonjë të mirë ...” – Këtu thuhet “dëshiron për ty”, ndërsa për të keqen thuhet “të prek ty”. A është ky vetëm ndryshim në shprehje, apo ka edhe ndryshim konceptual? Themi se ndryshimi është konceptual, sepse gjërat e urryera nuk i përshkruhen dëshirës së Allahut, por krijesave të Tij. Prekja është veprim i Allahut, ndërsa dëmi vjen nga krijesat e Tij. Allahu nuk e dëshiron të keqen në vetvete, por e dëshiron për atë që arrihet nëpërmjet saj, për shkak të mirësive që vijnë prej saj dhe urtësive të mëdha që qëndrojnë pas. Në një hadith *kudsij* thuhet: “Vërtet ka nga robërit e Mi, që po t’i pasurosh, pasuria i prish ata.”² Nga ana tjetër, Allahu e dëshiron të mirën si të tillë në vetvete dhe ajo është veprim i Tij.³ Me këtë që thamë përafrohet edhe kuptimi i ajetit në suren Xhin: “Ne nuk e dimë nëse është dëshiruar e keqja për ata që janë në tokë, apo Zoti i tyre ka dashur t’i udhëzojë në Rrugë të Drejtë ...” (Xhin, 10).

Njeriun mund ta prekë ndonjë sëmundje, por Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) nuk i dëshiron atij lëndimin si lëndim. Ai dëshiron sëmundjen, por jo dëmin e saj, përkundrazi, dëshiron të mirën që vjen pas asaj. Urtësia mund të shfaqet në personin e goditur nga fatkeqësia, por ndoshta edhe në diçka tjetër: “Ruajuni *fitneve*, të cilat nuk godasin vetëm ata që bëjnë keq; dhe ta dini se Allahu dënon ashpër.” (Enfal, 25).

E rëndësishme është që ne të mos e kufizojmë urtësinë e Allahut, sepse ajo është më e gjerë se logjika jonë, por ne jemi të sigurt se Allahu nuk e dëshiron dëmin si dëm. Allahu nuk e do atë në vetvete, por për diçka tjetër, sepse prej Tij vijnë vetëm mirësi. Ndërsa e mira është e dëshiruar në vetvete dhe ajo është veprim i

¹ Transmeton Ahmedî dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

² Transmeton Tabarani. Sipas Albanit është i dobët.

³ Ka ndryshim ndërmjet fjalës 'veprim i Tij dhe pasojë e veprimit të Tij' ose 'krijimi i Tij dhe krijesës si pasojë e veprimit të Tij', sepse e keqja nuk i atribuohet 'veprimit të Tij dhe krijimit të Tij' por i atribuohet 'pasojës së veprimit të Tij dhe krijesës së Tij'.

Tij. Allahu është më i Dituri për çfarë ka dashur të thotë me fjalën e Tij, por kjo është ajo që kuptoj unë nga kjo fjalë.

– “... *s'ka kush që ta pengojë mirësinë e Tij ...*” - Kjo do të thotë se askush nuk mund ta pengojë mirësinë e Allahut, edhe nëse mblidhet i gjithë njerëzimi për këtë, siç thuhet në hadith: “... O Zot, nuk ka kush e ndalon atë që Ti e jep, dhe nuk ka kush e jep atë që Ti e ndalon.¹ Sipas kësaj, ne i mbështetemi veç Allahut për arritjen e mirësive, për shmangien e të ligave dhe për vazhdimësinë e begative të Tij. Ne duhet ta dimë se sado që njerëzit të kurdisin plane e dredhi për të penguar mirësitë e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), ata nuk do të mund ta bëjnë këtë.

– “... *Ai ia jep atë mirësi kujt të dëshirojë prej robërve të Tij ...*” – Çdo veprim i Zotit lidhur me dëshirën e Tij është i lidhur gjithashtu me urtësinë, sepse Allahu nuk e bën diçka sepse thjesht e dëshiron dhe kaq. Një nga cilësitë e Allahut është urtësia (*hikme*) dhe një nga emrat e Tij është *El Hakim* (më i Urti): “Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me dëshirën e Allahut! Ai është vërtet i Gjithëdijshëm e i më i Urti.” (Insan, 30).

– “... *prej robërve të Tij ...*” – Fjala “*robër*” këtu është për të gjithë, sepse mirësia e tij përfshin dynjanë dhe të ahiretit, dhe e mira e dynjasë e përfshin edhe qafirin.

– “... *Ai është Falës dhe Mëshirëplotë.*” – Atributi “Falës” (*El Gafurr*) do të thotë që fal mëkatet e njerëzve, i mbulon të metat dhe i toleron ato. Mëshirëplotë (*Err Rrahim*) është atribut që i përshtatet Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) dhe tregon bamirësi dhe begatim.

Pjesa e ajetit që dëshmon për çështjen në fjalë është: “Mos lut tjetër përveç Allahut, nga ata që nuk të sjellin as dobi, as dëm ...”. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) në ajetin e parë i ka tërhequr vërejtjen të Dërguarit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), se ai që lut dikë tjetër veç Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) nuk ka ç’të presë as të mira dhe as të këqija prej atij që lut. Kjo duket edhe te pjesa e ajetit tjetër: “Nëse Allahu të prek ty me ndonjë të keqe, askush nuk

¹ Buhariu, Muslimi.

mund të ta largojë atë, përveç Tij.”

Ajeti 3. “... andaj, vetëm Allahut kërkujini furnizim; adhuroni vetëm Atë dhe falënderoni Atë. Tek Ai do të ktheheni.” (Ankebut, 17)

– “... *prandaj, vetëm Allahut kërkujini furnizim ...*” – Sikur dijetari (Allahu e mëshiroftë!) ta sillte ajetin nga fillimi: “Vërtet ata që ju i adhuroni në vend të Allahut, nuk kanë fuqi t’ju furnizojnë ...” (Ankebut, 17), do të ishte më mirë. Pra, ata adhurorin idhujt prej druri, gurësh e të tjera. Ata idhuj nuk kishin mundësi për furnizim. Edhe sikur t’i lutnin deri në Ditën e Kijametit, përsëri ata nuk do t’u sillnin as edhe një kokërr gruri dhe nuk do t’ua largonin sëmundjen më të vogël apo varfërinë. Pra, ata nuk e kanë në dorë furnizimin, se ai që e ka në dorë atë është Allahu, e për këtë thotë: “... prandaj, vetëm Allahut kërkujini furnizim”. Kërkoji të mirat nga Allahu, sepse Atij nuk i shterojnë ato. “Gjithçka që keni ju është kalimtare, ndërsa ajo që ndodhet tek Allahu është e përhershme.” (Nahl, 96)

Përderisa dhurimi i të mirave i përket Allahut, kërkujeni atë tek Ai dhe tek askush tjetër.

– “... *adhuroni vetëm Atë ...*” – Nënshtrujuni Atij me bindje, se nëse do t’i përuleni Atij me bindje, ky është një nga shkaqet e dhurimit të të mirave. Allahu i Madhëruar thotë: “Kujtdo që i frikësohet Allahut, Ai ka për t’i gjetur rrugëdalje ...”. (Talak, 2)

Pra, pasi urdhëron kërkimin e furnizimit prej Tij, Ai e pason me thënien: “adhuroni vetëm Atë.” Kjo tregon se element adhurimi është edhe kërkimi i furnizimit. Përderisa njeriu beson se po t’i frikësohet Allahut, Ai do t’i sjellë rrugëdalje e do ta furnizojë andej nga s’e pret, atëherë adhurimi përmban kërkimin e furnizimit.

– “... *dhe falënderoni Atë ...*” – Pra, jini mirënjohës ndaj Allahut për begatitë e Tij. Mirënjohja për begatitë e Allahut, duhet te jetë vetëm për Të. Ndoshta dikush e falënderon Allahun që t’i vazhdojë begatia, e kjo s’ka ndonjë të keqe, por nëse e falënderon dhe dëshira për vijimin e begatisë vjen pas kësaj, kjo është më e mirë.

Falënderimi është komentuar si bindje ndaj Dhuruesit të

begative, dhe kanë thënë se ai shprehet me tri mënyrë:

1. *Me zemër*. Kjo ndodh kur njeriu pohon me zemrën e tij se begatia i ka ardhur prej Allahut dhe kur e sheh mirësinë e Allahut ndaj tij: "... ç'do të mirë që keni, është nga Allahu." (Nahl, 53). Begatia më e madhe është Islami: "Ata quajnë si favor për ty (Muhamed) që ata kanë përqafuar Islamin. Thuaj: 'Mos e quani si favor për mua se keni pranuar Islamin, përkundrazi, Allahu ju ka dhuruar mirësi dhe ju ka udhëzuar në besim.'" (Huxhurat, 17). "Vërtet Allahu derdhi mbi besimtarët mirësi të madhe kur Ai çoi ndërmjet tyre një të Dërguar (Muhamedin) nga gjiri i tyre i cili ua lexon vargjet e Tij (Kuranin)." (Ali Imran, 164)

2. *Me gjuhë*, kur njeriu e përdor fjalën e vet për të shprehur mirënjohjen ndaj Allahut të Madhëruar, kur i pranon begatitë e Tij e nuk i mohon, por jo duke u mburrur dhe duke u treguar mendjemadh ndaj robërve të Allahut. Mund të flasësh për pasurinë që ke, jo për t'i thyer zemrën të varfrit, por për t'u treguar mirënjohës ndaj Allahut. Kjo formë është e lejuar, ashtu si në tregimin e të verbrit te benu Israilët. Kur meleku u përmendi atyre begatitë e Allahut, i verbëri tha: "Isha i verbër e Allahu ma ktheu shikimin, isha i varfër e Allahu më dha pasuri." Kjo është formë e falënderimit për begatitë e Allahut. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sellem) flet për begatitë e Allahut ndaj tij kur thotë: "Unë do të jem më i nderuari i bijve të Ademit, Ditën e Kijametit."¹

3. *Me vepra konkrete*, që do të thotë të veprosh në bindje ndaj Begatuesit, sipas llojit të begatisë. Falënderimi i Allahut për begatinë e dijes, për shembull, bëhet duke e zbatuar atë dhe duke ua përcjellë të tjerëve; falënderimi i Allahut për begatinë e pasurisë, bëhet duke e përdorur atë në bindje ndaj Allahut dhe duke ndihmuar njerëzit me të; falënderimi i Allahut për ushqimin, është ta përdorësh atë për qëllimin e caktuar: të ushqesh trupin e të mos e shpërdorosh atë.

– "... Tek Ai do të ktheheni." – Kthimi ynë është tek Allahu i Madhëruar dhe Ai do të na marrë në llogari për detyrat që na ka caktuar në adhurim, për falënderimin dhe kërkimin e të mirave prej Tij.

¹ Muslimi.

Pjesa e ajetit që dëshmon për çështjen në fjalë është: “Vërtet ata që ju i adhuron në vend të Allahut nuk kanë fuqi t’ju furnizojnë, prandaj vetëm Allahut kërkojini furnizim.”

I varfri i kërkon ndihmë Allahut që ta shpëtojë prej varfërisë dhe Allahu është Ai që meriton të falënderohet. Kur idhujt nuk e kanë në dorë furnizimin, si mund të kërkohet ndihmë prej tyre?!

Ajeti 4. “Kush është në rrugë më të gabuar sesa ai, i cili, në vend të Allahut, u lutet atyre që nuk mund t’i përgjigjen atij deri në Ditën e Kiametit e që janë krejt të pavetëdijshëm për lutjet që u bëhen atyre?!” (Ahkaf, 5)

– “*Kush është në rrugë më të gabuar ...?*” – Kuptimi i kësaj pyetjeje retorike, me përgjigje të nënkuptuar mohuese, është se nuk ka më të humbur sesa një njeri i tillë. “I humbur” do të thotë “i dalë nga rruga e drejtë”. Nëse mohimi shprehet me një formë pyetëse, ai është më i fortë sesa kur shprehet me fjali mohore, sepse forma pyetëse përmban edhe kuptimin e sfidës. Kështu ajeti do të thotë: më tregoni se kush mund të jetë më i humbur se ai që lut të tjerë në vend të Allahut. Pra, duke qenë se forma pyetëse ngërthen në vetvete edhe sfidimin, ajo është më e fuqishme sesa forma: “nuk ka më të humbur sesa ai që lut të tjerë përveç Allahut”, e cila shpreh thjesht mohim.

– “*... sesa ai, i cili, në vend të Allahut, u lutet ...*” – Flitet për ‘lutjen e kërkitimit’ dhe ‘lutjen e adhurimit’.

– “*... u lutet atyre që nuk mund t’i përgjigjen atij deri në Ditën e Kiametit ...*” – Sikur të qëndrojë gjithë jetën duke e lutur nuk ka për të marrë përgjigje. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur ta dëgjonin, nuk mund t’ju përgjigjen juve, ndërsa Ditën e Kiametit ata do të mohojnë adhurimin tuaj ndaj tyre.” (Fatir, 14). Kjo është deklarata nga Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala). “Askush nuk mund të të njoftojë ty (o Muhamed), ashtu si Ai që është i Gjithëdijshëm”, pra vetë Allahu.

– “... atyre që nuk mund t’i përgjigjen ...” – Përemri ‘men’ (atyre) në ajet, u referohet qenieve me logjikë, megjithëse ata adhurojnë gurë e drurë, të cilët nuk janë të tillë. Kjo ndodh sepse idhujtarët i konsiderojnë idhujt e tyre si qenie të logjikshme, dhe kështu Allahu u është drejtuar atyre sipas asaj që ata pandehnin. Kjo mënyrë është një argument plus kundër tyre, që do të thotë se idhujtarët lutin objekte që i pandehin si të logjikshme, e megjithatë ato përsëri nuk u përgjigjen atyre. Ky është element i stilit të Kuranit. Allahu i Madhëruar u flet paganëve sipas gjendjes dhe rrethanave të tyre, që ata të kuptojnë. Nëse do të ishte përdorur përemri ‘ma’,¹ mund të thuhej nga ndonjë se mospërgjigja e tyre është e justifikuar, sepse janë sende të palogjikshme.

– “... e që janë krejt të pavetëdijshëm për lutjet që u bëhen atyre?!” – Përemri lidhor “që” mund t’u referohet idhujve, pra ata janë të pavetëdijshëm ndaj lutjes që u bëhet; ose mund t’u referohet paganëve që i lusin idhujt. Varianti i parë është më i qartë; pra idhujt janë të pavetëdijshëm për lutjet që u drejtohen atyre, kështu nuk vlejnë për asgjë, as për dynjanë e as për ahiretin.

“... Kur njerëzimi të grumbullohet (Ditën e Kijametit) ata (idhujt e tyre) do të jenë armiq të tyre dhe do ta mohojnë adhurimin e tyre.” (Ahkaf, 6)

Cili është kuptimi: që adhuruesit do të jenë armiq të të adhuruarve të tyre, apo e anasjellta? Ajeti i përfshin të dyja kuptimet, dhe kjo është pjesë e stilit të Kuranit.

Pjesa e ajetit që lidhet me temën e diskutimit tonë është: “... u lutet atyre që nuk do t’i përgjigjen atij deri në Ditën e Kiametit ...”. Përderisa nuk të përgjigjet deri në Ditën e Kiametit, atëherë si i kërkon ndihmë atij, në vend të Allahut?! Kjo tregon se lidhja e adhuruesve me idhujt e tyre është e pavlefshme. Kush shkon tek të ashtuquajturat “vendet e mira” dhe i lut ata: “Më ndihmoni, më shpëtoni!”, ta dijë se ata nuk mund ta ndihmojnë aspak.

Mund të ndodhë që ndihma vjen pikërisht atëherë kur njeriu kryen këtë adhurim, dhe jo më parë, por duhet të dihet se ka ndryshim mes rezultatit që ndodh për shkak të diçkaje dhe rezultatit që ndodh tek diçka. Për shembull: një grua i lutet

¹ Përemri ‘ma’, në arabisht, u referohet sendeve dhe qenieve pa logjikë.

Bedeviut¹ për të pasur fëmijë, pasi ka kryer marrëdhënie intime me bashkëshortin e saj. Më parë, nuk mbeste shtatzënë, ndërsa tani po. Në këtë rast, themi se mbarsja nuk ka ndodhur për shkak të lutjes ndaj “të shenjtit”, por kur ajo ishte tek ai.

Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “... u lutet atyre që nuk do t’i përgjigjen atij deri në Ditën e Kiametit ...”. Në vende të ndryshme, ka njerëz që u luten dhe u kërkojnë largimin e së keqes të vdekurve në varre. Ata kurrë nuk kanë për të përfituar prej tyre, edhe sikur të qëndrojnë duke i lutur derisa të bëhet Kiameti; askush nuk ka për t’iu përgjigjur. Vërtet, të lutësh ata, është mendjelehtësi dhe humbje në fe. Në fakt, ata që duhet të kritikohen për këtë gjendje janë ata që kanë njëfarë dije, qofshin dijetarë apo jo.

Ajeti 5. “A nuk është Ai që i përgjigjet nevojtarit kur i lutet Atij, duke ia larguar të keqen dhe ju bën juve trashëgimtarë në tokë? A ka zot tjetër krahas Allahut?! Sa pak që mendoni!” (Neml, 62)

– “A nuk është Ai që i përgjigjet nevojtarit ...” – Nevojтари këtu nënkupton atë që e ka goditur e keqja. Allahu thotë: “... (Kujto) edhe Ejubin, kur iu lut Zotit të vet: ‘Mua më ka goditur fatkeqësia, e Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve.’” (Enbija, 83). Pra, nevojtarit nuk mund t’i përgjigjet askush tjetër përveç Allahut, por Allahu e ka lidhur këtë përgjigje me lutjen ndaj Tij: “... kur i lutet Atij.” Kësisoj, nëse nuk i lutet Allahut, Ai ndoshta ia largon të keqen e ndoshta jo.

– “... duke ia larguar të keqen ...” – “*Es-suu*” (e keqe), në arabisht, quhet ajo gjë që e mërzit njeriun. Ajo është më e lehtë se dëmi, se njeriun mund ta godasë një e keqe, e cila ndoshta nuk e dëmton. Megjithatë, çdo dëm është i keq.

Për shpjegimin e togut “... duke ia larguar të keqen” janë dhënë dy variante. Njëri prej tyre lidhet me pjesën e parë të ajetit, domethënë, nëse Allahu ia pranon lutjen, ia largon të keqen. Sipas variantit tjetër, ky tog nuk varet dhe nuk lidhet me pjesën e parë të ajetit, por ka kuptim gjithëpërfshirës.

¹ Bedeviu është një njeri i vdekur, i ashtuquajtur “i shenjtë”, në Egjipt.

Shpjegimi i dytë është më i përgjithshëm, sepse ai përfshin largimin e së keqes së nevojtarit dhe jo nevojtarit, të atij që e lut Allahun dhe të atij që nuk e lut Atë. Sipas përcaktimit të parë, e keqja largohet vetëm nga nevojtari. Mirëpo dihet se sa më përfshirës të jetë kuptimi, aq më tepër ka përparësi. Këtë përgjithësim e mbështet vijimi i ajetit: “... dhe ju bën juve trashëgimtarë në tokë.”

- “... dhe ju bën juve trashëgimtarë në tokë. ...” – Ata që Allahu i bën trashëgimtarë në tokë, janë robërit e Tij të mirë. Allahu thotë: “Ne shënuam në Zebur, pasi Ne e patëm shënuar (që më parë në *Leuhi Mahfudh*), se tokën (e Xhenetit) do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë.” (Enbija, 105). “Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t’i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t’ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur, dhe që frikën do t’ua shndërroj në siguri, (me kusht që) që të më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë asgjë (në adhurim).” (Nur, 55)

- “... A ka krahas Allahut zot tjetër?! Sa pak që mendoni!” – Pyetja këtu është për kundërshtim ose për mohim. Të dyja mundësitë janë të përafërta, që do të thotë: a ka ndonjë si Allahu që të bëjë të tilla gjëra? Përgjigjja është: jo. Nëse është kështu, atëherë është detyrë që adhurimi t’i drejtohet vetëm Allahut të Lartësuar, po kështu edhe lutja. Për njeriun është detyrë që kërkesat e veta t’ia drejtojë veç Allahut (Subhanehu ue Te’Ala) dhe askujt tjetër, sepse askush tjetër nuk ka mundësi t’ia realizojë.

Këtu duhet të sqarohet një çështje: kur nevojtari i cili kërkon prej dikujt tjetër veç Allahut dhe i jepet ajo që kërkon. Për shembull, kur ka nevojë për ushqim, kërkon prej atij që ka ushqim që t’i japë dhe ai i jep, a është e lejuar kjo apo jo?

Kjo është e lejuar, por duke besuar gjithmonë se ai që të jep është thjesht një shkak. Allahu i Madhëruar ka bërë shkaqe për gjithçka. Allahu mund t’ia rrotullojë zemrën personit, duke e bërë të ndërrojë mendje e të mos të japë; ti mund të hash, por Allahu mund të bëjë që të mos ngopesh; Ai mund të vërë gjithçka në shërbimin tënd duke të të plotësuar kështu kërkesat e tua.

Taberani përcjell me *sened-in* e tij, se në kohën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte një munafik që i mundonte shumë besimtarët. Disa prej të lënduarve thanë: “Hajde të shkojmë së bashku tek i Dërguari i Allahut dhe t’i kërkojmë të na largojë të keqen që na vjen nga ky munafik.” Por Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u tha: “Largimi i së keqes nuk kërkohet nga unë, por kërkohet prej Allahut.”

– “... me *sened-in* e tij ...” - Autori (Allahu e mëshiroftë) me këtë fjalë aludon se ky zinxhir transmetimi nuk është sipas kushteve të sakta, ose sipas asaj që janë pajtuar dijetarët. Përkundrazi zinxhiri i transmetimit është vetëm i tij. Atëherë ky zinxhir transmetimi duhet të shikohet, pasi jo çdo zinxhir transmetimi që përcjell dijetari përmbush kushtet që të jetë i pranuar. Ibn Hejthemi në "Mexhma ez-zevaid" ka përmendur se transmetuesit e tij janë të saktë, përveç Ibn Luhej’a, pasi hadithi i transmetuar prej tij konsiderohet i mirë. Ai ka bërë përzierje në kohën e fundit të jetës së tij, për shkak se iu dogjën librat. Autori gjithashtu nuk ka përmendur sahabiun që e përcjell nga i Dërguari (‘alejhis-selam). Ai ka qenë Ubade ibn Samit (r.a).

Ky person që i mundonte muslimanët ishte fillimisht qafir që e shfaqte hapur kufrin e tij dhe s’donte t’ia dinte, por kur muslimanët u forcuan, pas luftës së Bedrit, qafirëve në përgjithësi u hyri frika, prandaj nisën të shtireshin si muslimanë, duke fshehur kufrin e tyre.

Munafik quhet ai person që hiqet si musliman, por që në realitet është qafir. Ky soj njerëzish u shfaq për herë të parë pas betejës së Bedrit. Në këtë hadith nuk është përmendur emri i munafikut: mund të ketë qenë Abdullah Ibn Ubeji, sepse ai njihet për mundimet që u shkaktonte besimtarëve, por mund të ketë qenë edhe ndonjë tjetër.

Munafikët nuk i lëndojnë muslimanët me rrahje e vrasje, sepse ata hiqen se i duan besimtarët, por me fjalë të maskuara, siç vepruan në rastin e Shpifjes së Madhe.¹

¹ Flitet për shpifjen ndaj Nënës së Besimtarëve, Aishes (radijAllahu ‘anha).

– “... *Disa prej të lënduarve ...*” – Pra, disa prej sahabëve.

– “... *t’i kërkojmë të na largojë të keqen që na vjen nga ky munafik ...*” – Kjo, ose duke e ndaluar atë, ose duke e dënuar, në përshtatje me rrethanat.

Rrëfimi ka një pjesë që nënkuptohet nga konteksti: ata shkuan te Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe i thanë: “O i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ne kërkojmë ndihmën tënde nga e keqja e këtij munafiku!”.

– “... *Largimi i së keqes nuk kërkohet nga unë ...*” – Në pamje të parë, kjo shprehje duket se tregon mohim absolut, në kuptimin që: prej meje nuk mund të kërkohet ndihmë, për asnjë çështje. Por mund të shpjegohet edhe kështu: prej meje nuk mund të kërkohet largimi i një të keqeje si kjo.

Atëherë, sipas variantit të parë, ndalimi është bërë për të mbyllur shtigjet e shirkut dhe për të ruajtur shprehitë në të folur. Në këtë kuptim, ndalimi nuk ka karakter përgjithësues, sepse kërkimi i ndihmës nga Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk mohohet në çdo rast, përkundrazi, lejohej që të kërkohet ndihmë prej tij, për ato gjëra që ai kishte mundësi.

Sipas variantit të dytë, mohimi këtu është për atë çështje që ata i kërkuan ndihmë Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), me kuptimin: në raste të tilla, nuk kërkohet largimi i së keqes prej meje. Kjo, sepse Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i trajtonte munafikët si muslimanë. Ai nuk mund ta ndëshkonte atë njeri, sipas gjykimit për munafikët, sepse ata i mbulojnë veprimet e tyre.

Përfundimisht, nuk kërkohet shpëtimi nga e keqja e munafikut prej dikujt tjetër, veç prej Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala).

Dobitë e temës

- Rënditja e lutjes pas kërkimit të ndihmës, me lidhëz bashkërenditëse, si e përgjithshme pas së veçantës.

Autori në titull thotë: “Kërkimi i ndihmës apo lutja e tjetërkujt, veç Allahut, është element politeizmi”. E përgjithshmeja vjen pas së veçantës, sepse kërkimi i ndihmës përbën një lloj lutjeje, ndërsa lutja nuk është gjithmonë parashtrim i një kërkese për ndihmë.

Kjo është e lejuar në gjuhën arabe, si në fjalën e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “O ju që keni besuar! Përkuluni dhe përujeni në sexhde (para Allahut)! Adhuroni Zotin tuaj dhe bëni vepra të mira që të jeni të shpëtuar.” (Haxh, 77)

- Komenti i fjalës së Allahut: “Mos lut tjetër përveç Allahut, nga ata që nuk të sjellin as dobi, as dëm. Nëse do ta bëje këtë, atëherë, ti do të ishe vërtet keqbërës.” (Junus, 106)

Ajeti i është drejtuar posaçërisht Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), siç dëshmon ajeti paraardhës: “Dhe (më është shpallur): ‘Bëhu i sinqertë në fe dhe kurrsesi mos u bëj nga idhujtarët.’” (Junus, 105).

Po si mund ta ndalonte Allahu atë, për diçka që ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), fetarisht, kurrsesi nuk mund ta bënte?

Qëllimi është që t’u tërhiqet vërejtja atyre që mund ta bëjnë një vepër të tillë, me kuptimin: “Mos merr këtë rrugë që kanë marrë të humburit!”, edhe pse kjo vepër, fetarisht, nuk mund të ndodhte nga i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

- Të lusësh dikë tjetër përveç Allahut, është shirk i madh.

Argument është ajeti “Mos lut tjetër përveç Allahut, nga ata që nuk të sjellin as dobi, as dëm. Nëse do ta bëje këtë, atëherë ti do t’i kishe bërë padrejtësi vetes.” (Junus, 106), ashtu si edhe ajeti tjetër: “Vërtet, idhujtaria është padrejtësia më e madhe.” (Lukman, 13)

- Edhe sikur këtë ta veprojë më i miri i njerëzve, për të kënaqur dikë tjetër veç Allahut, ka për t’u bërë më i

padrejti.

Kjo kuptohet nga fjala drejtuar Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), i cili është më i miri i njerëzve. Nëse dikush e vepron këtë, për të kënaqur dikë tjetër veç Allahut, atëherë bëhet zullumqar, edhe sikur t'a bëjë për t'i bërë qefin një idhujtari duke lutur ndonjë të vdekur në varr për kënaqësi të mushrikut, atëherë ai është mushrik, pasi nuk lejohet favorizimi i dikujt në fenë e Zotit.

➤ Komenti i ajetit të dytë.

Qëllimi është për fjalën e Allahut: “Nëse Allahu të prek ty me ndonjë të keqe, askush nuk mund të ta largojë atë, përveç Tij...” (Junus, 107). Përderisa të keqen nuk mund ta largojë askush përveç Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), atëherë është detyrë që adhurimi të jetë vetëm për Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala), e po kështu ndihma duhet t'i kërkohet vetëm Atij. Në të kundërt, ajo nuk të bën dobi në këtë botë dhe, përveç kësaj, është edhe kufër.

Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Nëse Allahu të prek ty me ndonjë të keqe, askush nuk mund të ta largojë atë, përveç Atij ...” (En’am, 17)

➤ Njeriu nuk përfiton kurrë në këtë botë nga lutja që i drejton dikujt tjetër veç Allahut, dhe përveç kësaj, kjo gjë është edhe kufër, kështu që humb edhe ahiretin.

➤ Komenti i ajetit të tretë.

Qëllimi është për fjalën e Allahut: “... prandaj, vetëm Allahut kërkoni të mira ...”. Përderisa të mirat i ka në dorë Allahu, atëherë ato duhet t'i kërkohen vetëm Atij (Subhanehu ue Te‘Ala).

➤ Të mirat i kërkohen vetëm Allahut, ashtu si edhe Xheneti kërkohet vetëm prej Tij.

Kjo del nga fjala e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “... adhuroni vetëm Atë dhe falënderoni Atë. Tek Ai do të ktheheni.” Adhurimi është shkak për hyrjen në Xhenet, siç nënkuptohet nga fragmenti:

“Tek Ai do të ktheheni.”

- Komenti i ajetit të katërt.

Qëllimi është për fjalën e Allahut: “Kush është në rrugë më të gabuar sesa ai, i cili, në vend të Allahut, u lutet atyre që nuk mund t'i përgjigjen atij deri në Ditën e Kiametit e që janë krejt të pavetëdijshëm për lutjet që u bëhen atyre?!” (**Ahkaf, 5**)

- Nuk ka më të humbur se ai që lut dikë tjetër veç Allahut.

Ky përfundim del nga ajeti: “Kush është në rrugë më të gabuar sesa ai, i cili, në vend të Allahut, u lutet atyre...”, sepse forma pyetëse këtu, është me kuptim mohimi.

- Idhujt janë të pavetëdijshëm për lutjet që u bëhen dhe nuk dinë gjë për to.

Kjo sipas fjalës së Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “... e që janë krejt të pavetëdijshëm për lutjet që u bëhen atyre?!”

- Këto lutje janë shkak për urrejtje dhe armiqësi ndërmjet lutësit dhe të luturit.

Argument është fragmenti: “Kur njerëzimi të grumbullohet (Ditën e Kijametit), ata (idhujt e tyre) do të jenë armiq të tyre dhe do ta mohojnë adhurimin e tyre.” (Ahkaf, 6)

- Një lutje e tillë është quajtur adhurim për të luturin.

Argument është pjesa: “... dhe do të mohojnë adhurimin e tyre.”

- Mohimi i këtij adhurimi nga ana e të luturit.

Kuptimi i kësaj është refuzimi dhe kundërshtimi nga ana e të adhuruarve. Ditën e Kijametit ata do të distancohen prej

adhuruesve të tyre dhe do ta kundërshtojnë këtë adhurim. Kjo del nga fjala e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala): "... dhe do të mohojnë adhurimin e tyre."

➤ Një lutje e tillë e bën njeriun të jetë më i humburi.

Kjo për arsyet e mëposhtme:

- ai lut në vend të Allahut, të atillë që nuk do t'i përgjigjen kurrë atij;
- të luturit janë të pavetëdijshëm për lutjet që u bëhen atyre;
- kur të ringjallen njerëzit, ata do të jenë armiq të adhuruesve të tyre;
- të adhuruarit do ta mohojnë adhurimin e adhuruesve të tyre.

➤ Komenti i ajetit të pestë.

Qëllimi është për fjalën e Allahut: "A nuk është Ai që i përgjigjet nevojtarit kur i lutet Atij, duke ia larguar të keqen ...". Ky ajet u komentua edhe më parë.

➤ I çuditshëm është pranimi i idhujtarëve se lutjes së nevojtarit i përgjigjet vetëm Allahu. Prandaj, kur ata ishin në vështirësi, lutnin vetëm Allahun.

Kjo është vërtetë ashtu siç e ka thënë autori (Allahu e mëshiroftë!), madje vlen edhe për sot. Në ditët tona ka shumë njerëz që u përulën statujave me madhërim, pasi i kanë bërë ato me duart e veta, por kur bien në vështirësi, i luten me sinqeritet vetëm Zotit. Nëse idhujtaria e tyre do të ishte e vërtetë, ata duhet t'u ktheheshin statujave të tyre edhe në kohë vështirësie. Gjithashtu, mjaft idhujtarë të sotëm e kanë më të fortë politeizmin sesa idhujtarët e mëparshëm. Këta të tashmit, kur i kap e keqja e madhe, u drejtohen me lutje "shenjtorëve" të tyre, kurse për ndonjë çështje të thjeshtë, lusin Allahun e Madhëruar. Kur betohen në të vërtetën, betohen në shenjtorët e tyre, nëse betohen në të gënjeshtërt,

betohen pa problem në Allah.

- Përkushtimi i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në mbrojtjen e teuhidit dhe edukata e tij me Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala) në mënyrën e të shprehurit.

Autori ka zgjedhur mendimin se thënia e tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Largimi i së keqes nuk kërkohet nga unë ...”, synon edukatën në të shprehur dhe largimin nga lidhja me dikë tjetër veç Allahut, në mënyrë që lidhja e njeriut të jetë përherë me Të. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e mësoi umetin e tij që, në vështirësi, t’i drejtohen vetëm Allahut, e të mos kërkojnë ndihmë nga askush përveç Tij.

Tema 15

Thënia e Allahut: “A mos vallë ata i veshin Atij si ortakë idhuj, që nuk mund të krijojnë asgjë, ndërkohë që vetë janë të krijuar, idhuj që nuk mund t'u japin ndonjë ndihmë atyre e as veten nuk mund ta ndihmojnë?!” (Araf, 191-192)

Lidhja e këtij kapitulli me të mëparshmit, qëndron në faktin se dijetari (Allahu e mëshiroftë!) pasi flet për kërkimin e mbrojtjes dhe të ndihmës nga dikush tjetër përveç Allahut, sjell argumentet që tregojnë pavlefshmërinë e adhurimit të dikujt tjetër veç Tij. Ndërsa në titullin e kësaj teme ka vendosur vetë argumentin.

Autori (Allahu e mëshiroftë!) ka sjellë këtu tri ajete.

– “*A mos vallë ata i veshin Atij si ortakë idhuj ...*” – Këtu kemi një pyetje, që tregon mohim dhe përçmim, dhe do të thotë se ata bënë idhujtari.

– “*... që nuk mund të krijojnë asgjë ...*” – Këtu është përdorur pjesëza “*ma*” dhe jo “*men*”, ndërsa në ajetin: “Kush është në rrugë më të gabuar sesa ai, i cili, në vend të Allahut, u lutet atyre që nuk mund t'i përgjigjen atij ...” (Ahkaf, 5), është përdorur “*men*”. Lidhja është e qartë, sepse lutësit në ajetin e sures Ahkaf, i kanë vendosur idhujt e tyre në gradën e qenieve me logjikë, ndërsa këtu të luturit janë krejt të gurtë, sepse ai që nuk krijon e as nuk prodhon gjë, është i gurtë dhe nuk bën dobi.

– “... *ndërkohë që vetë janë të krijuar ...*” – Këta idhuj janë përshkruar me paaftësi dhe mangësi, ndërsa Zoti, i Adhuruari i Vërtetë, nuk mund të jetë i krijuar, përkundrazi, Ai është Krijuesi. Ai as nuk mund të jetë i krijuar dhe as nuk mund të zhduket, ndërsa krijesa është e krijuar. E krijuara mund të mos ekzistojë, e përderisa fillimisht nuk ka ekzistuar, logjikisht mund të zhduket prapë, edhe pasi ka ekzistuar. Atëherë, si mund të adhurohen këta përveç Allahut?! Krijesa në vetvete ka nevojë për krijuesin e saj, sepse ajo ekziston pas mosekzistencës, duke mos qenë më parë. Atëherë, krijesën e karakterizon mangësia dhe nevoja si në zanafillën e krijimit edhe në vazhdimësinë e ekzistimit.

– “... *idhuj që nuk mund t'u japin ndonjë ndihmë atyre ...*” – Ata nuk kanë mundësi t'i ndihmojnë nëse do t'i sulmonte armiku, sepse këta të adhuruar janë të paaftë. Të ndihmohesh do të thotë: të mbështetësh të dëmtuarin ose atë që nuk ka përkrahje, duke bërë që ai të fitojë mbi armikun e tij.

– “... *e as veten nuk mund ta ndihmojnë.*” – Përveç asaj që u përmend më lart, ata janë të paaftë të ndihmojnë vetet e tyre, e si mund të ndihmojnë pastaj të tjerët?!

Allahu i Madhëruar ka qartësuar paaftësinë e këtyre idhujve. Ata nuk vlejné të jenë të adhuruar për katër arsye:

1. ata nuk krijojnë, dhe kush nuk krijon, nuk meriton të adhurohet;
2. ata janë të krijuar nga hiçi dhe kanë nevojë për të tjerë gjatë gjithë kohës;
3. ata nuk mund t'i ndihmojnë lutësit e tyre. Fjala e Allahut: “... nuk munden ...”, është më e qartë se shprehja “nuk i ndihmojnë ata”, se po të thoshte kështu, dikush mund të thoshte se ata paskan mundësi. Prandaj, kur ai thotë: “... e as veten nuk mund ta ndihmojnë”, kjo e shpalos akoma më mirë paaftësinë e tyre;
4. ata nuk mund të ndihmojnë as vetveten.

Ajeti 2. “... Kurse ata që ju i lutni krahas Tij, nuk zotërojnë as sa cipa e bërthamës së hurmës. Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur

ta dëgjonin, nuk do t'ju përgjigjeshin. Në Ditën e Kiametit ata do ta mohojnë adhurimin që u bënit atyre. Askush nuk mund të të njoftojë ty (o Muhamed) ashtu si Ai që është i Gjithëdijshtëm.” (Fatir, 13-14)

– *“Kurse ata që ju i lutni krahas Tij ...”* – Fjala “lutni” këtu, përfshin lutjen e adhurimit dhe lutjen e kërkimit.

– *“... nuk zotërojnë as sa cipa e bërthamës së hurmës. ...”* – Këta nuk zotërojnë as sa një grimcë. Po a nuk e zotëron njeriu një kokërr hurmë? Vërtet ai e zotëron atë, por ky zotërim është i mangët, jo i plotë. Ai mund të veprojë me të, vetëm sipas asaj që është e lejuar në fe. Për shembull, ai nuk mund ta djegë më kot atë, për shkak të ndalimit në Islam të humbjes së pasurisë.

– *“... Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur ta dëgjonin, nuk mund t'ju përgjigjeshin ...”* – Këta idhuj, sikur t'i lutni, nuk kanë për të dëgjuar. Edhe nëse supozohet se ata dëgjojnë, ata përsëri nuk mund të përgjigjen, sepse nuk kanë mundësi për një gjë të tillë. Prandaj dhe Ibrahim (alejhi selam) i ka thënë babait të tij: “O babai im! Pse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh dhe nuk të sjell dobi për asgjë?” (Merjem, 42) Nëse çështja është e tillë, atëherë për çfarë arsyeje u luten të tjerëve veç Allahut? Kjo pra është mendjelehtësi. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) ka thënë: “Kush i shmanget fesë së Ibrahimit përveç atij që e nënçmon vetveten?” (Bekare, 130)

– *“... Në Ditën e Kijametit, ata do ta mohojnë adhurimin që u bënit atyre.”* – I ngjashëm me këtë është edhe ajeti: “Kur njerëzimi të grumbullohet (Ditën e Kijametit), ata (idhujt e tyre) do të jenë armiq të tyre dhe do ta mohojnë adhurimin e tyre.” (Ahkaf, 6). Këta të adhuruar, nëse ringjallen, do ta mohojnë patjetër adhurimin që iu është bërë atyre, siç do të ndodhë me Uzejrin dhe Isain (alejhimu selam). Nëse janë gurë apo pemë, mund të interpretohet me kuptimin e drejtpërdrejtë të ajetit: që Allahu do t'i sjellë ata të mohojnë adhurimin e çdo idhujtari. Këtë e përforcon edhe fjala e Allahut: “Me të vërtetë, ju (idhujtarë) dhe idhujt që i adhuroni në

vend të Allahut, do të jenë lëndë djegëse për Xhehenemin ...” (Enbija, 98). Po kështu, për këtë dëshmon edhe hadithi në “Sahihun” e Buhariut dhe në atë të Muslimit: “Kur të ringjallen njerëzit, do t’i thuhet çdo umeti: ‘Le të ndjekë çdo umet të adhuruarin e vet.’” Guri do të dalë para tyre në Ditën e Kijametit, do të flasë dhe do të mohojë idhujtarinë e tyre. Nëse të adhuruarit do të sillen e do të bëhen lëndë djegëse në Zjarr, si poshtërim për adhuresit e tyre, atëherë nuk është habi që edhe këta adhures t’i mohojnë ata kur të sillen.

– “... Askush nuk mund të të njoftojë ty (O Muhamed) ashtu si Ai që është i Gjithëdijshëm.” – Ky shembull sillet për atë që lajmëron për diçka, ndërsa shikon dyshim tek ai të cilit i është drejtuar për ta lajmëruar. Në ajet thuhet se askush nuk të tregon si ai që e di shumë mirë se për çfarë lajmëron, dhe ky është Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), sepse askush nuk e di se çdo të ndodhë në Ditën e Kijametit veç Tij, dhe kumti i Tij është i vërtetë: “... dhe fjalët e kujt tjetër mund të jenë më të vërteta se Fjalët e Allahut?!” (Nisa, 122). *El Habir* (i Gjithëdijshëm) quhet i dituri për gjërat e padukshme.

Çështje për diskutim

A e dëgjojnë të vdekurit përsëritjen “*es-selamu alejkum*”, dhe a e kthejnë ata këtë përsëritje? Për këtë ka dy mendime.

Sipas mendimit të parë, të vdekurit nuk e dëgjojnë selamin. Përsëritja e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kur vizitohen varrezat: “*Es-selamu alejkum...*”, është lutje, dhe jo për qëllim bashkëbisedimi.

Megjithatë, sipas një hadithi, që e ka vlerësuar të saktë Ibn Abdulberri dhe e ka pohuar Ibn Kajimi, thuhet: “Kur i vdekuri përsëritet me selam nga një person që e ka pas njohur në jetën e kësaj bote, Allahu i Lartësuar ia kthen shpirtin, që ai t’ia kthejë selamin.”¹ Nëse do të pranohet se të vdekurit dëgjojnë, duke e konsideruar të saktë këtë hadith, themi se edhe sikur ata të dëgjonin selamin, nuk do të thotë me domosdo që dëgjojnë gjithçka tjetër. Po edhe nëse do të supozojmë se dëgjojnë edhe të tjera përveç selamit, Allahu i Lartësuar e thotë qartë se ata që luten veç Allahut,

¹ Ibn Abdul-Berri në "el-Istidhkar. Sipas Albanit hadithi është i dobët.

nuk e dëgjojnë lutjen e adhuruesve të tyre. Pra, nuk mund të themi se ata e dëgjojnë lutjen e idhujtarëve, sepse kjo do të thotë të mohosh Kuranin. Mbështetur në këto, është e qartë se nuk ka mospërputhje mes fjalës së të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe ajetit kuranor. Ndërsa fjala: “... por edhe sikur ta dëgjonin atë ...”, ka kuptimin se edhe nëse supozohet se dëgjojnë, ata nuk përgjigjen, sepse nuk mundën.

Sipas mendimit të dytë, të vdekurit dëgjojnë. Ata që mbështesin këtë mendim, argumentohen me përshëndetjen gjatë vizitës së varreve dhe me hadithin e saktë që thotë se i vdekuri e dëgjon zhurmën e këpucëve të përcjellësve të xhenazes, kur ata largohen. Le të japim përgjigjen për këto dy argumente. Së pari, nuk është kusht që ata të dëgjojnë vetëm sepse u jepet selam. Muslimanët i jepnin selam Resulullahit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në *teshehud* kur ai ishte gjallë, e ai kurrë nuk e dëgjonte atë. Së dyti, hadithi tjetër flet për një moment të veçantë, kohën e largimit të përcjellësve të xhenazes pas varrimit.¹ Gjithsesi, të dyja mendimet janë të barazvlefshme, dhe Allahu është më i dituri për to.

Sipas një hadith të saktë, që përcillet nga Enesi (radijallahu anhu), kur i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u plagos në Ditën e Uhudit dhe iu thye dhëmbi, tha: “Si do të shpëtojë populli që plagosi Profetin e tij?” Pas kësaj zbriti ajeti: “Ti (o Muhamed) nuk ke asgjë në dorë ...” (Ali Imran, 128) ²

Uhudi është një mal i njohur në veri të Medinës. Medinës nuk i thuhet “*Munevere*” (e ndritshme), sepse çdo vend ku ka hyrë Islami është i ndriçuar me të. Ky atribut nuk ka qenë i njohur ndër selefë e, gjithashtu, në Kuran ajo është përmendur vetëm me emrin Medinë.

Në malin e Uhudit u krye një betejë në vitin e 3-të hixhri, në muajin *sheval*, në të cilën muslimanët humbën, për shkak të kundërshtimit të urdhrat të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem),

¹ Kjo gjë është e veçantë për këtë kohë. (Kjo shprehje nuk gjendet në botimin e dytë.)

² Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

siç e tregon Allahu i Lartësuar: “... Por kur ju u frikësuat, u grindët midis jush dhe kundërshtuat (Profetin), pasi Ai ju tregoi atë që pëlqenit ...” (Ali Imran, 152). Rrjedhimi është i nënkuptuar: “... u ndodhi ajo që e urrenit.”

Muslimanët humbën në atë betejë për shkak të një gjynahu të vetëm, kurse ne sot duam fitore me kaq shumë gjynahe që jemi duke vepruar. Në këtë gjendje që jemi, ne nuk mund të arrijmë fitore, vetëm nëse na mëshiron Allahu i Lartësuar dhe na përmirëson të gjithëve.

– “... *Si do të shpëtojë populli që plagosi Profetin e tij?*” – Këtu kemi një pyetje, përgjigja e të cilës nënkuptohet që është mohore, që do të thotë se është e largët mundësia që populli që plagosi Profetin e tij të shpëtojë.

– “... *të shpëtojë ...*” – Shpëtimi është arritja e së dëshiruarës dhe shpëtimi nga ajo që të tmerron.

– “... *Ti nuk ke asgjë në dorë...*” – Fjalët në ajet i drejtohen të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Këtu flitet për çështjet e krijesave, të cilat i përkasin Krijuesit të tyre dhe i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk ka asgjë në dorë në lidhje me to. I Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u plagos në fytyrë e iu thye dhëmbi, megjithatë Allahu i Lartësuar nuk e arsyetoi vetëm për një fjalë: “Si do të shpëtojë populli që plagosi Profetin e tij?”

Kur ndodhi kështu me Pejgamberin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), çfarë mund të thuhet për të tjerët?! Ata, pra idhujt, statujat, njerëzit e mirë, Profetët, etj, nuk kanë në dorë asgjë. I tërë pushteti i takon Allahut të Lartësuar, sepse Ai është i Vetmi Krijues. Falënderimi i takon Allahut të Lartësuar që nuk e ka lënë çështjen tonë në dorë të tjetërkujt. Një krijesë nuk ka në dorë të përfitojë apo të largojë të keqen për veten e saj, e si mund të ketë diçka në dorë për të tjerët?

Nga ky hadith mësojmë, gjithashtu, se nuk duhet ta lëshojmë gjuhën pa kufi. Kur shohim një njeri të provuar me gjynahe, të mos mendojmë se ai është përfundimisht larg mëshirës së Allahut të

Lartësuar, se ndoshta Ai ia pranon pendimin, ashtu siç iu kundërpërgjigj Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), kur ai mohoi shpëtimin e atyre që e plagosën: “Ti nuk ke asgjë në dorë.”

Një burrë i bindur ndaj urdhrave të Allahut të Lartësuar, kur kaloi pranë një tjetri që bënte gjynahe, nga bijtë e Israilit, tha: “Vallahi, Zoti nuk e fal atë!” Allahu i Lartësuar i tha: “Kush është ai që betohet në Mua se Unë nuk e fal atë?! Unë ia fala atij gjynahet dhe e asgjësova punën tënde.”¹ Njeriu duhet ta frenojë gjuhën, sepse gjynahet që dalin prej saj janë të mëdha. Pastaj, ne kemi dëgjuar për disa njerëz, që ishin fillimisht nga mohuesit më të fortë, dhe që më vonë u kthyen në të dashur të Allahut.² Pra, si të mohojmë mëshirën e Allahut të Lartësuar për ata që bëjnë gjynahe?! Përderisa njeriu nuk ka vdekur, çdo gjë mund të ndodhë. Edhe muslimanit mund t’i vishet zemra, sidomos kur e ka atë të prishur. Muslimani duhet të marrë mësim nga ky hadith, duke mos e mohuar mëshirën e Allahut të Lartësuar për çdo mëkatar.

Si përfundim, shkakut i zbritjes së këtij ajeti ishte thënia: “Si do të shpëtojë populli që plagosi Profetin e tij?”

Ibn Umeri tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), kur po e ngrinte kokën nga rukuja në rekatën e fundit të namazit të sabahut dhe pasi tha: “*Semi Allahu limen hamideh, Rabbenâ ue lekel hamd*”, u lut: “O Allah, mallkoje filanin dhe filanin!” Pas kësaj zbriti ajeti: “Ti nuk ke asgjë në dorë.”³ Sipas një transmetim tjetër, thuhet: “Po bënte lutje kundër Safuan Ibn Umejes, Suhejl Ibn Amrit dhe Harith Ibn Hishamit. Pas kësaj zbriti ajeti: “Ti nuk ke asgjë në dorë.”⁴

– “... kur po e ngrinte kokën nga rukuja në rekatën e fundit të namazit të sabahut ...” – Është përcaktuar vendin e duarë në namazin e sabahut; për sa i përket rekateve, në të fundit; për sa i

¹ Transmeton Muslimi.

² Aludohet për sahabët.

³ Transmeton Buhariu.

⁴ Transmeton Buhariu.

përket pozicionit në rekat, pas ngritjes nga rukuja.

– “O Allah, mallkoje filanin dhe filanin.” – Largoji nga mëshira Jote dhe dëboji ata prej saj.

– “... filanin dhe filanin.” – Në një transmetim tjetër ka sqaruar se ata ishin: Safuan Ibn Umeje, Suhejl Ibn Amri dhe Harith Ibn Hishami.

– “... pas kësaj zbriti ajeti: “Ti nuk ke asgjë në dorë.” – Sipas këtij varianti, shkak i zbritjes së ajetit është lutja e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kundër tyre, por kjo nuk do të thotë që shkak tjetër të mos jetë edhe hadithi: “Si do të shpëtojë populli që plagosi Profetin e tij?”.

Që të tre personat, për të cilët flitet në hadith, e pranuan Islamin dhe u përmirësuan – radij-Allahu ‘anhum. Armiqësia e tyre u kthye në miqësi, sepse zemrat janë në dorë të Allahut. Sikur çështja të ishte në dorën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ata do të mbeteshin në kufër deri në vdekje. Në qoftë se do të pranohej lutja kundër tyre e do të dëboheshin nga mëshira, atëherë do t’u mbetej vetëm dënimi, por Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), nuk kishte asgjë në dorë dhe i tërë vendimi i takonte Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Kështu i udhëzoi Allahu ata, të cilët u bënë më pas ndër më të përkushtuarit dhe mbrojtës të fesë së Tij, edhe pse kishin qenë armiq të Tij. Allahu i Madhëruar begaton atë që do nga robërit e Vet.

E tillë është edhe ngjarja e Usejrim Ibn Abdul el Eshhel el Ensarit, i cili ishte i njohur për armiqësinë ndaj Shpalljes së të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Kur erdhi çasti i betejës së Uhudit, Allahu futi në zemrën e tij Islamin, pa e ditur Profeti apo ndonjëri prej popullit të tij. Ai doli në luftë dhe ra dëshmor. Pas mbarimit të luftës, njerëzit filluan të kërkojnë të vrrarët e tyre. Atë e gjetën në agoni dhe e pyetën: “Si ishte puna jote? A luftove për patriotizëm apo nga dëshira për Islamin?” Ai tha: “Nga dëshira për Islamin. Unë dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut. Tregojini për mua të Dërguarit të Allahut.” Njerëzit ia kallëzuan Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ai tha: “Ai është banor i

Xhenetit.” Ky burrë nuk kishte falur për Allahun asnjë rekat, e megjithatë Allahu e bëri banor të Xhenetit. Allahu është i Urtë; Ai udhëzon kë të dojë për një urtësi të caktuar, dhe humb kë të dojë për një urtësi tjetër. E rëndësishme është që ne të mos e mohojmë mëshirën e Allahu për asnjë.

Ebu Hurejre ka thënë: “Kur zbriti fjala e Allahut: ‘Paralajmëro farefisnin tënd më të afërm’ (Shuara, 213), i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u ngrit dhe tha: ‘O grup i kurejshëve (ose një shprehje të ngjashme)! “Blini” veten tuaj, se unë nuk kam në dorë asgjë për ju para Allahut të Lartësuar. O Abas, biri i Abdul Mutalibit, unë nuk kam në dorë asgjë për ty para Allahut të Lartësuar. O Safije!¹. Unë nuk kam në dorë asgjë për ty para Allahut të Lartësuar. O Fatime, bija e Muhamedit, kërko nga pasuria ime çfarë të duash, se para Allahut të Lartësuar unë nuk kam në dorë asgjë për ty!”²

– “... *Kur zbriti fjala e Allahut ...*” – Pra, erdhi ajeti te Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) me anë të Xhibrilit.

– “... *paralajmëro ...*” – Fjala arabe “*endhir*” do të thotë “paralajmëro” dhe “frikëso”, domethënë është një paralajmërim me frikësim.

– “... *farefisnin tënd ...*” – Farefisi është lidhja e gjakut të një personi, nga katragjyshi e poshtë.

– “... *më të afërm ...*” – Do të thotë të afërmit dhe më të afërmit. Të parët që futen në fisin e njeriut janë fëmijët e tij, pastaj prindërit, vëllezërit, xhaxhallarët e tij, e kështu me radhë. Kjo tregon se më të afërmit e meritojnë më shumë të paralajmërohen, sepse gjykimi varet nga objektivi dhe fuqizohet sipas shkallës së tij. Kjo për faktin

¹ Safija ishte halla e të Dërguarit të Allahut.

² Transmeton Buhariu.

se sa më i qartë të jetë objektivi i gjykimit, aq më mirë trajtohet ai.

– “... *kur zbriti ...*” – Nga kjo mësojmë se Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk u vonua, por menjëherë u ngrit dhe tha: “O grup i kurejshëve...”. Kurejsh ishte Fihri Ibn Nadr Ibn Malik, njëri nga gjyshërit e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

– “... *Blini veten tuaj ...*” – Kjo do të thotë “shpëtoni veten tuaj”, sepse blerësi i vetvetes e ka shpëtuar atë nga shkatërrimi. Blerësi ka dëshirë të blejë, prandaj është shprehur kështu, si të thoshte: “Blini vetet tuaja me dëshirë.” Edhe nxitja përfshihet në këtë shprehje, sepse blerësi e dëshiron atë që blen.

– “... *se unë nuk kam në dorë asgjë për ju para Allahut të Lartësuar. ...*” – Pra: nuk mundem t’ju ndihmoj për largimin e diçkaje pa lejen e Allahut, dhe as për pengimin diçkaje që Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) e dëshiron për ju, sepse i tërë pushteti i përket Atij. Për këtë arsye e ka urdhëruar Allahu i Lartësuar Profetin e Tij, duke i thënë: “Thuaj: ‘Unë nuk mundem t’ju largoj ndonjë dëm e as t’ju sjell ndonjë dobi. Thuaj: ‘Edhe mua askush nuk mund të më mbrojë nga dënimi i Allahut; dhe nuk kam për të gjetur strehim tjetërkund, përveçse tek Ai.’” (Xhin, 21-22).

– “... *O Abas, biri i Abdul Mutalibit ...*” – Abasi ishte xhaxhai i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Këtu është përdorur emërtimi *Abdul Mutalib*. Po si quan Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) “*Abdul Mutalib*” (Rob i Mutalibit), duke qenë se “*Abd-i*” (Robi) duhet t’i përkasë vetëm Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala)?! Përgjigja është se ky nuk ishte emër që e vuri Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), por ishte thjesht thirrje me atë emër. Emri i gjyshit të tij ishte Abdul Mutalib, dhe ai kështu njihej. Edhe në një hadith tjetër, i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: “Unë jam Pejgamber, jo gënjeshtar, unë jam biri i Abdul Mutalibit.”

Edhe ti, nëse do të kishe një baba me emrin Abdul Mutalib ose Abdul Uza, me këtë atësi do të thirreshe, dhe kjo nuk do të konsiderohej si pohim nga ana jote i përmbajtjes kuptimore të emrit, por do të ishte thjesht një emërtim. Mirëpo, nëse personi

është gjallë dhe emri i tij është i palejuar, atëherë duhet ta ndërrojë atë.

– “... unë nuk kam në dorë asgjë për ty para Allahut të Lartësuar ...” – Kjo do të thotë: unë nuk mund të të jap asnjë ndihmë pa lejen e Allahut, dhe as nuk mund të largoj ndonjë gjë prej teje që Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) e dëshiron. Pra, i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk mund të ndihmonte asnjë, madje as babain dhe nënën e tij.

– “... O Fatime, bija e Muhamedit, kërko nga pasuria ime çfarë të duash ...” – Pra, më kërko nga pasuria ime çfarë të duash, se nuk kam për të mbajtur asgjë. Kjo, sepse pasurinë e vet Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e zotëronte, ndërsa kur flitej për detyrat ndaj Allahut ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thoshte: “... unë nuk kam në dorë asgjë për ty para Allahut...”.

Kështu iu drejtua Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) farefisit të tij më të afërt: xhaxhait, hallës dhe së bijës. E ç’mund të thuhet për ata që janë më të largët? Për ta ndihma e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është akoma më e largët. Njerëz që i lidhin shpresat me të Dërguarin e Allahu (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), që i kërkojnë atij mbrojtje dhe shpëtim, ka pasur dhe ende ka. Shejtanët i kanë mashtruar dhe i kanë devijuar këta nga rruga e drejtë, duke i bërë të mbështeten në diçka që nuk është mbështetje. Ajo çfarë bën dobi, në lidhje me të Dërguarin e Allahut, është ta besosh dhe ta ndjekësh atë, ndërsa t’i lutesh atij, të lidhësh shpresën tek ai apo t’i frikësohesh atij, është shoqërim me Allahun. Kjo është ndër veprat që të largojnë nga Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe nga shpëtimi prej ndëshkimit të Allahut.

Ky hadith dëshmon zbatimin nga ana e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të fjalës së Allahut: “Këshilloje farefisin tënd të afërm!” Ai e zbatoi këtë urdhër më së miri. Ai ftoi, përgjithësoi, veçoi dhe sqaroi se ai vetë nuk mund të shpëtonte asnjë prej dënimit të Allahut, por ky shpëtim mund të arrihet veçse me anë të besimit të drejtë dhe ndjekjes së Shpalljes që iu përcoll atij.

Kur lidhja e gjakut me Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk i bën dobi të afërmit, atëherë kërkimi i afrimit tek Allahu me anë të

pozitës së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është i ndaluar. Pozita e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk i bën dobi askujt, përveçse vetë atij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Qëndrimi më i saktë i dijetarëve, në lidhje me kërkimin e afrimit të Zotit me anë të pozitës së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), është se ky konsiderohet haram.

▮ **Dobitë e temës**

- ▮ ➤ Komenti i dy ajeteve.

Dy ajeteve të sures “Araf”, si dhe ajeti i tretë i sures “Fatir”.

- ▮ ➤ Ngjarja në Uhud.

Ngjarja e plagosjes së të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), siç përcillet në hadith.

- ▮ ➤ Bërja e duasë së Kunutit nga zotëriu i të Dërguarve, ndërsa pas tij, në namaz, më të mirët e evlijave thoshin “amin”.

Me këtë përfundim, autori ka dashur të thotë se Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), zotëriu i të Dërguarve dhe shokët e tij, më të mirët e evlijave, nuk e quanin veten të shpëtuar, atëherë si mund të shpëtojnë ata të tjerët? Qëllimi i autorit nuk ka qenë thjesht pohimi i duasë së Kunutit dhe thënies “amin”. Ai ka përdorur termin *sejjid* (zotëri) dhe “*sadat*” (zotërinjtë, më të mirët). Askush nga ky umet nuk është më afër Allahut se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe shokët e tij, e megjithatë ata i drejtoheshin Allahut për largimin e telasheve. Pra, qëllimi i dijetarit nuk ka qenë pohimi i një riti.

- ▮ ➤ Ata, kundër të cilëve u bë lutja (e Pejgamberit) ishin

qafirë.

Ky konkluzion del nga fjala e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “... nëse do t’u pranojë Ai pendimin ...”, që tregon se, në atë kohë, ata nuk ishin në gjendje të kënaqshme. Dihet se Safuan Ibn Umeje, Suhejl Ibn Amri dhe Harith Ibn Hishami, në kohën kur Profeti lutej kundër tyre, ishin qafirë.

Kjo lutje kundër qafirëve tregon se Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), edhe pse mendonte se lutja kundër tyre ishte e drejtë, ai përsëri nuk kishte gjë në dorë.

Ndoshta dikush mund të pyesë se, meqë ata ishin qafirë, a nuk kishte të drejtë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të lutej kundër tyre? Themi se, edhe në të tilla rrethana, ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk kishte asgjë në dorë në lidhje me çështjen e tyre.

Kur autori thotë se Pejgamberi u lut kundra qafirëve, qëllimi nuk është përcjellja e faktit se ata ishin qafirë, sepse kjo dihej, por të tregonte se ai nuk kishte asgjë në dorë në lidhje me ta.

- Ata kishin kryer disa gjëra, që nuk i kishin bërë shumica e qafirëve, si: plagosjen e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), komplete për vrasjen e tij, gjymtimin e të vrarëve, megjithëse ishin djemtë e xhaxhallarëve të tyre etj.,

Do të thotë se përveçse jobesimtarë ishin edhe agresorë. E megjithatë, në lidhje me ta, u shpall: “Ti nuk ke asgjë në dorë.”

- Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) shpalli se: “Ti (o Muhamed) nuk ke asgjë në dorë ...” (Ali Imran, 128)

Do të thotë se me gjithë faktet e lartpërmendura, të cilat çojnë në përfundimin logjik se Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kishte të drejtë të lutej kundër tyre, çështja i përkiste vetëm Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Nëse kjo gjë iu ndalua të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), për të tjerët nuk diskutohet.

- Allahu i Lartësuar thotë: “... se a do t’u pranojë Ai pendimin ...” (Ali Imran, 128)¹. E në fakt Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) ua mundësoi të bënin kthesë, dhe kështu ata më pas u bënë besimtarë.

Kjo tregon për pushtetin dhe fuqinë e plotë të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Ata vepruan diçka të rëndë, por Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) i mëshiroi dhe ata më pas u bënë besimtarë. Ai poshtëron kë të dojë dhe krenon kë të dojë. Kështu ndodhi me Omerin (r.a.): nga një armik i hapur ndaj Islamit, ai u bë muslimani që dha ndihmën e pakrahasueshme për fenë e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Përfundimisht, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe të tjerë pas tij nuk mund t’i ndryshojnë vendimet e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala).

- Duaja e Kunutit në situata të vështira.

Kjo është një çështje *fikh*-u. Kur muslimanët ndodhen në vështirësi, duhet të bëhen lutje derisa ajo të largohet. *Duaja e Kunutit* mund të bëhet në çdo namaz, siç thuhet në hadithin e Ibn Abasit, që përcillet nga Ahmedit e të tjerë². Megjithatë, dijetarët – Allahu i Lartësuar i mëshiroftë! – e kanë përjashtuar rastin e epidemisë së kolerës, për shkak se nuk ka dëshmi fetare që vërtetojnë se *duaja e Kunutit* bëhet për të. Një rast i tillë ka ndodhur në kohën e Omerit (r.a.), dhe ai nuk bëri *dua Kunuti*. Gjithashtu, vdekja nga kolera është si vdekje dëshmori, dhe *duaja e Kunutit* nuk bëhet për largimin e shkaqeve të rënies dëshmor.

Me sa shihet nga Suneti, *duaja e Kunutit* bëhet në situata të vështira, që nuk janë drejtpërdrejt nga Allahu i Lartësuar, si: mundimi i muslimanëve, lëndimi i tyre etj. Kur ndodhitë janë drejtpërdrejt nga Allahu, veprohet sipas traditës pejgamberike: për eklipsin falet namazi i eklipsit; në rast tërmeti falet *namazi i eklipsit*, siç ka vepruar Ibn Abasi (r.a.), i cili ka thënë se ky quhet “*salatul ajati - namazi i dukurive*”; për thatësi të falet namazi i shiut, etj. Deri

¹ Kjo pjesë ajeti është vazhdimësia e ajetit të përmendur në pikën para kësaj.

² Sipas Albanit hadithi i Ibn Abasit është i mirë.

tani unë nuk di që *duaaja e Kunutit* të bëhet për ndonjë gjë që vjen drejtpërdrejt nga Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), por përkundrazi, di që bëhen lutje të posaçme, të cilat janë dëshmuar në Sunet. Mirëpo në rastet e mundimit, torturave apo përndjekjes së muslimanëve, duhet bërë *duaaja e Kunutit*, duke zbatuar kështu edhe Sunetin e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). *Duanë e Kunutit* mund ta bëjë çdo person që falet. Ky është qëndrimi i saktë, duke marrë si argument tërësinë e hadithit të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “*Faluni ashtu siç më patë mua duke u falur.*”¹ Kjo përfshin edhe lutjen e tij në rastet e vështirësive.

- Përmendja e atyre që mallkoi, me emrat personalë dhe me emrat e etërve të tyre.

Konkretisht Safuan Ibn Umeje, Suhejl Ibn Amri dhe Harith Ibn Hishami.

A është e ligjshme kjo? Po, është e lejuar. Nëse përmendja e emrit të personit ka dobi, atëherë është më mirë që të bëhet. Pra, nëse lutesh ndaj disa personave të caktuar në namaz, lejohet, sepse është një lutje, dhe lutja është t’i drejtohesh Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Ajo nuk përfshihet në thënien e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Ky është namaz, prandaj gjatë tij nuk duhet të thuash fjalë njerëzish.”²

Çështje për sqarim:

Të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) iu ndalua lutja apo mallkimi i personave të posaçëm? Ndalimi ishte për mallkimin e qafirëve me emra konkretë, ndërsa mallkimi i tyre në përgjithësi nuk ka asgjë të keqe. Ebu Hurejra transmeton se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka mallkuar qafirët në përgjithësi. Po kështu, nuk është e ndaluar nëse lutemi kundër një qafiri me fjalët: “O Zot, shpëtoi muslimanët nga ai dhe ruaji prej të keqes së tij me mënyrën që Ti ! Bëje të keqen e tij të kthedohet po tek ai!”

Ndërsa lutja për shkatërrimin e qafirëve në përgjithësi, ka nevojë për shqyrtim. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk është

¹ Transmeton Buhariu.

² Transmeton Muslimi

lutur kundër kurejshëve për shkatërrim, përkundrazi ka thënë: “O Allah, jepu mundim atyre! O Allah, sill mbi ta vite (thatësire) si në kohën e Jusufit!”¹ Kjo lutje është për vështirësi, dhe kjo mund të jetë në dobi të keqbërësve, pasi kështu ata mund të kthehen tek Allahu e t’i lënë zullumet.

Nga ana ime, për sa i përket lutjes kundër qafirëve në përgjithësi, unë ngurroj. Ndoshta për lejimin e kësaj mund të sillet si argument lutja e Hubejbit: “O Allah shkatërroi ata të gjithë dhe mos lër asnjë prej tyre!” Kjo ka ndodhur në kohën e Pejgamberit dhe vërtetë ndodhi siç u lut ai: në krye të vitit nuk mbeti askush prej tyre. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) nuk e kundërshtoi këtë e gjithashtu as Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), madje përgjigja e Allahut për lutjen e tij, dëshmon se Ai ka qenë i kënaqur dhe e ka pohuar atë.

Ndoshta autori kërkon të provojë se lutja kundër qafirëve për shkatërrim lejohet, por ngjarja e mësipërme ka nevojë të rishikohet, se ndoshta shkaqet e saj janë të posaçme e që nuk janë të mundshme në çdo rast. Pastaj Hubejbi u lut për shkatërrimin e një grupi të kufizuar jobesimtarësh, jo për të gjithë ata.

Me këtë çështje lidhet edhe lutja e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kundër Utbe Ibn Ebu Lehebit (nëse hadithi është i saktë): “O Allah, lësho mbi të një nga egërsirat e Tua.”² Ajo fakton lutjen për shkatërrim, madje për një person të caktuar e jo kundër të gjithë qafirëve.

► Mallkimi i një personi të caktuar në duanë e kunutit.

Ky konkludim është vërtetë i çuditshëm, pasi nëse autori (Allahu e mëshiroftë) ka për qëllim të thotë se kështu ndodhi, por më pas kjo gjë u ndalua, s’ka asnjë problem. E nëse qëllimi i tij është se prej këtij fakti mund të konkludohet lejimi i mallkimit të një personi të caktuar, rregullisht, në duan e kunutit, kjo duhet të shqyrtohet, sepse të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) iu ndalua diçka e tillë.

¹ Transmeton Buhariu.

² Ibn Asaker, Hakimi.

- Veprimi i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), kur iu shpall ajeti: “Paralajmëroje farefisnin tënd më të afërm.”

Ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u thirri kurejshëve sapo i zbriti ajeti. Në fillim foli në përgjithësi, pastaj në veçanti, duke zbatuar menjëherë urdhrin e Allahut.

- Përpjekja e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në thirrjen për tek e vërteta iu përshkrua si çmenduri. Kështu ndodh me çdo musliman që bën këtë punë.

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) qe aq i angazhuar për t’i ftuar njerëzit në fenë e Allahut, sa ata e quajtën të marrë që i mblodhi vetëm për t’u thënë ato fjalë?

Kështu mund t’i ndodhë çdo muslimani nëse bën të njëjtën gjë. Kjo do të thotë se sikur një njeri sot t’i grumbullojë njerëzit, e pastaj t’i paralajmërojë ashtu siç bëri Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ata kanë për ta quajtur të çmendur, veç nëse ky veprim është i zakonshëm për ata njerëz. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Ato ditë (fitoreje dhe humbje) Ne i ndërrojmë midis njerëzve ...” (Ali Imran, 140); “Allahu ndërron ditën dhe natën ...” (Nur, 44). Situata ndryshon sipas vendeve dhe kohës, por është detyrë për muslimanin të sakrifikojë gjithçka në thirrjen për në rrugë të Allahut me urtësi e butësi. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) mori përsipër zbatimin e këtij urdhri, pa marrë parasysh akuzat e njerëzve për marrëzi.

- “Fjalët e Profetit u drejtoheshin të afërmve dhe të largëtve: “... unë nuk kam gjë në dorë për ju para Allahut të Lartësuar ...” dhe pastaj: “O Fatime, bija e Muhamedit! kërko nga pasuria ime çfarë të duash, se para Allahut të Lartësuar unë nuk kam gjë në dorë për ty”. Kur “Zotëriu i Profetëve” i tha kështu më të nderuarës së grave të botës, vajzës së tij, – dhe ne besojmë se ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thoshte

vetëm të vërtetën, – dhe më pas sheh se ç’ndodh me zemrat e parisë së sotme, e kupton qartë se si është braktisur teuhidi dhe si janë larguar nga feja.”

Të vërtetën ka thënë, Allahu e mëshiroftë! Kur më i nderuari i Profetëve i foli kështu më të nderuarës së grave të botës, – duke besuar se ai thoshte veçse të vërtetën, – dhe kur shohim se ai nuk kishte gjë në dorë as për vajzën e vet, e kuptojmë mirë se ajo çfarë veprojnë disa njerëz të elitës sot është largim nga teuhidi. Ka disa udhëheqës që e mendojnë veten e tyre si dijetarë, e po të tillë i mendojnë edhe ata që u rrinë rreth tyre se ata janë dijetar dhe meritojnë të pasohen. Ata lusin Pejgamberin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për largimin e së keqes dhe dhurimin e të mirës, me fjalë politeizmi, si:

O krijesa më e nderuar,
Kur të zezat t’me kenë pushtuar,
Ndihmë veç ty kam për t’kërkuar!

Nëse i kundërshton, ata të hidhen e të thonë se, gjoja, nuk e njeh pozitën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tek Allahu, se ai është më i ndershmi i krijesave, se xhindët dhe njerëzit u krijuan për shkak të tij, se ai u krijua nga drita e Arshit etj., duke mashtruar kështu njerëzit e thjeshtë. Disa prej tyre edhe i besojnë, për shkak të injorancës. Nëse i fton në teuhid, nuk të përgjigjen, sepse vetë udhëheqësi i tyre shkon kundër teuhidit: “Edhe sikur t’u sillje të gjitha provat atyre që u është dhënë Libri, ata prapëseprapë nuk do ta pranonin kiblën tënde.” (Bekare, 145).

Ndjenjat e muslimanit, duke dashur me pasion Pejgamberin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), nuk mund të mohohen, por njeriu nuk duhet të gjykojë i nisur nga ndjenjat. Përkundrazi, ai duhet të përqafojë gjithçka që vërteton Kurani e Suneti dhe që e mbështet logjika e pastër, e pa molepsur nga dyshimet dhe pasionet. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) tregon se qafirët, të cilët ndjekin traditën e të parëve tyre, nuk logjikojnë. Autori (Allahu e mëshiroftë!) thotë të vërtetën: nëse sheh gjendjen e njerëzve sot në shumë vende, bindesh për lënien e teuhidit nga ana e tyre dhe largimin nga feja e vërtetë.

Tema 16

Thënia e Allahut: “... Kur t'u hiqet frika nga zemrat e tyre, ata do të pyesin njëri-tjetrin: ‘Çfarë tha Zoti juaj?’ Melaiket do të përgjigjen: ‘Të vërtetën! Ai është i Lartësuar dhe i Madhërishëm.’” (Sebe, 23)

Lidhja e titullit me çështjen në fjalë qëndron në faktin se ky ajet është një nga argumentet që tregojnë se askush nuk meriton të jetë ortak me Allahun, sepse edhe melaiket, që janë krijesat më të afërta tek Allahu – me përjashtim të njerëzve të zgjedhur, që janë edhe më të afruar sesa melekët – i frikësohen Allahut kur dëgjojnë fjalën e Tij.

– “... Kur t'u hiqet frika (*el fez'u*) nga zemrat e tyre (*melekëve*) ...” – “*El fez'u*” quhet frika e përkohshme, sepse frika e vazhdueshme nuk quhet *fezun* (trishtim).

– “... nga zemrat e tyre ...” – Domethënë nga zemrat e melekëve. Përemri “*i tyre*”, i përket emrit “melekët”, siç do të dëshmohet me hadithin e Ebu Hurejrës. Askush nuk është më i ditur në shpjegimin e Kuranit, sesa Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem).

– “... Melaiket do të përgjigjen: “Të vërtetën! ...” – Kuptimi është se Ai ka thënë të vërtetën, sepse Allahu i Lartësuar është i Vërteti dhe nga Ai del vetëm e vërteta. Ai flet dhe vepron vetëm të vërtetën. E

vërteta është në fjalë, në kumtim, ndërsa drejtësia është në gjykim: “Fjala e Zotit tënd është e plotësuar me vërtetësi dhe drejtësi ...”. (En'am, 15)

Nga kjo nuk kuptohet se fjala e Tij mund edhe të mos jetë e vërtetë, përkundrazi, pohimi këtu është përshkrim i realitetit. Megjithatë, dikush mund të thotë: përderisa është përshkrim i realitetit dhe melekët e dinë se Ai thotë vetëm të drejtën, përse është përdorur forma pyetëse? Kjo përdoret si lavdërim për Allahun (Subhanehu ue Te'Ala), i Cili (Subhanehu ue Te'Ala) thotë vetëm të vërtetën.

– “... Ai është i Lartësuar dhe i Madhërishtëm.” – Ai është i lartësuar me Qenien dhe Cilësitë e Tij. Gjithashtu, madhështia e Tij nuk krahasohet me asgjë; nuk ka tjetër më të madh se Ai.

Lidhja e këtij fragmenti me teuhidin, qëndron në faktin se Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), përderisa ka madhështi unike, atëherë duhet të jetë patjetër i Vetëm edhe në adhurim.

Lartësimi i Zotit është dy llojesh:

1. *Lartësim i attributeve të Tij.* Këtë e pohojnë të gjithë ata që emërtohen muslimanë, madje edhe *xhehmitë* apo sekte të tjera.

2. *Lartësimi i Qenies së Tij.* Këtë e kanë mohuar shumë nga ata që quhen muslimanë, si për shembull *xhehmitë* dhe disa *eshari*, përveç disa kërkuesve nga radhët e tyre, të cilët e kanë pohuar lartësimin e Qenies së Zotit. Lartësimi i Tij nuk e mohon afërsinë e Tij me krijesat, duke ditur gjendjen e tyre, duke i dëgjuar dhe shikuar ata; Ai nuk i përngjan askujt dhe asgjëje, në të gjitha atributet e Tij.

Dobitë e ajetit:

- Engjëjt i frikësohen Allahut të Lartësuar: “Ata i frikësohen Zotit të tyre, i Cili është lart mbi ta, dhe bëjnë çfarë urdhërohen ...” (Nahl, 50).

- Engjëjt kanë zemër: “... Kur t'u hiqet frika nga zemrat e tyre ...”

- Engjëjt kanë trup; nuk janë shpirt pa trup. Kjo është thellësisht e njohur: “... i Cili i bëri melekët të dërguar me nga dy, tre dhe katër krahë ...” (Fatir, 1). Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e pa

Xhibrilin me gjashtëqind fletë, që kishte bllokuar horizontin.¹ Mendimi se ata janë vetëm shpirtra, në fakt është mohim i tyre, kështu është i papranueshëm.

- Engjëjt nuk hanë e nuk pinë. Ushqimi i tyre është madhërimi i Allahut: “Ata e lavdërojnë (Atë) natën dhe ditën, pareshtur.” (Enbija, 20). Ajeti dëshmon se netët dhe ditët e tyre janë të mbushura me adhurim. Është përcjellë se ata bëjnë *tesbih* natën, dhe jo gjatë natës, që do të thotë se ata bëjnë *tesbih* vazhdimisht. *Tesbih*-u është dëlirësimi i Allahut nga gjithçka që nuk i përshtatet Madhërisë së Tij.

- Engjëjt kanë mendje. Zemra është qendra e mendjes. Kjo kundërshton mendimin se ata nuk mendojnë. Ata i bëjnë *tesbih* Allahut e gjithashtu bëjnë *tavaf* në Bejtul Ma'mur.

- Allahu i Lartësuar flet, dhe kjo ndodh kur ka dëshirë Ai, sepse ajeti vjen i kushtëzuar: “... Kur t’u hiqet frika ...”. Lidhëza kohore “*kur*” tregon varësi nga kushti kohor. Ky qëndrim kundërshton *esharitë*, të cilët thonë se e folura e Allahut nuk varet nga vullneti i Tij, por është atribut i mëvetësishëm i Tij. Sipas tyre, ajo qëndron me Allahun, e pafillimtë dhe e pafundme, ashtu si atributet e diturisë, forcës, dëgjimit e shikimit. Megjithatë, nuk ka dyshim se qëndrimi i tyre është i pavërtetë, sepse në thelb ai është mohim i të folurës së Allahut. Ata thonë se Allahu flet me fjalë të mëvetësishme të Tij, të pafillimta e të pafundme, dhe se fjalët që dëgjuan Musai, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe ato që zbriti Xhibrili, ishin të krijuara e të barasvlefshme me fjalët e Allahut që ndodhen në Qenien e Tij. Kështu thonë edhe *xhehmitë*, dhe siç pohojnë disa hulumtues *eshari*: “Nuk ka ndryshim mes nesh (*esharive*) dhe *xhehmive*. Ne jemi pajtuar se gjithçka që ndodhet ndërmjet dy kapakëve të Kuranit është e krijuar, por ne themi se ajo është e barasvlefshme me fjalët e Allahut, ndërsa ata thonë se është fjalë e Allahut.” *Xhehmitë* kanë të drejtë kur thonë se është fjalë e Allahut, por e kanë gabim kur deklarojnë hapur se fjala e Allahut është e krijuar.

- Allahu i Lartësuar thotë të vërtetën: “... kurse Allahu thotë të vërtetën dhe udhëzon në rrugë të drejtë.” (Ahzab, 4). “Allahu tha: ‘E vërteta është - dhe Unë them vetëm të vërtetën.’” (Sad, 84). Pra,

¹ Transmeton Buhariu.

Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë vetëm të vërtetën, sepse Ai është i Vërteti dhe nga i Vërteti del vetëm e vërteta.

Në një hadith të saktë nga Ebu Hurejre, përcillet se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kur Allahu vendos për një çështje në qiell, melaiket i rrahin fletët e tyre si përukje për Thënien e Tij, si të jetë ai (zëri i fjalës që dëgjohet) zinxhir mbi rrasën e lëmuar, duke arritur ky zë tek të gjithë melaiket. “... Kur t’u hiqet frika nga zemrat e tyre (melekëve), ata do të pyesin njëri-tjetrin: ‘Çfarë tha Zoti juaj?’ melaiket do të përgjigjen: ‘Të vërtetën! Ai është i Lartësuar dhe i Madhërishëm.’” Ndërkohë xhindët e dëgjojnë atë vjedhurazi. Ata rrinë njëri mbi tjetrin kështu (Sufjani e ilustron me pëllëmbën e tij, duke i vendosur gishtërinjtë e hapur njërin mbi tjetrin). I pari dëgjon një fjalë dhe ia përcjell atij që ndodhet poshtë tij, pastaj ky ia thotë tjetrit më poshtë, e kështu me radhë, derisa fjala shkon në gjuhën e magjistarëve ose fallxhorëve. Shkëndija mund ta kapë para se të përcjellë fjalën, por mund ta përcjellë edhe para se të goditet, pastaj falltari ose magjistari i shton asaj njëqind gënjeshtër. Pas kësaj, njerëzit, duke përmendur arsyen pse u besojnë falltarëve, thonë: ‘A nuk na tha një ditë kështu e kështu?’ Kësisoj, i besojnë për shkak të fjalës që u dëgjua nga qielli.”¹

– “*Kur Allahu vendos për një çështje në qiell ...*” – Vendimi jepet me fjalë: “Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të: ‘Bëhu!’ dhe ajo bëhet.” (Ali Imran, 47)

– “*... si përukje për Thënien e Tij, si të jetë ai ...*” – Kjo shprehje do të thotë se i këtillë është ndikimi i zërit të fjalës që dëgjojnë në zemrat e tyre.

– “*... zinxhir mbi rrasën e lëmuar ...*” – Nëse një zinxhir lëviz mbi

¹ Transmeton Buhariu.

një gur të fortë e të lëmuar, ai lëshon tinguj të fortë. Ky nuk është përngjasim i zërit të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), sepse në lidhje me Allahun: "Asgjë nuk i shëmbëllen Atij; Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi." (Shura, 11), por është përngjasimi i frikës nga dëgjimi i fjalës së Tij, me frikën nga dëgjimi i zinxhirit mbi gurin e lëmuar.

– "... Kur t'u hiqet frika nga zemrat e tyre (melekëve), ata do të pyesin njëri-tjetrin: 'Çfarë tha Zoti juaj?' dhe do të përgjigjen: 'Të vërtetën!'" – E thonë këtë sepse e dëgjojnë çfarë u tha dhe e mësojnë se ajo është e vërtetë, apo e dinë se Ai thotë vetëm të vërtetën? Mund të jetë e para, duke iu referuar shpalljes që sapo u kumtua, por mund të jetë edhe e dyta: që e dinë se Allahu flet vetëm të drejtën, sepse kjo është cilësi e Tij (Subhanehu ue Te'Ala).

Hadithi është në përputhje të plotë me ajetin e, rrjedhimisht, ai duhet të jetë edhe shpjegimi i ajetit. Nuk pranohet prej askujt të japë shpjegim tjetër, kur gjenden komentime të Kuranit me Kuran ose me Sunet. Gjithashtu, për shumicën e komentatorëve të Kuranit shpjegimet e sahabëve janë të pranueshme; ndërsa për tabiinët, shumica e dijetarëve thonë se shpjegimet e tyre nuk janë argumente bazë, me përjashtim të ndonjërit që ka veçuar Muxhahidin, pasi ky i fundit e ka përsëritur këndimin e Kuranit përpara Ibn Abasit njëzet herë apo më shumë, duke ndaluar në çdo ajet dhe duke e pyetur Ibn Abazin për kuptimin e tyre. E për sa i përket dijetarëve që vinë pas tabiinëve, komenti i tyre nuk ka ndonjë vlerë argumentimi përkundër asaj që mendojnë të tjerët, por nëse komenti i ndonjërit prej tyre mbështetet nga konteksti i Kuranit, atëherë argumenti qëndron në vetë kontekstin.

Nuk pranohet, për shembull, interpretimi: kur t'u hiqet njerëzve frika nga zemra në Ditën e Kijametit. Përkundrazi, Pejgamberi (sal-lallahu 'alejhi ue sel-lem) i dha ajetit një koment të pamundur për t'u njohur nga njerëzit, në të cilin nuk ka vend për gjykime individuale (*ixhtihad*). Për çështje të tilla, kur vijnë të argumentuara, bëhet e detyrueshme pranimi i tyre. Kësisoj, në disa çështje *ixhtihadi* është i pranueshëm dhe në disa të tjera jo. I papranueshëm është në bazat e fesë, kurse për degët e saj mund të justifikohet. Dijetarët thonë se në çështjet themelore nuk ka vend

për *ixhtihad*, dhe kundërshtarët në këtë pikë gabojnë.

Shejhu i Islamit Ibn Tejmije e ka kundërshtuar ndarjen e fesë në baza dhe degë. Ai thotë se kjo ndarje nuk vlen, sidomos për namazin, të cilin disa e quajnë si ndër degët e fesë, kur ai është nga themelet kryesore të saj.

Diskutimi ngrihet rreth çështjeve që lejojnë *ixhtihad*-in, dhe atyre që nuk kanë vend për të. Në çështjet e *gajb*-it nuk justifikohet *ixhtihad*-i, për shembull në atributet e Allahut, Ditën e Gjykimit e të tjera si këto. Ndërsa për rastet e tjera, *ixhtihad*-i nuk kritikohet, përveç kur bie ndesh me argumente fetare të qarta. Nëse kundërshtohen këto të fundit, humbja është e sigurt, siç është fjala e Ibn Mesudit në lidhje me trashëgiminë: “Vajzës i takon gjysma, vajzës së djalit një e gjashta, ndërsa plotësimi i dy të tretave dhe ajo që mbetet, i takojnë motrës (së të vdekurit).” I përmendën atij ndarjen që bënte Ebu Musa: “Vajzës i takon gjysma dhe motrës i takon gjysma tjetër e trashëgimisë” dhe deklaratën e tij: “Silleni Ibn Mesudin të më pasojë mua!” Kur e dëgjoi Ibn Mesudi këtë, tha: “Atëherë unë paskam humbur dhe nuk jam në rrugë të drejtë.”

– “... *Xhindët e dëgjojnë atë vjedhurazi ...*” – Ata dëgjojnë fjalët e engjëjve. Heto fjalën “vjedhurazi” dhe të duket si një grabitje e shpejtë. Këtë e përforcon fjala e Allahut të Lartësuar: “Përveç atij që grabit diçka e që e ndjek një yll verbues.” (Safat, 10)

– “... *Ata janë kështu njëri mbi tjetrin ...*” – Këto mund të jenë fjalët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ose të Ebu Hurejres, ose të Sufjanit.

– “... *kështu Sufjani e ilustron me pëllëmbën e tij, duke i vendosur gishtërinjtë e hapur njërin mbi tjetrin ...*” – Kjo do të thotë se ata hipin mbi njëri-tjetrin, derisa arrijnë në qiell, e atëherë çdonjëri qëndron në vendin e vet. Allahu përmend fjalët e xhindëve: “Dhe uleshim rreth tij, në vende të përshtatshme për të dëgjuar diçka, por ai që dëgjon tani, do të hasë në shigjeta të zjarra (meteorë) në pritë.” (Xhin, 9).

– “... *E dëgjon një fjalë dhe ia thotë atij që është poshtë tij ...*” – E

dëgjon “vjedhësi” i fjalëve, që ndodhet më lart, dhe ia përcjell tjetrit që është poshtë tij, pra i tregon atë çfarë dëgjon.

– “... pastaj ky ia thotë tjetrit më poshtë, e kështu me radhë, derisa fjala shkon në gjuhën e magjistarëve ose fallxhorëve ..” – Ai që ndodhet në fund, në tokë, ia përcjell ndonjë magjistari ose falltari.

Magji quhet përdorimi i formave magjepsëse, si: lexime të ndryshme, hajmali etj., të cilat ndikojnë në trupin, zemrën, logjikën dhe mendimin e njeriut.

Falltar është ai që parashikon ngjarjet e së ardhmes. Disa nxënës të dijes janë ngatërruar në këtë çështje, duke menduar se çdo njeri që tregon për të panjohurën, qoftë edhe për diçka që ka ndodhur në të shkuarën, quhet falltar. Ajo që ka ndodhur në të shkuarën, nuk është e panjohur absolute, por relative. Për shembull, diçka që ka ndodhur brenda në xhami, quhet e panjohur për atë që, në atë çast, ka qenë jashtë, në rrugë, por jo edhe për atë që ka qenë brenda saj. Ndokush mund të lidhet me ndonjë xhind, i cili mund t’i tregojë gjëra që kanë ndodhur diku larg. Përdorimi në këtë mënyrë i xhindit nuk është fall, sepse fall quhet parashikimi se ç’do të ndodhë në të ardhmen.

Gjithashtu është thënë se fallxhor është ai që tregon për gjërat që ke në mendje. Në realitet ky është një lloj falli, nëse nuk mbështetet në intuitë. Nëse ai lajmëron për atë që ke në mendje duke u bazuar në intuitë, kjo nuk ka të bëjë aspak me fallin. Disa njerëz zbulojnë aspekte të ndryshme të një njeri tjetër, duke u bazuar, për shembull, në tiparet e fytyrës dhe shenjat e saj edhe pse nuk i di në mënyrë të hollësishme, por i di në mënyrë të përgjithshme.

Ai që tregon se ç’ka ndodhur më parë në Tokë nuk është fallxhor. Në këtë rast këqyret gjendja e personit: nëse nuk jemi të sigurt për fenë e tij, nuk i besojmë, sepse Allahu thotë: “O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i shthurur ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë) ...” (Huxhurat, 6). E nëse është i besueshëm në fe dhe nuk përzihet me shirk e me haramë, për të arritur qëllimet e veta, nuk e konsiderojmë fallxhor te i cili nuk lejohet të shkohet.

Kush flet për gjëra që kanë ndodhur në një vend, ku askush nuk i ka parë, nuk quhet fallxhor, sepse nuk ka folur për të ardhmen. Ai mund të ketë ndonjë xhind që i tregon, pa rënë në haram, sepse

xhindi mund t'i shërbejë njeriut pa kryer ndonjë haram. Ai mund ta bëjë këtë ose nga dashuria për Allahun, ose për shkak të ndonjë diturie që përfiton prej tij, ose për ndonjë qëllim tjetër të lejueshëm.

Edhe magjistarët mund të kenë xhindë që përgjojnë, për të kapur ndonjë fjalë. Këta “vjedhës” arrijnë deri në qiellin e dynjasë. Allahu i Lartësuar thotë: “Ne e bëmë qiellin mbulesë ruajtëse.” Pra, ata nuk mund të ngjiten më lart se kaq.

– “... *Shkëndija mund ta kapë ...*” – “*Shihabun*” quhet pjesa e shkëputur nga yjet, meteor, i cili e çan tejprtej atë që kap. Ajetin: “Ne jua kemi zbukuruar qiellin më të afërt me yje të shkëlqyeshme dhe i kemi bërë ato si predha për të larguar shejtanët” (Mulk, 5), dijetarët e komentojnë kështu: Ne kemi bërë që shkëndijat të cilat shkëputen nga yjet të gjuajnë shejtanët. Kjo tregon se ata janë pjesë të shkëputura nga yjet, dhe jo yje të plotë. Meteorët, siç thonë astronomët, bien në tokë, dhe mund të shkaktojnë çarje në të. Ndërsa po të arrinte në tokë një yll i plotë, do ta digjte krejt planetin.

Disa dijetarë mendojnë se “vjedhësit” e fjalëve u ndaluan përgjithmonë nga veprimi i tyre, pas zbritjes së Shpalljes hyjnore, e disa të tjerë mendojnë se ata u ndaluan vetëm në kohën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Mendimi i dytë është më i saktë. Ata u ndërprejnë vetëm në atë kohë, që fjalët e fallxhorëve të mos përziheshin me Shpalljen hyjnore. Kur Shpallja u realizua plotësisht, nuk ekzistonte më arsyeja e ndalesës.

– “... *i shtojnë asaj njëqind gënjeshtër ...*” – Numri “njëqind” është i përcaktuar aq, apo thjesht tregon se janë shumë gënjeshtër? Varianti i dytë është më e drejtë. Gënjeshtër e tyre mund të jenë më shumë ose më pak se njëqind.

Është e çuditshme se si njerëzit u besojnë pastaj plotësisht fjalëve të këtyre fallxhorëve, duke u nisur vetëm nga një e vërtetë e tyre. Gjithashtu këta fallxhorë mund të tregojnë diçka që ka ndodhur më parë, që njerëzit t'u besojnë më pas për “parashikimet” në të ardhmen.

Dobitë e hadithit:

- Pohimi se Allahu i Madhëruar flet.
- Madhështia e Allahut të Lartësuar.
- Pohimi se engjëjt kanë krahë.
- Frika e engjëjve nga Allahu i Lartësuar dhe nënshtrimi i tyre ndaj Tij.
- Engjëjt flasin dhe logjikojnë.
- Nga Allahu buron vetëm e vërteta.
- Allahu i Lartësuar ua mundëson xhindëve arritjen në qiell, si provë për njerëzit, duke u sjellë fallxhorëve lajme, me anë të të cilave arrihet prova. Allahu i Lartësuar është i Urti. Disa gjëra Ai i bën si dështim për disa njerëz, dhe udhëzim e provë për disa të tjerë.
- Numri i madh i xhindëve që u mundëson atyre ngjitjen njëri mbi tjetrin, deri në qiell. Kjo do të thotë, së pari, se ata janë të shumtë në numër dhe se trupat e tyre janë të lehtë, prandaj ngjiten me lehtësi. Shejhu i Islamit Ibn Tejmije, kur flet për magjistarët që kanë në shërbim xhindët, me anë të të cilëve fluturojnë, thotë se ata, në mëngjes të Ditës së Arafatit i gjen në atdheun e tyre, ndërsa në darkë i gjen me njerëzit e tjerë në Arafat. Sot kjo është e mundur me anë të avionëve, po në atë kohë avionët e tyre ishin shejtanët, të cilët bëheshin si fshesa, dhe magjistari thoshte: “Unë i hipi fshesës dhe fluturoj me të drejt e në Mekë.” Shejhu i Islamit thotë: “Këta janë gënjeshtarë, të cilët shfrytëzojnë shejtanët. Këta veprojnë keq edhe në aspektin e praktikës fetare, sepse kështu ata kalojnë në Mikat dhe nuk bëhen *muhrim-ë*.”
- Fallxhorët janë njerëzit më gënjeshtarë. Ata i shtojnë asaj që dëgjojnë një mal me gënjeshtër, e me anë të tyre humbin të tjerët. Ata shpesh u kallin datën njerëzve, duke u thënë: këtë ditë do të bëhet Kijameti, ti do të vdesësh, ose: ty do të të grabisin etj.
- Magjistarët ia shtrembërojnë realitetin personit që i kanë bërë magji. Ky është paralajmërim që të ruhemi nga mashtruesit. Edhe nëse ata thonë ndonjë të vërtetë, përsëri duhet të ruhemi prej tyre, sido që të jetë.

En Nuas Ibn Semani (r.a.) përcjell se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kur Allahu i Lartësuar

dëshiron të shpallë një çështje, Ai komunikon Shpalljen, ndërsa qiejt fillojnë të dridhen (mund të ketë thënë: 'të dridhen fort') nga frika prej Allahut të Lartësuar. Kur e dëgjojnë banorët e qiejve, alivanosen dhe i bien Allahut në sexhde. I pari që e ngre prej tyre kokën është Xhibrili. Allahu i kumton atij nga Shpallja çfarë dëshiron, pastaj Xhibrili e përcjell te engjëjt e tjerë. Sa herë që kalon një qiell, e pyesin melekët e atij qielli: 'Çfarë tha Zoti ynë, o Xhibril?' Ai përgjigjet: 'Tha të vërtetën. Ai është i Lartësuar dhe i Madhërishëm.' Të gjithë ata thonë ashtu siç thotë Xhibrili, dhe ai vazhdon me Shpalljen aty ku e ka urdhëruar Allahu i Lartëmadhëruar.¹

– “ *En Nuas Ibn Seman (r.a.) përcjell se ...* ” – Autori nuk ka përmendur se cili është përcjellësi i hadithit, bashkë me vargun e transmetimit, por Ibn Kethiri thotë se ai është Ibn Ebu Hatimi, madje ka vënë në dukje edhe një mangësi në vargun e transmetimit, e cila qëndron tek Uelid Ibn Muslimi. Ai është *mudelis*,² i cili ka përcjellë hadithin nga mësuesi i vet pa u përcaktuar qartë, kështu që në hadith ka dobësi. Por Muslimi dhe Ahmedi kanë përcjellë një hadith nga Ibn Abasi, që mund të jetë përforcues i të mësipërmit, duke lajmëruar se kur Allahu kumton Shpalljen, atë e dëgjojnë mbajtësit e Arshit, të cilët bëjnë *tesbih*. Më pas e dëgjojnë banorët e çdo qielli, të cilët gjithashtu bëjnë *tesbih* si banorët e qiellit të shtatë, derisa të arrijë në qiellin e dynjasë. Atëherë, në këtë moment, kumtesën e “rrëmben” xhindi ose shejtani. Ky hadith, edhe pse në të nuk përmendet dridhja e qiejve apo sexhdja e engjëjve, provon se hadithi i mëparshëm ka një bazë.

– “... *Kur Allahu i Lartësuar dëshiron të shpallë një çështje, Ai komunikon Shpalljen ...* ” – Pra, në fillim është dëshira, pastaj fjala. Kjo është kundërpërgjigje ndaj esharive, të cilët thonë se “Allahu

¹ Transmeton Ibn Ebi Asim në 'Es-Sune', Taberiu në 'Tefsirë', Ibn Ebi Hatim dhe ibn Huzejme në 'Teuhid'. Sipas Albanit hadithi është i dobët.

² *Mudelis* quhet ai transmetues hadithi i cili flet me termin "nga filani" që të duket sikur ai e ka dëgjuar drejtpërsëdrejti prej tij.

nuk flet me vullnet” dhe se “fjala e Tij është e pafillimtë, si dëgjimi dhe shikimi”. Ky hadith pohon që fjalët e Zotit kanë një nisje, një fillim. Nuk ulet përsosmëria e Allahut, kur themi se Ai flet kur të dojë dhe si të dojë, përkundrazi, kjo është cilësi e përkryer. Mangësi do të ishte nëse Ai nuk do të fliste me germa dhe zë, por t’i kishte fjalët thjesht nocione brenda Qenies së Tij.

– “... *ndërsa qiejt fillojnë të dridhen ...*” – Qiejt fillojnë e dridhen, sepse Allahu është Madhështor dhe Atij i frikësohet gjithçka, deri edhe qiejt, të cilët nuk kanë shpirt.

– “... *Kur e dëgjojnë banorët e qiejve, alivanosen dhe i bien Allahut në sexhde. ...*” – Nëse dikush pyet se si ka mundësi që të alivanosen dhe të bien në sexhde, themi se, së pari, atyre u bie të fikët, pastaj, pasi përmenden, bien në sexhde; e Allahu është më i Dituri.

– “... *I pari që e ngre prej tyre kokën është Xhibrili. Allahu i kumton atij nga Shpallja çfarë dëshiron ...*” – sepse Allahu flet me vullnet.

– “... *pastaj Xhibrili e përcjell te engjëjt e tjerë. ...*” – Kështu ai e zbret Shpalljen që nga Allahu, e deri atje ku Ai e ka urdhëruar ta shpjerë.

– “... *Sa herë që kalon një qiell, e pyesin melekët e atij qielli: ‘Çfarë tha Zoti ynë, o Xhibril?’ Ai përgjigjet: ‘Tha të vërtetën. Ai është i Lartësuar dhe i Madhërishëm.’...*” – Është komentuar më parë se “tha të vërtetën”, mund të ketë kuptimin: “tha të vërtetën në këtë çështje të caktuar”, ose vetëm: “tha të vërtetën”. Cilado qoftë, Xhibrili nuk u tregon melekëve se çfarë ka shpallur Allahu, por thotë vetëm: “tha të vërtetën”, pa e qartësuar atë. Për këtë, ai është quajtur “Besniku”, dhe besnik është ai i cili nuk e zbulon sekretin që i është besuar.

– “... *të gjithë ata thonë ashtu siç thotë Xhibrili ...*” – Pra thonë: “Tha të vërtetën. Ai është i Lartësuar dhe i Madhërishëm.”

– “... *dhe ai vazhdon me Shpalljen, aty ku e ka urdhëruar Allahu i*

Lartëmadhëruar.” – Domethënë e përcjell Shpalljen atje ku e ka urdhëruar Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala): te Profetët.

Dobitë e hadithit:

- Pohimi i dëshirës së Allahut, e dëshmuar nga fragmenti: “*kur dëshiron Allahu*”. Dëshira e Tij është dy llojesh: fetare dhe krijuese. Ndryshimi ndërmjet tyre qëndron, së pari, në aspektin e referimit të dëshirës. Kështu, dëshira fetare ka të bëjë me gjërat që i pëlqen Allahu i Lartësuar, ndodhin apo nuk ndodhin ato, ndërsa dëshira për krijim ka të bëjë me gjërat që do të ndodhin patjetër, i pëlqen Allahu apo jo. Dallimi i dytë qëndron në aspektin e arritjes së asaj që dëshirohet. Për sa i përket dëshirës fetare, realizimi i asaj nuk është kusht, ndërsa dëshira krijuese do të realizohet patjetër. Allahu i Lartësuar thotë: “Allahu do t’jua pranojë juve pendimin.” Kjo është dëshira fetare, sepse po të ishte dëshirë fetare, Ai do të pranonte pendimin e të gjithë njerëzve. Gjithashtu, kjo ka lidhje edhe me atë që pëlqen Allahu, që në rastin tonë është pendimi i njeriut. Nga ana tjetër, në ajetin: “Dëshira e Allahut është që t’ju lërë ju në rrugë të humbur” kjo është dëshirë krijuese, sepse nga njëra anë Allahu si Ligjvënës nuk e do humbjen, por nga ana tjetër, ajo krijohet, ndodh dhe ekziston me dëshirën, me vullnetin e Tij.

Allahu i Madhëruar thotë: “Allahu dëshiron që t’ju sqarojë çështjet, t’ju udhëzojë në rrugën e atyre që ishin para jush dhe t’ju pranojë pendimin tuaj...” (Nisa, 26). Kjo është dëshirë e krijimit, por në origjinë është fetare, sepse thotë: “...t’ju pranojë pendimet tuaja...”.

Në ajetin: “... Allahu dëshiron që t’jua lehtësojë dhe jo që t’jua vështirësojë ...” (Bekare, 185), flitet për dëshirë fetare, sepse shprehja: “... dhe jo që t’jua vështirësojë ...”, nuk mund të jetë krijuese, sepse vështirësia ndodh. Sikur Allahu të mos e dëshironte në aspektin e përcaktimit dhe krijimit, ajo nuk do të ekzistonte.

- Krijesat, edhe ato që janë pa shpirt, e ndiejnë madhështinë e Krijuesit. Allahu thotë: “Atë e madhërojnë shtatë qiejt, Toka dhe gjithçka gjendet në to. Nuk ka gjë që nuk e madhëron Atë, por ju (o njerëz) nuk e kuptoni madhërimin që bëjnë ata.” (Isra, 44).

- Pohimi se melekët flasin, kuptojnë e logjikojnë, sepse ata pyesin: “Çfarë tha Zoti ynë?” dhe përgjigjen: “Tha të vërtetën.” Ky

fakt kundërshton mendimin se melekët nuk i kanë këto cilësi, sipas të cilit ne e paskemi marrë fenë nga krijesa që nuk kanë logjikë! Kjo, padyshim, është një shpifje ndaj fesë.

- Pohimi i shumësisë së qiejve, siç thuhet në hadith: “Sa herë që kalon një qiell ...”

- Për çdo qiell ka melekë të posaçëm, siç thuhet në hadith: “E pyesin atë melekët e tij ...”

- Vlera e Xhibrilit, që është i njohur për besnikërinë në ruajtjen e Shpalljes. Për këtë tha Uereka Ibn Noufeli: “Ky është *Namusi*, që i vinte Musait.” *Namus*, në hebraisht, do të thotë “Ruajtësi i Sekretit”.

- Besnikëria e Xhibrilit, i cili e çon Shpalljen aty ku e urdhëron Allahu i Lartësuar. Kjo është kundërpërgjigje për *rafiditë*¹ mosbesimtarë, që thonë se Xhibrili u urdhërua t’ia çonte Shpalljen Aliut (r.a.), por ai ia çoi Muhamedit. Ata thonë se Xhibril Besniku tradhtoi, duke e devijuar Shpalljen nga *Hajderahu*. *Hajderah* quhet Ali Ibn Ebu Talibi (r.a.), sepse në luftën e Hajberit ai vetë thoshte: “Unë jam ai që më ka quajtur nëna *Hajderah*.”² Me këto fjalë, ata bien në kundërshti me veten e tyre, sepse cilësimi “Besnik” e mohon cilësinë e tradhtisë.

- Pohimi i *El Ize* dhe *El Xhelal* për Allahun, në fjalën e Profetit: “*Azze ue Xhele*”. *El Ize* është ngadhënjimi, fuqia, dominim mbi çdo gjë. *El Aziz* ka tri kuptime:

a- I tillë që është e pamundur që dikush t’i bëjë ndonjë të keqe.

b- I tillë që ka fuqi që askush tjetër nuk mund ta ketë.

c- Ngadhënjimtari, i Papërballueshmi.

Ndërsa *Xhele* do të thotë: “madhështi absolute, e pakrahasueshme”.

| Dobitë e temës

| ➤ Komenti i ajetit.

¹ Rafiditë (janë një sekt për origjinën e emërtimit të tyre me këtë emër kemi folur në një futnotë tjetër)

² Transmeton Muslimi.

Qëllimi është për fjalën e Allahut: “... Kur t'u hiqet frika nga zemrat e tyre (melekëve)...”. Ky koment u dha më lart.

- Në ajet ka argument për kotësin e shirkut, veçanërisht atij që lidhet me njerëzit e mirë. Ky është ajeti për të cilin është thënë se ia ka prerë damarët shirkut që në embrion.

Edhe vetë engjëjt – e ç'forcë e madhësi kanë ata! – alivanosen dhe frikësohen nga madhështia e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). E çfarë mund të thuhet për idhujt, që adhurohen përveç Allahut e që janë shumë më të dobët? E si mund të lidhet zemra e njeriut me ta?! Ja përse i ka prerë ky ajet damarët e shirkut. Kur njeriu e njeh madhësitinë e Allahut të Lartësuar, prej të Cilit dridhen qiejt, ndërsa engjëjve u bie të fikët vetëm me të folurit e Tij, atëherë ai nuk mund të adhurojë bashkë me Allahun diçka tjetër, të krijuar e ndoshta të bërë me dorën e tij. Ndër arabët para Islamit, ka pasur nga ata që e bënë “zotin” e tyre prej hurmash, e kur ndonjërin e merrte uria, e hante atë! Gjithashtu, ka pasur prej tyre që, kur zbrisnin në një luginë, merrnin katër gurë, tre prej tyre i vendosnin poshtë tenxheres, për ta mbajtur atë, kurse të katërtin – atë “më të mirin” – e bënë idhullin e vet.

- Komenti i fragmentit: “Tha të vërtetën! Ai është i Lartësuar dhe i Madhërishëm”.

- Shkakun e pyetjes së tyre për këtë.

Pyetja është: “Çfarë tha Zoti ynë?”. Ndërsa shkakun është frika e madhe e tyre se mos Ai i ka thënë për ndëshkimin e tyre, çka nuk mund ta përballojnë dot.

- Xhibrili u përgjigjet atyre më pas me thënien e tij: tha kështu e ashtu.

Pra, është Xhibrili ai që u përgjigjet duke thënë: “Tha të vërtetën.”

- Dëshmia se i pari që ngre kokën është Xhibrili.

E marrë kjo nga hadithi i En Nuas Ibn Semani (r.a.), dhe kjo tregon vlerën e Xhibrilit.

- Xhibrili u përgjigjet të gjithë banorëve të qiejve, kur ata e pyesin.

Ky fakt argumenton madhësitinë e tij në raport me ta.

- Alivania i përfshin të gjithë banorët e qiejve.

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë në hadith: “Kur e dëgjojnë banorët e qiellit, alivanosen dhe bien në sexhde.”

- Dridhja e qiejve nga fjala e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala).

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: “... qiejt fillojnë të dridhen.”

- Xhibrili ishte ai që e dërgoi Shpalljen atje ku e urdhëroi Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala).

Kjo do të thotë se askujt tjetër, veç Xhibrilit, nuk i është ngarkuar dërgimi i Shpalljes, sepse ai është Besniku i Shpalljes.

- Dëshmia se shejtanët “vjedhin” fjalët.

Do të thotë se ata dëgjojnë vjedhurazi çfarë thuhet në qiell. Më pas, këta ua përcjellin fallxhorëve, të cilët ose i shtojnë, ose i pakësojnë.

- Mënyra e hipjes së xhindëve njëri mbi tjetrin.

Këtë mënyrë e përshkroi Sufjani, duke vendosur pëllëmbët njëra mbi tjetrën me gishtërinj të hapur.

- Goditja me yje zjarri.

Yjet i djegin ata xhind që dëgjojnë diçka vjedhurazi. Allahu i Lartësuar thotë: “Përveç ndonjërit që dëgjon vjedhurazi (ndonjë fjalë), po edhe atë e kap një yll shndritës që e djeg.” (Hixhr, 18).

- Ndonjëherë ylli e djeg shejtanin para se t’ia thotë në vesh mikut të tij njeri, por ndonjëherë shejtani arrin t’ia përcjellë, para se ta kapë ylli.

- Fallxhori thotë edhe ndonjë të vërtetë.

Kjo sepse ai përcjell atë që është dëgjuar në qiell, por duke i shtuar të tjera gjëra. E vërtetë është vetëm ajo që vjen prej qiellit. Lind pyetja: Çfarë dëgjojnë shejtanët, kur përgjigjja e Xhibrilit është vetëm: “Të vërtetën tha”? Banorët e qiellit nuk mësojnë për Shpalljen, pasi nga Allahu ajo shkon te Xhibrili, e pastaj te Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Ndërsa çështjet e *kader*-it, që Allahu flet me ta, nuk janë të posaçme për Xhibrilin. Ndoshta banorët e qiellit i dinë me hollësi këto çështje, nga të cilët pastaj i dëgjojnë xhindët, që ngjiten në qiell për të kapur ndonjë fjalë.

- Fallxhori shton, përveç fjalëve që dëgjon nga vjedhësit, edhe njëqind gënjeshtër.

Numri njëqind është përdorur me kuptim figurativ, dhe jo për të treguar numrin e saktë të gënjeshtërave.

- E vërteta që thotë fallxhori është vetëm ajo pak që është dëgjuar në qiell. Për shkak të kësaj besohen edhe ato shumë të tjera që ai thotë nga ana e tij dhe që janë të gjitha gënjeshtër.

- Pranimi i sajësive nga njerëzit. Ata lidhen pas një të vërtete dhe nuk i marrin parasysh njëqind gënjeshtat!

Kjo është e vërtetë, por jo për të gjithë njerëzit; vetëm për injorantët dhe mendjelehtët. Vetëm këta lidhen me fallxhorët. Mendjelehtët mashtrohen me një të mirë që është e zhytur në të këqija, por nuk mund të mashtrohen të mençurit dhe besimtarët. Prandaj, kur zbriti ajeti (Subhanehu ue Te‘Ala): “Të pyesin ty (o Muhamed) për verën¹ dhe kumarin. Thuaju: ‘Ato sjellin dëme të mëdha, por edhe dobi për njerëzit. Megjithatë, dëmi i tyre është më i madh se dobia” (Bekare, 129). Shumë sahabë hoqën dorë menjëherë nga këto dy gjëra, duke këqyrrur raportin midis së mirës dhe së keqes. Nëse një njeri i mençur bën një krahasim, nuk ka mundësi që ai të anojë nga ajo çka është e keqe. I mençuri, edhe nëse nuk di ndonjë argument fetar për përcaktimin e të mirës ose të keqes, arrin t’i njohë dhe t’i dallojë ato duke peshuar dëmin dhe dobinë.

- Fallxhorët e marrin këtë fjalë (të vërtetë) nga njëri-tjetri, e ruajnë atë dhe argumentohen me të.

Shprehja “këtë fjalë” do të thotë fjalën e vërtetë, sepse duke shfrytëzuar atë ata përhapin gënjeshtat e tyre. Në të kundërt, po të ishin gënjeshtër gjithçka që ata thonë, atëherë ato nuk do të përhapeshin ndër njerëz.

- Pohimi i cilësive të Allahut, ndryshe nga *esharitetë* mohues.

Esharitetë pretendojnë se pasojnë Ebu el Hasan el Eshariun. Ata janë quajtur mohues, sepse u mohojnë argumenteve fetare kuptimin e tyre të vërtetë dhe, gjithashtu, mohojnë përshkrimin që Allahu i ka bërë Vetes së Tij. Ç’është e vërteta, ata mohojnë shumicën e cilësive të Zotit, e jo të gjitha ato. Ndryshe veprojnë *mutezilët*, që mohojnë cilësitë e Allahut dhe besojnë në emrat e Tij,

¹ Vera nënkupton të gjitha pijet dhe lëndët dehëse.

në përgjithësi. Ndërsa ekstremistët e këtij drejtimi i mohojnë edhe emrat e Allahut.

Esharitetë janë mohues, pasi mohojnë shumicën e cilësive dhe pohojnë vetëm shtatë të tilla, ndërkohë që cilësitë e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) janë aq shumë sa nuk numërohen. Edhe shtatë cilësitë që pohojnë, ata nuk i pohojnë ashtu si të parët e mirë të umetit. *Ehli Suneti*, për shembull, beson se Allahu flet kur Ai dëshiron, me tinguj dhe germa, ndërsa esharitetë thonë se fjala është pjesë e pandashme e Qenies së Tij, ashtu si jeta dhe dija. Ai nuk flet kur dëshiron, ndërsa ajo që dëgjohet është fjalë e barasvlefshme me atë të Allahut, por nuk është fjalë e Tij; ajo është fjalë e krijuar. Në fakt, sipas kësaj që thonë, ata nuk e pohojnë të folurin si cilësi të Allahut. Për këtë arsye, disa prej tyre kanë thënë: “Nuk ka ndryshim mes nesh dhe *mutezilëve* në lidhje me çështjen e të folurit të Allahut, sepse ne bashkohemi me ta në faktin se çfarë ndodhet ndërmjet dy kapakëve të librit të Kuranit është e krijuar.” Ata i pranojnë këto shtatë cilësi, sepse, sipas tyre, ato i pranon edhe logjika, ndërsa të tjerat nuk i pranojnë, pasi nuk iu duken të logjikshme.

Kundërpërgjigjja ndaj tyre, është si vijon:

Së pari, fakti që logjika argumenton për shtatë cilësitë, nuk tregon për mospraninë e cilësive të tjera, sepse mungesa e një argumenti, nuk do të thotë që të mohohen edhe argumentet e tjera. Supozojmë se cilësitë e tjera nuk janë të kapshme për logjikën e njeriut, por nga ana tjetër, ato cilësi i mbrojnë argumentet e qarta fetare. Atëherë, këto cilësi pranohen si të dëshmuara nga argumentet fetare.

Së dyti, cilësitë e tjera që janë të kapshme për logjikën, nëse nisemi nga shtatë cilësitë që pohojnë ata. Ata, për shembull, e pranojnë që Allahu ka dëshirë, duke u argumentuar se Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) e ka bërë diellin diell, hënë hënë, qiellin qiell dhe tokën tokë. Fakti që Ai i ka bërë të ndryshme, do të thotë se Ai dëshiron, se po të mos ishte dëshira e Tij, i gjithë universi do të ishte njëloj. Kësisoj, ata e pohojnë këtë atribut sepse atë e pranon edhe logjika. Por ne u themi atyre: se për sa i përket atributit të mëshirës, dihet që në çdo moment që kalon, krijesat gëzojnë mirësinë e Allahut. Atëherë, të gjitha këto mirësi të mëdha,

dëshmojnë më fort për mëshirën e Tij ndaj krijesave, sesa faktet që provojnë dëshirën e Tij. Hakmarrja e Tij ndaj mëkatarëve, tregon për urrejtjen e Tij ndaj tyre. Po kështu, shpërblimi i të bindurve dhe ngritja e gradës së tyre në dynja dhe ahiret, tregon për dashurinë e Tij ndaj tyre, më shumë sesa faktet që tregojnë për dëshirën e Tij. Po kështu shihen edhe cilësitë e tjera.

Autori (Allahu e mëshiroftë!), duke qenë se *esharitë* pohojnë vetëm shtatë cilësi të Zotit, të cilat edhe ato i pohojnë në kundërshtim me *Ehlu Sunetin*, i ka quajtur ata *mohues*, në mënyrë absolute, edhe pse, në fakt, ata nuk janë të tillë.

- Dëshmia se dridhjet dhe alivania, janë për shkak të frikës nga Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala).

Kjo tregon për madhështinë e Krijuesit, duke qenë se frika e melekëve prej Tij arrin deri në këtë gradë.

- Ata i bien në sexhde Allahut.

Kjo si madhërim për Të (Subhanehu ue Te‘Ala) dhe për t’u mbrojtur nga ajo që i frikësohen. Edhe ky përfundim tregon madhështinë e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala).

Tema 17

| Ndërmjetësimi te Zoti.

Autori ka trajtuar çështjen e ndërmjetësimit te Zoti në librin e Teuhidit, sepse politeistët që adhuronin idhujt e tyre, thoshin se idhujt ishin ndërmjetësuesit e tyre tek Allahu. Duke lutur ata dhe duke u kërkuar shpëtim atyre, ata bënë shirk. Ata mendonin se me të tilla vepra, ata bëheshin madhërues të Allahut, por në të vërtetë ata ishin përçmues të Tij, sepse Ai është i Ditur për gjithçka. Ai ka pushtet dhe kontroll të plotë, absolut, dhe nuk ka nevojë për ndërmjetësuesit. Idhujtarët thoshin se i adhuronin ata, që të bëheshin ndërmjetësuesit e tyre tek Allahu, për t'i afruar tek Ai. Ata ishin të humbur në rrugën e tyre, sepse Zoti është i Dituri absolut, i Plotfuqishëm dhe me sundim të plotë, e kush është i tillë, nuk ka nevojë për ndërmjetësues.

Mbretërit e kësaj bote kanë nevojë për ndërmjetësues, ose për shkak të dijës së tyre të mangët, ose për shkak të pushtetit të tyre të mangët. Për këto arsye, futen ndërmjetësuesit, të cilët ndërmjetësojnë pa kërkuar leje. Ndërsa Allahu i Lartësuar ka dije, pushtet e sundim të plotë dhe nuk ka nevojë për asnjë ndërmjetësues. Nuk mund të ketë ndërmjetësim tek Ai, përveçse me lejen e Tij, për shkak të Madhështisë dhe Pushtetit të plotë që Ai ka. Edhe ky lloj ndërmjetësimi nuk do të thotë që është ndihmë për Allahun, se kjo është e pamundur, – siç do të sqarohet më pas në shpjegimin e shejhut të Islamit Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!), – por me anë të tij synohen dy gjëra: nderimi i ndërmjetësuesit dhe dobia për të ndërmjetësuarin.

Ndërmjetësimi bëhet për t'i dhënë një të mirë dikujt ose për t'i

larguar të keqen. Shembulli i ndërmjetësimit për afrimin e së mirës është ai i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) që do të ndërmjetësojë për futjen e besimtarëve në Xhenet. Ndërsa për shmangien e së keqes do të jetë gjithashtu ndërmjetësimi i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për ata që meritojnë Zjarrin, që ata të mos futen në Xhehenem.

Në këtë temë, autori (Allahu e mëshiroftë!) ka përmendur disa ajete:

Ajeti 1. “Paralajmëroji me të (Kuranin) ata që i frikësohen daljes para Zotit të tyre, se atëherë nuk do të kenë as mbrojtës, as ndihmës tjetër, përveç Tij ...”. (Enam, 51)

– “ *Paralajmëroji me të ...* ” – Fjala arabe “*el indhar*” do të thotë paralajmërim, që përmban në vetvete frikësim. Përemri “me të” nënkupton Kuranin, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala): “Dhe kështu pra, Ne të kemi shpallur ty (o Muhamed) një Kuran në gjuhën arabe, për të paralajmëruar popullin e Mekën dhe ata rreth tyre.” (Shura, 7) dhe: “... që nëpërmjet tij të paralajmërosh (jobesimtarët), si edhe të përkujtosh besimtarët” (Araf, 2).

– “... *ata që i frikësohen daljes para Zotit të tyre ...*” – Kjo do të thotë se ata kanë frikë nga ndëshkimi që mund të vijë gjatë kësaj daljeje. Kuptimi i “*daljes*”, është: grumbullimi Ditën e Gjykimit, derisa të përfundojnë tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala).

– “... *se atëherë nuk do të kenë as mbrojtës, as ndihmës tjetër, përveç Tij ...*” – Pra, nuk do të ketë mbrojtës që t’i ndihmojë ata dhe as ndërmjetësues për ta. Në këtë ajet mohohet ndërmjetësimi pa lejen e Allahut. Kuptohet që është pohuar ndërmjetësimi me lejen e Tij, dhe ky është qëllimi ynë. Ndërmjetësimi pa lejen e Tij është i pamundur, kurse me lejen e Tij është i mundshëm dhe i lejuar. Nga ana tjetër, te mbretërit e kësaj bote ndërmjetësimi është i mundshëm dhe pa lejen e tyre; i afërmi i mbretit bën ndërmjetësim edhe pa i marrë leje atij.

– “... *përveç Tij ...*” – Nga ky përjashtim mësohet se ata do të kenë

ndihmues dhe ndërmjetësues, me lejen e Tij (Subhanehu ue Te'Ala), siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) në një ajet tjetër: “Miqtë dhe mbrojtësit tuaj janë vetëm Allahu, Pejgamberi i Tij ...” (Maide, 55).

Ajeti 2. “Thuaju: ‘Allahu i zotëron të gjitha ndërmjetësimet.’” (Zumer, 44).

– “... Allahu i zotëron të gjitha ndërmjetësimet” – Kjo do të thotë se ndërmjetësimet janë të tëra nën kontrollin e Allahut të Vetëm, dhe nuk ka asnjë ndërmjetësim pa lejen e Allahut dhe pa dëshirën e Tij. Nga fjala “të gjitha” nënkuptohet se ndërmjetësimet janë disa llojesh. Dijetarët e kanë ndarë në dy kategori kryesore:

I. Ndërmjetësimi i posaçëm i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem), ku përfshihet:

1. *Ndërmjetësimi i madh.* Ky është pjesë e *Mekamil Mahmud*,¹ të premtuar nga Allahu. Ditën e Kijametit, njerëzit do t’i kapë brenga e dëshpërimi nga qëndrimi dhe pritja e gjatë, aq sa nuk do të mund ta përballojnë. Ata do t’i thonë njëri tjetrit të kërkojnë dikë që të ndërmjetësojë tek Allahu. Do të shkojnë tek Ademi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), Babait të njerëzisë, dhe do t’i përmendin atij disa cilësi, me të cilat Allahu e ka dalluar atë, si faktin që Allahu e krijoi me Dorën e Vet, që Allahu i urdhëroi engjëjt t’i bëjnë sexhde atij e që ia mësoi atij emrat e çdo gjëje. Pas këtyre, do t’i thonë: “Ndërmjetëso për ne te Zoti yt! A nuk e sheh se në çfarë gjendje jemi?” Ai do të justifikohet duke thënë se ai e ka kundërshtuar Allahun në ngrënien e pemës. Dihet se kur ke bërë diçka që të ul dinjitetin përballë atij që do të pranojë ndërmjetësimin, nuk mund të ndërmjetësosh nga turpi. Vërtet Allahu ia pranoi Ademit pendimin, e zgjodhi atë dhe e udhëzoi: “... kështu që devijoi (nga rruga e drejtë). Pastaj Zoti i tij e zgjodhi atë, ia pranoi pendimin, e udhëzoi.” (Ta Ha, 121-122), por Ademi nuk do të pranojë për shkak të turpit të madh prej Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

Pastaj njerëzit do të shkojnë te Nuhu (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe do t’i përmendin disa nga cilësitë e tij të

¹ Më poshtë do të sqarohet se ç’është *Mekamil Mahmud*.

posaçme, duke i thënë se ai ishte i pari i të Dërguarve të Allahut në tokë, por edhe ai nuk do të pranojë, me arsyen se ai i ka kërkuar Allahut diçka për të cilën nuk kishte dije, kur i tha: “Zoti im, vërtet biri im është nga familja ime, dhe nuk ka dyshim se premtimi Yt është i vërtetë dhe se Ti je më i Drejti i gjykuesve.”

Pastaj do të shkojnë tek Ibrahim (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), të cilit gjithashtu do t’i përmendin disa nga cilësitë e tij të posaçme, por ai do të refuzojë me arsyen se ka “gënjyer” tri herë, edhe pse sipas qëllimit të tij kishte thënë të vërtetën.

Më pas do të shkojnë te Musai dhe do të veprojnë në të njëjtën mënyrë, por ai do të arsyetohet me vrasjen njeriut, për të cilën nuk ishte urdhëruar. Ky njeri i përkiste popullit të Faraonit. Kur dikush nga Beni Israilët i kërkoi Musait ndihmë kundër atij, Musai i ra me grusht dhe ai vdiq.

Në fund do të shkojnë tek Isai, do t’i përmendin atij disa nga cilësitë e tij, që bëjnë të pranueshme ndërmjetësimin, por ai gjithashtu nuk do të pranojë dhe nuk do të paraqesë ndonjë arsyetim. Isai do t’i përcjellë tek ai që ka pozitë më të lartë, duke u thënë: “Shkoni te Muhamedi, robit që i janë falur gjynahet e kaluara dhe të ardhmet!” Kështu ai do t’i drejtojë për te Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), pa u treguar arsyen që e pengon të ndërmjetësojë.¹ Atëherë ata do të shkojnë te Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), dhe ai do të ndërmjetësojë tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) për të qetësuar njerëzit e grumbulluar.

2. *Ndërmjetësimi i Pejgamberit për banorët e Xhenetit që ata të hyjnë në të.* Kur banorët e caktuar për në Xhenet të kalojnë urën e Siratit, do të arrijnë në dyert e Xhenetit, por do t’i gjejnë ato të mbyllura. Ata do të kërkojnë dikë, që të ndërmjetësojë tek Allahu për hapjen e tyre, e këtë do ta bëjë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), dëshmuar nga ajeti: “... Kur t’i afrohen atij, dyert e tij do të hapen ...” (Zumer, 73), që nënkupton – megjithëse nuk është thënë tekstualisht – se dyert do të hapen pas ndërmjetësimit.

3. *Ndërmjetësimi i Pejgamberit për xhaxhain e tij, Ebu Talibin, që t’i lehtësohet dënimi.* Këtë ndërmjetësim nuk e përfshin fjala e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “... kurrfarë ndërmjetësimi i cilitdo ndërmjetësuesi nuk do t’i ndihmojë ata”. (Mudethir, 48) dhe: “Atë

¹ Transmeton Buhariu.

Ditë nuk do të bëjë dobi ndërmjetësimi i askujt, përveç ndërmjetësimit të atij, që i jep leje i Gjithëmëshirëshmi dhe fjala e të cilit është pranuar prej Tij.” (Ta Ha, 109). Kjo do të ndodhë ngaqë Ebu Talibi e kishte ndihmuar dhe e kishte mbrojtur Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Ai nuk do të dalë nga Zjarri, por do t’i lehtësohet ndëshkimi, derisa – Allahu na ruajtë – të jetë në një cektësi të Zjarrit, do të ketë mbathur këpucë prej zjarri, nga të cilat do t’i vlojnë trutë. Ky ndërmjetësim është i posaçëm për Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Askush tjetër nuk mund të bëjë ndërmjetësim për ndonjë jobesimtar, përveç Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), të cilit, gjithsesi, nuk iu pranua ky ndërmjetësim plotësisht, por vetëm pjesërisht.

II. Ndërmjetësimi i përgjithshëm, që do të bëjë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe të gjithë besimtarët, tek i cili hyjnë:

1. *Ndërmjetësimi për ata që e meritojnë Xhehenemin, që të mos hyjnë në të.* Argument ndoshta për këtë është hadithi i të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Kur vdes një musliman, nëse ia falin xhenazen dyzet burra, të cilët nuk i shoqërojnë Allahut asgjë, Allahu ka për t’i bërë ata ndërmjetësues për të.”¹ Ky ndërmjetësim do të bëhet para se njeriu të futet në Zjarr.

2. *Ndërmjetësimi për ata që janë futur në Xhehenem, që të dalin prej tij.* Këtë e dëshmojnë hadithe, me rrugë të shumta transmetimesh, si edhe është mbështetur nga të gjithë sahabët dhe muslimanët, përveç dy grupeve: *mutezilëve* dhe *havarixhëve* të cilët e mohojnë kategorikisht ndërmjetësimin për gjynahvepruesit. Ata thonë se kush bën gjynahe të mëdha, do të jetë në Zjarr përgjithmonë, dhe se atij që meriton përhershmerinë në Zjarr, nuk i bën dobi ndërmjetësimi. Ata mohojnë se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), apo të tjerë, do të bëjnë ndërmjetësim që gjynahmëdhenjtë të dalin nga Zjarri. Qëndrimi i tyre është i pasaktë, i kundërshtuar nga argumente fetare dhe nga dijetarët.

3. *Ndërmjetësimi për ngritjen e gradave të besimtarëve.* Kjo faktohet nga lutja që besimtarët mund të bëjnë për njëri-tjetrin, siç bëri Profeti për Ebu Selemen: “O Allah, fale Ebu Selemen, ngrija gradën me të udhëzuarit, zgjeroja dhe ndriçoja varrin dhe bëj të

¹ Transmeton Muslimi.

vazhdojnë pasardhësit e tij!”¹ Lutja është ndërmjetësim, siç thotë hadithi: “Kur vdes një musliman, nëse ia falin xhenazen dyzet burra, të cilët nuk i shoqërojnë Allahut asgjë, Allahu ka për t’i bërë ata ndërmjetësues për të.”

Nëse ndërmjetësimi bëhet vetëm me lejen e Allahut, atëherë si mund të quhet “ndërmjetësim” lutja që bën besimtari për vëllain e vet, kur ai nuk merr leje nga Zoti për këtë?

Allahu i ka urdhëruar besimtarët që të lutën për të vdekurit, prandaj themi se ky urdhër është më i fortë sesa leja. Nga ana tjetër, ndërmjetësimi i idhujve, i mëtuar nga adhuruesit e tyre, është i papranueshëm, sepse Allahu nuk i jep leje askujt për këtë, përveç atyre me të cilët Ai është i kënaqur dhe për të cilët ndërmjetësimi është i lejuar.

▲ Ajeti 3. “E kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndonjë, përveçse me lejen e Tij?” (Bekare, 255).

– “*E kush mund të ndërhyjë ...*” – Pra, askush nuk mund të ndërhyjë tek Allahu ndryshe, përveçse me lejen e Tij. Më përpara kemi thënë se të tilla pyetje janë me kuptim sfidues, pra: nëse ka ndonjë që ndërmjetëson pa lejen e Allahut, sille atë!

– “*... tek Ai ...*” – Parafjala “tek” në këtë rast, tregon referim, ndërsa “Ai” (Subhanehu ue Te‘Ala) është në lartësi. Atëherë, askush nuk ndërmjetëson tek Ai, qoftë edhe i afërt, siç janë engjëjt, vetëm se me lejen e Tij të paracaktuar. Leja e Tij mund të vijë vetëm pasi Ai të jetë i kënaqur.

Nga ajeti mësohet se për ndërmjetësimin është kusht leja e Allahut të Madhëruar, për shkak të sundimit të Tij të plotë. Sa më i fortë të jetë autoriteti i një mbreti, aq më pak ndërhyjnë e i flasin atij, qoftë edhe për mirë, pa i dhënë leje ai. Për këtë, zhurma në kuvendin e ndonjë njeriu të madh, konsiderohet si nënçmim dhe si argument se ai nuk ka autoritet për ata që janë mbledhur aty. Kur sahabët rrinin me Profetin, dukej sikur mbi kokat e tyre qëndronin

¹ Transmeton Muslimi.

zogj, aq qetësi ishte, dhe kjo vinte nga respekti që ata tregonin; ata flisnin veçse kur hapej mundësia për diskutim.

Ajeti 4. “Sa engjëj ka në qiej, ndërmjetësimi i të cilëve nuk bën asnjë dobi, veçse pasi të japë leje Allahu, për kë të dojë e të pëlqejë Ai vetë.” (Nexhm, 26)

– “*Sa engjëj ka në qiej ...*” – Pra, sa të shumtë janë melekët në qiell, e megjithatë, ndërmjetësimi i tyre nuk vlen asgjë, veçse pas lejes së Allahut dhe pëlqimit të Tij: “... veçse pasi të japë leje Allahu, për kë të dojë e pëlqejë Ai vetë.”

Ndërmjetësimi ka dy kushte:

1- Lejen nga Allahu: “... vetëm pasi Allahu të ketë dhënë lejen ...”

2- Pëlqimin e Allahut për ndërmjetësuesit dhe të ndërmjetësuarit, sipas fjalës së Tij (Subhanehu ue Te‘Ala): “... e të pëlqejë ...” dhe ajetit tjetër: “... ndërsa ata ndërmjetësojnë vetëm për atë me të cilën Ai është i kënaqur ...” (Enbija, 28). Për ndërmjetësuesin dhe të ndërmjetësuarin duhet patjetër leja e Allahut të Lartësuar dhe kënaqësia e Tij, me përjashtim të lehtësimit të ndëshkimit për Ebu Talibin, siç u përmend më parë. Ky ajet ka ardhur për të sqaruar pavlefshmërinë e adhurimit të *Latit* dhe *Uzas*.

Allahu, (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) pas përshkrimit të ndodhisë së Profetit gjatë Miraxhit, thotë: “Vërtet ai (Muhamedi) pa disa nga shenjat më madhështore të Zotit të tij!” (Nexhm, 18), që do të thotë se Profeti pa shenja që tregojnë për Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala). E ç’mund të thuhet, atëherë, për Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala)? Ai (Subhanehu ue Te‘Ala) është më i Madhi dhe më Madhështori. Pastaj thotë: “A e keni parë Latin dhe Uzan? Po Menatën, të tretën, të fundit?” Kjo është formë pyetëse për poshtërim. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), pasi përmend madhësitinë e Vet, thotë: më tregoni, çfarë madhështie kanë ata idhuj. Ky është kulmi i poshtërimit për ta.

Pastaj Allahu thotë: “Vallë, për ju janë djemtë, ndërsa, për Atë (Allahun) vajzat?! Atëherë kjo ndarje është e padrejtë. Ata janë vetëm emra, që ua keni ngjitur (idhujve) ju dhe të parët tuaj, kurse Allahu nuk ju ka dërguar për ata ndonjë provë. Ata ndjekin vetëm hamendjet dhe atë që ua ka qejfi, ndonëse u ka ardhur prej Zotit të

tyre udhëzim (për rrugën e drejtë). A do të ketë njeriu gjithçka që dëshiron? Vetëm Allahut i përkasin bota e tjetër dhe kjo botë! Sa melaike ka në qiej ...” (Nexhm, 21-26). Nëse ndërmjetësimi i melekëve që janë në qiell në lartësi, vlen vetëm pas lejes së Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) dhe kënaqësisë së Tij (Subhanehu ue Te‘Ala), ç’mund të thuhet për Latin dhe Uzan, që ishin në tokë?! Prandaj Allahu vazhdon: “Sa melaike ka në qiej ...”, megjithëse melaike ka edhe në qiej, edhe në tokë, por këtu flitet për melaiket e qiellit, që ndodhen tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), qoftë edhe ata më të afërmit, domethënë mbajtësit e Fronit. Ndërmjetësimi i tyre vlen vetëm pasi Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) t’u japë leje për atë që dëshiron dhe me të cilin është i kënaqur.

Ajeti 5. “Thuaju (O Muhamed): ‘Thirrini ata të cilët ju i hyjnizoni krahas Allahut. Ata nuk kanë në sundim as sa pesha e një grimce, qoftë në qiej apo në tokë; për ata nuk ka pjesë as në qiej, as në Tokë dhe Allahu nuk ka asnjë ndihmës nga radhët e tyre.’ ...” dhe në vazhdim. (Sebe, 22-23)

– “*Thuaju: ‘Thirrini ...’*” – Urdhri këtu është një sfidë, për të treguar paaftësinë e tyre. “Thirrini”, përmban dy kuptime: 1. sillini ata këtu; 2. lutini ata. Sikur t’u luteshin idhujve të tyre, ata nuk do t’u përgjigjeshin, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala): “Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur ta dëgjonin, nuk mund t’ju përgjigjen juve, ndërsa Ditën e Kijametit, ata do të mohojnë adhurimin tuaj ndaj tyre. Askush nuk mund të të njoftojë ty (o Muhamed) ashtu si Ai, që është i Gjithëdijshtëm.” (Fatir, 14). Me togun “... do të mohojnë ...”, kuptohet “do të largohen”.

Me gjithë këto ajete madhështore, përsëri disa njerëz shkojnë e i bëjnë shok Allahut të Lartësuar, duke kërkuar shpëtim prej dikujt tjetër. Edhe nëse do t’i thërrisnin ata që lusin të paraqiteshin, nuk do të vinin, por edhe sikur të vinin, ardhja e tyre nuk do t’i ndihmonte aspak.

– “... ata nuk kanë në sundim as sa pesha e një grimce ...” –

Shembulli i sjellë shërben për të treguar vogëlsinë e diçkaje. Ata nuk kanë në sundim as më pak sesa një grimcë. Krahasimi me grimcën është figurativ, që do të thotë se ai përcjell idenë dhe jo krahasimin në vetvete. I tillë është edhe ajeti: “... edhe sikur ti të kërkosh falje për ta shtatëdhjetë herë, sërish Allahu nuk do t’i falë ...”, (Teube, 80), që do të thotë: sado të kërkosh falje për ta.

Të mos na lindë ndonjë paqartësi kur shohim se Allahu, diku tjetër, e ka pohuar që njeriu sundon diçka, sepse sundimi i njeriut është i mangët dhe jo absolut. Ai përtërihet dhe zhduket, dhe nuk është si sundimi i Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala).

– “... për ata nuk ka pjesë as në qiej, as në Tokë ...” – Nuk kanë pjesë në qiell dhe as në tokë, as më vete, as së bashku.

– “... Allahu nuk ka asnjë ndihmës nga radhët e tyre ...” – Këtyre idhujve u mohohet çdo gjë me të cilën lidhen adhuruesit e tyre. Ata nuk sundojnë asgjë, qoftë vetëm, qoftë me bashkëpunim, qoftë edhe si ndihmës. Dikush që të ndihmon, edhe nëse nuk është pjesëtar me ty në diçka, ka merita për ty, e kështu ndoshta e favorizon, duke i dhënë atë që ai dëshiron. Përfundimisht, të trija mundësitë mohohen, dhe mbetet vetëm ndërmjetësimi, të cilin gjithashtu Allahu e ka mohuar me fjalën e Tij: “Asnjë ndërmjetësim tek Ai nuk bën dobi, përveçse për atë që Ai i jep leje.” (Sebe, 23). Ndërmjetësimi i tyre te Allahu nuk vlen, sepse ata janë idhuj e Allahu nuk u jep leje atyre. Kështu, për idhujtarët janë shuar të gjitha shanset. Këto janë ajete madhështore, që tregojnë për kotësinë e adhurimit të idhujve, sepse ata nuk u bëjnë dobi adhuruesve të tyre, qoftë të vetëm, qoftë në bashkëpunim, në ndihmë apo në ndërmjetësim: “Kush është në rrugë më të gabuar sesa ai, i cili, në vend të Allahut, u lutet atyre që nuk mund t’i përgjigjen atij deri në Ditën e Kiametit (Ahkaf, 5). Të gjitha këto ajete argumentojnë se është detyrë për njeriun të ndërpresë çdo lidhje tjetër të tij, e të lidhet vetëm me Allahun në adhurim, frikë, shpresë, kërkimin e ndihmës, dashuri dhe madhërim, derisa të jetë rob i vërtetë i Allahut. Dëshira, dashuria, urrejtja, miqësimi dhe armiqësimi të jenë veç për hir të Allahut, sepse njeriu është krijuar vetëm për adhurim. Allahu i Lartësuar thotë: “Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot

dhe që nuk do të ktheheshit te Ne?” (Mu'mininun, 115). Kjo do të thotë: a mos mendoni që nuk duhet t’ju urdhërojmë apo t’ju ndalojmë, por që jeni bërë vetëm për të ngrënë, për të pirë e për t’u martuar? Po të ishte kështu, do të ishte krejtësisht e kotë, prandaj qëllimi i krijimit tuaj është diçka tjetër: adhurimi i Allahut të Lartësuar në këtë botë. “... dhe që nuk do të ktheheshit te Ne” domethënë: a menduat ju se nuk do silleshit te Ne, që t’ju shpërblenim për çfarë keni vepruar?! Nëse ky ka qenë mendimi juaj, atëherë ky është një mendim i kotë.

Ebu Abasi ka thënë: “Në ajetin e sipërpërmendur Allahu e ka mohuar gjithçka, veç Tij, me të cilën lidhen idhujtarët. Ai e mohon se dikush tjetër mund të ketë sundimin, që mund të jetë pjesëtar në të apo që mund të jetë ndihmës i Allahut. Kështu nuk mbetet tjetër, veçse ndërmjetësimi, por Ai sqaron se edhe ai nuk vlen ndryshe, por veçse për atë që e lejon Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala). Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “... ndërsa ata ndërmjetësojnë vetëm për atë me të cilën Ai është i kënaqur...” (Enbija, 28)

Ndërmjetësimi që mendojnë idhujtarët për Ditën e Kijametit është i mohuar nga Kurani dhe nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), që thotë se ai do t’i bjerë në sexhde Zotit të tij, pastaj do ta falënderojë Atë; pra nuk do ta fillojë menjëherë me ndërmjetësimin. Pastaj atij do t’i thuhet: ‘Ngrije kokën tënde. Fol, të dëgjohesh! Kërko, të të jepet! Kërko ndërmjetësim, të të pranohet!’¹

Ebu Hurejra e ka pyetur Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): ‘Kush do të jetë më i lumturi i njerëzve me ndërmjetësimin tënd?’ Ai është përgjigjur: ‘Ai që thotë *La*

¹ Transmeton Buhariu.

ilahe il'All-llah me sinqeritet nga zemra e tij.’¹ Ky ndërmjetësim do të jetë për të sinqertët, me lejen e Allahut, dhe jo për ata që i bëjnë shok Atij.

E vërteta është se vetëm Allahu i Lartësuar u jep mirësi të sinqertëve, i fal ata nëpërmjet pranimit të lutjes së atij që i jepet leja, për ta nderuar atë dhe për të arritur gradën *Mekamul Mahmud*. Ndërmjetësimi që ka mohuar Kurani, është ai që përmban shirk. Allahu e ka pohuar ndërmjetësimin me lejen e Tij, në disa vende. Ndërsa Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka sqaruar se ndërmjetësimi do të jetë vetëm për ata që kanë teuhid të pastër.” Këtu përfundon edhe fjala e shejhut të Islamit Ibn Tejmije.

– “*Ebu Abasi thotë ...*” – Është fjala për shejhun e Islamit Takijuddin Ahmed Ibn Abdul-Halim Ibn Abdus-Selam Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!). Ai është quajtur Ebu Abas, (Babai i Abasit), por ai nuk ka qenë martuar, për shkak se ka qenë i angazhuar me kërkimin e dijes dhe xhihadin, e jo se nuk është martuar për asketizëm. Ai ka vdekur në vitin 728 Hixhri kur ishte 67 vjeç e 10 muaj.

– “*... Ai e mohon se dikush tjetër mund të ketë sundimin ...*” – Siç thuhet në ajet: “... ata nuk kanë në sundim as sa pesha e një grimce, qoftë në qiej apo në tokë.”

– “*... që mund të jetë pjesëtar në të ...*” – Siç thuhet në ajet: “... për ata nuk ka pjesë as në qiej, as në Tokë ...”

– “*... apo që mund të jetë ndihmës i Allahut ...*” – Siç thuhet në ajet: “Allahu nuk ka asnjë ndihmës nga radhët e tyre ...”, pa përjashtim.

¹ Transmeton Buhariu.

– “... *Kështu nuk mbetet tjetër, veçse ndërmjetësimi ...*” – Është sqaruar se ndërmjetësimi është i vlefshëm vetëm për atë që Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) jep leje, siç thotë Allahu: “... ndërsa ata ndërmjetësojnë vetëm për atë me të cilën Ai është i kënaqur” dhe: “E kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndonjë, pa lejen e Tij?” Dihet se Ai nuk është i kënaqur me idhujt, sepse ata janë të kotë, kësisoj, ndërmjetësimi i tyre është i mohuar.

Politeizmi i idhujtarëve, në të kaluarën, ka qenë në adhurimin e idhujve, ndërsa tani bëhet me bindjen e krijesave në mëkate. Këta të sotmit i shenjtërojnë udhëheqësit e tyre më shumë sesa Allahun. Nëse e pohojnë këtë, atëherë u thuhet se ata nuk sundojnë asgjë në mënyrë absolute, se janë njerëz si puna juaj dhe kanë dalë andej nga del urina dhe gjaku i lehonisë, nuk kanë pjesë në qiell e as nuk e kanë në dorë ndërmjetësimin tek Allahu për ju. Atëherë, si lidheni pas tyre, aq sa, ndonjëherë, shkoni e u bëni *rukú* e *sexhde*, ashtu siç i bëhet Zotit?! Detyrë për ne, në lidhje me udhëheqësit tanë është që t’u bindemi atyre, dhe kjo është pjesë e bindjes ndaj Allahut, kurse adhurimi i tyre është injorancë dhe mohim.

– “... *Ndërmjetësimi që mendojnë idhujtarët për Ditën e Kijametit është i mohuar nga Kurani ...*” – Allahu ka mohuar që idhujt t’u bëjnë dobi adhuruesve të tyre, madje ka thënë: “Me të vërtetë, ju (idhujtarë) dhe idhujt që i adhuroni në vend të Allahut, do të jenë lëndë djegëse për Xhehenemin. Ju do të vini në të. Sikur këta të ishin zota (të vërtetë) nuk do të vinin atje dhe të gjithë do të mbeteni përherë aty.” (Enbija, 98). Derisa idhujt nuk i bëjnë dobi vetvetes e nuk mund të ndërmjetësojnë për të, e si mund të jenë ndërmjetësues për të tjerët? Madje vetë ata dhe adhuruesit e tyre do të jenë në Zjarr.

– “... *dhe nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), që thotë se ai do t’i bjerë në sexhde Zotit të tij, pastaj do ta falënderojë Atë ...*” – Kur Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), i cili është njeriu me pozitën më të lartë tek Allahu, do të ndërmjetësojë veçse pasi të falënderojë Allahun, ashtu siç do ta frymëzojë Ai, duke e zgjatur qëndrimin në sexhde, e çfarë mund të thuhet për idhujt? A mund të ndërmjetësojnë ata për adhuruesit e tyre?!

– “... *Pastaj atij do t'i thuhet: 'Ngrije kokën tënde. Fol, të dëgjohesh! Kërko, të të jepet! Kërko ndërmjetësim, të të pranohet!'*” – Atëherë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) do të ndërmjetësojë për krijesat, që të fillojë gjykimi i tyre.

– “... *Ebu Hurejra e ka pyetur Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): 'Kush do të jetë më i lumturi i njerëzve me ndërmjetësimin tënd?' ...*” – Kjo pyetje është bërë nga Ebu Hurejra. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i tha atij: “Vërtet kam menduar se askush tjetër veç teje nuk do të më pyeste për këtë, sepse e kisha parë përkushtimin tënd ndaj dijes.” Kjo dëshmon se një formë e arritjes së dijes është të pyeturit.

– “... *Ai që thotë La ilahe il'All-llah ...*” – Sipas kësaj, del se idhujtarët nuk kanë shans të përfitojnë nga ndërmjetësimi, sepse ata nuk thonë: *La ilahe il'All-llah*. Allahu i Lartësuar thotë: “Kur u thuhej atyre: 'Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut!', ata tregoheshin mendjemëdhenj dhe thoshin: 'Vallë a ti braktisim hyjnitë tona për shkak të një poeti të marrë?'” (Safat, 36). Po kështu, Allahu i citon ata: “A mos kërkon ai, që të gjithë zotat t'i bëjë një Zot të Vetëm? Vërtet që kjo është një gjë e çuditshme.” (Sad, 5). Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) gjithashtu thotë: “Ti çuditesh (pse ata s'të besojnë) ndërsa ata të përqeshin (pse çuditesh).” (Safat, 12) dhe: “Nëse ti (Muhamed) çuditesh nga idhujtarët, më të çuditshme janë fjalët e tyre: 'Vallë, pasi të bëhemi dhë, do të krijohe mi vërtet përsëri?!'...” (Rrad, 5).

– “... *me sinqeritet nga zemra e tij. ...*” – Nga kjo del se kush e thotë atë me hipokrizi nuk ka shanse për ndërmjetësim, sepse edhe munafikët thonë *La ilahe il'All-llah* dhe dëshmojnë që Muhamedi është Pejgamberi i Allahut, por Allahu i Lartësuar e përgënjeshton dëshminë e tyre: “Allahu e di se ti je i Dërguari i Tij dhe Allahu dëshmon se munafikët janë me të vërtetë gënjeshtarë.” (Munafikun, 1). Pra, ata gënjejnë kur thonë se Muhamedi është i Dërguari i Tij dhe kur deklarojnë “*La ilahe il'All-llah*”, sepse po të kishin

dëshmuar me vërtetësi, ata nuk do të kishin bërë hipokrizi dhe *kufër* të fshehur.

– “... *me sinqeritet* ...” – Pra, vetëm për hatër të Allahut dhe për asgjë tjetër; të mos përzihet me syfaqësi dhe shtirje, por të shprehet me plot bindje vetëm për Allahun.

– “... *nga zemra* ...” – Çdo çështje varet nga zemra. Zemra nuk është një nocion abstrakt, përkundrazi, është një organ në gjoksin e njeriut. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor.” Në fillim të ajetit Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë që zemrat e tyre të mendojnë dhe veshët të dëgjojnë?” (Haxh, 46). Ndërsa Profeti (sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Vërtet në trup është një organ; nëse ai rregullohet, rregullohet i gjithë trupi ...”.¹ Këto fakte e bëjnë të pavlefshëm qëndrimin se logjika është në tru. Nuk mohohet se truri ka ndikim në të kuptuar dhe logjikë, por logjika ndodhet në zemër. Për këtë arsye, imam Ahmedi ka thënë: “Logjika është në zemër, por ka lidhje me trurin.” Ai që e thotë fjalën e sinqeritetit, *La ilahe il’All-llah*, me sinqeritet nga zemra e tij, patjetër do ta kërkojë këtë të adhuruar, duke ndër marrë rrugët që e çojnë tek Ai, pra, duke zbatuar urdhrat e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) dhe duke u larguar prej ndalesave të Tij.

– “... *Ky ndërmjetësim do të jetë për të sinqertët* ...” – sepse për ata që i bëjnë shok Allahut, Ai thotë: “... kurrfarë ndërmjetësimi i cilitdo ndërmjetësuesi nuk do t’i ndihmojë ata”. (Mudethir, 48).

– “... *E vërteta është se vetëm Allahu i Lartësuar u jep mirësi të sinqertëve, i fal ata nëpërmjet pranimit të lutjes së atij që i jepet leja* ...” – Kjo do të thotë se dobia e ndërmjetësimit është se Allahu dëshiron që ta falë atë për të cilin bëhet ndërmjetësimi, por nëpërmjet kësaj mënyre. Gjithashtu urtësia e ndërmjetësimit është sqaruar më tej kur thuhet: “... për ta nderuar atë dhe për të arritur

¹ Transmeton Buhariu.

gradën *Mekamul Mahmud ...*”. Po të donte Allahu, do t’i falte ata pa ndërmjetësues, por Ai do që të duket qartë vlera e ndërmjetësuesit dhe që ai të nderohet para njerëzve. Dihet se ai që Allahu ia pranon ndërmjetësimin, ka një gradë të lartë tek Ai.

Ndërmjetësuesi nderohet në dy forma: 1. duke u pranuar ndërmjetësimi i tij; 2. duke shfaqur pozitën e tij tek Allahu i Lartësuar.

– “... *Mekamul Mahmud. ...*” – Kjo është një gradë, për të cilën ndërmjetësuesi meriton të lavdërohet. Personi që e meriton më shumë këtë gradë është Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) i premtoi të Dërguarit të Vet të arrijë *Mekamul Mahmud*-in. Grada *Mekamul Mahmud* do t’i japë mundësi që Allahu t’ia pranojë ndërmjetësimin, pasi të jenë tërhequr të gjithë Profetët e tjerë, bashkë me më të mirët e tyre. Të gjithë ata besimtarë që do të ndërmjetësojnë Ditën e Kijametit, do të kenë një gradë, për të cilën do ta meritojnë të lavdërohen, sipas vlerës së ndërmjetësimit të tyre.

– “... *Allahu e ka pohuar ndërmjetësimin me lejen e Tij në disa vende ...*” – Për shembull, në ajetet: “E kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndonjë, pa lejen e Tij?” (Bekare, 255). “Asnjë ndërmjetësim tek Ai nuk bën dobi, përveçse për atë që Ai i jep leje.” (Sebe, 23). “Sa engjëj ka në qiej, ndërmjetësimi i të cilëve nuk bën asnjë dobi, veçse pasi të japë leje Allahu, për kë të dojë e të pëlqejë Vetë ...” (Nexhm, 26).

– “... *Ndërsa Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka sqaruar se ndërmjetësimi do të jetë vetëm për ata që kanë teuhid të pastër.*” – Për politeistët nuk do të ketë ndërmjetësim, sepse ndërmjetësuesit e tyre janë idhujt, dhe ata janë të pavlerë.

Arsyeja e futjes së temës së ndërmjetësimit në librin e Teuhidit është se ndërmjetësimi që pretendojnë politeistët e mohon teuhidin, dhe distancimi nga ky politeizëm është vërtetim i teuhidit.

| Dobitë e temës

➤ Komenti i pesë ajeteve të mësipërme.

➤ Forma e ndërmjetësimit të ndaluar.

Ky është ndërmjetësim që përmban politeizëm, dhe çdo ndërmjetësim që përmban politeizëm refuzohet.

➤ Forma e ndërmjetësimit të lejuar.

Ai është ndërmjetësimi i zotëruesve të teuhidit, me kusht që ndërmjetësuesi dhe personi për të cilin kërkohet ndërmjetësimi të kenë lejen nga Allahut dhe kënaqësinë e Tij.

➤ Përmendja e Ndërmjetësimit të Madh. Ai i përket gradës *Mekamul Mahmud*.

Ky ndërmjetësim do të bëhet për të tubuarit në Ditën e Gjykimit që të fillojë gjykimi ndaj tyre.

➤ Paraqitja e mënyrës së sjelljes së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) Ditën e Gjykimit. Ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk do të fillojë me ndërmjetësimin, por së pari do të bjerë në sexhde dhe, pasi t’i jepet leja, do të ndërmjetësojë.

Siç ka thënë shejhu i Islamit Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!), kjo duket nga konteksti. Ky është tregues i madhështisë së Zotit dhe i edukatës së të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

➤ Cilët janë më fatlumët e ndërmjetësimit?

Ata janë njësuësit e Allahut dhe të sinqeritet, ata që thonë *La ilahe il’All-llah* me sinqeritet nga zemra e tyre.

Kuptimi i fjalës *La ilahe il’All-llah*, është: “Nuk ka të adhuruar

tjetër me të drejtë përveç Allahut”, dhe jo thjesht “nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut”, se po të ishte kështu, atëherë realiteti e përgënjeshtrohet këtë, sepse ka edhe të adhuruar të tjerë përveç Allahut, që adhurohen dhe emërtohen të adhuruar, por ata janë të pavërtetë. Atëherë përcaktohet se kuptimi është “Nuk ka të adhuruar me të drejtë veç Allahut.” Fjala *La ilahe il’All-llah*, përmban mohim dhe pohim. Ky është teuhidi, se po të kishte vetëm pohim, kjo nuk do ta përjashtonte diçka tjetër shoqëruese. Nga ana tjetër, po të ishte vetëm mohim, do të mohohej gjithçka. Nëse do të thuash *La ilahe* (“Nuk ka të adhuruar”), ke mohuar çdo të adhuruar, e nëse thua: Allahu është i adhuruar, nuk e ke njësuar Atë, sepse kjo formë nuk e pengon shoqërimin. Prandaj Allahu ka thënë: “I Adhuruar juaj është Një i Vetëm.” (Bekare, 163). Kështu, pasi ka bërë pohimin, e ka vërtetuar atë me fjalën e Tij: “është Një i Vetëm”.

- S’ka ndërmjetësim për atë që i bën *shirk* Allahut (Subhanehu ue Te’Ala).

Ashtu siç thuhet në ajetin: “... kurrfarë ndërmjetësimi i cilitdo ndërmjetësuesi nuk do t’i ndihmojë ata”, por edhe në ajete të tjera, ku Allahu mohon ndërmjetësimin për idhujtarët. Po kështu, ky ndërmjetësim mohohet edhe nga thënia e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... me sinqeritet nga zemra e tij”.

- Qartësimi i çështjes së ndërmjetësimit.

E vërteta e tij është se Allahu (Subhanehu ue Te’Ala) u jep mirësi të sinqertëve dhe i fal ata nëpërmjet ndërmjetësimit të atij që Ai i ka dhënë gradën e lartë *Mekamul Mahmud*, gradë e dhënë për ta nderuar atë dhe për të treguar pozitën e tij të lartë tek Allahu.

Tema 18

Thënia e Allahut të Lartësuar: “Vërtet, ti nuk mund të udhëzosh kë të duash”.

Lidhja e këtij kapitulli me të mëparshmin qëndron në brendinë e tyre. Meqenëse askush nuk mund të ndërmjetësojë te Zoti sipas dëshirës, për ta shpëtuar tjetrin nga dënimi, po kështu askush nuk mund të udhëzojë një tjetër sipas dëshirës, që tjetri të veprojë ato çfarë urdhëron Allahu.

– *“Vërtet, ti nuk mund të udhëzosh kë të duash.”* – Fjala i është drejtuar Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), sepse ai donte udhëzimin e xhaxhait të tij Ebu Talibit, ose të dikujt tjetër në mënyrë të përgjithshme. Pra, edhe pse ke një gradë të lartë tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) nuk mund ta udhëzosh atë që ti dëshiron të udhëzohet.

Dihet se ai që dëshiron udhëzimin e dikujt, kujdeset për të e, megjithatë, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk mund ta bënte këtë gjë, sepse gjithçka është në dorën e Allahut: “Ti nuk ke asgjë në dorë, nëse do t'ua pranojë Ai pendimin apo do t'i dënojë ...” (Ali Imran, 128). “Allahu i di të fshehtat e qiejve dhe të Tokës dhe çdo gjë kthehet tek Ai!” (Hud, 123).

Allahu i mohon Profetit të Tij frytin, rezultatit përfundimtar të udhëzimit, por ia pohon atij rrugën e udhëzimit dhe të argumentimit. Ajeti ka ardhur në formë të përgjithshme, për të sqaruar se në dorë të Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte rruga e udhëzimit e jo fryti i tij. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala)

thotë: “Ti, me të vërtetë, udhëzon në rrugën e drejtë.” (Shura, 52). Allahu sqaron se Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) vetëm tregonte rrugën e udhëzimit. Ai vetëm u hapte udhën njerëzve, i sqaronte dhe i orientonte ata, ndërsa rezultati i udhëzimit nuk i përkiste të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), sepse ai është ndër gjërat që i përkasin vetëm Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Pra, detyrë për ne është të sqarojmë dhe të ftojme njerëzit, ndërsa suksesin e ka në dorë vetëm Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala). Në këtë mënyrë harmonizohen edhe dy ajetet e mësipërme.

Në ajet duket se Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka dashur Ebu Talibin. Për këtë ka tri sqarime: Së pari, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) donte udhëzimin e tij dhe jo atë vetë. Së dyti, ai kishte një dashuri të natyrshme për xhaxhain, si ajo e djalit për babain, edhe pse ai ishte jobesimtar. Së treti, kjo ka ndodhur para se të ndalohej dashuria për kafirët.

Shpjegimi i parë duket më afër të vërtetës, pra, dashja e udhëzimit dhe jo e vetë personit, e kjo vlen për Ebu Talibin dhe për të tjerët. Lejohet gjithashtu të kesh për tjetrin dashuri natyrore, për shkak të afërsisë së gjakut, dhe kjo nuk e kundërshton dashurinë për hir të Allahut. Nga ana tjetër, unë mund të dua që të udhëzohet një person, edhe pse personalisht e urrej, për shkak të mosbesimit të tij, sepse unë dua që njerëzit të marrin rrugën e fesë.

Në një hadith të saktë Ibn el Musejebi përcjell nga i ati: “Kur Ebu Talibi ishte në shtratin e vdekjes, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) shkoi tek ai, e pranë tij gjeti Ebu Xhehlin dhe Abdullah Ibn Ebu Umejen. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i tha: ‘O xhaxhai im! Thuaj: *La ilahe il’All-llah*, një shprehje që unë ta përmend si argument tek Allahu për ty.’ Ata të dy i thanë: ‘O Ebu Talib, a do ta braktisësh fenë e Abdul Mutalibit?’ Profeti e përsëriti atë që tha më parë, ashtu si edhe ata të dy përsëritën çfarë thanë në fillim, aq sa fjala e fundit që Ebu Talibi u tha atyre ishte: ‘Ai¹ është në fenë e Abdul

¹ Ai në fakt tha: "Unë" por transmetusi për të mos ia atribuuar këtë fjalë kaq të rëndë vetes së tij tha: "Ai" në vetën e tretë, pavarësisht se Ebu Talibi e tha në vetën e parë.

Mutalibit.’ Atëherë, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: ‘Do të vazhdoj të kërkoj faljen e Allahut për ty, nëse nuk ndalohem të veproj kështu.’ Pas kësaj u shpall ajeti: “Nuk i takon të Dërguarit dhe besimtarëve që të kërkojnë falje për idhujtarët, qofshin këta edhe të afërmit ...” (Teube, 113), dhe posaçërisht për çështjen e Ebu Talibit ajetin: “Vërtet, ti nuk mund të udhëzosh kë të duash, por është Allahu Ai që udhëzon kë të dëshirojë ...” (Kasas, 56)¹

- “... *O xhaxhai im! ...*” – Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) përdori këtë thirrje, e cila tregon butësi, sepse xhaxhai është njësoj si babai, si degët e të njëjtit trung të përbashkët.

- “... *Thuaj: La ilahe il’All-llah...*” – Mundet që këtë t’ia ketë thënë në formë urdhërore dhe të detyrueshme, sepse është detyrë që çdonjëri të thotë: *La ilahe il’All-llah*. Po kështu, mundet që t’ia ketë thënë në formë këshille, me butësi. Por Ebu Talibi dhe ata që ishin me të, e dinin kuptimin e kësaj deklarate, prandaj ai e mohoi atë.

- “... *Ata të dy i thanë: ‘O Ebu Talib, a do ta braktisësh fenë e Abdul Mutalibit?’ ...*” – Ata të dy ishin Ebu Xhehli dhe Abdullah Ibn Ebu Umeje. Me pyetjen e tyre ata shprehnin kundërshtim, sepse ata e dinin që, po ta thoshte atë deklaratë, ai do të njësonte Zotin, ndërsa feja e Abdul Mutalibit ishte idhujtaria. Ata i përmendën atë çka i ngacmonte fanatizmin e tij fetar, fenë e Abdul Mutalibit, me qëllim që ai të mos dilte nga feja e prindërve të tij. Ebu Xhehli vdiq në fenë e Abdul Mutalibit, ndërsa Abdullah Ibn Ebu Umejeh dhe El Musejebi, i cili na ka përcjellë hadithin, pranuan Islamin. Domethënë, prej këtyre të treve, dy u bënë muslimanë - radij-Allahu ‘anhum

- “... *Profeti tha: ‘Do të vazhdoj të kërkoj faljen e Allahut për ty, nëse nuk ndalohem të veproj kështu.’ ...*” – Duket sikur Profeti (sal-

¹ Transmeton Buhariu.

lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e kishte njëfarë merakuri në vetvete, kur tha “nëse nuk ndalohem”, dhe ndodhi ashtu siç ai e kishte parandjerë: u ndalua.

– “... Nuk i takon të Dërguarit dhe besimtarëve, që të kërkojnë falje për idhujtarët, qofshin këta edhe të afërmit ...” – Pra, nuk i takon Profetit dhe atyre që besojnë, të kërkojnë falje Allahut për politeistët, edhe sikur ata të jenë më të afërmit e tyre. Kështu, kur Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) bëri umren, kaloi pranë varrit të nënës së tij dhe iu lut Allahut që ta lejonte të kërkonte falje për të, por Ai nuk e lejoi. Pastaj i kërkoi leje që të vizitonte varrin e saj dhe Allahu e lejoi. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e vizitoi varrin e saj dhe qau, po ashtu qanë edhe sahabët që ishin rreth tij. Allahu e ndaloi atë të kërkonte falje për idhujtarët, sepse ata nuk e meritojnë faljen. Kështu, nëse e lut Allahun të bëjë atë që nuk është e përshtatshme, quhet tejkalim i kufijve në lutje.

– “... Vërtet, ti nuk mund të udhëzosh kë të duash ...” – Fjala këtu i është drejtuar Profetit (Subhanehu ue Te‘Ala).

– “... por është Allahu Ai që udhëzon kë të dëshirojë ...” – Që do të thotë se Allahu i jep suksesin e udhëzimit atij që Ai dëshiron. Pastaj, çdo veprim që ndodh me dëshirën e Allahut të Lartësuar, ka në vete edhe urtësi, që do të thotë se atë që e përfshin Urtësia e Tij për ta udhëzuar, udhëzohet, dhe atë që sipas Urtësisë së Tij do të humbë, Allahu e humb.

Ky hadith i pret lidhjet e politeizmit me Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe me të tjerë. Ata të cilët mbështeten te Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe i kërkojnë ndihmë atij, janë idhujtarë. Këto veprime nuk u bëjnë dobi atyre, sepse Allahu nuk e lejoi vetë Pejgamberin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të kërkonte falje për xhaxhain e tij, edhe pse ky i fundit kishte luajtur një rol të rëndësishëm, duke e ndihmuar Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në thirrjen islame. E çfarë mund të thuhet pastaj për të tjerët, nga ata që e shoqërojnë Pejgamberin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) me Allahun?

Shpjegime për paqartësitë që mund të lindin nga hadithi

1. Çështja e mundësisë dhe pamundësisë së udhëzimit, që u sqarua më parë.

2. Thënia e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në momentet e vdekjes së Ebu Talibit, duket sikur bie ndesh me ajetin kuranor: “Nuk pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të këqija e, kur u afrohet vdekja, atëherë thonë: ‘Unë tani me të vërtetë po pendohem...’ (Nisa, 18). Nga konteksti i hadithit duket se pendimi i tij pranohet, por për këtë janë dhënë dy përgjigje:

E para: ajeti i mësipërm komentohet: “kur Ebu Talibit iu afrua vdekja...”, që do të thotë se atij iu shfaqën shenjat e vdekjes, por ajo ende nuk i kishte ardhur. Kështu, nisur nga fakti se shenjat në mënyrë të padiskutueshme tregonin se ai po vdiste, përshtkrimi i gjendjes së tij nuk bie ndesh me atë që thuhet në ajet.

E dyta: ky ishte një rast i posaçëm, dhe kjo del nga dy aspekte:

Së pari, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i tha: “...një shprehje që ta përmend si argument tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) për ty” dhe nuk i tha prerë se ajo do t’i bënte dobi apo që do ta nxirrte nga Zjarri.” Së dyti, Allahu i dha leje të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për të ndërmjetësuar për xhaxhain e tij, megjithëse ishte jobesimtar, por kjo vlente vetëm për xhaxhain e tij dhe ndërmjetësimi ishte vetëm që t’i lehtësohej ndëshkimi.

Shpjegimi i parë, se Ebu Talibit iu shfaqën shenjat e vdekjes, është i dobët, sepse fjala: “Kur Ebu Talibi ishte në shtratin e vdekjes”, është në përputhje të plotë me ajetin: “... kur u afrohet vdekja ...”. Atëherë, shpjegimi më i saktë është i dyti: se leja e ndërmjetësimit ishte e posaçme vetëm për të Dërguarin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) me xhaxhain tij, Ebu Talibin.

3. Ajeti, “nuk i takon të Dërguarit dhe besimtarëve, që të kërkojnë falje për idhujtarët...”, është në suren “Teube”. Kjo sure ka zbritur vonë në Medinë, ndërsa ngjarja me Ebu Talibit ka ndodhur në Mekë. Kjo tregon se ndalimi i kërkimit të faljes për idhujtarët ka ardhur shumë më vonë. Kjo që gjithashtu arsyeja që Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i kërkoi leje Allahut që të lutej për falje të nënës së tij, atëherë kur ishte duke shkuar për umre. Ishte e pamundur që ai të kërkonte leje pasi të kishte zbritur ajeti i mësipërm. Qëllimi i paraqitjes së këtij ajeti është të sqarohet se kjo

çështje ka lidhje me të, dhe nuk do të thotë se ky ajet ka zbritur në atë kohë.

Është thënë gjithashtu se shkak i zbritjes së ajetit është kërkimi i lejes tek Allahu nga ana e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) që të lutej për faljen e nënës së tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Nuk ka pse ajeti të mos ketë zbritur për dy shkaqe.

4. Dijetarët kanë thënë se është sunet t’i përmendësh atij që është duke vdekur deklaratën *La ilahe il’All-llah*, por pa i thënë “thuj”, sepse për shkak të ngushtimit të gjoksit nga vdekja, ai mund të thotë jo apo mund ta urrejë këtë fjalë ose domethënien e saj. Ndërkohë në hadith përcillet: “thuj”.

Shpjegimi është se në hadith flitej për një jobesimtar, prandaj nëse atij i thuhet “thuj” dhe ai refuzon, atëherë ai ka për të mbetur në kufrin e tij, dhe kështu përmendja e kësaj fjale nuk i bën dëm. Ai, ose do të mbetet në kufrin e tij, ose do të udhëzohet nga Allahu. Ndosht ndryshe me muslimanin i cili është në rrezik dhe ndoshta kjo fjalë, në atë formë që u përmend, e dëmton.

■ **Dobitë e temës**

- Komenti i thënies së Allahut të Lartësuar: “Vërtet, ti nuk mund të udhëzosh kë të duash ...”.

Pra, atë që dëshiron ti të udhëzohet. Ne e theksuam se, kur Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk mund të udhëzonte asnjë duke qenë i gjallë, si mundet ai të udhëzojë tani, duke qenë i vdekur?! Allahu thotë: “Thuj: ‘Unë nuk mundem t’ju largoj ndonjë dëm e as t’ju sjell ndonjë dobi’ (Xhin, 21).

- Komenti i ajetit: “Nuk i takon të Dërguarit dhe besimtarëve që të kërkojnë falje për idhujtarët ...”.

Komenti u bë më lart dhe u qartësua se është e ndaluar kërkimi i faljes nga muslimanët për idhujtarët, edhe nëse janë të afërmit e

tyre. Është problem me disa njerëz, që, kur vdesin krerë të mosbesimit, i quajnë “të mëshiruarit”. Ky veprim është haram, sepse ata kanë qenë kundërshtarë të Allahut. Po ashtu ndalohet shfaqja e hidhërimit për vdekjen e tyre, duke mbajtur zi apo me forma të tjera. Përkundrazi, besimtarët duhet të gëzohen për vdekjen e tyre, madje nëse kanë fuqi dhe mundësi për eliminimin e tyre, duhet ta bëjnë këtë, me qëllim që feja të jetë plotësisht vetëm për Allahun.

- Çështje e madhe, ajo është shpjegimi i fjalës së Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) “Thuaj: *La ilahe il’All-llah*”, ndryshe nga ç’veprojnë ata që pretendojnë se janë të ditur.

– “Çështje e madhe, ajo është shpjegimi i fjalës së Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem)...” – Domethënë ky shpjegim është i rëndësishëm për këtë kapitull. “*La ilahe il’All-llah*” do të thotë të distancohesh nga çdo i adhuruar tjetër veç Allahut. Xhaxhai i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e njihte kuptimin, kushtet dhe detyrimet e saj, prandaj nuk donte ta thoshte.

– “... ndryshe nga ç’veprojnë ata që pretendojnë se janë të ditur...” – Me këtë, duket sikur autori aludon për shpjegimin që *mutekeliminët* i japin shprehjes “*La ilahe il’All-llah*”. Ata thonë se *Ilah* quhet ai që ka fuqi për të krijuar, dhe kështu shprehja do të thotë se askush nuk ka fuqi për shpikje, krijim dhe përsosmëri në krijim, përveç Allahut. Ky koment është i papranueshëm. Është e vërtetë se askush tjetër, përveç Allahut, nuk ka fuqi për krijim, por ky nuk është kuptimi i shprehjes “*La ilahe il’All-llah*”. Domethënia e saj është: “Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut”. Nëse do të thoshim se kuptimi i fjalës “*La ilahe il’All-llah*” është: “Nuk ka fuqi për krijim askush tjetër përveç Allahut”, atëherë idhujtarët që luftoi Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) paskan qenë muslimanë. Edhe njëherë nga fjala e autorit (Allahu e mëshiroftë!) duket se ai ka pasur për qëllim

mutekeliminët, të cilët e komentojnë “*La ilahe il’All-llah*” me teuhidin *rububije*, si edhe ata që adhurojnë të Dërguarin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe evlijatë, e që, nga ana tjetër, thonë: “*La ilahe il’All-llah*”.

- Ebu Xhehli dhe ata që ishin me të, e dinin qëllimin e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kur po i thoshte atij burrit: thuaj: “*La ilahe il’All-llah*”. Atëherë, Allahu i shëmtoftë ata që janë më të paditur sesa Ebu Xhehli mbi thelbin e Islamit!

Ebu Xhehli dhe shokët e tij e dinin domethënien e shehadetit, prandaj iu hodhën Ebu Talibit e i thanë: “A do ta braktisësh fenë e Abdul Mutalibit?” Po ashtu, ai vetë nuk donte ta thoshte atë, sepse edhe ai e njihte qëllimin e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) me atë deklaratë. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “... kur u thuhej atyre: ‘La ilahe il-l Allah’ ata tregoheshin mendjemëdhenj dhe thoshin: “Vallë, a t’i braktisim zotat tanë, për shkak të një poeti të marrë?”” (Safat, 35-36).

Përfundimisht, ata që pretendojnë se kuptimi i shehadetit është: “Nuk ka fuqi për krijim askush tjetër përveç Allahut”, dhe ata që e thonë “*La ilahe il’All-llah*”, por, nga ana tjetër, adhurojnë të tjerë veç Allahut, si evlijatë etj., janë më injorantë se Ebu Xhehli.

Autori është treguar i kujdesshëm në mospërmendjen e emrave të atyre që ishin me Ebu Xhehlin, për faktin se ata, më vonë, pranuan Islamin, e kështu ata u bënë më të ditur se ata që erdhën pas tyre, veçanërisht ata që kanë jetuar në kohën e autorit, Allahu e mëshiroftë!

- Përpjekja e madhe e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për pranimin e Islamit nga xhaxhai i tij.

Kjo me qëllim që, me dëshminë e tij, ai të argumentojë tek Allahu. Gjithë atë përpjekje Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e bëri për dy arsye: së pari, për lidhjen e afërt të gjakut dhe, së dyti, për ndihmën që ai i kishte dhënë Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-

lem) në përhapjen e Islamit. Për këtë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ishte mirënjohës, edhe pse do të mbetej jobesimtar, duke u futur në Zjarr.

Ebu Talibi e braktisi popullin e vet për shkak të mospajtimeve që ata kishin me Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Ai i tregonte parisë sinqeritetin dhe besnikërinë e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ai recitonte poezi duke e lavdëruar nipin e vet dhe i duronte vështirësitë për shkak të tij. Në dukje, këto tregojnë përkushtim në rrugën e drejtë, por udhëzimi është në dorën e Rrotulluesit të zemrave, ashtu siç përmendet në hadith: “Vërtet, zemrat e njerëzve janë të gjitha ndërmjet dy gishtave të Mëshiruesit, dhe Ai i rrotullon ato si të dojë.” Pastaj, në të njëjtin hadith, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: “O Allah! O Rrotullues i zemrave! Forcoji zemrat tona në adhurimin tënd!”¹

- Kundërpërgjigjja ndaj atyre që pretendojnë se Abdul Mutalibi dhe paraardhësit e tij kishin pranuar Islamin.

Kjo vërtetohet nga fjalët e Ebu Xhehlit me shokë: “A do ta braktisësh fenë e Abdul Mutalibit?”, kur Pejgamberi e nxiste Ebu Talibin që të thoshte *La ilahe il’All-llah*. Kjo tregon, pra, se feja e Abdul Mutalibit kishte qenë idhujtari.

Gjithashtu hadithi provon të kundërtën edhe të atyre që pretendojnë se Ebu Talibi e pranoi Islamin ose profetësinë e Muhamedit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), siç pretendojnë *rafidi-të* (Allahu i shëmtoftë!), sepse fjala e fundit e Ebu Talibit ishte: “...unë jam në fenë e Abdul Mutalibit”, duke refuzuar të thoshte: *La ilahe il’All-llah*.

- Kërkimi i faljes nga ana e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për xhaxhain e vet dhe mosfalja e këtij të fundit, madje, më pas, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u ndalua ta përsëriste këtë veprim.

¹ Transmeton Muslimi.

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte më i afërti që Allahu mund t’i përgjigjej lutjes së tij, por megjithëkëtë, Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) me urtësinë e Vet, kishte caktuar që të mos i përgjigjej lutjes për Ebu Talibin, sepse pushteti është në dorën e Allahut, jo në dorën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e as të dikujt tjetër: “Thuaj: ‘Gjithçka është në dorë të Allahut.’” (Ali Imran, 154); “Tek Ai kthehen të gjitha çështjet...” (Hud, 123). Askush nuk mund të bëjë ndonjë lëvizje në këtë gjithësi, pa dashur Krijuesi i saj.

E njëjta gjë ndodhi edhe për nënën e tij, kur Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk iu lejua të kërkonte falje për të. Kjo tregon se jobesimtarët nuk meritojnë falje në asnjë gjendje, dhe se lutjet për faljen dhe mëshirimin e tyre nuk pranohen. E vetmja lutje që mund të bësh për ta është që t’i udhëzojë Allahu për sa kohë janë ende gjallë.

➤ Rreziku i shokëve të këqij.

Allahu është më i ditur, po sikur të mos kishin qenë ata dy burra, ndoshta Ebu Talibit do ta pranonte udhëzimin e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Ata – Allahu na ruajtë! – i kujtuan atij pikërisht fenë e injorancës.

Pasojë e shoqërisë së keqe nuk është vetëm politeizmi, por të gjitha sjelljet e ulëta të njeriut. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka krahasuar shokun e keq me farkëtarin, i cili, ose do të të djegë rrobat, ose do t’i ndjesh erën e keqe.¹ Gjithashtu, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “... prindërit e bëjnë çifut, të krishterë ose mexhus ...”,² për shkak të shoqërimit dhe përzierjes së tij me ta. Ndërsa në një përcjellje tjetër ka thënë: “Njeriu është në fenë e shokut të vet, prandaj le të shikojë gjithsecili se me kë shoqërohet.”³ Është detyrë për njeriun e mençur, të shohë shokët që e rrethojnë. Nëse ata janë të këqij, ai duhet të largohet prej tyre, sepse ata janë më infektues sesa vetë zgjebja, por nëse janë të mirë, e ndalojnë nga të këqijat dhe i hapin dyert e së mirës, ai duhet të shoqërohet me ta.

¹ Transmeton Buhariu.

² Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

³ Transmeton Ahmedi dhe Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i mirë.

➤ Rreziku i madhërimit të udhëheqësve dhe të parëve.

Ebu Talibi zgjodhi të qëndronte në fenë e Abdul Mutalibit atëherë kur i përmendën të parët e tij, duke kundërshtuar kështu fenë e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Megjithatë, nëse të parët e brezave e meritojnë nderimin, nuk bën dëm, por përkundrazi, është mirësi. Kështu, nderimi dhe vlerësimi i të parëve tanë në fillimet e këtij umeti nuk ka dyshim se është mirësi, dhe nuk cenon asgjë. Nëse nderimi i udhëheqësve është për shkak të dijës dhe moshës së tyre, nuk ka gjë të keqe, por nëse e nderojmë dikë edhe pse ka qenë i paudhëzuar, ky është dëm i madh për fenë e njeriut, si për shembull, të nderosh Ebu Xhehlin apo Abdul Mutalibin se kanë qenë ndër prijësit e Mekës, etj. Pra, nuk lejohet që të ruash ndonjë vlerë për ta, sepse ata kanë qenë armiqtë e Allahut të Lartësuar. Po ashtu, nuk duhet të madhërosh prijësit jobesimtarë të kohës kur jeton, sepse kjo të çon në kundërshtim me Islamin.

Atëherë, përfundimisht, është detyrë që nderimi i të tjerëve të bëhet në përputhje me parimet e Kuranit dhe të Sunetit.

➤ Dyshimet që të paudhët krijojnë ndaj së vërtetës, me tezën e shenjtërimit të parëve, siç veproi edhe Ebu Xhehli.

Këto dyshime i fakton, kështu, thënia e Ebu Xhehilit: “A mos do të braktisësh fenë e Abdul Mutalibit?” Këtë dukuri na e përmend edhe Allahu në Kuran: “Po ashtu, në çdo vend që Ne kemi dërguar paralajmërues para teje, (o Muhamed), pasanikët e atij vendi thonin: ‘Ne i kemi gjetur etërit tanë në këtë fe dhe po ndjekim gjurmët e tyre.’” (Zuhruf, 23). Gënjeshtarët shprehin dyshimet e tyre, duke thënë se të parët e tyre janë në të drejtën ndaj do të ecin në rrugën e tyre. Ata thonë: si të injorojmë mençurinë e tyre e të quajmë të humbur atë në të cilën ndodhe ata? Këtë e gjen edhe te fanatikët pas hoxhallarëve, prijësve apo medhhebeve të tyre, të cilët nuk e pranojnë Kuranin dhe Hadithin, kur bien në kundërshtim me ta, aq sa disa i konsiderojnë si të pagabueshëm krerët e tyre, si

rafidi-të, tejxhani-të dhe kadjani-të. Ata besojnë se imami i tyre nuk gabon kurrë, ndërsa Kurani dhe hadithet mund të gabojnë.

Njeriu duhet të ndjekë udhën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe çfarëdo argumenti i sjellë nga ndonjë imam apo dijetar, që bie në kundërshtim me Kuranin dhe Sunetin, nuk pranohet. Për imamin, siç thonë dijetarët, gjendet justifikim, nëse e meriton, kur njihet që nuk i kundërshton argumentet e vërteta; në të kundërt, nëse njihet për kundërshtimin e Kuranit dhe Sunetit, nuk justifikohet.

Libri më i mirë që është përpiluar në këtë lëmë është libri i shejhut të Islamit Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) “*Refulmelam anil-leimeti-l alam – Mënjanimi i fajësimit nga dijetarët e shquar*”.

- Një mësim tjetër që del nga ajo ngjarje, është se veprat e njeriut vlerësohen sipas përfundimit të tyre, sepse po ta thoshte Ebu Talibi atë që i kërkoi Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ajo do t’i bënte dobi.

Kjo bazohet në mendimin se fragmenti “i erdhi vdekja” do të thotë që tek Ebu Talibi u dukën shenjat e vdekjes, por ajo ende nuk e kishte përfshirë.

- Mendo për rrezikun e madh të shenjtërimit të të parëve dhe dyshimeve që ai ngjall në zemrën e të humburve. Nga ndodhia shohim se Ebu Xhehli me shokë sollën veç këtë argument, megjithë këmbënguljen e madhe dhe përsëritjen nga ana e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të fjalës *La ilahe il’All-llah*. Për shkak se kjo ishte një çështje e madhe dhe e qartë te ata, vetëm atë përsëritnin.

Tema 19

Argumentet që tregojnë se shkaku i kufirit që bëjnë bijtë e Ademit dhe i lënies së fesë nga ana e tyre, është tejkalimi i caktit në lidhje me njerëzit e mirë.

– “... *bijtë e Ademit* ...” – Ky përkufizim përfshin burrat dhe gratë, sepse kur themi “bijtë e filanit” nënkuptojmë meshkujt dhe femrat, veç nëse specifikohet vetëm për burrat.

– “... *tejkalimi i caktit* ...” – Flitet për tejkalimin e kufirit në lavdërimi e nderime.

– “... *njerëzit e mirë* ...” – I mirë është ai që zbaton detyrat ndaj Allahut dhe ato ndaj njerëzve.

Në titullin e kësaj teme “shkaku i mosbesimit të bijve të Ademit dhe i lënies së fesë nga ana e tyre, është tejkalimi i caktit në lidhje me njerëzit e mirë” vihet re se veprimi i atribuohet shkakat (objektit) dhe jo Allahut. Kjo lejohet, kur objekti (ose edhe subjekti) njihen dhe janë të vërtetuar nga feja, ndijimi ose rrethanat aktuale. Kështu, në një hadith, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: “Po të mos isha unë, ai do të futej në nivelin më të ulët të Zjarrit”¹ dhe dihet se bëhet fjalë për Ebu Talibin.

¹ Transmeton Buhariu.

Allahu i Lartësuar thotë: “O ithtarët e Librit! Mos i kaloni kufijtë në besimin tuaj dhe për Allahun thoni vetëm të vërtetën! ...” **(Nisa, 171)**

– “O ithtarët e Librit! ...” – Këta janë judejtë dhe të krishterët, kurse “Libri” është: Teurati për jehudët dhe Ungjilli për të krishterët.

– “... Mos i kaloni kufijtë në besimin tuaj. ...” – Pra, mos i kaloni kufijtë as me lavdërime, as me ofendime. Këtë fenomen e has, në përgjithësi, tek të krishterët dhe hebrenjtë. Ata, me Isain, birin e Merjemes, e tejkalan kufirin si me lavdërime, po ashtu edhe me ofendime. Të krishterët thonë se ai ishte biri i Allahut dhe e konsiderojnë atë si të dytin e Trinisë së Shenjtë. Ndërsa jehudët e kaluan kufirin në lidhje me të në ofendim, kur thanë se nëna e tij ishte lavire dhe ai qe djalë i lindur nga imoraliteti (Allahu i vraftë!). Të dyja palët e tepruan në fenë e tyre, me lavdërime ose fyerje.

– “... dhe për Allahun thoni vetëm të vërtetën! ...” – Kjo është ajo çfarë Allahu ka thënë për veten e Tij: se Ai është i Adhuruari i Vetëm, Ai është Një i Vetëm, Atij i drejtohen krijesat për çdo nevojë, meqenëse Ai është i Fuqishëm t’i përmbushë nevojat, dhe Ai nuk ka as grua, as fëmijë.

Ajeti vazhdon me pjesën: “... Mesihu – Isai, i biri i Merjemes, është vetëm i Dërguar i Allahut dhe Fjala e Tij, të cilën ia ka dërguar Merjemes, si dhe shpirt nga Ai. Pra, besojeni Allahut dhe të Dërguarve të Tij! Dhe mos thoni: “Tre zota”! Hiqni dorë, se është më mirë për ju! Allahu është vetëm një Zot – qoftë lavdëruar Ai! Ai është tepër i lartësuar për të pasur fëmijë. E Tij është gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Allahu mjafton për rregullimin e gjithësisë.”

“... Mesihu - Isai, i biri i Merjemes, është vetëm i Dërguar i Allahut ...” – Kuptimi është se Isai, i biri i Merjemes, ishte vetëm Pejgamber.

Allahu e ka përshkruar atë si “biri i Merjemes” për të kundërshtuar të krishterët që thonë “biri i Zotit”. Po ashtu, duke e pohuar se Isai ishte: “... i Dërguar i Allahut ...”, Ai hedh poshtë fjalët

e çifutëve të cilët thonë se ai qe sharlatan, si edhe fjalët e të krishterëve që thonë se ai ishte Perëndi. Ndërkaq, përshtkrimi tjetër: “... dhe fjala e Tij, të cilën ia ka dërguar Merjemes ...”, rrëzon qëndrimin e çifutëve, që thonë se ai qe fryt i imoralitetit.

“... si dhe shpirt nga Ai ...” – Pra, Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) e krijoi Isain (*alejhi selam*) si të gjithë njerëzit e tjerë, me trup dhe shpirt. Shpirtin ia ka atribuar Vetes së Tij (Subhanehu ue Te‘Ala) si nderim dhe fisnikëri për Isain, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) edhe për Ademin (*alejhi selam*): “... dhe t’i fryj prej shpirtit Tim ...”, pikërisht për të treguar nderim.

“... Pra, besojini Allahut dhe të Dërguarve të Tij! ...” – Këto fjalë i drejtohen ithtarëve të Librit. Një nga të Dërguarit e Allahut është Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), i cili ishte dhe i fundmi i tyre, vula e tyre dhe më i vlefshmi ndër ta.

“... Dhe mos thoni: “Tre zota!” Hiqni dorë, se është më mirë për ju! Allahu është vetëm një Zot - qoftë i lavdëruar Ai! Ai është tepër i lartësuar për të pasur fëmijë. E Tij është gjithçka që gjendet në qiej dhe në tokë. ...” – Kjo do të thotë se Ai është larg të pasurit fëmijë, sepse Ai është Sunduesi i gjithçkaje në qiell dhe në tokë, ku bën pjesë edhe Isai, biri i Merjemes (*alejhi selam*). Ai është një nga këto krijesa të sunduara dhe të krijuara, e si mund të jetë perëndi bashkë me Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala), apo fëmijë i Tij (Subhanehu ue Te‘Ala)?!

“... Allahu mjafton për rregullimin e gjithësisë.” – Kjo do të thotë se Ai (Subhanehu ue Te‘Ala) është Ruajtësi i robërve të Tij, Rregullues i çështjeve të tyre dhe i Ditur për punët e tyre.

Pjesa e ajetit që dëshmon për çështjen në fjalë është: “... Mos i kaloni kufijtë në besimin tuaj ...”. Kalimi i caqeve është ndaluar, sepse ky veprim përmban shumë anë negative, ndër të cilat:

- Ngritjen e të lavdëruarit përtej pozitës së tij, nëse është lavdërim, dhe ulje të pozitës së tij, nëse është ofendim.
- Lavdërimi i tepruar kalon në adhurim, siç ndodh shpesh.
- Teprimet të pengojnë nga madhërimi i Allahut të Lartësuar, sepse njeriu mund të angazhohet plotësisht vetëm me njërën: ose me të rremen, ose me të vërtetën. Kështu, nëse do të angazhohet me lavdërimin dhe madhërimin e një krijese, do të

lidhet me të dhe do të harrojë detyrimet që ka ndaj Allahut.

- Atij që i thuren këto lavde të tepërta (nëse është i pranishëm) i hyn vetja në qejf, i pëlqen të madhërohet dhe përfundon kështu në shkatërrim. Teprimi me lavdërime e shkatërron njeriun, ndërsa teprimi me poshtërime fut armiqësinë, urrejtjen, shkakton luftëra dhe sjell të këqija.

– “... në besimin tuaj...” – Me fjalën “besim” (*din*) emërtohen veprat dhe shpërblimi. Fjala këtu është për veprat, që do të thotë: Mos fusni gjëra të tepërta në adhurimin tuaj, duke mbivlerësuar krijesat.

A hyn këtu teprimi me adhurimet e rregullta? Po, edhe ai përfshihet, për shembull kur njeriu e lodh veten jashtë mase me ndonjë adhurim të caktuar, gjë të cilën Profeti (sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka ndaluar. Kështu ndodh edhe kur shton në adhurim më tepër sesa është e ligjshme, për shembull të gjuash në Mina gurë të mëdhenj ose të bësh dhikër shtesë nga ai që është ligjësuar pas namazeve. Përfundimisht, ndalimi i teprimit në fe i përfshin të gjitha llojet e tejkalimeve.

Sipas një përcjellje të saktë që vjen nga Ibn Abasi, në komentin e ajetit: “... dhe thanë: ‘Mos i lini kurrsesi zotat tuaj! Mos e lini kurrsesi as Veddin as Suvain, as Jeguthin, as Jaukën e as Nesrin!’”, (Nuh, 23) ai ka thënë: “Këta ishin emrat e disa njerëzve të mirë nga populli i Nuhut. Kur ata vdiqën, shejtani e shtyu popullin e tyre që të ndërtonte përmendore në vendin ku ata mblidheshin dikur dhe këtyre përmendoreve t’u vinin emrat e tyre. Populli e bëri këtë, pa i adhuruar përmendoret. Kështu ndodhi derisa ata që i ndërtuan vdiqën, por kaloi kohë dhe u harrua qëllimi i parë, e kështu nisi adhurimi i tyre.”¹

Sipas Ibn Kajimit, shumë selefë kanë dëshmuar se kur njerëzit e mirë vdiqën, populli filloi të qëndronte te varret e tyre, pastaj u ngriti përmendore, derisa kaloi një kohë e

¹ Transmeton Buhariu.

gjatë kështu, e nisën t'i adhuronin.”

– “... *Mos i lini kurrsesi zotat tuaj ...*” – A nënkupton kjo: mos lini adhurimin e tyre, apo: mos lejoni asnjë t'i poshtërojë ata. Të dyja shpjegimet janë të sakta, që do të thotë: ndihmoni zotat tuaj dhe mos lejoni asnjë t'i poshtërojë ata. Mos i lini ata për hir të njerëzve të tjerë, e mos e lini adhurimin e tyre, përkundrazi, tregoni përkushtim ndaj tyre.

Kjo porosi është nxitje e njëri-tjetrit për padrejtësi, ndryshe nga besimtarët që bëjnë punë të mira dhe porositin njëri-tjetrin për të vërtetën.

– “...*Mos e lini kurrsesi as Veddin as Suvain, as Jeguthin, as Jaukën e as Nesrin!*” – Këta të pestë kanë pasur cilësi të veçanta nga të tjerët, sepse fjala e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) “zotat tuaj” përfshin të gjithë ata që adhuroheshin, mirëpo këta të pestë duket se kanë qenë më të mëdhenjtë e tyre, prandaj dhe janë përmendur në veçanti. Ilah “hyjni” quhet kushdo që adhurohet, qoftë ky adhurim i drejtë apo i padrejtë; kur i adhuruari është Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), adhurimi është i drejtë, e nëse është dikush tjetër veç Tij, atëherë është i padrejtë.

– “... *Ibn Abasi (r.a.) ka thënë: “Këta ishin emrat e disa njerëzve të mirë nga populli i Nuhut.”* – Në koment ka diçka të paqartë pasi thuhet se ata kanë qenë nga populli i Nuhut, ndërkohë që nga kuptimi i drejtpërdrejt i ajetit kuptohet se ata kanë jetuar përpara Nuhut. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Nuhu tha: ‘O Zoti im, ata më kundërshtuan mua dhe u dhanë pas atyre njerëzve, pasuria dhe fëmijët e të cilëve nuk kanë sjellë gjë tjetër veç shkatërrimit. Ata kurdisën një kurth të madh dhe thanë: ‘Mos i lini kurrsesi zotat tuaj!...’” (Nuh, 22-23). Ajeti tregon se, ndërkohë, populli i Nuhut i adhuronte ata, pastaj Nuhu i ndaloi nga ky adhurim dhe i urdhëroi që ta adhuronin Allahun si një të vetëm, por ata e refuzuan dhe thanë: “Mos i lini kurrsesi zotat tuaj...”. Ky është edhe mendimi i Muhamed Ibn Kab Ibn Kajsit, i cili është edhe më i sakti, për shkak të përputhjes së tij me kuptimin e drejtpërdrejtë të Kuranit.

Mundet që të kenë qenë në fillim të shpalljes së Nuhut, t'i jenë

përgjigjur atij duke i besuar, të kenë vdekur para tij e pastaj i adhuruan, mirëpo kjo është e largët edhe nga konteksti i fjalës së Ibn Abasit. E rëndësishme është që të thuhet se këta idhuj kanë qenë në popullin e Nuhut, kanë qenë burra të mirë dhe pasi kaloi një kohë e gjatë, i adhuruan.

– “... Kur ata vdiqën, shejtani e shtyu popullin e tyre që të ndërtonte përmendore në vendin ku ata mblidheshin dikur dhe këtyre përmendoreve t’u vinin emrat e tyre. ...” – Pra, ngrini përmendoret e tyre në vendin ku ata mblidheshin dhe, thoni: ky është Veddi, ky është Suvai, ky është Jeguthi, ky është Jauka, ndërsa ky është Nesri, me qëllim që, kur të shikoni përmendoret, të kujtoni adhurimin e tyre e të bëheni më të përkushtuar. Kështu shejtani ua zbukuroi veprën, dhe ky qe një mashtrim dhe shtysë prej tij, siç veproi me Ademin (alejhi selam): “Por shejtani e shtyu: ‘O Adem, a do të të tregoj pemën e përjetësisë dhe për një mbretërim që nuk zhduket?’” (Ta Ha, 120). Nëse njeriu kujtohet për adhurimin e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) vetëm pasi shikon hijet e këtyre, ky adhurim është i mangët ose nuk është aspak adhurim.

– “... Kështu ndodhi derisa ata që i ndërtuan vdiqën, por kaloi kohë dhe u harrua qëllimi i parë, e kështu nisi adhurimi i tyre.” – Ibn Abasi (r.a.) ka thënë se ndërmjet Ademit dhe Nuhut ka kaluar një periudhë dhjetë shekullore. Pas kësaj periudhe plasën kundërshtitë dhe përçarjet mes njerëzve, e atëherë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) dërgoi Profetët: “Dikur, të gjithë njerëzit përbënin një bashkësi të vetme. Pastaj Allahu dërgoi Profetët përgëzues dhe paralajmërues ...” (Bekare, 213).

Ky ishte komenti që Ibn Abasi i kishte bërë ajetit, po a është komenti i tij argument i padiskutueshëm? Komenti fillimisht kërkohet në Kuran, sepse Kurani mund ta komentojë një pjesë të tij me një pjesë tjetër, siç është rasti me ajetin: “Kush mund të ta shpjegojë ty se ç’është ai?”, të cilin e komenton ajeti vijues: “Ai është një Zjarr i vrullshëm.” (Karia, 10-11). Nëse komentin nuk e gjejmë në Kuran, atëherë kërkojmë në Sunetin e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), e nëse nuk e gjejmë në Sunet, atëherë e kërkojmë në komentet e sahabëve. Pa dyshim që komenti i sahabëve përbën

argument fetar, sepse ata janë më të diturit në lidhje me Kuranin, duke qenë se ai zbriti në kohën e tyre dhe në gjuhën e tyre; ata kanë pasur më shumë njohuri rreth tij se të tjerët që erdhën më pas. Madje, disa dijetarë kanë arritur deri atje sa të thonë se komentet që kanë bërë sahabët i atribuohen Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Kjo nuk është e saktë, por megjithatë, nuk ka dyshim se ato janë dëshmi për pasardhësit e tyre. Nëse sahabët kanë dhënë komente të ndryshme për një ajet, atëherë ne marrim mendimin që i përshtatet më tepër kontekstit të ajetit.

Si përfundim, ajeti i mësipërm sqarohet me shpjegimin e Ibn Abasit, vetëm se nga konteksti del që ata njerëz të mirë kanë qenë para Nuhut (alejhi selam). Sakaq, treguam edhe se cili është mendimi më i saktë.

– “...por kaloi kohë dhe u harrua qëllimi i parë, e kështu nisi adhurimi i tyre.” – Ky është komenti i Ibn Abasit. Ai thotë që u ndërtuan përmendore në vendin ku ata mblidheshin, ndërsa Ibn Kajimi thotë se njerëzit filluan të rrinin pranë varreve të tyre. Nuk është e pamundur që ata t’i kenë bërë të dyja veprimet, ose edhe mund t’i kenë varrosur në vendin ku ata mblidheshin në të gjallë.

Pjesa që i shërben autorit si argument për çështjen në fjalë, është: “... nisi adhurimi i tyre”. Atëherë pra, shkaku i politeizmit u bë tejkalimi i kufirit në nderimin e atyre njerëzve të mirë.

Përcillet nga Omeri se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Mos e teproni në lavdërimin tim, siç e tepruan të krishterët me të birin e Merjemes. Unë jam vetëm një rob, prandaj thoni: rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij.”¹

– “... Mos e teproni në lavdërimin tim ...” – Ky ndalim mund të jetë për llojin e teprimit të krishterëve, të cilët e bënë Profetin të adhuruar apo bir të Zotit. Këtë e mbështesin edhe vargjet e El Busirit:

Se ç’thotë i krishteri për Isanë, mos shih,

¹ Transmeton Buhariu.

Për lavde të tjera, fol e mos rri,
Me prova apo jo, nuk ka rëndësi!

Kjo do të thotë: mos thuaj si të krishterët se Isai është bir i Zotit ose që ai është pjesë e Trinisë, ndërsa për lavde të tjera ji i pakursyer, edhe në qofshin gjëra që vetë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk i pëlqen .

Por ndalimi mund të jetë edhe i tërësishëm, që përfshin edhe forma të tjera teprimi, përveç atij që bëjnë të krishterët në lidhje me Isain, birin e Merjemes. Atëherë krahasimi i referohet zanafillës së teprimit, jo pasojës së fundit të tij, sepse teprimi i të krishterëve në lidhje me Isain pati si shkak burimor kalimin e caqeve në lavdërimin që ata i bënin këtij Profeti të ndershëm, duke e quajtur përfundimisht atë si “birin e Zotit” dhe “të dytin e Trinisë”. Kjo mbështetet nga vazhdimi i hadithit: “Unë jam vetëm një rob, prandaj thoni: rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij.”

– “... *Unë jam vetëm një rob ...*” – Pra, nuk zotëroj asgjë në sundim dhe krijim, e as në ato gjëra që janë të posaçme vetëm për Allahun e Lartësuar.

– “... *thoni: rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij.*” – Këto janë dy cilësitë më të drejta dhe më të ndershme për përshkrimin e të Dërguarit të Allahut. Cilësia më e pastër për njeriun është të jetë ndër robërit e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë ...”; (Furkan, 63) “Shumë kohë më parë, Ne u premtuam robërve Tanë Profetë ...” (Safat, 171). Allahu i Madhëruar i ka përshkruar ata së pari si robër të Tij, pastaj si Profetë. Edhe pse grada e dytë është nderim mjaft i madh, përshkrimi i tyre si “robër të Allahut”, është më fisniku, më i larti. Po kështu, ky është përshkrimi më i drejtë dhe më i merituar për Pejgamberin Muhamed (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Ai ishte rob, prandaj nuk adhurohet, ai ishte Pejgamber, prandaj nuk mohohet. Ndaj ne gjatë namazit kur i çojmë selam dhe dëshmojmë profetësinë e tij themi: “... dëshmoj se Muhamedi është rob i Tij dhe i Dërguari i Tij.” Ky është përshkrim më i mirë, përshkrim që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) zgjodhi për veten e tij.

E drejta ndahet në tri lloje:

a) *E drejta e Allahut*, të cilën Ai nuk e ndan me asnjë, as me engjëj të afërt e as me Pejgamberë. Ajo përfshin njëshmërinë e Tij në veprat Tij, njësimin e Tij me adhurim dhe njëshmërinë e Tij në emrat dhe cilësitë që ka.

b) *E drejta e veçantë e Profetëve*, që nënkupton ndihmën, respektin dhe nderimin e tyre për aq sa e meritojnë.

c) *E drejta e përbashkët e Allahut dhe Profetëve*, që është *imani* – besimi në Allahun dhe Profetët e Tij. Të tria këto i gjen në ajetin: “... që t’i besoni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që ta ndihmoni e ta nderoni atë (Muhamedin) dhe që ta lartësoni Atë (Allahun) në mëngjes e pasdite.” (Fet’h, 9).

“... që t’i besoni Allahut dhe të Dërguarit ...”. Kjo është e drejta e tyre e përbashkët.

“... që ta ndihmoni dhe ta nderoni atë ...”. Kjo është e drejta e posaçme e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

“... dhe që ta lartësoni Atë (Allahun) në mëngjes e pasdite.” – Kjo është e drejta e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala).

Ndërsa ata që e teprojnë në lidhje me të Dërguarin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), të drejtën e Allahut ia kushtojnë të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), duke marrë argument fjalën: “...që ta lartësoni Atë...”, që, sipas tyre, do të thotë: të lartësoni të Dërguarin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Kështu ata i bëjnë *tesbih* të Dërguarit, siç i bëjnë edhe Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Nuk ka dyshim që kjo është shirk, sepse *tesbih*-u është e drejtë e posaçme për Allahun. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka ndaluar teprimin në lavdërim, kur ka thënë: “... ashtu siç e tepruan të krishterët me të birin e Merjemes...”, sepse teprimi dhe kalimi i kufirit, çon në adhurimin e tij, siç ndodh tani. Ka njerëz që e lusin atë në varrin e tij në Medinë dhe thonë: “O i Dërguari i Allahut! Na ndihmo! O i Dërguari i Allahut! Na jep shi, se vendi ynë u tha!” e të tjera si këto. Unë kam parë me sytë e mi një person nën ullukun e Qabes, që rrinte me shpinë nga Qabeja duke u kthyer në drejtim të Medinës, sepse drejtimi për nga varri i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte për të më i vlefshëm sesa drejtimi nga Kibla – Allahu na ruajtë!

Ka disa që thonë se Qabeja është më e vlefshme se dhoma, si dhomë, ku ndodhet varri i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-

lem), por përderisa atje është Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), thonë: “Jo, vallahi, nuk është më e vlefshme se ajo as Qabeja, as Froni i Zotit me mbajtësit e tij dhe as Xheneti.” Ky është një ekzagjerim, të cilin Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk e do as për ne e as për veten e tij. Është e vërtetë që trupi i tij është më i vlefshëm, por jo që dhoma është më e vlefshme se Qabeja, Arshi dhe Xheneti, për shkak se në të ndodhet Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Ky është një gabim shumë i madh. Lusim Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala) të na shpëtojë prej tij!

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Ruajuni teprimeve (*el gulúu*), se, vërtet, ata që kanë qenë para jush i shkatërroi vetëm teprimi.”¹

– “... *Ruajuni teprimeve (el gulúu) ...*” – Pra, ruajuni, tregohuni të kujdesshëm dhe largojuni teprimeve.

“*El gulúu*” quhet tejkalimi i kufirit me lavdërime dhe ofendime. Ndoshta ky term mund të përdoret me një kuptim më përfshirës se kaq, kështu që mund të përkufizohet në këtë mënyrë: ai është tejkalimi i kufirit me lavdërime, me adhurim dhe punë, sepse ky hadith është përcjellë për gjuajtjen e gurëve në Haxh, siç tregon Ibn Abasi: “Në mëngjesin e Akabesë, ndërkohë që ishte i hipur mbi devenë e tij, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: ‘Merr gurë për mua!’ Mora për të (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) shtatë gurë të vegjël dhe ai filloi t’i lëvizë në dorën e tij duke thënë: ‘Si këta (gurë) gjuani, dhe ruajuni teprimeve, se vërtet ata që kanë qenë para jush i shkatërroi teprimi.’”

– “... *i shkatërroi ...*” ka dy kuptime: 1. I shkatërroi fetarisht. Sipas kësaj, shkatërrimi i fesë vjen drejtpërdrejt nga tejkalimi i caqeve, pasi ky tejkalim është vetë cenim i fesë. 2. I shkatërroi fizikisht. Sipas kësaj, teprimi bëhet shkak për shkatërrim, që do të thotë se kur njerëzit e kalojnë cakun, nuk i binden Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), atëherë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) i shkatërron ata.

¹ Transmeton Ahmedi dhe Nesaiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

– “... vërtet ata që kanë qenë para jush i shkatërroi vetëm teprimi.”

– Kufizimi i shprehur këtu është absolut apo relativ?

Nëse thuhet se është absolut, kjo përbën problem, për arsye se ka hadithe ku Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka treguar shkaqe të tjera të shkatërrimit, si për shembull: “Ata që ishin para jush u shkatërruan vetëm sepse kur vidhte ndonjë fisnik ndër ta, ata e linin, e kur vidhte ndonjë njeri i thjeshtë, ata e dënonin menjëherë.”¹ Atëherë do të kishim përplasje mes dy kufizimesh, nëse do të pranohet se ato janë absolute. Shkatërrimi do të kishte veç një shkak, dhe dy hadithet do të binin në kundërshtim me njëri-tjetrin.

E nëse themi se kufizimi është relativ, pra, nuk është e thënë të jetë veç një shkak, atëherë mes haditheve të Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk ka kundërthënie.

Përfundimisht, kufizimi është relativ, prandaj jepet shpjegimi: ata që kanë qenë më përpara i shkatërroi teprimi, domethënë teprimi në adhurim. Për hadithin tjetër thuhet: ata që kanë qenë më përpara i shkatërroi mënyra e gjykimit. Pra, njerëzit shkatërrohen nëse dënimet penale i zbatojnë mbi të dobëtit dhe jo mbi ata që kanë pozitë. Me këtë hadith, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) paralajmëron umetin e tij për kalimin e caqeve, që është shkak shkatërrimi, sepse është në kundërshtim me Sheriatin dhe se ka rrënuar popujt e mëparshëm.

Nga hadithi dalin dy shkaqe që e bëjnë teprimin haram. Së pari, kemi të bëjmë me një paralajmërim nga Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), dhe paralajmërimi do të thotë ndalim, madje më tepër se kaq. Së dyti, ai është shkak për shkatërrimin e popujve, siç ka ndodhur me ata para nesh, dhe shkaqet që sjellin shkatërrimin janë haram.

Llojet e njerëzve përkundrejt adhurimit

Njerëzit, për sa i përket mënyrës së adhurimit të tyre, ndahen në tri grupe. Dy prej tyre janë në ekstrem dhe njëri i mesëm. Kështu, disa njerëz që e teprojnë, disa e lënë mangët adhurimin dhe disa të tjerë janë mesatarë. Ndërmjet atyre që e teprojnë në fe dhe atyre që e lënë mangët, është feja e Allahut, rruga e mesme. Për këtë arsye,

¹ Transmeton Buhariu.

është detyrë që njeriu të jetë i mesëm, as duke e tepruar e as duke e lënë mangët. Në fe nuk lejohet të zgjedhësh më të vështirën dhe të kalosh caqet e adhurimit, ashtu si nuk lejohet nënvlerësimi dhe neglizhenca, por duhet të jesh në mes të këtyre të dyjave.

Teprimet mund të jenë në akide, në adhurime, në marrëdhëniet e ndërsjella me njerëzit dhe në zakone.

1- Teprimet në akide

Shembull për këtë janë *ehlul kelam*-ët, në qëndrimin e tyre ndaj çështjes së attributeve të Allahut. Ata u zgjatën e rrëmuan aq shumë në këtë fushë, sa gjetën shkatërrimin e sigurt, pasi ranë në njërin nga dy përfundimet: ose në përngjasim të attributeve të Zotit me ato të krijesave, ose, më keq akoma, në mohimin e plotë të cilësive të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Ata, ose e përngjasuan Allahun me krijesat e Tij, duke thënë se ky është kuptimi i pohimit të cilësive të Zotit, duke e tepruar deri aty sa i pohuan Allahut atë që Ai ia ka mohuar Vetes së Tij, ose i mohuan fare cilësitë e Tij, duke pretenduar se Ai duhet të dëlrësohet nga çdo përngjasim me krijesat, pasi – sipas tyre – pohimi i cilësive të Zotit qenka përngjasim i Tij me krijesat.

Grupi i mesëm nuk e tepron as në pohim, as në mohim. Ata marrin kuptimin e qartë të fjalëve dhe deklarojnë se nuk u takon të shtojnë gjëra të tjera, dhe kështu ata nuk u shkatërruan, sepse ecin në rrugën e drejtë. Polemikët e pafundme në këtë çështje nisën atëherë kur në Islam po futeshin persianët, romakët e popuj të tjerë. Ata u zhytën thellë e më thellë, derisa e humbën rrugën e drejtë, Allahu na ruajtë! Kështu pra, paqartësitë që ekzistojnë, nuk i kanë sjellë aspak sahabët, të cilët ndiqnin rrugën e mesme, por brezat e mëvonshëm.

2- Teprimet në adhurim

Kjo do të thotë të kryesh më të vështirën në adhurim, duke menduar se, në të kundërt, ke bërë kufër, ke dalë nga Islami. I tillë është teprimi i *havarixh*-ëve dhe i *mutezilëve*, të cilët thonë se kushdo që bën një gjynah të madh, ka dalë nga feja, kështu që lejohet vrasja dhe marrja e pasurisë së tij. Me këtë arsyetim, ata kanë lejuar daljen në luftë dhe gjakderdhjen kundër udhëheqësve muslimanë. Po kështu, *mutezil*-ët thonë se kush vepron një gjynah të madh, qëndron ndërmjet besimit dhe mosbesimit, e kjo ashpërsi i

ka çuar ata në shkatërrim. Në ekstremimin e kundërt doli tolerimi i *murxhi-ve*, që thonë se krimi i vrasjes, prostitucioni, vjedhja, pirja e alkoolit e gjynahe të tjera si këto, jo vetëm që nuk të nxjerrin nga Islami, por nuk ta ulin aspak imanin, për të cilin mjafton pohimi me gojë. Ata thonë se imani i atij që bën një gjynah të madh, është njëllë si imani i engjëllit Xhibril dhe i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), sepse imani i krijesës nuk ndryshon, madje kanë shkuar deri atje sa të thonë që Iblisi është besimtar, sepse e ka pohuar besimin me gojë. Nëse u thua se Allahu e ka quajtur atë qafir, të thonë se Iblisi nuk ka thënë të vërtetën në pohimin e tij, por ka gënjyer. Në realitet, këta u vijnë për shtat shumë njerëzve të kësaj kohe, dhe nuk ka dyshim se ky është ekstremizëm në tolerim, ndërsa i pari ishte ekstremizëm në ashpërsi.

Nga ana tjetër, Ehli Suneti beson se imani shtohet dhe pakësohet. Kush vepron një gjynah, e pakëson besimin sipas gradës së mëkatit që ka bërë,¹ ndërsa nga Islami del vetëm për shkak të atyre veprave që argumentet e qarta dëshmojnë se janë kufër.

3- Teprimet në marrëdhëniet ndërnjerëzore

Një formë e tillë teprimi është ndalimi i gjithçkaje, qoftë edhe mjet, që nuk është domosdoshmëri jetese. Kjo është rruga e *sufive*, që thonë se kush angazhohet sado pak me dynjanë, nuk e do ahiretin, dhe kush merr diçka mbi nevojat e domosdoshme jetësore, nuk e ka hallall atë.

Përballë tyre qëndrojnë liberalët, që thonë se lejohet çdo gjë që shton pasurinë dhe forcon ekonominë, deri aty sa kanë lejuar kamatën, mashtrimin etj. Këta i gjen duke gënjyer për vlerën e mallit, cilësinë e tij dhe për çdo gjë, në mënyrë që të fitojnë me çdo kusht dy lekë më tepër, e nuk ka dyshim se ky është ekstremizëm.

I mesëm është qëndrimi se marrëdhëniet ndërnjerëzore duhet të rregullohen në përputhje me Sheriatin: “Allahu e ka lejuar tregtinë, por ka ndaluar kamatarinë ...” (Bekare, 275). Jo çdo gjë është e ndaluar, sepse Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka blerë e ka shitur; sahabët (radij-Allahu ‘anhum) gjithashtu kanë blerë e kanë shitur, dhe Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ua ka miratuar një gjë të tillë.

¹ Pakësimi e imanit ndodh në raport të zhdrejtë me vëllimin e mëkatit; sa më i madh të jetë mëkati, aq më shumë pakësohet imani.

4- Teprimet në zakone

Sa u përket zakoneve, nëse ekziston droja se braktisja e ndonjërit prej tyre ndikon në braktisjen e adhurimit, atëherë nuk është keq që të vazhdohet me atë zakon, pa e ndryshuar atë. Po nëse teprimi me një zakon të pengon nga kalimi në një zakon të ri më të dobishëm se i pari, atëherë ai është i ndaluar. Dikush që është kapur pas një zakoni, dhe nuk e ndërron atë me një tjetër më të mirë, quhet teprues dhe ekstremist në zakonin që ndjek. Nga ana tjetër, nëse zakonet, kanë dobi të barabartë, por ekziston droja që njerëzit të kalojnë nga ky zakon për në shumë zakone të tjera të cilat mund të cenojnë nderin ose fenë, atëherë nuk duhet të kalohet te zakoni i ri.

Muslimi përcjell nga Ibn Mesudi, se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Të shkatërruar janë ekstremistët (*mutenetiun*)!”, dhe e ka përsëritur këtë tri herë.

“*Mutenetiun*” quhet ata që shkojnë në skaj, që stërmundohen, qoftë me fjalë apo me vepra. Ata janë të shkatërruar, qoftë edhe sikur ta teprojnë veç me fjalët e zakonëshme. Derisa mund të ndodhë që shpeshherë stërmundimit t'i, bashkangjitet edhe vetëkënaqësia. Ndashta ai i është bashkangjitur e kështu shikon ata që, kur flasin, flasin nën hundë, madje edhe përshëndetjen ta kthejnë nën hundë. Edhe ekstremizmi në vepra të çon në vetëkënaqësi e mendjemadhësi. Ja përse Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Të shkatërruar janë ekstremistët!”

Ekstremizmi në çështjet e fesë është një formë e teprimit, prandaj është edhe një nga shkaqet që të çojnë në shkatërrim. Për shembull, disa njerëz, duke u stërzgatur në çështjen e attributeve të Zotit, bëjnë disa pyetje, që sahabët nuk i bënë kurrë, ndërkohë që e dinë shumë mirë se sahabët ishin më të mirë dhe më të interesuar për diturinë, pa përmendur pastaj që mes tyre ishte vetë i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), më mirë se i cili, askush tjetër, sado dituri të ketë, nuk i di përgjigjet.

Të trija hadithet e mësipërme provojnë se teprimi është haram dhe se ai është shkak për shkatërrim. Detyrë për njeriun është që të

ecë drejt Allahut në rrugën mes dy ekstremeve, në fenë e mesme. I tillë është edhe ky umet, i mesëm, feja e tij është e mesme, kështu që edhe rruga e tij duhet të jetë e mesme.

Dobitë e temës

- Nëse e kupton këtë temë dhe dy të tjerat që vijojnë, qartësohesh përse Islami është bërë i huaj për muslimanët. Kjo çështje të bën gjithashtu të habitësh me fuqinë e Allahut dhe me rrotullimin që Ai u bën zemrave.

– *“Kush kupton këtë kapitull dhe dy të tjerët që vijojnë ...”* – Kjo do të thotë ta kuptosh plotësisht komentin e ajetit: “... dhe thanë: ‘Mos i lini kurrsesi zotat tuaj! ...’”, dhe dy kapitujt vijues.

– *“... qartësohesh përse Islami është bërë i huaj për muslimanët. ...”* – Kjo është e vërtetë. Islami është ndërtuar mbi teuhidin e pastër, prandaj është e çuditshme që në shumë vende islame has dukuri të tilla në lidhje me varret e njerëzve të mirë, madje nuk gjen sot vend musliman ku të mos bëhen teprime me varret e njerëzve të mirë. Shpesh ato nuk janë aspak varre të njerëzve të mirë, por veç pandehen si të tillë, siç është rasti me varrin e Husejnit. Irakianët thonë se është në Irak, banorët e Shamit thonë se është në Sham, e po kështu në Egjipt dhe në Algjeri. Pra i bie që Husejni ose të ketë pasur katër trupa, ose të jetë ndarë më katërsh! Përfundimisht, nuk kemi të bëjmë me të vërteta.

E rëndësishme është, – siç thotë vetë shejhu i Islamit Muhamed Ibn Abdul Uehabi, – që të “qartësohesh përse Islami është bërë i huaj për muslimanët”.

Gadishulli Arabik, para thirrjes së shejhut Muhamed Ibn Abdul Uehabi, ishte i mbushur me varre e tyrbe ku bëhej pelegrinazh e ku adhuroheshin të tjerë përveç Allahut, por me mirësinë e Allahut, i Cili i bëri krah imam Muhamed Ibn Saudin, ai i zhdukuri, i shembi ato, duke e kthyer sërish vend të teuhidit të pastër, falë i qofshim

Allahut!

- Njohja e zanafillës së politeizmit në tokë, që nisi me paqartësinë rreth njerëzve të mirë.

Idhujt e popullit të Nuhut kishin qenë njerëz të mirë në të gjallë të tyre. Brezat që erdhën më vonë, pas vdekjes së njerëzve të mirë, e tepruan aq shumë me nderimin e tyre derisa i adhuruan si zota. Ky është edhe paralajmërim që të ruhemi nga tejkalimi i kufijve në lidhje me njerëzit e mirë.

- Njohja e faktorit të parë që ndryshoi fenë e Profetëve dhe njohja e shkakut të tij, kur dihet se ishte Allahu Ai që i dërgoi Profetët.

Kështu, e para gjë që çoi në ndryshimin e fesë së Profetëve ishte idhujtaria, ndërsa shkakut i tij ishte teprimi në lidhje me njerëzit e mirë.

– “... kur dihet se ishte Allahu Ai që i dërgoi Profetët.” – Allahu i Madhëruar thotë: “Dikur të gjithë njerëzit përbënin një bashkësi të vetme. Pastaj Allahu u dërgoi Profetët përgëzues dhe paralajmërues. Bashkë me ta, Ai zbriti edhe Librin me të vërtetën, për t'i gjykuar njerëzit në çështjet për të cilat nuk pajtoheshin.” (Bekare, 213). Kjo do të thotë se njerëzit, në fillim, ishin një bashkësi e vetme monoteiste, por më pas u përçanë. Atëherë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) u dërgoi Profetë, përgëzues e qortues, duke u dhënë edhe libër, që të gjykonin për kundërshtimet mes njerëzve. Ky ishte rasti i parë kur bijtë e Ademit kryen idhujtari.

- Pranimi i bidatit nga njerëzit, edhe pse ligjet hyjnore dhe natyrshmëria e pastër e refuzojnë atë.

Njerëzit e pranojnë atë, por kjo nuk do të thotë që ai është i ligjshëm. Të gjitha kodet hyjnore nuk e kanë pranuar atë, e po kështu edhe njeriu në thelb është krijuar për adhurimin e Allahut të Vetëm, pa shoqërim: “Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër

monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit ...” (Rum, 30). Natyrshmëria e kulluar e pranon ligjin vetëm prej atij që e zotëron atë.

- Shkaku i idhujtarisë ishte, në vetvete, përzjerja e të vërtetës me të rremen. E para ishte dashuria për njerëzit e mirë, e dyta, një vepër me të cilën fetarët e ditur të asaj kohe synonin të mirën. Brezat pasardhës pandehën se ata kishin pasur qëllim tjetër.

Autori (Allahu e mëshiroftë!) ka dashur të sqarojë se e vërteta u përzje me të rremen për dy arsye:

1. Dashuria për njerëzit e mirë, dhe nga dëshira për t'i parë imazhet e tyre u gdhendën statujat.
2. Qëllimi i dijetarëve fetarë kishte qenë i mirë: përtëritja e adhurimit, por ky qëllim ndërroi me kalimin e kohës.

Nga kjo mësohet se kush kërkon të “forcojë” fenë me një bidat, sjell më tepër pasoja të dëmshme sesa dobi. Kështu, për shembull, ata të cilët e teprojnë kundrejt Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) duke festuar ditëlindjen (*mevlud*) e tij, qëllimin e kanë të mirë, por që duan ta arrijnë përmes një bidati. Rrjedhimisht, pasojat negative të tij janë më të mëdha se ato pozitive, pasi kështu njeriu angazhohet me një rit të paligjëruar, në një kohë të caktuar. Më pas, ky angazhim i zellshëm shoqërohet me përkushtim fetar të plogët në pjesën tjetër të vitit. Ata që e teprojnë me këtë bidat, i sheh gjithashtu të dobët, më poshtë se të tjerët, në adhurime të përcaktuara qartë. Kjo tregon gjurmën që lë bidati në zemrat e tyre. Sado që ta zbukurojnë ata, bidati i shton njeriut vetëm humbje, sepse vetë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Çdo bidat është humbje ...”.¹

Dikush mund të thotë se festimi i mevludit ka bazë në Sunet, për faktin se, kur i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u pyet për agjërimin në ditë të hëne, tha: “Ajo është dita në të cilën kam lindur dhe kur jam bërë Pejgamber.”² Gjithashtu, – mund të thonë, –

¹ Transmeton Muslimi.

² Transmeton Muslimi.

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka agjëruar të hënën dhe të enjten, dhe thoshte: “Këto janë dy ditët kur paraqiten veprat tona tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), prandaj dua kur të paraqiten veprat e mia, të jem duke agjëruar.” Përgjigja jonë jepet me disa argumente:

Së pari, agjërimi nuk është festim. Kjo vepër nuk ngjan aspak me mënyrën e festimit të atyre që bëjnë mevlud. Nëse njeriu e agjëron këtë ditë, kjo bëhet sepse ajo është një ditë e begatshme, ditë kur u lind Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), dhe kjo nuk do të thotë që ne ta festojmë.

Së dyti, le ta marrim sikur është një pikë referimi; atëherë mbetet detyrë që, për formën dhe mënyrën e këtij “riti”, të ndjekim se çfarë thuhet në Kuran dhe Sunet. Nëse mevludi që festohet sot nga njerëzit do të ishte i ligjshëm, atë duhej ta kishte sqaruar patjetër Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ose me fjalë, ose me vepra, ose thjesht me miratim nga ana e tij.

Së treti, këta që festojnë ditëlindjen e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), nuk e kufizojnë atë në ditë të hënë, por në atë datë që ata pretendojnë se ai ka lindur. Kjo është dita e dymbëdhjetë e muajit *rabiul-euvel*, megjithëse kjo nuk qëndron historikisht. Disa astronomë të kohëve të fundit kanë bërë hulumtime dhe kanë arritur në përfundimin se ajo ka qenë dita e nëntë, jo e dymbëdhjeta.

Së katërti, forma se si bëhet mevludi është bidat i qartë, sepse ajo ka qenë e panjohur në kohën e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe shokëve të tij, megjithëse rrethanat ishin krejt të mundshme, pa ndonjë pengesë për kryerjen e tij.

Festimi i ditëlindjeve të fëmijëve

Çdo ditë që shihet si festë, duke u përsëritur ritualisht çdo javë apo çdo vit dhe kur është e papërcaktuar në ligjin fetar, konsiderohet bidat. Sheriati ka përcaktuar për të sapolindurit *akika-n*¹ dhe asgjë tjetër veç saj. Festimi i ditëlindjes çdo javë apo vit do të thotë përngjasim me festat e Islamit, dhe kjo është haram, e palejuar. Në Islam nuk ka festa të tjera, përveç këtyre të trijave: Fitër Bajrami, Kurban Bajrami dhe festa javore, dita e Xhumasë.

¹ *Akika* quhet riti i therjes së kurbanit me rastin e lindjes së një fëmije.

Ditëlindja dhe festimi i saj nuk mund të shihen si pjesë e traditës së lejuar, pasi ajo përsëritet rregullisht. Kur Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) shkoi në Medinë, pa që atje ensarët respektonin dy festa të tjera, prandaj u tha: “Vërtet Allahu ua zëvendësoi ato me dy festa më të vlefshme: me Fitër Bajramin dhe Kurban Bajramin”¹, megjithëse ata i konsideronin ato festa si pjesë të traditës.

➤ Komenti i ajetit 23 të sures “Nuh”.

Në shpjegimin e atij ajeti u tha se ata porositnin për të padrejtën. Të tillë janë gënjeshtarët e të humburit, të cilët propagandojnë veprimet e tyre, qofshin këta prijës politikë apo fetarë, e nuk vdesin pa përçarur rrugën që kanë ndjekur vetë. Kjo është në kundërshtim me rrugën e besimtarëve, të cilët porositin për të vërtetën, për durim dhe mëshirë.

➤ Njeriu në natyrën e tij është i tillë që e vërteta i zbehet në zemër dhe i shtohet e kota.

E tillë është vetë natyra e njeriut, pa llogaritur se çfarë mund t’i bëjë ai vetes, e lartëson apo e poshtëron atë. Njeriun si krijesë, Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) e ka përshkruar me këto cilësi: “Njeriu është i padrejtë dhe mosmirënjohës.” (Ibrahim, 34); “... Me të vërtetë, njeriu është i padrejtë dhe i paditur ...” (Ahzab, 72). Ndërsa ai që begatohet nga Allahu me iman dhe punë të mira, shpëton nga këto veti: “Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer, pastaj e çuam atë (kur nuk beson) në gjendjen më të ulët, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira: ata do të kenë shpërblime të pandërprera (në Xhenet).” (Tin, 6-7). Prandaj, e keqja që ndodhet në zemrën e njeriut, kur Allahu i fal udhëzim, ajo pakësohet ose edhe zhduket krejtësisht, si në rastin e Omer Ibn Hatabit, Halid Ibn Uelidit, Ikrima Ibn Ebu Xhehlit etj. Po kështu, ka pasur edhe raste që, njerëz të ditur si Ebu el Hasan el Eshariu, i cili ka qenë *mutezil*, pastaj *kilabi*, në fund janë bërë pasues të Sunetit. Gjithashtu Ibn Kajimi, në fillim ka qenë *sufi*, por Allahu e begatoi

¹ Transmeton Ahmedi dhe Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

me shoqërinë e shejhut të Islamit Ibn Tejmijen, dhe e udhëzoi përmes tij, derisa edhe vetë u bë një dijetar i madh.

- Kjo çështje dëshmon se bidati është shkak i kufrit, siç është përcjellë nga selefët.

Dijetarët thonë se kufri ka shkaqe të shumta dhe se nuk është e pamundur që një dukuri të ketë shumë shkaqe. Kështu, një ndër shkaqet e kufrit është edhe bidati. Dijetarët thonë se bidati e nxin zemrën pak nga pak, derisa e çon në kufër. Për këtë, ata argumentohen me hadithin: “Çdo bidat është humbje dhe çdo humbje është në Zjarr.”¹ Ata thonë gjithashtu se mëkatet janë postierë të kufrit, në kuptimin që ato të çojnë drejt tij. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka treguar se ato grumbullohen në zemër, duke bërë atje një njollë të zezë. Nëse njeriu pendohet, zemra pastrohet dhe zbardhet, në të kundërt njolla e zezë mbetet, duke u shtuar e shtuar, derisa pllakos e zeza².

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka tërhequr vërejtjen edhe për nënvlerësimin e gjynaheve, duke sjellë si shembull një grup njerëzish që zbresin në një vend dhe atje duan të ndezin një zjarr për të gatuar. Çdonjëri sjell nga një shkarpë, i grumbullojnë ato dhe kështu ndezin një zjarr të madh³. Kështu ndodh edhe me gjynahet. Ato lënë gjurmë të mëdha në zemër. Ndikimin më të madh e ka epshi, madje më tepër se dyshimi. Largimi i dyshimit është më i lehtë për atë që Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) ia lehtëson, pasi shkak i tij është injoranca. Ndërsa epshi është dëshira e keqe, është murtaja që kap injorantin dhe dijetarin. Për këtë arsye, mëkati i jehudëve është më i madh se mëkati i të krishterëve, sepse shkak për ata është epshi, synimi i të keqes dhe padrejtësisë, kurse për të krishterët shkak është dyshimi. Shkak i bidateve, më së shumti, është dyshimi, por jo rrallë është edhe epshi.

Bidatbërësit, shpesh, edhe pasi u sqarohet e vërteta, këmbëngulin në gabimin e tyre, pasi kështu synojnë thjesht ruajtjen e pozitës a të postit të tyre, pa u shqetësuar për korrigjimin e vetes.

¹ Transmeton Nesaiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

² Transmeton Ahmedi dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i mirë.

³ Transmeton Ahmedi. Sipas Albanit hadithi është i saktë.

Ata mendojnë, se kështu ia dikton shejtani, se po të tërhiqen nga bidati, do t'u ulet pozita që ka te njerëzit, të cilët do t'i gjykojnë pastaj si jo parimorë dhe të pa ditur. Por nuk është kështu. Ebu el Hasan el Eshariu, për shembull, i cili përmendet si shembull në këtë aspekt, kur ishte *mutezil*, nuk qe imam, por pasi u kthye në rrugën e *Ehli Sunetit*, u bë i tillë. Pra, kushdo që kthehet tek e vërteta, së pari i rritet grada tek Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), e pastaj te krijesat.

Si përfundim, bidati është një nga shkaqet që e çojnë njeriun në kufër. Nuk kemi pse të turbullohemi nga qëndrimi i dijetarëve, që thonë se gjynahet, në përgjithësi, janë postierë të kufrit, sepse nuk është e pamundur që një dukuri të ketë disa shkaqe.

- Shejtani e di se ku të çon bidati, edhe nëse qëllimi i vepruesit të tij është i mirë.

Ishte shejtani ai që ua zbukuroi veprën idhujtarëve, duke i shtyrë të krijonin figura e imazhe, pasi ai e dinte që ky bidat të çon në shirk.

Bidati mbetet shumë i keq, edhe nëse njeriu ka qëllim të mirë. Ai bën gjynah nëse e di që është bidat, sepse ka guxuar të shkelë kufijtë. Kjo është njëlloj si të lejosh gënjeshtren apo mashtrimin, duke pretenduar se ato janë të mira. Nga ana tjetër, nëse nuk e njeh për bidat, nuk merr gjynah, pasi njeriu mban përgjegjësi vetëm kur është i vetëdijsëm që po kryen një shkelje. Në këtë rast, ndoshta ai mund të shpërblehet për nijetin e mirë, siç thotë shejhu i Islamit Ibn Tejmije, në librin "*Iktida Siratil Mustekim*": "shpërblehet vetëm për nijetin, e jo për veprën e tij. Tek Allahu, kjo vepër është e papranuar dhe e papëlqyeshme, por për nijetin e mirë dhe për shkak të mosnjohjes, njeriu merr shpërblim. Dikujt që e kishte falur njëherë namazin, por që pasi kishte gjetur ujë, kishte marrë abdes dhe kishte përsëritur namazin, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i tha: "Ti ke marrë shpërblim dy herë".¹ Kjo ndodhte për qëllimin që ai kishte dhe sepse vepra e tij ishte e mirë në vetvete. Mirëpo nëse dikush dëshiron ta kryejë një vepër dy herë, duke e ditur se kjo nuk

¹ Trametoni Ebu Daudi dhe Nesaiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

lejohet, nuk merr shpërblim, sepse vepra e tij, duke qenë në kundërshtim me Sunetin, nuk është e ligjshme. Sërish Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i tha një tjetri që nuk e përsëriti namazin: “Ke vepruar tamam sipas Sunetit.”¹ Nëse pretendohet se ky bidat synon përtëritjen e vullnetit apo nxitjen e njerëzve për vepra të mira, përgjigjemi se kjo dëshirë është një lloj akuze për mospërmbushje ndaj misionit të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), që do të thotë se ai, ose nuk e ka mësuar popullin e tij, ose nuk ka pasur dituri rreth kësaj çështjeje. Kjo është tepër e rrezikshme, sepse nuk përputhet me rrugën e Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe të Kalifëve të Drejtë.

Megjithatë, nëse qëllimi është i mirë dhe personi nuk e di se vepra është bidat, ai shpërblehet për njetin e tij dhe jo për veprën, sepse bidati është vepër e keqe dhe e shëmtuar. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kush vepron diçka që nuk është në pajtim me fenë tonë, ajo është e refuzuar.”² Edhe në lidhje me njerëzit e thjeshtë, të cilët nuk kanë njohuri fetare, themi se përderisa ata vazhdojnë të kenë për qëllim të vërtetën, duke mos e ditur atë, gjynahu i tyre do të rëndojë mbi ata që u kanë dhënë fetva të tilla dhe mbi shkaktarët e devijimit.

Nga ana tjetër, për popujt që nuk dinë asgjë nga Islami, në Afrikë a në vende të tjera, nuk i quajmë si muslimanë, nuk ua falim namazin e xhenazes kur vdesin dhe nuk kërkojmë mëshirë për ta, edhe pse atyre nuk u ka ardhur e vërteta. Në këtë botë, ne sillemi me ata sipas veprave të dukshme, kurse në ahiret çështja e tyre i përket Allahut.

- Njohja e një rregulli të përgjithshëm. Ai është ndalimi nga teprimi dhe njohja e përfundimit se ku të çon.

Kjo është ajo për të cilën ka paralajmëruar Profeti (‘alejhis-selam), sepse teprimi është tejkallim i caktuar. Kjo ashtu siç vlen për fushën e adhurimit, vlen edhe për të tjerat. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Hani e pini, por mos e teproni ...” (Araf, 31), si dhe: “Edhe ata që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëlëshuar, as

¹ Vazhdimësia e hadithit të lartpërmendur.

² Transmeton Muslimi.

dorështrënguar ...” (Furkan, 67). Siç u sqarua edhe më lart.

- E keqja që vjen nga qëndrimi pranë varreve për të bërë një vepër e mirë.

Pasoja është e padiskutueshme për faktin se të çon në politeizëm. Veprime të tilla janë, për shembull, këndimi i Kuranit te varri i ndonjë njeriu të mirë, dhënia e sadakasë te një varr i caktuar, duke besuar se ai e meriton këtë më shumë se të tjerët. Këto janë bidate që mund të çojnë deri në adhurimin e varrit.

- Njohja e ndalesës së bërjes të statujave dhe urtësia e zhdukjes së tyre.

Flitet për figura që janë shëmbëlltyra të njerëzve, kafshëve ose gurëve, dhe kryesisht për ato që prodhohen për t’u adhuruar. Urtësia e zhdukjes së tyre është parandalimi i rrugëve të idhujtarisë.

- Njohja e rëndësisë së kësaj ngjarjeje dhe nevoja e madhe për mësimet që rrjedhin prej saj, në një kohë kur njerëzit tregohen tepër të shkujdesur ndaj tyre.

Fjala është për ata që e tepruan me njerëzit e mirë, ose të pandehur si të tillë, derisa shkuan në adhurimin e tyre. Ja përse është detyrë njohja e kësaj historie dhe e pasojave të rënda të saj. Mësimi prej saj është i domosdoshëm, por nga ana tjetër, neglizhenca e njerëzve është e madhe. Nëse sheh gjendjen dhe zemrat e njerëzve, do të vësh se ata janë të shkujdesur ndaj këtij fenomeni, i cili është mjaft i pranishëm në vendet islame.

- Është çudi, sepse ata e kanë lexuar këtë ndodhi në librat e *tefsir*-it dhe të haditheve, duke e njohur mirë kuptimin e fjalëve të përdorura. Por në fakt Allahu nuk lejoi që zemrat e tyre të merrnin mësim nga kjo ndodhi. Madje këta njerëz arritën deri në atë pikë sa

që besuan se veprimi i popullit të Nuhut është adhurimi më i mirë, një besim ky i cili në fakt është kufër që bën të lejuar derdhjen e gjakut dhe marrjen e pasurisë.¹

– “*Është çudi ...*” – Fjala *axheb* mund të shënojë pëlqimin e gjërave të mira, siç përmendet në fjalën e Aishes (r.a): “Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i pëlqente² e djathta në veshjen e këpucëve, në krehjen e flokëve, në pastrim dhe në çdo çështje ...”³, por mund të përdoret edhe për të treguar paradoksin e së keqes, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala): “Nëse ti (o Muhamed) çuditesh nga idhujtarët, atëherë më e çuditshme është thënia e tyre: ‘Vallë, pasi të bëhemi dhë, do të krijohe mi vërtet përsëri?!’” (Rrad, 5). Autori, natyrisht, e ka përdorur për të shprehur paradoksin e fenomenit. Ai përshkruan njerëzit e kohës së vet, të cilëve nuk u bënte përshtypje bidati i tyre, duke besuar se vepra e popullit të Nuhut ishte forma më e mirë e adhurimit, edhe pse e lexonin ngjarjen e tij në librat e tefsirit dhe hadithit. E keqja më e madhe është: të besosh se ajo është e mirë: “A është ai, që veprat e veta të këqija i duket të mira (si ai që është udhëzuar në rrugë e drejtë)? Me të vërtetë, Allahu shpie në humbje kë të dojë dhe udhëzon në rrugë të drejtë kë të dojë ...” (Fatir, 8); “Thuaj (o Muhamed): ‘A doni t’ju lajmëroj për ata që, më së shumti, humbasin nga punët e veta, për ata, përpjekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e kësaj bote, ndër kohë që mendonin se po bënin vepra të mira?’” (Kehf, 103-104)

– “*... një besim ky i cili në fakt është kufër që bën të lejuar derdhjen e gjakut dhe marrjen e pasurisë.*” – Kjo do të thotë se nëse dikush beson që politeizmi është adhurimi më i mirë dhe se ai të afron me Allahun, ta dijë se ky është kufri që e bën të lejuar derdhjen e gjakut dhe marrjen e pasurisë. Këtë ka dashur të shprehë autori (Allahu e mëshiroftë!), edhe nëse ky shpjegim nuk ndihmohet shumë nga konteksti. Unë mendoj gjithashtu, se

¹ Vetëkuptohet që pohime të tilla i referohen kushteve kur autoritetet zbatojnë ligjet e Sheriatit.

² Në hadith është përmendur fjala *ju'xhibuhu* e përkthyer 'i pëlqente'.

³ Transmeton Buhariu.

ndoshta kuptimi është që, këta të cilët e teprojnë me njerëzit e mirë, mendojnë se i ndaluar është vetëm kufri që e bën të lejuar derdhjen e gjakut dhe marrjen e pasurisë, ndërsa veprat e tjera më të vogla, siç është teprimi, nuk janë të ndaluara. Allahu e di më së miri.

- Ata deklarorin se synimi i tyre ishte vetëm ndërmjetësimi te Zoti.

Megjithatë vepra u klasifikua si politeizëm. Domethënë, ata synonin vetëm të siguronin ndërmjetësimin e tyre te Zoti, por që gjithsesi, ranë në idhujtari.

- Mendimi i të paditurve se dijetarët që punuan ato statuja patën po këtë qëllim.

Domethënë t'i merrnin si ndërmjetësues. Pra, këta njerëz hamendësojnë se dijetarët e popullit të Nuhut i gdhendëm përmendoret, me qëllim që të ndërmjetësonin për ta, por kjo s'është e vërtetë. Përkundrazi, ata menduan se përmendoret e njerëzve të mirë do t'i bënin aktivë në adhurim, por siç u përmend më parë, ky është gjykim i pavlefshëm.

- Deklarimi shumë i qartë i të Dërguarit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): “Mos e teproni me lavdërimin tim, siç e tepruan të krishterët me të birin e Merjemes. Unë jam vetëm një rob, prandaj për mua thoni veç: rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij.” Lavdërimet dhe paqja e Allahut qofshin mbi atë që e përcolli kumtesën në formën më të qartë të mundshme!

Lavdërimet e tepërta janë pikërisht ato që ka ndaluar i Dërguari (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), por që një pjesë e këtij umeti ka rënë sërish viktimë e tyre. Madje, akoma më keq, puna ka arritur deri aty sa Pejgamberin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e konsiderojnë si mbështetje për çdo gjë. Kjo është më e rrezikshme se qëndrimi i të krishterëve se Mesihu është bir i Allahut dhe i dyti i Trinisë.

- Paralajmërimi i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem) për shkatërrimin e ekstremistëve.

Ai thotë: “Të shkatërruar janë ekstremistët (*mutenetiu*)!” Qëllimi nuk ishte thjesht kumtimi, por është edhe këshillë për t’u ruajtur nga ekstremizmi.

- Përmendoret nisën të adhuroheshin vetëm pasi u zhduk dituria. Ky është tregues i qartë i vlerës së diturisë dhe i pasojave të humbjes së saj.

Pra, skulpturat u adhuruan vetëm pasi u harrua dhe u dobësua dija. Kjo tregon vlerën e diturisë dhe domosdoshmërinë e saj për umetin. Nëse humb dituria, vendin e saj e zë injoranca, e nëse ndodh kjo, atëherë mos pyet më për njerëzit. Ata nuk do të dinë si ta adhurojnë Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala) dhe as se si t’i afrohen Atij.

- Shkakun e humbjes së dijes është vdekja e dijetarëve.

Ky është një ndër shkaqet më të mëdha për humbjen e dijes. Nëse vdesin dijetarët, atëherë do të mbesin injorantët, që do të japin fetva pa pasur dituri. Shkak tjetër i humbjes së dijes është edhe shpërfillja, angazhimi me çështjet e dynjasë dhe moskokëçarja për dijen. Gjithashtu, dituria mund të ekzistojë dhe, njëkohësisht, mund të jetë e paqenë. Kjo ndodh kur shtohen lexuesit të cilët nuk veprojnë sipas asaj që lexojnë, ndërkohë që pakësohen dijetarët e vërtetë që veprojnë sipas asaj që lexojnë. Kështu, dija bëhet e padobishme dhe është njëlloj sikur të mos jetë. Madje ajo lë pasojat të dëmshme mbi popullin, sepse kur njerëzit e thjeshtë shikojnë atë që mbahet si i ditur që hesht dhe nuk zbaton dijen e tij, mendojnë se e keqja që veprojnë njerëzit e tjerë është e drejtë. E keqja e diturisë që nuk bën dobi është më e madhe se e keqja e injorancës, sepse kur ka veç injorancë njerëzit mund ta kërkojnë dijen dhe të gjejnë rrugën drejt saj.

Përmbledhje e temës

Deklarojmë se teprimi me njerëzit e mirë është shkak që të çon në kufër, por ky nuk është shkak i vetëm. Rreziku i teprimit është i madh dhe përfundimet e tij janë të dëmshme. Detyrë është që njerëzit e mirë t'i vendosësh në gradën që u takon, pa e kaluar masën. Feja e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) është mesatare; ajo nuk i jep njeriut më tepër apo më pak sesa e meriton. Kjo është drejtësia.

Cili është ndryshimi mes termave në arabisht *et tenetu*, *el gulúu* dhe *el ixhtihad*?

- *El gulúu* do të thotë: kalim caqesh.

- *Et tenetu* do të thotë: ekstremizëm dhe stërmundim. Ai është një nga llojet e *el gulú*.

- *El ixhtihad* do të thotë: përpjekje maksimale për arritjen e së vërtetës. Ai nuk është tejkalim kufijsh, përveç rasteve kur teprohet dhe dilet jashtë normave. Kjo ndodh, për shembull, kur njeriu fal namaz gjithë natën e nuk fle, kur agjëron çdo ditë pa ndërprerje, kur largohet nga të gjitha kënaqësitë e dynjasë si martesë, ngrënia e mishit apo frutave e të tjera. Ky është tejkalim kufijsh, ndonëse shtysë kanë qenë zelli dhe devocioni, pasi është në kundërshtim me udhëzimin e Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

Cili është gjykimi për këndimin e sures Fatiha në varret e njerëzve të mirë?

Kjo vepër është bidat, si të pranosh se atyre u përcillet shpërblimi, si të mos e pranosh. Këndimi i Kuranit në mënyrë të posaçme te varri është bidat. Selefët kanë pasur qëndrime të ndryshme për rastin e këndimit të sures Fatiha ose të ndonjë pjese tjetër nga Kurani, tek i vdekuri, menjëherë pas varrimit. E sakta është se ky veprim nuk është *sunet*. Sunet është të kërkosësh falje për të vdekurin dhe të lutesh që Allahu ta forcojë.

Tema 20

Argumentet që ndalojnë rreptësisht adhurimin e Allahut pranë varreve të njerëzve të mirë. Po kur adhurohen vetë varret?!

Në një hadith të saktë nga Aishja, thuhet se Umu Selemeh i tregoi njëherë Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për një kishë që e kishte parë në Abisini, në të cilën kishte pasur figura njerëzore. Atëherë, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i tha: “Kur ndër ta vdiste ndonjë njeri i mirë ose rob i mirë, ata ndërtonin mbi varrin e tij një faltore dhe bënë këto figura. Ata janë krijesat më të këqija për Allahun.”¹

– “... ndaj adhurimit të Allahut pranë varreve të njerëzve të mirë ...”
– Flitet për vepra me anë të të cilave adhurohet Allahu, si: këndim Kurani, namaz, sadaka etj.

– “... Po kur adhurohen vetë varret?! – Kjo është më e rëndë dhe më e rrezikshme. Varrezat dhe varret e njerëzve të mirë ose muslimanëve të tjerë, të vdekurit kanë vetë nevojë për lutje. Varrezat vizitohen me qëllim që vetë të vdekurit të përfitojnë, dhe jo të gjallët, përjashto këtu shpërblimin që arrihet për ndjekjen e Sunetit. Megjithatë, edhe ky përfitim nuk vjen nga të vdekurit, por nga vepra e vetë personit që vepron sipas Sunetit. Vizita që ka si

¹ Transmeton Buhariu.

qëllim përfitimin nga të vdekurit, është bidat, ndërsa vizita që synon lehtësimin e gjendjes së të vdekurve dhe kujtimin e ahiretit është e ligjshme.

– “... *Umu Selemeh* ...” – Kjo ishte njëra prej emigrantëve të parë. Pasi i vdiq burri i saj Ebu Selemeh, ajo u martua me Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Kur ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte në sëmundjen e vdekjes ajo i tregoi atij për çfarë kishte parë në Habeshe.

– “... *në të cilën kishte pasur figura njerëzore* ...” – Me sa kuptohet, kanë qenë piktura dhe skulptura të gdhendura (buste).

– “... *ata* ...” – Është fjala për të krishterët, por mund të nënkuptohet kushdo që vepron kështu.

– “... *njeri i mirë, ose rob i mirë* ...” – Përcjellësi i hadithit ka qenë në dyshim nëse flitej për njeri të mirë apo për rob të mirë.

– “... *ndërtonin mbi varrin e tij* ...” – Pra, mbi varrin e atij njeriu të mirë.

– “... *bënin këto figura* ...” – Pra, figurat e qenieve me shpirt, siç i kishte parë ajo. Më afër së vërtetës është që të ketë qenë imazhi i ndonjë njeriu të mirë, por pranë tij mund të jetë vendosur edhe figura të tjera me përmasa të ndryshme, prandaj kanë qenë shumë.

– “... *Ata janë krijesat më të këqija për Allahun.*” – Sepse vepra e tyre të çon në kufër dhe politeizëm, e ky është zullumi më i madh. Kush e kryen këtë padrejtësi meriton të jetë tek Allahu i Lartësuar ndër më të këqijtë e krijesave.

■ Këta njerëz gërshetuan ndërmjet dy sprovave (*fitneve*): varret dhe ikonat.

Ky është një citat i shejhut të Islamit Ibn Tejmije, që do të thotë se njerëzit u sprovuan me varret, për shkak se ndërtuan mbi to

faltore dhe u sprovuan edhe me ikonat që kishin punuar, kështu që ata ndërthurën dy faktorë që i joshën (u bënë *fitne*) për të rënë në idhujtari.

Janë quajtur "*fitne*", sepse janë shkak për pengimin e njerëzve nga feja e tyre, dhe çdo gjë që është e tillë është *fitne*. Allahu thotë: "A mendojnë njerëzit se do të lihen të thonë: 'Ne besojmë' pa u vënë në provë?" (Ankebut, 2); "Vërtet, ata të cilët i vënë në provë besimtarët dhe besimtare ..." (Buruxh, 10), që do të thotë se "i penguan ata" ose "bënë gjëra që i pengonin njerëzit nga feja e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala)".

Buhariu dhe Muslimi shënojnë rrëfimin e Aishes: "Kur i zbriti Meleku i Vdekjes, i Dërguari i Allahut e largoi shaminë nga fytyra e vet. Kur u mërzit me të, e hoqi fare dhe, duke qenë në atë gjendje, tha: "Mallkimi i Allahut qoftë mbi judejtë dhe të krishterët, që i bënë varret e Profetëve të tyre faltore!" Kështu ai tërhoqi vërejtjen për të keqen e veprimit të tyre. Të mos ishte kjo drojë, atëherë varri i tij do të bëhej jashtë shtëpisë, por ai druante se mos bëhej faltore."

– "... *Mallkimi i Allahut qoftë mbi judejtë dhe të krishterët, që i bënë varret e Profetëve të tyre faltore! ...*" – Këtë Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e tha në momentet e vdekjes. Mallkim do të thotë "largim, dëbim". Kjo thënie mund të merret me kuptim të drejtpërdrejtë, pra si kumtim që Allahu i ka mallkuar ata. Por ajo mund të merret edhe si lutje. Kësisoj themi që, fjalia është kumtim në shprehje dhe lutje në përmbajtje. Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është lutur kundër tyre, kur ishte në çastet e vdekjes, për shkak të veprës që bënë.

– "... *i bënë varret e Profetëve të tyre faltore ...*" – Kjo shpjegon pikërisht mallkimin e Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Sikur të pyesin pse i ka mallkuar i Dërguari 'alejhis-selam. ata, përgjigjja është: sepse ata i bënë varret e Profetëve të tyre faltore.

Ata i kthyen ato në vende për t'u falur. Kështu, pas këtij veprimi nuk ka shumë rëndësi a u ndërtuan faltore mbi varre apo jo, gjykimi është njëlloj. Kryesorja është që ata faleshin dhe adhuronin Allahun në to.

– “... Kështu ai tërhoqi vërejtjen për të keqen e veprimit të tyre ...” – Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e tha këtë në prag të vdekjes, si paralajmërim për bashkësinë e tij. Ai e dinte se do të vdiste, e ndoshta ajo mund të ndodhte edhe me të, qoftë edhe në një të ardhme të largët.

– “... Të mos ishte kjo drojë, atëherë varri i tij do të bëhej jashtë shtëpisë ...” – Pra, sikur mos të ishte droja që varri i tij mund të kthehej në faltore ai do të varrosej, për shembull, në varrezat e Medinës. Brenda shtëpisë së tij ishte më i mbrojtur dhe mundësia e kthimit të varrit në faltore ishte më e vogël. Për këtë arsye, e cila e bëri dhe të nevojshme, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk u varros jashtë shtëpisë. Shkak tjetër për mosvarrosjen e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) jashtë shtëpisë ishte edhe lajmërimi nga ana e tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) se çdo Profet është varrosur në vendin ku ka vdekur¹. Siç e kemi thënë, nuk ka ndonjë pengesë që, për një çështje të ketë dy ose më shumë shkaqe, siç ndodh, për shembull, me përfundimin e diellit, i cili është shkaku për çeljen e iftarit për agjëruesin dhe shkaku për faljen e namazit të akshamit.

– “... Të mos ishte kjo drojë ...” – Kështu ka ndodhur. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kishte treguar më parë se të gjithë Profetët ishin varrosur në vendin ku u ishte marrë shpirti. Pastaj ai i mallkoi judejtë dhe të krishterët, se ata i kishin bërë varret e Profetëve të tyre faltore, nga droja se edhe varri i tij shndërrohej në xhami. Sahabët (radij-Allahu ‘anhum) gjithashtu, pas konsultimit me njëri-tjetrin, ishin të gjithë të mendimit që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të varrosej në shtëpinë e tij, sepse edhe ata iu druajtën asaj rrjedhoje.

Këto hadithe paralajmërojnë për kthimin e varreve të Profetëve në faltore, duke ditur që ata mbeten njerëzit më të mirë, sepse

¹ Ahmedi dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

profetësia është e para ndër katër gradat që përmend Allahu i Lartësuar: “Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me Profetët, me të singertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh, sa shokë të mrekullueshëm janë këta.” (Nisa, 69)

Përgjigja ndaj një pretendimi

Dikush mund të thotë se kemi një problem: vetë varri i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ndodhet në mes të xhamisë! Përgjigja është si vijon:

Së pari, xhamia nuk u ndërtua mbi varr, pasi ajo u ngrit kur Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte gjallë.

Së dyti, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk u varros brenda në xhami që të merret si dëshmi se lejohet varrosja e të mirëve në faltore, por u varros në shtëpinë e tij.

Së treti, përfshirja e dhomave të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), midis të cilave edhe dhoma e Aishes, brenda në xhami, nuk ishte mendim i përbashkët i sahabëve, pasi kjo u bë kur vetëm pak prej tyre kishin mbetur gjallë, dhe pikërisht rreth vitit 94 hixhri. Sërisht, disa nga sahabët e kundërshtuan këtë veprim, ndër të cilët ishte edhe një tabiin, Said Ibn Musejebi, i cili nuk u kënaq me një veprim të tillë.

Së katërti, gjithsesi, varri nuk përfshihet në xhami. Ai ndodhet në një dhomë, i ndarë nga xhamia, e cila nuk është ndërtuar mbi të. Ky vend është i ruajtur dhe i rrethuar me tri mure, që ngrihen në formë trekëndëshi, me kulm në anën veriore, në mënyrë të tillë që njerëzit nuk mund të qëndrojnë në drejtim të tij kur falen.

Të gjitha këto fakte largojnë mjegullën që përhapin adhuruesit e varreve. Nëse dikush thotë se qysh në kohën e tabiinëve e deri më sot, muslimanët e kanë pohuar këtë dhe nuk e kanë kundërshtuar, i themi se ka pasur kundërshtim për këtë qysh në kohën e tabiinëve dhe kjo është një çështje që nuk ka unanimitet. Edhe nëse do ta marrim sikur ka pasur unanimitet, më lart u sqarua ndryshimi në katër aspekte.

Muslimi përcjell se Xhundub Ibn Abdullahi e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) pesë

net para se të vdiste, duke thënë: “Unë deklaroj i pastër para Allahut se nuk kam *khalil* (mik të ngushtë) prej jush. Vërtet, Allahu më ka bërë mua *khalil*, ashtu siç e bëri Ibrahimin. Sikur të bëja ndonjë *khalil* nga umetit im, do të bëja Ebu Bekrin. Ata që ishin para jush, i bënin varret e Profetëve të tyre faltore, por ju mos i bëni varret faltore, se unë jua ndaloj këtë.”

Khalil quhet ai që gëzon kulmin e dashurisë, e dashurisë që përshkon të gjithë qenien. Ajo është më e madhja dhe më e larta e llojeve të dashurisë. Allahu i Lartësuar, me sa dimë, e ka pohuar vetëm për dy nga krijesat e Tij, të cilët janë Ibrahim: “Allahu e ka bërë Ibrahimin *khalil*?” (Nisa, 125), dhe Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), siç ka thënë vetë: “Vërtet, Allahu më ka bërë mua *khalil*, ashtu siç e bëri Ibrahimin.”

Këtu del në pah dhe injoranca e madhe e atyre që thonë se Ibrahim është *Khalilu-ll-llah* (Mik i Allahut), kurse Muhamedi është *Habibu-ll-llah* (i Dashuri i Allahut). Ky është cenim i të drejtës së Profetit, pasi kështu ata e bëjnë gradën e Profetit tonë (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) më të ulët se të Ibrahimit (alejhi selam). Kur e quajnë Pejgamberin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) *habibu-ll-llah*, ata nuk bëjnë dallim ndërmjet tij dhe njerëzve të tjerë, sepse Allahu i do bamirësit, durimtarët e të tjerë për të cilët Ai ka shprehur dashurinë. Rrjedhimisht, sipas tyre, nuk ka ndonjë ndryshim mes tij dhe të tjerëve. Allahu tregon në Kuran vetëm për miqësinë me Ibrahimin, ndërsa për Muhamedin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ne na ka treguar vetë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Njerëzit e thjeshtë vazhdimisht e përshkruajnë të Dërguarin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) si *Habibu-ll-llah*, por ne u themi: Gaboni, sepse ia ulni vlerën Profetit tuaj (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem); ai është *Khalilu-ll-llah*, më lart se *habib*.

– “... Vërtet, Allahu më ka bërë mua *khalil*, ashtu siç e bëri Ibrahimin ...” – Kjo shpjegon fjalinë paraardhëse: “Unë deklaroj i pastër para Allahut se nuk kam *khalil* asnjërin prej jush”, që do të thotë se dashuria më e lartë në zemrën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte veç për Allahun e Lartësuar, e për asnjë tjetër.

– “... *Sikur të bëja ndonjë khalil nga umetit im, do të bëja Ebu Bekrin ...*” – Ky është një argument i qartë se Ebu Bekri (r.a.) ishte më i mirë se Aliu (r.a.), fakt i cili iu kundërvihet shiitëve, të cilët pretendojnë të anasjellën.

– “... *mos i bëni varret faltore ...*” – Këtu Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tërheq vëmendjen mbi ndalimin e shndërrimit të varreve në faltore. Ndalimi është i përgjithshëm, që përfshin qoftë varrin e tij, qoftë të njerëzve të tjerë.

– “... *unë jua ndaloj këtë.*” – Ndalimi është shprehur qartë dhe prerë, për shkak të rëndësisë së madhe që ka.

Mësimet prej hadithit

- Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u distancua nga zgjedhja e ndonjë njeriu si *khalil*, sepse zemra e tij ishte e mbushur me dashurinë për Allahun e Lartësuar.

- Allahu e bëri Muhamedin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) *khalil* të Vetin, ashtu siç kishte bërë Ibrahimin, dhe ky ishte vlerësim i madh për të (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

- Vlera e Ibrahimit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), si *khalil* i Allahut.

- Vlera e Ebu Bekrit (r.a.), si më i miri i sahabëve, sepse hadithi tregon se ai ishte më i dashuri ndër sahabët për Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

- Ndalimi për kthimin e varrezave në faltore: “... ju mos i bëni varret faltore, se unë jua ndaloj këtë.”

- Nëse dikush është varrosur brenda në xhami, ai duhet të nxirret prej andej dhe të varroset jashtë.

- Përkushtimi i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ndaj umetit, për largimin e tij nga politeizmi dhe faktorët e tij. Kthimi i varreve në xhami është një nga rrugët që të çojnë në politeizëm. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i kushtoi rëndësi të madhe umetit, dhe kjo vinte prej keqardhjes dhe mëshirës së tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për njerëzit.

- Një xhami e ndërtuar mbi një varr duhet të shembet.

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ndaloi kthimin e varreve në xhami, kur ishte në fundin e jetës së tij, dhe më pas, kur ishte duke u ndarë nga kjo jetë, ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e mallkoi cilindo që e vepron këtë. Po kështu, edhe falja e namazit pranë një varri ka të njëjtën natyrë, edhe nëse nuk ndërton xhami atje.

Ky është kuptimi i pohimit të Aishes: “Ai druhej se mos bëhej faltore”, prandaj sahabët nuk ndërtuan xhami rreth varrit të tij. Çdo vend që bëhet për të falur namaz konsiderohet si faltore, madje edhe si xhami, siç ka thënë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Mua më është bërë toka e tëra xhami dhe e pastër.”¹

– “... Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ndaloi kthimin e varreve në xhami, kur ishte në fundin e jetës së tij ...” – Kjo është nga thëniet e shejhut të Islamit Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!).

– “... falja e namazit pranë një varri ka të njëjtën natyrë, edhe nëse nuk ndërton xhami atje.” – Sipas kësaj, falja e namazit në varreza nuk lejohet. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka deklaruar qartë në hadithin që ndodhet në “Sahihun” e Muslimit, përcjellë nga Ebu Murthid el Ganeviu: “Mos u falni në varreza!”²

– “Ky është kuptimi i pohimit “drojës” që tha ajo ...” – Është fjala për Aishen (radijAllahu ‘anha).

– “... prandaj sahabët nuk ndërtuan xhami rreth varrit të tij ...” – Kjo është fjalë e shejhut të Islamit Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!).

Dikush mund të thotë se fjala e Aishes “... por ai druante se mos bëhej faltore ...” ka kuptimin që ai u druajt se mos ndërtonin xhami mbi varrin e tij. Por ne përgjigjemi se mundësia që sahabët të

¹ Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

² Transmeton Muslimi.

ndërtonin një xhami rreth varrit të tij duket e largët, pasi xhamia ishte shumë pranë shtëpisë së tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Si mund të ndërtonin ata një xhami tjetër? Kjo, logjikisht, ishte e pamundur. Atëherë, Aishja nënkuptonte një vend për t’u falur, edhe nëse nuk ndërtohej xhami.

Nuk ka dyshim se parimisht, ndërtimi i xhamive mbi varre është i ndaluar. Xhamitë janë vende ku njerëzit vijnë për të falur namazin. Nëse falesh në një xhami të ndërtuar mbi varr, do të ishte sikur të faleshe te varri. Ndalesa për ndërtimin e xhamive mbi varre, vlen edhe për vendet e zgjedhura për namaz, qoftë edhe pa u ndërtuar xhami. Atëherë, kthimi i varrezave në xhami ka dy kuptime: 1- të ndërtosh xhami mbi to; 2- t’i bësh ato (varrezat) vendfalje, edhe pa ndërtuar xhami. Nëse falesh pranë një varri, është njëlloj sikur atë vend e ke bërë xhami apo vendfalje. Çdo vend që shërben për të falur namazin konsiderohet si faltore; këtë e dëshmon përvoja njerëzore. Nëse pyet njerëzit në vendin e tyre të punës, se ku ndodhet xhamia, ata do të tregojnë vendin ku ata falen, edhe pse atje nuk është ndërtuar ndonjë xhami. Quhet xhami, se shfrytëzohet për të falur namazin.

Çdo vend që shërben për të falur namazin, konsiderohet si faltore, pra, quhet vend për të bërë sexhde (*mesxhid*). Ky është kuptimi i tretë: çdo vend në të cilin falesh vazhdimisht, quhet vendfalje (*mesxhid*), siç ka marrë emrin edhe *sixhadeja*, mbi të cilën falesh. Në fakt, në të shumtën e rasteve, (në arabisht) për vendfaljen përdoret fjala *musala*.

Përfundimisht, nuk lejohet ndërtimi i xhamive mbi varreza, sepse kjo është rrugë që të çon në idhujtari, pra në adhurimin e të vdekurit në varr. Po kështu, nuk lejohet të falësh namazin në varreza, sepse kjo është njëlloj si t’i bësh ato xhami. Nëse dikush shkon dhe falet te varri i ndonjë “njeriu të mirë” – siç pretendon ai, i themi se e ka bërë atë varr xhami dhe meriton nga mallkimi që bie mbi jehudët dhe të krishterët.

Fjalët e shejhut të Islamit Ibn Tejmije dëshmojnë se çdo vend ku falet namazi quhet xhami, sipas kuptimit të përgjithshëm.

■ Ahmed i përcjell me *sened* të mirë nga Ibn Mesudi një

hadith *merfuun*¹: “Njerëzit më të këqij janë ata që do t’i kapë Ora e Kijametit gjallë dhe ata të cilët i bëjnë varrezat xhami.”²

– “... *Njerëzit më të këqij ...*” – Kjo tregon se njerëzit dallojnë mes njëri-tjetrit, sa i përket ligësisë; disa janë më të këqij se të tjerët.

– “... *Ora e Kijametit ...*” – Pra, Dita e Kijametit. Quhet kështu, sepse ajo është katastrofë, e çdo katastrofë e madhe quhet (në arabisht) “*orë*” (çast), si për shembull: erdhi ora jote, gjëma jote.

– “... *ata që do t’i kapë Ora e Kijametit gjallë ...*” – Kjo duhet sqaruar, sepse nga Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) një hadith tjetër është përcjellur: “Një grup i kapur në mënyrë të qartë pas së vërtetës do të vazhdojë të mbetet dhe nuk do të cenohen nga ata që i kundërshtojnë, derisa të bëhet Kijameti.” Atëherë, cili është komenti?

Shprehja “derisa të bëhet Kijameti” do të thotë “derisa të afrohet Kijameti”, sepse Kijameti realisht do të ndodhë kur mbi tokë të jenë më të këqijtë e krijesave. Para kësaj ngjarjeje, Allahu do të dërgojë një erë, e cila do të marrë shpirtrat e të gjithë besimtarëve, e kështu kanë për të mbetur më të këqijtë, mbi të cilët do të bëhet Kijameti.

– “... *dhe ata të cilët i bëjnë varrezat xhami.*” – Pra, edhe këta janë krijesat më të këqija, edhe nëse nuk kryejnë idhujtari, por bëjnë diçka që të çon në idhujtari, sepse mjetet gjykohen si qëllimet e tyre, edhe nëse janë në shkallë më të ulët; ato marrin gjykimin e qëllimit të tyre, në shikimin tërësor. Nëse diçka është mjet për realizmin e një detyre, atëherë edhe ajo vetë është detyrë, e nëse objektivi është haram, edhe mjeti që të çon atje bëhet haram.

Njerëzit më të këqij sipas këtij hadithi, janë dy syresh:

- 1- ata që do t’i kapë çasti i Kijametit të gjallë;
- 2- ata që i bëjnë varrezat xhami.

Hadithi tregon se njerëzit ndryshojnë në raport me të keqen,

¹ *Merfuun* quhet hadithi që i atribuohet Profetit – (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

² Transmeton Ebu Hatim ibn Hibani në “Sahihun” e tij dhe Ahmedi. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

ashtu siç ndryshojnë edhe në raport me të mirën: disa janë më të këqij se disa të tjerë. Allahu i Lartësuar thotë: “Tek Allahu ata kanë shkallë të ndryshme; Allahu i sheh të gjitha veprat që bëjnë ata.” (Ali Imran, 163).

Ndryshimet mund të jenë në sasi dhe në formë. Kështu, ai i cili fal dy rekatë namaz, nuk është si ai i cili fal katër, dhe ai që falet me përpulshmëri, ndjeshmëri e me zemër të përqendruar, nuk është si ai që falet i shkujdesur.

Ndryshimi mund të jetë edhe në llojet e adhurimit: *farz*-et, për shembull, janë më të vlefshme se *nafil*-et. Po kështu, namazi është më i vlefshëm se sadakaja, sepse namazi është vepra më e mirë fizike.

Këto argumente flasin për drejtimin e *Ehli Sunetit dhe Xhematit*. Veprat ndryshojnë, madje edhe besimi. Ndonjëherë njeriu e ndjen shkallën e lartë të besimit, si kurrë herë tjetër. E ç’mund të thuhet për dallimin mes dy njerëzve të ndryshëm? Sigurisht, ndryshimi është më i madh.

Përmbledhje

Është detyrë largimi nga idhujtaria dhe rrugët që të çojnë atje. Duhet të tregohemi të rreptë, gjithashtu, ndaj çdokujt që adhuron Allahun pranë varrit të ndonjë njeriu të mirë.

Fjala “adhurim”, e përdorur në titull, përfshin namazin dhe adhurimet e tjera. Hadithet që autori ka sjellë janë për namazin, por duket se ai është marrë si shembull për adhurimet e tjera, sepse kushdo që mendon se dhënia e sadakasë pranë një varri të caktuar është më e mirë se në një vend tjetër ngjan me ata që i bëjnë varret xhami, pasi mendon se ky vend ose personi që është brenda në varr ka cilësi që e bëjnë më të vlefshëm se të tjerët. Dijetari këtu ka bërë një përgjithësim, ndërsa argumenti i dhënë është i veçantë.

Dobitë e temës

- Qëndrimi i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ndaj atyre që ndërtojnë faltore mbi varret e njerëzve të mirë

dhe adhurojnë Allahun në to, qoftë edhe me nijet të mirë.

Ky qëndrim është pikërisht mallkimi i tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për këtë kategori.

Thuhet “... qoftë edhe me nijet të mirë”, sepse gjykimi, në këtë rast, lidhet me atë që duket nga vepra. Kjo punë nuk ka nevojë për nijet, sepse atë e tregon veprimi.

Nijeti ndikon në plotësimin e veprave të mira, në veprat që njeriu nuk ka mundësi t’i kryejë, por që, gjithsesi fiton shpërblimin e tyre. Ndryshe është çështja e mësipërme; ajo nuk varet nga nijeti. Edhe nëse adhuron Allahun në një faltore të tillë, edhe nëse me ndërtimin e saj synon afrimin tek Ai, pasi dihen pasojat e kësaj vepre. Ky rast është i krahasueshëm me ndalimin që i është bërë përngjasimit me jomuslimanët edhe nëse qëllim nuk është i tillë, ndërkohë që disa njerëz nuk e kanë të qartë dhe mendojnë se ky përngjasim është i ndaluar vetëm atëherë kur ai synohet. Kjo do të thotë se veprat që ngjajnë me ato të jomuslimanëve kanë të njëjtin gjykim, qoftë apo jo me qëllim. Përngjasimi, thonë disa dijetarë, bëhet edhe kur veprat kanë përputhje vetëm nga ana e jashtme, pavarësisht nga nijeti. Po a bie ndesh kjo me parimin se: “Vërtet, veprat vlerësohen sipas qëllimit.”? Jo, pasi në rastin kur për veprimin ka një dispozitë ligjore, ai do të trajtohet sipas kësaj dispozite, qoftë edhe nëse nuk kryhet me këtë qëllim, siç është për shembull *dhihar*-i,¹ imoraliteti e të tjera të ngjashme.

➤ Ndalimi i skulpturave dhe rreptësia ndaj kësaj vepre.

Kjo kuptohet nga fragmenti i hadithit: “... bënin këto figura ...”, sidomos kur kanë qenë njerëz të nderuar për çështje të kësaj bote, si: udhëheqës, etër apo vëllezër, ose për çështje fetare, si: njerëz të mirë, Profetë, e të ngjashëm.

➤ Rëndësia e madhe që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-

¹ *Dhihar* quhet rasti kur burri i quan të paligjshme marrëdhëniet seksuale me të shoqen, duke i thënë asaj: “Ti për mua je si shpina e nënës sime”. Për *dhihar*-in flasin ajetet e para të sures Muxhadele.

lem) i kushtoi kësaj çështjeje. Ai e sqaroi atë gjatë shpalljes së tij, e sqaroi përsëri pesë net para vdekjes, e më pas e përsëri kur ishte në pragun e vdekjes duke mos u mjaftuar me çfarë kishte thënë më parë.

Kjo tregon përkushtimin e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për ruajtjen e teuhidit, si një nga çështjet më të rëndësishme. Ai ka qenë thelbi i thirrjes së Profetëve, sepse është adhurimi më i madh.

Gjynahet, sado të mëdha që të jenë, janë më të lehta se idhujtaria. Ibn Mesudi ka thënë: “Të betohem në Allahun duke gënjyer, është më e dashur për mua sesa të betohem në dikë tjetër, duke thënë të vërtetën.”¹, sepse betimi në dikë tjetër, është formë politeizmi, kurse betimi në Allahun duke gënjyer, është gjynah, por është më i lehtë se idhujtaria.

Ne i këshillojmë vëllezërit tanë muslimanë të kenë kujdes ndaj angazhimit të tepërt me dynjanë, derisa harrojnë qëllimin për të cilin janë krijuar, duke iu përkushtuar asaj që është krijuar për ta. Sot gjen shumë njerëz të angazhuar me çështjet dhe gjërat e kësaj bote, me mendjen e pushtuar prej tyre, madje edhe në gjumë. Kjo, në fakt, është një lloj idhujtarie, pasi rrjedhon në shpërfillje ndaj Allahut të Lartësuar. Për këtë arsye, Profeti e ka quajtur “robëri” një veprim të tillë: “Ka dështuar robi i dinarit, ka dështuar robi i argjendit, ka dështuar robi i veshjes së bukur, ka dështuar robi i shtresës së butë ...”.²

Nëse njeriu i drejtohet Allahut me zemrën dhe trupin e tij, do ta marrë patjetër pjesën që i është caktuar për këtë botë. Kjo botë është një mjet dhe jo qëllimi final. Kush e bën atë qëllimin kryesor, ka dështuar. Si mund ta bësh atë qëllimin kryesor, kur ti nuk e njeh rolin tënd në të? Si mund ta bësh atë qëllimin kryesor, kur gëzimet e saj shoqërohen me hidhërime? Një poet thotë:

Një ditë është kundër nesh, tjetra në favor,
Një ditë sterrë e zezë, tjetra e bardhë si borë.

Si përfundim, themi se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u dërgua për të konsoliduar teuhidin, prandaj ai u përkushtua në

¹ Abdurr-Rrezaku dhe Tabarani në "El-Kebir". Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

² Transmeton Buhariu.

mbylljen e të gjitha dyerve që të çojnë në politeizëm. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) na paralajmëroi tri herë për rrezikun e kthimit të varreve në faltore: së pari, gjatë gjithë jetës së tij, së dyti pesë net para vdekjes dhe, së treti në prag të vdekjes.

- Ndalimi i kësaj veprë te varri i tij, para se varri të ekzistonte.

Kjo kuptohet nga hadithi: “Mos i bëni varret faltore ...”. Nuk ka dyshim se varri i tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) përfshihet në këtë ndalim, madje ai është i pari.

- Kthimi i varreve në faltore është traditë e çifutëve dhe e të krishterëve me varret e Profetëve të tyre.

Kjo del nga fragmenti i hadithit, që thotë “... i bënë varret e Profetëve të tyre faltore.” Sa i lig është ai që ndjek çifutët dhe të krishterët, duke u përngjarë në veprat e tyre të shëmtuara.

- Mallkimi që i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u ka bërë atyre.

Ai ka thënë: “... Mallkimi i Allahut qoftë mbi judejtë dhe të krishterët ...”

- Qëllimi i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte të na paralajmëronte në lidhje me varrin e tij.

Ky përfundim del nga fjala e Aishes (*radijallahu anha*): “Kështu ai tërhoqi vërejtjen për të keqen e veprimit të tyre”, domethënë, për atë çka bënë çifutët dhe të krishterët me varret e Profetëve të tyre.

- Shkaku i mosnxjerrjes së varrit të Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nga dhoma.

Kjo mësohet nga thënia e Aishes (*radijallahu anha*): “Të mos ishte

kjo drojë, atëherë varri i tij do të bëhej jashtë shtëpisë, por ai druante se mos bëhej faltore.” Është edhe një shkak tjetër: lajmërimi nga ana e vetë Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) se çdo Profet është varrosur aty ku ka ndërruar jetë. Nuk ka ndonjë pengesë që për një gjykim të ketë dy arsye, ashtu siç nuk ka ndonjë pengesë që për një shkak të ketë dy gjykime

➤ Kuptimi i kthimit të varreve në faltore.

Më lart thamë se kjo ka dy kuptime: a) të ndërtohet xhami mbi varre; b) t’i bësh ato vendfalje për namaz. Madje, ai që falet në to, edhe nëse nuk i ka bërë vendfalje, gjykohet sikur i ka kthyer në xhami, sipas domethënies së përgjithshme.

➤ Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka përmendur bashkë njerëzit që i bëjnë varret vendfalje dhe ata mbi të cilët do të bëhet Kijameti. Kështu, ai ka treguar edhe rrugën që të çon në politeizëm, edhe përfundimin që sjell kjo rrugë.

Që do të thotë se Profeti (‘alejhis-selam) ka paralajmëruar nga shirku para se të vdesë. Ndërsa ata mbi të cilët do të bëhet Kijameti do të jenë më të këqijtë e krijesave, do të jenë qafirë, ndërsa ata që i kthejnë varrezat në faltore, kanë bërë shkakun që të çon në një përfundim të tillë, domethënë që të çon në idhujtari e në kufër.

➤ Paralajmërimi i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) pesë net para vdekjes, është kundërpërgjigje e fortë ndaj dy grupeve, që janë më të këqijtë e bidatbërësve, madje, disa dijetarë i përjashtojnë edhe nga shtatëdhjetë e dy grupet e muslimanëve. Ata janë *rafiditë*¹ dhe *xehmitë*. *Rafiditë* qenë nismëtarë të

¹ Fjala “rafida” do të thotë: refuzues. Origjina e emërtimit të tyre si “rafida” është marrë nga koha e Zejd Ibn Aliut. Shiat u ndanë në; rafida dhe zejdiye. Kur Zejdi u pyet për Ebu Bekrin dhe Umerin, ai i lavdëroi. Atëherë një grup e refuzuan. Ai u tha atyre ju më refuzuat mua. Për këtë arsye u quajtë “rafida-refuzues për shkak të refuzimit që i bënë atij. Ndërsa të tjerët që nuk e

politeizmit nëpërmjet adhurimit të varreve dhe të parët që mbi to ndërtuan faltore.

Autori (Allahu e mëshiroftë!) flet për *rafiditë*, *xhehmitë* dhe gjykimin për ta, para se t'u përmendë emrat me qëllim që të nxisë kureshtjen e lexuesit se cilët janë këta. Kur niset me gjykimin dhe përshkrimin e përgjithshëm, pa përmendur emrin konkret, kjo shkakton interesim më të madh. Nëse ai do të thoshte që në fillim: “është kundërpërgjigje ndaj *rafidive* dhe *xhehmive*, lexuesit do t'i humbte kureshtja. Sa i përket përshkrimit të tyre, ata janë bidatçinjtë më të ndyrë, ndërsa gjykimi për ta, sipas disa dijetarëve, është se ata nuk futen as te shtatëdhjetë e dy grupet e muslimanëve.

Dy fjalë për *rafiditë* ose *shittët*:

Er rafid quhet ai që nuk pranon diçka, refuzues. Janë quajtur kështu, sepse ata e refuzuan Zejd Ibn Ali Ibn Husejn Ibn Ali Ibn Ebu Talibin, kur e pyetën atë se ç'mendim kishte për Ebu Bekrin dhe Omerin (r.a.). Ai i lavdëroi, duke i quajtur si dy ministrat e gjyshit¹ të tij. Ata e refuzuan dhe e braktisën atë, edhe pse para kësaj kishin qenë përkrahës të tij. Kur Zejdi tha të vërtetën, e cila ishte në kundërshtim me dëshirën e tyre, u larguan prej tij – Allahu na ruajtë! – e kështu u quajtën *rafidi*.

Zanafilla e sektit të tyre është Abdullah Ibn Sebe, një çifut i shtirur si musliman. Ai shfaqti përkrahjen e tij për *Alul Bejt*-in,² duke i lavdëruar ata më shumë seç duhet, me qëllim që t'i largonte njerëzit nga Islami e ta prishte fenë, siç bëri Pali me krishterimin, duke u hequr si i krishterë. Për herë të parë, bidati u shfaq në kohën e Ali Ibn Ebu Talibit, kur Abdullah Ibn Sebe i shkoi këtij të fundit e i tha: “Ti je Zoti i vërtetë!”. Allahu na ruajtë! Aliu (r.a.) urdhëroi të hapej një hendek, të mblidheshin dru dhe të ndizej një

refuzuan u quajtën zejdije, për lidhjen e tyre me të.

¹ Flitet për Pejgamberin (sal-IAllahu 'alejhi ue sel-lem).

² *Alul bejt* do të thotë familja e Pejgamberi (sal-IAllahu 'alejhi ue sel-lem), ku pa dyshim përfshihet edhe Aliu dhe dhurijeti i tij, por Abdullah Ibn Sebe' kishte për qëllim vetëm Aliun, Fatimen, Hasenin, Husejnin dhe dhurijetin e këtij të fundit (radij-Allahu 'anhum). Pra, në fakt në *Alul Bejt* hyjnë të gjitha gratë e Profetit, familja e Aliut, Akilit, Xhaferrit dhe Abasit, të cilëve u është ndaluar marrja e zekatit.

zjarr. Më pas, ata që mendonin kështu, i dogji në zjarr. Por thuhet, gjithashtu, se Abdullah Ibn Sebe u arratis në Egjipt, ku edhe përhap bidatin e tij, por Allahu e di më mirë.

E rëndësishme është që Aliu (r.a.) u përball me diçka që nuk mund ta pranonte. Kjo ishte arsyeja që i dogji në zjarr ata që e quajtën Zot. Por ky grup i poshtër filloi të shtohet, sepse ata i fshehin shenjat dhe besimin e vet. Ky sekt është më i rrezikshmi ndaj Islamit, sepse ata hiqen si muslimanë, ftojnë në Islam dhe zbatojnë dispozitat e tij të dukshme, siç është ndalimi i alkoolit, por në thelb janë krejt kundër tij. Ata besojnë se imamët e tyre janë të zotë të rregullojnë çështjet e gjithësisë, besojnë se ata janë më të mirë se Profetët, melekët dhe evlijatë, dhe se janë në një gradë që nuk i arrin as ndonjë melek e as ndonjë Pejgamber. E si pra, mund t'u pranohet këtyre pretendimi se janë muslimanë?! Për këtë arsye, shejhu i Islamit, në shumë nga librat e tij thotë se ata janë njerëzit më të dëmshëm ndaj Islamit. Ata braktisën xhamitë dhe mirëmbajnë tyrbet, vendet e sajuara. Ata thonë se falen me xhemat vetëm pas një imami të pagabueshëm, por që tani nuk ka të tillë. Ata janë të parët që kanë ndërtuar tyrbe mbi varreza, siç thotë shejhu: “Ata flasin rëndë ndaj pasuesve më të mirë të Profetit, ndaj Ebu Bekrit dhe Omerit, duke i akuzuar për hipokrizi dhe për vdekje të ngjashme me Abdullah Ibn Ubej Ibn Selulin e të tjerë si ai, Allahu na ruajtë!”

Tani që u njohe me besimin dhe rrugën e tyre, vlerësoji vetë se ç'janë.

Dy fjalë për xhehmitë:

Ata janë pasuesit e Xhehm Ibn Safuanit. Bidati i parë i tij ishte mohimi i cilësive të Allahut, kur tha: “Allahu nuk e ka bërë Ibrahimin *khalil* - mik të ngushtë - dhe nuk i ka folur Musait me fjalë.” Ai mohoi Dashurinë dhe të Folurën e Allahut. Ky bidat filloi të përhapet e të zgjerohet, duke u përfaquar nga grupe të tjera, si: *mutezilët* dhe të mëvonshmit e *rafidive*, të cilët në fillim kanë qenë përngjasues të cilësive të Allahut me ato të krijesave. Për këtë, dijetarët kanë thënë se i pari që njihet si përngjasues, është Hisham Ibn el Hakem er Rafidi, që më pas kaloi nga përngjasimi në mohim të cilësive të Zotit. Kështu, edhe ata nisën të mohojnë cilësitë e

Allahut.

Xhehm Ibn Safuani e mori bidatin e tij nga Xhad Ibn Derhemi, Xhadi nga Eban Ibn Sem'ani, Ebani nga Taluti e ky i fundit nga Lebid Ibn el Asem el Jehudi, i cili i bëri magji Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Kësisoj, bidati i mohimit të cilësive të Zotit e ka prejardhjen nga çifutët.

Xhehm Ibn Safuani u rrit në zonën e Horasanit, ku kishte shumë *sabii*, adhures të yjeve dhe filozofë, prej të cilëve mori shumë ide dhe teori. Edhe ky bidat është një përzjerje hebraizmi, sabiizmi e paganizmi, e kështu u përhap te muslimanët.

Xhehmijet janë mohues të cilësive të Zotit. Disa prej tyre mohojnë edhe emrat e Zotit bashkë me cilësitë. Emrat që Allahu ia atribuon Vetes së Tij, i konsiderojnë si përkthime joreale, ose thonë se janë emra të disa krijesave të Tij. Sipas tyre emri *Es Semi* (Dëgjues), do të thotë: Krijuesi i dëgjimit jo për Vetën e Tij.

Disa të tjerë kanë mohuar madje të thuhet që Allahu ekziston apo nuk ekziston, duke thënë se nuk lejohet t'i pohojmë Atij ndonjë atribut. Po të themi – sipas tyre – që ekziston, e kemi përngjasuar Atë me gjërat që ekzistojnë, e po të themi që nuk ekziston, e kemi përngjasuar me mosekzistencën. Atëherë, themi – deklarojnë ata – se nuk është as qenie, as mosqenie. Kështu, ata kundërshtojnë me kryeneçësi logjikën dhe përgënjeshtrojnë argumentet fetare.

Ideja e tyre është e pamundur, sepse ekzistenca qëndron përballë mosekzistencës ashtu siç përballen dy gjëra krejt të kundërta, të cilat është e pamundur t'i eliminosh apo t'i bashkosh, sepse patjetër duhet të ekzistojnë secila më vete. Përkthimi i Allahut me këtë mënyrë, sipas rregullit të tyre, është përngjasim i Tij me të pamundurën.

Qëndrimi i tyre në çështjet e kaderit është si ai i *xhebrive*, sepse thonë që njeriu është i detyruar me forcë për veprat e tij, pra, vepron pa pasur mundësi zgjedhjeje. Nëse fal namaz për shembull, është i detyruar ta bëjë këtë, nëse bën një krim është gjithashtu i detyruar, e kështu me radhë. Kështu, ata mohojnë urtësinë e Allahut, sepse po të ishte i detyruar njeriu në veprat e tij, atëherë nuk do të kishte urtësi në vendosjen e shpërblimit dhe dënimit, por Allahu do të ndëshkonte apo e shpërblente njeriun thjesht sipas dëshirës së Vet. Në këtë mënyrë, ata mohojnë që njeriu meriton të

lavdërohet dhe qortohet. Pra, nuk mund ta lavdërosh apo ta qortosh dikë, sepse mëkatari ka qenë i detyruar ta bëjë gjynahun, ashtu si edhe mirëbërësi veprën e tij të mirë.

Atyre u kthehet përgjigje e u thuhet se kështu ata pohojnë që Allahu është më i padrejti i të padrejtëve, sepse si mund të dënohet mëkatari për veprën e tij, kur ai ka qenë i detyruar ta bëjë, e si të shpërblehet mirëbërësi, kur ai thjesht ka qenë i detyruar ta bëjë? Kjo do të thotë se Allahu shpërblen dhe ndëshkon ata që nuk e meritojnë, e kjo është padrejtësi.

Ata pretendojnë se nuk është padrejtësi, sepse padrejtësi ka veç atëherë kur vepron diçka që nuk e ke në zotërim, ndërsa ky është veprim i Sunduesit në zotërimin e Tij, me të cilin Ai bën çfarë të dojë. Por ne përsëri i përgjigjemi se kjo nuk është e vërtetë, sepse Sunduesi, që ka cilësi të përsosura, nuk mund ta shkelë premtimin e Tij, kur thotë: “Ndërsa ai që bën vepra të mira dhe është besimtar, nuk do të druajë nga padrejtësia, as nga pakësimi i asaj që i përket.” (Ta Ha, 112).

Ndërsa në çështjet e besimit dhe fesë, *xhehmitë* janë të drejtimit *murxhi*. Ata thonë se besimi është thjesht njohja e Krijuesit, me përshkrime që i mohojnë cilësitë. Sipas rrugës së tyre, fjalët dhe veprat nuk janë pjesë e besimit, dhe besimi as nuk shtohet e as nuk pakësohet. Nga këto parime rrjedh se njeriu më i keq dhe ai më i mirë, sipas tyre, në besim janë të barabartë. Madje ata thonë se Faraoni ishte besimtar me iman të plotë, njëlloj si Xhibrili, por Faraoni mohoi dhe u bë qafir vetëm se pretendoi që ishte perëndi.

Sekti i tyre është ndër më të këqijtë. Më poshtë akoma është sekti *rafidi*, derisa shejhu i Islamit thotë: “Bidati, i gjithë, e ka zanafillën te *rafiditë*.” Ata janë burimi i ngatërresave në Islam, prandaj autori thotë më tej: “... disa dijetarë i kanë përjashtuar nga shtatëdhjetë e dy grupet e muslimanëve.” Dihet që ky umet do të ndahet në shtatëdhjetë e tre grupe. Të gjithë do të jenë në Zjarr, me përjashtim të njërit: atij që i përmbahet rrugës së Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe të shokëve të tij.

Të drejtën ka thënë autori (Allahu e mëshiroftë!) për këta dy grupe: *rafiditë* dhe *xhehmitë*, se janë më të këqijtë e bidatçinjve. Xhehm Ibn Safuanin e vrau Seleme Ibn Ahuezi, komandant në varësi të Nasër Ibn Sejjarit, sepse ai kishte shfaqur dhe përhapur

ide të tilla.

Autori thotë: “*Rafiditë* genë nismëtarë të politeizmit nëpërmjet adhurimit të varreve, dhe të parët që mbi to ndërtuan faltore”. Kjo tregon se është detyrë të ruhesh prej bidatit të tyre. Bidati, pa dyshim, vjen shkallë-shkallë, prandaj njeriu duhet të jetë i kujdesshëm ndaj tij, duke qenë pasues i brezave të parë të mirë.

- Sprova që përjetoi Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në agoninë e vdekjes.

Provë e cila duket në këto fjalë: “... i Dërguari i Allahut e largoi shaminë nga fytyra e vet. Kur u mërzit me të, e hoqi fare ...”. Kjo dëshmon për vështirësitë e vdekjes. Agonia e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte dyfish më e rëndë se e njerëzve të tjerë, dhe kjo qe prej urtësisë së Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) provoi mjaft mundime e lëndime gjatë thirrjes së tij. Po kështu, edhe sëmundjet që e prekën ishin dyfish më të rënda. Urtësia ishte që ai të arrinte gradën më të lartë të durimit, sepse kur njeriu provohet me një të keqe dhe duron, ai ngrihet më lart në gradë. Durimi është vetë një gradë e lartë, që arrihet vetëm me anë të shkaqeve, ndër të cilët është edhe sprovimi. Kështu, njeriu duhet të bëjë durim, duke llogaritur shpërblimin tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), derisa të arrijë gradën e “durimtarëve”.

- Nderimi që i është bërë atij me gradën “Mik i Allahut”.

Këtë na e tregon hadithi: “Me të vërtetë Allahu më ka bërë mua *khalil*, ashtu siç e bëri Ibrahimin.” Nuk ka dyshim se ky është një nder i madh, sepse ne nuk njohim tjetër që të ketë arritur këtë gradë, veç të Dërguarit tonë (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe Ibrahimit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

- Dëshmia se grada “*khalil*” është më e lartë se “*habib*”.

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e donte Ebu Bekrin më shumë se çdo njeri tjetër, por në të njëjtën kohë ai e mohoi që ta

kishte *khalil*. Kjo tregon se dashuria për *khalil*-in është më e lartë se për *habib*-in. Deklarimi nuk vjen vetëm nga ky hadith, por edhe nga të tjerë shoqërues. Në një hadith tjetër, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka deklaruar qartë që Ebu Bekri ishte burri më i dashur për të, ndërsa këtu ka thënë: “... sikur të bëja nga umeti im një “*khalil*”, do të bëja Ebu Bekrin ...”.

➤ Dëshmia se Ebu Bekri ishte më i miri ndër sahabët.

Kjo është marrë nga fjala e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... sikur të bëja nga umeti im një *khalil*, do të bëja Ebu Bekrin ...”. Nëse dikush tjetër do të ishte më i mirë për të Dërguarin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), do ta meritonte më shumë këtë.

Çështje tjetër me rëndësi është se njeriu vlerësohet nga besimi dhe veprat e mira, e jo nga prejardhja. Nëse do të merrej si kriter prejardhja, sahabët më të mirë do të ishin Hamza Ibn Abdul Mutalibi (r.a.), Abasi (r.a.), Ali Ibn Ebu Talibi (r.a.) apo të afërm të tjerë të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

➤ Aludimi për *halifatin* e Ebu Bekrit.

Kjo nuk është deklaruar hapur, por është nënkuptuar. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk ka thënë që Ebu Bekri do të ishte *halifi* pas tij, por kur tha: “... sikur të bëja nga umeti im një *khalil*, do të bëja Ebu Bekrin”, u tregua qartë se ai (r.a.) ishte njeriu më i dashur për Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), rrjedhimisht njeriu që e meritonte më tepër kryesimin e *halifatit*.

Tema 21

Argumentet për faktin se teprimet me varret e njerëzve të mirë, i bëjnë ata të kthehen në idhuj që adhurohen në vend të Allahut të Lartësuar.

Kjo temë lidhet me kapitullin e mëparshëm, sepse shfaqjet ekstreme nëpër varret e njerëzve të mirë, i bëjnë ata idhuj që adhurohen në vend të Allahut. Pra, çështja shkon deri në adhurimin e varreve ose të të vdekurve.

Shfaqjet ekstreme mund të jenë në aspektin e nderimit ose në ofendimit, por këtu flitet për nderimin.

Përkundrajt varreve kemi dy detyra:

1. të mos i përçmojmë, për shembull duke u ulur mbi to;
2. të mos e teprojmë me kujdesin dhe nderimin e tyre.

Në “Sahihun” e Muslimit, përcillet se Ali Ibn Ebu Talibi i tha Ebu Hejxh el Esedit: “Po të dërgoj me atë misjon që më dërgoi mua i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Të mos lësh figurë frymori pa prishur dhe as varr të ngritur pa e rrafshuar.” “Varr i ngritur” quhet ai i cili dallohet nga të gjitha varret e tjera. Ai patjetër duhet të shembet e të barazohet me të tjerët, që të mos mendohet se i vdekuri aty ka ndonjë cilësi të veçantë, qoftë edhe pas një kohe të gjatë, sepse kjo është rruga e ekstremizmit.¹

¹ Në fe nuk lejohet që varri të ngrihet mbi një pëllëmbë, ashtu siç nuk lejohet betonimi, gurëzimi, çimentimi, mermerizimi i varrit dhe as ngritja lart e tij. Ai varr që është i ngritur duhet të shmbet dhe të barazohet me varret e tjera. Por këtë gjë e bëjnë vetëm autoritetet ku veprohet sipas ligjit të shariatit (shën. për).

– “... *njerëzve të mirë ...*” – Ky përkufizim përfshin Profetët dhe evlijatë, madje edhe ata që janë në gradë më të ulët.

– “... *idhuj ...*” – Kështu quhet çdo objekt adhurimi. Mund të jetë edhe vetëm statujë, por nga teksti duket se është fjala për çdo gjë që adhurohet veç Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), edhe nëse nuk është statujë, sepse varret mund të jenë pa statuja, e megjithatë ato adhurohen.

Në adhurimin e Allahut është detyrë njësimi i Tij. Nëse ky adhurim shoqërohet me adhurimin e dikujt apo diçkaje tjetër, atëherë për Allahun ai nuk është i vlefshëm. Në një hadith *kudsi* përcillet se Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) ka thënë: “Unë nuk e dua atë adhurim që ma kushtojnë të përpjesëtuar me të tjerë. Kur dikush e bën një vepër njëherazi për Mua dhe për dikë tjetër, Unë e lë atë dhe politeizmin e tij.”¹

Imam Maliku shënon në librin e tij “*Muvata*” se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “O Allah! Mos e bëj varrin tim objekt adhurimi! Allahu është mjaft i zemëruar me ata njerëz që i kanë kthyer varret e Profetëve të tyre në faltore.”²

“*Muvata*” është një libër mjaft i njohur. Ai është ndër librat më korrektë, sepse autori – Allahu e mëshiroftë! – i ka dhënë shumë rëndësi saktësisë së vargut të përcjellësve të haditheve, i cili qëndron më lart se ai i Buhariut, për shkak se afrohet më tepër te Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Sa më afër të shkojë vargu i përcjellësve te Pejgamberi, aq më i saktë është hadithi. Në këtë vepër ka hadithe, fjalë të sahabëve, si dhe fjalë e kërkime të vetë imamit. Veprës i kanë bërë analizë shumë dijetarë, ndër të cilat më e zgjeruara dhe më e mirë është “*Et-Temhid-i*” i Ibn Abdul Berrit.

– “... *O Allah! Mos e bëj varrin tim objekt adhurimi! ...*” – Profeti

¹ Transmeton Muslimi.

² Transmeton Maliku në 'Muvata'. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

(sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ia kërkoi këtë Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), sepse bashkësitë fetare para nesh, i kthyen varret e Profetëve të tyre në faltore, madje hyjnizuan edhe njerëzit e mirë. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i kërkoi Zotit që të mos e bënte varrin e tij objekt adhurimi, sepse thirrja e tij ishte krejtësisht për monoteizëm dhe kundër politeizmit.

– “... Allahu është mjaft i zemëruar ...” – Pra zemërimi është i madh. Kjo është ndër atributet e vërteta të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), që nuk ngjan me zemërimin e krijesave as në formë, as në ndikim. Keqinterpretuesit thonë se zemërimi i Allahut është “hakmarrja ndaj atij që e kundërshton”, kurse disa të tjerë thonë se është “dëshira e hakmarrjes ndaj atij që e kundërshton Atë”. Ky është shtrembërim i kuptimit të vërtetë, sepse Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk thotë: “Allahu është hakmarrë”, por: “Allahu është zemëruar”. Ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e dinte shumë mirë si të shprehej, ashtu siç e dinte shumë mirë ndryshimin ndërmjet zemërimit të Allahut dhe hakmarrjes së Tij. Ai ishte këshilluesi më i mirë ndër njerëzit dhe më i dituri për Zotin e tij. Ai nuk mund të sillte fjalë, që kanë përmbajtje të kundërt me formën, duke u bërë maskues i së vërtetës; kjo është e pamundur.

Zemërimi nuk është hakmarrje dhe as dëshirë për hakmarrje. Zemërimi është një cilësi e vërtetë e Tij, që pranohet ashtu siç i përshtatet Madhërisë së Tij. Ai nuk përngjasohet me zemërimin e krijesave as në formë, as në ndikim.

Ka shumë ndryshime ndërmjet zemërimit të krijesave dhe zemërimit të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Së pari, kur zemërohen krijesat, u nxehet gjaku, ndërsa shejtani i fryn edhe më fort zjarrit që ndizet në zemër. Kurse zemërimi i Allahut nuk ka asgjë të përbashkët me këtë. I Lartësuarit thotë: “Asgjë nuk i shëmbëllen Atij; Ai është Gjithëdëgjuesi Gjithëshikuesi.” (Shura, 11).

Së dyti, zemërimi i njerëzve lë pasoja të padëshirueshme. Kur njeriu zemërohet, ai mund të thyejë enë, të ndajë gruan ose arrin deri aty sa edhe mund ta vrasë tjetrin. Ndërsa zemërimi i Allahut ka vetëm rezultate të mira, sepse Ai është më i Urti, që e vendos çdo gjë në vendin e vet. Nga zemërimi i Tij rrjedhin veç veprime të drejta, të përshtatshme, që ndodhin në vendin e duhur. Zemërimi i Allahut

nuk është si ai i krijesave, as në formë e as në ndikim.

Kur themi që Allahu zemërohet, nuk e përshekruajmë me cilësitë e krijesave, por me cilësi që tregojnë forcë dhe pushtet të plotë. Zemërimi dëshmon për fuqi, për hakmarrje dhe për pushtet të plotë të Tij. Zemërimi i Krijuesit është cilësi e përsosur, ndërsa zemërimi i krijesave është mangësi.

Shpjegimin e “zemërimit” nga ana e tyre si hakmarrje, e hedh poshtë fjala e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “Kështu, kur ata na zemëruan, Ne i ndëshkuam ata dhe i mbytëm të gjithë bashkë.” (Zuhruf, 55). Pra, shprehja “na zemëruan” nuk do të thotë se hakmarrja është zemërim, por një nga pasojat e zemërimit.

Dije se çdo njeri që shtrembëron tekstet hyjnore që flasin për cilësitë e Zotit, ndryshe nga qëllimi që kanë dashur të shprehin Allahu dhe Pejgamberi i Tij, patjetër do të përfundojë në rrëshqitje dhe shkatërrim. Ne jemi të detyruar të pranojmë informacionin që vjen në Kuran dhe Sunet, në lidhje me cilësitë e Allahut të Lartësuar, ashtu siç është ai: pa i përngjasuar me krijesat, të pacenuar nga të metat, pa i mohuar krejtësisht dhe pa u shtrembëruar kuptimet.

– “... me ata njerëz që i kanë kthyer varret e Profetëve të tyre në faltore.” – Që i kanë kthyer në faltore ose duke ndërtuar mbi to, ose duke falur namaz në to. Falja e namazit në varre konsiderohet si kthim i tyre në faltore, njëlloj si të ndërtosh mbi to.

Lind pyetja: A i është përgjigjur Allahu lutjes së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) që të mos e bënte varrin e tij vend që adhurohet, apo Urtësia e Tij kishte përcaktuar diçka tjetër? Ibn Kajimi thotë se po, i është përgjigjur. Nuk është thënë kurrë që varri i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është bërë objekt adhurimi, sepse ai është i mbrojtur me tri mure, e askush nuk mund t’i afrohet e ta bëjë objekt kulti, që ta adhurojë në vend të Allahut. As në histori nuk është dëgjuar kjo. Është e saktë se ka njerëz që e teprojnë me të, por ata nuk kanë arritur që ta kthejnë varrin në kult. Ndoshta ata adhurojnë Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), qoftë edhe nga larg, por vetë varrin e tij jo.

■ Ibn Xheriri përcjell, nëpërmjet vargut të tij të

transmetimit, nga Sufjani, ky nga Mensuri e ky nga Muxhahidi, se për ajetin: “A e keni parë Latin dhe Uzën?” (Nexhm, 19), ka thënë: “Lati (kur ishte gjallë) përgatiste ushqim për haxhinjtë, duke përzier elb të bluar me hurma e me gjëra të tjera. Pasi vdiq, ata qëndronin te varri i tij për ta lutur.” Edhe Ebu el Xheuzai përcjell se Ibn Abasi ka thënë që: “Ai përgatiste ushqim për haxhinjtë, duke përzier elb të bluar me hurma e me gjëra të tjera”

– “... A e keni parë ...” – Pjesëza “a” këtu shpreh nënçmim. Pyetja i drejtohet adhuruesve të statujave të Latit, Uzës e të tjerë. Pasi përmend ndodhinë e Miraxhit, si një nga shenjat madhështore të Tij: “Vërtet ai (Muhamedi) pa disa nga shenjat më madhështore të Zotit të tij!”, Allahu thotë: “A e keni parë Latin dhe Uzën?” Kjo do të thotë: Çfarë janë këto statuja përkundër shenjave madhështore që pa Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) natën e Miraxhit?

– “... Latin ...” – Thuhet se *El Lat* vjen nga fjala “*el ilah* – i adhuruar”. Në origjinë ky ka qenë emri i një burri, që përzinte bollgurin me dhjamë si ushqim për haxhinjtë. Pasi vdiq, njerëzit e nderuan duke u lutur pranë varrit të tij, e pastaj e bënë perëndi.

Kështu, origjina e emrit, në arabisht, vjen nga emri i ushqimit që ky njeri përgatiste për haxhinjtë. Ai përzinte elb të bluar me hurma e me gjëra të tjera. Në një variant tjetër përcillet se origjina e këtij emri është marrë nga fjala *el ilah* (hyjni). Gjithsesi, njerëzit e tepruan me varrin e tij, duke u justifikuar se ishte njeri bamirës, që përgatiste ushqim e ua jepte haxhinjve, derisa e hyjnizuan. Teprimi në varre i shndërroi ata në perëndi, që adhuroheshin veç Allahut.

Ky është një paralajmërim për rrezikun e teprimit me varret. Prej këtij rreziku, është ndaluar zbukurimi i tyre dhe ndërtimi mbi to. Kur Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dërgonte delegatë diku, i urdhëronte që të mos linin varr të ngritur pa e rrafshuar, ngase ai e dinte që, me kalimin e kohës, njerëzit thonë: po të mos kishte ndonjë cilësi të veçantë ky njeri, varri i tij nuk do të ishte ndryshe nga të tjerët. Kjo është arsyeja që varret duhet të jenë të njëjtë, pa dallim nga njëri-tjetri.

– “... *Lati (kur ishte gjallë) përgatiste ushqim për haxhinjtë, duke përzier elb të bluar me hurma e me gjëra të tjera. Pasi vdiq, ata qëndronin te varri i tij për ta lutur. ...*” – Kjo do të thotë se më pas ata nisën ta adhuronin si zot.

Ibn Abasi ka thënë: “Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka mallkuar vizitueset e varrezave, ata që i kanë kthyer ato në faltore dhe ata që i mbajnë të ndriçuara.”¹

– “... *i ka mallkuar ...*” – Mallkimi është largim nga mëshira e Allahut. Kjo do të thotë se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është lutur kundër tyre në formë mallkimi.

– “... *vizitueset e varrezave ...*” – Domethënë ato që shkojnë në varreza. Vizita e varrezave mund të jetë:

a) *Sunet*. E tillë është vizita e burrave, me qëllimin për të nxjerrë mësim prej tyre dhe për t’u lutur për të vdekurit;

b) *Bidat*, kur shkohet për t’u lutur atje Allahut, për të lexuar Kuran etj;

c) *Shirk*, kur bëhet për të lutur ata, për t’u kërkuar ndihmë etj.

Për t’u quajtur “vizitor”, mjafton të bësh vetëm një vizitë te varret, ndërsa në hadithin e Ebu Hurejres: “Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka mallkuar (*zuv-varat*) ato që vizitojnë shpesh dhe dendur varret”² fjala vjen në numrin shumë, domethënë se flitet për vizita të shumta.

– “... *ata që i kanë kthyer ato në faltore ...*” – Kjo është pjesa e hadithit që dëshmon për temën tonë, e që do të thotë: ata që ndërtojnë faltore mbi to. Më parë e sqaruar se kthimi i varreve në xhami ka dy kuptime: të falesh pranë tyre dhe të ndërtosh mbi to xhami.

– “... *ata që i mbajnë të ndriçuara.*” – E bëjnë këtë si shenjë madhërimi.

¹ Transmetojnë autorët e katër “Suneneve”. Sipas Albanit ky variant i hadithit është i dobët.

² Transmeton Ahmedi dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit ky variant i hadithit është i vërtetë.

Ky hadith tregon gjithashtu se grave iu ndalohet vizita e varreve. Ai e përshkruan veprën si mëkat të madh, sepse mallkimi është bërë vetëm për mëkatet e mëdha. Në hadith ndalohet kthimi i varreve në xhami dhe ndriçimi i tyre, të cilat përbëjnë mëkat të madh, për shkak të mallkimit që bie mbi ata që i kryejnë këto punë.

Lidhja me temën qëndron në faktin se të ndërtosh xhami mbi varre dhe t'i ndriçosh ato, është teprim, që të çon më pas në adhurimin e varreve.

Çështje për sqarim:

- Ç'lidhje ka ndërmjet vizitës së varreve nga gratë, kthimit të varreve në xhami dhe ndriçimit të vazhdueshëm të tyre?

Lidhja është e qartë. Femrat, për shkak të dobësisë së tyre, keqardhjes dhe mosdurimit, mund të kalojnë deri në adhurimin e të vdekurit. Kjo është arsyeja e pranëvënies së këtyre fakteve.

- A lejohet ndriçimi i varrezave me llamba elektrike?

Nëse njerëzit nuk kanë nevojë për ndriçim, për shembull kur varreza është e gjerë dhe kur varrimi (nëse bëhet natën) ka mbaruar, atëherë nuk ka përse të ndriçohet. Por kur varrimi bëhet natën, ndriçimi mund të lejohet, sepse është i nevojshëm. Megjithatë, mendimi ynë është se ndalohet në mënyrë absolute, për shkaqet e mëposhtme:

a) Diçka e tillë nuk është e nevojshme.

b) Kur është e domosdoshme, mund të kryhet me anë të dritave të makinave ose me mjete të tjera, që mund të merren me vete.

c) Nëse kjo çështje lihet e hapur, e keqja mund të marrë dhenë e nuk mund t'i vësh më fre. Nëse, për shembull, varroset dikush pas namazit të sabahut, drita mund të lihet ndezur jo qëllimisht, por që mund të merret nga të tjerët si një ritual fetar. Kjo është arsyeja që ne mendojmë se duhet të ndalohet plotësisht.

Nga ana tjetër, nëse në varreza ka ndonjë dhomë, ku vendosen, për shembull, pllakat e varreve, nuk ndalohet ndriçimi i saj, sepse dritat janë brenda dhe nuk kanë lidhje me varret.

E rëndësishme është që njeriu të largohet nga rrugët që çojnë në politeizëm, sepse e keqja ndoshta nuk rrezikon të tashmen, por ajo zhvillohet me kalimin e kohës. Siç shihet pra, çështja nuk është e thjeshtë.

▪ Në hadith tregohet se vizita e varreve nga gratë është haram dhe një ndër mëkatet e mëdha. Në lidhje me këtë çështje, ka tri qëndrime dijetarësh:

1- Vizita e varreve nga gratë është haram, madje gjynah i madh, nisur nga ky hadith.

2- Vizita e varreve nga gratë është e urryer, por jo haram. Ky është qëndrimi më i njohur në shkollën e Ahmedit, nga ndjekësit e tij, mbështetur në hadithin e Umu Atijes: “Jemi ndaluar për ndjekjen e xhenazeve, por kjo nuk është vendosur prerazi.”¹

3- Vizita e varreve nga gratë është e lejuar, sipas hadithit që tregon se, njëherë, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kaloi pranë një gruaje, e cila ishte duke qarë mbi një varr dhe i tha asaj: “Frikësoju Allahut dhe duro!” Ajo i tha: “Ik, largohu, se ty nuk të ka goditur ajo që më ka goditur mua.” Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u largua. Kur i thanë gruas se ai ishte i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ajo shkoi tek ai të justifikohej, por ai i tha: “Vërtet durimi duhet në momentet e para të goditjes.” Kështu, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e pa atë pranë varrit dhe nuk ia ndaloi vizitën, por e urdhëroi t’i frikësohej Allahut dhe të duronte.

Dëshmi tjetër është edhe hadithi i gjatë, në “Sahihun” e Muslimit, që vjen nga Aishja (*radijallahu anha*), e që thotë se i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) doli njëherë natën, shkoi te të vdekurit e varrosur në Bekia dhe u lut e kërkoi falje për ta. Ishte Xhibrili që e kishte urdhëruar të dilte natën. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) doli pa e parë Aishja (*radijallahu anha*), i vizitoi, u lut dhe u kthye në shtëpi. Pastaj i tregoi Aishes se si kishte ndodhur. Ajo e pyeti: “Çfarë të them, o i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), nëse shkoj e i vizitoj unë?” Ai i tha: “Thuaj: ‘Es-selamu alejkum, o banorë të varreve besimtarë e muslimanë ...’”. Fakti që Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i mësoi Aishes lutjen e vizitës së varrezave, provon se vizita nga gratë lejohet.

Unë kam dëgjuar edhe një mendim të katërt, që thotë se vizita e varreve nga gratë është *sunet*, ashtu si edhe për burrat, sipas hadithit të Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), që thotë: “Unë ju kam ndaluar më parë nga vizita e varreve, por tani vizitohet ato, se ju përkujtojnë botën tjetër.” Kjo thënie përfshin burrat dhe gratë,

¹ Transmeton Buhariu, Muslimi.

sepse Aishja (radijallahu anha), kur vizitoi njëherë varrin e vëllait të saj, Abdullah Ibn Ebu Mulejke i tha: “A nuk e ka ndaluar Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) vizitën e varreve?” Ajo i tha: “Më pas ai ka urdhëruar për këtë.”¹ Kjo tregon se ndalimi i parë është shfuqizuar.

I saktë është mendimi i parë, ndërsa për mendimet tjera themi se ai që është i qartë, nuk është i saktë, ndërsa ai që është i saktë, nuk është i qartë.

Së pari, pretendimi për shfuqizimin e urdhrit të parë nuk është i saktë, sepse ai mund të pranohet vetëm me dy kushte:

1- Nëse nuk mund të harmonizohen dy fakte të vërteta (që në pamje të jashtme duken si kontradiktore). Ndërkaq, harmonizimi këtu është i lehtë, pasi mund të thuhet se hadithi: “Unë ju kam ndaluar më parë nga vizita e varreve, por tani vizitojini ato ...”, është për burrat.

Kur fjalët e hadithit iu drejtohen burrave, a vlejnë edhe për gratë? Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme. Nëse themi se vlejnë, – që dhe është përgjigjja më e saktë, – kjo është si përfshirja e pjesës tek e tëra. Megjithatë, ka mundësi që një pjesë të veçohet nga e tëra, me gjykim të veçantë. Edhe në këtë rast, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka veçuar gratë nga ky gjykim, që do të thotë se urdhri i tij për vizitë ishte vetëm për burrat. Gratë janë përjashtuar me anë të mallkimit për vizitoret e varreve.

Fakt tjetër që e bën të papranueshëm shfuqizimin është pjesa e dytë e hadithit: “Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka mallkuar vizitueset e varrezave, ata që i kanë kthyer ato në faltore dhe ata që i mbajnë të ndriçuara.” Dihet se gjykimi për “ata që i kanë kthyer ato në faltore dhe ata që i mbajnë të ndriçuara” nuk është anuluar. Hadithi është një i tërë, prandaj pretendimi i shfuqizimit të një pjese pa pjesën tjetër, nuk qëndron. Atëherë, gjykimi është i pa shfuqizuar.

2- Të njohësh kronologjinë e ngjarjeve. Në këtë rast, ne nuk e dimë se kur është thënë hadithi i parë dhe kur e dyti. Nga ana tjetër, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk ka thënë: “Ju kam mallkuar”, por ka thënë: “Ju kam ndaluar ...”, dhe ndalimi

¹ Transmeton Hakimi. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

qëndron më ulët sesa mallkimi. Gjithashtu, thënia: “Ju kam ndaluar ...”, është për burrat, ndërsa mallkimi për vizitën e varreve është për gratë. Për këtë arsye, fjalët që iu drejtohen burrave, nuk mund t’i vëmë në zbatim edhe për gratë. Rrjedhimisht, pretendimi për abrogimin e hadithit është i pavlefshëm.

Së *dyti*, përgjigjja për hadithin e gruas që qante pranë një varri, është se ajo kurrsesi nuk kishte dalë për të vizituar varret, por se e kishte zënë një hall. Nga halli i madh, ajo nuk e kishte përmbajtur veten e të qëndronte në shtëpi, por kishte dalë të qante atje pranë varrit. Dhimbja për zemrën e saj kishte qenë e padurueshme, prandaj kishte shkuar të vajtonte jashtë, te varri i të birit. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e urdhëroi të bënte durim, pasi ai e dinte që ajo nuk kishte dalë për vizitë, por prej dhimbjes që po kalonte dhe prej humbjes së durimit. Hadithi nuk tregon qartë se ajo kishte dalë për të vizituar varrin, e rrjedhimisht, nuk mund të kundërshtohet diçka e qartë me diçka të paqartë.

Edhe te hadithi i Aishes (radijallahu anha), ajo e pyeti Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Çfarë të them?” dhe ai iu përgjigj: “Thuaj: ‘Es-selamu alejkum ...’”. A nënkupton kjo që lutja duhet të thuhet kur të kalosh rastësisht pranë varreve apo kur të shkosh atje për vizitë? Hadithi nuk e tregon qartë nëse Aishja duhet ta thoshte *dua*-në kur të shkonte si vizitore, pasi është edhe mundësia që ajo duhet ta thoshte kur të kalojë rastësisht pranë tyre. Nëse është e paqartë, atëherë ajo nuk mund të shërbejë për të kundërshtuar faktin e qartë.

Në hadithin tjetër me Aishen, Abdullah Ibn Ebu Mulejke nuk i përmendi asaj argumentin e mallkimit të vizitoreve të varreve, por atë të ndalimit të përgjithshëm të vizitës së varreve. Kjo duket edhe nga përgjigjja e Aishes. Ajo i tregoi për anulimin e ligjit të parë të ndalimit dhe hyrjen në fuqi të ligjit të ri të lejimit për burrat. Megjithatë, edhe sikur të pranojmë që Aishja (radijallahu anha) e solli si argument për lejimin e grave, themi se ajo konsiderohet njëlloj si dijetarët në përgjithësi, që do të thotë se fjala e saj nuk e rrëzon fjalën e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Ajo ka thënë: “Po të kisha parë, nuk do të vizitoja.” Ky është argument se ajo (radijallahu anha) ka dalë për t’u lutur për të, sepse nuk e pa

xhenazen e tij¹. Disa dijetarë kanë folur për këtë përcjellje nga Aishja (radijallahu anha) e kanë thënë se nuk është e saktë. Megjithatë, ne mbetemi në përcjelljen e parë, e cila është e saktë, pasi nuk tregohet se i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka anuluar atë. Gjithsesi, nëse ajo ka kuptuar se u lejohet grave të vizitojnë varret, mendimi i saj nuk mund të hedhë poshtë gjykimin e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Sqarimi i një çështjeje

Për vizitoret, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) përdor në hadith fjalën “*zuv-varat*”, që do të thotë “ato që vizitojnë shpesh dhe dendur varret”. Atëherë, a nuk është e mundur që ndalimi të jetë vetëm për vizitat e shpeshta?

Kjo është e mundur, por ama nëse i japim hadithit një kuptim të tillë, atëherë kjo bën të mos merret parasysh varianti tjetër që ua ndalon grave vizitën e varreve pa asnjë përcaktim, pasi në të thuhet: “*zairat -vizitueset*”, një formë kjo që nuk jep të kuptohet se flitet vetëm për vizitat e shpeshta dhe dendur sikurse në variantin e parë. Për më tepër që fjala “*zuv-varat*” mund të kuptohet edhe si “vizitor-e”, në numrin shumës, e jo si “vizitore të shpeshta”. “*Zuv-varat*” do të thotë se kur janë njëqind gra, shumëfishohet edhe vepra e tyre, dukuri kjo që haset në gjuhën arabe. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Kopshtet e përhershme të Xhenetit të Adnit, dyert e të cilit do të hapen për ta ...” (Sad, 50). Meqë dyert janë shumë, folja “do të hapen” është përdorur në formën që të jep idenë se dyert do të hapen disa herë, megjithëse e vërteta është që do të hapen vetëm një herë. E njëjta gjë ndodh edhe në ajetin: “... derisa kur të arrijnë tek ai, do të hapen dyert ...” (Zumer, 73).

Atëherë, më i saktë është gjykimi se grave iu ndalohet të vizitojnë varret dhe se ky veprim është mëkat i madh për to. Lexo për këtë edhe se çfarë ka thënë shejhu i Islamit Ibn Tejmije në “*Mexhmul Fetaua*”.

| Dobitë e temës

¹ Bëhet fjalë për vëllain e saj Abdurrahmanin, të birin e Ebu Bekrit.

- Përkufizimi i konceptit “idhull”.

Idhull do të thotë gjithçka që adhurohet përveç Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), qoftë bust, statujë, varr etj.

- Përkufizimi i konceptit “adhurim”.

Adhurimi është “përrulje dhe nënshtrim ndaj të adhuruarit, me frikë, shpresë, dashuri dhe madhërim”. Kjo del nga fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... Mos e bëj varrin tim idhull, që të adhurohet.”

- Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka kërkuar mbrojtje nga gjërat që druhej se mos ndodhnin.

Kjo shihet në lutjen e tij: “O Allah! Mos e bëj varrin tim objekt adhurimi!” Për këtë ai solli një fakt argumentues, që ishte shndërrimi i varreve të Profetëve të tjerë në faltore, kur tha: “Allahu është mjaft i zemëruar me ata njerëz që i kanë kthyer varret e Profetëve të tyre në faltore.”¹

- Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) bashkë me këtë lutje ka përmendur edhe shdërrimin e varreve të Profetëve në faltore.

Kjo shihet në thënien e tij: “Allahu është zemëruar shumë ndaj një populli që i kthyen varrezat e Profetëve të tij në faltore.”

- Dëshmia e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për zemërimin e madh të Allahut.

Ai thotë: “Allahu është mjaft i zemëruar ...”. Kështu pohohet se Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) zemërohet realisht, por ne nuk e

¹ Transmeton Buhariu.

dimë mënyrën se si ndodh kjo. Nga rrëfimi mësojmë gjithashtu se zemërimi i Allahut ndryshon, pasi në një hadith tjetër të saktë, që flet për ndërmjetësimin në Ditën e Gjykimit, thuhet: “Vërtet Zoti im sot është i zemëruar si asnjëherë më parë e që nuk do të jetë asnjëherë më pas.”¹

- Ky mësim është edhe më i rëndësishmi: njohja e formës së adhurimit të Latit, idhullit më të madh.

Kjo bëhet e mundur nga fragmenti: “Pasi ai vdiq, ata qëndronin te varri i tij për ta lutur”.

- Njohja e faktit se ai idhull ishte varr i një njeriu të mirë.

Kjo del nga thënia e tij: “përgatiste ushqim për haxhinjtë, duke përzier elb të bluar me hurma e me gjëra të tjera”. Ai ishte madhëruan tek ata, dhe në përgjithësi madhërohen vetëm ata që janë fetarë.

- “Lat” ishte emri i personit të varrosur, emër që është nxjerrë nga puna që ai bënte.

Ai përziante (në arabisht: *lat-te*) thekër të bluar me hurma e të tjera.

- Mallkimi i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për *zuvarat* -et e varreve (ato që i vizitojnë shpesh varret apo që dynden tek varret).

Autori (Allahu e mëshiroftël!) ka përmendur shprehjen “zuv-varat” për të treguar kujdes ndaj shprehjes tjetër (në të cilën është përmendur shprehja “zairat” vizitueset).

- Mallkimi i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për

¹ Transmeton Buhariu.

| ndriçuesit e varreve.

Kjo del nga thënia e tij: “... dhe ata që i mbajnë të ndriçuara.”

Këtu nuk është renditur një mësim i rëndësishëm që del nga kjo temë ai është: tejkalimi i kufijve me varret e njerëzve të mirë, i kthen ata në idhuj, siç ndodhi me varrin e Latit. Autori nuk e ka përmendur, ndoshta sepse është mjaftuar me shtjellimin e ndodhisë së Latit dhe pasojat e saj, dhe kjo quhet arsye.

Shënim: Nëse një grua shkon për të falur namaz në vendin ndërmjet varrit të Profetit dhe minberit, atje, meqenëse varri ndodhet afër, ajo mund ta përshëndesë me selam. A ka ndonjë problem? Jo, nuk ka ndonjë të keqe, megjithatë, më e mira është që gruaja të qëndrojë larg dyndjeve dhe përzierjeve me burrat, me qëllim që të tjerët që e shohin të mos mendojnë se lejohet që gratë të vizitojnë varrin. Kështu, njeriu mund të bëjë haram, ndërsa selami i arrin Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) prej ngado që të bëhet.

Tema 22

Faktet të cilat dëshmojnë për mbrojtjen që Mustafai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka bërë teuhidit dhe mbylljes së të gjitha rrugëve të politeizmit.

Mustafa do të thotë: i Zgjedhur. Origjina e këtij emri është fjala arabe “*safvetu*” – përzgjedhje. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte më i miri i të zgjedhurve, më i miri i të Dërguarve të paepur. Profetët janë të zgjedhurit e Zotit. Emri *Mustafa* këtu është për Muhamedin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Përzgjedhja është në grada: më e larta është “më të mirët e të Dërguarve” (*Ulu el Azmi min er-Rusul*), pastaj vijnë gradat e të Dërguarve (*er-Rusul*), lajmëtarëve (*el Enbija*), besnikëve (*es-Sidikin*), dëshmorëve (*esh-Shuheda*) dhe e të mirëve (*es-Salihin*).

– “... mbrojtjen ...” – Është pengimi i çdo gjëje që i afrohet diçkaje, për shembull të mbrosh tokën nga bagëtitë.

– “... teuhidit ...” – *Teuhid* do të thotë përnjësimi i Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) në aspektet që janë detyrë, si në *rububije*, *uluhije* dhe *esma ue sifata*.

– “... mbylljes së të gjitha rrugëve të politeizmit.” – Kjo do të thotë se përveç mbrojtjes së përgjithshme, ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk ka lënë të hapur asnjë shteg që të çon në *shirk*, sepse politeizmi është gjynahu më i madh: “Padyshim që Allahu nuk fal që

Atij t'i vihen shokë, por Ai fal përveç kësaj (çdo gjë tjetër), për këdo që Ai dëshiron.” (Nisa, 48). Shejhu i Islamit Ibn Tejmije ka thënë: “Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) nuk e fal *shirk*-un e vogël, sipas kuptimit gjithëpërfshirës të fjalës së Tij (Subhanehu ue Te‘Ala): “... nuk fal që Atij t'i vihen shokë”. Të gjitha gjynahet e tjera janë nën këtë nivel, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala): “... por Ai fal përveç kësaj (çdo gjë tjetër), për këdo që Ai dëshiron”, që përfshin mëkatet e mëdha dhe të vogla. Pra, politeizmi nuk është diçka e lehtë që mund të nënvlerësohet. Ai prish zemrën dhe qëllimin, e kur prishet qëllimi, prishet edhe vepra, pasi ajo bazohet te qëllimi. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Atyre që duan jetën e kësaj bote dhe bukuritë e saj, Ne do t’ua shpërblejmë krejtësisht veprat e tyre në dynja, pa iu lënë gjë mangët. Këta janë ata për të cilët në botën tjetër nuk do të ketë kurrgjë, përveç Zjarrit. Kështu, veprat e tyre që i kryen atje (në dynja), janë pa asnjë dobi, dhe pa asnjë vlerë është gjithë ajo që ata bënë.” (Hud, 15-16). Ndërsa i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Vërtet, veprat shpërblehen sipas qëllimit.”

Pra, i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka bërë teuhidit një mbrojtje perfekte dhe i ka mbyllur të gjitha rrugët që të çojnë në politeizëm, edhe nëse rruga është e largët, pasi kush ecën në një rrugë, një ditë do të arrijë. Ndërkaq, shejtani ia zbukuron njeriut veprat e këqija dalëngadalë, derisa ta çojë tek objektivi i vet.

Allahu i Madhëruar thotë: “Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar (Muhamedi) nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, dëshiron (lakmon) besimin tuaj dhe përmirësimin e gjendjes suaj dhe është i butë (i ndjeshëm, zemërdhembshëm) e i mëshirshëm për besimtarët.” (Teube, 128).

– “... *Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj ...*” – Thuhet se këto fjalë iu janë drejtuar arabëve, sepse vetë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte arab. Allahu i Lartësuar thotë: “Ai është i Cili çoi në mesin e analfabetëve një Pejgamber prej tyre ...” (Xhumuah, 2).

Megjithatë, ato mund t'i jenë drejtuar të gjithë umetit, dhe

shprehja “nga gjiri juaj” të nënkuptojë specien (xhinsin). Pra, nuk erdhi nga melekët e as nga xhindët, por ishte njeri, siç thotë Allahu i Lartësuar diku tjetër: “Është Ai, i Cili ju ka krijuar nga një njeri i vetëm ...” (Araf, 189).

Interpretimi i parë duket si i paqartë, sepse Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte dërguar për të gjithë popujt, arabë dhe joarabë. Por në përgjigjen e kësaj thuhet se fjala u është drejtuar sepse mirësia e Allahut mbi ta më e madhe se ndaj të tjerëve, me zgjedhjen e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) prej radhëve të tyre, është më e madhe se mbi popujt e tjerë. Pa dyshim që ky ishte një nderim i madh për ta.

Mundësia e dytë është më e fortë edhe sipas fjalës së Allahut: “Vërtet Allahu derdhi mbi besimtarët mirësi të madhe, kur Ai çoi ndërmjet tyre një të Dërguar (Muhamedin) nga gjiri i tyre ...” (Ali Imran, 164), sepse kur flitet për arabët, thuhet: “prej tyre” dhe jo “nga gjiri i tyre”. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Ai është i Cili çoi në mes të analfabetëve një të Dërguar prej tyre ...” Po kështu, Allahu i Lartësuar thotë për Ibrahimin dhe Ismailin: “Zoti ynë! Dërgo ndër ta, nga gjiri i tyre, të Dërguar.” (Bekare, 129). Kështu, kur thuhet “nga gjiri i tyre”, nënkuptohet i gjithë umeti, e kur thuhet “prej tyre”, qëllimi është për arabët, dhe me interpretimin e dytë ajeti nuk ka asnjë paqartësi.

– “... i Dërguar ...” – I Dërguar nga Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), siç thotë Ai (Subhanehu ue Te‘Ala): “Një i Dërguar nga Allahu, që t’u lexonte fletët e pastra.” (Bejine, 2)

– “... Atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja ...” – Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u dërgua me fe të drejtë e të lehtë. Kur ishte për të zgjedhur midis dy gjërave të lejueshme, ai zgjidhte gjithmonë më të lehtë. Ky ishte lehtësimi për umetin e tij.

– “... lakmon besimin tuaj dhe përmirësimin e gjendjes suaj ...” – Fjala “lakmon” nënkupton përpjekjen maksimale për arritjen e një qëllimi të caktuar, që në rastin tonë do të thotë: ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) përpiqet maksimalisht për të mirën tuaj.

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka pasur dy synime:

largimin e së urryerës, që vërehet në fragmentin: “Atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja ...”; dhe arritjen e së dëshiruarës, që duket te pjesa: “... lakmon besimin tuaj dhe përmirësimin e gjendjes suaj ...”. Ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i gëzonte të dyja cilësitë. Ishte begati e Allahut ndaj nesh dhe ndaj Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), që ai të kishte këtë moral të lartë, siç thuhet në ajet: “... se ti (Muhamed) ke moral të lartë” (Kalem, 4).

– “... është i butë e i mëshirshëm (*er-rafetu*) për besimtarët ...” – Fjala “*er-rafetu*” tregon mëshirën më të lartë, më të butë. Nga ana tjetër, “*er-rahmetu*” është dhembshuri, e cila përfshin keqardhjen për të mëshiruarin dhe dhembshuria ndaj tij për t’i afruar të mirën dhe për t’i shmangur atij të keqen.

Fjala zemërbutësi (*rrikatu*) është cilësi për krijesat, ndërsa për Allahun e Lartësuar nuk i japim këtë kuptim, sepse Atij (Subhanehu ue Te‘Ala) nuk i përngjan asgjë. Mëshira e Allahut është më e madhe se mëshira e krijesave, madje as nuk i afrohet asaj, as nuk i shëmbëllen. Në një hadith të saktë përcillet se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Allahu ka njëqind mëshira. Prej tyre ka zbritur një mëshirë të vetme me qëllim që krijesat të mëshirojnë njëra-tjetrën, që nga koha kur u krijuan e deri në Ditën e Kijametit, aq sa edhe kafsha e ngre këmbën prej të voglit të saj, nga frika se mos e shkelë atë.”¹ Kush mund ta llogarisë në sasi këtë mëshirë që gjendet te krijesat, që nga koha e krijimit e deri në Ditën e Kijametit? Kush mund ta përcaktojë atë në formë? Askush nuk mundet, përveç Allahut të Lartësuar, që e krijoi atë. Kjo ishte veç një mëshirë, ndërsa kur të vijë Dita e Kijametit, Allahu do t’i mëshirojë krijesat, duke pasur nëntëdhjetë e nëntë mëshirat e tjera, bashkë edhe me mëshirën e parë. A i afrohet kjo, mëshirës së krijesave? Kurrë!

E përbashkëta e mëshirës së Krijuesit me atë të krijesave është bamirësia për të mëshiruarin. Mëshira e Krijuesit nuk është e krijuar, por është cilësi e qenësishme e Tij, kurse mëshira e krijesave është e krijuar, pasi është pjesë e krijesës. Cilësitë e Krijuesit nuk mund të shkëputen prej Tij për te krijesa. Është e pamundur që cilësitë e Krijuesit të futen te krijesat; Krijuesi ka

¹ Buhariu.

cilësitë e Krijuesit dhe krijesa përshkruhet me cilësitë e krijesës. Megjithatë, cilësitë e Krijuesit lënë ndikim te krijesat. Në këtë rast, ndikimi është mëshira që ne kemi për njëri-tjetrin.

Me jobesimtarët, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk ishte as i butë, as i mëshirshëm, përkundrazi, ishte i ashpër, siç e ka përshkruar Allahu i Lartësuar atë dhe shokët e tij: “Muhamedi është i Dërguari i Allahut dhe ata që janë me të janë të ashpër ndaj mohuesve (të Allahut) dhe të mëshirshëm ndërmjet tyre.” (Fet’h, 29).

Në suren Teube Allahu i Madhëruar vazhdon e thotë:

“Por nëse ata kthejnë shpinën, atëherë thuaju (o Muhamed): “Allahu është më se i Mjaftueshëm për mua; nuk ka Zot që meriton me të drejtë të adhurohet, përveç Atij. Tek Ai unë mbështetem plotësisht; Ai është Zot i Fronit madhështor.”” (Teube, 129).

“Por nëse ata kthejnë shpinën ...”. Pra, nëse kthejnë shpinën me gjithë përshkrimin e qartë që iu bë të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Këtu kemi një kalim nga veta e dytë në të tretën, për shkak se kthimi i shpinës, pavarësisht nga sqarimi, është vepër e urryer. Prandaj Allahu nuk ka thënë: “nëse ju ktheni shpinën”.

“... atëherë thuaju: ‘Allahu është më se i Mjaftueshëm për mua ...’”. Fjalët i drejtohen Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Pra: thuaju, duke qenë i mbështetur dhe i mbrojtur prej Allahut: Allahu është më se i mjaftueshëm për mua. Lidhja e përgjigjes me kushtin është e qartë: nëse ata do të kthejnë shpinën, mos u shqetëso, por thuaj me gjuhën dhe zemrën tënde: Allahu është më se i mjaftueshëm për mua!

“... Tek Ai unë mbështetem plotësisht ...”. T’i mbështetesh Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) do të thotë t’i varësh të gjitha shpresat tek Ai, për arritjet e të mirave dhe për shmangien e të këqijave, duke pasur sigurinë tek Allahu dhe duke kryer shkaqet e dobishme.

Pjesët e ajetit: “nuk ka Zot që meriton me të drejtë të adhurohet, përveç Atij ...” dhe: “Tek Ai unë mbështetem plotësisht ...”, janë vendosje pranë njëri-tjetrit e *teuhidit rububije (veprat e Zotit)* dhe *teuhidit në adhurim*. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) i ka pranëvendosur disa herë këto dy aspektet, si për shembull: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë.” (Fatiha, 5) dhe:

“... Adhuroje Atë dhe vetëm tek Ai mbështetu” (Hud, 123).

“... dhe Ai është Zot i Fronit madhështor ...”. Kjo do të thotë se Ai është Krijuesi i Fronit. Përshkrimi i veçuar si “Zot i Fronit”, edhe pse Allahu është Zoti i gjithçkaje, është vlerësim për Fronin.

Dy pjesët e ajetit: “... Tek Ai unë mbështetem plotësisht ...” dhe: “Ai është madhështor” lidhen kuptimisht me njëra-tjetrën, sepse “Zot i Fronit” tregon që Ai qëndron mbi gjithçka, askush nuk ngadhënjën mbi Të, rrjedhimisht Ai është i vetmi që meriton t'i mbështetesh.

Fjalën “*Arsh*” (Fron) disa e kanë shpjeguar si “*Kursi-u*”, ndërsa për “*Kursi-un*” kanë thënë se është dija e Allahut. Sipas këtij shpjegimi, nuk paska as *Kursi*, as *Arsh*, prandaj themi se është i pasaktë.

Arshi është i ndryshëm nga *Kursi-u* dhe *Kursi-u* është e ndryshme nga dija. Komenti se *Kursi-u* është dija e Allahut nuk është i saktë. *Kursiu-u* është nga krijesat më të mëdha të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), e cila shtrihet mbi qiejt dhe tokën. Ndërsa Arshi është akoma më i madh, prandaj Allahu e ka përshkruar si madhështor, kur thotë: “... dhe Ai është Zot i Fronit madhështor (*adhim*).” Ai e ka përshkruar gjithashtu si të lavdishëm: “Zotëruesi i Fronit të lavdishëm.” (Buruxh, 15), dhe të lartë: “Zoti i Fronit të lartë.” (Mu‘minun, 116). Froni është krijesa më e madhe, për të cilën ne kemi njohuri, dhe më e larta, sepse Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) qëndron mbi të.

Ajetet tregojnë gjithashtu se me fjalën “*adhim*” (madhështor) mund të përshkruhet edhe një krijesë, siç është Froni. Një krijesë mund të përshkruhet edhe me epitetet *er-rahim* (i mëshirshëm), *er-rauf* (i ndjeshëm, i butë) dhe *el hakim* (i urtë, gjykues). Nëse dy përshkrime bëhen me terma të njëjtë, nuk do të thotë patjetër që dy të përshkruarit janë të njëjtë. Nëse një njeri është *rauf* (i ndjeshëm, i butë), nuk do të thotë se është si Allahu. Pra, mos thuaj se nëse njeriu është dëgjues, shikues e i ditur, atëherë kjo do të thotë se është si Krijuesi, për faktin se edhe Allahu është Dëgjues, Shikues dhe i Ditur. Meqë Zoti ekziston, kjo nuk do të thotë që ekzistenca e Tij është si ajo e krijesave. Po kështu, edhe emrat e Tij nuk janë aspak si ato të krijesave, pasi ndryshimi mes tyre është tepër i madh.

“... Allahu është më se i Mjaftueshëm për mua ...”. Kjo do të

thotë: më mjafton mua. Është detyrë që njeriu ta shfaqë mbështetjen te Zoti, veçanërisht në raste të tilla kur të tjerët e lënë atë, sepse Allahu thotë: “Por nëse ata kthejnë shpinën ...”, pra kjo thënie – thënia "Allahu është më se i Mjaftueshëm për mua" thuhet në vështirësi. Këtë e ka thënë Ibrahim (alejhi selam), kur u hodh në zjarr, dhe i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) me shokët e tij në situatën që përshkruhet në ajet: “Vërtet populli (idhujtar) ka grumbulluar kundër jush (një ushtri të madhe), kështu që frikësojuni atyre! e kjo gjë ua shtoi atyre besimin dhe thanë: “Neve na mjafton Allahu Ai është mbrojtës i mrekullueshëm.” (Ali Imran, 173).

Nga Ebu Hurejre përcillet se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Mos i bëni shtëpitë tuaja varreza dhe mos e bëni varrin tim vend pelegrinazhi, por dërgoni *salavat*-e për mua, sepse *salavat*-et tuaja do të më vijjnë kudo që ju të jeni.”¹

– “Mos i bëni shtëpitë tuaja varreza ...” – Ka shpjegime të ndryshme dijetarësh për këtë fjali. Disa mendojnë se kjo nënkupton që të mos varrosim të vdekur në shtëpi, e nuk ka dyshim se ky është kuptimi i drejtpërdrejtë i saj.

Këtu duket sikur del një problem, pasi vetë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u varros në shtëpinë e tij. Përgjigjja jonë është se ky akt ishte një ndër përjashtimet, që i takojnë veç atij.

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u varros në shtëpinë e tij për dy arsye:

1. Përcillet nga Ebu Bekri se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të thotë: “Çdo Profet, kur vdes, varroset aty ku i merret shpirti.” Disa dijetarë e konsiderojnë të dobët këtë hadith.

2. Aishja përcjell: “Ai u druajt se mos shndërrohej në faltore.”

Dijetarë të tjerë thonë se: “Mos i bëni shtëpitë tuaja varreza” nënkupton që shtëpitë të mos bëhen si varrezat. Varrezat janë

¹ Ebu Daudi me zinxhir të mirë. Përcjellësit janë të drejtë dhe të përpiktë. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

vende ku nuk falim namaz, sepse është e ndaluar. Këtë koment e përforcon një variant tjetër i këtij hadithi, me rrugë të tjera transmetimi: “Falini një pjesë të namazeve në shtëpitë tuaja, e mos i bëni ato varreza.”

Por që të dy kuptimet janë të sakta. Nuk lejohet varrosja në shtëpi, por në varreza, me muslimanët e tjerë. Kjo është traditë që nga koha e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e deri më sot. Një varr në shtëpi ndoshta mund të bëhet vend kulti dhe shkak që të çon në *shirk*. Gjithashtu, i vdekuri kështu nuk përfiton nga lutjet që bëjnë muslimanët kur vizitojnë varrezat. Nga ana tjetër, kjo mënyrë mund të ngushtojë banorët e shtëpisë, aq sa mund t’i bëjë të mërzhiten e ndoshta të zemërohen me të. Nëse do të duan ta shesin shtëpinë, ajo do të ketë një vlerë mjaft të vogël. Po kështu, në shtëpi mund të ketë ngritje zërash, lojëra, argëtime dhe veprime të tjera të cilat bien ndesh me normat e synimet e Sheriatit që lidhen me varret, pasi i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Vizitohuni varret, se ato ju kujtojnë botën tjetër.”

Ndërsa për domethënien: “Mos i bëni ato varreza”, pra, mos i bëni si varreza duke mos falur namazit në to. Kjo thënie është argument se duhet, - nëse nuk themi se është detyrë – që burri të falë namaz në shtëpi e të mos e braktisë atë në to¹. Gjithashtu nga hadithi përfitohet se vendimi për ndalimin e faljes së namazit në varreza ishte i përcaktuar dhe i qartë për njerëzit në atë kohë. Për këtë arsye, veprimi i kundërt shihej si përafrim i shtëpive me varrezat.

Hadithi tregon se varrezat nuk janë vend për namaz. Kjo është edhe dëshmia e hadithit për temën, sepse kthimi i varreve në xhami është shkak shumë i fortë për idhujtari. Kthimi i varreve në xhami, – siç e kemi thënë edhe më parë, – ka dy kuptime: të ndërtohet mbi to xhami ose t’i shfrytëzosh për namaz.

Nga hadithi mësohet gjithashtu, se më e mira është që muslimani të falë një pjesë të namazeve në shtëpinë e vet, këtu bëhet fjalë për namazet *nafile*, sipas fjalës së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Namazi më i mirë është ai që njeriu e fal në shtëpinë e tij, përveç farzeve.”² Këtu nuk futen edhe disa namazet jo farze, si namazi i eklipsit dhe teravitë gjatë Ramazanit, që Sheriati i ka përcaktuar të

¹ Qëllimi është për namazet vullnetare. (shën.për).

² Buhariu.

falen në xhami.

Namazi nafile është më i vlefshëm në shtëpi, edhe nëse ndodhesh në Medinë, në xhaminë e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), sepse hadithi është thënë pikërisht në Medinë. Atëherë, shumëfishimi i namazeve në xhami bëhet vetëm për farzet ose për ato nafile që duhet të falen me xhemat.

– “... *mos e bëni varrin tim vend pelegrinazhi (el i'id)...*” – “*el i'id*” ka kuptimin ‘ritual, festim’, që njeriu e përsërit, ose ‘pelegrinazh’ në një vend të caktuar, në një kohë të caktuar.

Nëse në një ditë të caktuar, dhe në mënyrë të përsëritur, njerëzit përgatisin ushqime dhe ftojnë miq, për shembull, ky quhet festim, sepse ai përsëritet ritualisht çdo vit.

Po kështu, “*el i'id*” festë quhet edhe një vizitë e përsëritur e një vendi të caktuar në një kohë të caktuar, siç bëjnë disa injorantë në muajin *rexheb* atë që quhet ndryshe *vizita e Rexhebit*. Ata shkojnë nga Meka në Medinë dhe vizitojnë, siç pretendojnë, varrin e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Kur dalin përballë Medinës, i dëgjon të klithin. Më parë shkonin nga Meka në Medinë të hipur vetëm mbi gomarë, po kur dolën automjetet, nisën të shkonin me to.

Atëherë, me ç’kuptim është fjala në hadith: me të parin; pra, veprimi që përsëritet çdi vit (rituali i festimit) apo të dytin; që është vizita e shpeshtë? Më i qartë është kuptimi i dytë, pra: mos e vizitoni shpesh varrin tim e ta ktheni në ritual, e kufizuar ose jo me një vit, muaj apo javë të caktuar, sepse Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka ndaluar këtë. Varri i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) duhet të vizitohet veçse me shkak, si për shembull kur, në udhëtim e sipër, ndalon e shkon atje, ose kur e viziton thjesht për të kujtuar ahiretin, si me varret e tjera.

Në Medinë, disa njerëz, gjithmonë pas namazit të sabahut, shkojnë te varri i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për t’i dhënë selam, duke menduar se kjo është njëlloj sikur ta vizitoje në të gjallë të tij, por është injorancë e tyre. Ata nuk e dinë se ngado që ta përshëndesin, atij i shkon selami i tyre.

– “... *dërgoni salavate për mua ...*” – Ky është urdhër, pra duhet të

thoni: “*Allahumme sal-li ala Muhamedin!*” Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) na ka urdhëruar për këtë në ajetin: “Allahu dërgon *salat* (lavdërim) mbi Profetin, edhe melekët e Tij gjithashtu. O ju që keni besuar! Dërgoni *salat* mbi të dhe përshëndeteni atë me nderim, me përshëndetjen islame.” (Ahzab, 56).

Vlera e salavatit për Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është e njohur. Ai që dërgon salavat për Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) një herë, Allahu e përmend për mirë dhjetë herë. Salavati i Allahut mbi të Dërguarin e Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk nënkupton, siç kanë thënë disa dijetarë, mëshirë prej Allahut, kërkim faljeje nga melekët dhe lutje nga njerëzit. Kjo nuk është e saktë. Salavati i Allahut mbi një njeri, është përmendja e Tij e mirë te të zgjedhurit e Tij (engjëjt), siç ka thënë Ebu A’lije, i cili mbështetet edhe nga dijetarë të tjerë. Pasaktësinë e mendimit të parë e tregon ajeti: “Ata janë mbi të cilët derdhen *salavat*-et nga Zoti i tyre dhe ata mbi të cilët derdhet mëshira e Tij.” (Bekare, 157). Allahu e ka përmendur mëshirën bashkë me salavatin dhe, parimisht, një renditje e tillë nocionesh tregon se ata ndryshojnë nga njëri-tjetri.

Mëshira është për cilindo. Dijetarët pajtohen me mendimin se lejohet të thuash: “Allahu e mëshiroftë!” për këdo, por nuk janë të një mendimi kur flitet për salavatet.

Kush dërgon një herë salavate mbi Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), Allahu e përmend dhjetë herë për mirë te të zgjedhurit e Tij, e kjo është mirësi e madhe.

– “... *sepse salavat-et tuaja do të më vijnë kudo që ju të jeni.*” – Si i shkon salavati atij? Për çështje të tilla, të cilat i përkasin fushës së *gajb*-it, është detyrë të thuhet se mënyra është e panjohur. Kësisoj, ne nuk e dimë se si bëhet kjo përcjellje. Megjithatë, nga Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është përcjellur se: “Allahu ka disa engjëj, të cilët shëtisin në tokë dhe i përcjellin Profetit përshëndetjet e umetit të tij.”¹ Nëse ky hadith është i saktë, atëherë themi që kjo është edhe mënyra.

¹ Ahmedi dhe Nesaiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

Ali Ibn Husejni tregon se ka parë një burrë që futej në një të çarë te varri i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe lutej. Aliu e ndaloi atë dhe pastaj i tha: “A t’ju tregoj një hadith që e kam dëgjuar nga babai im, ai nga gjyshi e ai nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem)? “Mos e bëni varrin tim vend pelegrinazhi, as shtëpitë tuaja varreza, por dërgoni salavate për mua, sepse përshëndetja juaj më përcillet kudo që të jeni.” Është përcjellë në *El Muhtareh*.¹

– “*Ali Ibn Husejni ...*” – Ai është Ali Ibn Husejn Ibn Ali Ibn Ebu Talibi. Quhej ndryshe Zejnel Abididin. Ai ka qenë më i miri i *Ehlul Bejtit* në dije, devotshmëri dhe *fikh*. Husejni është i njohur si i biri i Fatimes (radijallahu anha), ndërsa babai i tij ka qenë Aliu (r.a.).

– “*... futej në një të çarë ...*” – Nuk ka dyshim se ky burrë, që shkonte në mënyrë të përsëritur tek ai vend, besonte se ai kishte cilësi të veçanta. Mendimi se lutja pranë varrit është e privilegjuar do të thotë se ke hapur një portë të idhujtarisë. Madje për çdo adhurim, qoftë namaz, lutje apo lexim Kurani, nëse kryhet pranë një varri, nuk lejohet të besohet se atje ka merita më të larta. Për këtë arsye, themi se është e urryer të këndohet Kuran te varri, me mendimin se në atë vend është më i vlefshëm.

– “*... e ndaloi atë ...*” – Pra, i kërkoi që të mos e bënte më atë veprim.

– “*... A t’ju tregoj një hadith ...*” – Ai tha: “A t’ju tregoj”, ndërkohë që përmendet vetëm një person. Atëherë konteksti tregon se Aliu ka qenë duke folur me shokët e vet, ndërkohë që te varri shkonte një burrë.

– “*... Mos e bëni varrin tim vend pelegrinazhi ...*” – Shpjegimi për këtë është njëlloj si i hadithit të mëparshëm: ndalimi i vizitave rituale është bërë sepse ato janë udhë që të çojnë në politeizëm.

¹ Transmeton Buhariu në "Et-Tarikh El-Kebir", Ebu Ja'la në Mexhma Ez Zvaid dhe Daja'a në "El Muhtareh".

– “... *as shtëpitë tuaja varreza ...*” – Kjo u komentua më parë.

– “... *por dërgoni salavate për mua, sepse përshëndetja juaj më përcillet kudo që të jeni.*” – Më parë sqarua se ç’është salavati mbi Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Qëllimi është: dërgoni salavate për mua kudo që të jeni; nuk ka nevojë ta bëni këtë veç duke ardhur te varri.

– “... *më përcillet ...*” – Më parë u sqarua se si i përcillen salavatet Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

– “... *Është përcjellë në El Muhtareh.*” – *El Muhtareh* është titulli i librit, që do të thotë se hadithi ndodhet në këtë vepër, autor i së cilës është Abdul-Gani el Makdesij, dijetar hanbeli.

■ **Dobitë e temës**

➤ Komenti i ajetit në suren Teube.

Koment i dhënë në krye të temës.

➤ Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është përpjekur maksimalisht për largimin e umetit të tij nga ky haram.

Kjo mësohet nga hadithi: “Mos i bëni shtëpitë tuaja varreza dhe mos e bëni varrin tim vend pelegrinazhi ...”.

➤ Nxjerrja në pah e përpjekjes maksimale nga ana e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për të mirën tonë, e butësisë dhe mëshirës së tij.

Këto përmenden në ajetin e sures “Teube”.

- Ndalimi i posaçëm nga ana e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për vizitën rituale të varrit të tij, megjithëse kjo është ndër veprat më të mira.

Kjo del nga thënia: “... mos e bëni varrin tim vend pelegrinazhi ...”. Ndalesa është për kthimin në vend pelegrinazhi, sepse, në vetvete, vizita e varrit të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është vepra më e mirë në llojin e saj. Ajo përmban përshëndetjen e tij me selam, duke ditur se atij i takon kjo përshëndetje më shumë se çdokujt tjetër. Ndërsa, në drejtim të përkujtimit të ahiretit, varri i tij nuk ka ndryshim nga ndonjë varr tjetër.

- Ndalimi që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u ka bërë vizitave të shpeshta varreve.

Kjo del nga fjala e tij: “... mos e bëni varrin tim vend pelegrinazhi ...”. Megjithatë, nuk është kusht që vizitat të jenë mjaft të shpeshta. Edhe vizitat rituale një herë në vit konsiderohen të shpeshta.

- Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka nxitur për faljen e namazeve nafile në shtëpi.

Kjo mësohet nga thënia: “Mos i bëni shtëpitë tuaja varreza ...”. Ne thamë se kjo ka dy kuptime: a) mos varrosni njeri në shtëpi, që del nga kuptimi i drejtpërdrejtë, dhe: b) të mos lihen shtëpitë pa falur namaz, kuptim ky që rrjedh nga argumentet e tjera.

- Për sahabët ka qenë e përcaktuar që në varreza nuk mund të falesh.

Kjo del nga pjesa: “Mos i bëni shtëpitë tuaja varreza ...”, që do të thotë: mos i lini ato pa falur namaz, sipas njërit nga dy kuptimet e mundshme.

- Salavatet dhe selamet i përcillen Pejgamberit (sal-

lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ngado që të bëhen, pa qenë e nevojshme të jesh afër varrit.

Prandaj dhe Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ndaloi pelegrinazhin në varrin e tij. Për këtë çështje, Ali Ibn Husejni i ka thënë dikujt: “Ti dhe ai që ndodhet në Indonezi, jeni njëlloj.”

- Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), edhe pse është në jetën e varrit i përcillen salavatet dhe selamet e umetit të tij.

Por vetëm këto vepra. Kjo del nga fragmenti: “... salavatet tuaja do të më vijnë kudo që ju të jeni.”

Tema 23

Argumentet që tregojnë se një pjesë e këtij umeti do të adhurojnë idhujt.

Shkaku që autori (Allahu e mëshiroftë!) ka sjellë këtë temë, është hedhja poshtë e qëndrimit të disave se në këtë umet nuk ka për të pasur politeizëm. Kështu, ata mohojnë që adhurimi i varreve dhe i evlijave është politeizëm, sepse ky umet është i mbrojtur prej kësaj dukurie, sipas fjalës së të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Vërtet shejtani është bërë i pashpresë që ndonjëri prej besimtarëve t’i rikthehet idhujtarisë në gadishullin Arabik, por ai nuk e ka humbur shpresën për mbjelljen e grindjeve ndërmjet tyre.”¹

Përgjigja për këtë është dhënë kur kemi renditur dobitë e temës nr. 9.

– “... një pjesë e këtij umeti ...” – Pra, jo të gjithë, pasi në këtë umet, një grup do të vazhdojë të jetë i ndihmuar në të vërtetën, deri afër Ditës së Kijametit. Në ditët e fundit të kësaj bote do të fryjë një erë, e cila do të marrë shpirtrat e të gjithë muslimanëve, e atëherë kanë për të mbetur më të këqijtë e njerëzve.

– “... do të adhurojnë idhujt ...” – Idhull quhet çdo gjë që adhurohet veç Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala).

Në këtë temë, autori ka përmendur disa ajete:

¹ Transmeton Muslimi.

Ajeti 1: “A nuk i sheh ata, të cilëve u është dhënë pjesë nga Libri! Ata besojnë në *xhibt*¹ e *tagut* (hyjnitë e rreme) dhe u thonë jobesimtarëve se ata janë më të udhëzuar dhe në rrugë më të drejtë sesa ata që kanë besuar.” (Nisa, 51).

– “A nuk i sheh ...” – Kjo është një pyetje retorike për ta bërë dëgjuesin më të vëmendshëm.

– “... ata, të cilëve u është dhënë pjesë nga Libri! ...” – Nuk u është dhënë i gjithë Libri për shkak të kundërshtimeve të tyre. Ata nuk kanë dije të plotë për gjithçka që përmban Libri.

– “... Libri ...” – Qëllimi është për Teuratin dhe Ungjillin. Ngjarja e Kab Ibn Eshrefit sillet si shembull për këtë rast. Kur shkoi në Mekë, rreth tij u mblodhën idhujtarët dhe e pyetën: “Ç’mendon për këtë burrë² i cili po përçmon inteligjencën tonë dhe beson se është në rrugë më të mirë se ne?” Ai iu përgjigj: “Ju jeni më të mirë se Muhamedi.” Kjo citohet në fundin e ajetit: “... dhe u thonë jobesimtarëve se ata janë më të udhëzuarit dhe në rrugë më të drejtë sesa ata që kanë besuar.”

– “... Ata besojnë ...” – Pra, i besojnë, i pohojnë dhe nuk i mohojnë. Nëse njeriu i pohon këta idhuj, atëherë ai i ka besuar ata.

– “... Ata besojnë në *xhibt* e *tagut* ...” – *El xhibt* thuhet se është magjia. Është thënë gjithashtu se “*el xhibt*” quhen statujat. Megjithatë, sipas mendimit më të saktë, ai është një term i përgjithshëm me të cilin nënkuptohen statujat, magjia, falli e të tjera.

Tagut quhet çdo gjë përkundrajt së cilës tejkalohej kufiri duke e pasuar, adhuruar ose duke iu bindur. Të adhuruar mund të jenë idhujt; *tagut*-ë që pasohen mund të jenë dijetarët e humbur; ndërsa *tagut*-ë që njerëzit iu binden mund të jenë prijësit, udhëheqësit.

¹ Besimi në *xhibt* përfshin besimin tek idhujt, magjia, falli etj.

² Bëhet fjalë për Pejgamberin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Bindja ndaj tyre në ndalimin e asaj që e ka lejuar Allahu ose në lejimin e asaj që Ai e ka ndaluar, konsiderohet si adhurim i tyre. Këtu flitet për ata që janë të kënaqur me adhurimin që u bëhet atyre. Po ashtu, diçka apo dikush mund të jetë *tagut* përkundrejt adhuresve të tij, por jo vetë. Në këtë rast, janë vetëm adhuresit ata që i kanë kaluar caqet, duke e ngritur ‘*tagut-in*’ mbi gradën që ia ka caktuar Allahu.

Et tagut vjen nga fjala ‘*tug’jan*’-tejkalim kufiri. Çdo gjë ndaj së cilës njeriu e kalon kufirin, konsiderohet *tagut*.

Lidhja e ajetit me temën bëhet e qartë nëpërmjet hadithit: “Do të ndiqni rrugët e atyre para jush ...”. Përderisa ata, të cilëve iu është dhënë pjesë nga Libri hyjnor, besojnë në *xhibt* e *tagut*, edhe nga ky umet do të ketë që do të ndjekin rrugët e paraardhësve, që do të thotë se do të besojnë në *xhibt* dhe *tagut*.

Ajeti 2: “Thuaj: ‘A doni t’ju tregoj se kush do ndëshkohet më rëndë se kjo tek Allahu? Ata që Allahu i ka mallkuar dhe me të cilët është zemëruar, duke shndërruar disa prej tyre në majmunë dhe derra, si dhe ata që adhurojnë *tagut-in*, ata janë në vendin më të mjerë dhe janë tepër larg nga rruga e drejtë.” (Maide, 60).

– “*Thuaj: ‘A doni t’ju tregoj ...’*” – Ky ajet i drejtohet Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), që t’i kundërpërgjigjej jehudëve, të cilët e morën fenë Islame si tallje dhe lojë.

“A t’ju tregoj”. Kjo formë pyetëse shërben këtu për të bërë një sqarim dhe për tërhequr vëmendjen.

– “... më rëndë se kjo ...”¹ – Përemri “kjo” i referohet besimit (që jobesimtarët e shihnin si diçka të keqe) të Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe shokët e tij. Judejtë pretendonin se ishin në rrugën e vërtetë dhe se ishin më të mirë se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe shokët e tij, të cilët, sipas tyre, ishin të humbur. Atëherë,

¹ Për ta kuptuar më mirë, duhet parë konteksti, duke lexuar një ajet më përpara në suren Maide, ajetin nr. 59: “Thuaj: ‘O ithtarë të Librit! A na kundërshtoni vetëm pse besuam Allahun, atë që na është shpallur neve dhe atë çfarë është shpallur para nesh ...’”.

Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) u tha: “Thuaj: ‘A t’ju tregoj...”.

– “... *tek Allahu ...*” – Domethënë tek ajo që Ai di, për shpërblimin dhe ndëshkimin.

– “... *Ata që Allahu i ka mallkuar ...*” – Kjo është përgjigjja e pyetjes pararendëse në ajet dhe do të thotë: Ata që Allahu i ka dëbuar dhe larguar nga mëshira e Tij.

– “... *dhe me të cilët është zemëruar ...*” – Zemërimi është një ndër cilësitë reale të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) nga e cila rrjedh hakmarrja ndaj atyre mbi të cilët ka rënë mallkimi i Tij. Nuk është e saktë që “zemërimi i Allahut” të keqinterpretohet si “hakmarrja e Tij”. Për këtë kemi folur dy tema më përpara.

Rregulli i përgjithshëm i *Ehlu Sunetit* është se ajetet dhe hadithet e cilësive merren me kuptimin e drejtpërdrejtë të tyre, siç i përshtatet Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Mos i krahaso me cilësitë e krijesave, mos i shtrembëro dhe mos i moho ato; me fjalë të tjera, mos e tepro as me pohim dhe as me mohim.

– “... *duke shndërruar disa prej tyre në majmunë dhe derra ...*” – Majmuni është kafsha më e përafërt në pamje me njeriun, ndërsa derri është një kafshë e ndyrë dhe e njohur, të cilën Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) e ka përshkruar si të pistë. Judejtë u mallkuan, siç e tregon Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) në ajet: “Ata nga bijtë e Israilit, të cilët nuk besuan, u mallkuan nga Dauti dhe Isait, biri i Merjemes.” (Maide, 78), dhe u bënë majmunë: “Bëhuni majmunë të përçmuar e të urreyer.” (Bekare, 65). Allahu u zemërua me ta, siç thotë: “... Dhe kështu, tërhoqën mbi vete zemërim përmbi zemërim!” (Bekare, 90).

– “... *si dhe ata që adhurojnë tagut-in ...*” – Kjo është sipas një varianti të leximit të Kuranit, që do të thotë se flitet për të njëjtët njerëz. Sipas një leximi tjetër të tekstit, ata u bënë adhurues të *tagut*-it si rrjedhojë e veprës së tyre.

■ Ajeti 3: “... pastaj, ata që fituan mbi çështjen e tyre,

thanë: ‘Ne do të ndërtojmë një faltore mbi ta.’” (Kehf, 21).

Ky ajet flet për ngjarjen e Shpellës. Ndodhia me njerëzit e saj është e çuditshme, siç e përshkruan Allahu i Lartësuar: “Vallë, a mendon ti se banorët e Shpellës dhe Mbishkrimi ishin një çudi nga mrekullitë Tona” (Kehf, 9). Ata ishin disa djem që i kishin besuar Allahut, por jetonin në një vend politeizmi, e për këtë arsye u larguan prej andej për hir të Allahut të Lartësuar. Ai ua lehtësoi futjen në shpellë, në të cilën bënë një gjumë, që zgjati: “... treqind vjet (diellorë), duke shtuar nëntë (për vitet hënore).” (Kehf, 25). Gjatë gjumit, ata nuk patën nevojë as për ushqim, as për pije. Allahu, me urtësinë e Vet, i kthente ata nga e djathta dhe nga e majta, që të mos u binte gjaku vetëm në njërën anë të trupit.

Kur u zgjuan, ata dërguan njërin prej tyre në qytet për të blerë ushqime. Ai vajti dhe, kur nxori monedhat, pa se ato kishin ndryshuar. Pasi banorët e qytetit e mësuan çështjen e tyre, thanë: “Ne do të ndërtojmë një faltore mbi ta.”

– “... ata që fituan mbi çështjen e tyre ...” – Është fjala për prijësit e asaj kohe, që thanë: “do të ndërtojmë një faltore mbi ta”, por ndërtimi i faltoreve mbi varreza është një nga mënyrat që të çojnë në idhujtari, siç e kemi thënë edhe më lart.

Dobitë e ajetit të parë:

- Është e çuditshme se si njeriu, pasi i është dhënë pjesë nga Shpallja hyjnore, të besojë sërish në *xhibt* dhe *tagut*.

- Nuk është e thënë që dituria ta mbrojë gjithmonë njeriun nga gjynahu, siç ndodhi me bashkësitë të cilëve iu dha një Libër hyjnor, por që gjithsesi besuan kufrin. Ai i cili beson kufrin, beson edhe në gjëra më të vogla, siç janë gjynahet.

- Domosdoshmëria e mohimit të *xhibt*-it dhe *tagut*-it, sepse Allahu e përshkruan besimin në ato si diçka jo normale dhe poshtëruese. Me fjalë të tjera, nuk lejohet pohimi i *xhibt*-it dhe *tagut*-it.

- Dijetari i ka sjellë këto argumente, për të pohuar se nga ky umet do të ketë njerëz që besojnë në *xhibt* dhe *tagut*: “... ju do të ndiqni rrugët e atyre para jush.” Përderisa, ndër benu Israilët pati

që besuan në *xhibt* dhe *tagut* atëherë të tillë do të ketë dhe nga ky umet.

Dobitë e ajetit të dytë:

- Përdorimi ndaj kundërshtarit i argumenteve që ai nuk mund t'i kundërshtojë. Çifutët e dinin se ndër ta ka pasur njerëz me të cilët Allahu u zemërua, i mallkoi dhe disa prej tyre i shndërroi në majmunë dhe derra. Nëse ata e pohojnë këtë dhe ndërkohë tallen me muslimanët, atëherë i pyesim: cilët janë për t'u tallur, ata që përfshihen nga këto dënime, apo ata që nuk janë prekur prej tyre? Përgjigjja është e qartë.

- Njerëzit kanë pozita të ndryshme tek Allahu: "... kush do ndëshkohet më rëndë se kjo tek Allahu ...". Nuk ka dyshim se njerëzit ndryshojnë për sa i përket shtimit dhe pakësimit të besimit, si dhe në shpërblimin që vjen si rezultat i tij.

- Gjendja e keqe e çifutëve të cilëve u erdhën gjithë këto dënime, si: mallkimi, zemërimi i Zotit, shndërrimi dhe adhurimi i *tagut*-ëve.

- Pohimi se Allahu vepron; Ai bën çfarë të dojë. Ai thotë: "... Ata që Allahu i ka mallkuar ...", dhe mallkimi është një veprim.

- Pohimi se Allahu zemërohet: "... dhe me të cilët është zemëruar ..."

- Pohimi i mundësive absolute të Allahut që mësohet nga ajeti: "... duke shndërruar disa prej tyre në majmunë dhe derra ...". A do të thotë kjo se majmunët dhe derrat e sotëm rrjedhin prej tyre? Jo, sipas hadithit të përcjellë në "*Sahih-un*" e Muslimit, ku Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) thotë: "Çdo populli të shndërruar, nuk i mbetet pasardhës." Majmunët dhe derrat kanë ekzistuar edhe para kësaj ngjarjeje, prandaj nuk janë pasardhës të atyre.

- Dënimi është sipas llojit të punës. Ata të cilët u shndërruan në majmunë (të cilët ngjasojnë më shumë me njerëzit) bënë një veprim që dukej i lejuar, por që në të vërtetë është haram. Atyre iu ndalua peshkimi në ditën e shtunë, por si sprovë nga Allahu, kur vinte e shtuna, deti mbushej me peshq, aq sa dukeshin në sipërfaqen e ujit, ndërsa në ditët e tjera nuk vinte asgjë. Pasi kaloi një periudhë, çifutët filluan të përdornin hilenë. Ata i hidhnin rrjetat ditën e premte, i linin në det të shtunën, që të binin peshqit, pastaj të dielën shkonin dhe i merrnin. Një hile që, në pamje të jashtme

dukej e lejuar, por në të vërtetë ishte gjynah i plotë. Për këtë arsye, ata u shndërruan në një kafshë që i përngjan njeriut, por që nuk është njeri: majmun. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: “Bëhuni majmunë të përçmuar e të urryer ...” (Bekare, 65). Shpërblimi është sipas punës që bën, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): “Ne të gjithë i dënuam sipas gjynahut të vet ...” (Ankebut, 40).

- Judejtë adhuronin *tagut*-ët: “... si dhe ata që adhurojnë *tagutin* ...”, e nuk ka dyshim se ata edhe sot vazhdojnë ta adhurojnë atë. Ata adhuruan shejtanin, iu bindën atij dhe kundërshtuan Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Mallkimi dhe zemërimi i Allahut është për të gjithë jehudët, kurse në derra dhe majmunë u shndërruan vetëm disa prej tyre. Allahu thotë: “Ata që Allahu i ka mallkuar dhe me të cilët është zemëruar, duke shndërruar disa prej tyre në majmunë dhe derra ...”. Pra, Allahu thotë: “duke shndërruar disa prej tyre në majmunë” dhe jo: “duke i shndërruar ata në majmunë”.

Dobitë e ajetit të tretë:

- Ajeti është në kontekstin e ngjarjes së çuditshme të banorëve të Shpellës, e cila është një argument bindës për fuqinë absolute të Allahut dhe urtësinë e Tij.

- Ndër shkaqet e ndërtimit të xhamive mbi varreza, është teprimi me të vdekurit. Banorët e Shpellës u bënë njerëz të respektuar dhe të nderuar në popull, prandaj të pushtetshmit e popullit, duke kaluar kufijtë, ndërtuan një faltore mbi ta.

- Teprimi në lidhje me varret, edhe pse i vogël, mund të të çojë në diçka më të madhe, prandaj i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i tha Aliut (radijAllahu ‘anhu): “Mos lër figurë frymori pa e shkatërruar dhe as varr të ngritur pa e rrafshuar.”¹

Ebu Seidi tregon se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Do të pasoni rrugët e atyre që ishin para jush, përbri tyre, si pendët në dy anët e shigjetës së harkut, aq sa, sikur ata të futen në vrimën e *dab'it* ² (hardhucës) edhe ju do të futeshit atje.” I thanë: “O i Dërguari i

¹ Muslimi.

² Një zvarranik shkretëtire.

Allahut, jehudët dhe të krishterët? Ai u përgjigj: “Kë tjetër veç tyre!”¹

Togu “do të pasoni” theksohet me tri përforcime: betimi i nënkuptuar, pjesëza e parashtuar *lam* dhe prapashtesa përforcuese *nun*. Atëherë, kuptimi është kështu: Ullahi do të pasoni

– “... *Do të pasoni rrugët e atyre që ishin para jush ...*” – Kjo fjalë nuk merret me kuptimin e drejtpërdrejtë. Qëllimi është për një pjesë të umetit, sepse gjithmonë ka njerëz që nuk i ndjekin ato rrugë, siç e ka pohuar i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), i cili ka thënë se një grup nga ky umet do të mbetet gjithnjë në të vërtetën.

Një interpretim tjetër mund të jetë që hadithi i referohet të gjithë umetit, por nuk kushtëzon që ky umet do t’i pasojë bashkësitë e mëparshme në të gjitha sjelljet e tyre, përkundrazi, disa i imitojnë në një aspekt, të tjerë në një aspekt tjetër. Rrjedhimisht, kjo nuk do të thotë që ky umet do të dalë nga Islami. Dihet se disa ndër veprat e atyre që kanë qenë para nesh, nuk të nxjerrin nga feja, si: përfitimi nga kamata, smira, dhunimi i tjetrit, gënjeshtër etj., por ka edhe të tjera që të nxjerrin nga feja, siç është adhurimi i idhujve.

– “... *rrugët ...*” – Ato janë të shumta: disa janë shkelje përkundrejt Krijuesit, e disa përkundrejt krijesave. Këtu po rendisim disa prej tyre:

- Adhurimi i varrezave dhe i njerëzve të mirë. Këtë e kanë bërë popujt e mëparshëm, por gjendet si dukuri edhe në këtë umet. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë për popullin e Nuhut: “Dhe kanë thënë: ‘Ju nuk do t’i lini zotat tuaj dhe as nuk do të lini Vedanë, as Suvanë, as Jeguthin, as Jeukun, as Nesran (emra të idhujve të tyre) ...’” (Nuh, 23).

- Teprimi me njerëzit e mirë, dukuri kjo e pranishme në bashkësitë e mëparshme, por edhe në këtë umet.

- Lutja drejtuar dikujt apo diçkaje tjetër, përveç Allahut. Kjo ndodh edhe te ky umet.

- Ndërtimi i faltoreve mbi varreza, që ka ekzistuar në

¹ Buhariu dhe Muslimi.

bashkësitë e mëparshme, e po kështu gjendet edhe te ky umet.

- Përshkrimi i Allahut me të meta. Judejtë thanë: “Dora e Allahut është e shtrënguar.” (Maide, 64). “Vërtet Allahu është i varfër e ne jemi të pasur.” (Ali Imran, 181). Ata kanë thënë gjithashtu se Allahu u lodh nga krijimi i qiejve dhe tokës. Por edhe në këtë umet ka që thonë gjëra të tilla, ose edhe më keq se kaq. Ka nga ata që thonë se Ai nuk ka dorë; Ai nuk mund të bëjë ç’të dojë; nuk është lart mbi Arsh; nuk zbret në qiellin e dynjasë; nuk flet. Gjithashtu, ka që thonë se Ai nuk është as brenda universit, as jashtë tij, as i lidhur me të dhe as i ndarë nga ai, pra e kanë përshkruar në një mënyrë të tillë që e bën të pamundur ekzistencën e Tij. Ata thonë se nuk lejohet të bësh me shenjë nga Ai; Ai nuk vepron, nuk zemërohet nuk kënaqet dhe nuk dëshiron. Kështu është sipas medhhebit *Eshari*.

- Ngrënia e haramëve. Kjo dukuri gjendej te bashkësitë e mëparshme, por gjendet edhe në këtë umet.

- Ngrënia e kamatës, e cila ka ekzistuar në bashkësitë e mëparshme, por edhe në këtë umet.

- Përdorimi i hilesë me haramet që ka përcaktuar Allahu, dukuri në bashkësitë e mëparshme, por edhe në këtë umet.

- Zbatimi i dënimeve penale vetëm mbi të dobëtit dhe jo ndaj shtresave të larta.

- Shtrembërimi i fjalës së Allahut në formë dhe në përmbajtje, duke e veçuar nga konteksti. Kështu vepruan jehudët, të cilët, kur iu tha: “... hyni te porta duke u përkulur dhe thoni: ‘Falna ne (*hitatun*)!’”, (Bekare, 90) ata nuk dëgjuan, por u futën me shpinë dhe thanë: “*hintatun*”¹ e jo “*hitatun*”.

Edhe në këtë umet ka nga ata që e bëjnë një gjë të tillë. Ata ndryshojnë fjalën e Kuranit “*el isteua*” në “*el isteula*”. Allahu i Lartësuar thotë: “I Gjithëmëshirshmi u ngrit (*isteua*) mbi Fron” ndërsa sipas tyre është: “I Gjithëmëshirshmi e mbizotëroi (*isteula*) Fronin.” Ibn Kajimi thotë se l-ja tek “*isteula*” është e shtuar, ashtu siç bënë jehudët me fjalën “*hitatun*”, duke e ndryshuar në “*hintatun*”.

- Në bashkësitë e mëparshme, priftërinjtë dhe murgjit e tyre i

¹ *Hintatun* ishte emri i një bime.

trajtonin si zota përveç Allahut. Edhe në këtë umet ka nga ata që e kundërshtojnë fjalën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kur ajo bie në kundërshtim me fjalën e shejhut të tyre. Po ta këqyrësh me kujdes fjalën e të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), vëren se ajo është në përputhje me realitetin: “Do të pasoni rrugët e atyre që ishin para jush ...”.

Po a është ky një paralajmërim apo miratim për këtë veprim? Nuk ka dyshim se është paralajmërim. Pra, askush të mos thotë se unë do të bëhem ziliqar, do të fitoj nga kamata dhe do t’u bëj padrejtësi njerëzve për shkak se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka thënë këtë. Kush mendon kështu, ka gabuar, sepse nuk ka dyshim që fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte një paralajmërim. Prandaj sahabët pyetën: “Jehudët dhe të krishterët?” e ai u përgjigj: “Kë tjetër veç tyre!” Po kështu, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka lajmëruar disa herë për dukuri që do të ndodhin, edhe pse ka bërë të ditur se ato janë të ndaluara me ajete kuranore. Ai ka parathënë se burri do të respektojë gruan e tij, por jo nënën e vet; se njeriu do të kundërshtojë babanë e tij, për të afruar shokun e vet¹. Këto vepra nuk lejohen me tekst nga Kurani, prandaj themi se qëllimi është paralajmërimi i njerëzve.

- Në bashkësitë e mëparshme kishte nga ata që thoshin për besimtarët: “Këta janë të humbur.” Edhe në këtë umet, ka njerëz që thonë: “Këta janë të prapambetur”.

Gjynahet e kanë originën në bashkësitë e mëparshme, siç u përmend, por atij që Allahu i jep sukses për t’u udhëzuar, udhëzohet.

Si përfundim, themi se gati të gjitha mëkatet që bëhen në këtë umet, e kanë prejardhjen nga popujt e mëparshëm. Gjithashtu, nuk ka pasur ndonjë mëkat në popujt e mëparshëm që të mos ketë trashëgimtarë në këtë umet.

Lidhja e hadithit me temën është: përderisa në popujt e mëparshëm u adhuruan statujat dhe idhujt, atëherë do të ketë edhe në këtë umet nga ata që do të adhurojnë statujat dhe idhujt.

¹ Transmeton Tirmidiu. Sipas Albanit hadithi është i dobët

– “... përbri tyre, si pendët në dy anët e shigjetës së harkut ...” – Shigjeta ka pendë në bishtin e saj nga të dyja anët; ato duhet të jenë patjetër të barabarta, se përndryshe shigjeta devijon.

– “... aq sa, sikur ata të futen në vrimën e dab'it (hardhucës), edhe ju do të futeshit atje. ...” – Ky shembull shërben për përforsim të idesë së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Vrima e hardhucës është tepër e vogël. Kjo tregon se imitimi do të bëhen deri në imtësi, pa diskutuar pastaj për gjërat e mëdha. Shembujt me imtësi ndihmojnë për të theksuar idenë, siç është hadithi tjetër: “Kush zaptonte një pëllëmbë tokë padrejtësisht, Ditën e Kijametit do të detyrohet të mbajë shtatë toka si ajo”.¹ Po ai që zaptonte një krah?!

– “Jehudët dhe të krishterët? ...” – Kjo pyetje mund të interpretohet në dy mënyra: “A ke për qëllim jehudët dhe të krishterët?” ose: “A janë ata jehudët dhe të krishterët?” Gjithsesi, kjo është një fjali pyetëse, sepse ata e pyetën Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), duke kërkuar informacion prej tij.

Jehudët (judejtë) janë pasuesit e Musait (alejhi selam). U quajtën *jehud* (në arabisht) nga Jehudha, njëri nga nipërit e Is’hakut. Një mundësi tjetër është se emri i tyre rrjedh nga fjala “*hadu*” (u kthyen, u penduan)², ngaqë ata u penduan për adhurimin e viçit. Ndërsa të krishterët (*nesara*) janë pasuesit e Isait (alejhi selam). U quajtën *nesara* nga vendi Nasire. Thuhet gjithashtu se vjen nga fjala “*ensar*” - ndihmues, siç është në Kuran: “Kush janë ndihmuesit (*ensari*) e mi tek Allahu.” (Saf, 14).

– “... Kë tjetër veç tyre?” – Pyetja është pohuese, që do të thotë: “Kë kam për qëllim tjetër veç tyre?” Ose sipas variantit tjetër: “E kush janë tjetër veç tyre?” Sahabët pyetën për t’u qartësuar, dhe Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e pohoi se ata ishin jehudët dhe të krishterët.

Dobitë e hadithit:

- Ky hadith është cituar nga dijetari për të treguar që një pjesë

¹ Muslimi.

² Fjala *hadu* përmendet në syren El A'raf.

e këtij umeti do të adhurojë idhujt, sepse kështu kanë bërë ata që ishin para nesh, ndërsa Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) na ka vërtetuar se ne do të ndjekim shembullin e tyre.

- Nga kuptimi i fjalëve të hadithit mësojmë se duhet të ruhem i nga pasimi i atyre që ishin para nesh, kur bie në kundërshtim me Allahun.

- Duhet të njohim se ç’kanë bërë bashkësitë paraardhëse, me qëllim që të ruhem i. Falënderimi i takon Allahut, se shumica e këtyre veprave përmenden në Kuran dhe Sunet.

- Rëndësia e madhe që kishte kjo çështje për sahabët, kur pyetën: “Jehudët dhe të krishterët?” Kjo, sepse pyetja shpreh njëkohësisht edhe habinë se si është e mundur të ndjekim rrugët e atyre që ishin para nesh, pasi Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) na solli udhëzimin.

- Sa më e gjatë të jetë koha ndërmjet njeriut dhe zbritjes së Shpalljes, aq më larg do të jetë ai nga e vërteta, sepse Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) na foli për të ardhmen dhe jo për të tashmen. Edhe në bashkësitë para nesh, kur kalonte një kohë e gjatë nga zbritja e Shpalljes, zemrat e tyre ngurtësoheshin. Allahu i Madhëruar thotë: “A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë që zemrat e tyre të përuken nga përkujtimi i Allahut dhe nga ajo që është Shpallur nga e Vërteta e të mos bëhen si ata, që iu dha Libri më parë?! Me kalimin e një kohe të gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan dhe shumë syresh janë të pa bindur.” (Hadid, 16).

Nëse largësia kohore ishte shkak për ashpërsimin e zemrave në popujt para nesh, do të jetë edhe për ne. Për këtë dëshmon hadithi i sjellë nga Buhariu, ku Enesi tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të thotë: “Për çdo periudhë kohore, ajo që vjen më pas është më e keqe se ajo para, derisa të takoni Zotin tuaj.” Kush vëren gjendjen e këtij umeti në histori, e vërteton diçka të tillë, por duhet të dimë se ka ndryshim ndërmjet gjendjes së përgjithshme dhe njerëzve të veçantë. Hadithi i Enesit është i saktë, si në zinxhirin e përcjelljes, po kështu edhe në tekstin e tij. Teksti nuk ka parregullsi, ndërsa vargun e sjell Buhariu.

Ky hadith tregon për situatë në përgjithësi, sepse, në veçanti, ndër pasuesit e tabiinëve, ka pasur nga ata që ishin më të mirë se shumë prej tabiinëve. Prandaj mos i humbni shpresat e të thoni se

në kohën tonë kjo nuk ka mundësi të ndodhë.

Për më tepër, shikoni gjendjen midis burrave dhe grave. Cilët janë më të mirë? Përgjigjja është: burrat, sepse Allahu i Lartësuar thotë: “ndonëse burrat kanë një shkallë (më shumë përgjegjësi) mbi to.” (Bekare, 228), por nga ana tjetër, ka gra që janë më të mira se shumë burra. Ne duhet të dallojmë të përgjithshmen nga rastet e veçanta. Nëse shohim shekujt në tërësi, vërejmë se shekulli që vjen më pas, është më i keq se ai i mëparshmi. Megjithatë, mund të ndodhë që një pjesë e umetit të ngrihet e të bëhet më e mirë. Kjo mundësohet kur gjallërohen dijetarët, me anë të të cilëve Allahu sjell mirësi dhe ndryshon gjendjen e njerëzve. Atëherë, ata bëhen më të mirë sesa brezat para tyre.

Për sa u përket sahabëve, askush nuk mund të barazohet me statusin e tyre si shokë të Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Për këtë arsye, shembulli ynë ishte me pasuesit e tabiinëve dhe brezat pasues. Madje, edhe tabiinë të veçantë nuk mund të barazohen me sahabët, sado lart të kenë arritur, sepse ata nuk e patën shoqërinë e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Çështje për diskutim:

Cila është urtësia e sprovimit të umetit me këtë imitim, bashkë me të gjitha të këqijat e atyre?

Urtësia qëndron në shfaqjen e përsosmërisë së fesë, pasi feja i kundërshton të gjitha këto të këqija. Kjo tregon se kjo fe ka ardhur për plotësimin e çdo mangësie te popujt e mëparshëm, pasi gjërat qartësohen kur vihen përballë të kundërtave të tyre.

Vërejtje: Pjesën e hadithit: “... përbri tyre si pendët në dy anët e shigjetës së harkut ...”, nuk e kam gjetur në “Sahihun” e Buhariut dhe Muslimit, në vendin që mendoja, prandaj le të hulumtojnë të tjerët.¹

Muslimi përcjell nga Theubani se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Allahu e afroi për mua tokën

¹ Kjo shprehje gjendet në “Musned-in” e imam Ahmedit. (sh. nga botuesi i librit, në arabisht)

dhe unë pashë viset lindore dhe perëndimore të saj. Umeti im do të sundojë aq tokë sa u shfaq para meje. Mua m'u dhanë dy thesare: i kuqi dhe i bardhi. Unë i kërkova Zotit për umetin tim që të mos e shkatërrojë atë me thatësirë të përgjithshme; të mos u japë pushtet armiqve qafirë, mbi ta, e për pasojë të ngadhënjejnë mbi ta. Zoti im më tha: 'O Muhamed! Kur Unë vendos për një çështje, ajo nuk kthehet mbrapsht. Unë të premtoj për umetin tënd që të mos i shkatërroj me thatësirë të përgjithshme dhe nuk do t'u jap pushtet armiqve qafirë të ngadhënjejnë mbi muslimanët, qoftë edhe sikur të mblidhen kafirat kundër muslimanëve nga çdo anë, për sa kohë që muslimanët nuk shfarosin njëri-tjetrin dhe nuk robërojnë njëri-tjetrin.'¹ Këtë hadith e sjell edhe El Burkani në "*Sahih-un*" e tij, por duke shtuar: "Unë druhem për umetin tim nga prijësit që i çojnë njerëzit në humbje. Nëse mbi ta bie shpata, nuk ka për t'u ngritur deri Ditën e Kijametit. Nuk ka për t'u bërë Kijameti pa iu bashkuar një fis nga umeti im idhujtarëve dhe derisa grupe nga umeti im të adhurojnë idhujt. Nga umeti im do të dalin tridhjetë sharlatanë, çdonjëri prej të cilëve do të pretendojë se është profet. Vula e Profetëve jam unë dhe nuk ka Profet tjetër pas meje. Një grup nga umeti im do të vazhdojë në të vërtetën, i ndihmuar. Atyre nuk do t'u bëjnë dëm ata që nuk i ndihmojnë, as ata që i kundërshtojnë, derisa të vijë Urdhri i Allahut të Madhëruar."²

– "... Allahu e afroi për mua tokën dhe unë pashë ..." – Shikimi është me sy, por mund të jetë edhe në ëndërr.

– "... viset lindore dhe perëndimore të saj ..." – Kjo për Allahun nuk është aspak e vështirë, sepse Ai është i Fuqishëm për gjithçka.

¹ Deri këtu është transmetimi i Muslimi.

² Ebu Daudi e transmeton me gjithë shtesën. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

Me fuqinë e Tij Ai e mblodhi tokën, derisa i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e pa se deri ku do të arrinte sundimi i umetit të tij.

A nënkupton kjo se u mblodh toka apo se shikimi i të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u fuqizua aq sa ai të shihte larg? Më e afërt me kuptimin e drejtpërdrejtë të shprehjes është se iu mblodh toka, e jo se iu fuqizua shikimi. Ka dijetarë që mendojnë se iu forcua shikimi, por më pranë të vërtetës është shpjegimi i parë.

Një shembull i përafërt është fotografimi që i bëhet tokës sot, dhe njeriu shikon lindjen dhe perëndimin e saj. Allahu është i Fuqishëm për të bërë çdo gjë. Ai (Subhanehu ue Te‘Ala) është i Fuqishëm që ta mbledhë tokën e ta bëjë të vogël, aq sa shikimi të arrijë nga lindja në perëndim.

Përgjigje ndaj një kundërshtimi

Dikush mund të thotë: ajo çfarë u përmend më lart është e vërtetë nëse do të përputhej me realitetin, por nuk është kështu, sepse po të tkurrej toka aq sa ta kapte shikimi i thjeshtë i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), atëherë ku do të shkonin njerëzit, detrat, malet dhe shkretëtirat?

Përgjigje: Kjo është një çështje *gajbi*, në të cilën nuk lejohet të ndërhysh duke pyetur si dhe pse, por themi se vërtet Ai është i Plotfuqishëm për të bërë çdo gjë. Fuqia e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) është më e madhe se fuqia jonë dhe shumë më e madhe sesa ne mund ta përfytyrojmë. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka lajmëruar për shembull se shejtani qarkullon në trupin e njeriut, siç qarkullon gjaku, por nuk lejohet të pyesim më tej se si. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) është më i ditur për këtë.

Në lidhje me gjërat që nuk mund t’i perceptojmë është detyrë të dorëzohemi plotësisht duke i pranuar. Për këtë arsye, në lidhje me temën e emrave dhe cilësive të Zotit, themi se ato merren sipas kuptimit të drejtpërdrejtë të tyre, duke mos u dhënë formë dhe duke mos u bërë krahasim. Ky është parimi për të cilin kanë rënë në ujdj *ehlu suneti dhe xhemati*.

– “... dhe pashë viset lindore dhe perëndimore të saj ...” – Domethënë, vendet në lindje dhe në perëndim të tokës.

– “... *Umeti im do të sundojë aq tokë sa u shfaq para meje ...*” – Flitet për umetin që i është përgjigjur Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe që i ka besuar atij. Sundimin i këtij umeti do të arrijë në tokë aq sa Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) pa. Kjo është e vërteta, pasi sundimi i këtij umeti u shtri mjaft gjerë nga lindja në perëndim, por nga veriu dhe jugu shumë më pak. Umeti islam arriti në lindje deri në Sind e Indi e më tepër, ndërsa në perëndim deri përtej oqeanit.

– “... *Mua m’u dhanë dy thesare: i kuqi dhe i bardhi ...*” – Ai që ia dha ishte Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), ndërsa dy thesaret janë floriri dhe argjendi, thesaret e Kisras dhe Kajserit. Floririn e kishte Kajseri, kurse argjendin Kisra. Të dy këta kishin edhe florinj, edhe argjend, por shumica e thesarit të Kajserit ishte flori, kurse shumica e thesarit të Kisras ishte argjend.

Pyetje: A iu dhanë këto Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) gjatë jetës së tij apo pas vdekjes?

Këto iu dhanë umetit pas vdekjes së tij, dhe kjo është një lloj sikur t’i ishin dhënë atij. Shtrirja e sundimit të umetit nuk erdhi sepse ishin arabë, siç thonë disa injorantë, por sepse ishin muslimanë dhe ndiqnin udhën e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

– “... *Unë i kërkoja Zotit për umetin tim që të mos e shkatërrojë atë me thatësi të përgjithshme ...*” – Domethënë me shkatërrim të përgjithshëm. Në disa përcjellje thuhet: “... me vit thatësire të përgjithshme”. Thatësira nënkupton mungesën e reshjeve, e cila është shkatërruese. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “O Allah, sill mbi ta vite thatësire, si vitet e Jusufit!”¹ Allahu thotë: “Dhe, me të vërtetë, Ne e shkatërruam popullin e Faraonit me vite thatësire dhe me zi drithërash e frutash.” (Araf, 130). Kuptimi mund të jetë gjithashtu edhe me një vit thatësirë.

– “... *të mos u jap pushtet armiqve kafira, mbi ta, e për pasojë të*

¹ Buhariu.

ngadhënjejnë mbi ta ...” – Të mos sundohen nga armiq, që kanë urrejtje dhe mllef.

– “*Kur Unë vendos për një çështje, ajo nuk kthehet mbrapsht ...*” – Përcaktimi i Allahut është dy llojesh:

a) *Përcaktimi fetar*. Ndoshta ky mund të refuzohet; Allahu e do atë, por krijesat ndoshta nuk e pranojnë.

b) *Përcaktimi i krijimit*. Ky lloj nuk kthehet mbrapsht, por realizohet patjetër.

Që të dyja janë përcaktime me drejtësi, siç thuhet në ajet: “Allahu gjykon me drejtësi e me të vërtetën.” (Gafir, 20).

Për caktimin fetar flet ajeti: “Ndërsa Zoti yt ka urdhëruar (*kada*) që të mos adhurosh askënd e asgjë veç Atij.” (Isra, 23). Sikur këtu të flitej për caktimin e krijimit, të gjithë njerëzit do të adhuronin vetëm Allahun.

Përcaktimin e krijimit e ilustron ajeti tjetër: “Dhe Ne përcaktuam për bijtë e Israilit në Libër (Teurat): Vërtet që ju (Beni Israilët) do të bëni dy herë padrejtësi në tokë, se do të bëheni tiranë dhe tepër kryelartë e të vrazhdë.” (Isra, 4). Allahu nuk përcakton fetarisht padrejtësinë dhe prishjen, por Ai përcakton krijimin e tyre, edhe nëse i urren ato. Allahu nuk e do mosbindjen e as shkatërrimtarët, por ka përcaktuar që ato të jenë për një urtësi të madhe; Ai i ka ndarë krijesat në besimtarë dhe në qafirë, pasi prej kësaj rrjedhin mjaft të mira.

Në hadithin e mësipërm, përcaktimi nënkupton atë të krijimit, të cilin askush nuk mundet ta kthejë mbrapsht, sado kufër e mëkate të ketë. Caktimi i Allahut do të zbatohet, qoftë edhe me njeriun më arrogant. Ai u zbatua me Faraonin, që Allahu e mbyti në ujin me të cilin ai mburrej, e po kështu edhe me njerëzit që kanë kaluar kufijtë, të cilët Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) më pas i ka shkatërruar.

– “*... Kur Unë vendos për një çështje, ajo nuk kthehet mbrapsht ...*”
– Kjo shpreh qartë sundimin dhe pushtetin absolut të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), sepse nuk ka ndonjë sundues tjetër, që nuk kthen kurrë diçka që ka vendosur më parë.

Dije se përcaktimi i Allahut është si dëshira e Tij, i shoqëruar me

urtësi. Ai përcakton vetëm me urtësi. Nga ana tjetër, ajo që Ai nuk e dëshiron, nuk përmban urtësi. Këtë e dëshmon ajeti: “... Por ju nuk mund të dëshironi ndryshe, por veç me dëshirën e Allahut! Ai është vërtet i Gjithëdijshëm e i Urtë Gjithëgjykues.” (Insan 30).

Përfundimisht, Ai dëshiron diçka vetëm me dije dhe urtësi, e jo thjesht si dëshirë, ndryshe nga ç’mendojnë mohuesit e urtësisë së Allahut, për shembull *xhehmitë* e të tjerë. Ata thonë se Ai i vepron gjërat thjesht nga dëshira. Sipas pretendimit të tyre, veprimet e krijesave janë më të sakta se të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), pasi çdo krijesë me logjikë vepron sipas një urtësie të caktuar. Kush është i papjekur, privohet nga pasuria. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Të papjekurve mos u jepni pasuri, të cilën Allahu e ka bërë mjet jetese për ju.” (Nisa, 5).

Pyetje: Ne themi se Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) vepron dhe gjykon vetëm sipas një urtësie të caktuar. Po a është kusht që ne ta njohim këtë urtësi?

Jo, nuk është kusht, sepse ne jemi të dobët për të njohur të gjitha urtësitë e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Vërtet, disa gjërave ne ua dimë urtësinë, por disa të tjerave logjika jonë është e paaftë t’ua dijë urtësinë.

Fjalë: “Kur Unë vendos për një çështje, ajo nuk kthehet mbrapsht ...” nënkupton se ka pasur disa gjëra që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka kërkuar, por që nuk i janë dhënë, sepse Allahu i kishte përcaktuar ndryshe, me dijen dhe urtësinë e Tij, dhe ato vendime nuk mund të tjetërsoheshin.

Megjithatë, përcaktimet e Zotit mund të jenë të lidhura me lutjet e njeriut. Madje çdo përcaktim, ose shumë prej tyre, ka shkaqet e veta. Ato mund të jenë të njohura ose të panjohura. Kështu, për shembull, futja në Xhenet mund të realizohet vetëm përmes plotësimit të shkaqeve të saj, që janë besimi i drejtë dhe veprat e mira. Gjithashtu, Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) ndoshta na pengon të marrim atë çfarë kërkojmë, derisa ne ta lusim Atë. Por ka edhe kërkesa, plotësimi i të cilave nuk përmban urtësi. Atëherë lutësi ose shpërblehet me diçka më të mirë se kërkesa e tij, ose përgjigjja i vonohet dhe i rezervohet tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), ose i shmanget një e keqe më e madhe. Nëse janë plotësuar të gjitha

kushtet e lutjes, dhe ajo nuk plotësohet, themi me siguri se ajo është ruajtur për të, për më vonë.

– “... Unë të premtoj për umetin tënd që të mos i shkatërroj me thatësi të përgjithshme ...” – Kjo ishte përgjigjja e lutjes së parë.

– “... dhe nuk do t’u jap pushtet armiqve kafira të ngadhënjë mbi muslimanët, qoftë edhe sikur të mblidhen kafirat kundër muslimanëve nga çdo anë, për sa kohë që muslimanët nuk shfarosin njëri-tjetrin dhe nuk robërojnë njëri-tjetrin.” – Kjo ishte përgjigjja e lutjes së dytë, e cila është e kushtëzuar: “... për sa kohë që muslimanët nuk shfarosin njëri-tjetrin dhe nuk robërojnë njëri-tjetrin.” Nëse ndodh kjo, atëherë ata do t’i sundojnë armiq kafirë, që nuk janë prej tyre, të cilët do t’ua heqin mburojat.

Përgjigjja e Allahut për lutjen e parë është pa kushtëzues, kurse e dyta është e kushtëzuar, sipas një urtësie të caktuar.

Prej mirësisë së Allahut, ky umet nuk do të shkatërrohet kurrë me thatësira gjithëpërfshirëse. Kushdo që kapet pas rrugës së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), nuk do të shkatërrohet. Nëse thatësira zë një pjesë, do të ketë të tjerë që nuk do të preken.

Nga ana tjetër, nëse disa fillojnë të vrasin dhe të robërojnë njëri-tjetrin, atëherë do të sundohen nga armiq, që nuk janë prej tyre. Dhe kjo ka ndodhur aktualisht. Kur umeti islam ishte i bashkuar, ndihmues në të drejtën, kundër së rremes, kishte autoritet, por pasi u përçanë dhe kur disa prej tyre filluan të vrasin, shfarosin dhe të robërojnë njëri-tjetrin, Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) bëri që ata të sundoheshin nga armiq, që nuk ishin prej tyre.

Sundimi më i rëndë që unë di, ka qenë ai i tartarëve. Ata vranë në Bagdat më shumë se pesëqind dijetarë brenda një dite, dhe kjo është e tmerrshme. Ata vranë kalifin, librat islamë i bënë urë mbi lumë, duke i shkelur me këmbë, u çanin barkun grave shtatzëna, ua nxirrnin foshnjat e gjalla, që lëviznin para syve të tyre dhe pastaj i vrisnin; nëna që ishte e gjallë, e shikonte këtë skenë, pastaj vdiste.

Ibn Ethiri në “*El Kamil*” shkruan:

“Kalova vite pa pranuar të flisja për këtë ngjarje, për dimensionet e mëdha të saj, ngaqë e urreja. Bëja një hap para, sërish prapësohesha. E kush e ka të lehtë të flasë për gjëmën e Islamit dhe

të muslimanëve? Kush e ka të lehtë t'i sjellë ndër mend këto?! Ah, më mirë të mos më kish lindur nëna! Më mirë të kisha vdekur para asaj ngjarjeje dhe të isha harruar krejt! Shokët më shtynin për të kundërtën, por unë rezistoj. Pastaj mendova që kështu nuk kishte dobi ...”

E më tej, ai flet gjerë e gjatë, duke përshkruar episode nga më të dhimbshmet. Kush dëshiron të dijë më shumë për ngjarjet e vitit 618 hixhri, le të lexojë librin e lartpërmendur.

Hadithi është argument për ndalimin e luftës ndërmjet muslimanëve, për ndalimin e vrasjes dhe robërimit të njëri-tjetrit. Ai dëshmon që umeti e ka detyrë të jetë i bashkuar, në qoftë se dëshiron të ketë pushtetin e t'u frikësohen të tjerët.

– “... *Unë druham për umetin tim nga prijësit që i çojnë njerëzit në humbje...*” – Profeti tregon se ai i druhej umetit vetëm nga udhëheqësit që i çojnë njerëzit në humbje. Prijësit mund të udhëheqin në të mira ose në të këqija. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) ka thënë për prijësit e së mirës: “Dhe Ne bëmë nga mesi i tyre prijës, që udhëzojnë nën Urdhrin Tonë, që janë të duruar dhe që besojnë me vendosmëri në shenjat Tona.” (Sexhde, 24). Ndërsa për Faraonin, Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Dhe Ne i bëmë ata prijës drejt Zjarrit, të cilët në Ditën e Ringjalljes nuk do të ndihmohen aspak.” (Kasas, 41). Pjesa e hadithit të temës: “*prijësit që i çojnë njerëzit në humbje*” flet për prijësit e këqinj.

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë të vërtetën, sepse fatkeqësia më e madhe dhe më e frikshme për umetin, janë prijësit që i çojnë njerëzit në humbje, si: krerët e *xhehmive*, *mutezilëve* e të tjerë, për shkak të të cilëve umeti u përça. Qëllimi me togun: “*prijësit që i çojnë njerëzit në humbje*” janë ata që udhëheqin njerëzit në emër të Sheriatit, duke i nënshtruar njerëzit me dhunë. Këtu hyjnë pushtetarët e prishur, edhe dijetarët që çojnë njerëzit në humbje, të cilët pretendojnë se janë në rrugën e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), por që në fakt janë armiqtë më të egër të tij. Imam Ahmedi ka thënë: “Sikur të kisha një lutje që do të më pranohej, do ta bëja për udhëheqësin, sepse rregullimi i tij është rregullim i umetit.”

– “... Nëse mbi ta bie shpata, nuk ka për t’u ngritur deri Ditën e Kijametit ...” – Kjo profeci është një nga mrekullitë e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), e cila u përmbush. Që kur mbi këtë umet ra shpata për herë të parë, kur u vra kalifi Othmani (r.a.), ajo nuk u ngrit më; lufta ndërmjet muslimanëve vazhdon, duke vrarë dhe robëruar njëri-tjetrin.

– “... Nuk ka për t’u bërë Kijameti pa u takuar një fis nga umeti im me idhujtarët ...” – A nënkupton ky takim, bashkimin fizik, konkret, që do të thotë se ky fis do të futet në radhët e idhujtarëve e do të përzihet me ta; apo do të jetë bashkim në ide e vepra, që do të thotë se do të bëjë veprat e idhujtarëve, apo nënkuptohen të dyja? Nga kuptimi i drejtpërdrejtë rrjedhin të dyja interpretimet.

– “... dhe derisa grupe nga umeti im të adhurojnë idhujt ...” – Kjo ka ndodhur në çdo vend të muslimanëve, duke adhuroar varret, duke shenjtëruar të vdekurit, duke iu lutur dhe duke iu mbështetur atyre. Nuk është kusht që të jenë fise të caktuara; disa mund të jenë nga njëri fis, disa nga tjetri, e kështu bëjnë grupin.

– “... Nga umeti im do të dalin tridhjetë sharlatanë ...” - Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka kufizuar me numër. Çdonjëri prej tyre do të pretendojë se është profet dhe se i ka zbritur shpallja hyjnore. Janë sharlatanë, sepse Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) qe vula e Profetëve, pas të cilit nuk ka Profet tjetër. Kush e mban veten për Profet, pas Profetit tonë (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ai është sharlatan, qafir dhe lejohet të vritet e t’i merret pasuria. Edhe ai që e beson është qafir, lejohet të vritet dhe t’i merret pasuria, sepse nuk është musliman dhe as anëtar i umetit të Muhamedit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Po kështu, kush pretendon se është më i mirë se Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), apo se e merr shpalljen drejtpërdrejt nga Allahu, ndërsa Muhamedi e merrte nëpërmjet engjëllit, është gënjeshtar, qafir dhe lejohet të vritet e t’i merret pasuria.

A janë shfaqur këta tridhjetë sharlatanë apo jo? Disa kanë dalë, disa të tjerë pritet të dalin, sepse i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk e përcaktoi se kur. Përderisa Kijameti akoma nuk

është bërë, atëherë mund të dalin edhe të tjerë.

– “... *Vula e Profetëve jam unë ...*” - Kjo do të thotë që ai ishte i fundit i tyre, e përforcuar me fjalinë: “... nuk ka Profet pas meje ...”.

Po hadithi i saktë që flet për zbritjen e Isait, birit të Merjemes, pranë fundit të botës, meqenëse ai është Profet, i cili do të heqë *xhizjen* dhe nuk do të pranojë fe tjetër veç Islamit? Për këtë themi se ai ishte Profet përpara Muhamedit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Për sa i përket faktit se ai do të heqë *xhizjen* dhe se nuk do të pranojë fe tjetër veç Islamit, themi se këto nuk përbëjnë ligj të ri, që shfuqizon *xhizjen*, përkundrazi, kjo është e ligjëruar nga Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), i cili e ka parathënë dhe miratuar.

– “... *Një grup nga umeti im do të vazhdojë në të vërtetën, i ndihmuar.*” – Kuptimi është se ata do të jenë të ndihmuar deri në fund.

Është mirësi e Allahut të Lartësuar që kjo përmendet pasi u tha se një fis nga umeti do të bashkohet me idhujtarët, se disa grupe do të adhurojnë idhujt dhe se disa njerëz do të hiqen si profetë. Shfaqje të tilla kundërshtojnë plotësisht shehadetin: idhujtaria kundërshton dëshminë se “nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut”, kurse pretendimi i profetësisë kundërshton dëshminë se “Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Allahut”, të cilat janë dy themelet e teuhidit dhe të vetë Islamit.

Pas dy fakteve të dhimbshme, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk i la njerëzit ta humbnin shpresat, por u tha: “Një grup nga umeti im do të vazhdojë në të vërtetën, i ndihmuar”. Pra, ky grup do të jetë gjithmonë në të vërtetën dhe, njëkohësisht, i ndihmuar.

Siç shihet, nuk është përcaktuar vendndodhja e këtij grupi, që do të thotë se mund të jetë në çdo vend: në Mekë, Medinë, Irak e të tjerë. E rëndësishme është se ky grup, sado i shpërndarë të jetë në vende të ndryshme, është një, i ndihmuar në të vërtetën, i pacenueshëm nga ata që nuk i ndihmojnë dhe që i kundërshtojnë, derisa të vijë Urdhri i Allahut.

Disa selefë kanë thënë se grupi i shpëtuar janë studiuesit e hadithit (*ehlul hadith*). A është e saktë kjo? Jo, nuk është tërësisht e

saktë, megjithëse përgjigjja duhet të shtjellohet.

Nëse me termin “studiuues të hadithit” nënkuptohen ata të cilët punojnë me hadithet, duke njohur vargun e përcjellësve dhe tekstet e tyre, ku referohen dijetarët e *fik'h*-ut, *tefsir*-it e të tjerë si ata, kjo nuk është e saktë, sepse edhe dijetarët e *tefsir*-it dhe ata të *fik'h*-ut, të cilët kërkimet e tyre i bazojnë në tekstet fetare, në realitet janë *ehlul hadith*. Pra, nuk është e posaçme veç për studiuuesit e hadithit, sepse dituritë e fesë përfshijnë edhe *tefsir*-in, *fikh*-un e të tjera.

Përfundimisht, çdokush që i përmbahet Kuranit dhe Sunetit, është *ehlul hadith*, në kuptimin e përgjithshëm. *Ehlul hadith* janë të gjithë ata të cilët kujdesen që veprat të jenë sipas traditës së Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Shejhu i Islamit Ibn Tejmije, nuk konsiderohet si studiuues i thellë i hadithit, e megjithatë, ai ishte ngritësi i flamurit të hadithit. Po kështu, edhe për imam Ahmedin (Allahu e mëshiroftë!), dijetarët e *fik'h*-ut thonë se ai qe *fakih*, ndërsa studiuuesit e hadithit thonë se ai qe *muhadith*, ndërkohë që ai ishte i pari në *fikh*, *hadith* dhe *tefsir*.

Nuk ka dyshim se zbatuesit më të mirë të hadithit, janë atë që merren me të. Prej qëndrimit se grupi i shpëtuar janë *ehlul hadith*, mund të mendohet që ata janë vetëm studiuuesit e thelluar të hadithit, duke përjashtuar kështu të tjerët. Rrjedhimisht, ky emërtim është i saktë veç nëse merret me kuptimin e tij të përgjithshëm.

– “... *Atyre nuk do t’u bëjnë dëm ata që nuk i ndihmojnë, as ata që i kundërshtojnë ...*” – Kjo tregon se do të ketë njerëz që do t’i braktisin ata, por nuk do t’i dëmtojnë, sepse çështjet janë në dorë të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Dije se, sikur i gjithë umeti të mblidhet për të të bërë keq, nuk mund të të dëmtojë, përveç se aq sa e ka shkruar Allahu për ty ...”.¹ Edhe ata nuk do të dëmtohen prej njerëzve që i kundërshtojnë, sepse kanë ndihmën e Allahut. Nëse Allahu e ndihmon dikë, askush nuk mund ta cenojë atë.

– “... *derisa të vijë Urdhri i Allahut.*” – Kjo do të ndodhë në prag të Kijametit, kur, me urdhrin e Allahut, do të merret çdo shpirt

¹ Transmeton Ahmedin dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

besimtar, ndërsa mbi tokë do të mbesin veç krijesat më të liga; e mbi këta të fundit do të bëhet Kijameti.

Pjesa e hadithit që lidhet drejtpërdrejt me temën tonë është: “Nuk ka për t’u bërë Kijameti pa u takuar një fis nga umeti im me idhujtarët dhe derisa grupe nga umeti im të adhurojnë idhujt”.

| **Dobitë e temës**

| ➤ Komenti i ajetit të sures “Nisa”.

Ky ajet është: “A nuk i sheh ata të cilëve u është dhënë pjesë nga Libri? Ata besojnë në *xhibt* dhe *tagut*...”.

| ➤ Komenti i ajetit të sures “Maide”.

“Thuaj: ‘A doni t’ju tregoj se kush do ndëshkohet më rëndë se kjo (që ju e mendoni të keqe) tek Allahu? Ata që Allahu i ka mallkuar dhe me të cilët është zemëruar, duke shndërruar disa prej tyre në majmunë dhe derra, si dhe ata që adhurojnë *tagut*-in, ata janë në vendin më të mjerë dhe janë tepër larg nga rruga e drejtë.’”. Fragmenti që lidhet me temën është: “... si dhe ata që adhurojnë *tagut*-in ...”.

| ➤ Komenti i ajetit të sures Kehf.

“... pastaj, ata që fituan mbi çështjen e tyre, thanë: ‘Ne do të ndërtojmë një faltore mbi ta.’”

| ➤ Kjo pikë është edhe më e rëndësishmja: Cili është kuptimi i besimit në *xhibt* dhe *tagut*? A është besimi i zemrës? Apo është pajtimi me adhuruesit e tyre, nga njëra anë, duke i urryer ata dhe duke e ditur se janë të pavërtetë, nga ana tjetër?

Nuk ka dyshim se fjalët e ajetit e përmbajnë besimin me zemër, por për sa i përket interpretimit të dytë, ai ka nevojë për shpjegim. Kështu, nëse pajtohesh me adhuruesit e *xhibt*-it dhe *tagut*-it, duke menduar se ata janë të vërtetë, kjo përbën kufër. Nga ana tjetër, nëse pajtohesh me adhuruesit e tyre, duke menduar se *xhibt*-i dhe *tagut*-i nuk janë të vërtetë, nuk bën kufër, por ndodhesh në një rrezik të madh, në një rrugë drejt *kufri*-it, Allahu na ruajt!

- Deklarimi i çifutëve se qafirët, që njiheshin mirë si të tillë, ishin në udhë më të drejtë se besimtarët.

Ky qëndrim është kufër dhe dalje nga Islami, sepse cilido që pretendon se qafirët, të shpallur hapur si të tillë, janë në rrugë më të drejtë se muslimanët, është qafir, për arsye se i jep përparësi mohimit ndaj besimit.

- Kjo pikë është edhe qëllimi i temës: në këtë umet do të ekzistojë patjetër dukuria e adhurimit të idhujve, – siç është parathënë në hadithin e Ebu Seidit (r.a.).
- Deklarimi i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për ndodhjen e tij – domethënë adhurimin e idhujve.

Autori thotë që në titull: “Argumentet se nga ky umet do të ketë njerëz që do të adhurojnë idhujt”, kurse Ebu Seidit (r.a.) përcjell hadithin e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Do të pasoni rrugët e atyre që ishin para jush, përbri tyre, si pendët në dy anët e shigjetës së harkut, aq sa, sikur ata të futen në vrimën e *dabit* - hardhucës, edhe ju do të futeshit atje.” I thanë: “O i Dërguari i Allahut, jehudët dhe të krishterët? Ai u përgjigj: “Kë tjetër veç tyre!” Ky qe një paralajmërim për rënien e këtij umeti në ato të këqija ku ranë popujt e mëparshëm.

- Më e çuditshmja nga të gjitha është shfaqja e pretenduesve të profetësisë, siç qe Muhtari, ndonëse deklaronte shehadetin, pohonte se i përket umetit të

Muhamedit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), se ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte i vërtetë, se Kurani në të cilin përmendet, se Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është vula e Profetëve, është i vërtetë! Pavarësisht pra nga tërë këto kundërshti të qarta, pati njerëz që i besuan këtij sharlatani. Muhtari u shfaq në fund të periudhës së sahabëve. Ai u pasua nga një numër i madh njerëzish.

Emri i tij ishte Ibn Ebu Ubejd eth Thekafi. Si fillim, Muhtari shfaqti një dashuri të madhe për familjen e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), *Al el Bejt*-in. Ai u bëri thirrje njerëzve që të ngriheshin për hakmarrje ndaj vrasjes së Husejnit, ndërsa vetë ndoqi dhe vrau shumë prej atyre që morën pjesë ose ndihmuan në këtë krim. Kështu, njerëzit e thjeshtë u gënjyen pas tij. Më pas, ai u vetëshpall “profet”, duke mëtuar se i vinte dhe e takonte engjëlli Xhibril. Pa dyshim se kjo është për t’u habitur. Të pretendosh profetësinë, duke deklaruar se Kurani është i vërtetë, teksa në Kuran thuhet se Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte vula e Profetëve! E si mund të jetë i vërtetë ky njeri e si mund t’i besohet atij? Por ai të cilit Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) nuk i jep dritë nuk ka për të pasur dritë.

- Përgëzimi se e vërteta nuk ka për t’u zhdukur krejtësisht në këtë umet, siç ndodhi me ata të mëparshmit, por do të jetë gjithmonë një grup që do ta ruajë atë.

Ky grup do të jetë i ndihmuar deri në Ditën e Kijametit, siç thotë pjesa e fundit e hadithit: “... Një grup nga umeti im do të vazhdojë në të vërtetën, i ndihmuar. Atyre nuk do t’u bëjnë dëm ata që nuk i ndihmojnë, as ata që i kundërshtojnë, derisa të vijë Urdhri i Allahut të Madhëruar.”

- Është mrekulli e madhe që, edhe pse janë pak në numër, ata nuk do të dëmtohen prej atyre që nuk i

ndihmojnë dhe që i kundërshtojnë.

Shumica e njerëzve, që janë ndryshe nga kjo pakicë, nuk mund t'i dëmtojnë ata! Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Sa herë një grup i vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe me Vullnetin dhe Lejen e Allahut? Allahu është me durimtarët." (Bekare, 249).

- Ky grup do të vazhdojë të jetë derisa të vijë Ora e Kijametit.
- Mrekullitë e mëdha që tregohen në këtë hadith, se si Allahu e mblodhi Tokën, lindjen dhe perëndimin e saj, për Pejgamberin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe se si ai (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e shpjegoi këtë. Dhe në fakt, ndodhi ashtu siç paratha Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): umeti pati suksese në drejtim të lindjes dhe perëndimit, ndryshe nga kahu i jugut dhe veriut të globit. Mrekulli ishin edhe profecitë e tjera: se do t'i jepeshin dy thesaret; se Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) iu plotësuan dy lutjet e para dhe nuk iu pranua e treta; se pasi të bjerë shpata mbi këtë umet, ajo nuk do të ngrihet më; se disa prej këtij umeti do të shkatërrojnë dhe do të robërojnë njëri-tjetrin; droja nga prijësit prijësit që i çojnë njerëzit në humbje; shfaqja në këtë umet e profetëve sharlatanë dhe qëndrimi i vijueshëm i një grupi në të vërtetën, duke qenë i ndihmuar. Të gjitha këto ndodhën ashtu siç i përshkroi Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), megjithëse asokohe ishin larg logjikës.

Mrekullitë janë shenja me të cilat Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) përforcoi të Dërguarit e Tij dhe shenja treguese për besnikërinë e tyre, siç ishin ato që u renditën më lart.

Pjesa e hadithit që flet për plotësimin e vetëm dy lutjeve, nga tre

që u bënë, përforcohet nga hadithi tjetër i Amir Ibn Sadit, i cili përcjell nga i ati, që tregon: “Një ditë, kur i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) po vinte nga El Alija, kaloi pranë xhamisë Beni Muavija, dhe u fut në të. Atje fali dy rekatë namaz, dhe bashkë me të u falëm edhe ne. Ai bëri një lutje të gjatë, pastaj u kthye nga ne dhe tha: “I kërkova Zotit tim tri gjëra: Ai më dha dy dhe nuk më plotësoi një. I kërkova Zotit tim që të mos e shkatërrojë umetin tim me thatësi, dhe atë ma dha. I kërkova Atij që të mos e shkatërrojë umetin tim me përmbytje, dhe atë ma dha. I kërkova Atij që të mos e bëjë të mundur luftën e tyre ndërmjet njëri njëri-tjetrit, por këtë nuk ma plotësoi.”¹.

Për profecinë e tridhjetë profetëve sharlatanë, Ibn Haxheri ka thënë: “Numri tridhjetë, nuk do të thotë se ata do të jenë fiks tridhjetë; numri i tyre është më i madh se kaq.”

Nga ana ime, (thotë Ibn Uttejmini) unë mendoj se numri tridhjetë tregon kufirin më të ulët, që do të thotë se ata nuk do të jenë më pak se kaq. Kuptimin e drejtpërdrejtë të shprehjes ne nuk e marrim parasysh, për shkak se realiteti tregon ndryshe. Ky – dhe Allahu është më i Ditur – është edhe shkaku, ndoshta, që autori (Allahu e mëshiroftë!) nuk e ka analizuar çështjen e numrit, megjithëse ai është deklaruar në hadith.

- Fakti që droja e vetme që kishte Pejgamberi për umetin ishte prej prijësve që i çojnë njerëzit në humbje.

Udhëheqësit mund të jenë në tri fusha: politikë, dituri dhe adhurim. Nëse këta janë të humbur duhet të frikësohesh, sepse ata ndiqen nga njerëz të tjerë. Udhëheqësit në politikë mund t’i humbin njerëzit nëpërmjet pushtetit dhe autoritetit, dijetarët nëpërmjet direktivave që lëshojnë, ndërsa adhuruesit mund të mashtrojnë të tjerët me sjelljen e tyre. Por, nëse këta janë në rrugë të drejtë, prej tyre mund të udhëzohen shumë njerëz.

- Vërejtje për konceptin e adhurimit të idhujve.

¹ Muslimi.

Me fjalë të tjera, idhujtari nuk do të thotë vetëm që të bësh rukú e sexhde për idhujt, përkundrazi, koncepti i saj përfshin edhe ndjekjen e të humburve, kur ata lejojnë atë që e ka ndaluar Allahu dhe kur ndalojnë atë që Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) e ka lejuar.

Tema 24

| Argumentet që flasin për magjinë.

Kuptimi gjuhësor i fjalës *es sihr* (magji) është: diçka që vjen prej një shkaku misterioz dhe të padukshëm. Fundi i natës quhet *es sehr*, sepse veprimet që kryhen në atë kohë janë të fshehta; ose *es suhur* – ngrënia që bëhet në fund të natës, para agimit. Pra, çdo gjë që shkakun e ka të fshehtë quhet *sih*r.

Në fe, fjala *es sihr* ka dy kuptime:

1. Nyje dhe yshtje. Ato janë lexime dhe hajmali, me anë të të cilave magjistari arrin t'i vendosë shejtanët në shërbim të tij, për të dëmtuar një tjetër. Por Allahu i Lartësuar thotë: "... por ata nuk mund të dëmtonin ndonjë, përveçse me Vullnetin dhe Lejen e Allahut." (Bekare, 102)

2. Ilaçe dhe droga, të cilat ndikojnë në trupin, mendjen, dëshirat dhe prirjet e njeriut.

Me anë të *sih*r-it, njeriu mund të largohet nga diçka që e do dhe të anojë nga diçka që nuk e do. Ata mund ta bëjnë një burrë të lidhet pas bashkëshortes ose ndonjë gruaje tjetër si një kafshë manare, që ajo ta komandojë si të dojë.

Magjia ndikon në trupin e personit, duke e dobësuar atë gradualisht, derisa ta shkatërrojë përfundimisht. Ajo ndikon në mendjen e tij, duke e bërë atë të shohë gjëra jo ashtu siç janë në realitet, ose edhe ta çmendë, Allahu na ruajt!

Magjia është dy llojesh:

a. Vepër idhujtarie. Kjo bëhet nëpërmjet shejtanëve, të cilëve magjistari u bindet, me qëllim që t'i përdorë kundër një njeriu.

b. Tejkalim i normave të Sheriatit dhe mëkat. Kjo bëhet

nëpërmjet barnave, drogave etj.

Kështu prekëm një çështje të rëndësishme: a del nga feja magjistari, apo jo? Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme. Disa thonë se magjistari bën kufër, e disa të tjerë thonë jo, por ndarja e mësipërme e qartëson gjykimin e drejtë. Kush bën magji me ndërmjetësimin e shejtanëve, ka bërë kufër, sepse ajo realizohet në të shumtën e rasteve vetëm me anë të shirkut, sipas fjalës së Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “Ata ndoqën atë që shejtanët e nxorën në kohën e sundimit të Sulejmanit. Nuk mohoi Sulejmani, por shejtanët mohuan, duke u mësuar njerëzve magjinë dhe gjëra të tilla që zbritën në Babiloni prej dy melekëve, Harut dhe Marut. Në të vërtetë, asnjëri prej tyre nuk i mësoi ndokujt gjëra të tilla, veç pasi u thanë: ‘Ne jemi vetëm sprovë, kështu që mos u bëni mosbesimtarë ...’” deri te: “... por ata nuk mund të dëmtonin ndokënd, përveçse me Vullnetin dhe Lejen e Allahut. Dhe ata mësuan atë gjë që i dëmtonte dhe nuk u sillte përfitim. E në të vërtetë, ata e dinin se blerësit e saj (të magjisë) nuk do të kishin aspak pjesë nga Bota e Pastajme.” (Bekare, 102). Ndërsa kush e bën magjinë me substanca dhe droga të ndryshme nuk ka bërë kufër, por konsiderohet si tejkalues i kufijve, si gjynahqar.

Për sa i përket çështjes së dënimit me vdekje të magjistarit, themi: nëse bën magji kufri, atëherë ekzekutohet si *murted* (i dalë nga feja). Bën përjashtim rasti kur ai pendohet, sipas një qëndrimi, i cili është edhe më i sakti. Nëse magjia nuk është e llojit kufër, magjistari mund të dënohet sërish me vdekje, për t’u ruajtur nga e keqja që përhap ai. Kjo çështje varet nga gjykimi i kreut të vendit.

Sipas kuptimit të drejtpërdrejtë të argumenteve të sjella nga autori, magjistari duhet të ekzekutohet, në çfarëdo rrethane a gjendje qoftë.

Magjia pa dyshim ka ndikimin e saj, por ajo nuk i tjetëron sendet në sende të tjera, sepse këtë nuk mund ta bëjë askush tjetër përveç Allahut të Madhëruar. Nëpërmjet magjisë, objekti duket sikur ndryshohet apo sikur lëviz, siç ndodhi me Musain para magjistarëve të Faraonit, kur, nga magjia e tyre, atij iu duk se shkopinj të dhe litarët që ata hodhën lëviznin si gjarpërinj.

Përse futet tema e magjisë në librin e *teuhid-it*? Sepse shumë lloje të magjisë realizohen vetëm me anë të *shirk*-ut. Shejtanët i

shërbejnë njeriut veçse për interes të tyre, dhe dihet se qëllimi i tyre është që të humbin njerëzit e t'i fusin në politeizëm.

Në këtë temë, autori ka përmendur dy ajete:

Ajeti 1: “E, në fakt, ata e dinin se blerësit e saj (magjisë) nuk do të kishin aspak pjesë nga ahireti.” (Bekare, 102)

– “... *ata e dinin se blerësit e saj ...*” – Kuptimi i “blerësit e saj” është: “mësimi i saj”.

– “... *nuk do të kishin aspak pjesë nga ahireti.*” – Për çdo njeri që nuk ka pjesë në botën tjetër, do të thotë se atij i janë shuar të gjitha veprat. Njeriu nuk fiton asgjë në botën tjetër kur ka bërë vepra kufri, por kur ka bërë gjynahe, atëherë pjesën e ahiretit ka për ta gjetur të cinguar.

Ajeti 2: “Ata besojnë në *xhibt* dhe *tagut ...*” (Nisa, 51).

Omeri (r.a.) ka thënë që “*xhibt*” është magjia, ndërsa “*tagut*” është shejtani.

– “*Ata besojnë në xhibt ...*” – “*Ata*” janë judejtë, ndërsa “*xhibt*” do të thotë magji, siç e ka komentuar Omer Ibn el Hatabi (r.a.).

Judejtë ishin populli që e mësonin dhe e ushtronin më shumë magjinë, duke pretenduar se atë ua kishte mësuar Sulejmani (*alejhi selam*). Ata i kaluan kufijtë kur i bënë magji Pejgamberit (sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem).

– “... *tagut ...*” – Përkufizimi më i saktë për këtë koncept është: Çdo gjë ndaj të cilës njeriu i tejkalon kufijtë, duke e pasuar, adhuruar ose duke iu bindur. Kur thuhet “duke e adhuruar” nënkuptohet: me dijen dhe pëlqimin e atij që adhurohet. Kështu ka thënë Ibn Kajimi – Allahu e mëshiroftë! Në fillim të librit, kur është folur për ajetin: “... dhe shmanguni nga *tagut*-ët ...”, është sqaruar mirë ky term.

Lidhjen me temën e bën komenti që Prijësi i besimtarëve, Omeri (r.a.), i ka bërë fjalës “*xhibt*”. Ndërsa shpjegimi që “*tagut*” është

shejtani, në fakt është në formën e shembullit. Ndonjëherë selefët i komentojnë fjalët duke bërë një përngjasim, siç është ajeti: “Pastaj Ne u dhamë për trashëgim Librin (Kuranin) robërve Tanë, të cilët Ne i zgjodhëm. Disa prej tyre i bëjnë dëm vetes, disa janë në rrugë të mesme, ndërsa disa, me lejen e Allahut janë të parët në mirësi ...” (Fatir, 32).

Disa komentatorë të Kuranit kanë thënë se dëmtuesit e vetes janë ata që falen pasi ka kaluar koha e namazit; ata të cilët ndjekin rrugë të mesme, janë ata që e falin në fundin e kohës, ndërsa të parët në mirësi janë ata që e falin në fillim të kohës. Ky ishte vetëm një nga shumë shembuj. Ajeti nuk bën kufizime, prandaj të tjerë e komentojnë se ata që i bëjnë dëm vetes janë ata që nuk japin zekatin; ata të cilët ndjekin rrugë të mesme janë ata që e japin zekatin, por nuk japin sadaka, ndërsa të parët në mirësi janë ata që e japin edhe zekatin, edhe sadakanë.

Shpjegimi se “*tagut*-i” është “shejtan”, është dhënë si ilustrim, sepse termi “*tagut*” është më përfshirës se termi “*shejtan*”. Për shembull, idhujt janë *tagut*-ë, siç thotë Allahu: “... dhe ata të cilët adhuruan *tagut*-in ...”. (Maide, 60). Gjithashtu, dijetarët dhe udhëheqësit të cilët i humbin njerëzit, konsiderohen *tagut*-ë, sepse kalojnë caqet, duke bërë diçka që nuk u takon.

▮ Xhabiri ka thënë: “*Tagut*-ë janë falltarët, të cilëve u zbrisnin shejtanët; çdo lagje kishte nga një të tillë.”

Edhe ky është një ilustrim, sepse falltarët i konsideroj prej tagutëve. Ndërsa për “falltarin” është thënë: “ai që tregon se çfarë ke fshehur në mendje” ose “ai që tregon për misteret në të ardhmen.” Ishin shejtanët ata që u përcillnin falltarëve lajmet që përgjonin në qiell. Në epokën paraislamike, çdo lagje e arabëve kishte nga një falltar, ku njerëzit shkonin për tu gjykuar tek ata. Por *tagut*-ët nuk janë vetëm falltarë, prandaj themi se Xhabiri ka sjellë vetëm një ilustrim, ashtu siç bëri Omeri (r.a.).

▮ Ebu Hurejra përcjell se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Largohuni nga shtatë vepra shkatërruese!” I thanë: “O i Dërguari i Allahut, cilat janë

ato?” Ai u përgjigj: “Politeizmi, magjia, vrasja e njeriut që e ka ndaluar Allahu – përveçse kur e kërkon e drejta, ngrënia e kamatës, përfitimi nga pasuria e jetimit, braktisja e fushëbetejës dhe shpifja ndaj grave të ndershme besimtare.”¹

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte këshilluesi më i mirë për njerëzit. Ai i paralajmëroi ata për çdo gjë që i dëmton në fenë dhe jetën e tyre. Ai ka thënë: “Largohuni...”, formë kjo më e goditur sesa thjesht “mos e bëni”, sepse kur largohesh nga diçka, je më i sigurt nga ajo sesa kur i rri pranë dhe nuk e prek.

– “... shtatë vepra shkatërruese ...” – Ky nuk është numër i kufizuar, sepse ka edhe vepra të tjera shkatërruese. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka përdorur edhe herë të tjera këtë stil, duke përmendur një numër të caktuar, por që ai numër nuk ishte i kufizuar, siç ndodh në hadithin: “Shtatë kategori njerëzish Allahu do t’i fusë nën hijen e Tij,² atë ditë kur nuk do të ketë hije tjetër veç saj ...”³

Përmendet numri shtatë, por ka edhe kategori të tjera që do të futen nën hijen e Fronit të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). I tillë është edhe hadithi: “Ditën e Gjykimit, tri lloje njerëzish Allahu nuk do t’u flasë ...”⁴

¹ Buhariu.

² “Nën hijen e Tij” do të thotë: “Nën hijen e Fronit të Tij”, siç përkthuhet në disa hadithe të tjera.

³ Transmeton Buhariu dhe Muslimi. Hadithi i plotë: “Shtatë kategori njerëzish Allahu do t’i fusë nën hijen e Tij, atë ditë kur nuk do të ketë hije tjetër veç saj, prijësin e drejtë; një të ri që rritet duke adhuruar Allahun; një burrë që e ka zemrën të lidhur me xhaminë; dy burra që duhen për hir të Allahut, të cilët bashkohen për hir të kësaj dashurie dhe vazhdojnë kështu derisa ndahen; një burrë të cilin një grua me pozitë dhe e bukur e fton për imoralitet, por ai i thotë: ‘Unë i frikësohem Allahut’; një person që jep një sadaka dhe e fsheh aq shumë, sa që e majta nuk e di se çfarë ka dhënë e djathta dhe një burrë që e përmend Allahun i vetmuar e i mbushen sytë me lot.”

⁴ Muslimi. Hadithi i plotë: “Ditën e Gjykimit, tri lloje njerëzish Allahu nuk do t’u flasë, nuk do t’i shikojë dhe nuk do t’i pastrojë nga gjynahet, e këta do të marrin ndëshkim të dhimbshëm.” Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e përsëriti tri herë këtë, sa që unë i thashë: “Të privuar nga mirësitë e të dështuar qofshin! Cilët janë ata, o i Dërguari i Allahut?” Ai u përgjigj: “Ai që e lëshon poshtë rrobën (nën nyjen e këmbës, për

Shembuj të tillë ka shumë. Megjithatë, edhe sikur të pranojmë që në hadithin e Ebu Hurejres shifra shpreh numrin e saktë, për shkak se vjen me nyjën shquese “el”, themi se kjo është bërë për të treguar veprat më të rënda ndër mëkatet e mëdha.

– “... O i Dërguari i Allahut, cilat janë ato?’...” – Sahabët ishin njerëzit më të përkushtuar ndaj diturisë. Kur Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u thoshte diçka të paqartë, ata kërkonin shpjegimin e saj. Edhe në këtë rast, ata donin të dinin se cilat ishin veprat shkatërruese, me qëllim që të ruheshin prej tyre, dhe ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ua tregoi.

Megjithatë, kur ishte më mirë që diçka të mos shtjellohej më tej, i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk e bënte këtë, si për shembull hadithi: “Allahu ka nëntëdhjetë e nëntë emra, të cilët kush i mëson përmendësh, hyn në Xhenet.”¹ Nuk ka ardhur ndonjë tekst i saktë që të tregojë se cilët janë këta emra, pavarësisht se ka pasur përpjekje që të saktësojnë listën me nëntëdhjetë e nëntë emrat, e që nuk ia kanë arritur. Shejhu i Islamit Ibn Tejmije ka thënë se të gjithë studiuesit e hadithit janë të mendimit se nuk është e saktë që kjo listë është dhënë nga Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Të vërtetën ka thënë dijetari, pasi vetë kundërshtitë që ka ngjallur kjo çështje dëshmojnë se ai qëndrim është i drejtë.

Kush është përpjekur ta vlerësojë si të saktë, thotë se shpërblimi që përshkruhet në hadith është i madh, për këtë arsye është e pamundur që sahabët të mos pyesnin për hollësi e që Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të mos ua shpjegonte, duke e humbur kështu shpërblimin.

Megjithatë, ne themi se ky nuk është kusht. Sikur nëntëdhjetë e nëntë emrat të ishin përcaktuar, atëherë ata do të ishin më të qarta për njerëzit se drita e diellit, e do të gjendeshin në *Sahih*-ët e Buhariut, Muslimit e në të tjerë, si diçka e domosdoshme për t’u mësuar e për t’u arritur. Atëherë, si është e mundur që ky informacion vjen i dobët dhe me shkëputje?! Profeti (sal-lAllahu

mendjemadhësi), ai që kur fal diçka, e përmend, dhe ai që shet një mall përmes betimit të rremë.”

¹ Buhariu.

‘alejhi ue sel-lem) nuk i përcaktoi ato për një urtësi të madhe, që është kërkimi i tyre në Librin e Allahut dhe Sunetin e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Kështu, kush interesohet, do t'i mësojë.

E njëjtë është çështja e momentit të përgjigjes së lutjes në ditën e xhuma. Dijetarët kanë pasur mendime të ndryshme për hadithin e Ebu Musës, që përcillet nga Muslimi, në të cilin thuhet: “Ai është nga çasti kur imami ulet (në mimber) e derisa të mbarojë namazi”. Disa e vlerësojnë të saktë e disa të tjerë e kanë të dobët, por për mua është i saktë, sepse vlerësimi si i dobët është vetë i dobët. Nga ana tjetër, vetë momenti që përshkruhet mbështet saktësinë e tij, sepse në këtë kohë realizohet grumbullimi më i madh i njerëzve për kryerjen e namazit farz, e kështu bëhet koha më e volitshme për përgjigjen e lutjes.

Po kështu, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk ka sqaruar as se kur është Nata e Kadrit, megjithëse ajo është shumë e rëndësishme.

Pyetja “o i Dërguari i Allahut, cilat janë ato?” ishte për sqarimin e tyre, e me anë të kësaj qartësohet dobia e përgjithësimit: që atij të cilit i është drejtuar fjala, të kërkojë qartësimin e këtij përgjithësimi. Kjo, se nëse ai do të vinte i qartë qysh në fillim, nuk do të merrej e pranohej njësoj si në rastin kur përgjithësohet, pastaj qartësohet.

– “... *Politeizmi* ...” – I pari është renditur politeizmi, sepse ky është më i madhi i mëkateve shkatërruese. Mëkati më i madhi është t'i bësh shok Allahut, kur dihet që Ai të ka krijuar. Ky gjynah përfshin politeizmin në rrububije (vepret e Allahut), politeizmin në adhurimin që bën krijesa dhe politeizmin me emrat dhe atributet unike të Zotit. Kështu, kush beson se ka edhe një krijues tjetër bashkë me Allahun, ose që dikush tjetër përveç Allahut meriton të adhurohet, ai është politeist, edhe nëse nuk i kushton adhurime të posaçme, por nëse e bën edhe këtë, kjo është akoma më e rëndë. *Mushrik* është edhe ai që beson se Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) ka të ngjashëm në emrat dhe atributet e Veta, ose që beson se Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) ngrihet lart mbi Fronin e Vet ashtu siç qëndron një mbret, ose që beson se Allahu zbret në qiell ashtu si zbret njeriu nga shtëpia. Allahu thotë: “Padyshim që Allahu nuk fal

që Atij t'i vihen shokë, por Ai fal përveç kësaj, këdo që Ai dëshiron.” (Nisa, 48). “Nuk ka dyshim se kushdo që i vë shok Allahut, atëherë Allahu e ka bërë të ndaluar Xhenetin për të, dhe vendbanimi i tij do të jetë Zjarri. Dhe për zullumqarët nuk do të ketë asnjë ndihmues ...” (Maide, 72).

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) sqaroi se politeizmi është krimi më i madh: “Ti bësh Allahut shok, ndërkohë që Ai të ka krijuar ty.” Ai të ka krijuar ty, të bëri të ekzistosh, të ndihmoi me të mira, të dha formën më të përsosur e të furnizoi, atëherë si e bën të barabartë me dikë tjetër. Nëse një njeri do të bënte më pak mirësi ndaj teje se kaq, e ti ta barazojë atë me dikë tjetër që nuk do të t'i kishte bërë këto, kjo do të konsiderohej mosmirënjohje dhe mohim të mirash.

– “... *magjia ...*” – Kjo është një ndër veprat shkatërruese. Me aq sa duket nga hadithi, nuk ka ndryshim ndërmjet magjisë që bëhet me anë të shejtanëve dhe asaj që bëhet me anë të ilaçeve dhe drogave: nëse bëhet me anë të shejtanëve, ajo arrihet vetëm përmes politeizmit, ndërsa me mënyrën tjetër, ajo përbën gjynah të madh, sepse është krimi më i rëndë kundër njeriut. Ajo i prish njeriut fenë dhe jetën e kësaj bote, duke e bërë si kafshët, madje edhe më keq se ato, sepse kafshët ashtu janë krijuar, ndërsa kur njeriu ndryshon natyrën e tij, atë e zë një brengë dhe mërzi e tillë, që veç Zoti i njerëzve e di. Për këtë arsye, magjia renditet menjëherë pas politeizmit.

– “... *vrasja e njeriut që e ka ndaluar Allahu ...*” – Pra, që ka ndaluar vrasjen e tij.

– “... *përveçse kur e kërkon e drejta ...*” – Pra, me drejtësi. Këtu kemi të bëjmë me një gjykim dhe, kur e drejta përmendet në kuadër të një gjykimi, ajo nënkupton drejtësinë, ndërsa nëse paraqitet thjesht si kumt, ajo nënkupton vërtetësinë. Drejtësi është ajo që urdhëron Allahu dhe i Dërguari i Tij: “Allahu urdhëron për drejtësi.” (Nahl, 90).

Njerëzit që futen në këtë ndalim janë: 1) besimtarët muslimanë; 2) jomuslimanët që jetojnë në shtetin islam, të mbrojtur prej tij

(*dhimi*); 3) njerëzit me të cilët është bërë marrëveshjeje paqeje (*muahid*); 4) njerëzit për të cilët muslimanët kanë dalë dorëzanë (*mustemin*).

Besimtarët nuk preken për shkak të besimit të tyre, *dhimi*-të për shkak të garancisë që u ka dhënë shteti islam, *muahid*-ët për shkak të marrëveshjes paraprahe, dhe *mustemin*-ët për sigurinë e ofruar nga muslimanët.

Dhimi quhen ata që jetojnë në shtetin islam dhe që janë nën mbrojtjen e tij, përkundrejt pagesës së xhizjes. *Muahid*-ët jetojnë në vendin e tyre, por midis nesh dhe atyre ka marrëveshje që të mos na luftojnë e as të mos i luftojmë. *Mustemin*-ë janë ata që kanë kërkuar siguri, pa pasur marrëveshje për paqe e as garanci, por që muslimanët e mbrojnë për një kohë të caktuar. Rast i tillë është, për shembull, kur një njeri, prej një vendi që është në luftë me shtetin islam, futet te muslimanët për qëllime tregtie ose për të kuptuar Islamin. Allahu i Lartësuar thotë: “Dhe në qoftë se ndonjëri prej idhujtarëve kërkon mbrojtjen tënde, atëherë siguroji atij strehim, me qëllim që ai të dëgjojë Fjalën e Allahut (Kuranin) dhe pastaj përcilleni në vend të sigurt, sepse ata janë njerëz që nuk dinë.” (Teube, 6).

Marrëveshjet lejohet të bëhen me të gjithë jomuslimanët, ndërsa si *dhimi* mund të trajtohen vetëm çifutët, të krishterët dhe mexhusët e jo të tjerë. Ky është qëndrimi i medhhebeve, mirëpo e sakta është se ashtu mund të trajtohen të gjithë jomuslimanët.

Për këto katër kategori, vrasja është e ndaluar, por gjithsesi ndalimin nuk e kanë të njëjtë. Më e rënda është vrasja e besimtarit, pastaj sipas rëndësisë: e *dhimi*-t, e *muahid*-it dhe në fund e *mustemin*-it.

“... përveçse kur e kërkon e drejta ...”. E drejta nënkupton rastet që e bëjnë të detyrueshme dënimin me vdekje, si: imoraliteti nga një i martuar, krimi i vrasjes, braktisja e Islamit dhe e bashkësisë së muslimanëve.

– “... *ngrënia e kamatës* ...” – Kamata, sipas Sheriatit, është: shtesa e masës së një malli, gjatë shkëmbimit të atyre mallrave që janë të njëjtë në lloj e që, kësisoj, duhet të kenë masë të barabartë, dhe vonesa në aktin e shitblerjes për ato sende që duhet të

shkëmbehen dorë më dorë, aty për aty. Janë gjashtë lloje të tilla artikujsh, siç tregon Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Floriri me floririn, argjendi me argjendin, gruri me grurin, hurma me hurmën, elbi me elbin dhe kripa me kripën.” Kjo mbështetet edhe nga ujdia e përgjithshme e muslimanëve. Në shkëmbimet e këtyre artikujve me llojin e vet, nëse masa e njërit është më e madhe sesa e tjetrit, quhet “kamatë shtesë”, ndërsa kur masa e artikujve është e barabartë, por këmbimi nuk bëhet dorë më dorë, aty për aty, atëherë kemi të bëjmë me “kamatë vonesë”. Por një akt shitblerjeje mund të shoqërohet gjithashtu me të dyja këto dukuri njëkohësisht. Rrjedhimisht, duhet patjetër të plotësohen dy kushte: masa e barabartë e artikujve dhe këmbimi i menjëhershëm në vendin e shitblerjes.

Nëse mallrat ndryshojnë në lloj, por me funksione të njëjta, atëherë mund të ketë kamatë vonesë, por jo kamatë shtesë. Shkëmbimi i një mase flori me një masë më të madhe argjend është i lejuar, por nëse shkëmbimi nuk bëhet aty për aty, por me vonesë, kjo nuk lejohet. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Nëse llojet e mallrave që këmbehen ndryshojnë, atëherë shitni si të doni, nëse shkëmbimi bëhet në moment.”

Kur themi: “me funksione të njëjta”, përjashtojmë rastet kur artikujt nuk shërbejnë për të njëjtin qëllim. Për shembull, ari shërben si masë e vlerës së mallrave, kurse gruri shërben si ushqim. Kësisoj, lejohet të shesësh grurë me flori, pa e pasur masën të barabartë dhe pa e bërë shkëmbimin e dyanshëm në një moment.

Dikush mund të thotë se hadithi tregon se çdo shitblerje është e saktë vetëm me shkëmbim të plotë aty për aty. Atëherë, cila është përgjigjja?

Vërtet që ky është kuptimi i drejtpërdrejtë i hadithit: “Nëse llojet e mallrave që këmbehen ndryshojnë, atëherë shitni si të doni, nëse shkëmbimi është dorë më dorë (në moment).” Pra, nëse shet grurë me flori, është detyrë shkëmbimi i plotë në momentin e shitblerjes. Megjithatë, Suneti tregon qartë, me fakte të tjera, se shkëmbimi nuk është kusht që të jetë dorë më dorë kur njëri nga artikujt është matës i vlerës. Ibn Abasi ka thënë se kur Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) erdhi në Medinë, banorët e saj i shitnin frutat me parapagim një vit ose dy vjet afat. Ai tha: “Kush shet me parapagim

diçka, le ta shesë atë me masë dhe peshë të caktuar, të qartë e të njohur dhe në afat të caktuar e të njohur.”¹ Pra, këmbimi i menjëhershëm nuk është kusht për çdo lloj tregtie, por vetëm për ato mallra që kanë të njëjtin funksion, siç është shkëmbimi i arit me argjend, ose grurit me thekër.

Dijetarët kanë pasur qëndrime të ndryshme për artikuj të tjerë, që nuk janë përmendur në hadith. *Dhahiritë* thonë se kamatë mund të ketë vetëm me sendet që citohen në hadith, duke mos e pranuar analogjinë. Sipas tyre, për shembull, orizi me misrin lejohet të këmbehen me masa të pabarabarta, madje edhe duke mos e bërë shkëmbimin në vend, sepse ato nuk përfshihen në llojet e përmendura në hadith.

Dijetarët e katër medhhebeve të tjera, nga ata që e pranojnë analogjinë si metodikë, mendojnë se gjykim të njëjtë kanë edhe artikuj të tjerë. Megjithatë, njëri prej tyre, Ibn Akili (*rrahimullah*), nuk është i këtij mendimi. Ai thotë se kamata nuk prek mallra të tjera veç ketyre gjashtë llojesh, jo sepse ai nuk pranon analogjinë, por ngaqë dijetarët kanë mosmarrëveshje rreth arsyes për të cilën konsiderohet kamatë. Përderisa ka mosmarrëveshje për arsyet, ata i hodhën poshtë të gjitha arsyet, duke e kufizuar kështu kamatën vetëm në atë që përmendet në tekstin e hadithit.

E sakta është se kamata mund të prekë edhe mallra të tjerë. Për mallrat ushqimorë, kriteri është që ato duhet të jenë ndër artikujt që ruhen dhe mund të depozitohen për një kohë të gjatë, pa u prishur, siç janë, për shembull, gruri, hurma e Arabisë, thekra etj. Kurse për arin dhe argjendin, kriteret janë lloji dhe funksioni i matjes së vlerës. Kriteri i llojit do të thotë që, edhe nëse një send nuk ka funksion themelor matjen e vlerës, ai mund të preket nga kamata nëse është prej ari ose argjendi, siç janë për shembull bizhuteritë.

Matës të vlerës janë monedhat e argjendit ose të arit dhe paratë e sotme, të cilat zëvendësojnë arin dhe argjendin. Sot mund të thuhet se kriter është vetëm funksioni i matjes së vlerës, sepse bizhuteritë shërbejnë tashmë vetëm si zbukuruese dhe nuk përdoren për këmbime.

Për sa i përket kripës, dijetari i Islamit Ibn Tejmije ka thënë se,

¹ Buhariu.

meqenëse ajo është rregulluese e përhershme e ushqimit, atëherë ajo trajtohet njëllor si ushqimi bazik. Ajo nuk është ushqim, por është një nga elementet e domosdoshme të tij; ajo e ruan ushqimin nga prishja.

– “... *ngrënia e kamatës ...*” – Sipas dijetarëve, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë “ngrënia”, sepse më së shumti kamata përdoret për ngrënie. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë për çifutët: “... Dhe për shkak të marrjes së kamatës prej tyre, megjithëse e kishin të ndaluar që ta marrin atë ...” (Nisa, 161). Kështu pra në këtë ajet nuk ka përdorur fjalën ‘ngrënie’, sepse marrja është më përfshirëse sesa ngrënia. Ngrënia e kamatës nënkupton marrjen e saj, pavarësisht nga qëllimi i përdorimit: në ushqim, në ndërtim, në banesë, në shtresë etj.

– “... *përfitimi nga pasuria e jetimit ...*” – Jetim konsiderohet fëmija, mashkull apo femër, pa arritur moshën madhore, të cilit i ka vdekur babai. Kujt i vdes nëna para se të mbushë moshën madhore, nuk quhet jetim. Jetim është ai që ka mbetur pa kujdestar, sepse është babai ai që duhet të punojë për fëmijën.

I është vënë theksi jetimit, sepse atë nuk ka kush ta mbrojë; ai është i pari që meriton të mëshirohet. Për këtë arsye, Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) i ka caktuar pjesë në *el fej* (pasurinë e fituar nga jomuslimanët pa luftë). Kur ai është i pari që duhet të mëshirohet, ç’është ai mizor që kërkon ta grabisë dhe t’i hajë pasurinë?!

Sa i përket pasurisë së jetimit, thuhet e njëjta gjë ashtu si për kamatën: nuk ka rëndësi për çfarë e përdor, sepse gjykimi është i njëjtë. Të hash nga pasuria e atij që nuk është jetim, nuk është gjynah i madh; çështja e jetimit është krejt ndryshe. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar i kërcënon ata që e hanë pasurinë e jetimëve, kur thotë: “Vërtet ata që padrejtësisht hanë pasurin e jetimëve, vetëm mbushin barkun e tyre me zjarr dhe ata do të digjen në Zjarrin flakërues.” (Nisa, 10).

– “... *braktisja e fushëbetejës ...*” – Braktisja e fushëbetejës është gjynah i madh, sepse është shmangie nga xihadi në rrugën e

Allahut, shkakton thyerje të zemrave të muslimanëve dhe forcim të armiqve të Allahut, të cilat çojnë në humbjen e muslimanëve. Këtë hadith e specifikon ajeti: “Dhe kushdo që u kthen shpinën atyre në një ditë të tillë, në qoftë se nuk është çështje dredhie, mashtruese në luftë ose për t’u bashkuar me trupat e tjera, atëherë me të vërtetë ai ka tërhequr mbi vete zemërimin e Allahut. (Enfal, 16).

Allahu i Lartësuar përjashton dy raste:

a) Manovrat mashtruese, për shembull tërheqja për të rregulluar pozicionet ose armët, ose largimi nga një front lufte në një tjetër. Këto lëvizje nuk quhen dezertime, por manovra ushtarake.

b) Largimi nga një pozicion, për t’u bashkuar me trupa të tjera të ushtrisë, të cilat, për shembull, janë të rrethuara nga armiku dhe rrezikojnë të shkatërrohen. Kusht është që nga ky ndërrim pozicioni të mos dëmtohet sektori që lihet. Nëse largimi sjell dobësim apo – më keq akoma – thyerjen e tij përpara armikut, atëherë ai nuk lejohet. Qëllimi është epërsia e fesë së Allahut, kurse kjo shkakton rënie të fesë së Allahut.

Tërheqja lejohet vetëm nëse qafirët janë më shumë sesa dyfishi i muslimanëve, me argument fjalën e Allahut: “Tani Allahu e ka lehtësuar detyrën tuaj, pasi Ai e di se ka dobësi në mesin tuaj. Kësisoj, nëse nga mesi juaj janë njëqind të palëkundur, do të thyenin dyqind, dhe po të kishte prej jush njëmijë, ata do të sfidonin dymijë, me lejen dhe vullnetin e Allahut. Dhe Allahu është me të duruarit.” (Enfal, 66).

I njëjti vlen edhe për rastin kur armiqtë kanë mjete të cilave muslimanët nuk mund t’i bëjnë qëndresë, për shembull ata kanë avionë, ndërsa muslimanët nuk kanë kundërajrorë për t’u mbrojtur. Nëse është e qartë se rezistenca do të sjellë veç shkatërrimin e muslimanëve, atëherë ajo nuk lejohet.

Dy ajetet kuranore të mësipërme specifikojnë një hadith, dhe kjo është diçka e rrallë. I tillë është edhe rasti i marrëveshjes së Hudejbijes ndërmjet Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e idhujtarëve, një kusht i së cilës ishte se çdo musliman që vinte nga vendi i idhujtarëve, duhej të kthehej sërish mbrapsht. Ky kusht i përgjithshëm i përfshinte meshkujt dhe femrat, por Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) zbriti fjalën e Tij specifikuese: “O ju që keni besuar! Kur gra besimtare vijnë te ju si të shpërngulura, provojini

ato, ndonëse Allahu i njuh mjaft mirë për besimin e tyre. Në qoftë se bindeni që ato janë besimtare të vërteta, atëherë mos i ktheni prapë te mosbesimtarët ...” (Mumtehine, 10).

– “... *shpifja ndaj grave të ndershme besimtare (el muhsanat).*” – Shpifja këtu nënkupton akuzën për imoralitet. Fjala “*el muhsanat*” është shpjeguar si “gra të lira”, por është përkufizuar edhe si “gra të ndershme”. Ndërsa cilësimi si “besimtare” është bërë për të përjashtuar jobesimtarët.

Shpifja ndaj nderit të një gruaje me këto cilësi është një nga veprat shkatërruese, kundër së cilës zbatohet dënimi penal: tetëdhjetë goditje me kamxhikë, nuk i pranohet më dëshmia dhe konsiderohet si *fasik* (i prishur). Allahu i Lartësuar ka vendosur tri masa ndëshkuese ndaj tij: “Dhe ata që akuzojnë gra të dlira dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, t’i fshikulloni me tetëdhjetë kamxhikë dhe mos ua pranoni më kurrë dëshminë e tyre. Vërtet që ata janë *fasikë*.” (Nur, 4). Pastaj thotë: “... Përveç atyre që pendohen pas kësaj dhe punojnë mirësi e drejtësi.” (Nur, 5).

Nëse shpifësi pendohet, a pranohet dëshmia e tij? Ka pasur mendime të ndryshme dijetarësh për këtë çështje. Disa thonë se dëshmia e tij nuk pranohet kurrë, edhe sikur të pendohet, pasi Allahu e ka bërë atë një sanksion të përhershëm: “... mos ua pranoni më kurrë dëshminë e tyre.”

Ndërsa të tjerë thonë se, përkundrazi, dëshmia u pranohet nëse ata pendohen, sepse pranimi i saj është peng i veprës së ndyrë, e cila, nëse asgjësohet, çliron edhe pengun e saj.

Në raste të tilla, çështja i lihet gjykatësit. Nëse ai e shikon se është më i dobishëm mospranimi i dëshmisë, që njerëzit të kenë kujdes ndaj nderit të muslimanëve, atëherë le ta bëjë; në të kundërt, le ta pranojë.

A është shpifja ndaj burrave të ndershëm besimtarë njëlloj si shpifja ndaj grave të ndershme besimtare?

Mendimi i shumicës së dijetarëve është se shpifja ndaj burrave konsiderohet njëlloj si shpifja ndaj grave. Janë theksuar gratë, sepse shpifjet ndaj tyre ishin më të mëdha në numër, pasi para Islamit kishte pasur shumë gra që bënin prostitucion. Gjithashtu, shpifja ndaj gruas është më e rëndë, sepse ajo sjell dyshime mbi

prejardhjen e fëmijëve të saj. Përfundimisht, pasojat e shpifjes mbi gratë janë më të rënda, prandaj theksi vihet mbi to.¹

Hadithi i Ebu Hurejrës lidhet me temën tonë, sepse ai flet edhe për magjinë.

Nga Xhundubi, në një hadith *merfu*² përcillet: “Dënimi penal për magjistarin është goditje me shpatë.” (Transmetohet nga Tirmidhiu, i cili thotë se ky transmetim është *meukuf*³.)⁴

– “Nga Xhundubi ...” – Nuk bëhet fjalë për Xhundub Ibn Abdilal el Bexheliun, por për Xhundub el Hajrin, i njohur si “ekzekutuesi i magjistarëve”.

– “... *merfu* ...” – Pra, hadithi i atribuohet të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), por autori ka cituar gjykimin e Tirmidhiut, sipas të cilit më i saktë është varianti *meukuf*, që do të thotë se kjo është një thënie e Xhundubit dhe jo e Pejgamberit ‘alejhis-selam.

Nga kuptimi i drejtpërdrejtë i hadithit, duket se magjistari nuk del nga feja, sepse masat ndëshkuese e pastrojnë mëkatarin nga gjynahu, përveç mohuesit të fesë, të cilin nuk e shpëtojnë. Kjo lidhet me atë çka u tha më lart: se disa lloje magjish nuk e nxjerrin njeriun nga feja, siç janë ato që bëhen me ilaçe dhe droga.

– “... *goditje me shpatë* ...” – Fjala “goditje” në hadith nënkupton ekzekutimin dhe jo goditje me faqen e shpatës.

Buhariu përcjell nga Bexhaleh Ibn Abedeh se ky ka thënë: “Omer Ibn Hatabi kishte urdhëruar me shkrim për vrasjen e çdo magjistari dhe magjistareje, prandaj ne vramë tre magjistarë.”⁵

¹ Pas analizës që i bëhet hadithit të Ebu Hurejrës për shtatë veprat shkatërruese, tani do të vijohet me temën përkatëse, që është magjia.

² *Merfu* quhet hadithi që i atribuohet Profetit.

³ *Meukuf* quhet hadithi ose thënia që i atribuohet një sahabi.

⁴ Transmeton Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i dobët.

⁵ Shfi’iu në Bedaiul-minen, Ahmedi dhe Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

Në shpjegimin e këtij rrëfimi – kam për qëllim komentimin në “*Tejsirul Azizil Hamid*” – thuhet se ai nuk gjendet në “*Sahih-un*” e Buhariut. Në “*Sahihun*” e Buhariut formulohet kështu: “Omer Ibn Hatabi kishte urdhëruar që të zgjidheshin martesat e *mexhusve* brenda fisit”, sepse ata e lejonin martesën me të afërmit – Allahu na ruajt! Autori i librit “*Tejsirul Azizil Hamid*” shkruan që El Katiju përcjell në vëllimin e dytë të “*El Feuid*” fragmentin plotësues: “... *pastaj vritni çdo falltar dhe magjistar*”. Më tej, autori i librit të lartpërmendur shton se vargu i përcjellësve është i mirë dhe se referimi te Buhariu vlen për sa i përket një versioni të rrëfimit, por jo formulimit të plotë të tij.

Ekzekutimi i magjistarit bëhet për shlyerjen e mëkatit apo për kufirin e tij?

Të dyja janë të mundshme, nëse marrim parasysh llojet e magjisë: nëse magjia kalon në kufër, vritet si kafir, e nëse jo, ekzekutohet për t’u ruajtur nga një e keqe, prandaj ai duhet të ndiqet e të kapet kudo që të jetë.

Si përfundim, themi se është detyrë që magjistarët të ekzekutohen, qofshin apo jo në gjendje kufri, sepse ata sëmurin njerëz, vrasin, ndajnë bashkëshortët e bashkojnë armiqtë, për të realizuar qëllimet e tyre. Disa i bëjnë magji dikujt që të lidhen me të dhe të përfitojnë prej tij atë që u duhet, ose i bëjnë magji ndonjë gruaje për të kënaqur epshin me të. Për shkak të angazhimit të tyre për të sjellë prishje e shkatërrim, është detyrë për autoritetet që t’i dënojnë me vdekje, pa u kërkuar të pendohen.

Sipas një rrëfimi të saktë, që vjen nga Hafsa (radijallahu anha), ajo ka urdhëruar që një skllave e saj të ekzekutohej, sepse i kishte bërë magji, dhe skllavja u vra¹. Po kështu, përcillet një pohim i saktë nga Xhundubi². Ahmed i ka sjellë për këtë gjykim dëshmi nga tre sahabë.

Këta sahabë ishin Omeri, Hafsa dhe Xhundub el Hajru, që do të

¹ Maliki në ‘Muvata’ dhe Ahmed i. Sipas Abdul Kadir Arnautit *senedi* është me shkëputje.

² Transmeton Buhariu në Tarih.

thotë se ata vërtetojnë që magjistarët duhet të dënohen me vdekje.

Ky gjykim është në përputhje me rregullat bazë të fesë: ata shkaktojnë trazira, dhe trazirat e tyre janë nga më të mëdhatë. Ekzekutimi i tyre është detyrë për autoritetin. Nuk lejohet që të falen, sepse po të lihen të veprojnë ç'të duan, e keqja e tyre do të përhapet shpejt.

| Dobitë e temës

- | ➤ Komenti i ajetit 102 të sures Bekare.

Ai që nuk ka pjesë nga bota tjetër është kafir, pasi përfundimi i çdokujt që ka pjesë nga bota tjetër do të jetë Xheneti.

- | ➤ Komenti i ajetit 51 të sures Nisa.

“Ata besojnë në *xhibt* dhe *tagut* ...”

- | ➤ Shpjegimi i *xhibt*-it dhe *tagut*-it dhe dallimet ndërmjet tyre.

Kjo sipas komentit të Omerit (r.a.).

- | ➤ Tagutët mund të jenë xhindë, por mund të jenë edhe njerëz.
- | ➤ Njohja e shtatë veprave shkatërruese, të veçuara me ndalim në hadith.
- | ➤ Magjistari bën kufër.

Kjo është marrë nga fjala e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “... por në të vërtetë asnjëri prej tyre nuk i mësoi ndokujt gjëra të tilla, veç pasi ata thanë: ‘Ne jemi vetëm sprovë, kështu që mos u bëni

mosbesimtarë ...” (Bekare, 102).

- Magjistari ekzekutohet, pa iu kërkuar të pendohet.

Kjo del nga hadithi: “Dënimi penal për magjistarin është goditje me shpatë.” Nëse çështja penale i arrin autoritetit, ai nuk duhet t’i kërkojë fajtorit që të pendohet, por duhet të japë dënimin me vdekje në çfarëdolloj rrethane. Ndërsa kur kemi të bëjmë më veprën e kufrit, personit duhet t’i kërkohej që të pendohet; ky është edhe dallimi ndërmjet ndëshkimit të veprave penale dhe ndëshkimit të kufrit.

Kështu sqarohet edhe gabimi që bëhet kur ndëshkimi i kufrit futet në të njëjtën kategori me ndëshkimin e veprave penale, por siç u tha, për veprën e kufrit kërkohej pendesë, e nëse njeriu pendohet, atëherë nuk ekzekutohet. Nga ana tjetër, veprat penale nuk shfuqizohen me pendesë, përveç rastit kur kriminelin pendohet para se të kapet nga autoritetet. Ndëshkimi i veprave penale është shlyerje mëkati për fajtorin dhe ai nuk është kafir, ndërsa vrasja për mohim të Islamit nuk e shlyen mëkatin. Në rastin e fundit, mohuesi vdes si jomusliman, prandaj nuk i lahet xhenazja, nuk i falet namazi dhe nuk varroset në varrezat e muslimanëve.

- Kur fenomeni i magjisë ka qenë i pranishëm ndër muslimanët në kohën e Omerit, ç’mund të thuhet për kohërat më pas?

Ajo ishte koha e halifit të dytë, epoka më e mirë; po tani, shekuj larg Profetit dhe sahabëve të tij?! Sa më shumë largohesh nga koha e Shpalljes hyjnore, aq më shumë mbizotëron humbja dhe injoranca ndër muslimanët. Humbja është kur gabon pa pasur dijeni për veprën, ndërsa injoranca është kur gabon me dashje. Kush e bën gabimin nga neglizhenca, është gjynahqar, dhe kush gabon nga padija, nuk është gjynahqar. Allahu i Lartësuar thotë: “Allahu është pranues i pendimit vetëm për ata që bëjnë ndonjë të keqe nga mendjelehtësia dhe pendohen shpejt ...” (Nisa, 17).

Fjala “*el xhehaletu*” (e përmendur në ajet) nuk është e kundërta e dijes, por është e kundërta e arsyetimit, pra mendjelehtësia.

Tema 25

| Përmendja e disa llojeve të magjisë.

Më parë u tha se magjia ndahet në dy lloje: kufër dhe mëkat. Nëse ajo realizohet nëpërmjet përdorimit të shejtanëve dhe formave të ngjashme, atëherë është kufër, ndërsa llojet e tjera janë mëkat, sipas përcaktimeve në Sheriat.

Më parë, gjithashtu, u dha edhe kuptimi gjuhësor i magjisë: diçka që vjen prej një shkakut misterioz dhe të padukshëm, derisa Fāhru Rāzi ka quajtur si një ndër llojet e magjisë edhe matësin e kohës, orën, kur dihet që orët e asokohe ishin ca mjete të thjeshta; ç'mund të thuhet për orët elektronike sot?!

Ahmedi thotë: “Na ka folur Muhamed Ibn Xhaferri, ai nga Auf Ibn Hajan Ibn el Alai dhe Katan Ibn Kabisa, e ky nga i ati, se e ka dëgjuar Pejgamberin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem) të thotë: ‘Vërtet, lëshimi i shpendëve në fluturim (el ijafeh), bërja e vijave (et tark) dhe besimi tek oguret e zeza (et-tijarah) janë forma të magjisë (xhibtit).”¹

Aufi ka shpjeguar se “*el ijafeh*” quhet lëshimi i shpendit në fluturim, ndërsa “*et tark*” quhen vijat e bëra në tokë. Kurse Hasani thotë se “*xhibt*” quhet inspirimi prej shejtanit. (*Sened*-i është i mirë.)

– “... *el ijafeh* ...” – Kështu quhej lëshimi i shpendëve që bëhej nga

¹ Ahmedi në “Musned” dhe Ebu Daudi. Sipas Albanit është i dobët.

arabët për të parashikuar fatin. Por lëshimi i shpendit për qëllime të tjera: për gjah, për shembull, ose për ta mësuar të fluturojë, nuk hyn në këtë kategori.

Lloj i magjisë është ai kur e lëshon shpendin për të parashikuar fatin: nëse zogu merrte drejtimin majtas, arabët e quanin si shenjë të fatit të keq, e nëse shkonte djathtas, gëzoheshin sepse parashikonte fat të mirë.

– “... *et tark* ...” – Këtë term Aufi e ka shpjeguar si “vijë që vizatohet në tokë”, kuptim ky mjaft i njohur për arabët. Ata, sidomos gratë, bënë vija mbi rërë për të shtënë fall. Nuk e di me saktësi se si e realizonin këtë dhe se si pretendonin zbulimin e së ardhmes, por e sigurt është që kjo përbënte një lloj magjie. Nga ana tjetër, vijat e tjera që bëhen në tokë, për shembull që shërbejnë për namazin ose për vendosjen e kufijve, nuk futen në këtë kategori.

Diskutohet për një transmetim të saktë, që thotë se, njëherë, kur Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është pyetur për një Profet që bënte vija, ka thënë: “Kush ia qëllon vijave të tij, ia ka qëlluar në atë që thotë”.¹ Për këtë rast ka dy përgjigje.

Së pari, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e lidhi çështjen me diçka të pamundur për t’u arritur, sepse ai tha: “Kush ia qëllon vijave të tij, ia ka qëlluar... .” E kush na siguron se a ia ka qëlluar vijës së tij apo jo?

Së dyti, në qoftë se vijat janë bërë me anë të shpalljes nga Allahu, siç qe rasti me atë Profet, në këtë nuk ka asgjë të keqe, pasi kjo mund të quhet një mrekulli që Allahu e bënte nëpërmjet vijave, ndërsa për njerëz të tjerë, që nuk janë Profetë, parashikimet me vija janë inspirime shejtani.

Objektivi i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte mbyllja e të gjitha portave të së keqes, e sidomos portave të politeizmit, atëherë pse nuk e ka mbyllur këtë portë? Përgjigjemi që, me sa duket, kjo – dhe Allahu është më i ditur – ishte diçka e njohur, pra që një nga Profetët ka bërë vija në tokë, prandaj nuk kishte dyshim që Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) do të përgjigjej për këtë.

¹ Muslimi.

– “... *et tijarah* ...” – Besimi tek oguret e zeza, i cili është një lloj magjie. Ai sjell një ndjenjë pesimizmi tek njeriu, prej gjërave që shikon ose dëgjon. Gjithashtu thuhet: ndjenja e pesimizmit me anë të një njohurie që shihet, apo dëgjohet, kohë apo vend, dhe ky përkufizim është më përfshirës, pasi përfshin atë që nuk shihet dhe atë që nuk dëgjohet, si rasti i pesimizmit me kohën. Pesimizmi i atribuohet shpendëve (at tetajur), sepse më së shumti, arabët e parashikonin fatin me anë të shpendëve, prandaj dhe është cituar kjo formë, por ajo është përmendur si njëra nga format përfaqësuese të dukurisë, pasi përkufizimi përfshirës i tij është: ndjenja e pesimizmit prej gjërave që shihen, dëgjohej ose njihen. Arabët bëheshin pesimistë me anë të zogjve, kohës, vendeve dhe personave. Këto janë shfaqje të idhujtarisë, siç ka thënë Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem)¹.

Nëse njeriu ia hap vetes derën e besëtytnive ndjellakeqe, atëherë i ngushtohet jeta, sepse fillon dhe e sheh çdo gjë si të tilla. Ka njerëz që, kur u del përpara ndonjë burrë me një sy në mëngjes, bëhen pesimistë e thonë se është ditë ters, prandaj mbyllin dyqanet e as blejnë, as shesin – Allahu na ruajt! Disa thonë për ditën e mërkurë se është ditë tersi e fatkeqësie. Të tjerë e mendonin ters muajin *sheval*, sidomos për martesë. Aishja e prishi këtë besëtytni, sepse vetë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u martua me të në muajin *sheval* dhe ajo thoshte: “Cila prej jush ishte me më tepër fat sesa unë?”² Përgjigjja dihet: Asnjëra.

Është e rëndësishme për njeriun që të mos të bjerë në pesimizëm nga gjëra të tilla, sepse ai kështu turbullon jetën e tij. Ne duhet të marrim shembull Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), të cilit i pëlqente optimizmi. Disa njerëz i futen disa herë një çështjeje, e pastaj bëhen pesimistë dhe dorëzohen. Kjo është gabim. Në çdo gjë që e di se ia vlen, mos u tërhiq që në hapin e parë, por përpiku disa herë, derisa Allahu të ta hapë rrugën.

– “... *janë forma të xhibt-it* ...” – Një kapitull më përpara u përmend shpjegimi nga Omeri (r.a.) se *xhibt* quhet magjia. Pra, të tria veprat e renditura në hadith janë forma të magjisë.

¹ Më hollësisht kjo çështje do të shtjellohet në temën e njëzetetë.

² Muslimi.

Edhe nëse marrim parasysh shpjegimin e Hasanit, se *el xhibt* quhet inspirimi prej shejtanit, themi se nuk ka dyshim që kushdo që i referohet shejtanit, ka rënë në një lloj *kufri*. Kjo mënyrë interpretimi nga ana e Hasanit gjendet në “*Tefsir-in*” e Ibn Kethirit, ndërsa në “*Musned*” thuhet: “*el xhibt* është shejtani”.

Praktika e lëshimit të shpendëve për të paraparë fatin është përfshirë te magjia, sepse ajo tregon mbështetje të njeriut tek diçka që assesi nuk ka ndikim tek ai. E ç’kuptim ka që shpendi ikën djathtas, majtas, përpara ose prapa? Kjo nuk ka bazë e logjikë as në fe dhe as në praktikë. Nëse njeriu mbështetet tek ajo, është mbështetur në diçka misterioze, pa ndikim, e kjo është magjia, ashtu siç e kemi përkufizuar atë gjuhësisht. Gjithashtu, vijat janë një lloj i magjisë, sepse ato i përdorin për magji dhe nëpërmjet tyre arrijnë te magjia. Edhe besimi tek oguret e zeza është formë e magjisë, sepse është plotësisht mbështetje në diçka misterioze, ku nuk ia vlen të mbështetesh.

Në temën: “Argumentet për besëtytnitë” do të tregohet se cilat raste bëjnë përjashtim.

Nga Ibn Abasi përcillet se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kush mëson një degë nga fusha e astrologjisë, ka mësuar një degë nga degët e magjisë. Sa më tepër të thellohet, aq më shumë e shton (gjynahun ose magjinë).”¹

– “... *fusha e astrologjisë* ...” – Qëllimi këtu është për vëzhgimin dhe studimin e yjeve me qëllim që të parashikohet se çfarë do të ndodhë në tokë. Ata thonë, për shembull, se kur filan yll afrohet me këtë yllin tjetër, do të ndodhë kjo gjë, apo nëse dikush lind me këtë yll, ai do të jetë i lumtur ose do të jetë fatzi.

Ngjarjet në tokë vijnë prej Zotit, me shkaqe të njohura ose të panjohura për ne, kurse yjet nuk kanë aspak lidhje me to. Zejd Ibn Halid el Xuheni tregon se, gjatë betejës së Hudejbijes, i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) fali namazin e sabahut pas

¹ Ahmedi dhe Ebu Daudi i cili thotë se zinxhiri i transmetimit të tij është i saktë. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

një shiu që kishte rënë natën, e pasi mbaroi, u kthye nga njerëzit dhe tha: “Allahu i Lartësuar tha: ‘Disa nga robërit e Mi këtë mëngjes u bënë besimtarë ndaj Meje dhe disa jobesimtarë. Kush tha: ‘Na erdhi shiu prej këtij ylli’, ai është jobesimtar ndaj Meje dhe besimtar ndaj yjeve. Kush tha: ‘Na erdhi shiu prej mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij’, ai është besimtar ndaj Meje dhe jobesimtar ndaj yjeve .” Më lart u tha se ky kufër është dy llojesh, në varësi të besimit të atij që e shpreh.

Yjet nuk sjellin as shi, as erë. Kështu del në pah edhe gabimi i disa njerëzve të thjeshtë, që thonë se, kur fillon era, lind filan yll, sepse yjet nuk kanë ndikim tek era. Është e vërtetë se në disa periudha dhe stinë të veçanta ka erë dhe shi, por ato janë periudha të erës dhe shiut, e nuk janë shkak për erë apo shi.

Dija mbi yjet është dy llojesh:

1- Dija për parashikim (astrologjia), e cila është për të shpjeguar ngjarjet që ndodhin në tokë me anë të lëvizjeve në kozmos. Kjo lloj dijeje është e ndaluar dhe e pasaktë. Argument është hadithi i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), përcjellë nga Ibn Abasi: “Kush nis të mësojë një degë nga fusha e astrologjisë, ka nisur të mësojë një nga degët e magjisë ...”; hadithi i përcjellë nga Zejd Ibn Halidi: “Kush tha: ‘Na erdhi shiu prej këtij ylli’, ai është jobesimtar ndaj Meje dhe besimtar ndaj yjeve”; si dhe hadithi tjetër që flet për diellin dhe hënën: “... Vërtet të dyja ato janë shenja që tregojnë për njësimin e Allahut dhe fuqinë madhështore të Tij. Ato nuk eklipsohen për vdekjen e ndonjërit dhe as për lindjen e ndonjërit.”¹ Pra, nuk ka lidhje ndërmjet lëvizjeve në kozmos dhe ngjarjeve që ndodhin në tokë.

2- Dija për orientim, e cila u shërben njerëzve të orientohen në hapësirë dhe kohë. Kjo është e lejuar dhe ndonjëherë mund të jetë detyrë, siç thonë dijetarët: Kur futet koha e namazit, është detyrë për njeriun që të gjejë Kiblën nëpërmjet yjeve, diellit dhe hënës. Allahu i Lartësuar thotë: “Dhe Ai ka ngulitur në tokë male, të cilët qëndrojnë fort, se përndryshe ajo do të dridhej bashkë me ju; (Ai ka vendosur atje) edhe lumenj, edhe rrugë që mund të drejtohen në të.” (Nahl, 15). Pasi përmend shenjat e tokës, kaloi në shenjat qiellore: “Dhe me shenjat treguese në tokë (për ditën) dhe me yjet (për natën)

¹ Buhariu.

që ata (njerëzit) të drejtohen.” (Nahl, 16). Orientimi me yjet për të përcaktuar kohët nuk ka ndonjë gjë të keqe, për shembull, kur lind aksh yll, futet koha e shirave ose koha e pranverës.

– “... *Kush nis të mësojë një degë nga fusha e astrologjisë, ka mësuar një degë nga degët e magjisë. Sa më tepër të thellohet, aq më shumë e shton.*” – Koncepti “magji” këtu është më i gjerë se magjia tipike. Ai përshkruan diçka që ka orientime të mistershme, që nuk janë të vërteta, njëlloj si magjia, e cila nuk është e vërtetë. Magjia nuk e ndryshon realitetin, por e manipulon atë. Kështu ndodh edhe me yjet: ato nuk e ndryshojnë realitetin.

Sa më tepër merresh me studimin e tyre, aq më shumë i shton degët e magjisë. Kjo, për arsye se kur shtohet elementi i një pjese, shtohet e tërë pjesa.

Lidhja e hadithit me temën është se një nga format e magjisë është astrologjia. Ky hadith, edhe pse ka dobësi në *sened*, kuptimin e ka të saktë, i cili përforcohet edhe nga argumente të tjera.

Nesaiu sjell hadithin e Ebu Hurejres: “Kush lidh një nyje e pastaj i fryn asaj, ai ka bërë magji, e kush bën magji, ka bërë *shirk*. Kush kapet pas diçkaje, lihet në mbështetjen e saj.”¹

– “... *Kush lidh një nyje e pastaj i fryn asaj ...*” – Fryrje këtu do të thotë të pështysh lehtë për të bërë magji. Hadithi nuk e ka fjalën për lidhjen e nyjeve të zakonshme, edhe nëse i pështyn që të lidhen mirë.

Nyjet për magji bëhen në disa raste për të ndarë burrin nga gruaja, ose për ta bërë burrin të pamundur të kryejë marrëdhënie me bashkëshorten. Kush lidh të tilla nyje, ka bërë magji, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar: “... dhe nga e keqja e atyre që bëjnë magji kur u fryjnë nyjeve.” (Felek, 4).

– “... *ka bërë shirk ...*” – Këtu nuk futen të gjitha llojet e magjisë, por vetëm ato që bëhen me anë të shejtanëve.

¹ Nesai. Sipas Albanit hadithi është i dobët.

– “... *Kush kapet pas diçkaje, lihet në mbështetjen e saj.*” – Kjo do të thotë se nëse mbështetesh te diçka, Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) të braktis dhe të lë në mbështetjen e saj.

Lidhja me pjesën e mësipërme është se kush fryn nyje, synon të arrijë diçka, kështu ai lihet në mbështetjen e asaj. Sipas një këndvështrimi tjetër, disa njerëz, kur u bëhet magji, nuk shkojnë të bëjnë rukjet e lejuara, por shkojnë sërish te magjistarët dhe u mbështeten atyre.

Kush i mbështetet Allahut, Ai do t’i mjaftojë. Allahu i Lartësuar thotë: “Kushdo që mbështetet e vë shpresat tek Allahu, Ai do t’i mjaftojë atij plotësisht.” (Talak, 3). Nëse është Allahu Ai që të mjafton ty, patjetër që do të arrish tek ajo që dëshiron. Por kush mbështetet në një krijesë, është mbështetur tek i dobëti dhe i paafti.

Ndoshta në hadith përfshihet edhe ai që mbështetet te vetja, derisa të arrijë t’i pëlqejë vetja në atë që thotë dhe vepron. Ai do të lihet në dorë të vetvetes. Kësisoj ai është lënë të mbështetet tek e paafta dhe e dobëta. Për këtë arsye duhet të jeshë i lidhur me Allahun në të gjitha punët dhe gjendjet, madje edhe në më të thjeshtat gjëra.

Megjithatë, ne themi: mbështetu në veten tënde kur çështja ka të bëjë me njerëzit. Mos u kërko atyre, mos u ul para tyre, tregohu i panevojshëm për ta sa të mundesh. Ndërsa në lidhje me Allahun, asnjëherë mos u trego i panevojshëm prej Tij! Gjithmonë qëndro i mbështetur te Zoti yt, derisa të të lehtësohen çështjet.

Në hadith futen edhe ata që mbështeten në disa nuska, të cilët, si të tjerët, lihen në mbështetjen e tyre, prandaj nuk arrijnë qëllimet që kanë. Po t’i mbështeteshin Allahut, me format e ligjëruara, do t’ia dilnin mbanë. Kjo vlen edhe për ata që varin në trup sende të marra prej varresh të ndryshme, për t’u mbrojtur dhe për të shpëtuar nga vështirësitë dhe telashet. Megjithatë, ndonjëri edhe mund të sprovohet duke realizuar çfarë kërkon nëpërmjet lutjes drejtuar tyre. Ajeti është i qartë për këtë: “Kush është në rrugë më të gabuar sesa ai, i cili, në vend të Allahut, u lutet atyre që nuk mund t’i përgjigjen atij deri në Ditën e Kijametit ...” (Ahkaf, 5), por Allahu sprovon kë të dojë nga robërit e Tij.

Lidhja e hadithit me temën është se kush e përdor magjinë për të arritur qëllimet e veta, lihen në mbështetjen e saj, e përfundimi do të jetë dështim dhe pendim.

Nga Ibn Mesudi përcillet se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “A t’ju tregoj se ç’është ‘el ad’hu’? Është spiunimi, bartja e fjalëve ndërmjet njerëzve.”¹

– “... A t’ju tregoj se ç’është ‘el ad’hu’? ...” – Pyetja shërben këtu për të ngacmuar kërshërinë (kureshjen), siç është ajeti: “O ju besimtarë! A t’ju tregoj për një marrëveshje, e cila do t’ju shpëtojë nga një ndëshkim i dhimbshëm?” (Saf, 10) Kjo, sepse kureshtja është në vetë natyrën e njeriut. Por pyetja mund të jetë edhe për të tërhequr vëmendjen, sepse që të mësosh, duhet të dëgjosh i përqendruar.

– “... *el ad’hu* ...” – Kështu quhet shkëputja mes njerëzve, ose edhe përçarja.

– “... *Është spiunimi* ...” – Spiunimi është kalimi i fjalëve nga njëri te tjetri. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka shpjeguar vetë me fjalën vijuese: “... bartja e fjalëve ndërmjet njerëzve.” Për shembull, shkon te dikush e i thua se filani e ka sharë. Kjo është bartje fjalësh, qoftë kur thua të vërtetën, qoftë kur gënjen. Nëse gënjen, quhet edhe shpifje; nëse thua të vërtetën, vetëm ke spiunuar.

Spiunimi, siç ka treguar Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ndërpret lidhjet dhe i përçan njerëzit². Nëse i thua njërit prej dy shokëve, që shoku tjetër e ka sharë, dashuria ndërmjet tyre kthehet në armiqësi, e kështu ndahen. Kjo i ngjan magjisë për ndarjen e dy vetëve: “Dhe nga këta melekë njerëzit mësuan atë që shkaktonte ndarjen e burrit ...”.

Spiunimi është një nga gjynahet e mëdha. Ai është shkak për dënimin në varr dhe për mosfutjen në Xhenet. Profeti (sal-lAllahu

¹ Transmeton Muslimi.

² Ahmedi

‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Spiuni nuk futet në Xhenet.”¹ Ndërsa në hadithin e Ibn Abasit, të sjellë nga Buhariu dhe Muslimi, tregohet se Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... kaloi pranë dy varreve, të vdekurit e të cilëve po dënoheshin, sepse njëri prej tyre merrej me përgojime.”

Spiunimi, përveçse gjynah i madh, është edhe një ves shumë i ulët. Njeriu nuk duhet ta dëgjojë përgojuesin, sido që të jetë. Allahu i Lartësuar thotë: “Dhe mos iu bind kujtdo shpifësi, që përhap thashetheme.” (Kalem, 10-11). Dije se ai që spiunon te ti, spiunon edhe për ty tek të tjerët, prandaj duhet pasur kujdes prej tij.

Ky veprim bëhet shkak për prishjen e tërë shoqërisë, sepse shoqëria është e përbërë nga individë, rrjedhimisht kur armiqëson dy shokë të dashur, ke prishur shoqërinë. Nëse shoqëria përçahet, bëhet siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala): “... mos u grindni ndërmjet jush, se do të humbisni guximin e do t’ju lërë fuqia ...” (Enfal, 46). Nëse shoqëria nuk është e bashkuar si një person i vetëm, atëherë ajo nuk është më shoqëri, por individë të shpërndarë. Individët e shpërndarë nuk janë fuqi, siç thotë një poet:

S’i thyen dot thuprat kur mbahen bashkuar,
Por lehtë copëtohen, pasi i ke veçuar.

Nëse studion Sheriatin, do të vëresh se ai ndalon çdo gjë që është shkak për ndarje dhe përçarje mes njerëzve. Për shembull, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Mos ia prishni kontratën e shitjes njëri-tjetrit.”²; ose: “Asnjë burrë të mos kërkojë të fejohej me atë grua që është në fjalë me ndonjë vëlla të tij.” Qëllimi është të shmangen shkaktarët e armiqësisë dhe urrejtjes ndërmjet njerëzve.

Ibn Omeri përcjell se Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Ka forma ligjërimi që janë magjepsëse.”³

¹ Buhariu.

² Domethënë: nëse vallai yt është duke shitur një mall, mos ia prish atij kontratën e shitjes për të shitur mallin tënd. Atëherë, është e ndaluar për shembull t’i thuash blerësit: ktheja mallin, sepse unë të njëjtin mall do ta shes me një çmim më të lirë, ose: ktheja artikullin që i ke shitur, sepse unë ta blej me një çmim më të shtrenjtë.

³ Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Të folurit është një mirësi e Allahut për njeriun. Allahu i Lartësuar thotë: “Ai ka krijuar njeriun. Ai i mësoi atij të folurit e bukur.” (Rrahman, 4). Por ka dy lloj ligjërimesh:

1- Ligjërimi që shërben për të shprehur diçka të domosdoshme. Këtë lloj e praktikojnë të gjithë njerëzit. Çdo njeri, nëse është i uritur, do të thotë se është i uritur, nëse është i etur, do të thotë se është i etur, e kështu me radhë.

2- Ligjërimi në formë oratorie të plotë, që ndikon te ndjenjat dhe mendimet e njerëzve. Për këtë formë ligjërimi Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë se është magjepsëse.

Ndërsa aspekti i të qenurit të ligjërimit “magjepsës”, është për faktin se ai e mahnit dëgjuesin sa i merr mendtë dhe e bën të komandueshëm. Si pasojë, dëgjuesi mund ta shohë të rremen si të vërtetë, dhe kështu bëhet për vete nga ligjëruesi gënjeshtar, duke përqafuar të rremen ose duke iu larguar të vërtetës. Kjo, në fakt, është puna e magjisë. Ndërsa për hyritë e Xhenetit, Ibn Kajimi thotë se biseda e tyre është magji e lejuar.

Lind pyetja: Ky përkufizim i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është bërë për të zbuluar anën negative të ligjërimit, anën pozitive, apo thjesht është për të treguar funksionin real të tij, i cili më pas gjykohet sipas përdorimit?

E vërteta është se gjykimi bëhet sipas përdorimit, sepse ligjërimi si i tillë nuk është as pozitiv, as negativ, por shihet se cili është ndikimi dhe qëllimi i tij. Nëse ai ka qëllim të kundërshtojë të vërtetën dhe të pohojë të rremen, ai është negativ, sepse një mirësi e Allahut shfrytëzohet për kundërshtimin e Tij. Ndërsa kur qëllimi i tij është pohimi i të vërtetës dhe zhdukja e të rremes, ai është i lavdëruar.

Oratoria që përdoret për bindje ndaj Allahut dhe për thirrje në rrugën e Tij, është më e mirë se të folurit e paqartë, por nëse dikush e shfrytëzon oratorinë e vet për të penguar njerëzit nga rruga e Allahut, atëherë të folurit e paqartë është më i mirë sesa oratoria. Oratoria, duke e marrë thjesht si ligjërim, është padyshim begati, prandaj Allahu i Lartësuar ia përmend këtë mirësi njeriut, duke thënë: “Ai i mësoi atij të folurit e bukur”.

Autori – Allahu e mëshiroftë! – është treguar i matur në formulimin e titullit të temës: “Trajtesë e shkurtër mbi format e

magjisë”, duke mos dhënë asnjë gjykim në lidhje me të, sepse ka forma ligjërime që përbëjnë *shirk*, të tjera që janë gjynahe të mëdha, ashtu siç ka që janë më të vogla se kaq apo që janë edhe të lejuara. Ato varen nga qëllimi dhe nga pasojat e tyre. Kështu lidhet kjo çështje edhe me temën e librit.

Dobitë e temës

- *El ijafeh* (lëshimi i shpendit në fluturim), *et tark* (bëra e vijave në tokë) dhe *et tijarah* (besimi tek oguret e zeza) janë formatë magjisë.
- Shpjegimi i *el ijafeh* dhe *et tark*.
- Astrologjia është një lloj i magjisë.

Sipas fjalës së Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Kush nis të mësojë një degë nga fusha e astrologjisë, ka nisur të mësojë një nga degët e magjisë. Sa më tepër të thellohet, aq më shumë e shton.”

- Lidhjet dhe fryrjet e nyjeve janë forma të magjisë.
- Bartja e fjalëve ndërmjet njerëzve është nga format e magjisë.

Sipas hadithit: “A t’ju tregoj se ç’është ‘*el ad’hu*? ...”. Quhet “magji” sepse kryen të njëjtin funksion që bën magjistari: përçan njerëzit dhe mbjell grindje ndërmjet tyre.

- Disa ligjërime janë magjepsëse.

Kjo do të thotë se nga llojet e magjisë është edhe një pjesë e oratorisë, sipas fjalës së të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem): “Ka

forma ligjërimi që janë magjepsëse.” Autori – Allahu e mëshiroftë! – ka thënë disa ligjëtime duke u argumentuar me fjalën e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem): “Ka forma ligjërimi ...”, pasi sipas autorit – Allahu e mëshiroftë! – bëhet fjalë për një pjesë të saj. Aspekti i të qenit të saj magjepsëse, qëndron në faktin se ai që është orator (është i gojës), flet bukur, ndoshta i shmang dëshirat ose i ndez ato për shkak të oratorisë së tij.

Tema 26

Argumentet që flasin për fallxhorët dhe të ngjashmit me ta.

Falltarët ishin mjaft të përhapur në vendbanimet arabe, ku njerëzit shkonin e u kërkonin gjykim. Ata lidheshin me shejtanë, të cilët, pas përgjimeve në qiell, shkonin e lajmëronin falltarët. Më pas, këta të fundit u shtonin gënjeshtër këtyre lajmeve sa të donin dhe ua përcillnin njerëzve. Kur ndodhte diçka ashtu siç kishte lajmëruar falltari, ata besonin se ai dinte plotësisht të ardhmen.

Nga ana tjetër, ata që parashikojnë me anë të llogaritjeve shkencore, nuk kanë lidhje me fallin, siç mund të jetë, për shembull, parashikimi i eklipsit të diellit ose të hënës, i perëndimit të diellit, i shfaqjes së ndonjë komete etj.

Po parashikimi i motit nga ana e meteorologëve, a konsiderohet fall? Jo, për arsye se ai bazohet në faktorët natyrorë, të cilët ndryshojnë në situata të ndryshme dhe që meteorologët i masin me saktësi. Ai është një lloj me parashikimet e thjeshta, që bëhen me anë të shenjave të dukshme, siç janë grumbullimi i reve të zeza, vetëtimat e bubullimat, të cilat për ne paralajmërojnë shiun.

E rëndësishme është që kur një parashikim bazohet në prova të prekshme e të dukshme, nuk konsiderohet fall, edhe pse disa njerëz të thjeshtë mendojnë se kjo është një lloj si të besosh në fall. Mohimi i rezultateve që arrihen nëpërmjet provave të tilla është një veprim i shëmtuar, dhe kur dikush e mohon diçka të tillë duke u argumentuar me Sheriatin, ka bërë, në të vërtetë, një shpifje ndaj këtij të fundit.

Muslimi shënon në “*Sahih-un*” e tij se disa prej bashkëshorteve të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) përcjellin që ai ka thënë: “Kush shkon te ndonjë *araf* (falltar), e pyet për diçka dhe i beson përgjigjes së tij¹, nuk i pranohet namazi dyzet ditë.”

– “... *falltar* ...” – Kështu quhet ai që tregon për të ardhmen. Termi “*araf*” përfshin çdo lloj falltari, çfarëdo mjeti të përdorë ai. Prejardhja e tij është fjala “njohje”, sepse falltari pretendon se e njeh të ardhmen.

– “... e pyet atë ...” – Sipas kuptimit të drejtpërdrejtë të hadithit, vetëm pyetja e tij sjell mospranimin e namazit për dyzet ditë, por kjo nuk është në formë të prerë. Ka disa raste e mënyra të tilla, që duhet të merren në konsideratë:

a) Ta pyesësh atë thjesht për pyetje. Kjo është haram. Sipas hadithit të lartpërmendur, dënimi që sjell pyetja drejtuar tij, tregon se ajo është e ndaluar, haram, pasi dënimet janë vetëm për haramet.

b) Ta pyesësh atë, ta besosh dhe ta marrësh në konsideratë parashikimin e tij. Kjo vepër është kufër, sepse ta besosh për çështje misterioze, është mohim i Kuranit, ku Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Thuaj: ‘Askush në qiej dhe në tokë nuk e di *gajb*-in (mysterin) veç Allahut ...” (Neml, 65).

c) Ta pyesësh atë për të provuar nëse thotë të vërtetën apo gënjen, por jo për t’u bazuar te fjala e tij. Kjo vepër nuk ka ndonjë gjë të keqe dhe hadithi nuk e përfshin atë. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e pyeti Ibn Sajadin: “Çfarë të fsheh unë ty?”² Ai i tha: “*Ed Duh*”³ Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), në këtë rast, e pyeti për ta provuar.

d) Ta pyesësh për të nxjerrë në dukje paaftësinë dhe mashtrimin e tij. Ky veprim është i kërkuar, madje mund të jetë edhe detyrë.

¹ Shprehja “I beson përgjigjes së tij” nuk gjendet në sahihun e Muslimit.

² Buhariu.

³ Ibn Sajadi ishte falltar. Në fakt, ai desh të thoshte “*Duhan*”, por veç gjysmën e fjalës arriti të zbulonte nëpërmjet fallit.

Përfundimisht, të pyesësh falltarin nuk është e ndaluar në çdo lloj rrethane, por vetëm në ato raste që sqaron Sheriati.

Për këtë, shejhu i Islamit Ibn Tejmije thotë: “Xhindët ndonjëherë vihen në shërbim të njeriut. Falltarët, për shembull, i përdorin xhindët për t’u sjellë lajme nga qielli, të cilat i shtojnë pastaj me gënjeshtër. Shërbimi i xhindëve për njeriun, jo në të gjitha rastet është i ndaluar. Ata mund t’i shërbejnë njeriut në të mirë të këtij të fundit, por ndoshta edhe të atyre vetë. Madje ata mund të mos kenë asnjë dobi për vete, por e bëjnë thjesht se e duan për hir të Allahut. Nuk ka dyshim se ka xhindë besimtarë, të cilët i duan njerëzit besimtarët, sepse i bashkon besimi në Allahun.

Ka gjithashtu xhindë që i shërbejnë njeriut për shkak se ai u bindet atyre për gjëra që zemërohet Allahu i Lartësuar, si për shembull duke bërë kurban për ta, duke i adhuruar etj. Ata mund t’u shërbejnë njerëzve për vepra të ndaluara, si imoraliteti apo homoseksualizmi, sepse ashtu xhindët mund të kënaqin epshtet e tyre me njeriun ose e kundërta. Gjëra të tilla janë të njohura, të cilat ndonjëherë rrëfehen vetë nga xhindët që zaptojnë njerëzit, të dëshmuara nga ata që u lexojnë të sëmureve me xhindë.

Disa xhindë, njëherë, shkuan dhe takuan Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), i cili u tregoi atyre Udhën e Drejtë dhe u premtoi një lloj ushqimi të pashembullt: “Çdo kockë për të cilën është përmendur emri i Allahut (kur është therur kafsha) do ta gjeni të mbushur plot me mish, ndërsa bajgat do të jenë ushqim për kafshët tuaja.”¹

Thuhet se, në kohën e Omerit (r.a.), një grua kishte një xhind, i cili i rrëfente asaj gjëra të ndryshme. Një ditë, kur Omeri u vonua e nuk po kthehej në shtëpi, njerëzit shkuan tek ajo dhe i kërkuan asaj që ta gjente se ku ndodhej ai. Xhindi që ishte me të shkoi, e kërkoi, e gjeti dhe pastaj u kallëzoi se Omeri ishte në aksh vend, duke u bërë shenja deveve të zekatit".

– “... i beson përgjigjes së atij ...” – Ky fragment nuk është në “Sahih-un” e Muslimit. Atje hadithi është: “Kushdo që shkon te ndonjë falltar (*araf*) dhe e pyet për diçka, nuk i pranohet namazi dyzet ditë.” Shtesa mund të jetë e autorit ose e kopjes nga e cila e

¹ Muslimi.

ka marrë ai, ose autori ia ka atribuar Muslimit, duke marrë në konsideratë origjinën e hadithit. Gjithashtu, ai mund të ketë marrë nga Muslimi frazën: “... e pyet për diçka ...”, ndërsa “... i beson përgjigjes së atij ...” mund ta ketë marrë nga Ahmed-i.

– “... nuk i pranohet namazi dyzet ditë.” – Si duhet të kuptohet kjo? Mospranimi i namazit nga Allahu mund të vijë për shkak të mosplotësimit të ndonjë kushti. Për shembull, kur falesh pa pasur abdes ose në një vend të zaptuar, namazi nuk pranohet, sepse nuk plotësohen kushtet e tij, sipas atyre që mendojnë kështu (për çështjen e fundit).

Nëse mospranimi nuk lidhet me mosplotësimin e kushteve, atëherë ai nënkupton pranimin jo të plotë të veprës, që do të thotë se me të nuk arrihet pëlqimi dhe shpërblimi i plotë nga Allahu, ose që kjo vepër e keqe do të vihet në peshore me namazin dhe do ta rrëzojë ose do ta barazojë këtë të fundit. Rrjedhimisht, nëse namazi nuk ka shpërblim, është njëlloj sikur të mos jetë pranuar. Hadith i ngjashëm me këtë është: “Atij që pi alkool, nuk i pranohet namazi dyzet ditë.”¹

– “... dyzet ditë.” – Ne nuk mund të gjejmë një arsye përse ky numër është kaq. Në lidhje me gjërat e përcaktuara, në të shumtën e rasteve, njeriu nuk mund ta njohë urtësinë e tyre. Ne nuk e dimë, për shembull, përse janë caktuar pesë namaze në ditë. Qëllimi i tyre është adhurimi i Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Nënshtrimi ndaj Allahut me një adhurim që nuk ia di urtësinë, është më i plotë sesa ai që i dihet urtësia, sepse tregon përulje më të plotë. Është e vërtetë se kur njeriu e njeh urtësinë e diçkaje, ai qetësohet më shumë, por zbatimi i asaj që nuk ia njeh urtësinë tregon për nënshtrim dhe adhurim më të plotë ndaj Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Ai adhurim që nuk i dihet urtësia, përse i përket nënshtrimit është më i plotë dhe më i përsosur, ndërsa tjetri që ia di urtësinë, përse i përket qetësisë për dispozitën është më i plotë, sepse njeriu kur e mëson urtësinë e diçkaje, pa dyshim qetësohet më shumë te kjo gjë, i futet asaj më me zell dhe është më e pranushme për të.

Pra, ka gjëra që Sheriati i ka përcaktuar me numër ose formë, e

¹ Ahmed-i, Tirmidhiu dhe Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i mirë.

ne nuk e dimë urtësinë përse janë ashtu, por rruga jonë është të jemi siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): “Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyre ...” (Ahzab, 36). Pra, është detyrë për ne të dorëzohemi, të nënshtrohemi dhe t’ia lëmë çështjen Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

Hadithi dëshmon ndalimin e vajtjes te falltari dhe të pyeturit e tij, përveç rasteve të përjashtuara. Vajtja tek ata dhe të pyeturit e tyre ka pasoja të rënda, sepse kështu nxit mashtrimin e njerëzve nga ana e tyre, pasi ata më së shumti thonë gënjeshtër.

Nga Ebu Hurejra përcillet se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kush shkon te ndonjë falltar, e pyet atë për diçka dhe i beson gjithçkaje që ai i thotë, ka mohuar atë që iu zbrit Muhamedit.”¹

– “... e beson ...” – Domethënë mendon se ai thotë të vërtetën. Besimi i fjalëve të tij tregon miratim të tij.

– “... gjithçkaje që ai i thotë ...” – Fjala “gjithçka” përmban edhe të vërtetën që ai mund të thotë, mirëpo sërish nuk lejohet t’u besosh falltarëve, sepse në thelb ata janë gënjeshtarë.

– “... ka mohuar atë që iu zbrit Muhamedit.” – Muhamedit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), nëpërmjet Xhibrilit, iu zbrit Kurani. Allahu i Lartësuar thotë: “Sigurisht që ky (Kurani) është Shpallje nga Zoti i botëve, të cilin e ka zbritur Rruhu (Xhibrili) i besueshëm.” (Shuara, 192-193); “Thuaj: ‘E ka zbritur atë (Kuranin) prej Zotit tënd, padyshim me të vërtetën.” (Nahl, 102).

Prej këtej, kuptojmë se mendimi më i saktë për hadithet *kudsi* është se: përmbajtja e tyre ka ardhur nga Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), ndërsa forma e shprehjes i përket Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Nëse nuk e pranojmë këtë, atëherë hadithet *kudsi* do të ishin më lart në *sened* (zinxhirin e përcjelljes) sesa Kurani, meqë

¹ Ahmedi, Buhariu në 'Tarih El-Kebir, dhe Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka përcjellë ato drejtpërdrejt nga Zoti i tij, kurse Kurani i zbriti me ndërmjetësimin e Xhibrilit. Gjithashtu, sikur ato të ishin fjalë të Allahut edhe me shprehje, do të ishte detyrë që për to të vendoseshin rregullat e Kuranit. Dihet mirë se rregullat e Kuranit nuk zbatohen për hadithet *kudsi*. Ato nuk lexohen në namaze dhe, po ashtu, hadithet *kudsi* nuk janë sfiduese. Po të ishin fjalë të Allahut, do të ishin sfiduese, sepse fjalët e njerëzve as nuk mund t’u afrohen fjalëve të Allahut. Po ashtu, sipas mendimit të të gjithë dijetarëve – me sa di unë – nëse tek ne vjen një jomusliman për të dëgjuar fjalën e Allahut, ndërsa ne i lexojmë atij hadithet *kudsi*, atëherë nuk është e saktë nëse themi se ai dëgjoi fjalën e Allahut. Ky është qëndrimi i saktë, edhe pse ka edhe një mendim tjetër nga dijetarët, sipas të cilit hadithet *kudsi* janë fjalë të Allahut edhe në shprehje.

Dikush mund të pyesë: Si thoni që ky është qëndrimi i saktë, ndërsa Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ia atribuon fjalën Allahut kur thotë: “Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) ka thënë”?

Përgjigjja është se kjo ngjan me rastet kur Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) citon Musain, Faraonin, apo Ibrahimin dhe thotë: “Musai tha ...”, “Faraoni tha ...”, “Ibrahimi tha ...”, ndërkohë që ne e dimë se fjalët që citohen nuk janë të tyret në formë, sepse ata nuk flisni arabisht. Pra, Allahu citon përmbajtjen e fjalëve, e megjithatë Ai ua atribuon ato fjalë atyre, për shembull: “... kur Ibrahim i tha të atit dhe popullit të tij: ‘Me të vërtetë që unë jam larg asaj që ju adhuroni në vend të Atij, i Cili më ka krijuar mua ...’ (Zukhruf, 26); ‘I tha Musai popullit të tij: ‘Kërkoni mbështetje tek Allahu dhe jini të duruar.’ (Araf, 128); ‘(Faraoni) U tha krerëve rreth tij: ‘Vërtet që ky është një magjistar tepër i ditur.’” (Shuara, 34).

Ehli Suneti thotë se çdo fjalë që Kurani e përshkruan si të zbritur nga Allahu, dëshmon se Allahu ndodhet lart dhe se Kurani është Fjala e Allahut, sepse zbritja bëhet nga lart poshtë, kurse fjalët dalin vetëmse nga një folës.

“... ka mohuar atë që iu zbrit Muhamedit” për arsye se në Kuran, në atë që iu zbrit Muhamedit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), thuhet: “Thuaj: ‘Askush në qiej dhe në tokë nuk e di *gajb*-in (çështjet e mistershme) veç Allahut ...’ (Neml, 65). Kjo është nga format më të forta të kufizimit, sepse përmban mohim dhe pohim. Pra, ai që e

beson falltarin për çështjet që janë mister për njeriun, duke e ditur se ato i di vetëm Allahu, është qafir, i dalë nga feja. E nëse ai nuk e di dhe nuk mendon se në Kuran ka gënjeshtër, atëherë kufri i tij është i vogël, që nuk të nxjerr nga feja.

Katërshja e transmetuesëve¹ dhe Hakimi, me kushtet e saktësisë të Buhariut dhe Muslimit, përcjellin nga Ebu Hurejra: “Kush shkon te një parashikues i gjërave të fshehta ose te falltarët dhe u besojnë fjalëve të tyre, ka mohuar atë që iu zbrit Muhamedit.”²

Ebu Ja’la transmeton nga Ibn Mesudi, me sened të mirë, një hadith të ngjashëm, por *meukuf*³.

– “*Katërshja e transmetuesëve ...*” – Katërshja është Ebu Daudi, Nesaiu, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe. Hakimi nuk është ndër përpiluesit e “*Sunen-eve*”, megjithëse ka një libër të titulluar “*Sahih el Hakim*”.

– “*... me kushtet e saktësisë të Buhariut dhe Muslimit ...*” – Ky përcaktim është sipas mendimit të Hakimit, por mund të jetë edhe ndryshe.

– “*... Kush shkon te një parashikues i gjërave të fshehta ose te falltarët ...*” – Lidhëza “ose” mund të tregojë luhatje, por edhe variante të ndryshme. Në hadithin e parë përdoret fjala “*araf*”, në të dytin fjala “*kahin*”, ndërsa në këtë të tretin përdoren të dyja. Rrjedhimisht, lidhëza “ose” këtu tregon variante të ndryshme.

Edhe pse dy hadithe janë të mjaftueshëm, autori sjell një të tretë, sepse shumë fakte e dëshmi e përforcojnë një argument. Dikush të sjell një lajm dhe ti e beson atë; po të të vijë edhe një tjetër me të njëjtin lajm? Patjetër që do të të shtohet siguria dhe besimi. Për këtë arsye, Sheriati ka bërë dallim ndërmjet atij që sjell një dëshmitar dhe atij që sjell dy.

¹ Me katërshen janë për qëllim: Ebu Daudi, Nisaiu, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe.

² Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

³ *Meukuf* quhet hadithi ose thënia që i atribuohet një sahabi

Nga fjalët e autorit duket se hadithi i Ebu Hurejres është *meukuf*, sepse thotë: “nga Ebu Hurejra”. Mirëpo, përderisa për dëshminë vijuese thotë që është “*meukuf*”, ne anojmë se hadithi është *merfu*.

Nga Imran Ibn Husejni përcillet një hadith *merfu*: “Nuk është prej nesh ai që u beson shenjave ogurzeza ose kërkon nga dikush që t’i parashohë fatin, që bën fall ose që kërkon nga falltari që t’i bëjë fall, që bën magji ose që kërkon nga magjistari t’i bëjë magji. Kush shkon te falltari dhe beson çfarë thotë ai, ka mohuar atë që iu zbrit Muhamedit.”¹

– “... *Nuk është prej nesh ...*” – Është shtjelluar edhe më parë kjo shprehje. Ajo nuk tregon kategorikisht përjashtim nga Islami, por varet nga rrethanat konkrete.

– “... *ai që u beson shenjave ogurzeza ...*” – Kjo, tek arabët, e ka zanafillën te një praktikë besëtyte, që mbështetej nga drejtimi që merrnin shpendët e lëshuar në fluturim, prej të cilit arabët bëheshin pesimistë ose optimistë. Por njeriu, siç thamë më lart, duhet t’i mbështetet Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), përderisa e di se në punën që do të kryejë ka mirësi. Atëherë merr guxim dhe vepra, e mos u bëj pesimist nëse nuk ia del që në fillim. Sa njerëz nuk kanë pasur sukses herën e parë, por ia kanë dalë herën e dytë ose të tretë?

Thuhet se imam El Kisai, i pari në gramatikë arabe, i hyri studimit të kësaj fushe disa herë në fillim, por nuk pati sukses. Një ditë, ai pa një milingonë që, duke mbajtur një farë, ngjitej mbi një mur, por rrëzohej poshtë. Ajo u ngjit e u rrëzua disa herë, derisa në fund ia doli të hipte deri në majë. Atëherë tha: “Subhanallah! Kjo milingonë vuajti me këtë bërthamë, derisa ia doli mbanë. Edhe unë do të përpiqem me gramatikën, derisa t’ia dal.” E kështu, ai u bë i pari i Kufës në gramatikën e gjuhës arabe.

– “... *ose kërkon nga dikush që t’i parashohë fatin ...*” – Për

¹ El Bezzari me zinxhir të mirë. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

shembull, shkon te dikush e i thua: Nesër do të nisem për udhëtim, dhe meqë ti provon fatin me shpendë, dua që të hedhësh shpendin tënd për të parë se a do të jetë ky udhëtim i hajrit për mua apo jo. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është i distancuar nga kushdo që e vepron këtë.

Ndërsa fragmenti: “... ai që u beson shenjave ogurzeza ...”, përfshin ata që bëjnë të tilla gjëra si për veten e tyre, edhe për të tjerët.

– “... që bën fall ...” – Më parë kemi thënë se falltarë quhen ata që pretendojnë se parashikojnë të ardhmen, thotë do të ndodhë kështu e ashtu, e ndoshta mund të ndodhë ashtu. Në këto kohët e fundit është përhapur te njerëzit shprehja ‘tekehene’ – parashikoi, nga kjo fjalë rrjedh fjala ‘kahin’ – parashikues (falltarë). P.sh: parashikoi se do vijë filani. Pra ata këtë shprehje të ndaluar e përdorin për diçka të lejuar. Kjo gjë nuk duhet të ndodhë, sepse njerëzit e thjeshtë të cilët nuk dinë t’i dallojnë gjërat, mendojnë se çdo lloj parashikimi është i lejuar, duke sjellë si argument këtë shprehje që përdoret për diçka, lejimi i të cilës është i njohur.

– “... ose që kërkon nga falltari që t’i bëjë fall ...” – Pra, kërkon nga falltari që të parashikojë për të, si p.sh. t’i kërkojë falltarit t’i tregojë se çfarë do t’i ndodhë nesër ose në filan muaj apo në filan vit. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është i distancuar prej tij.

– “... që bën magji ...” – Përkufizimin e magjisë dhe llojet e saj i kemi dhënë më lart.

– “... ose që kërkon nga magjistari t’i bëjë magji ...” – E tillë është edhe prishja e një magjie me anë të magjisë. Format janë të ndryshme, për shembull, sjellin një gotë me ujë, në të cilën hedhin plumb. Te ky plumb formohet pastaj fytyra e atij që ka bërë magjinë. Njerëzit e thjeshtë tek ne e quajnë “derdhje plumbi”, por kjo është një nga format e ndaluara të magjisë. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është distancuar prej autorëve të saj.

Pjesa e hadithit që lidhet me çështjen tonë është: “Kush shkon te falltari dhe beson çfarë thotë ai ...” e deri në fund.

Taberani në *“El Eusat”*, me *sened* të mirë, përcjell hadithin e Ibn Abasit pa pjesën: “... kush i shkon ...” e deri në fund.

Megjithatë, ky transmetim është përforcues i të parit.

El Begavi thotë se *“araf”* është ai që pretendon se i di gjërat e fshehura, nëpërmjet disa veprimeve e mjeteve paraprake. Për shembull, gjen sendet e vjedhura, vendin e plaçkave të humbura etj. Shpjegim tjetër është se *‘araf’* quhet ai që lajmëron për të ardhmen. Thuhet gjithashtu se *‘araf’* quhet ai që tregon për gjërat që ke në mendje.

Ebu Abas Ibn Tejmije thotë se *‘araf’* është një term përfshirës, që nënkupton falltarët, astrologët etj., domethënë të gjithë ata që mëtojnë për njohjen e çështjeve të misterhme për njerëzit.

Ibn Abasi thotë për ata njerëz që, duke shikuar yjet, shkruajnë *“Eba xhad-in”*¹. “Nuk mendoj se ata që merren me këtë punë, kanë pjesë tek Allahu në botën tjetër.”²

Me sa duket nga përkufizimi i Begavit, kuptohet se ai përfshin pretenduesit për njohjen e të ardhmes dhe njohjen e të shkuarës, sepse vendi i sendit të vjedhur, për shembull, mësohet vetëm pas vjedhjes. Mirëpo në këtë çështje nuk ka ujdi mes dijetarëve. Për këtë arsye, autori – Allahu e mëshiroftë! – thotë: “Shpjegim tjetër është ...”.

– *“... Thuhet gjithashtu se ‘araf’ quhet ai që tregon për gjërat që ke në mendje. ...”* – Për shembull, të mendosh diçka e t’i kërkosh atij ta

¹ Me thënien e mësipërme Ibn Abasi ka për qëllim ata që shkruajnë geramat arabe (ebaxhad), duke menduar se kështu bëhet lidhja e ngjarjeve që ndodhin në tokë me lëvizjen e yjeve dhe lindjen ose perëndimin e tyre.

Ndërsa nëse shkruhen geramat arabe për llogaritjen e fjalive, informacionit, ose kohës, kjo nuk ka gjë.

² Bejhakui në *“Sunen el Kubra”*.

gjejë, dhe ai të tregojë se çfarë ke fshehur në mendje. Ndërsa për të ardhmen, për shembull, po t'i thuash se çfarë do të ndodhë në këtë muaj ose ditë, çfarë do të lindë gruaja ime ose kur do të kthehet im bir, ai këto nuk i di.

Si përfundim, themi se dijetarët kanë qëndrime të ndryshme në lidhje me përkufizimin e “*el araf-it*”.

– “... *Ebu Abas Ibn Tejmije* ...” – Emri i plotë është Ahmed Ibn Abdulhalim Ibn Abdusselam Ibn Tejmije. Ai është thirrur edhe Ebu Abas (babai i Abasit), por e vërteta është se ai nuk u martua kurrë, dhe këtë nuk e bëri se donte të bënte jetë murgu, por sepse ai – dhe Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) e di më mirë – ishte tepër i angazhuar me xhihadin dhe diturinë. Gjithashtu, epshi i tij ishte i dobët, se përndryshe do të qe martuar. Nuk është absolutisht e vërtetë ajo që thonë disa zëra, se ai ka pasur një djalë, i cili qenka varrosur në krah të tij në Damask.

Nga konteksti duket se autori nuk ka dhënë përkufizim të prerë për këtë, pasi shprehet me forma të tilla si: “Thuhet se ...”. Megjithatë, meqë ai sjell një mendim dhe nuk e kundërshton, kjo tregon se e ai e përkrah atë.

Më pas, shejhu i Islamit thotë se nëse termi “*araf*” konsiderohet si përfshirës i të gjitha llojeve të fallit, kjo bëhet sepse, nëse i krahason me njëri-tjetrin, del se thelbin e kanë të gjithë të përbashkët.

Shejhu i Islamit thekson se ka tri mënyra shfrytëzimi të xhindëve nga ana e njeriut:

a) Shfrytëzim në bindje ndaj Allahut, si në rastin kur xhindi bëhet përfaqësuesi i njeriut në përcjelljen e fesë. Kjo ndodh kur njeriu ka shok një xhind besimtar, i cili merr dije prej tij, dhe që xhindët mësojnë nga njerëzit është diçka e vërtetuar. Kur njeriu i shfrytëzon xhindët për përcjelljen e fesë te populli i tyre ose për ndihmë në çështje të nevojshme fetare, nuk ka asgjë të keqe, përkundrazi, mund të jetë një veprim i lavdëruar. Kjo është thirrje në rrugë të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Disa xhindë shkuan te Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), i cili u lexoi atyre Kuranin. Pas kësaj, ata u kthyen te populli i tyre si këshillues. Nga mesi i xhindëve ka të mirë, adhurues, asketë dhe dijetarë. Këshilluesi

duhet të ketë dituri për çka tërheq vërejtje, si dhe duhet të jetë i nënshtruar e i bindur ndaj Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) në këtë punë.

b) Shfrytëzimi i tyre për çështje të lejuara. Dijetari thotë se kjo lejohet, por kushti është që edhe mënyra e përdorimit të jetë e lejuar. Nëse mënyra e afrimit të ndihmës së tyre është haram, atëherë shfrytëzimi i tyre është haram. Për shembull, nëse xhindi e kushtëzon ndihmën e tij me prerjen e një kurbanit ose me një përkulje për të, kjo është e ndaluar.

Pastaj ai tregon një ngjarje me Omerin, i cili u vonua njëherë në rrugën e kthimit nga një udhëtim. Ebu Musa u shqetësua, por disa njerëz i thanë se një grua nga Medina kishte një xhind, dhe ai mund ta urdhëronte atë që ta dërgonte xhindin e saj për të kërkuar Omerin. Ashtu u bë. Xhindi shkoi dhe, kur u kthye, tha: “Prijësi i besimtarëve nuk ka asnjë problem. Ai është duke u bërë shenja deveve të zekatit në aksh vend.” Një shërbim i tillë është i lejuar.

c) Shfrytëzimi i tyre për punë të ndaluara, si për vjedhje të pasurisë, për frikësimin e njerëzve e të ngjashme me këto. Kjo është e ndaluar. Nëse mënyra me të cilën arrihet ky shfrytëzim përbën *shirk*, edhe shërbimi bëhet i tillë. Nëse mënyra nuk është formë idhujtarie, atëherë shfrytëzimi i tyre është mëkat, për shembull kur një xhind mëkatar do një njeri mëkatar, e kështu ata bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për mëkate. Ky është gjynah, por nuk e arrin gradën e idhujtarisë.

Pastaj shejhu thotë: “Nëse dikush pyet një xhind ose dikë tjetër që ia përcjell pyetjen xhindit, dhe i beson gjithçkaje që thotë, kjo është gjynah dhe kufër. Mënyra për mbrojtjen nga xhindët është leximi i ajetit Kursij. Kush e lexon atë në mbrëmje, vazhdon të ketë mbrojtjen e Allahut dhe nuk i afrohet atij shejtani, derisa të gdhijë, siç është përcjellë nga Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).”

– “... *Ibn Abasi thotë për ata njerëz që, duke shikuar yjet, shkruajnë “Eba xhad”-in ...*” – Domethënë ata në të njëjtën kohë shohin tek yjet dhe shkruajnë, duke menduar se ajo që shkruajnë ka lidhje me lëvizjen e yjeve. “Eba xhad-in” – Janë fjalët: *ebxhed heues hut’ti kelimun seafes karashet thekhadhe dadhaga ...* (pra, fjalë që përmbajnë shkronjat e gjuhës arabe).

Të mësuarit e “*eba xhad-it*” është dy llojesh:

a) Nxënie e lejuar, kur i mëson për llogaritjen e fjalive, e të tjera të ngjashme. Kjo nuk ka asgjë të keqe. Këto përdoren edhe sot, madje edhe nga dijetarët, të cilët me anë të këtyre shkronjave, fjalëve, apo fjalive llogarisin vitet, ditën e lindjes apo të vdekjes së njerëzve etj. Ibn Abasi nuk ka pasur për qëllim këtë lloj nxënie apo përdorimi.

b) Nxënie e ndaluar, kur shkrimi i “*eba xhad-it*” nënkupton lidhjen e ngjarjeve në tokë me lindjen, lëvizjen dhe perëndimin e yjeve. Këto ngjarje mund të jenë të përgjithshme, si thatësitat, sëmundjet, luftërat e të tjera, ose individuale, siç janë parashikime se dikush do të sëmuret, do të varfërohet, do të lumturohet, do të bëhet fatkeq e të tjera. Ata e bëjnë këtë, ndërkohë që nuk ka asnjë lidhje ndërmjet lëvizjeve të yjeve dhe ngjarjeve në tokë.

– “... nuk mendoj se ai që e vepron këtë, ka pjesë tek Allahu ...” – Nga fjalët e Ibn Abasit del se, sipas tij, kush e vepron këtë është qafir, sepse kush nuk ka pjesë tek Allahu është qafir. Askujt prej besimtarëve nuk i mohohet krejtësisht pjesa e botës tjetër. Nëse besimtari ka gjynahe, ndëshkohet sipas gjynaheve të tij, – ose Allahu i Lartësuar ia fal, – e më pas do të përfundojë te pjesa e vet, që do ta gjejë tek Allahu i Lartësuar.

Autori – Allahu e mëshiroftë! – nuk e ka sqaruar gjykimin për falltarët, për sa i përket ndëshkimit të tyre në këtë botë, pasi, nëse do t’i quajmë qafirë, atyre duhet t’u kërkohet që të pendohen; nëse nuk pendohen, atëherë duhet të ekzekutohen si qafirë. Nga ana tjetër, nëse nuk janë qafirë apo nëse ata nuk bëhen qafirë – sepse në këtë çështje nuk ka ujdi mes dijetarëve – kur magjia nuk arrin deri në kufër, përsëri është detyrë të ekzekutohen nga autoritetet, për shmangien e së keqes që ata sjellin.

Dënimet me vdekje nuk janë vetëm për kufrin, por për shumë vepra të tjera. Allahu i Lartësuar thotë: “Shpërblimi për ata që bëjnë luftë kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kryejnë mizori në tokë, është vetëm që ata të vriten, të kryqëzohen, t’u pritët njëra dorë dhe këmba tjetër (dora e djathtë dhe këmba e majtë) ose të dëbohen nga vendi i tyre ...” (Maide, 33). Nga çdokush që u prish njerëzve çështjet e fesë ose jetës së përditshme të tyre, kërkohet që të pendohet. Nëse pendohet, lihet i lirë, e nëse jo, dënohet me

vdekje, sidomos kur këto gjëra të çojnë deri në dalje nga Islami.

Studimi i yjeve bëhet për disa qëllime:

a) Për të shpjeguar dhe parashikuar ngjarjet që ndodhin në tokë. Kjo mënyrë është haram. Nëse beson se yjet janë përcaktuesit e fatit dhe çështjeve në këtë botë, ky është kufër që të nxjerr nga feja. Nëse beson se ata janë vetëm shkaktarë, ky është gjithashtu kufër, por nuk të nxjerr nga Islami, sipas thënies së të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) pas një shiu që ra natën: “A e dini çfarë tha Zoti juaj?” Të pranishmit u përgjigjën: “Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë.” Ai vazhdoi: “Ai tha: ‘Disa nga robërit e Mi këtë mëngjes u bënë besimtarë ndaj Meje dhe disa jobesimtarë. Kush tha: ‘Na erdhi shiu prej këtij ylli’, ai është jobesimtar ndaj Meje dhe besimtar ndaj yjeve. Kush tha: ‘Na erdhi shiu prej mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij’, ai është besimtar ndaj Meje dhe jobesimtar ndaj yjeve.’”

b) Për të përcaktuar stinët, sezonin e korrjes, mbjelljes etj. Kjo lejohet, sepse me anë të tyre ti ndihmohesh për gjërat e kësaj bote.

c) Për të njohur më mirë kohët e namazit, drejtimin e Kiblës etj. Ky lloj studimi është i ligjshëm, madje ndonjëherë mund të jetë farz kifaje (detyrë kolektive) ose farz ajn (detyrim individual).

Dobitë e temës

- Nuk mund të bashkohet besimi te falltari me besimin te Kurani.

Kjo sipas hadithit: “Kush shkon te falltari dhe beson çfarë thotë ai, ka mohuar atë që u zbrit Muhamedit.” Kjo, për arsye se ashtu mohohet Kurani, i cili është mohim më i madh.

- Deklarimi i qartë në hadithe se të besosh falltarët është kufër.

“... ka mohuar atë që u zbrit mbi Muhamedin.”

- Nxjerrja në pah e kërkuesit të fallit.

“Nuk është prej nesh ...”, që do të thotë se ai është si falltari, sa i përket distancimit të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) prej tij.

- Nxjerrja në pah e atij që kërkon të provojë fatin.

Marrë nga fragmenti: “... kërkon nga dikush që t’i parashohë fatin ...”.

- Nxjerrja në pah e kërkuesit të magjisë.

Kjo në fragmentin “... ose që kërkon nga magjistari t’i bëjë magji ...”. Autori ka renditur atë që kërkon t’i bëhet fall, atë që kërkon t’i bëhet magji dhe atë që kërkon të provojë fatin, se ndoshta dikush mund t’i kundërshtojnë këto, e të thotë se ato janë vetëm për falltarët e vetëm për magjistarët. Kush kërkon të tilla gjëra, ka të njëjtin ndëshkim me ata që i bëjnë ato.

- Gjykimi mbi nxënien e "*eba xhadit*" (semiotikës).

Siç u përmend më parë, për të dhënë një gjykim të saktë mbi mësimin "*eba xhad*"-it duhet shkoqitje: njeriu mund të lavdërohet ose të shahet për mësimin e tij në varësi të mënyrës sesi do ta përdorë.

- Dallimi ndërmjet termave "*el kahin*" (fattrëfytes) dhe "*el araf*" (parashikues i gjërave të fshehta).

Për këtë dallim ka mendime të ndryshme. Mendimi i parë është se "*el araf*" është njëlloj si "*el kahin*", domethënë janë sinonime që shënojnë atë që parasheh të ardhmen. Mendimi i dytë është se *el araf* quhet ai që di gjërat misterioze për njerëzit, për shembull sendet e vjedhura apo të humbura, me anë të disa metodave paraprake. Kështu, ky term është më përfshirës se "*el kahin*", sepse ai përfshin edhe parashikuesin e të ardhmes. Sipas mendimit të tretë, *el araf* quhet ai që tregon se çfarë çon në mendje, ndërsa *el*

kahin është parashikuesi i të ardhmes.

Tema 27

Argumentet që flasin për zgjidhjen e magjisë.

Zgjidhje e magjisë “*en nushreh*” nga ana gjuhësore do të thotë: “ndarje”, ndërsa në terminologjinë fetare do të thotë: zgjidhje, prishje e një magjie që i është bërë dikujt, sepse ai që prish magjinë, e heq, e largon, e ndan atë nga personi i prekur. Gjykimi i këtij veprimi shpjegohet nga vetë autori, mjaft qartë.

Sigurisht, prishja e një magjie, është një lloj mjekimi dhe kurimi për njeriun e prekur nga ajo. Prishja e saj me metoda të lejuara fetarisht dhe me nijetin për të kënaqur Allahun, ka mirësi dhe shpërblim tepër të madh, sepse magjia ndikon në trupin e të sëmurit, në mendjen e tij, në veten e tij. Të sëmurit i ngushtohet gjoksi, aq sa mund të qetësohet veç me ata që arrijnë ta bëjnë për vete. Ndonjëherë ajo kthehet edhe në sëmundje psikike.

Xhabiri (r.a.) tregon se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem) është pyetur për prishjen e magjisë, ai është përgjigjur se ajo është prej punëve të shejtanit. (Ahmedi me *sened* të mirë dhe Ebu Daudi, i cili thotë që Ahmedi është pyetur për të dhe ka thënë se Ibn Mesudi i urrente këto punë)¹.

– “... për prishjen e magjisë ...” – Është fjala për zgjidhjen e magjisë me metodat e xhahilijetit, të cilat janë:

¹ Transmeton Ahmedi dhe Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

a) Me anë të xhindëve, kur prishësi i magjisë ia arrin t'i përdorë ata vetëm duke bërë *shirk*. Kjo metodë është idhujtari. Por nëse përdorimi i xhindëve arrihet duke bërë ndonjë mëkat që nuk e arrin gradën e idhujtarisë, atëherë vepra merr gjykimin e atij mëkati.

b) Me anë të një magjie tjetër, si ilaçe, këndime, rukje, lidhje të nyjeve, fryrje etj. Këto gjithashtu trajtohen si magjia, siç u përmend më parë. Për shembull, disa njerëz vendosin mbi kokën e të sëmurit një gotë me ujë dhe brenda gotës derdhin plumb. Në plumb, sipas tyre, figurohet fytyra e magjistarit, dhe kështu ata gjejnë se kush e ka bërë magjinë. Njëherë, Imam Ahmedi – Allahu e mëshiroftë! – u pyet për prishjen e magjisë, dhe ai tha se disa e kanë lejuar. Pastaj i treguan se ata që prishnin magjinë mbushnin një gotë me ujë, në të cilën pastaj duket fytyra e magjistarit. Atëherë Imami shkundi dorën e tij dhe tha: “Nuk e di ç’është kjo, nuk e di!” Duket sikur ai – Allahu e mëshiroftë – nuk donte të futej në këtë çështje.

– “... prej punëve të shejtanit ...” – Domethënë është nga punët që i urdhëron dhe i frymëzon shejtani, pasi shejtani urdhëron dhe frymëzon për vepra të poshtra. Ky cilësim e bën të panevojshme të thuhet se vepra është haram, madje është më e rëndë, më e shëmtuar dhe më e neveritshme. Tregues se diçka është haram nuk është vetëm cilësimi “haram” ose shprehja “nuk lejohet”, por, për shembull, edhe kur tregohet se vepra ndëshkohet.

– “... Ahmedi, me sened të mirë, dhe Ebu Daudi...” – Senedi i Ebu Daudit tek Ahmedi është i lidhur, sepse ai ka jetuar në kohën e tij, madje ka folur me të.

– “... Ahmedi është pyetur për të dhe ka thënë se Ibn Mesudi i urrente këto punë.” – Imam Ahmedi (Allahu e mëshiroftë!) është përgjigjur me fjalët e sahabit. Duket sikur ai nuk ka pasur ndonjë dëshmi të saktë nga Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për këtë çështje, se përndryshe ai do të argumentohej me të.

Shprehja “i urrente këto punë” i referohet, me aq sa duket, çdo lloj zgjidhjeje magjie, edhe nëse bëhet me forma të lejuara, siç do të shtjellohet më poshtë, mirëpo nuk është kështu, sepse për zgjidhjen e magjisë me Kuran dhe lutjet e ligjshme askush nuk ka thënë se

është e urryer. Më parë është thënë se Ibn Mesudi urrente varjen e nuskave, qofshin ato me Kuran ose jo.

“... *i urrente* ...” – Urrejtja për brezat e parë të muslimanëve në përgjithësi, tregonte se vepra që e ndaluar, ku përjashtohet rastet të mirëargumentuara. Mos mendo se cilësimi “e urryer” në përkufizimet e brezave të mëvonshëm ka të njëjtin kuptim si për brezat e parë. Shih fjalën e Allahut: “Ndërsa Zoti yt ka porositur (dhënë urdhër) që të mos adhurosh askënd e asgjë veç Atij dhe që të jesh i përkushtuar ndaj prindërve të tu ...”. Pasi përmend gjërat e ndaluara thotë: “Të gjitha të këqijat janë të urryera te Zoti yt.” (Isra, 38). Nuk ka dyshim se cilësimi “të urryera” tregon se ato janë haram.

Në “*Sahih-un*” e Buhariut përcillet nga Katade: “E pyeta Ibn Musejebin për një burrë që kishte magji ose që nuk mund t’i afrohej bashkëshortes së tij: “A lejohet t’i prishet magjia?” U përgjigj: “Nuk ka gjë, sepse qëllimi i saj është rregullimi, dhe ajo që është e dobishme, nuk ndalohej.”¹

– “... *që nuk mund t’i afrohej bashkëshortes së tij* ...” – Kjo do të thotë se ai nuk mund të kryente marrëdhënie seksuale me të, pa pasur vetë asnjë problem shëndetësor. Kjo është një lloj magjie.

Ndër njerëz është përhapur një ide se, kur dikush lidh nyje në momentin që bëhet akti i martesës, burri nuk ka mundësi të kryejë marrëdhënie me bashkëshorten e tij. Disa e kanë tepruar duke thënë se mjafton që të lidhësh gishtat në atë moment, dhe ajo realizohet. Unë nuk di që të tilla ide të kenë ndonjë bazë, por e vërteta është se ndodh shpesh që burrat nuk mund t’u afrohen

¹ Disa dijetarë kanë menduar se ibën Musejebi këtu e lejon prishjen e magjisë me magji, pra nëse një njeri vuan nga magjia, lejohet të shkojë te një njeri që bën qoftë edhe magji për prishjen e magjisë (thënë ndryshe të shkojë te magjistari për të prishur magjinë). Por nuk është e qartë që ky ka qenë qëllimi i ibën Musejebit, pasi qëllimi i tij mund të ketë qenë, nëse një njeri prish magjinë (pra di të prishë magjinë) lejohet të shkosh përderisa nuk di se është magjistarë apo nuk është magjistarë. Mirëpo nëse e di me siguri që ai është magjistarë dhe prish magjinë duke bërë magji, diçka e tillë nuk mund të lejohet, sepse ai bën kufër. Atëherë si mund të shkosh te ai e të kërkosh diçka të tillë, por edhe nëse ibën Musejebi ka patur për qëllim prishjen e magjisë me magji pasi me këtë çlirohet dikush nga magjia. Kjo është e pa pranueshme, sepse hadithi i profetit është i qartë që kjo gjë është prej punëve të shejtanit.

bashkëshorteve të tyre, prandaj kërkojnë mjekim.

Disa dijetarë kanë thënë se ilaçi është ta ndash gruan, e pastaj ta rimarrësh, e kështu magjia zgjidhet. Edhe këtë nuk e di a është e saktë kjo apo jo. Nëse kjo është e saktë, atëherë një ndarje e tillë është e lejuar, sepse është ndarje për mbajtje, për shërim. Ne nuk japim fetva të tillë, përkundrazi, themi se nuk dimë gjë në lidhje me të.

– “... ose ...” – Ka mundësi që kjo të tregojë një dyshim të përcjellësit se si është shprehur realisht Katadja: “që kishte magji” apo “që nuk mund t’i afrohej bashkëshortes së tij”. Lidhëza “ose” tregon edhe variante të ndryshme, domethënë pyetja ka qenë për të dyja çështjet: për prekjen me magji dhe për pamundësinë e burrit që të kryejë marrëdhënie me gruan e vet.

– “... Nuk ka gjë, sepse qëllimi i saj është rregullimi ...” – Duket sikur Ibn Musejebi (Allahu e mëshiroftë!) e ka ndarë magjinë në dy lloje: të dëmshme dhe të dobishme. I dëmshëm është lloji haram: “Dhe ata mësuan atë që i dëmtonte dhe nuk u sillte përfitim ...” (Bekare, 102). Nga ana tjetër, e dobishme është lloji që mund të shfrytëzohet. Kështu duket nga fjala e tij.

Nga ky mendim janë nisur disa juristë të sotëm, që thonë se lejohet zgjidhja e magjisë me magji, për shkak të domosdoshmërisë. Ndërsa dijetarë të tjerë thonë se kjo nuk lejohet. Për qëndrimin e Ibn Musejebit, ata thonë se ai flet për rastin që nuk dihet në është magji apo jo. Nëse dihet që është magji, atëherë ajo nuk lejohet, dhe Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) është më i Ditur. Gjithsesi, edhe nëse Ibn Musejebi (Allahu e mëshiroftë!) apo edhe të tjerë që qëndrojnë më lart se ai, por që fjala e të cilëve nuk merret për argument fetar, mendojnë se ajo është e lejuar, kjo nuk do të thotë se Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) e ka lejuar, derisa të përballet me Kuranin dhe Sunetin.

Kështu Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është pyetur për zgjidhjen e magjisë (me metodat që bëhej në kohën paraislamike) dhe ai është përgjigjur: “Ajo është prej punëve të shejtanit.”

■ Nga Hasani është transmetuar se ka thënë: “Magjinë e

prish vetëm magjistari.”¹

Ky transmetim, nëse është i saktë, flet për zgjidhjen e njohur përgjithësisht, e cila realizohet vetëm nga magjistarët.

Ndërsa Ibn Kajimi thotë: “Prishja e magjisë bëhet me dy mënyra. E para është zgjidhja e magjisë me magji, por është prej punëve të shejtanit.” Ky është edhe kuptimi i fjalës së Hasanit. Në këtë rast zgjidhësi i magjisë dhe ai për të cilin bëhet zgjidhja i afrohen shejtanit, duke vepruar atë që ai dëshiron, e atëherë shejtani e largon ndikimin e tij nga i prekuri prej magjisë. Mënyra e dytë është prishja e magjisë me këndime (Kurani), me kërkim mbrojtjeje nga Allahu, me ilaçe dhe lutje të lejuara. Kjo mënyrë është e lejuar.”

Fjala e Ibn Kajimit është e plotë dhe tepër e qartë, prandaj dhe nuk ka nevojë për komente të mëtejshme.

Dobitë e temës

- Ndalimi i prishjes së magjisë me magji ose me anë të shejtanëve.

Kjo mësohet nga hadithi: “Ajo është prej punëve të shejtanit.” Këtu nuk shprehet hapur ndalimi, por format e ndalimit janë disa, si, për shembull, qortimi i ashpër i një vepre etj.

- Sqarimi i dallimit ndërmjet formës së ndaluar dhe asaj të lejuar, në atë mënyrë që largon paqartësitë.

¹ Ai nuk ka patur qëllim që magjia nuk priset duke lexuar kuran e duke bërë lutje e dhikër por qëllimi i tij ka qenë që magjinë me magji e prish vetëm një magjistarë.

Siç u bë nga Ibn Kajimi.

Pyetje: Si mund të harmonizohet qëndrimi i disave se zgjidhja e magjisë me magji lejohet dhe se ekzekutimi i magjistarëve është detyrë?

Përgjigje: Kur flasin për ekzekutim, ata nënkuptojnë magjistarët që bëjnë dëm me magjinë e tyre, jo ata që bëjnë dobi, të cilët nuk duhet të dënohen me vdekje, sipas tyre. Gjithashtu, ata mund të flasin për këtë zgjidhje, duke pasur parasysh domosdoshmërinë e saj, ndërsa magjistari ka gjykim tjetër, më vete. Allahu është më i Dituri.

Tema 28

Argumentet që flasin për pesimizmin besëtytnor¹.

¹Pesimizmi besëtytnor është parandjenja e së keqes nga shenjat ogurzeza i cili ndryshe quhet dhe supersticion. Në gjuhën popullore mjaft gjëra të tilla quhen “*llafe plakash*”. Këto besime të kota janë shumë të përhapura tek njerëzit e vendit tonë, sepse kur mungon besimi i saktë në një Zot, njerëzit e plotësojnë boshllëkun shpirtëror me besëtytni. Sa për shembull po përmend disa besëtytni: shfaqja e korbave të zinj ndjell keq; lehja e qenit në formë ulërimë drejtuar një ndërtesë, ose qëndrimi i bufit në çatinë e ndonjë shtëpie ndjell vdekje; klithma e kukuvajkës paralajmëron vdekjen; kruajtja e hundës paralajmëron sherr; dridhja e syrit ose zhurma e veshit paralajmërojnë fatkeqësi; udhëtimi ditën e martë del ters; thyerja e pasqyrës sjell shtatë vjet ters; macja e zezë që të pret rrugën paralajmëron ters; nëse lepuri të pret rrugën, nuk të ecën mbarë; kur të del përpara njeriu i një fisi të caktuar atë ditë nuk të ecën mbarë; nëse dikush është duke folur dhe ndërkohë një tjetër teshtin, kjo tregon se po thotë të vërtetën; nëse dikush është duke folur dhe ndërkohë tjetrit i bën zhurmë veshi, kjo do të thotë se po thotë të vërtetën; puthja e lekut sjell mbarësi; kur fillon një tregti ose kur fillon punën në mëngjes, nëse fërkon fytyrën ose mallin me lekun e parë që fiton të ecën mbarë; puthja e bukës dhe fërkimi i syve me të, ose madhërimi i saj duke mos shkelur thërrimet në mënyrë kategorike nga besimi i kotë se thërrimet kanë shenjtëri; kur të derdhet kripa apo qumështi do të të ndodhë diçka e keqe, ose do të mungojë një ushqim në shtëpi; besimi i kotë se natën nuk bën të qepësh, nuk bën të fshishë shtëpinë, nuk bën të lash, nuk bën të shihesh në pasqyrë, nuk bën të presësh thonjtë etj.; besimi në ditë të caktuara, në filan ditë nuk bën të bësh këtë, në filan ditë nuk bën të bësh atë; besime të kota që lidhen me martesën si: hedhja e orizit kur del nusja nga shtëpia, spërkatja e rrugës me raki para nuses, hedhja e vezës; martesë ndërmjet dy bajrameve nuk është me fat; fatkeqësia në ditën e martesës tregon ters etj.; në rast vdekjeje, disa therin kurban që të kalojë xhenazja mbi të, ose therin një pulë të zezë dhe kokën e pulës ia vendosin xhenazes në arkivol; besimi i kotë se kur shkon për ngushëllim në një familje nuk bën të shkosh për vizitë në një shtëpi tjetër pa u kthyer në shtëpinë tënde, sepse ju ndjell vdekje; besimi se lënia e gërshtëre ose e çadrës hapur sjellin grindje në shtëpi; besimi se gruaja nuk duhet t’ia japë gërshtëret me dorën e saj të shoqit sepse kjo është tregues për ndërprerjen e lidhjeve mes tyre, por nëse ia kërkon, ajo duhet t’i vendosë në një tabaka dhe ai duhet t’i marrë vetë; parandjenja e fatkeqësisë nga dëgjimi i disa emrave ose shikimi i njerëzve me mangësi fizike; parandjenja e fatkeqësisë nga disa muaj apo ditë, parandjenja e fatkeqësisë nga disa numra; parashikimi i fatit me anë të leximit të fillimit të ajeteve: kur lexon ajete kërcënimi, bëhet pesimist, kur lexon ajete mëshire, bëhet optimist; pesimizmi nga ndonjë fatkeqësi që i bie, se ajo do ta shkatërrojë e se nuk ka shërim a shpëtim pas saj; veshja e rrobave të zeza paralajmëron për ndodhjen e një fatkeqësie; prezenca e fluturës

Et tetajur (pesimizëm besëtytnor) rrjedh nga fjala “*tajr*” – shpend, sepse arabët parashikonin fatin me anë të shpendëve. Ata lëshonin një zog, e pastaj shihnin nga do të shkonte: djathtas apo majtas. Nëse shpendi shkonte djathtas, ata e vazhdonin punën për të cilën ishin nisur, e nëse ndodhte e kundërta, hiqni dorë nga ajo.

Në terminologjinë fetare, ky term shënon pesimizmin që lind prej disa gjërave që shihen, që dëgjoen. Ky është një rast i rrallë, kur kuptimi terminologjik është më i gjerë se ai etimologjik, sepse zakonisht kuptimi i parë, i origjinës është më i ngushtë: për shembull, fjala “*salat*” (namaz) në etimologji do të thotë “lutje”, por në terminologji ajo ka kuptim më të kufizuar se lutje. Po kështu mund të themi edhe për fjalën “*zekat*” etj.

Prej disa gjërave që shihen: për shembull, të shohësh një shpend të vetmuar dhe, për këtë shkak, të bëhesh pesimist. Që dëgjoen: për shembull, dëgjon dikë që thotë: “O i dështuar!” dhe bëhesh pesimist. Prej disa koncepteve të njohura: për shembull, kur bëhesh pesimist prej disa ditëve, muajve ose viteve, të cilat janë gjëra që as shihen e as dëgjoen.

Pesimizmi besëtytnor bie ndesh me monoteizmin në dy aspekte:

Së pari, besimi tek oguret e këqija ndërpresin mbështetjen tek Allahu, sepse rrjedh nga mbështetja në diçka tjetër veç Tij.

Së dyti, ai është lidhur me gjëra joreale, me imagjinatën. E ç’lidhje ka ndërmjet ogureve dhe ngjarjeve?

S’ka dyshim se pesimizmi besëtytnor e prish monoteizmin, sepse ky i fundit është adhurim dhe kërkim ndihme vetëm ndaj Allahut. Në Kuran thuhet: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje kërkojmë ndihmë.” (Fatiha, 4); “... Lutju Atij dhe mbështetu tek Ai ...” (Hudë, 123).

Njeriu që bie në pesimizëm besëtytnor nuk mund t’u shmanget njërës prej dy gjendjeve të mëposhtme:

së zezë në shtëpi tregon se aty ka ardhur një shpirtë; trokitja në dru kur dëgjon për një gjë të mirë me qëllim që e mira të mos ndryshojë; kur prek fytyrën, duhet t’i frysh dorës pasi kjo mund të sjellë daljen e gushës.

Por çfarë gjykimi ka besimi në shenjat ogurzeza?

Nëse njeriu beson se oguri e bën ose e krijon të keqen vetë, ka bërë *shirk* të madh. Nëse beson se oguri është thjesht shkak, bën *shirk* të vogël.

1- Ose do të ndërpresë tërësisht atë punë që ka nisur, dhe ky është ndikimi më i madh i pesimizmit;

2- ose do ta vazhdojë punën, por me merak dhe brengë, nga ndikimi i ogureve. Kjo është më e lehtë.

Që të dyja tregojnë mangësi në teuhid dhe janë të dëmshme për njeriun, i cili, në të kundërt, duhet të vazhdojë i çlirët për ku dëshiron, me mbështetje tek Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) dhe pa menduar keq për Atë (Subhanehu ue Te'Ala).

Autori (Allahu e mëshiroftë!) ka përmendur dy ajete në këtë temë:

Ajeti 1. “Por jo! Vërtet, fati i zi i tyre u vinte prej Allahut, ndonëse shumica e tyre nuk e dinin.” (Araf, 131)

– *“Por jo! Vërtet, fati i zi i tyre u vinte prej Allahut ...”* – Ky ajet ka zbritur për popullin e Musait, i cili, siç tregon Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): “... e kur i godiste ndonjë e keqe, atë e merrnin si ogur të zi që vinte për shkak të Musait dhe të atyre që ishin me të ...”. Atëherë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) ua ktheu: “Por jo! Vërtet, fati i zi i tyre u vinte prej Allahut ...”.

Kuptimi i: “... e merrnin si ogur të zi që vinte për shkak të Musait dhe të atyre që ishin me të ...” është që ata, kur përballeshin me ndonjë provë, për shembull me thatësi, thonin se ajo vinte për shkak të Musait dhe shokëve të tij. Allahu i Lartësuar e zhvlerësoi këtë besim me ajetin: “Por jo! Vërtet, fati i zi i tyre u vinte prej Allahut...”. Ishte Ai që e caktoi atë dhe s’kishte lidhje me Musain dhe popullin e tij. E vërteta qe se Musai dhe populli i tij ishin shkak për bereqet dhe mirësi, por ata, Allahu na ruajtë, i gënjenin njerëzit e thjeshtë, duke u servitur të kundërtën e realitetit.

– *“... ndonëse shumica e tyre nuk e dinin.”* – Ata nuk e dinin se kishte një Krijues rregullator dhe që fatkeqësitë u vinin nga Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), e jo për shkak të Musait dhe popullit të tij.

Ajeti 2. “Ata thanë: ‘Fatkeqësia që ju ndollët, mund të vijë vetëm nga vetja juaj. Vallë, për shkak se u këshilluat, na kërcënoni?! Ju jeni një popull që kaloni çdo lloj kufiri.’” (Ja Sin, 19)

– “... *Fatkeqësia që ju ndollët, mund të vijë vetëm nga vetja juaj ...*” – Këtë e thanë të Dërguarit në një vendbanim, siç thuhet po në atë sure: “Përmendu atyre rastin e banorëve të qytetit, kur u shkuan të Dërguarit ...” (Ja Sin, 13). Por ai popull u kundërpërgjigj: “Ne parandiejmë fatkeqësi nga ju ...” (Ja Sin, 18). Pra: ne parandiejmë fatkeqësi nga ju dhe nuk shohim se ju po na orientoni në të mira, por në të këqija, në atë që është shkatërrimi ynë. Dhe të Dërguarit u përgjigjën: “Fatkeqësia që ju ndollët, mund të vijë vetëm nga vetja juaj.” Pra, ajo që ju ndodh juve, vjen nga vetë ju dhe punët tuaja; ju jeni shkak për to.

Nuk ka mospërputhje ndërmjet këtij ajeti dhe atij që autori citon më përpara, sepse i pari tregon se përcaktuesi është Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), ndërsa i dyti sqaron shkakun: që ishin ata. Në realitet, fati i keq lidhej me ta, sepse ishin pikërisht veprat e tyre ato që e bënë të detyrueshme diçka të tillë, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala): “Sikur banorët e atyre vendbanimeve të kishin besuar e të ishin frikësuar, Ne do të hapnim për ta begatitë nga qielli dhe toka, por ata përgënjeshtonin dhe ne i dënuam për atë çka ishin duke fituar.” (Araf, 94).

Nga këto dy ajete, mësohet se besimi te shenjat ogurzeza ka qenë i pranishëm tek arabët dhe në popuj të tjerë.

– “... *Vallë, për shkak se u këshilluat, na kërcënoni?! Ju jeni një popull që kaloni çdo lloj kufiri (musrifun).*” – Pra, fatkeqësitë nuk u vinin për shkak të Profetëve, por për shkak të teprimit me gjynahe. “*Musrifun*” quhen ata që teprojnë me gjynahe.

Nga Ebu Hurejra përcillet se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Nuk ka infektim (sëmundje ngjitëse¹), nuk ka pesimizëm besëtytnor, nuk ka kukuvajka ndjellakeqe, nuk ka ters në *sefer*”². Ndërsa te Muslimi

¹ Qëllimi i Pejgamberit është se sëmundjet ngjitëse nuk mund të kalojnë vetvetiu, pa caktimin e Allahut, siç besonin njerëzit në kohën e xhahilijetit. Kështu që Pejgamberi nuk e mohon infektimin me caktimin e Allahut.

² Buhariu

vazhdon: “Nuk ka ndikim nga yjet¹, nuk ka ndikim nga hijet”.

– “... *Nuk ka infektim ...*” – Ky është mohim i kategorisë në tërësi, i cili është më i përgjithshëm sesa mohimi i një lloji. Pra, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka mohuar kalimin e një sëmundjeje nga një trup në tjetrin. Sëmundjet që mund të përcillen janë si trupore, edhe shpirtërore, edhe morale. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka treguar se shoku i keq është si farkëtari, i cili ose do të të djegë rrobat, ose do të marrësh erën e keqe.² Shprehja “nuk ka infektim”, përfshin sëmundjet trupore dhe shpirtërore, edhe pse më qartë flitet për ato trupore.

– “... *nuk ka pesimizëm besëtytnor ...*” – Është shpjeguar më lart.

– “... *nuk ka kukuvajka ndjellakeqe ...*” – Arabët besonin se kur dikush vritej, kockat e tij bëheshin kukuvajkë dhe ajo fluturonte duke klithur, derisa të merrej haku i tij. Të tjerë besonin se ishte shpirti i vdekurit që kthehej në kukuvajkë.

Sipas një shpjegimi të dytë, flitet për një shpend tjetër, i cili kur këndonte pranë ndonjë shtëpie, paralajmëronte për vdekjen e të zotit të shtëpisë, ose këndonte në shenjë zie. Të gjitha këto janë padyshim besime të kota.

– “... *nuk ka ters në sefer. ...*” – Flitet për muajin hënor *sefer*. Arabët e shihnin atë si ters, sidomos për martesat. Thuhet gjithashtu se flitet për një sëmundje ngjitëse, që prek devetë. Sipas këtij interpretimi, kjo lidhet me pjesën e parë të hadithit: “Nuk ka infektim”.

Një shpjegim tjetër thotë që flitet për ndalimin e shtyrjes nga një muaj në një tjetër. Në kohën e xhahilijetit, nëse donin të bënin luftë në muajin *muharrem*, atëherë e shtynin shenjtërinë e muajit në

¹ Arabët e kohës së paditurisë paraislamike besonin se reshjet e shiut binin për shkak të yjeve që shfaqen gjatë cikleve të Hënës. Hëna ka njëzet e tetë cikle, ku në çdonjërin prej tyre lind ose perëndon një yll. Profeti (‘alejhis-salam) e hodhi poshtë këtë besim duke thënë se yjet nuk kanë ndikim për sa i përket rënies apo mosrënies së shiut.

² Buhariu.

sefer, për të cilën flet Allahu në Kuran: “Kështu, ata lejojnë atë që ka ndaluar Allahu ...” (Teube, 37). Por ky shpjegim është i dobët. Kjo mbështetet edhe nga fakti se hadithi vjen në kuadrin e besëtytnive. Më afër së vërtetës është se bëhet fjalë për muajin *sefer*, që do të thotë se nuk vijnë fatkeqësi prej këtij muaji. Muaji *sefer* është si të gjithë muajt e tjerë.

Mohimi i këtyre katër fenomeneve nuk tregon mohim të ekzistencës së tyre, sepse ato janë reale, por mohohet ndikimi i tyre, sepse ndikuesi është Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala). Ato që janë shkaqe të njohura, janë të sakta. Ndërsa ato që janë shkaqe iluzive, janë të kota. Kësisoj mohohet ndikimi i vetvetishëm nëse shkaku është i saktë dhe, mohohet qenia e tij si shkak nëse ai është i kotë.

Kështu, për sa i përket shprehjes: “nuk ka infektim”, themi se infektimi është real, që dëshmohet edhe nga hadithi: “Kush i ka devetë të sëmura, të mos i sjellë tek ai që i ka të shëndosha.” Pra, me qëllim që të mos infektohen. Ose nga hadithi tjetër: “Largohu nga lebrozi, siç largohesh nga luani.” Lebroza është një sëmundje e rëndë, e cila përhapet me shpejtësi dhe e shkatërron atë që prek, aq sa e kanë quajtur edhe murtajë. Urdhri për largim nga lebrozi, është që i shëndoshi të mos infektohet nga i sëmuri. Ky është pohim i

infektimit, por ndikimi i tij nuk është çështje e përfunduar, në atë mënyrë që ai të jetë shkaku veprues (pra, që të veproj në mënyrë të vetvetishme). Urdhri i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për largim, si dhe mos sjellja e të sëmurit te i shëndoshi, nënkupton largimin nga shkaqet dhe jo largimin nga ndikimi i tyre i vetvetishëm, sepse shkaqet nuk kanë ndikim të vetvetishëm. Mirëpo ne duhet t’u largohemi atyre shkaqeve që sjellin probleme, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala): “... mos e shkatërroni vetveten ...” (Bekare, 195) Nuk thuhet se Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka mohuar infektimin si dukuri, sepse kjo nuk përputhet me realitetin dhe me hadithet e tjera.

Kur Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha që nuk ka infektim, një burrë i tha: “O i Dërguari i Allahut, kur devetë janë të shëndosha, pa asnjë lloj sëmundje, nëse ndër to futet një deve me zgjebe, të gjitha i zë zgjebja.” Atëherë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i tha: “Po kush e infekton të parën?” Pra, është Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) Ai që e zbret sëmundjen tek e para, e cila

është pa infeksion. Po kështu, edhe përhapja e infeksionit bëhet me vullnetin e Allahut. Diçka mund të ketë shkaqe të njohura ose të panjohura. Rasti i parë i sëmundjes infektive nuk ka shkak tjetër të njohur, përveçse ajo ndodh me caktimin e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), kurse rastet e mëpasshme e kanë shkakun të njohur. Mirëpo sërish, nëse do Allahu, sëmundja nuk përhapet. Kështu, ka raste plot kur përhapet zgjebja dhe pastaj largohet, dhe disa deve shpëtojnë. Po kështu, ka pasur raste kur murtaja dhe kolera kanë prekur pjesë të një familjeje, të cilët kanë vdekur, dhe nuk ka prekur të tjerët, të cilët kanë shpëtuar. Prandaj njeriu duhet t’i mbështetet Allahut. Është transmetuar se, njëherë, te Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) shkoi një burrë me lebrozë. Ai e kapi burrin për dore dhe i tha: “Ha!”, nga ushqimi që po hante vetë¹. Për shkak të mbështetjes së fortë, ai u bë rezistent ndaj shkakut infektues.

Ky është një lloj harmonizimi shumë i mirë ndërmjet haditheve, edhe pse disa kanë pretenduar se kemi të bëjmë me shfuqizim të një hadithi. Sipas tyre, hadithi: “Nuk ka infeksion ...”, ka shfuqizuar hadithet: “Largohu nga lebrozi ...” dhe: “Kush i ka devetë të sëmura ...”. Disa të tjerë kanë mëtuar shfuqizimin e anasjelltë. Ndërkaq, e vërteta është që nuk ka pasur asnjë shfuqizim, sepse një kusht i shfuqizimit është pamundësia e harmonizimit të fakteve. Në të kundërt, nëse ekziston një mundësi e tillë, është detyrë t’i përmbahesh asaj, sepse harmonizimi përmban të dyja llojet e argumenteve, ndërsa shfuqizimi e përjashton njërin prej tyre. Në rastin tonë, edhe realiteti dëshmon se nuk ka shfuqizim.

Edhe për pjesën “nuk ka ters në sefer”, i renditëm tri mendimet dhe e treguam se cili qe më i sakti. Kohët nuk kanë ndikim në caktimin e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) dhe muaji *sefer* është si të gjithë muajt e tjerë, sa i përket përcaktimit të së mirës dhe së keqes. Disa njerëz, kur përfundojnë ndonjë punë në sefer, e shënojnë në kalendar, duke thënë se përfundoi në “seferin e mirë”. Ky është trajtim i bidatit me bidat, i injorancës me injorancë, sepse ai nuk është as muaj i mirë, as muaj i keq. Por kur themi për muajin *ramazan* se ai është muaji i mirësisë, me “mirësi” kuptojmë adhurimin. Nga ana tjetër, formulimi “muaji i madhërishëm i

¹ Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i dobët.

rexhebit” mbështetet në faktin se ai është nga muajt e shenjtë. Për të njëjtën arsye, disa selefë e kundërshtuan zakonin që, kur dëgjohej kënga e kukuvajkës, thuhej “hajër inshallah”. Nuk thuhet në këtë rast as “hajër” e as “sherr”, sepse ajo bën thjesht si gjithë shpendët e tjerë.

Mohimi i atyre katër gjërave (ndjellakeqe) nga Pejgamberi (sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem) thekson detyrën e mbështetjes së plotë tek Allahu. Muslimani nuk dobësohet përpara atyre ogureve. Në të kundërt, ka vetëm dy rrugë: ose t’u besojë atyre duke e vazhduar punën, ose të zbrapset tërësisht nga puna që ka nisur, por kështu ai i lidh veprat e veta pas diçkaje që nuk është e vërtetë dhe që nuk ka ndonjë bazë, e kjo është një lloj idhujtarie. Nëse ai nuk u beson dhe nuk u përgjigjet atyre, dhe vijon me punën e vet, por sërish në shpirt i mbetet njëfarë pikëllimi dhe frike, ai nuk duhet të dorëzohet, por duhet të mbështetet më fort tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala).

Disa njerëz hapin Kuranin për fat: nëse qëllonjë tek ajetet që flasin për Xhehenemin, thonë që është ters, e nëse janë ajete që flasin për Xhenetin, thonë se është shenjë e mirë. Kjo ngjan me veprimin e injorantëve, të cilët përdornin shigjetat për fat.

E rëndësishme është që të mos çosh kurrë nëpër mend gjëra të tilla. Nga e keqja të mbrojnë të gjitha ata faktorë që janë të njohur e të qartë. Gjërave të tjera, të cilat feja nuk i merr parasysh, ose që i mohon, mos u kushto rëndësi, por falëndero Allahun që të ruan nga të këqijat dhe thuaj: “O Zot, tek Ti mbështetemi!”.

– “... *Nuk ka ndikim nga yjet ...*” – Në arabisht është përmendur fjala *neu’*, që është njënjësi i fjalës “*enua*” ato janë ciklet e hënës. Hëna ka njëzet e tetë cikle, ku në çdonjërin prej tyre lind ose perëndon një yll. Disa yje quhen “*veriorë*”. Ato shfaqen në ditët e verës. Disa të tjerë quhen “*yje jugorë*”, që shfaqen në ditët dimërore. Allahu ka bërë që, zakonisht, në gadishullin Arabik shiu bie në ditët e dimrit, kurse në ditët e verës nuk ka shi.

Arabët e kohës së paditurisë paraislamike bëheshin pesimistë me yjet (ciklet e hënës), po kështu bëheshin optimistë. Ata thoshin për disa yje: ky yll është ters, i zi, ndërsa ky ylli tjetër është me fat dhe sjell të mira. Kur binte shi, thoshin se ai ra prej atij ylli, dhe nuk

thoshin se ra prej mirësisë dhe mëshirës së Allahut. Nuk ka dyshim se ky është kulmi i injorancës. A nuk kemi parë ne të njëjtin yll që të duket si në një vit me reshje ashtu edhe në një vit tjetër pa reshje? Sa e sa vite kalojnë pa rënë shi, edhe pse ka mjaft yje stinore. Përfundimisht, yjet nuk kanë ndikim. Kur themi se doli ky apo ai yll, është njësoj sikur themi “lindi dielli” apo “perëndoi dielli”. Yjet mund të shërbejnë për përcaktimin e kohës ose stinëve.

Në kohën tonë, reshjet lidhen me presionin atmosferik, ngritjen ose uljen e tij. Edhe pse këto mund të jenë shkaqe të vërteta, është detyrë të thuhet se shiu vjen si mëshirë dhe begati nga Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala). Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “A nuk e vëren ti se Allahu i shtyn retë ngadalë e pastaj i bashkon e i grumbullon njëra mbi tjetrën, derisa të shohësh shiun se si del prej tyre ...” (Nur, 43). “Allahu është Ai që dërgon erërat, që ato t'i lëvizin retë, pastaj i shpërndan ato në qiell si të dojë dhe i copëton ato pjesë-pjesë, e ti sheh shiun si bie prej tyre ...” (Rrum, 48). Lidhja e reshjeve vetëm me uljen e presionit atmosferik, i ngjan qëndrimeve të injorancës, të cilat e shmangin njeriun nga lidhja me Zotin e tij. Po, ulja e presionit atmosferik mund të jetë shkak për reshjet, por ajo nuk ka ndikim të vetvetishëm, prandaj ji i vëmendshëm.

– “... nuk ka ndikim nga hijet.” – Hije quhen ato që tmerrojnë njerëzit. Shejtanët u shfaqeshin ngjyra-ngjyra arabëve, duke futur tmerr dhe frikë në zemrat e tyre, aq sa kjo i pengonte të shkonin andej nga dëshironin. Nuk ka dyshim se kjo dukuri e dobëson mbështetjen tek Allahu. Shejtani është i përkushtuar në futjen e pikëllimit dhe frikës te njeriu. Allahu i Lartësuar thotë: “Bisedat e fshehta janë vetëm nga shejtani, me qëllim që t’u sjellë dhimbje dhe pikëllim besimtarëve, por ai nuk mund t’i dëmtojë ata aspak, por veçse me vullnetin e Allahut ...” (Muxhadele, 10).

Ajo çfarë ka mohuar Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është ndikimi i tyre. Pra, me mohimin e tyre nuk ka pasur për qëllim të tregonte se ato nuk ekzistonin. Njeriu sprovohet më tepër nga këto gjëra atëherë kur e ka zemrën të lidhur me to. E nëse është i mbështetur plotësisht tek Allahu, asgjë nuk ka për ta dëmtuar dhe penguar atë nga rruga që synon të shkojë.

Enesi (r.a.) rrëfen se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Nuk ka infektim, nuk ka shenja ogurzeza. Mua më pëlqen *oguri i mirë*.” E pyetën: “E ç’është *oguri i mirë*?” U përgjigj: “Është fjala e mirë.”¹

– “... *Nuk ka infektim, nuk ka pesimizëm besëtytnor* ...” – Këto janë shtjelluar më lart.

– “... *Mua më pëlqen oguri i mirë* ...” – “Më pëlqen” domethënë “më gëzon”. Ndërsa “oguri i mirë” është, siç e sqaron ai vetë, “fjala e mirë”.

Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i pëlqente fjala e mirë për shkak se ajo sjell gëzim te njeriu dhe e nxit atë të vazhdojë drejt synimit të tij. Kjo nuk është besëtytni, përkundrazi, sepse ajo nuk ndikon për keq, por i shton njeriut qetësinë, guximin dhe angazhimin në punë.

Nga kuptimi i drejtpërdrejtë i hadithit del se fjala e mirë duhet në çdo situatë. Ajo hap zemrën dhe bëhet shkak për shumë të mira, derisa e bën njeriun të radhitet ndër njerëzit me moral të lartë.

Në këtë hadith, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka bashkuar dy të ndaluara dhe një të pëlqyer. Të ndaluarat janë infeksioni (kalimi i sëmundjes nga i sëmuri tek i shëndoshi) dhe *tijeretu* (ndjenja e fatkeqësisë nga shenjat ogurzeza), kurse e dëshiruara është fjala e mirë. Kjo është prej mënyrës së shkëlqyer të mësimdhënies së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Prandaj, kush përmend të padëshiruarën, duhet të përmendë bashkë me të edhe atë që është e dëshiruar. Kurani është i tillë, që kur përmenden cilësi të jobesimtarëve, përmenden edhe cilësitë e besimtarëve; kur përmendet dënimi, përmendet edhe shpërblimi, etj.

Ebu Daudi përcjell nga Ukbe Ibn Amër, me zinxhir transmetimi të saktë, se dikush përmendi pesimizmin besëtytnor te Profeti. Atëherë ai tha: “*Më të mira janë shenjat optimiste. Oguret që ngjallin pesimizëm nuk duhet*

¹ Buhariu, Muslimi.

ta zmbropsin muslimanin. Nëse ndonjëri nga ju sheh diçka pesimiste, le të thotë: “O Allah, nuk i sjell të mirat askush veç Teje dhe nuk i largon të këqijat askush veç Teje; s'mund të ketë ndryshim të gjendjes e as fuqi për të vepruar pa ndihmën Tënde”. – Allahumme la je'ti bil hasenati il-la ente ue la jedfeus sejiati il-la ente ue la haule ue la kuvete il-la bike.¹

– “... dikush përmendi pesimizmin besëtytnor te Profeti...” – Domethënë u përmend çështja në fjalë ose fakti se gjendej te njerëzit.

– “... Më të mira janë shenjat optimiste ...” – Shenjat optimiste nuk janë si shenjat pesimiste, megjithëse kanë të përbashkët ndikimin e tyre te njeriu. Shenjat pesimiste e dobësojnë mbështetjen e tij tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) dhe e zmbropsin atë nga angazhimet e veta. Ndërsa shenjat optimiste i shtojnë njeriut fuqinë e qëndresën dhe e bëjnë atë më aktiv.

– “... Oguret që ngjallin pesimizëm nuk duhet ta zmbropsin muslimanin ...” – Nga kjo kuptohet se kush zmbropset prej ogureve të këqija, nuk është musliman.

– “... Nëse ndonjëri nga ju sheh diçka pesimiste ...” – Ajo gjë mund të ngjallë në zemër frikë për fatkeqësi, dhe kështu e largon njeriun nga synimet e veta, duke i humbur kurajën. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka treguar ilaçin për këtë, e ajo është lutja vijuese.

– “... O Allah, nuk i sjell të mirat askush veç Teje ...” – Kjo është mbështetja e vërtetë te Zoti. Togu: “Nuk i sjell të mirat askush veç Teje” do të thotë se askush tjetër, përveç Allahut të Vetëm e pa ortak, nuk i përcakton, nuk i krijon e nuk i sjell të mirat për njeriun. Kjo nuk mohon faktin se të mirat kanë shkaqet e tyre, por krijuesi i këtyre shkaqeve është sërish Allahu. Nëse këto të mira

¹ Ebu Daudi dhe Bejhakui. Sipas Albanit hadithi është i dobët.

vijnë me shkaqet që ka krijuar Ai, atëherë Allahu është dhënësi i vërtetë i tyre.

“E mirë” është çdo gjë që njeriu e miraton dhe që kënaqet. Këtu hyjnë të mirat e fesë, si: namazi, zekati etj., të cilat e kënaqin besimtarin më shumë se çdo gjë tjetër, por hyjnë edhe të mirat e dynjasë, si: pasuria, fëmijët etj. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Nëse ty të vjen ndonjë e mirë, ata hidhërohen; nëse të godet ndonjë e keqe, ata thonë: ‘Sa mirë që i morëm masat që më parë.’ dhe largohen të gëzuar.” (Teube, 50). Në një ajet tjetër thotë: “Nëse ju vjen ndonjë e mirë, ata i brengos e, nëse ju gjen ndonjë e keqe, ata gëzohen ...” (Ali Imran, 120).

– “... nuk i largon të këqijat askush veç Teje ...” – “Të këqija” janë ato gjëra që e mërzhisin njeriun, si në të tashmen, po ashtu edhe në të ardhmen. Ato i largon veçse Allahu, prandaj, kur njeriut i bie ndonjë fatkeqësi, ai duhet t’i kthehet Zotit të tij. Edhe idhujtarët, kur rrezikonin të mbyteshin me anije, lusnin vetëm Allahun.

Kjo nuk mohon faktin se largimi i të këqijave mund të bëhet me anë të disa shkaqeve. Për shembull, nëse sheh dikë duke u mbytur dhe ti shkon dhe e shpëton, e ke shpëtuar me dëshirën e Allahut. Sikur të dëshironte Allahu, nuk do të mund ta shpëtoje, pra shkaku është prej Allahut.

Besimi i çdo muslimani është se askush tjetër, përveç Allahut, nuk i sjell të mirat dhe nuk i largon të këqijat. Ky besim bën që muslimani të mos i kërkojë të mirat dhe as të mos kërkojë shmangien e të këqijave nga askush tjetër, por vetëm nga Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala). Për këtë arsye, Profetët (lavdërimi i Allahut dhe paqja e Tij qoftë mbi ta!) e kërkonin sjelljen e të mirave dhe shmangien e të këqijave vetëm nga Allahu i Lartësuar. Allahu i Lartësuar citon Zekerian: “Zoti im! Dhurorë nga ana Jote një pasardhës të mirë.” (Ali Imran, 38). Po kështu, Ejubin: “(Kujtoje) Ejubin, kur ai iu lut Zotit të vet: ‘Mua më ka goditur fatkeqësia e Ti je Mëshiruesi i mëshiruesve.’ (Enbija, 83). I tillë duhet të jetë edhe besimtari.

– “... s’mund të ketë ndryshim të gjendjes e as fuqi për të vepruar pa ndihmën Tënde ...” – Kjo ka dy shpjegime:

Së pari, s'mund të bëhet asnjë lëvizje dhe s'ka fuqi për asgjë, veçse me vullnetin e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), ndërsa të tjerët nuk kanë mundësi e as fuqi. Kështu mohohet mundësia dhe fuqia nga dikush tjetër veç Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Këtu bëhet fjalë për mundësinë dhe fuqinë absolute, sepse edhe të tjerë veç Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) kanë mundësi dhe fuqi, por ajo është e varur, nuk është absolute.

Së dyti, ne nuk kemi mundësi dhe as fuqi ndryshe, veçse me ndihmën e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Ky shpjegim është më i saktë, sepse ne nuk mund të kalojmë nga një gjendje në një tjetër dhe nuk kemi fuqi për këtë ndryshe, por vetëm se me ndihmën e Allahut. Kjo shprehje shfaq mbështetjen e plotë tek Allahu dhe pohimin se njeriu ka mundësi dhe fuqi për të ndryshuar diçka vetëm në atë masë të mundësisë dhe fuqisë që i ka dhënë Allahu.

Nëse hadithi është i saktë, atëherë ne duhet ta bëjmë atë lutje që na ka mësuar Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) kur shikojmë diçka që nuk na pëlqen.

Nga Ibn Mesudi rrëfëhet se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Pesimizmi besëtytnor është prej shirkut. Pesimizmi besëtytnor është prej shirkut. Nuk ka asnjë prej nesh që nuk bie në parandjenjë të keqe, por Allahu ia largon me mbështetje”. (Tirmidhiu e ka quajtur të saktë, ndërsa fjalia e fundit është e Ibn Mesudit.)¹

– “... *Pesimizmi besëtytnor është prej shirk-ut ...*” – Domethënë është prej formave të idhujtarisë.

A është për qëllim këtu *shirk*-u i madh, që të nxjerr nga feja, apo është një shfaqje e *shirk*-ut? Përgjigjemi se është një shfaqje e *shirk*-ut, sepse nuk thuhet që është *shirk*, siç ndodh me hadithin tjetër: “Dy shfaqje ndër njerëz janë prej kufrit ...”. Pra, nuk janë kufër i plotë, që të nxjerrin nga feja.

Ndërsa për sa i përket lënies së namazit, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Ndërmjet njeriut, shirkut dhe kufrit, është lënia e namazit.” Këtu është përdorur “kufrit” (*el kufri*), në

¹ Ahmedi, Ebu Daudi dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

trajtë të shquar, që tregon se është kufër që të nxjerr nga feja. Nëse është në trajtë të pashquar, flet për një lloj kufri që nuk të nxjerr nga feja.

Nëse parandien fatkeqësi prej diçkaje që e shikon ose e dëgjon, nuk konsiderohesh idhujtar, por shfaq një cilësi të idhujtarisë, sepse je mbështetur mbi një “shkak” që Allahu nuk e ka bërë të tillë. Kjo dobëson mbështetjen tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala). Ka një rregull në fe, i cili thotë: Çdo njeri që mbështetet mbi një shkak që feja nuk e ka bërë të tillë, ai është “idhujtar”, që ka bërë idhujtari të vogël. Kjo lloj idhujtarie bëhet ose në rrafshin e fesë, kur shkakua është fetar, ose në rrafshin e *kaderit*,¹ kur shkakua është i krijuar. Mirëpo nëse një besëtytë (person që bëhet pesimist me anë të shenjave ogurzeza) beson se oguri vepron me vetveten e tij, pa ndërhyrjen e Allahut, atëherë ai është mushrik, që ka bërë idhujtari të madhe, sepse ka bërë diçka si ortak me Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala) në krijim.

– “... Nuk ka asnjë prej nesh që nuk bie në pesimizëm besëtytnor ...” – Pra, nuk ka asnjë prej nesh që shpëton nga parandjenja e fatkeqësisë prej shenjave ogurzeza, por Allahu e largon këtë ndjenjë me anë të mbështetjes së vërtetë vetëm tek Allahu. Nuk mjafton vetëm mbështetja e vërtetë, por duhet patjetër të kesh siguri tek Allahu, sepse Ai thotë: “Kush i mbështetet Allahut, Ai i mjafton atij ...” (Talak, 3).

– “... fjalia e fundit është e Ibn Mesudit.” – Flitet për fjalinë: “Nuk ka asnjë prej nesh ...” e deri në fund. Ky është hadith *mudrexh* (me ndërfitje), që do të thotë se njëri nga transmetuesit e tij fut fjalë nga vetja e tij, pa e sqaruar se cilat fjalë janë të tijat. Kjo mund të ndodhë në *sened*, por mund të jetë edhe në tekstin e hadithit. Në të shumtën e rasteve ndodh në tekstin e hadithit. Kjo shtesë mund të jetë në fillim, mund të jetë në mes, por mund të jetë edhe në fund të tekstit, gjë që ndodh më shpesh.

Shembull kur shtesa është në fillim të hadithit, është hadithi i Ebu Hurejrës (r.a.): “Plotësojeni avdesin! Mjerë për ata që nuk i

¹ Shkakua quhet *kaderij* kur efekti, pasoja apo ndikimi i tij mësohet nga përvoja, provimi ose eksperimentimi shkencor.

lajnë mirë thembrat e këmbëve.” (Buhariu). Fjalja “Plotësojeni abdesin!” është futur nga Ebu Hurejra, ndërsa fjalja tjetër i përket të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Shembull kur shtesa është në mes është hadithi i Zuhriut, që flet për fillesat e Shpalljes hyjnore: “I Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ‘bënte *tehanuth*’ në shpellën Hira, - ‘*tehanuth*’ do të thotë: adhurim.”¹ Kështu, Zuhriu ka ndërftuar në rrëfim saqrimin se fjala *tehanuth* do të thotë: adhurim.

Shembull kur shtesa ndodhet në fund është, përveç atij që citohet këtu, edhe një hadith tjetër nga Ebu Hurejra, kur ky shton: “Kush ka mundësi të zgjasë dritën, le ta bëjë.”

Ahmedi sjell hadithin e Ibn Amrit: “Cilindo që zbrapset nga nevojat e veta për shkak të ogureve të zeza, ka bërë *shirk*. I thanë: “Cila është shlyerja e tij?” Ai u përgjigj: “Të thuash: ‘O Allah! E mira është vetëm në dorën Tënde dhe vjen vetëm prej Teje! Nuk ndodh veçse ajo e keqe që është caktuar nga Ty! Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë, veç Teje!”²

– “... ka bërë *shirk* ...” – Nëse beson se oguri nga i cili ai parandien fatkeqësi e bën ose e krijon të keqen vetë, ka bërë *shirk* të madh. Nëse beson se oguri është thjesht shkak, bën *shirk* të vogël.

– “... Cila është shlyerja e tij? ...” – Pra, cila është shlyerja e këtij *shirk*-u, ose cili është ilaçi që e largon atë. Shlyerja mund të bëhet pasi mëkati është kryer, por mund të bëhet edhe para se të kryhet.

– “...E mira është vetëm në dorën Tënde dhe vjen vetëm prej Teje!...” – Pra, Ti je Ai që ke në dorën mirësitë e drejtpërdrejta, siç janë shiu dhe bimët, po ashtu edhe mirësitë e tërthorta, siç janë ato që vijnë prej Allahut nëpërmjet një krijese, që Ai e bën shkaktar, për shembull dikush që të jep sadaka, dhuratë, etj. Pra, e mira vjen tërësisht nga Allahu, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi.

¹ Buhariu.

² Ahmedi. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

– “...Nuk ndodh veçse ajo e keqe që është caktuar nga Ty!...” – Të gjithë shpendët janë nën Sundimin Tënd. Ata vetë nuk mund të bëjnë asgjë, por vetëm u është dhënë mundësia të fluturojnë lirshëm në qiell: “A nuk i shohin ata shpendët mbi kokat e tyre se si i hapin dhe i mbledhin krahët? Askush nuk i mban ata përveçse të Gjithëmëshirëshmit ...” (Mulk, 19); “A nuk e shohin ata se si shpendët fluturojnë pa mundim në hapësirën qiellore? Askush nuk i mban ata (në fluturim), veçse Allahu. Vërtet që këtu ka tregues të qartë për popullin që beson.” (Nahl, 79). Zogjtë fluturojnë pa mundim me lejen e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) është Ai që i përgatit, i lëviz dhe i drejton të shkojnë majtas dhe djathtas. Ata nuk kanë asnjë lidhje me ngjarjet që i ndodhin njeriut.

Por fjala “ogur” mund të jetë për çdo gjë që quhet “ogur i keq”. Pra, çdo shenjë e tillë është nga Allahu, ashtu siç është edhe e mira: “Por jo! Vërtetë që fati i zi i tyre u vinte prej Allahut ...” (A’raf, 131).

Më përpara kemi thënë se e keqja nuk gjendet në veprimet e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), por te krijesat e Tij (që është pasojë e krijimit të tij), sepse të gjitha veprimet e Allahut janë mirësi. Ato, ose janë mirësi në vetvete, ose janë shkak për një dobi dhe mirësi më të madhe. Kështu: “...s’ka ogur të zi nga shpendët, përveç atij që vjen nga Ti ...” qëndron krahas: “... s’ka të mirë përveç të mirës Sate ...”.

– “... dhe nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Teje.” – Dikush mund të thotë që ka edhe të adhuruar të tjerë veç Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), siç thuhet në Kuran: “... kurse të adhuruarit e tyre, të cilëve ata u luteshin në vend të Allahut, nuk u sollën ndonjë dobi...” (Hud, 101). Përgjigjja është se ata, edhe pse janë adhuruar përveç Allahut, nuk janë të adhuruar të vërtetë, sepse ata nuk meritojnë të adhurohen. Prandaj themi: Nuk ka të adhuruar me të drejtë veç Allahut.

Dobitë e hadithit:

- Nuk lejohet që njeriu të zbrapsset nga shenjat “ogurzeza”; ai duhet të mbështetet tek Allahu dhe të mos u kushtojë rëndësi atyre.

- Besimi tek oguret e zeza është një lloj shirku.
- Kujt i lind në zemër ndonjë parandjenjë për fatkeqësi nga shenja të ndryshme, por që nuk zbrapset nga puna që ka nisur, ajo parandjenjë nuk e dëmton atë, siç u sqarua në hadithin e Ibn Mesudit.
 - Gjithçka është në dorën e Allahut, si e mira, ashtu edhe e keqja.
 - Njësimi i Allahut në adhurim, ashtu siç është Ai i Vetëm në krijim dhe në rregullimin e çështjeve të krijesave.

Po nga Ahmedi përcillet hadithi i Fadl Ibn Abasit: “*Me të vërtetë, besëtytni është ajo që të bën të vazhdosh ose të kthehesh mbrapsht*”¹

– “... *besëtytni është ...*” – Besëtytni është vetëm ajo që të bën të vazhdosh ose të kthehesh mbrapsht, e jo njëfarë parandjenje që lind në zemër, por që nuk ndikon tek ti. Nuk ka dyshim se nëse nuk ke as parandjenja të tilla, është akoma më mirë.

– “... *është ajo që të bën të vazhdosh ose të kthehesh mbrapsht.*” – Zbrapsjen sigurisht që e sjell besimi te shenjat ogurzeza, kurse shtysën për të vazhduar mund ta japë njëri nga dy shkaqet:

1. Besimi tek oguri i keq. Kjo ndodh, për shembull, me lëshimin e shpendit në fluturim, për të parë se ç’drejtim do marrë: nëse ai fluturon djathtas, quhet fat i mbarë, prandaj njeriu merr kurajë ta vazhdojë punën. Një njeri i tillë pa dyshim që beson edhe te shenja e kundërt, e keqe.

2. Një fjalë që dëgjon ose diçka që sheh, e cila tregon për lehtësimin e punës. Ky është optimizmi, që i pëlqente Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), por nëse njeriu mbështetet plotësisht në dukuri të tilla, duke i bërë shkaqe për t’iu futur punës, atëherë ato trajtohen njëlloj si besëtytnitë. Nëse ai nuk bazohet tek ato, por thjesht kënaqet, bëhet më aktiv dhe shton energjitë në kërkimin e tij, ky është veprim i lavdëruar.

Për *sened*-in e hadithit ka mendime të ndryshme, por nëse do ta

¹ Ahmedi. Sipas Abdul Kadir Arnautit hadithi ka dobësi dhe ndërprerje në senedin e tij.

konsiderojmë të saktë, ky do të ishte gjykimi që del prej tij.

| **Dobitë e temës**

- Tërheqja e vëmendjes për ajetet: “Por jo! Me të vërtetë që fati i zi i tyre u vinte prej Allahut ...” dhe “Fatkeqësia që ju ndollët, mund të vijë vetëm nga vetja juaj ...”.

Njeriu duhet të jetë i vëmendshëm, pasi nga kuptimi i drejtpërdrejtë i dy ajeteve duket sikur janë kontradiktorë. Mirëpo nuk është kështu, sepse Kurani dhe Suneti nuk janë kurrë kontradiktorë, por mospërputhjet mund të jenë vetëm në kokën e njeriut.

Më lart u sqarua se ajeti i parë do të thotë që përcaktuesi është vetëm Allahu, ndërsa ajeti i dytë tregon se cili është shkaku i fatkeqësisë.

- Mohimi i ngjitjes së sëmundjes pa caktimin e Allahut.

Qëllimi është mohimi i ndikimit të tij si shkak në vetvete, dhe jo thjesht si shkak, sepse Allahu (Subhanehu ue Te’Ala) i ka bërë disa sëmundje shkak për infektim.

- Mohimi i besëtytnive.

Domethënë i ndikimit të tyre dhe jo i ekzistencës së tyre.

- Mohimi i lidhjes së fatkeqësisë me “vajin” e kukuvajkës.

- Mohimi i fatit të keq për shkak të muajit *sefer*.

- Shenjat optimiste nuk hyjnë te besëtytnitë,

përkundrazi, janë të pëlqyeshme.

Pejgamberi ka thënë (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Mua më pëlqen shenja e mirë (*el fe’lu*)”, dhe çdo gjë që i ka pëlqyer të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është e mirë. Aishja (radijallahu anha!) ka thënë: “Të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i pëlqente të fillonte nga e djathta në mbathjen e këpucëve, në krehjen e flokëve (ose lyerjen e tyre), në pastrim dhe në çdo punë të tij.”¹

➤ Shpjegimi i fjalës ‘*el fe’lu*’ (optimizmi).

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tregoi se ajo është fjala e mirë, por ky qe një ilustrim prej tij, jo përkufizim, sepse ashtu quhet çdo gjë që e bën njeriun aktiv në vepra të lavdëruara, qoftë ajo fjalë, veprim që shikohet ose dëgjohet etj.

➤ Parandjenjat e këqija që lindin në zemër nga disa shenja, por që luftohen nga njeriu, nuk i bëjnë dëm atij; ato i largon Allahu, nëse i mbështetesh Atij.

➤ Lutjet që bëhen kur lindin në zemër parandjenja të këqija.

Ato janë përmendur më lart.

➤ Deklarimi se besimi tek oguret është formë idhujtarie.

Më lart u shpjegua mirë se kur është *shirk* i madh dhe kur është *shirk* i vogël.

➤ Shpjegimi i besëtytnisë.

¹ Buhariu, Muslimi.

Përmbajtja

| | |
|---|------------|
| DY FJALË NGA PËRKTHYESI | 3 |
| PARATHËNIE | I |
| TEMA 1 | 1 |
| THËNIA E ALLAHUT: "XHINDËT DHE NJERËZIT I KAM KRIJUAR VETËM QË TË MË ADHUROJNË." | 1 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 17 |
| TEMA 2 | 27 |
| VLERA E TEUHIDIT DHE GJYNAHET QË FSHIN REALIZIMI I TIJ NË JETË. | 27 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 45 |
| TEMA 3 | 51 |
| KUSH REALIZON TEUHIDIN, FUTET NË XHENET PA DHËNË LLOGARI. | 51 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 64 |
| TEMA 4 | 71 |
| RUAJTJA NGA IDHUJTARIA. | 71 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 80 |
| TEMA 5 | 83 |
| FTESA NË DËSHMINË LA ILAHE IL-L ALLAH. | 83 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 90 |
| TEMA 6 | 99 |
| KOMENTI I TEUHIDIT DHE I DËSHMISË: "NUK KA TË ADHURUAR TJETËR ME TË DREJTË PËRVEÇ ALLAHUT." | 99 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 106 |
| TEMA 7 | 111 |
| MBAJTJA E RRATHËVE, FIJEVE ETJ, PËR LARGIMIN E SË KEQES OSE PENGIMIN E SAJ, ËSHTË PJESE E SHIRKUT. | 111 |

| | |
|---|------------|
| <i>Dobitë e temës</i> | 117 |
| TEMA 8 | 123 |
| ARGUMENTET PËR RUKJET DHE TEMIME-T. | 123 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 132 |
| TEMA 9 | 137 |
| GJYKIMI I SHERIATIT PËR KËRKIMIN E BEREQETIT NËPËRMJET NJË PEME, NJË GURI E TË NGJASHME ME TO. | 137 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 147 |
| TEMA 10 | 157 |
| ARGUMENTET QË KANË ARDHUR LIDHUR ME THERJEN E KURBANIT JO PËR ALLAHUN E LARTËSUAR. | 157 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 166 |
| TEMA 11 | 173 |
| NUK LEJOHET KURBANI PËR ALLAHUN NË ATO VENDE KU BËHEN FLIJIME PËR TË TJERË. | 173 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 180 |
| TEMA 12 | 183 |
| ZOTIMI NË EMËR TË DIKUJT TJETËR VEÇ ALLAHUT ËSHTË POLITEIZËM. | 183 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 186 |
| TEMA 13 | 189 |
| KËRKIMI I MBROJTJES NGA DIKUSH APO DIÇKA TJETËR, VEÇ ALLAHUT TË LARTËSUAR, ËSHTË ELEMENT POLITEIZMI. | 189 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 193 |
| TEMA 14 | 197 |
| KËRKIMI I NDIHMËS APO LUTJA E TJETËRKUJT, VEÇ ALLAHUT, ËSHTË ELEMENT POLITEIZMI. | 197 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 212 |
| TEMA 15 | 217 |
| THËNIA E ALLAHUT: “A MOS VALLË ATA I VESHIN ATIJ SI ORTAKË IDHUJ, QË NUK MUND TË KRIJOJNË ASGJË, NDËRKOHË QË VETË JANË TË KRIJUAR, IDHUJ QË NUK MUND T’U JAPIN NDONJË NDIHMË ATYRE E AS VETEN NUK MUND TA NDIHMOJNË?!” (ARAF, 191-192) | 217 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 226 |
| TEMA 16 | 233 |
| THËNIA E ALLAHUT: “... KUR T’U HIQET FRIKA NGA ZEMRAT E TYRE, | |

| | |
|---|------------|
| ATA DO TË PYESIN NJËRI-TJETRIN: ‘ÇFARË THA ZOTI JUAJ?’ MELAIKET DO TË PËRGJIGJEN: ‘TË VËRTETËN! AI ËSHTË I LARTËSUAR DHE I MADHËRISHËM.’” (SEBE, 23) | 233 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 244 |
| TEMA 17 | 251 |
| NDËRMJETËSIMI TE ZOTI. | 251 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 263 |
| TEMA 18 | 267 |
| THËNIA E ALLAHUT: “VËRTET, TI NUK MUND TË UDHËZOSH KË TË DUASH”. | 267 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 271 |
| TEMA 19 | 279 |
| ARGUMENTET QË TREGOJNË SE SHKAKU I KUFRIT QË BËJNË BIJTË E ADEMIT DHE I LËNIES SË FESË NGA ANA E TYRE, ËSHTË TEJKALIMI I CAKUT NË LIDHJE ME NJERËZIT E MIRË. | 279 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 291 |
| TEMA 20 | 303 |
| ARGUMENTET QË FLASIN PËR RREPTËSINË NDAJ ADHURIMIT TË ALLAHUT PRANË VARREVE TË NJERËZVE TË MIRË. PO KUR ADHUROHEN VETË VARRET?! | 303 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 312 |
| TEMA 21 | 321 |
| ARGUMENTET PËR SHFAQJET EKSTREME NËPËR VARRET E NJERËZVE TË MIRË, DUKE I KTHYER ATA NË IDHUJ. | 321 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 330 |
| TEMA 22 | 333 |
| FAKTET TË CILAT DËSHMOJNË PËR MBROJTJEN QË MUSTAFAI (SAL- LALLAHU ‘ALEJHI UE SEL-LEM) I KA BËRË TEUHIDIT DHE MBYLLJES SË TË GJITHA RRUGËVE TË POLITEIZMIT. | 333 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 342 |
| TEMA 23 | 345 |
| ARGUMENTET SE NGA KY UMET DO TË KETË NJERËZ QË DO TË ADHUROJNË IDHUJT. | 345 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 365 |
| TEMA 24 | 371 |
| ARGUMENTET FETARE QË FLASIN PËR MAGJINË. | 371 |

| | |
|--|------------|
| <i>Dobitë e temës</i> | 384 |
| TEMA 25 | 387 |
| TRAJTESË E SHKURTËR MBI FORMAT E MAGJISË. | 387 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 395 |
| TEMA 26 | 397 |
| FALLTARËT DHE TË NGJASHMIT ME TA. | 397 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 408 |
| TEMA 27 | 411 |
| ARGUMENTET PËR ZGJIDHJEN E MAGJISË. | 411 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 414 |
| TEMA 28 | 417 |
| ARGUMENTET PËR PESIMIZMIN BESËTYTNOR. | 417 |
| <i>Dobitë e temës</i> | 430 |
| PËRMBAJTJA | 433 |